Dhiata e-Re

BKSH

BKSH

BKSH

DHIATA E-RE

e Zotit edhe Shpëtimtarit t'ënë

JISU KRISHT

Kthyerë prej Elinishtesë

Shqip

Ndë të folë Toskënisht

BKSH

MANASTIR

Shtypëshkronja «Bashkim' i Kombit»

1910

BKSH

Truveza
e libravet të Dhjatës' së-Re

Ungjilli pas Mattheut . . . . Faqe 1
Ungjilli „ Markut . . . . „ 97
Ungjilli „ Llukajt . . . . „ 159
Ungjilli „ Joanit . . . . „ 263
Punët' e Apostojvet . . . . „ 341
Karta e Apostollit Pavël mbë Romanëtë „ 444
„ e-Parë „ „ „ Korinthianëtë „ 486
„ e-Dytë „ „ „ Korinthianëtë „ 526
„ „ „ „ Gallatianëtë „ 553
„ „ „ „ Efesianëtë „ 566
„ „ „ „ Filippianëtë „ 580
„ „ „ „ Kolossianëtë „ 590
„ e-Parë „ „ „ Thessalonik. „ 599
„ e-Dytë „ „ „ Thessalonik. „ 608
„ e-Parë „ „ „ Timothenë „ 613
„ e-Dytë „ „ „ Timothenë „ 624
„ „ „ „ Titonë „ 632
„ „ „ „ Filimoninë „ 637
„ „ „ „ Ebrenjtë „ 639
Karta e-Përgjithëshme e Apostollit Jakov „ 670
„ e-Parë „ „ „ Pjetër „ 680
„ e-Dytë „ „ „ Pjetër „ 691
„ e-Parë „ „ „ Joan „ 699
„ e-Dytë „ „ „ Joan „ 709
„ e-Tretë „ „ „ Joan „ 711
Karta e-Përgjithëshme e Apostollit Judhë. „ 712
Sbulesa e Joan Theollogut. „ 715

BKSh

BKSH

Ungjilli pas Mattheut.

Krye 1.

1 Vivll' e gjeneallogis' së Jisu Krishtit, të
birit të Dhavidhit, të birit t' Avraamit.
2 Avraamit i lindi Isaaku; edhe Isaakut i
lindi Jakovi; edhe Jakovit i lindi Judha edhe
3 të vëllezërit' e ti; Edhe Judhësë i lindi Faresi
edhe Zaraj nga Thamara; edhe Faresit i lin-
4 di Esromi; edhe Esromit i lindi Arami; Edhe
Aramit i lindi Aminadhavi; edhe Aminadhavit
i lindi Naassoni; edhe Naassonit i lindi Sall-
5 moni; Edhe Sallmonit i lindi Voozi nga Ra-
hava; edhe Voozit i lindi Ovidhi nga Rutha;
6 edhe Ovidhit i lindi Jesseu; Edhe Jesseut i lin-
di Dhavidhi mbreti.
Edhe mbretit Dhavidh i lindi Sollomoni
7 nga *gruaja* e Uriut; Edhe Sollomonit i lindi
Rovoami; edhe Rovoamit i lindi Aviaj; edhe
8 Aviajt i lindi Asaj; Edhe Asajt i lindi Josafa-
ti; edhe Josafatit i lindi Jorami; edhe Joramit
9 i lindi Ozia; Edhe Ozisë i lindi Joathami; edhe
Joathamit i lindi Ahazi; edhe Ahazit i lindi E-
10 zeqia; Edhe Ezeqisë i lindi Manassiu; edhe
Manasiut i lindi Amoni; edhe Amonit i lin-

BKSH

11 di Josia; Edhe Josisë i lindi Jehonia edhe të
vëllezërit' e ti, mbë të-çpërgulurit të Babi-
llonësë.
12 Edhe pas të-çpërgulurit të Babillonë-
së, Jehonisë i lindi Sallathieli; edhe Salla-
13 thielit i lindi Zorobabeli; Edhe Zorobabelit
i lindi Aviudhi; edhe Aviudhit i lindi Eliaqi-
14 mi; edhe Eliaqimit i lindi Azori; Edhe Azo-
rit i lindi Saduku; edhe Sadukut i lindi Aqi-
15 mi; edhe Aqimit i lindi Eliudhi; Edhe Eliu-
dhit i lindi Eleazari; edhe Eleazarit i lindi
16 Matthani; edhe Matthanit i lindi Jakovi; Edhe
Jakovit i lindi Josifi, burr' i Marisë, prej së-
cilësë lindi Jisuj që thuhetë Krisht.
17 Gjithë brezatë pra që nga 'Avraami e
gjer mbë *ditët* të Dhavidhit *janë* katër-mbë-
dhjetë breza; edhe që nga Dhavidhi e gjer
mbë të-çpërgulurit të Babillonësë *janë* ka-
tër-mbë-dhjetë breza; edhe nga të-çpërgu-
lurit' e Babillonësë e gjer mbë *ditët* të Kri-
shtit *janë* katër-mbë-dhjetë breza.
18 Edhe të-lindurit' e Jisu Krishtit kështu
ka qënë; passi uvlua e ëm' e ati Maria me
Josifnë, përpara se të bashkoneshinë, ugjënt
me barrë nga Frym' e-Shënjtëruarë.
19 Edhe Josifi, burr' i asaj, dyke qënë i-
drejtë, e dyke mos dashurë t' i nxjerë asaj
20 zë të-lik, desh t' a lëshonjë fshehurazi. Po ay
tek po ishte dyke menduarë këto *punë* ja
nj' ëngjëll i Zotit tek i uduk nd' ëndërrë, dy-

BKSH

ke thënë, Josif, i bir' i Dhavidhit, mos ufri-
këso të marrç me vetëhe gruanë t' ënde Ma-
riamënë; sepse të-mbarsuritë që ubë tek ajo
21 është nga Frym' e-Shënjtëruarë, Edhe dotë
pjellë djalë edhe dot' j'a quanjç emërinë
Jisu; sepse ay dotë shpëtonjë llauzin' e ti
nga fajet' e atyre.
22 (Edhe gjithë këjo ubë, që të mbushe-
të e-thëna prej Zotit me anë të profitit, që
23 thotë, „Ja vërgjëresha tek dotë mbarsetë,
edhe dotë pjellë djalë, edhe dot' j'a qua-
njën' emërin' Emanuil" që e-kthyerë do me
thënë, Perëndia bashkë me ne.)
24 Edhe Josifi si uzgjua nga gjumi, bëri
sikundrë e urdhëroj ëngjëll' i Zotit, edhe mori
25 përanë vetëhesë gruan' e ti: Edhe nuk'e njohu
atë, gjersa bëri të birin' e saj të-parëlindu-
rinë; edhe j'a quajti emërinë **Jisu.**

Krye 2.

1 Edhe Jisuj si lindi ndë Vithleemë të Judhe-
së, ndë ditt të mbretit Irodh, ja *ca* magjish-
tarë nga të-lindurit' e djellit erthnë ndë Je-
2 rusalim, e thoshinë, Ku është mbret' i Ju-
dhenjvet që ka lindurë? sepse pam' yllin' e
ati ndë të-lindurit të djellit, e erthmë t' i fale-
3 mi. Edhe mbreti Irodh kur dëgjoj, undroth
4 edhe gjithë Jerusalimi bashkë me atë. Edhe
si mblodhi gjithë krye-priftërit' edhe shkronjë-
sit' e gjindjesë, pyeste të marrë vesh prej atyre,

5 ku lint Krishti. Edhe ata i thanë ati, Ndë Vi-
thlehemë të Judhesë; sepse kështu është
6 shkruarë me anë të profitit, „Edhe ti Vithle-
hemë, dheu i Judhesë, asfare nukë je m' e-vo-
gëla ndër zotërinjt të Judhesë; sepse prej teje
dotë dalë një i-parë, i-cili dotë kullosnjë
llauzinë t' im Israil."
7 Atëhere Irodhi thirri fshehurazi magjishta-
rëtë, e mori vesh mirë nga ata kohën' e yllit
8 që ishte dukurë; Edhe dyke dërguarë ata ndë
Vithlehemë, tha, Shkoni e vëshgoni mirë për
djalënë; edhe si t'a gjeni, të më epni zë, që të
9 vinj edhe unë e t' i falem ati. Edhe ata si
dëgjuanë mbretnë *vanë;* edhe ja ylli që kishinë
parë ndë të-lindurit të djellit tek shkonte për-
para atyre, gjersa erdhi e qëndroj sipër tek
10 ishte djali. Edhe *ata* kur panë yllinë, ugë-
11 zuanë gëzim të-math fort. Edhe si erthnë ndë
shtëpit, gjetnë djalënë bashkë me t' ëmën' e
ti Mari, edhe ranë mbë dhe e i ufalnë ati,
edhe si hapnë thesarët' e tyre, i prunë ati
12 dhurëti, ar e livan e smirnë. Edhe si udëf-
tye atyre nga Perëndia nd' ëndërrë të mos
kthenenë tek Irodhi, nga një tjatër' udhë
shkuanë ndë vëntt të tyre.
13 Edhe passi iknë ata, ja një ëngjëll' i Zotit
tek i duketë nd' ëndërrë Josifit, dyke thënë,
Ngreu e mer me vetëhe djalën' edhe t' ëmën'
e ati, edhe ikë ndë Egjyptë; edhe rri atje gjer
kur të të them tyj; sepse Irodhi dotë kërkonjë
djalënë që t'a prishnjë.

BKSH

14 Edhe ay ungrit, e mori me vetëhe djalën'
edhe t' ëmën' e ati natënë, edhe iku ndë E-
15 gjyptë; Edhe ndenji atje gjer mbë vdekëjet
të Irodhit; që të mbushetë e-thëna prej Zotit
me anë të profitit, që thotë: „Nga Egjypta
thirra t' im bir.“
16 Atëhere Irodhi, kur pa se ugënjye nga
magjishtarëtë, uzëmërua fort, edhe dërgoj e
vrau gjithë djemtë që ishinë ndë Vithlehemë,
e ndë për gjithë *sinoret* t' asaj, që mbë dy vjeç
e poshtë, si pas kohësë që kishte marrë vesh
17 mirë nga magjishtarëtë. Atëhere umbush ç'ë-
18 shtë thënë nga profiti Jeremi, që thotë: „Zë
udëgjua ndë Rama, vajë e të qarë e gjë-
më shumë; Rahilla qante djemt' e saj, edhe
nukë donte të ngushullonej, sepse nukë ja-
19 në.“ Edhe si vdjq Irodhi ja një ëngjëll' i Zotit
tek i duketë ndë ëndërrë Josifit ndë Egjyptë
20 e i thotë, Ngreu e merr me vetëhe djalën' e-
dhe t' ëmën' e ati, edhe ecë ndë dhet të I-
srailit; sepse vdiqnë ata që kërkonin jetën' e
21 djalit. Edhe ay ungrit e mori me vetëhe
djalën' edhe t' ëmën' e ati, edhe erdhi ndë
dhet të Israilit.
22 Po kur dëgjoj, se Arhellau mbretëron
ndë Judhet ndë vëntt të Irodhit t' et, pat fri-
kë të vejë atje; edhe si i udëftye ati nga
Perëndia nd' ëndërrë, iku nd' anët të Galilesë,
23 Edhe erdhi e ndënjti ndë një qytet që thu-
hetë Nazaret; që të mbushetë ç' është thënë
nga profitëritë, se Nazoreas dotë quhetë.

BKSH

Krye 3.

1 Edhe nd' ato dit vjen Joan Pagëzori
dyke lëçiturë ndë shkretëtirët të Judhesë, e
2 dyke thënë, Pendohuni; sepse uafërua mbre-
3 tëria e qiejvet. Sepse ky është ay që ufol
nga profiti Isai që thotë, „Zër' i ati që bër-
tet ndë shkretëtirët, Bëni gati udhën' e Zotit:
bëni rrugat' e ati të drejta".
4 Edhe Ioani vetë kishte të-veshurit' e
ti prej qimesh kamille, edhe bres të-lëkurtë
rreth mezit të ti; edhe ushqimi i ati ishte
karkalecë e mjalt' e-egrë.
5 Atëhere dilte jashtë tek ay Jerusalimi
edhe gjithë Judhea, edhe gjithë vëndi qark
6 Jordhanit; Edhe pagëzoneshinë ndë Jordhan
nga ay, dyke rrëfyerë fajet' e tyre.
7 Edhe kur pa se shumë nga Farisenjt' e
Sadduqenjtë po vinjënë ndë pagëzimt të ti,
u tha atyre, Të pjellë nepërkash, cili u dë-
fteu juve të ikëni nga zëmërimi që vjen?
8 Bëni pra pemë të-vjejtura për pendim;
9 Edhe mos shkoni ndër mënt të thoni më ve-
tëhenë t' uaj, Atë kemi Avraamnë; sepse po
u them juve, se Perëndia munt edhe nga
10 këta gurë t' i ngrerë djem Avraamit. E tashi
edhe sëpata rri përanë rrënjës' së drurëvet;
çdo dru pra që s' bën pemë të-mirë pritetë,
11 edhe hidhetë ndë zjar. Un' u pagëzonj juve
me ujë për pendim; po ay që vjen pas meje
është më i-fortë se unë, të-cilit nukë jam i-

zoti t' i mbanj këpucëtë; ay dot' u pagëzonjë
12 juve me frymë të-Shënjtëruar' e me zjar. Ay
ka lopatënë ndë dorët të ti, edhe dotë që-
ronjë lëmën' e ti, edhe dotë mbledhë grurin'
e ti ndë grunart, po kashtënë dot' a djegë
ndë zjar të-pashuarë.
13 Atëhere Jisuj vjen nga Galilea ndë Jor-
dhant te Joani, që të pagëzonetë prej ati.
14 Po Joani e ndalonte atë, dyke thënë, Unë
kam nevojë të pagëzonem prej teje, e ti vjen
15 tek unë? Edhe Jisuj upërgjeq e i tha, Le
tashi; sepse kështu gjan neve të mbushmë
ç' do drejtëri. Atëhere e le atë.
16 Edhe Jisuj si upagëzua për-një-herë dolli
nga ujët; edhe ja tek uhapnë qiejtë, edhe pa
Frymën' e Perëndisë dyke zbriturë possi pë-
17 llump, e dyke ardhurë mbi atë. Edhe ja një zë
nga qiejtë që thoshte, Ky është biri im i-da-
shurë. që e kam pëlqyerë.

Krye 4.

1 Atëhere Jisuj upru ndë shkretëtirët prej
2 Frymësë, që të ngitej prej djallit. Edhe si a-
gjëroj dy-zet dit e dy-zet net, pastaj i erdhi
3 uri. Edhe ay që nget erdhi tek ay e tha, Ndë
je i bir' i Perëndisë, thuaj të bënenë bukë
4 këta gurë. Po ay upërgjeq e tha, Është shkru-
arε, „Njeriu nukë dotë ronjë me bukë vetë-
më, po me çdo farë fjale që del nga goj' e Perën-
5 disë. „Atëhere djalli e merr me vetëhe ndë qy-
tett të-shënjtëruarë, edhe e vuri përmbi fle-

6 tëzët të hieroresë, edhe i thot' ati, Ndë je i
bir' I Perëndisë, hidhu poshtë; sepse është
shkruarë,“ Se dot' urdhëronjë ëngjëjt' e ti për
ty edhe dotë të ngrenë ty mbi duart, që të mos
7 përpjekç këmbënë t'ënde mbë gur.“ Jisuj i
tha ati, përsëri është shkruarë, „Të mos ngaç
8 Zotinë Perëndinë t' ënt.“ Përsëri djalli e merr
me vetëhe mbë një mal shumë të-lartë, e-
dhe i dëften gjithë mbretërit' e botësë edhe
9 lavdin' e atyre, e i thotë, Të gjitha këto dotë
10 t' i ap tyj, ndë rënç të më falesh. Atëhere Ji-
suj i thot' ati, Ikë *prej meje*, Satana; sepse
është shkrurë, „Zotit Perëndisë t' ënt dot' i
11 falesh, edhe vetëm ati do t' i lutesh.“ Atëhe-
re djalli e le atë; edhe ja ëngjëjtë tek erdhë
përanë e i shërbeninë.
12 Edhe Jisuj kur dëgjoj se Joani udha
13 ndër duar, iku ndë Galilet. Edhe si la Na-
zaretinë, erdhi e ndënji ndë Kapernaum që
është përanë detit, ndë sinoret të Zavûllonit
14 edhe të Nefthalinit, Që të mbushetë ç' është
15 thënë nga profiti Isai që thotë, „Dheu Zavu-
llon edhe dheu Nefthalim, mb' udhët të de-
16 tit përtej Jordhanit, Galilea e kombevet; Llau-
zi që rrintë nd' erësirë pa dritë të madhe, e-
dhe mb' ata që rrininë ndë vëntt e ndë hijet
17 të vdekjesë lindi dritë.“ Që atëhere Jisuj zu-
ri të lëçisnjë e të thotë, Pendohuni, sepse u-
afërua mbretëri' e qiejvet.
18 Edhe Jisuj tek ecënte përanë detit të

Galilesë, pa dy vëllezër, Simoninë, që thuhej
Pjetrë, edhe Andhrenë të vëllan' e ati dyke
hedhurë rrjetë ndë dett; sepse ishinë peshka-
19 tarë. Edhe u thot' atyre: Ejani prapa meje,
edhe dot' u bënj juve peshkatarë njerëzish.
20 Edhe ata për-një-herë lanë rrjetatë, e vanë
21 pas ati. Edhe si vate më tej, pa dy vëllezër
të-tjerë, Jakovinë të birin' e Zevedheut, edhe
Joaninë të vëllan' e ati, ndë lundrët bashkë
me Zevedhenë t' an' e tyre, dyke ndrequrë
22 rrjetat' e tyre, edhe i thiri ata. Edhe ata për-
një-herë lanë lundrën' e tyre, edhe vanë
pas ati.
23 Edhe Jisuj vinte përqark gjithë Galile-
së, dyke mësuarë ndëpër sinagogjit t' atyre,
edhe dyke lëçiturë ungjillin' e mbretërisë, e-
dhe dyke shëruarë çdo smundje e çdo
24 lëngatë ndë llaust. Edhe vate zër' i ati ndë-
për gjithë Syrinë, edhe bininë tek ay gjith'
ata që kishinë keq, të-përmbajturë prej çdo
farë smundjesh e mundimesh, edhe të-dja-
llosurë, e të-zënë nga lëngat' e hënësë, e u-
25 logë; edhe i shëroj ata. Edhe i vanë pas
shumë gjindje nga Galilea e nga Dhekapo-
li e nga Jerusalimi e nga Judhea, edhe *që*
përtej Jordhanit.

Krye 5.

1 Edhe ay kur pa gjindjené, hipi ndë malt,
edhe si ndënji, i erthnë péranë nxënësit' e ti.

BKSH

2 Edhe *atëhere* hapi gojën' e ti, e i mësonte
dyke thënë,
3 Lum të vobeqtë ndë shpirt; sepse e
atyre është mbretëri' e qiejvet.
4 Lum ata që bëjnë vajë; sepse ata do-
të ngushëllonenë.
5 Lum ata që janë të-butë; sepse ata do-
të trashëgonjënë dhenë.
6 Lum ata që kanë uri e et *për* drejtëri-
në; sepse ata dotë nginjenë.
7 Lum ata që janë të-përdëllyershim; se-
pse ata dotë përdëllenenë.
8 Lum ata që kanë zëmërë të-qëruarë;
sepse ata dotë shohënë Perëndinë.
9 Lum ata që bëjnë paqtim; sepse ata
dotë quhenë bij Perëndie.
10 Lum ata që ndiqenë për punë drejtërie;
sepse e atyreve është mbretëri' e qiejvet.
11 Të-lumurë jeni *ju*, kur t' u çpërndero-
njën' e t' u ndjekënë, e të thonë kundrë jush
çdo farë fjale të-keqe me të-rremë për punë
12 t' ime. Gëzohi e gazmohi, sepse paga juaj ë-
sht' e-shumë ndë qiejt; sepse kështu ndo-
qnë edhe profitëritë që kanë qënë përpara jush.
13 Ju jeni krip' e dheut; po ndë upri-
shtë kripa, me se dotë kripetë? as për fa-
rë gjëje s' vëjen më, përveç të hidhetë jashtë,
14 edhe të shkeletë nga njerëzitë. Ju jeni drit'
e botësë. Një qytet që është mbi mal nukë munt

BKSH

15 të fshihetë. As nukë ndesnjënë kandilinë, që
t'a vënë atë ndënë shinikt, po *e vënë* mbi
kandilert, edhe ndrit mbë gjith' ata që janë
16 ndë shtëpit. Kështu letë ndritnjë drita juaj
përpara njerëzvet, që të shohënë punëtë t'
uaj të-mira, e të lavdurojn' Atinë t' uaj që
është ndë qiejt.
17 Mos kujtoni se erdha të prish nomnë a
profitëritë; nuk' erdha të prish, po të mbush.
18 Sepse me të-vërtetë po u them juve, gjersa
të shkonjë qielli edhe dheu, një jotë a një
pikë nukë dotë shkonjë nga nomi, gjersa të
19 bënenë të-gjitha. Ay pra që të zgithnjë një
nga këto porosit' e vogëla, edhe të mësonjë
kështu njerëzitë, i-vogëlë dotë quhetë ndë
mbretërit të qiejvet; po ay që të bënjë e të
mësonjë, ky dotë quhetë i-math ndë mbre-
20 tërit të qiejvet. Sepse po u them juve, se ndë
mos tepëroftë drejtëria juaj më tepërë se *ajo*
e shkronjësvet edhe e Farisenjvet, nukë do-
të hyni ndë mbretërit të qiejvet.
21 Kini dëgjuarë së u është thënë të moçi-
mëvet, „Mos vraç," edhe ay që të vrasë dotë
22 jetë fajtuar ndë gjyqt. Po unë po u them juve,
se kushdo që zëmëronetë mbë kot kundrë vë-
llajt të ti, dotë jetë fajtuar ndëgjyqt; edhe ay
që t' i thotë të vëllat, Rraka, dotë jetë fajtuar
ndë bashkëndënjjet; edhe ay që t' i thotë, I-ma-
rrë, dote jetë fajtuar për ndë gjeenët të zja-
23 rit. Ndë prufsh pra dhurëtinë t' ënde ndë

theroret, edhe atje kujtonesh, se yt vëlla diç
24 ka kundrë teje, Ler' atje dhurëtinë t' ënde për-
para theroresë, edhe shko e paqtohu më për-
para me t' et vëlla, edhe atëhere si të vish
25 bjerë dhurëtinë t' ënde. Ndrequ shpejt me
kundrë-gjyqësinë t' ënt, gjersa të jesh mb'
udhë bashkë me atë; se mos të apë kun-
drë-gjuqësi ndë dorët të gjyqtarit edhe gjyq-
tari të ep ndë dorët të sherbëtorit, e hi-
26 dhesh ndë burg. Me të vërtetë po të them
tyj, Nukë dotë dalç andej, gjersa të pagu-
anjç asprën' e funçime.
27 Kini dëgjuarë se u është thënë (të moçimëvet),
28 „Mos kurvëronjç.“ Po unë po u them juve, se
kushdo që vë re grua me dëshërim, e ka kur-
29 vëruar' atë ndë zëmërët të ti. Edhe ndë të skan-
dalistë syri yt i-djathtë, nxir-e atë e hidhe prej
teje; sepse është më mirë për ty të humbasë një
nga copat' e trupit t' ënt, edhe të mos hidhetë
30 tërë trupi yt ndë gjeenët. Edhe ndë të skan-
dalistë dora jote e-djathtë, pre-e atë, edhe
hidhe prej teje, sepse është më mirë për ty të
humbasë një nga copat' e trupit t' ënt, edhe të
mos hidhetë tërë trupi yt ndë gjeenët.
31 Edhe është thënë, se ay që të lëshonjë gru-
32 an' e ti, let' i apë asaj kartën' e ndarjesë. Po
unë po u them juve, se ay që të lëshonjë gruan'
e ti, veç për fjalë kurvërie, e bën atë të kurvëro-
një; edhe ay që të marrë grua të ndarë kurvëron.
33 Përsëri kini dëgjuarë se u është thënë të moçi-

mëvet, Mos bënjç be mbë të rrem, po t' i apç
34 Zotit të-betuarat' e-tua. Po unë po u them
juve, të mos bëni be fare; as për qiellinë,
35 sepse është fron' i Perëndisë; As për dhenë;
sepse është vëndi që vë këmbet' e tia; as për Je-
rusalimnë, sepse është qytet i mbretit të-math;
36 As për kryetë t' ënt të mos bënjç be, sepse
nukë munt të bënjç një qime të-bardhë a të-
37 zezë. Po letë jetë fjala juaj, Po, po; Jo, jo;
sepse e-tepëra e këtyreve është nga i-ligu.
38 Kini dëgjuarë se është thënë „Sy ndë véntt
39 të syrit, edhe dhëmp ndë véntt të dhëmbit". Po
unë po u them juve, të mos i qëndroni kun-
drë të-ligut; po ay që të të bjerë tyj një shu-
plakë ndë nofullët t' ënde të-djathtë, kthe-i
40 ati edhe tjatrënë. Edhe ay që do të gjyko-
netë me ty, e të marrë këmishënë t' ënde,
41 lër'-i ati edhe rrobënë; Edhe ay që të marrë ty
42 angari një mil, ecë bashkë me atë dy. Ep-i
ati që lypen prej teje; edhe mos e kthe fa-
qenë mbë një anë prej ati që do të huhetë
prej teje.
43 Kini dëgjuarë se është thënë, "Të duash
të afërminë t' ënt", edhe t' i kesh mëri armi-
44 kut t' ënt. Po unë po u them juve. Doni ar-
miqtë t' uaj, bekoni ata që u mallëkonjënë
juve, bëni mirë atyre që u kanë mëri juve,
edhe fali për ata që u bëjnë keq e u ndje-
45 kënë juve; Që të bëhi bij Atit t' uaj që
është ndë qiejt, sepse ay bën djellin' e ti të
lintnjë mbi të-liq e mbi të-mirë, edhe lëshon

shinë mbi të-drejt' e mbi të-shtrëmbërë. Sepse
46 ndë daçi ata që u duanë juve, ç'far page
kini? a nukë bëjnë këtë edhe kumerqa-
47 rëtë? Edhe ndë përshëndofshi vetëmë vëlle-
zëritë t' uaj, ç' më tepërë bëni? a nukë bëjnë
48 kështu edhe kumerqarëtë? Bëhi pra ju të-so-
surë sikundrë Ati j-uaj që është ndë qiejt
ësht' i-sosurë.

Krye 6.

1 Shikoni të mos bëni eleimosinënë t'uaj për-
para njerëzet, që të shiheni nga ata; ndë mos,
nukë keni pagë përanë Atit t' uaj që është
2 ndë qiejt. Kur të bënjç pra eleimosinënë, mos
vërshëlënjç përpara teje, sikundrë bëjnë ipo-
kritëritë ndëpër sinagogjit e ndëpër udhët, që
të lavduronenë nga njerëzitë; me të vërtetë
po u them juve, se *ata* e kanë *marrë* pagën'
3 e tyre. Po ti kur të bënjç eleimosinënë, letë
mos e marrë vesh e-mëngjëra jote se ç' bën
4 e-djathta jote; Që të jetë eleimosina jote fshe-
hurazi; edhe yt' Atë që sheh fshehurazi, ay
dotë t'a çpaguanjë tyj faqeza.
5 Edhe kur të falesh, mos ij posi ipokri-
tëritë; sepse *ata* duanë të falenë dyke ndë-
njurë ndëpër sinago gjit e ndëpër çipet të rru-
gavet, që t' u dukenë njerëzet; me të-vërtetë
po u them juve se *ata* e kanë *marrë* pagën
6 e tyre. Po ti, kur të falesh, hyrë ndë dhomët

BKSH

t'ënde, edhe mbyλ derënë t'ënde, e i ufal
t' yt Et që është ndë të-fshehëtë: edhe yt Atë
që sheh fshehurazi, dotë t'a paguanjë tyj faqeza.
7 Edhe kur të faleni, mos thoni fjalë të-tepëra,
posi gjindarëtë; sepse pandehnjënë, se me
8 fjalët' e-shuma të tyre dotë dëgjonenë. Mos
u gjani pra atyre; sepse Ati juaj e di për
ç'gjë kini nevojë, para se të lypni juve prej ati.
9 Po ju faluni kështu:
Ati ynë që je ndë qiejt, ushënjtëroftë emëri
10 yt; Arthtë mbretëria jote; ubëftë dashurimi
11 yt, si ndë qiell, edhe mbë dhet; Bukënë t'ënë të-
12 përditëshmen' ep-na neve sot; Edhe fal-na
fajetë t' anë, sindëkur edhe neve u'a falimë
13 fajtorëvet t' anë; Edhe mos na shtjerë ndë
ngasje, po shpëto-na nga i-ligu; sepse jotja
është mbretëria e fuqia e lavdia ndë jetët *të
jetëvet;* Amin.
14 Sepse ndë u'a falçi njerëzvet fajet' e atyre,
15 dot u'a falnjë edhe juve Ati juaj qiellori. Po
ndë mos u'a falçi njerëzvet fajet' e atyre, as
Ati juaj nukë dotë falnjë fajetë t' uaj.
16 Edhe kur të agjëroni, mos bëhi të-vrërëtë,
posi ipokritëritë; sepse *ata* prishnjënë fytyrat' e
tyre, që të dukenë ndër njerëzit se agjëro-
njënë. Me të-vërtetë po u them juve, se *ata*
17 e kanë *marrë* pagën' e tyre. Po ti kur të agjë-
ronjç, lyej kryetë t' at, edhe laj fytyrënë t'ënde;
18 Që të mos dukesh ndë njerëzit se agjëron,
po tek yt Ate, që është ndë të-fshehëtë; edhe

BKSH

yt Atë që sheh fshehurazi, dotë t'a çpagu-
anjë tyj faqeza.
19 Mos mblithni thesarë për vetëhenë t' uaj
mbë dhet, ku krimbi edhe ndryshku i prish,
edhe ku vjedhësit rëmojn' edhe vjedhënë;
20 Po mblithni thesarë për vetëhenë t' uaj
ndë qiell, ku nuk' i prish as krimp as
ndryshk, edhe ku vjedhësitë nukë rëmojn' as
21 vjedhënë. Sepse tek është thesari juaj, atje
22 dotë jetë edhe zëmëra juaj. Kandil' i trupit
është syri; ndë qoftë pra se syri yt ësht' i-
kthjellëtë, gjithë trupi yt dotë jetë i-ndriçim;
23 Po ndë qoftë se syri yt ësht' i-lik, gjithë trupi
yt dotë jet' i-errëtë. Ndë qoftë pra se drita
që gjëndetë te ti esht' errësirë, errësira sa *e-
madhe dotë jetë?*
24 Asnjë s' munt t' u shërbenjë dy zotërinjve;
sepse a njërit dot'i ketë mëri, edhe tjatrinë
dot' a dojë; a njërit dot' i ngjitetë prapa, edhe
tjatërit dot'i kthenjë krahëtë. Nukë munt t' i
25 shërbeni Perëndisë edhe Mammonajt. Përan-
daj po u them juve, Mos mendohi për jetënë
t'uaj, ç' të hani a ç' të pini; as për trupinë
t' uaj ç' të vishni; a nuk' është jeta më *e-
nderçime* se ushqimi, edhe trupi se të-veshu-
26 ritë? Vështroni shpest' e qiellit, se nukë mbje-
llënë, as nukë korrnjënë, as nukë mbledhënë
ndë grunarë, edhe Ati juaj qiellori i ushqen;
27 a nukë ndani ju më tepërë se ata? Po cili
nga ju dyke pasurë kujdes munt të shtonjë

BKSH

28 një kut ndë shtatt të ti? Edhe ç' mendoni për
të-veshuritë? Vështroni lulet' e arësë, si rrite-
29 në; as mundonenë, as dredhënë. Po u them
juve, se as Sollomoni me gjithë lavdin' e ti
30 nukë qe vëshurë posi një nga këto. Po ndë
qoftë se barin' e arësë, që sot është, e ne-
sërë hidhetë ndë furrë, Perëndia e vesh kështu,
nukë *dot' u veshnjë* juve shumë më tepërë, o
31 besë-pakë? Mos mentohi pra dyke thënë, ç'
32 të hamë a ç' të pimë a ç' të veshimë? Sepse
gjithë këto i kërkojnë kombetë; sepse Ati
juaj qiellori e di, se keni nevojë për gjithë
33 këto. Po kërkoni më përpara mbretërin' e Pe-
rëndisë, edhe drejtërin' e ati; edhe këto të-gji-
34 tha dot' u shtonenë juve. Mos mendohi pra
për të-nesërmenë; sepse e-nesërmja dotë ketë
mendim për punët' e saja; mjaft *është* mbë
çdo ditë e-keqeja e saj.

Krye 7.

1 Mos gjykoni, që të mos gjykoneni;
2 Sepse me ç' farë gjyqi gjykoni, dotë gjyko-
neni; edhe me ç' farë matësi matni, dot' u
3 matetë *edhe* juve. Edhe përse shikon lë-
mishtenë që është ndë syt të t' yt vëllaj, edhe
tranë që është ndë syt t' ënt nuk' e ndjen?
4 A si dot' i thuash t' yt vëllaj, Letë nxjer lë-
mishtenë nga syri yt, edhe ja trari *tek është*
5 ndë syt t' ënt? Ipokrit, nxir më përpara tranë
nga syri yt, edhe atëhere dotë shohç mirë

të nxjerç lëmishtenë nga syri i t'yt vëllaj.
6 Mos u'a epni gjën'e shënjtëruarë qenvet; as mos hithni margaritarëtë t' uaj përpara derravet, semos i shkelnjën' ata [me këmbët' e tyre, edhe *pastaj* kthenen' e u çquenjën' *edhe* juve.
7 Lypni, edhe dot' u epetë juve; kërkoni
edhe dotë gjeni; trokollini, edhe dot' u ha-
8 petë juve; Sepse kushdo që lypën merr, edhe
ay që kërkon gjen, edhe ati që trokollin dot'
9 i hapetë. A cili ësht' ay njeri nga ju, i-cili,
10 ndë lyptë i biri bukë, dot' i apë ati gur? Edhe
11 ndë lyptë peshk, mos dot' i apë ati gjarpër? Ndë
qoftë pra se ju që jeni të-liq dini t' u epni
të-dhëna të mira bijvet t' uaj, sa më tepërë
Ati juaj që është ndë qiejt dot' u apë të-mira
12 atyre që lypëjnë nga ay? Gjithë sa të doni
pra t' u bëjnë juve njerëzitë, kështu bëni edhe
ju atyre; sepse ky është nomi edhe profitëritë.
13 Hyni ndëpër derët të-ngushtë; sepse e-gjerë
është dera, edhe e-hapët' udha që shpie ndë
humbjet, edhe shumë *veta* jan' ata që hujnë
14 ndëpër atë. Sepse e-ngushtë *është* dera, edhe
e-shtrënguar' *ësht'* udha që shpie ndë jetët,
edhe të-pakë jan' ata që e gjejn' atë.
15 Edhe ruhi nga profitërit' e-rrem, të-cilëtë
vijnë te ju me të-veshura dhënsh, po përbrënda
16 janë ujq që rrëmbenjënë. Nga pemët' e tyre
dot' i njihni ata; mos mbledhënë rrush nga
17 drizatë, a fiq nga murrizatë? Kështu çdo

BKSH

dru i-mirë bën pemë të-mira; po drur' i-do-
18 bëtë bën pemë të-liga. Drur' i-mirë s' munt të
bënjë pemë të-liga, as drur' i dobëtë të bënjë
19 pemë të-mira. Çdo dru që s' bën pemë të-
20 mirë pritetë e hidhetë ndë zjarr. Përandaj nga
21 pemët' e atyre dot' i njihni ata. Nukë dotë
hynjë ndë mbretërit të qiejvet kushdo që më
thotë, Zot, Zot; po ay që bën dashurimn' e
22 t' im Et që është ndë qiejt. Shumë *veta* dotë
më thonë nd' atë ditë, Zot, Zot, nukë profi-
tepsmë mb' emërit t' ënt, edhe mb' emërit t'
ënt nxuarmë djaj, edhe mb' emërit t' ënt bëmë
23 shumë çudira? Po atëhere dot' u rrëfenj atyre,
Se kurrë nuk' u kam njohurë juve; ikëni prej
meje ju që keni punuarë paudhërinë.
24 Kuhsdo pra që dëgjon këto fjalët' e mia,
edhe i bën ato, dot' a përgjanj atë me një
njeri të-mënçim që ndërtoj shtëpin' e ti mbi
25 shkëmpt; Edhe zbriti shiu, e erdhë lumënjtë,
e frynë erëratë, edhe upërpoqnë pas asaj shtë-
pie, po nuk' urrëzua; sepse ishte themelosurë
26 mbi shkëmpt. Po kushdo që dëgjon këto fja-
lët' e mia, edhe nuk' i bën, dot' i gjanjë një
njeriu të-marrë, që ndërtoj shtëpin' e ti mbi
27 rërët; edhe sbriti shiu, e erdhë lumënjtë, e
frynë erëratë, edhe upërpoqnë pas asaj shtë-
pie, edhe urrëzua; edhe të-rrëzuarit' e asaj
ishte të-math.
28 Edhe Jisuj kur mbaroj këto fjalë, gjindja
tmeroneshinë për mësimn' e ati. Sepse i më-

sonte ata si një që ka pushtet e jo si shkronjësitë.

Krye 8.

1 Edhe kur zbriti nga mali, i vanë prapa
shumë gjindje.
2 Edhe ja tek erdhi një i krromosur' e i ufal
ati, dyke thënë, Zot, ndë daç, munt të më
3 qëronjç. Edhe Jisuj ngjati dorëne, edhe e pre-
ku dyke thënë, Dua, qërohu. Edhe për-një-
4 herë i uqërua krroma. Edhe Jisuj i thot' ati,
Shiko mos i thuash ndonjëj; po shko e dëfte
vetëhenë t' ënde te prifti, edhe shpierë dhu-
rëtinë që ka urdhëruarë Moisiu për dësh-
mim mb' ata.
5 Edhe Jisuj kur hyri ndë Kapernaum, i
erdhi përanë një urdhër-qindës, dyke lutur'
6 ati, e dyke thënë, Zot, shërbëtori im dergjetë
7 ndë shtëpit ulok, e mundonetë keq. Edhe
Jisuj i thot' ati, Unë dotë vinj e dot'a shëronj.
8 Edhe urdhër-qindësi upërgjeq e tha, Zot, nukë
jam i-zoti të më hynjç ndënë strehët; po
thuaj vetëmë një fjalë, edhe shërbëtori im
9 dotë shëronetë. Sepse edhe unë jam një njeri
ndënë urdhërë, edhe kam ndënë vetëhenë t'
ime ushtëtarë; edhe i them këti, Shko, edhe
shkon; edhe tjatërit, Eja, edhe vjen; edhe shër-
10 bëtorit t'im, Bëj këtë, edhe e bën. Edhe Jisuj
kur dëgjoj uçudit, e u tha atyre që i vininë
prapa, Me të vërtetë u them juve, *se* as ndë

BKSH

11 Israilt nukë kam gjeturë kaqë besë. Edhe po
u them juve, se shumë dotë vijnë nga të-lin-
durit' e nga të-perënduarit' e *djellit*, edhe dotë
rrinë bashkë me Avraaminë e me Isaakunë
12 e me Jakovinë ndë mbretërit të qiejvet; Po
të bijt' e mbretërisë dotë hidhenë nd' errësi-
rët të-përjashtësme; atje dotë jetë të-qarët' e
13 të-kërcëllliturit' e dhëmbëvet. Edhe Jisuj i tha
urdhër-qindësit, Shko, edhe t' ubëftë sindëkur
besove. Edhe shërbëtor' i ati ushërua që mb'
atë herë.
14 Edhe Jisuj kur erdhi ndë shtëpit të Pje-
trit, pa të vjehërrën' e ati te po dergjej ndër
15 ethe. Edhe e zuri atë prej dore, edhe e lanë
ethetë; edhe *ajo* ungrit e u shërbente atyre.
16 Edhe si ungrys, i prun' ati shumë të-dja-
llosurë; edhe *ay* nxori frymat' *e ndyra* me
fjalë, edhe shëroj gjith' ata që kishinë keq;
17 Që të mbushetë ç' është thënë nga profiti
Isai, që thotë, „Ay mori smundjetë t' ona,
edhe mbajti lëngatatë *t' ona*.
18 Edhe Jisuj kur pa shumë gjindje rreth ve-
tëhes' së ti, urdhëroj që të shkojnë përtej.
19 Edhe një shkronjës uafërua e i tha ati,
Mësonjës, dotë vinj prapa teje kudo që të
20 veç. Edhe Jisuj i thot' ati, Dhelpëratë kanë
shtrofka, edhe shpest' e qiellit fole; po i bir'
i njeriut s' ka ku të pështetnjë kryetë.
21 Pastaj një tjatërë nga nxënësit' e ati i
thotë, Zot, lë-më përpara të vete të kllas ndë

22 varr t' im atë. Po Jisuj i tha ati, Eja pas meje,
edhe lërë të-vdekuritë të kllasënë ndë varr
të-vdekurit' e tyre.
Edhe kur hyri ndë lundrët, i vanë pas nxë-
24 nësit' e ati. Edhe ja tek ubë një tërmet i-math
ndë dett, kaqë sa po mbulonej lundra nga
25 valëtë; po ay flinte. Edhe nxënësit' e ati i
erthnë përanë edhe e ngritnë atë, dyke thënë,
26 Zot, shpëto-na, se po humbasëmë. Edhe ay
u thot' atyre, Përse jeni frikacarë, o besë-pakë?
Atëhere ungrit e qërtoj erërat' edhe detinë,
27 edhe ubë bunacë e-madhe. Edhe njerëzitë
çuditeshinë, e thoshinë, Ç' farë njeriu është
ky që edhe erërat' edhe deti e dëgjonjënë?
28 Edhe ay kur erdhi mb' anët të-përtejme,
ndë dhet të Gjergjesinëvet, i duallë përpara
dy të-djallosurë, që dilninë nga varretë, fort
të-egërë, kaqë sa s' munt të shkonte njeri
29 nga ajo udhë. Edhe ja tek bërtitnë dyke
thënë, Ç' *ke* me ne edhe ti, O Jisu, i bir' i Pe-
rëndisë? erdhe këtu përpara kohësë që të na
30 mundonjç? Edhe lark atyre ishte një tufë e-
31 madhe derrash dyke kulloturë. Edhe djajtë i
luteshin' ati, e i thoshinë, Ndë na nxjerç *që
këtej*, lë-na të shkojmë ndë tufët të derravet.
32 Edhe *ay* u tha atyre, Shkoni. Edhe ata duall-
në e shkuanë ndë tufët të derravet; edhe ja
gjithë tuf' e derravet tek udruth nga gremina
33 ndë dett, edhe ngorthnë ndë ujërat. Edhe
barinjtë iknë e erthnë ndë qytett, ë dhanë zë

për të-gjitha edhe për punët' e të-djallosurvet.
34 Edhe ja gjithë qyteti tek dolli përpara Jisujt:
edhe kur e pan' atë, i ulutnë ati të ikënjë
nga sinorët' e atyreve.

Krye 9.

1 Edhe *ay* si hyri ndë lundrët uhoth përtej,
e erdhi ndë qytett të ti.
2 Edhe ja tek i prunë një ulok të-dërgju-
rë mbi shtrat; edhe Jisuj si pa besën' e atyre,
i tha ulogut, Merr zëmërë, o bir; të janë fa-
3 lurë fajet' e tu. Edhe ja ca nga shkronjësitë
tek thanë me vetëhen' e tyre, *se* Ky po vllas-
4 fimis. Edhe Jisuj si pa mendimet' e atyre, tha,
Përse mendoni ju *punëra* të-liga ndër zëmë-
5 rat t' uaj? Sepse ç' është më lehtë, të them,
6 T' u-falnë fajet' e tu, apo të them, Ngreu e
ecë? Po që t'a dini se i bir' i njeriut ka push-
tet mbi dhet të falnjë faje, (atëhere i thot' u-
logut,) Ngreu, e merr mbë krahë shtratinë t'
7 ënt, edhe ecë ndë shtëpit t' ënde. Edhe *ay*
8 ungrit edhe vate ndë shtëpit të ti. Edhe gjin-
dja, kur panë, uçuditnë, edhe lavduruanë Pe-
rëndinë, që u dha njerëzet një të-këtillë
pushtet.
9 Edhe dyke shkuarë Jisuj andej, pa një njeri
që thuhej Matthe, dyke ndënjurë ndë ku-
merqt; edhe i thotë, Eja pas meje. Edhe ay
10 ungrit e vate pas ati. Edhe tek po rrinte ndë
mësallë ndë shtëpit, ja tek erthnë shumë ku-

merqarë e fajtorë, ehde rrininë bashkë me Ji-
11 sunë edhe me nxënësit’e ati. Edhe Farisenj-
të kur panë, u thanë nxënëset t’ ati, Përse
mësonjësi juaj ha bashkë me kumerqarë e
12 me fajtorë? Po Jisuj kur dëgjoj u tha atyre,
Ata që janë të-shëndoshë s’ kanë nevojë për
13 shëronjës, po ata që kanë keq. Edhe shkoni
e mësoni ç’ është, „Dua përdëllim, e jo kur-
ban“, sepse s’kam ardhurë të thërres të-drejtë,
po fajtorë ndë pendim.
14 Atëhere vijnë tek ay nxënësit’ e Joanit, e
i thonë, Përse ne edhe Farisenjtë agjërojmë
15 shumë, po nxënësit’ e tu nuk’agjërojnë? Edhe
Jisuj u tha atyre, Mos muntnjënë të mbajnë
zi dasmorëtë, gjersa të jetë dhëndëri bashkë
me ata? po kanë për të ardhurë dit, kur të me-
rretë dhëndëri prej atyrere, edhe atëhere dot’
16 agjëronjënë. Edhe asndonjë nukë vë anërë
pëlhure së-re mbi rrobë të-vjetërë; sepse të-
mbushurit’ e asaj heq nga rroba, edhe të-grisu-
17 ritë bënetë më të-keq. Edhe as nukë vënë verë
të-re ndë kacekë të-vjetërë; sepse ndë vën-
çinë, kacekëtë çirenë, edhe vera derdhetë,
edhe kacekëtë humbasënë; po vënë verë të-
re ndë kacekë të-rinj, edhe *kështu* ruhenë
të-dyja.
18 Tek po u fliste ay atyre këto, jo tek erdhi
një i-parë, edhe i falej ati, dyke thënë, Se
ime bijë vdiq tashti; po eja ehde vërë dorënë
19 t’ ënde mbi atë, edhe dotë rronjë. Edhe Jisuj u-

BKSH

ngrit e vate prapa ati, bashkë me nxënë-
sit' e ti.
20 Edhe ja një grua që i rrithte gjak nga
vetëheja dy-mbë-dhjetë vjet, uafërua së-pra-
21 pëzmi, edh' e preku anën' e rrobës' s' ati. Sepse
thoshte me vetëhen' e saj, Vetëmë ndë prekça
22 rrobën' e ati, dotë shëronem. Edhe Jisuj kur
ukthye, e pa atë, tha, Kij zëmërë, o bijë; besa
jote të shpëtoj. Edhe gruaja shpëtoj që mb'
atë herë.
23 Edhe Jisuj passi erdhi ndë shtëpit të të-
parit, edhe pa ata që u bininë fyejvet edhe
25 gjindjenë dyke bërë gjëmë, u thot' atyre, Ikëni;
sepse vashëza s' ka vdekurë, po po fle. Po ata
26 e përqeshnin' atë. Edhe gjindja si unxuar
jashtë, hyri edhe e zuri prej dore; edhe va-
shëza ungrit. Edhe ky zë dolli ndëpër gjith'
atë dhe.
27 Edhe Jisuj dyke ikur' andej, i vanë prapa
dy të-verbërë, dyke klithur' e dyke thënë,
28 Përdëlle-na, o bir' i Dhavidhit. Edhe ay kur
erdhi ndë shtëpit, erthnë përanë ati të-ver-
bëritë, edhe Jisuj u thot' atyre, Besoni se munt
29 t'a bënj këtë *unë?* Ata i thon' ati, Po, Zot.
Atëhere preku syt' e atyreve, dyke thënë,
30 Pas besësë s' uaj ubëftë mbë ju. Edhe uhapnë
syt' e atyreve. Edhe Jisuj i porositi ata shtrën-
guarshim, dyke thëne, Shikoni mos e marrë
31 vesh njeri *këtë.* Po ata posa duallnë dhanë
zë për atë ndëpër gjith'atë dhe.

BKSH

32 Edhe ata kur po dilninë, ja tek i prun'
33 ati një njeri shurth të-djallosurë. Edhe djalli
si unxuar, foli i-shurdhëri; edhe gjindja u-
çuditnë, dyke thënë, Se kurrë ndonjëherë
34 nuk' është parë kështu ndë Israilt. Po Fari-
senjtë thoshinë, *se* Me anë të të-parit të djaj-
vet nxjer djajtë.
35 Edhe Jisuj shkonte përqark ndëpër gjithë
qytetet e krye-fshatrat, dyke mësuarë ndëpër
sinagogjit t' atyreve, edhe dyke lëçiturë ungji-
llin' e mbretërisë, edhe dyke shëruarë çdo
36 smundje e çdo lëngatë ndë gjindjet. Edhe
kur pa gjindjenë, i udhëmp për ata; sepse
ishinë lodhur' e përndarë posi dhën që s'
37 kanë bari. Atëhere u thotë nxënësvet të ti, Të-
korrët' është të-shumë, po punëtorëtë janë
38 të-pakë. Lut-j-uni pra të-zotit të të-korrit, që
të nxjerrë punëtorë, për të korrët' e ti.

Krye 10.

1 Edhe si thirri të dy-mbë-dhjetë nxënësit' e
ti, u dha atyre pushtet kundrë frymave të-ndy-
ra, që t'i nxjerrën' ato edhe të shëronjënë çdo
sëmundje e çdo lëngatë.
2 Edhe emërat' e të dy-mbë-dhjet' Apostojvet
janë këta: i-pari Simoni që thuhetë Pjetër, edhe
Andreu i vëllaj i ati; Jakovi i Zevedheut, edhe
3 Joani i vëllaj i ati; Filippi, dhe Varthollomeu;
Thomaj, edhe Matthe kumerqari; Jakovi i
Allfeut, edhe Levveu që uquajt me përmbie-

BKSh

4 mërë Thadhdhe; Simon Kananiti, edhe Judhë
Iskarioti, i-cili edhe e trathëtoj atë.
5 Këta të dy-mbë-dhjetë dërgoj Jisuj, passi
i porositi ata, dyke thënë, Nd' udhë gjinda-
rësh mos shkoni, edhe ndë qytet Samaritësh
6 mos hyni; po shkoni më tepërë ndëpër dhënt
7 të-humbura të-shtëpis' s' Israilit. Edhe dyke
vaturë, lëçitni dyke thënë, Se uafërua mbretë-
8 ri' e qiejvet. Shëroni të-sëmurë, qëroni të-krro-
mosurë, (ngjallni të-vdekurë,) nxirni djaj;
9 dhurëti muartë, dhurëti epni. Mos kini ar, as
10 ergjënt, as ramë ndëpër brezat t' uaj; Mos
kini trajstë mb' udhë, as dy rroba, as këpucë,
as stap; sepse punëtori e vëjen ushqimn' e ti.
11 Edhe mbë çdo qytet a krye-fshat që të
hyni, vëshgoni cili ësht' i-vëjejturë nd' atë, edhe
12 mbetuni atje gjersa të dilni. Edhe kur të hyni
13 ndë shtëpit, përshëndet-e-ni atë. Edhë ndë
qoftë shtëpia e-vëjejturë, paqtimi juaj letë
vinjë mb' atë; po ndë mos qoftë e-vëjejturë,
14 paqtimi juaj letë kthenetë mbë ju. Edhe ay
që të mos u presë juve, as të mos dëgjonjë
fjalëtë t' uaj, kur të dilni prej asaj shtëpie,
a prej ati qyteti, shkuntni pluhurin' e këmbë-
19 vet t' uaj. Me të-vërtetë po u them juve, se
më i-duruarshim dotë jetë mundimi mbë dhet
të Sodhomavet e të Gomorravet ndë ditët të
gjyqit, se mb' atë qytet.
16 Ja tek po u dërgonj unë juve posi dhën
ndë mest të ujqërvet; bëhi pra të-urtë posi

17 gjërpënjtë, edhe të-butë posi pëllumbatë. Edhe
ruhi nga njerëzitë; sepse dot' u apënë juve
ndër duar ndëpër bashkëndënjje, edhe dot' u
18 rrahënë ndëpër sinagogjit të tyre; Edhe dot'
u nxjerrënë juve për punë t'ime përpara të-
parëve edhe përpara mbretërve, për dëshmim
19 mb'ata edhe mbë kombet. Po kur t'u apënë
juve ndë duar, mos kini kujdes *se* qysh a
se ç' dotë flisni; sepse dot' u epetë juve nd'
20 atë orë ç' dotë flisni. Sepse nukë jeni ju ata
që flisni, po Frym' e Atit t' uaj që flet ndër
21 ju. Edhe vëllaj dotë apë në dorë të vëllanë
për të vrarë, edhe i ati të birrë; edhe bijtë
dotë ngrenë krye kundrë përindërvet e dot'
22 i vrasënë. Edhe dot' u kenë mëri juve të-gji-
thë për emërinë t'im; edhe ay që të duronjë
23 gjer ndë funt, ky dotë shpëtonjë. Po kur t'u
ndjekënë juve ndë këtë qytet, ikëni mbë tja-
tërinë; sepse me të-vërtetë po u them juve,
se Nukë dot' i mbaroni qytetet' e Jsrailit, gjer
sa të vinjë i bir' i njeriut.
24 Nuk' është nxënësi përmbi mësonjësinë,
25 as shërbëtori përmbi të zonë. Mjaft *është* për
nxënësinë të bënetë si mësonjësi i ti, edhe
shërbëtori si i zoti. Ndë qoftë se të zon' e
shtëpisë e quajtnë Veellzevull, sa më shumë
26 shtëpjakësit' e ti? Mos u keni frikë pra aty-
reve; sepse nukë ka gjë të-mbuluarë që nukë
dotë sbulonetë; edhe *gjë* të-fshehurë që nukë
27 dotë dihetë. Atë që po u them juve nd' errë-

BKSH

sirët, tho-e-ni ndë dritët, edhe atë që dëgjo-
28 ni ndë vesht, lëçit-e-ni përmbi shtëpit. Edhe
mos kini frikë nga ata që vrasënë trupinë,
e shpirtinë s'munt t'a vrasënë; po kini frikë
më shumë nga ay që munt të humbasë ndë
29 gjehenë edhe shpirtinë edhe trupinë. Nukë
shitenë dy zoq për *një* asprë? po një nga
ata nukë dotë bjerë mbi dhet, pa urdhërin'
30 e Atit t' uaj. Po juve edhe qimet'e krejt u janë
31 të-numëruara. Mos kini frikë pra; juve ndani
32 nga shumë zoq. Kushdo pra që të më rrëfe-
një përpara njerëzet, edhe unë dot'a rrëfenj
atë përpara t'im Eti që është ndë qiejt. Po
33 kush të më mohonjë përpara njerëzvet, dot'a
mohonj edhe un' atë përpara t'im Eti që
është ndë qiejt.
34 Mos pandehni se kam ardhurë të vë paq-
tim mbi dhet; s' kam ardhurë të vë paqtim,
35 po thikë. Sepse kam ardhurë të ndanj nje-
rinë kundrë t'et, edhe bijënë kundrë s'ëmësë,
36 edhe nusenë kundrë së vjehërrësë. Edhe ar-
37 miqt' ë njeriut *dotë jenë* shtëpjakësit' e ti. Ay
që do t' an' a t'ëmënë më tepërë se mua,
nuk' është i-vëjejturë për mua; edhe ay që
do bir a bijë më tepërë se mua, nuk' ësht' i-
38 vëjejturë për mua. Edhe ay që nukë merr kry-
qin' e ti, e nukë vjen pas meje, nuk' ësht' i-
39 vëjejturë për mua. Ay që gjeti jetën' e ti dot'a
humbasë; edhe ay që të humbasë jetën' e ti
për punë t' ime dot' a gjenjë atë.

40 Ay që pret juve, më ka priturë mua; edhe
ay që më pret mua, ka pritur' atë që më ka
41 dërguarë mua. Ay që pret profit mb' emërë
profiti, pagë profiti dotë marrë; edhe ay që
pret të-drejtë mb' emërë të-drejti, pagë të-
42 drejti dotë marrë. Edhe ay që t' i apë vetëmë
një kupë ujë të-ftohëtë ndonjëjt nga këta të-
vegjëlitë mb' emërë nxënësi, me të-vërtetë po
u them juve, se nukë dot' e humbasë pa-
gën' e ti.

Krye 11.

1 Edhe Jisuj kur mbaroj dyke porositurë të
dy-mbë-dhjetë nxënësit' e ti, iku andej, që të
mësonjë e të lëçisnjë ndëpër qytetet t' atyre.
2 Edhe Joani kur dëgjoj ndë burgt punë-
rat' e Krishtit, dërgoj dy nga nxënësit' e ti; e
3 i tha ati, Ti je ay që ka për t' ardhurë, apo
4 presimë tjatërë? Edhe Jisuj upërgjeq e u tha
atyre, Shkoni e epni zë Joanit për ato që
5 dëgjoni e shihni. Të-verbërë shohënë, e të-
çalë ecëjnë; të-krromosurë qëronenë, edhe
të-shurdhërë dëgjonjënë; të-vdekurë ngjalle-
7 në, e të-vobeqve u rrëfenet' Ungjilli. Edhe i-
lumurë ësht' ay që të mos skandhalisetë
mbë mua.
7 Edhe këta tek po shkoninë, Jisuj zuri t' i
thotë gjindjesë për Joaninë, ç' dualltë të vini
re ndë shkretëtirët? kallam që tundetë nga
8 era? Po ç' dualltë të shihni? njeri të-vëshurë

me rroba të-buta? ja ata që kanë veshurë
rroba të-buta tek janë n'lëpër shtëpirat të
9 mbretërvet. Po ç'dualltë të shihni? profit?
me të-vërtetë po u them juve, edhe më te-
10 përë se profit; Sepse ky ësht' ay për të-cilinë
është shkruarë, „Ja unë tek dërgonj ëngjë-
llinë t' im përpara faqesë s' ate, i-cili dotë
11 ndreqnjë udhënë t'ënde përpara teje". Me të-
vërtetë po u them juve, se ndë mest t' aty-
reve që kanë lindurë prej grash nuk' është
ngriturë *ndonjë* më i-math se Joan Pagëzori;
po më i-vogëli ndë mbretërit të qiejvet është
12 më i-math se ay. Edhe që nga ditt' e Joan
Pagëzorit e gjer ndashti mbretëri' e qiejvet
shtrëngonet' edhe shtrëngimtarët' e rrëmbejn'
13 atë. Sepse gjithë profitërit' edhe nomi profi-
14 tepsnë gjer mbë ditët të Joanit. Edhe ndë doni
t'a prisni *këtë fjalë*, ay ësht' Ilia, që kishte
15 për të ardhurë. Ay që ka veshë për të dë-
16 gjuarë, letë dëgjonjë. Po me se t'a përgjanj
këtë bres? u gjan çunavet të-vegjëlë që rrinë
ndëpër tregjet, edhe u thërresënë shokëvet të
17 tyre, e thonë, I ramë fyellit për ju, edhe nukë
18 kërcyetë; u bëmë vajë, edhe nukë qatë. Se-
pse erdhi Joani që as hante, as pinte; edhe
19 thonë, *se* Ka djallinë. Erdhi i Bir' i njeriut
dyke ngrën' e dyke pirë, e thonë, Ja njeri
hamës e verëpirës, mik i kumerqarëve e i
fajtorëve. Edhe dolli e-drejtë dituria nga bijt'
e saj.

20 Atëhere zuri të qërtonjë ata qytete. mbë
të-cilët ubënë çudit' e-shuma t' ati, sepse nuk'
21 upenduanë; Mjerë ti Horazin, mjerë ti Vith-
saida; sepse çuditë që janë bërë ndër ju, po
t'ishinë bërë ndë Tyrë e ndë Sidhonë, që
kur dot' ishinë penduarë ndë thes e ndë hi.
22 Veç po u them juve, *se* ndë Tyrë e ndë Si-
dhonë më i-duruarshim dotë jetë mundimi
23 ndë ditët të gjyqit, se mbë ju. Edhe ti, Ka-
pernaum, që je ngriturë lart gjer ndë qiellt,
dotë zbreç gjer ndë hadht; sepse këto çudi
që janë bërë te ti, po t' ishinë bërë ndë So-
dhomat, dotë kishinë mbeturë gjer mbë ditët
24 të-sotme. *V*eç po u them juve, se mbë dhet
të Sodhomavet më i-duruarshim dotë jetë
mundimi ndë ditët të gjyqit se mbë ty.
25 Nd' atë kohë Jisuj upërgjeq e tha, Të lav-
duronj ty, o Atë, Zot' i qiellit edhe i dheut,
se u'a fshehe këto *punë* të-diturvet e të-
mënçimvet, edhe u'a sbulove ato foshnjavet.
26 Po, o Atë, sepse kështu upëlqye përpara teje.
27 Të-gjitha m' udhanë në dorë nga im Atë;
edhe asndonjë nuk' e njeh Birinë, veç Ati;
edhe as Atën' s'e njeh njeri, veç Biri edhe ay,
të-cilit të dojë Biri t' j'a sbulonjë.
28 Ejani tek unë gjithë sa jeni të-lodhur' e
të-ngarkuarë, edhe unë dot' u prënj juve.
29 Ngrini sgjedhënë t' ime mbi vetëhenë t' uaj,
edhe mësoni prej meje; se jam i-butë edhe
i-unjëtë ndë zëmërët; Edhe dotë gjeni të-prëj-

30 turë ndë shpirtërat t' uaj. Sepse sgjedha ime
ësht' e-mirë, edhe barra ime ësht' e-lehëtë.

Krye 12.

1 Nd' atë kohë Jisuj shkonte ndëpër të-
mbjellat një ditë të-shëtunë; edhe nxënësvet
të ti u erdhi uri, edhe zunë të çkoqinë ka-
2 llinj, e të hanë. Edhe Farisenjtë kur panë i
than' ati, Ja nxënësit' e tu tek bëjn' atë që
3 nuk' ësht' e udhësë t'a bëjnë të-shëtunë. Po
ay u tha atyre, Nukë keni kënduarë ç' bëri
Dhavidhi, kur i erdhi uri ati edhe atyre që i-
4 shinë bashkë me atë? Qysh hyri ndë shtëpit
të Perëndisë, edhe hëngri bukët' e parëvënjesë,
të-cilatë nuk' ishte e udhësë t'i hante ay, as
ata që ishinë bashkë me atë, po priftëritë
5 vetëmë? Apo nukë keni kënduarë ndë nomt,
se të-shëtunatë priftëritë e prishnjënë të-shë-
tunënë ndë hieroret, edhe janë të-pafajm?
6 Edhe po u them juve, se këtu është një më
7 i-math se hieroreja. Edhe t'a kishitë diturë
ç' është, „Dua përdëllim, e jo kurban", nukë
8 dot' i kishitë dënuarë të-pafajmitë. Sepse i Bir'
i njeriut ësht' i zoti *edhe* i së-shëtunësë.
9 Edhe si iku andej, erdhi ndë sinagogjit t' a-
10 tyre. Edhe ja tek ishte një njeri që kishte dorënë
të-tharë; edhe e pyetnë atë, dyke thënë, Nd'
ësht' e udhësë të shëronjë njeriu të-shëtunë;
11 që t'a përflisnin' atë, Edhe ay u tha atyre,
Cili njeri nga ju dotë jet' ay, që dotë ketë

një dele, edhe ndë i rëntë kjo ndë gropë
ditën' e-shëtunë, nukë dot' a zërë e t'a ngrerë
12 atë? Sa *më tepërë* pra ndan njeriu nga delja!
përandaj ësht' e udhësë të bënjë mirë *njeriu*
13 të-shëtunatë. Atëhere i thotë njeriut, Shtri do-
rënë t'ënde. Edhe *ay* e shtriti, edhe ubë e-
14 shëndoshë posi tjatëra. Po Farisenjtë duallë
e bënë këshillë kundrë ati, që t'a prishnjënë.
15 Po Jisuj si e kupëtoj, iku andej; edhe
vanë pas ati shumë gjindje, edhe i shëroj ata
16 të-gjithë. Edhe i porositi ata shtrënguarë të
17 mos e dëftejn' atë; Që të mbushetë ç' është
18 thënë nga profiti Isai, që thotë, „Ja shërbë-
tori im që e sgjodha, i-dashuri im, që e pël-
qeu shpirti im; dotë vë Frymënë t'ime mb'
atë, edhe dotë dëftenjë gjyq mbë kombet.
19 Nukë dotë bënjë fjalë, as nukë dotë bërtasë;
as nukë dotë dëgjonjë ndonjë zën' e ati ndë-
20 për rrugat. Kallam të-shtypurë nukë dotë shqy-
enjë, ehde li që nxjer tym nukë dotë shuanjë,
21 gjersa të nxjerrë gjyqinë ndë mundje. Edhe
kombetë dotë shprenjënë mb' emërit t'ati.“
22 Atëhere i prunë ati një të-djallosurë, të-
verbër' e të-shurdhërë; edhe e shëroj atë,
kaqë sa i-verbëri edhe i-shurdhërë fliste edhe
23 shihte. Edhe gjithë gjindja habiteshin' e tho-
24 shinë, Mos është ky i bir' i Dhavidhit? Po
Farisenjtë kur dëgjuanë thanë, Ky nukë nxjer
djajtë, veç me anë të Veellzevullit, të-parit
të djajvet.

BKSH

25 Edhe Jisuj si njohu mendimet' e atyreve,
u tha atyre, Çdo mbretëri ndë undaftë kun-
drë vetëhes' së saj, shkretonetë; edhe çdo
qytet a shtëpi ndë undaftë kundrë vetëhes'
26 së saj, nukë dotë qëndronjë. Edhe Satanaj
ndë nxjertë Satananë, unda kundrë vetëhes'
së ti; qysh pra dotë qëndronjë mbretëri' e
27 ati? Edhe ndë qoftë se unë nxjer djajtë me
anë të Veellzevullit, bijtë t' uaj me ç' anë i
nxjerrënë? përandaj ata dotë jenë gjyqtarëtë
28 t'uaj. Po ndë qoftë se unë nxjer djajtë me
anë të Frymës' së Perëndisë, pa fjalë arriti
mbë ju mbretëri' e Perëndisë.
29 A qysh munt të hynjë ndonjë ndë shtë-
pit të të-fortit, e të rrëmbenjë enët' e ati, ndë
mos lithtë më përpara të-fortinë, edhe atëhere
30 dot' a bënjë rrëmullë shëpin' e ati? Ay që
nuk' është bashkë me mua, është kuundrë
meje; edhe ay që nukë mbleth bashkë me
31 mua, përndan. Përandaj u them juve, *se* Çdo
faj e çdo sharje dot' u ndjenetë njerëzvet; po
sharja kundrë Frymës' *së-Shënjtëruarë* nukë
32 dot' u ndjenetë njërësvet. Edhe ati që të thotë
fjalë kundrë të Birit të njeriut, dot' i ndjenetë;
po ati që të thotë fjalë kundrë Frymës' së-
Shënjtëruarë, nukë, dot' i ndjenetë as mbë
33 këtë jetë, as mb' atë që vjen. A bëni drurinë
të-mirë, edhe pemën' e ati të-mirë; a bëni
drurinë të-lik, edhe pemën' e ati të-ligë; sepse
34 druri njihetë nga pema. Të-pjellë nepërkash,

qysh munt të flisni të-mira, dyke qënë të-
liq? sepse goja flet nga tepëric' e zëmërësë.
35 Njeriu i-mirë nxjer të-miratë nga thesar' i-
mirë i zëmërësë; edhe njeriu i-lik nxjer të-liga
36 nga thesar' i-lik. Edhe po u them juve, se
çdo fjalë të-kotë ndë e folçinë njerëzitë, dot'
37 apënë fjalë për atë ndë ditët të gjyqit. Sepse
nga fjalët' e tua dotë dalç i-drejtë, edhe nga
fjalët' e tua dotë dënohesh.
38 Atëhere upërgjeqnë ca nga shkronjësit' e
nga Farisenjtë, dyke thënë, Mësonjës, duamë
të shohëmë shënjë prej teje.
39 Edhe ay upërgjeq, e u tha atyre, Bres i-
lik edhe kurvar lypën shënjë; edhe shënjë
nukë dot' i epetë ati, përveç shënjës' së pro-
40 fitit Jona. Sepse sindëkur Jonaj ishte ndë
barkt të qitit tri dit e tri net, kështu dotë
jetë edhe i Bir' i njeriut ndë zëmërët të dheut
41 tri dit e tri net. Burra Ninevitë dotë ngjallenë
ndë ditët të gjyqit bashkë me këtë bres, edhe
dot' a gjykonjënë për të-lik; sepse upenduanë
ndë të-lëçiturit të Jonajt; edhe ja këtu *tek*
42 *është* më tepërë se Jonaj. Mbretëresh' e Anës'
së Mesditësë dotë ngjalletë bashkë me këtë
bres ndë *ditët* të gjyqit, edhe dot' a gjykonjë
për të-lik; sepse erdhi nga anët' e fundit të
dheut, që të dëgjonjë diturin' e Sollomonit;
edhe ja këtu *tek është* më tepërë se Sollomoni.
43 Edhe frym' e-ndyrë kur del nga njeriu
shkon ndëpër vënde të-paujëshim, dyke kër-

BKSH

44 kuarë të-prëjturë, e nukë gjen. Atëhere thotë
Letë kthenem ndë shëpit t' ime, andej nga
dolla. Edhe si vjen, e gjen *atë* të-zbrazëtë,
45 të-fshir' e të-stolisurë. Atëhere vete e merr me
vetëhe shtatë fryma të-tjera më të-liga se ve-
tëhen' e saj, edhe hyjn' e rrinë atje; edhe të-
pastajmet' e ati njeriu bënenë më të-këqia
se të-paratë. Kështu dotë jet' edhe mbë këtë
bres të-lik.
46 Edhe ay tek po ishte dyke folurë gjin-
djesë, ja e ëma edhe të vëllezërit' e ati tek
po rrininë jashtë, e kërkoninë të flisninë me
47 atë. Atëhere një *njeri* i tha ati, Ja jot' ëme
edhe t' ët vëllezër te po rrinë jashtë, e kër-
48 kojnë të flasënë me ty. Po ay upërgjeq e i tha
ati që tha *këtë,* Cila është im' më, edhe cilëtë
49 janë t'im vëllezër? Edhe shtriti dorën' e ti mbi
nxënësit' e ti, e tha, Ja im' më edhe t' im vë-
50 llezër. Sepse kush të bënjë dashurimin' e
t'im Eti që është ndë qiejt, ay më është vëlla
e motër' e mëmë.

Krye 13.

1 Edhe mb' atë ditë si dolli Jisuj nga shtë-
2 pia, rrinte përanë detit. Edhe umblothnë tek
ay shumë gjindje, kaqë sa *ay* hyri ndë lun-
drët e rrinte; edhe gjithë gjindja rrinte buzë
3 detit. Edhe u foli atyre shumë me paravoli,
dyke thënë, Ja mbjellësi tek dolli të mbjellë.
4 Edhe ay tek po mbillte, ca ranë përanë u-

dhësë; edhe erthnë shpestë e i hëngrrë të-
5 gjitha. Ethe të-tjera ranë mbë gurishtet, tek
s' kishte dhe shumë; edhe për-një-herë mbinë,
6 sepse s'kishte dhe të-thellë; Po kur lindi djelli,
udoqnë, edhe passi nukë kishinë rrënjë, uthanë.
7 Edhe të-tjera ranë mbë drizat, edhe urritnë
8 drizatë, e i mbytn' ato. Edhe të-tjera ranë
mbë dhe të-mirë; edhe epninë pemë, njëra
nje-qint, e tjatëra gjashtë-dhjetë, e tjatëra tri-
9 dhjetë. Kush ka veshë për të dëgjuarë letë
dëgjonjë.
10 Edhe nxënësit' erthnë përan' e i than' ati,
11 Përse u flet atyre me paravoli? Edhe ay u-
përgjeq e u tha atyre, Sepse mbë ju është
dhënë të merrni vesh të-fshehurat' e mbretë-
ris' së qiejvet, po mb' ata nuk' është dhënë.
12 Sepse ati që ka dot' i epetë *edhe më* edhe
dotë tepëronjë; po ay që nukë ka, edhe ç'të
13 ketë dotë merretë ngà ay. Përandaj u flas
atyre me paravoli, sepse dyke parë nukë
shohënë, edhe dyke dëgjuarë nukë dëgojnë,
14 as nukë kupëtojnë. Edhe mbushetë mb' ata
profiti' e Isaisë, që thotë, „Me të-dëgjuarë
dotë dëgjoni, po nukë dotë merrni vesh; edhe
dyke parë dotë shihni, po nukë dotë ku-
15 pëtoni. Sepse utrash zëmër' e këti llauzi,
edhe dëgjuanë rëndë me veshë' *e tyre*, edhe
mbyllnë syt' e tyre, semos shohënë ndonjë
herë me sytë, edhe dëgjojnë me veshëtë,
edhe kupëtojnë me zëmërënë, edhe kthe-

BKSH

16 nenë, e i shëron ata. Po juve u janë të-lu-
murë sytë, se shohënë; edhe veshëtë t' uaj,
17 se dëgjojnë. Sepse me të-vërtetë po u them
juve, se shumë profitër edhe të-drejtë dëshë-
ruanë të shohënë sa shihni *ju*, edhe nukë
panë; edhe të dëgjojnë sa dëgjoni *ju*, edhe
nukë dëgiuanë.
18 Ju pra dëgjoni paravolin' e mbjellësit.
19 Kujdo që dëgjon fjalën' e Perëndisë, edhe
nuk' e kupëton, vjen i-ligu edhe rrëmben atë
që është mbjellë ndë zëmërët t' ati; ky është
20 *si* ajo *fara* që umbuall përan' udhësë. Edhe
ç' umbuall mbë gurishtet, ky ësht' ay që dë-
gjon fjalënë, edhe për-një-herë e merr me gë-
21 zim; Po s' ka rrënjë ndë vetëhet të ti, andaj
është për pak kohë; sepse kur të bënetë
shtrëngim a të-ndjekurë për fjalënë, për-një-
22 herë skandhalisetë. Edhe ç' umbuall ndër dri-
zat, ky ësht' ay që dëgjon fjalënë; po kuj-
desi i kësaj bote, edhe gënjimi i gjësë mbyt
23 fjalënë, edhe bënetë i-papemshim. Edhe ç' u-
mbuall mbë dhet të-mirë, ky ësht' ay që dë-
gjon fjalënë, edhe e kupëton; përandaj ay
bije pemë, edhe bën njeri një-qint, edhe tja-
tëri gjashtë-dhjetë, e tjatëri tri-dhjetë.
24 Një tjatërë paravoli u pruri atyre, dyke
thënë, Mbretëri' e qiejvet gjan me një njeri
25 që mbolli farë të-mirë nd' arët të ti; po tek
flininë njerëzitë, erdhi armiku i ati, e mbolli
26 egjër ndë mest të grurit, edhe iku. Edhe kur

BKSH

mbiu bari e bëri pemë, atëhere uduk edhe
27 egjëri. Edhe shërbëtorët' erthnë përanë të-zo-
tit të shtëpisë, e i thanë, Zot, nukë mbolle *ti*
farë të-mirë ndë arët t' ënde? nga dolli pra
28 egjëri? Po ay u tha atyre, Ndonjë njëri armik
e ka bërë këtë. Edhe shërbëtorët' i than' ati,
29 Do pra të vemi e t'a mbledhëm atë? Po ay
tha, Jo; *sepse* dyke mbledhurë egjërinë mos
30 çkulni *edhe* grurëtë bashkë me atë. Lër-i-ni
të rritenë të dy bashkë gjer mbë të-korrët
edhe ndë kohët të të-korrit dot' u them ko-
rrësvet, Mblithni më përpara egjërinë, edhe
e lithni dorëza, për të djegur' atë; po grurët'
e mblithni ndë grunart t' im.

31 Një tjatërë paravoli u pruri atyre dyke
thënë:

Mbretëri' e qiejvet gjan me një koqe sinapi,
të-cilën' e mori një njeri edhe e mbolli nd'
32 arët të ti; Ajo është më e-vogëlë se gjithë
faratë; po kur rritëte, është më e-madhe se
lakratë, edhe bënetë dru, kaqë sa vijnë shpest'
e qiellit e rrinë ndë degat t' ati.

33 Një tjatërë paravoli u foli atyre.

Mbretëri e qiejvet gjan me brumë, të-cilin'
e mori një grua, edhe e fshehù ndë tri masa
mjelli, gjersa umbrujt gjithë.

34 Këto të-gjitha u'a foli Jisuj gjindjevet me
paravolira, edhe pa paravoli nuk' u fliste
35 atyre; Që të mbushetë ç' është thënë nga pro-
fiti që thotë, „Dotë hap gojënë t' ime me

paravolira; dotë flas *gjërra* të-fshehura që kur
është ngrehurë bota".
36 Atëhere Jisuj la gjindjen' e erdhi ndë
shtëpit, edhe nxënësit' e ati i erthnë përanë
e i thanë, sgith-na paravolin' e egjërit t'arësë.
37 Edhe ay upërgjeq e u tha atyre:
Ay që mbjell farën' e-mirë ësht' i Bir' i
38 njeriut; edhe ara është bota; edhe far' e-mirë,
këta janë të bijt' e mbretërisë; edhe egjëri janë
39 të bijt' e të-ligut; Edhe armiku, që mbolli
ata, është djalli; edhe të-korrëtë është të-
mbaruarët' e jetësë: edhe korrësitë janë ën-
40 gjëjtë. Sindëkur pra mblidhetë egjëri, edhe
digjetë ndë zjarr, kështu dotë jetë mbë të-
41 mbaruarët të kësaj jete. I Bir' i njeriut dotë
dërgonjë ëngjëjt' e ti, edhe dotë mbledhënë
nga mbretëri' e ati gjithë skandhalitë, edhe
42 ata që punojnë paudhërinë; Edhe dot' i
hedhën' ata ndë furrët të zjarrit; atje dotë
jetë të-qarët' e të-kërcëllitur it' e dhëmbëvet.
43 Atëhere të-drejtëtë dotë ndritnjënë si djelli
ndë mbretërit t' Atit të tyre. Ay që ka veshë
për të dëgjuar letë dëgjonjë.
44 Përsëri mbretëri' e qiejvet gjan më një
thesar të-fshehurë nd' arët, të-cilinë kur e
gjeti një njeri e fshehu; edhe nga gëzim' i ti
vete e shet gjithë ç' ka, edhe ble atë arë.
45 Përseri, mbretëri' e qiejvet gjan më një
njeri tregëtar, që kërkonte margaritare të-
46 mirë; i-cili kur gjeti një margaritar shumë

të-vjejturë, vate e shiti gjithë sa kishte, edhe
e bleu atë.
47 Përsëri, mbretëri' e qiejvet gjan me një
rrjetë që uhoth ndë dett, e mblodhi çdo farë
48 gjëje; Edhe si umbush, e nxuarrë atë ndë
buzët të detit, edhe ndenjtn' e mblothnë të-
miratë ndë enë, edhe të-ligat' i hothnë jashtë.
49 Kështu dotë jetë mbë të-mbaruarët të jetësë;
dotë dalën' ëngjëjtë, e dotë ndajnë të-liqtë
50 nga të-drejtëtë, Edhe dot' i hedhën' ata ndë
furrët të zjarrit; atje dotë jetë të-qarët' e të-
kërcëllliturit' e dhëmbëvet.
51 U thot' atyre Jisuj, A i kupëtuatë këto të-
52 gjitha? I thon' ati, Po, Zot. Edhe ay u tha a-
tyre, Përandaj çdo shkronjës që ka mësuarë
punët' e mbretëris' së qiejvet gjan me një
njeri zot-shtëpie, që nxjer nga thesar' i ti *gjërra*
të-reja edhe të-vjetëra.
53 Edhe Jisuj si mbaroj këto paravolira, iku
54 andej. Edhe si erdhi ndë dhet të ti, i mësonte
ata ndë sinagogjit t' atyre, kaqë sa çuditeshin'
ata e thoshinë, Nga *i erdhi* këti këjo dituri, e
55 *këto* fuqira? A nuk' është ky i bir' i mjesh-
trit? e ëm' e ati a nukë thuhetë Mariamë, edhe
të vëllezërit' e ati Jakov, edhe Josi, edhe Si-
56 mon, edhe Judhe? Edhe të motrat' e ati a
nukë janë të-gjitha ndër ne? nga i' *erthnë*
57 këti pra keto të-gjitha? Edhe skandhalise-
shinë mb' atë. Po Jisuj u tha atyre, Nuk' është
profit i-panderçim, përveç nd' atdhet të ti e

BKSH

58 ndë shtëpit të ti. Edhë nukë bëri atje shumë
çudira, për pa-besërin' e atyreve.

Krye 14.

1 Nd' atë kohë Irodhi katrurdhëtarësi dë-
2 gjoj zërin' e Jisujt, Edhe u tha shërbëtorëvet
të ti, Ky është Joan Pagëzori; ay është ngja-
llurë nga të-vdekuritë, edhe përandaj puno-
nenë çudira nga ay.
3 Sepse Irodhi zuri Joanë, edhe e lidhi,
edhe e vuri ndë burg, për Irodhiadhënë gruan'
4 e Filippit të vëllat; Sepse Joani i thoshte ati,
5 *se* Nuk' ësht' e udhësë t'a kesh ti atë. Edhe
donte t'a vriste atë, po kishte frikë prej gjin-
6 djesë, sepse e kishinë për profit. Edhe kur
bënej të-fështuarët' e ditës' së të-lindurit të
Irodhit, e bija e Irodhiadhësë lojti valle ndë
7 mest, edhe i pëlqeu Irodhit. Përandaj i uzotua
8 asaj me be t' i apë ç' të lypte. Edhe ajo, si
umësua prej s' ëmësë, thotë, Ep-më kryet' e
9 Joan Pagëzorit këtu mbë një talure. Edhe
mbretit i erdhi keq; po për betë, *që kishte
bërë,* edhe për ata që ishinë ndenjurë *ndë
mësallët* bashkë me atë, urdhëroj t' i epetë.
10 Edhe dërgoj e i pru kryetë Joanit ndë burgt.
11 Edhe kryet' e ati upru mbë një talure, e i
udha vashësë; edhe *ajo* j'a pruri s' ëmësë.
12 Edhe erthnë nxënësit' e ati, e ngritnë trupinë,
edhe e kallnë ndë varr; pastaj erthnë e i dhanë
zë Jisujt.

13 Edhe Jisuj, kur dëgoj, iku andej me lun-
drë mbë një vënt të-shkretë veçanë; edhe
gjindja kur dëguanë i vanë prapa mbë këm-
bë nga qytetetë.
14 Edhe kur dolli (Jisuj), pa shumë gjindje,
edhe i udhemp për ata, edhe shëroj të-sëmu-
rët' e atyre.
15 Edhe si ungrys, i erthnë përanë nxënësit
e ati, e i thanë, *se* Vëndi ësht' i-shkretë, edhe
koha ndashti ka shkuarë; lësho gjindjenë, që
të venë ndëpër krye-fshatrat të blenë të-
16 ngrëna për vetëhen' e tyre. Po Jisuj u tha a-
tyre, Nukë kanë nevojë të venë; ep-u-ni ju
17 atyre të hanë. Edhe ata i thon' ati, Nukë kemi
18 këtu veç pesë bukë edhe dy pishqe. Edhe ay
tha, Bi-m'i-ni mua ato këtu.
19 Edhe urdhëroj gjindjenë të rrijnë përmi
barërat, edhe mori të pesë bukët' e të dy
pishqetë, edhe ngriti sytë përpjetë ndë qiejt
e bekoj; edhe passi i theu, u'a dha bukëtë
20 nxënësvet, edhe nxënësitë gindjesë. Edhe
hëngrrë të-gjithë e unginjnë; edhe ngritnë
tepëricën' e copavet, dy-mbë-dhjetë kofinë
21 plot. Edhe ata që hëngrrë ishinë sindonja
pesë mijë burra, veç gravet e çunavet.
22 Edhe për-një-herë (Jisuj) shtrëngoj nxë-
nësit' e ti të hyjnë ndë lundrët, edhe të shkojnë
përtej më përpara se ay, gjersa të lëshonjë
23 gjindjenë. Edhe si lëshoj gjindjenë, hipi ndë
malt veçanë që të faletë; edhe si ungrys,
ishte vetëm' atje.

BKSH

24 Edhe lundra ishte ndashti ndë mest të
detit dyke përpjekurë nga valëtë; sepse era
25 ishte kundrë. Edhe mbë të-katërtënë ruajtje
të natësë Jisuj vate tek ata, dyke ecurë për-
26 mbi dett. Edhe nxënësitë kur e panë që po
ecënte përmbi dett, utrëmpnë e thanë, Se
27 është hije; edhe nga frika bërtitnë. Po Jisuj
për-një-herë u foli atyre, dyke thënë, Kini
28 zëmërë, unë jam: mos ufrikësoni. Edhe Pjetri
i upërgjeq e tha, Zot, ndë je ti, urdhëro-më
të vinj te ti mbi ujërat. Edhe ay tha, Eja.
29 Edhe Pjetri sbriti nga lundra, e eci mbi
30 ujërat, që të vinte te Jisuj. Po kur pa erënë
të-fortë, ufrikësua; edhe si zuri të kridhetë,
31 bërtiti, dyke thënë, Zot, shtëpo-më. Edhe Jisuj
për-një-herë ngjati dorënë, e zuri, e i thotë, O
32 besë-pak, përse qe me dy mëndje? Edhe *ata*
33 si hynë ndë lundrët, pushoj era. Edhe ata që
ishinë ndë lundrët erthnë e i ufalnë ati, dyke
thënë, Me të-vërtetë je bir Perëndie.
34 Edhe si shkuanë përtej erthnë ndë dhet
35 Gjennisaret. Edhe njerëzit' e ati vëndi, kur
e njohnë, dërguanë ndëpër gjith' ato anë edhe
36 i prunë ati gjith' ata që kishinë keq. Edhe
i luteshin' ati të preknjënë pëqin' e rrobës' s'
ati vetëmë; edhe sa e preknë ushëruanë.

Krye 15.

1 Atëhere vijnë te Jisuj shkronjësit' edhe
2 Farisenjtë nga Jerusalimi, e i thonë, Përse

BKSh

nxënësit' e tu shkelnjënë fjalënë që kanë lënë
pleqtë? sepse s' lajnë duart' e tyre, kur hanë
3 bukë? Po ay upërgjeq e u tha atyre, Përse edhe
ju shkelni porosin' e Perëndisë për fjalëtë t' uaj
4 të-mbetura gojë mbë gojë nga pleqtë. Sepse
Perëndia porositi, dyke thënë, „Ndero t' ët atë,
e t' ët ëmë;" edhe, „Ay që flet keq për t' anë
5 a për t' ëmënë letë vritetë." Po ju thoni, Kush
t' i thotë t' et a s' ëmësë, Se çdo e-mirë që
të shohç prej meje *është* dhurëti, *është mjaft*,
edhe munt të mos nderonjë t' an' a t' ëmënë.
6 Edhe s' mbajtë porosin' e Perëndisë për fjalëtë
7 t'uaj të-mbetura gojë mbë gojë. Ipokritër, mirë
8 profitepsi Isaia për ju, dyke thënë, „Ky llaus
(më afëronet me gojën' e ti, edhe) më nderon
me buzëtë; po zëmër' e atyre është lark prej
9 meje. Edhe kot më nderojnë, dyke mësuarë
10 mësime *që janë* porosira njerëzish". Edhe si
thirri gjindjenë, u tha, Dëgjoni, edhe kupë-
11 toni. Ç' hyn ndë gojët nukë ndyn njerinë, po
ç' del nga goja, këjo e ndyn njerinë.
12 Atëhere uafëruanë nxënësit' e ati, e i thanë,
A e di se Farisenjtë kur dëgjuanë *këtë* fjalë
13 uskandhalisnë? Edhe ay upërgjeq e tha, Çdo
bimë që nuk' e ka mbjellë im atë qiellori,
14 dotë çkuletë. Leni ata; se janë të-verbërë që
u heqën' udhënë të-verbërve; edhe ndë qoftë
se i-verbërë i heq udhënë të-verbëri, të dy
dotë bienë ndë gropët.
15 Edhe Pjetri upërgjeq e i tha ati, Dëfte-na

16 këtë paravoli. Edhe Jisuj tha, Edhe po pa
17 mënt jeni ju? Edhe nukë po kupëtoni, se
çdo gjë që hyn ndë gojët sbret ndë barkt,
18 edhe nxiretë ndë të-dalurit? Po ato që da-
lënë nga goja, dalënë nga zëmëra, edhe ato
19 ndyjnë njerinë. Sepse nga zëmëra dalënë men-
dime të-liq, vrasjε, ndyrësira, kurvërira, vje-
20 dhje, dëshmime të-rem, vllasfimira. Këto jan
ato që ndyjnë njerinë; po të-ngrënëtë me duar
të-palara nukë ndyn njerinë.
21 Edhe Jisuj si dolli andej, iku nd' anët të
22 Tyrës' e të Sidhonësë. Edhe ja një grua Ha-
naneë tek dolli nga ata sinorë, e i thërriste
dyke thënë, Përdëlle-më, o Zot, bir'i Dhavi-
23 dhit; ime bijë mundonetë keq prej djallit. Po
ay nuk'i upërgjeq asaj ndoŋë fjalë. Edhe nxë-
nësit'e ati erthnë përanë e i luteshinë, dyke
thënë, Lësho-e atë, sepse po thërret prapa nesh
24 Po ay upërgjeq e tha, Nuk' udërguashë
ngjetiu, veç te dhënt' e-humbura të shtëpis' së
25 Israilit. Pastaj ajo erdhi e i falej ati, dyke
26 thënë, Zot, ndih-më. Po ay upërgjeq e tha,
Nuk'është mirë të-marrë *njeriu* bukën' e djem-
27 vet, e t' u' a hedhë këlyshëvet të qënvet. Edhe
ajo tha, Po, Zot; po edhe këlyshët' e qënvet
hanë nga thërrimetë që bjenë nga truvez' e
28 zotërinjvet. Atëhere Jisuj upërgjeq e i tha a-
saj, O grua, besa jote ësht' e-madhe; t' ubëftë
si do. Edhe e bija ushërua që mb' atë herë.
29 Edhe Jisuj iku andej, e erdhi përanë de-

tit të Galilesë, edhe hipi ndë malt, e rrinte atje.
30 Edhe erthnë tek ay shumë gjindje, që ki-
shinë me vetëhe të-çalë, të-verbërë, të-shur-
dhërë, doracë, edhe shumë të-tjerë; edhe i
hothnë përanë këmbëvet të Jisujt, edhe *ay* i
31 shëroj ata; Kaqë sa uçudidnë gjinja, kur panë
të-shurdhërë të flasënë, doracë të-shëndo-
shurë, të-çalë të ecëjnë, edhe të-verbërë të
shohënë; edhe lavduruanë Perëndin' e Israilit.
32 Atëhere Jisuj thirri peranë nxënësit' e ti, e
tha, Me dhëmbetë për gjindjenë, sepse kanë
ndashti tri dit që mbesënë peranë meje, e
s' kanë ç' të hanë; edhe nukë dua t'i lëshonj
ata pa ngrënë, se mos gajasënë udhësë.
33 Edhe nxënësit' e ati i thon' ati, Ku dotë na gjen-
denë *këtu* ndë shkretëtirët kaqë bukë, sa të
34 nginjenë kaqë gjindje? Edhe Jisuj u tha atyre,
Sa bukë keni? Edhe ata thanë, Shtatë, edhe
35 pak pishqe të-vegjëlë. Edhe ay urdhëroj gjin-
36 djenë të unjenë përdhe. Edhe si mori të
shtatë bukëtë edhe pishqetë, ufal ndersë, e i
theu, e u'a dha nxënësvet të ti, edhë nxënë-
37 sitë gjindjesë. Edhe hëngrrë të-gjithë, e ungi-
njnë; edhe ngritnë tepëricën' e copavet, shtatë
38 shporta plot. Edhe ata që hëngrrë ishinë ka-
trë mije burra, veç gravet e çunavet të-vegjëlë.
39 Edhe si lëshoj gjindjenë, hyri ndë lundrët,
edhe erdhi ndë sinorët të Magdhallasë.

BKSH

Krye 16.

1 Edhe erthnë përanë Farisenjtë edhe Sad-
duqenjtë, edhe dyke ngar' atë kërkoninë t'u
2 dëftente atyre shënjë nga qielli. Po ay upër-
gjeq e u tha atyre, Kur bënetë mbrëmje, thoni,
Dotë bënetë koh' e-mirë; sepse qielli ësht'
3 i-kuq. Edhe ndë mëngjest, Sot *dotë bënetë*
koh' e ligë; sepse qielli ësht' i-kuq e i-vrërëtë.
Ipokritër, faqen' e qiellit dini t'a çquani, po
4 shënjat' e kohëravet nukë muntni? Bres i-lik
edhe kurvar kërkon shënjë; edhe shënjë nukë
dot' i epet' ati, përveç shënjës' së profitit Jona.
Edhe i la ata e iku.
5 Edhe nxënësitë si erthnë përtej, harruanë të
6 marrënë bukë. Edhe Jisuj u tha atyre, Shi-
koni e ruhi me kujdes nga brumi i Farisenj-
7 vet e i Sadduqenjvet. Edhe ata mendoneshinë
më vetëhen' e tyre, dyke thënë, Se nukë
8 muarmë bukë. Edhe Jisuj si e kupëtoj, u tha
atyre, Ç' mendohi me vetëhenë t' uaj, o besë-
9 pakë, se nukë muartë bukë? Edhe nukë po
kupëtoni, as nukë mbani mënt të pesë bu-
kët' e të pesë mijëvet, edhe sa kofinë muartë?
10 As të shtatë bukët' e të katrë mijëvet, edhe
11 sa shporta muartë? Qysh nukë kupëtoni se
nuk' u thashë juve për bukë të ruhi nga
12 brumi i Farisenjvet e i Sadduqenjvet? Atëhere
e kupëtuanë, se nuk' u tha të ruhenë nga
brum' i bukësë, po nga mësimi i Farisenjvet
e i Sadduqenjet.

13 Edhe Jisuj kur erdhi mb'anët të Qesaris'
së Filippit, pyeste nxënësit' e ti, dyke thënë,
Cili thonë njerëzitë se jam unë i Bir'i njeriut?
14 Edhe ata thanë, Ca *thonë*, *Se je* Joan Pagëzori;
e të-tjerë Iliu; e të-tjerë Jeremia, a një nga
15 profitëritë. U thot' atyre, Po ju cili thoni se
16 jam unë? Edhe Simon Pjetri upërgjeq e tha,
17 Ti je Kristi, i bir' i Perëndis' së-gjallë. Edhe
Jisuj upërgjeq e i tha, I-lumurë je ti, Simon
bir' i Jonajt, sepse mish edhe gjak nukë t'a
sbutoj ty *këtë*, po im Atë që është ndë qiejt.
18 Edhe unë po të them, Se ti je Pjetër *(shkëmp)*,
edhe përmbi këtë shkëmp dotë ndërtonj ki-
shënë t' ime; edhe dyert' e hadhit nukë dotë
19 kenë fuqi përmbi atë. Edhe dotë t'ap ty kjy-
çet' e mbretëris' së qiejvet; edhe ç' të lithç
mbi dhet, dotë jetë lidhurë ndë qiejt; edhe ç' të
sgithç mbi dhet, dotë jetë sgidhurë ndë qiejt.
20 Atëhere porositi nxënësit' e ti të mos i thonë
asnjeriu, se ay është Jisu Krishti.
21 Që atëhere Jisuj zuri t'u dëftenjë nxënëset
të ti, se duhetë të vejë ndë Jerusalim, edhe
të pësonjë shumë nga pleqt' e nga kryeprif-
tërit' e nga shkronjësitë, edhe të vritetë, edhe
22 të-tretënë ditë të ngjalletë. Atëhere Pjetri e
mori *mbë nj' anë*, e zuri t'a qertonjë, dyke
thënë, Letë të dhëmbetë vetëheja jote, Zot;
23 nukë dotë bënetë këjo te ti. Po ay ukthye e i
tha Pjetrit, Ikë prej meje, Satana, se më je

BKSH

skandhall; sepse s' ke ndër mënt punët' e Pe-
rëndisë, po punët' e njerësvet.
24 Atëhere Jisuj u tha nxënësvet të ti, Kush
të dojë të vinjë prapa meje, letë mohonjë
vetëhen' e ti, edhe letë ngrerë kryqin' e ti, edhe
25 letë vinjë pas meje. Sepse ay që të dojë të
shpëtonjë jetën' e ti, do t'a humbasë atë; edhe
ay që të humbasë jetën' e ti për punë t' ime,
26 do t'a gjenjë atë. Sepse ç'dobi ka njeriu, ndë
fitoftë tërë botënë, e të dëmëtonjë shpirtin' e
ti? apo ç'dotë apë njeriu për këmbyerje të
27 shpirtit të ti? Sepse ka për t'ardhur' i Bir' i nje-
riut ndë lavdit t' Atit të ti bashkë me ën-
gjëjt' e ti; edhe atëhere dot' j'a çpaguanjë
28 gjithë-si-cilit pas të-punuarit t' ati. Me te-vër-
tetë po u them juve, *se* janë ca nga ata që
rrinë këtu, të-cilëtë nukë dotë ngjëronjënë
vdekje, gjer sa të shohënë të Birin' e njeriut
dyke ardhurë ndë mbretërit të ti.

Krye 17.

1 Edhe pas gjashtë ditsh Jisuj merr më vetëhe
Pjetrin' edhe Jakovin' edhe Joaninë të vëllan'
e ati, edhe i ngjit mbë një mal të-lartë ve-
2 çanë. Edhe ndërroj fytyrënë përpara atyre;
edhe faqeja e ati ndriti posi djelli, edhe rro-
3 bat' e ati ubënë të-bardha posi drita. Edhe
ja tek uduknë atyreve Moisiu edhe Iliu dyke
4 folurë bashkë me atë. Edhe Pjetri upërgjeq e
i tha Jisujt, Zot, mirë është të jemi *ne* këtu; ndë

daç, letë bëjmë këtu tri tenda, një për ty, e një
5 për Moisinë, e një për Ilinë. Edhe ay tek po
ishte dyke folurë, ja tek i mbuloj ata një re e-
ndriçime; edhe ja një zë nga reja tek thoshte,
Ky është biri im i-dashuri, që e pëlqeva; atë
6 dëgjoni. Edhe nxënësitë kur dëgjuanë, ranë
7 përmbys, edhe ufrikësuanë fort. Po Jisuj erdhi
përanë, e i zuri, edhe tha, Ngreuni, e mos
8 ufrikësoni. Edhe ata kur ngritnë syt' e tyre
përpjetë, nukë panë asndonjë, përveç Jisunë
vetëmë.
9 Edhe tek sbritninë nga mali, Jisuj i poro-
siti, dyke thënë, Mos i thoni asnjeriu se ç'
patë, gjersa të ngallet' i Bir' i njeriut nga të-
10 vdekuritë. Edhe nxënësit' e ati e pyetnë, dyke
thënë, Përse pra thonë shkronjësitë, se du-
11 hetë të vinjë më përpara Iliu? Edhe Jisuj u-
përgjeq e u tha atyre, Iliu vjen më përpara,
edhe dotë vërë ndë vëntt gjithë *punëratë;*
12 Po unë po u them juve, se Iliu erdhi ndashti,
edhe nuk' e njohnë, po i bënë ç' deshnë; kështu
edhe i Bir' i njeriut ka për të pësuarë nga
13 ata. Atëhere e kupëtuanë nxënësitë, se u tha
për Joan Pagëzorinë.
14 Edhe ata kur erthnë te gjindja, i erdhi
përanë një njeri e i ra mbë gjunjë, dyke
15 thënë, Zot, përdëlle t' im bir, Sepse e zë lën-
gat' e hënësë, edhe heq keq; sepse shumë
16 herë bje ndë zjarr, e shumë herë nd' ujë; Edhe
e shpura te nxënësit' e tu, po nukë muntnë

BKSH

17 t' a shëronjënë. Edhe Jisuj upërgjeq e tha,
O bres i-pabesë edhe i-shtrëmbërë, gjer kur
dotë jem bashkë me ju? gjer kur dot' u du-
18 ronj juve? Bi-m'a-ni mua atë këtu. Edhe Jisuj
e qërtoj atë, edhe djalli dolli nga ay, edhe
djali ushërua që mb' atë herë.
19 Atëhere nxënësit' erthnë përanë Jisujt ve-
çanë, e thanë, Përse neve nukë muntmë t' a
20 nxjerm' atë? Edhe Jisuj u tha atyre, Për pa-
besërinë t' uaj; sepse me të-vërtetë po u them
juve, Ndë paçi besë sa një koqe sinapi, dot' i
thoni këti mali, Shko së-këtejmi atje, edhe
dotë shkonjë, edhe nukë dotë jetë gjë që të
21 mos muntni ju t' a bëni. Edhe ky komp nu-
kë del veç me të-falur' e me agjerim.
22 Edhe ata tek po silleshinë për qark ndë Ga-
lilet, Jisuj u tha atyre; I Bir'i njeriut dotë epetë
23 ndër duart të njerësvet; Edhe dot' a vrasën' atë,
edhe të-tretënë ditë dotë ngjalletë. Edhe aty-
re u erdhi keq fort.
24 Edhe kur erthnë ndë Kapernaum, erthnë
përanë Pjetrit ata që merninë *pagesën'* e të dy
dhrahmivet, edhe i thanë, A nukë paguan
25 mësonjësi juaj të dy dhrahmitë? Ay thotë,
Po. Edhe kur hyri ndë shtëpit, Jisuj e priti,
dyke thënë, Si të duketë, Simon? nga cilëtë
marrënë pagesa a të-dhëna mbretërit' e dheut,
26 nga bijt' e tyre, apo nga të-huajtë? Pjetri i
thot' ati, Nga të-huajtë. Jisuj i tha ati, Bijtë
27 pra janë të-liruarë. Po që të mos skandha-

BKSH

lisim' ata, shko ndë dett, e hith një grep,
edhe ngre peshkun' e-parë që të dalë, edhe
si t' i hapç gojënë, dotë gjenjç një statir;
merr-e, e ep-u' a atyre për mua edhe për ty.

Krye 18.

1 Nd' atë orë erthnë nxënësitë të Jisuj, e i
thanë, Vallë cili është më i-math ndë mbre-
2 tërit të qiejvet? Edhe Jisuj thirri përanë ve-
tëhes' së ti një çun të-vogëlë, edhe e qën-
3 droj atë ndë mest t' atyre, e tha, Me të-vër-
tetë po u them juve, ndë mos ukthefshi, e
të bëneni posi çunat' e-vegjëlë, nukë dotë
4 hyni ndë mbretërit të qiejvet. Kush të përu-
një pra vetëhen' e ti posi ky çun' i-vogëlë, ky
është më i-math ndë mbretërit të qiejvet;
5 Edhe kush të presë një të-këtillë çun të-vo-
gëlë mb' emërit t' im, më ka priturë mua.
6 Po kush të skandhalisnjë një nga këta të-
vegjëlitë që më mbesojnë, është më mirë për
atë të varetë një gur mulliri mbi qafët t' ati,
edhe të kredhetë ndë funtt të detit.
7 Mjerë bota nga skandhalitë; sepse është
nevojë të vinjënë skandhalitë; po mjerë ay
8 njeri, prej të-cilit vjen skandhalia. Edhe ndë
të skandhalistë dora jote a këmba jote, pre-
i, edhe hidh-i prej teje; është më mirë për
ty të hynjç ndë jetët i-çalë a dorac, se të
kesh dy duar a dy këmbë, e të hidhesh ndë
9 zjarrt të-pasosurë. Edhe ndë të skandhalistë

syri yt, nxir-e atë, e hidh-e prej teje; më
mirë është për ty të hynjç ndë jetët me një
sy vetëmë, se të kesh dy sy, e të hidhesh ndë
gjehenet të zjarrit.
10 Shikoni, mos bëni për asgjë një nga këta
të-vegjëlitë; sepse po u them juve, se ëngjëjt'
e atyre ndë qiejt shohënë gjithënjë faqen' e
11 t' im Eti që është ndë qiejt. Sepse i Bir' i
12 njeriut erdhi të shpëtonjë të-humburinë. Ç' u
duketë juve? ndë pastë ndonjë njeri një qint
dhën, edhe t' i humbasë një nga ato, a nukë
le të nënte-dhjet' e nëntatë, e vete ndëpër
13 malet të kërkonjë të-humburënë? Edhe ndë
qoftë se e gjen, me të-vërtetë po u them ju-
ve, se gëzonetë më tepërë për atë se për të
nëntë-dhjet' e nëntatë, që s' kanë humburë.
14 Kështu nuk' ësht' e-dashurë përpara Atit
t' uaj që është ndë qiejt të humbasë një
nga këta të-vegjëlitë.
15 Edhe ndë të bëftë faj yt vëlla, shko edhe
qerto-e ndë mest teje edhe t' ati vetëmë; ndë
16 të dëgjoftë, e fitove t' ët vëlla; Po ndë mos
të dëgjoftë, merr me vetëhe edhe një a dy
veta, që të qëndronjë çdo fjalë ndë gojë dy
17 a tre dëshmimtarëve. Edhe ndë mos i dë-
gjoftë ata, thua-j'a *këtë* kishësë; edhe ndë
mos e dëgjoftë edhe kishënë, *atëhere ay* letë
18 jetë të ti posi gjentari e kumerqari. Me të-
vërtetë po u them juve, Ç' të lithni mbi dhet,
dotë jenë lidhurë ndë qiellt; edhe ç' të sgith-

BKSH

ni mbi dhet, dotë jenë sgidhurë ndë qiellt.
19 Përsëri po u them juve, se ndë qofshinë mbi
dhet dy *veta* nga ju mbë një fjalë, për çdo
fare gjëje që të lypnjënë, dot' u bënet' atyre
20 nga im Atë që është ndë qiejt. Sepse ku të
jenë dy a tre *veta* mbledhurë mb' emërit t' im,
atje jam *edhe unë* ndë mest t' atyre.
21 Atëhere i erdhi përanë Pjetri, e tha, Zot,
sa herë të më fëjenjë im vëlla, edhe t' j' a
22 fal ati? gjer mbë shtatë herë? Jisuj i thot' ati,
Nukë të them, gjer mbë shtatë herë, po gjer
23 mbë shtatë-dhjetë herë *nga* shtatë. Përandaj
mbretëri' e qiejvet gjau me një njeri mbret,
që deshi të shohë llogari me shërbëtoret' e ti.
24 Edhe kur zuri të shohë llogari, i prunë një
detuar që i kishte detyrë dhjetë mije tallan-
25 da. Edhe *ay* passi nukë kishte t' i lanjë, i
zoti urdhëroj të shitet' ay, edhe gruaj' e ati,
edhe të bijtë, edhe gjithë ç' kishte, edhe të
26 lahetë *detyra.* Po shërbëtori i ra ndër këmbë,
e i lutej, dyke thënë, Zot, bënu zëmërë-gjerë
27 mbë mua, edhe dotë t' i lanj të-gjitha. Edhe
të zott si i udhëmp për atë shërbëtuar, e
28 lëshoj, edhe j' a la detyrënë. Po ay shërbë-
tuar si dolli, gjeti një nga shokët' e ti shër-
bëtorë që i kishte detyrë ati një qint dinare;
edhe si e zuri, e mbyste, dyke thënë, Laj-më
29 ç' detyrë më ke. *Atëhere* pra shoku i ti shër-
bëtuar i ra ndër këmbë, e i lutej, dyke thënë,
Bënu zëmërë-gjerë mbë mua, edhe dotë t' i

30 lanj të-gjitha. Edhe ay nukë donte, po shkoj
edhe e vuri ndë burk, gjersa t' i lante dety-
31 rënë. Edhe shokët' e ti shërbëtorë, kur panë
se ç' ubë, uhelmuanë fort; edhe erthnë e i
32 rrëfyenë të zott gjithë sa ubënë. Atëhere i
zoti e thirri përanë, e i tha, Shërbëtuar i-lik,
gjith' atë detyrë t' a lashë ty, sepse m' ulute;
33 Nukë duhej edhe ti t' a përdëllenje shoknë
t' ënt shërbëtuar, sindëkur të përdëlleva edhe
34 unë ty? Edhe i zoti uzemërua, edhe e dha
ndër duart t' atyre që mundojnë, gjer sa të
35 lanjë gjithë detyrënë që i kishte ati. Kështu
edhe im Atë qiellori dot' u' a bënjë juve, ndë
mos u' a falçi prej zëmërësë s' uaj gjithë-si-
cili të vëllat të ti fajet' e atyre.

Krye 19.

1 Edhe Jisuj kur mbaroj këto fjalë, ungrit
nga Galilea, edhe erdhi ndë sinorët të Judhesë,
2 përtej Jordhanit; Edhe i vanë pas ati shumë
gjindje; edhe i shëroj ata atje.
3 Edhe erthnë tek ay Farisenjtë dyke ngarë
atë, e dyke thënë ati, A ësht' e udhësë njeriu
të lëshonjë gruan' e ti për çdo· farë ngaje?
4 Edhe ay upërgjeq e u tha atyre, Nukë keni
kënduarë, se ay që bëri ata që ndë kryët të
herësë, mashkull edhe femërë i bëri ata,
5 edhe tha, „Për këtë *punë* njeriu dotë lerë
t' an' e t' ëmënë, edhe dotë ngjitetë pas gru-
as' së ti, edhe të dy dotë jenë një mish"?

BKSH

6 kaqë sa nukë janë me dy, po një mish. Atë
pra që Perëndia e bëri par, njeriu letë mos
e ndanjë.
7 I thon' ati, Përse pra Moisiu ka porosi-
turë t'i apë *njeriu gruasë* kartën' e ndarjesë,
8 edhe t'a lëshonjë? U thot' atyre, Sepse Moisiu
për zëmër-ashpërimnë t' uaj u dha juve lejë të
lëshoni gratë t' uaj; po ndë kryet të herësë
9 s' ka qënë kështu. Edhe po u them juve, se
ay që të lëshonjë gruan' e ti, përveç për punë
kurvërie, edhe të martonetë me tjatërë, kur-
vëron: edhe ay që të martonetë me grua të-
lëshuarë, kurvëron.
10 Nxënësit' e ti i thonë, Ndë qoftë kështu
pun' e njeriut me gruanë, nuk' është mirë të
11 martonetë. Edhe ay u thot' atyre, Nukë munt
t'a presënë këtë fjalë të-gjithë, po atyreve që
12 u është dhënë. Sepse ka të-dredhurë që kanë
lindurë kështu që nga barku i mëmësë; edhe
ka të-dredhurë që udrothnë nga njerëzitë;
edhe ka të-dredhurë që drothnë vetëhen' e
tyre për mbretërin' e qiejvet. Ay që munt t'a
presë *këtë* let' a presë.
13 Atëhere i uprun' ati ca çuna të-vegjëlë, që
të vinte duartë mbi ata, e t' i bekonte; edhe
14 nxënësitë i qertuanë. Po Jisuj tha, Lini çunat'
e-vegjëlë, edhe mos i ndaloni të vijnë tek
unë; sepse e të-këtillëvet është mbretëri' e
15 qiejvet. Edhe si vuri duartë mbi ata, iku andej.
16 Edhe ja tek i erdhi përanë një *njer*i, e i

tha, Mësonjës i-mirë, ç' të-mirë të bënj që të
17 kem jetë të-pasosurë? Edhe ay i tha, Ç' më
thua i-mirë? Asndonjë s' ësht' i-mirë veç një
Perëndia. Po ndë do të hynjç ndë jetët, ruaj
18 porositë. I thot' ati, Cilatë? Edhe Jisuj i tha,
„Mos vraç; mos kurvërojsh; mos vjethç; mos
apç dëshmim të-rrem; Ndero të t' at' e t' ët
19 ëmë;" edhe „Të duash të-afërminë t' ënt posi
20 vetëhenë t' ënde." Djaloshi i thot' ati, Të-gjitha
këto i kam ruajturë që mbë të-rit t' im; po
21 ç' më mbetetë më? Jisuj i tha ati, Ndë do të
bënesh i-sosurë, shko e shit gjënë t' ënde,
edhe ep-u'a të-vobeqvet; edhe dotë kesh the-
22 sar ndë qiell, edhe eja, e ngit-m'u pas. Po
djaloshi kur dëgjoj këtë fjalë, iku i-helmuarë,
sepse kishte shumë gjë.
23 Edhe Jisuj u tha nxënësvet të ti, Me të-
vërtetë po u them juve, se *njeriu* i-pasurë
mezi dotë hynjë ndë mbretërit të qiejvet.
24 Edhe përsëri po u them juve, Më kollaj është
të shkonjë kamilla ndëpër vrimet të gjëlpë-
rësë, se të hynjë i-pasuri ndë mbretërit të
25 Perëndisë. Edhe nxënësit' e ti, kur dëgjuanë,
tmeroneshinë fort, e thoshinë, Vallë cili munt
26 të shpëtonjë? Po Jisuj shtyri sytë *mb' ata* e u
tha atyre, Të njerëzitë këjo është *punë* që s'
munt *të bënetë*, po te Perëndia të-gjitha janë
të-mundura.
27 Atëhere upërgjeq Pjetri e i tha ati, Ja ne
tek lamë të-gjitha, edhe erdhmë prapa teje;

28 vallë ç'dotë jetë mbë ne? Edhe Jisuj u tha atyre,
Me të-vërtetë po u them juve, se ju që më erthtë
pas, ndë krijesët të-re, kur të rrijë i Bir' i njeriut
mbi front të lavdis së ti, dotë rrini edhe ju mbi
dy-mbë-dhjetë ftone dyke gjykuarë të dy-mbë-
29 dhjetë farat' e Israilit. Edhe kushdo që la shtëpi,
a vëllezër, a motëra, a atë, a mëmë, a grua, a bij,
a ara, për *punë* t' emërit' t' im, dotë marrë një
qint për një, edhe dotë trashëgonjë jetë të-
30 pasosurë. Po shumë të-parë dotë jenë të-pra-
pësm, edhe të-prapësm të-parë.

Krye 20.

1 Sepse mbretëri' e qiejvet gjan me *një* njeri
zot shtëpie, i-cili dolli që me natë të paj-
2 tonjë punëtorë për veshtin' e ti; Edhe si paj-
toj punëtorëtë nga një dinar ndë ditët, i
3 dërgoj ndë veshtet të ti. Pastaj dolli ndaj të-
tretënë orë, e pa të-tjerë dyke ndënjurë ndë
4 trekt pa punë. U thot' edhe atyre, Shkoni
edhe ju ndë veshtet, edhe dot' u ap ç' të jet'
5 e udhësë. Edhe ata vanë. Përsëri dolli ndaj të-
gjashtëtën' edhe të-nëntëtën' orë, edhe bëri po
6 actu. Edhe si dolli ndaj të-një-mbë-dhjetëtën'
orë, gjeti të-tjerë dyke ndënjurë pa punë; u
thot' edhe atyre, Përse rrini këtu tërë ditënë
7 pa punë? I thon' ati, Sepse asndonjë s' na pajtoj.
U thot' atyre, Shkoni edhe ju ndë veshtët, edhe
8 dotë merni ç' të jet' e udhësë. Edhe si ungrys,
i zot' i veshtit i thotë kujdestarit të ti, Thirrë

punëtorëtë, edhe laj-u pagënë atyre, dyke
zënë nga të-prapësmitë gjer mbë të parët.
9 Edhe erthnë ata *që ishinë pajtuarë* ndaj të-
një-mbë-dhjettënë orë, edhe muarnë nga një
10 dinar. Edhe kur erthnë të-parëtë, pandehnë
se dotë marrënë më shumë; po edhe ata
11 muarnë nga një dinar. Edhe si muarnë, qa-
heshinë mbë të zon' e shtëpisë, dyke thënë,
12 Se këta të-prapësmitë bënë një orë, edhe i
bërë si-një-një me ne që mbajtmë të-rëndit'
13 e ditës' edhe vapënë. Po ay upërgjeq e i tha
njerit nga ata, Mik, nukë të bënj keq; a nukë
14 bëre fjalë me mua një dinar? Merr t' ëndinë
edhe ikë; edhe këti të-prapësmit dot' i ap si
15 edhe ty; Apo s' munt unë të bënj ç' të dua
ndë punët t' ime? apo syri yt ësht' i-lik, se-
16 pse unë jam i-mirë? Kështu dotë jenë të-pra-
pësmitë të-parë, edhe të-parëtë të-prapësm;
sepse shumë *veta* janë të-thirrurë, po të-pakë
të-sgjedhurë.
17 Edhe Jisuj dyke hipurë ndë Jerusalim,
mori me vetëhe të dy-mbë-dhjetë nxënësitë
18 mbë nj' anë mb' udhë, edhe u tha atyre, Ja
tek po hipëjmë ndë Jerusalim, edhe i Bir' i
njeriut dot' epetë ndë duart të krye-priftëret
edhe të shkronjësvet; edhe dot' a dënonjënë ndë
19 vdekje; Edhe dot' a apënë ndë duart të kom-
bevet që t'a përqeshnjën' e t'a rrahën' e t'a
kryqëzonjënë; edhe të-tretënë ditë dotë
ngjalletë.

20 Atëhere i erdhi përanë e ëm' e të bijvet
të Zëvëdheut bashkë me të bijtë, dyke lu-
21 turë, e dyke lypurë një gjë nga ay. Edhe ay
i tha asaj, Ç' do? *Ajo* i thot' ati, Thuaj të rrinë
këta të dy bijt' e mi, njeri mbë të-djathtët
t' ënt, e njeri mbë të-mëngjërët, ndë mbretë-
22 rit t' ënde. Po Jisuj upërgjeq e tha, Nukë
dini se ç' lypni; muntni të pini kupënë, që dotë
pi unë, edhe të pagëzoneni me pagëzimnë që
dotë pagëzonem unë? *Ata* i thon' ati, Munt-
23 më. Edhe *ay* u thot' atyre, Kupënë t' ime dot'
a pini, edhe me pagëzimnë që pagëzonem
unë dotë pagëzonemi; po të rrini mbë të-
djathtët t' im edhe mbë të-mëngjërët t' im,
nuk' është në dorët t' ime t'a ap, po dot'
u epet' atyre që u është bërë gati nga im Atë.
24 Edhe të dhjetëtë, kur dëgjuanë, uzëmë-
25 ruanë për të dy vëllezëritë. Po Jisuj i thirri
ata e tha, E dini se të-parët' e kombevet
kanë pushtet mbi ata, edhe të-mëdhenjt' i ur-
26 dhërojn' ata; Po kështu nukë dotë jetë ndër
ju; po kush të dojë të bënet' i-math nder ju,
27 letë jetë shërbëtori juaj; Edhe kush të dojë
të jet' i-parë ndër ju, letë jetë shërbëtori juaj;
28 Sikundrë i Bir' i njeriut nuk' erdhi që të
shërbenetë, po që të shërbenjë, edhe t' apë
jetën' e ti çpërblim për shumë *veta*.
29 Edhe ata tek po dilninë nga Jerihoja, i
30 vanë pas ati shumë gjindje. Edhe ja dy të-
verbërë, që rrininë mb' udhët, kur dëgjuanë,

BKSH

se po shkonte Jisuj, bertitnë, dyke thënë, Për-
31 dëlle-na, o Zot, bir' i Dhavidhit. Edhe gjindja
i qertoj ata, që të pushoninë; po ata bërtit-
ninë më fort, dyke thënë, Përdëlle-na, o Zot,
32 bir' i Dhavidhit. Edhe Jisuj qëndroj e i thirri
33 ata, edhe tha, Ç'doni t'u bënj juve? I thonë,
34 Zot, të na hapenë sytë. Edhe Jisujt si i u-
dhëmp *për ta*, preku syt' e atyre; edhe për-
një-here uhapnë syt' e atyre, e vanë pas ati.

Krye 21.

1 Edhe kur uaferuanë ndë Jerusalim, edhe
erthnë ndë Vithfagji ndaj malit të Ullinjvet,
atëhere Jisuj dërgoj dy nxënës, dyke thënë aty-
2 re, Shkoni mb' atë fshat që është përkundruell
jush; edhe për-një-here dotë gjeni një go-
mare lidhuré, edhe një pulisht bashkë me atë;
3 sgidh-i-ni e m' i bini. Edhe ndë u thëntë gjë
juve ndoŋë *njeri*, t' i thoni, se Zoti ka nevojë
për atë; edhe për-një-here dot' i dërgonj' ata.
4 Edhe gjithë këjo ubë, që të mbushetë ç'
5 është thënë nga profiti, që thoté, „Thoni bi-
jësë Sionë; Ja mbreti yt tek po të vjen i-butë,
edhe hipurë mbi gomare, edhe mbi pulisht
bir stëze."
6 Edhe nxënësitë si vanë, edhe bënë sindë-
kur i urdhëroj ata Jisuj, prunë gomaren' edhe
7 pulishtinë; Edhe vunë mbi ata rrobat' e tyre
8 edhe e hipnë *atë* sipër' atyre. Edhe më e-
shum' e gjindjesë shtruanë rrobat' e tyre mb'

udhë; edhe të-tjerë këputninë dega drush, e
9 i shtroninë mb' udhë. Edhe gjindja që shko-
ninë përpara edhe ata që i vininë prapa bër-
titninë, dyke thënë, Hosanna mbë të birin' e
Dhavidhit; i-bekuar' ësht' ay që vjen mb' e-
10 mërit të Zotit; Hosanna mbë të-lartatë. Edhe
ay kur hyri ndë Jerusalim, utunt tërë qyteti
11 dyke thënë, Cili është ky? Edhe gjindja tho-
shinë, Ky është Jisuj, profiti, që është nga Na-
zareti i Galilesë.
12 Edhe Jisuj hyri ndë hieroret të Perëndisë,
edhe nxori jashtë gjith' ata që shisnin' e blininë
ndë hieroret, edhe përmbysi truvezat' e tru-
vezarëvet, edhe fronet' e atyre që shisninë
13 pëllumbatë; Edhe u thot' atyre, Eshtë shkru-
arë „Shtëpia ime dotë qyhetë shtëpi lutjeje";
po ju e bët' atë „shpellë vjedhësish".
14 Edhe i erthnë përanë të-verbër' e të-çalë
15 ndë hieroret; edhe i shëroj ata. Po krye-prif-
tërit' edhe shkronjësitë kur panë çudiratë që
bëri, edhe çunatë dyke bërtiturë ndë hieroret
e dyke thënë, Hosanna mbë të birin' e Dha-
vidhit, uzëmëruanë, edhe i than' ati, Dëgjon
16 se ç' thonë këta? Edhe Jisuj u thot' atyre, Po;
kurrë s' keni kënduarë, „Se nga goj' e fosh-
njavet edhe e atyreve që pinë sisë bëre gati
lavdim?"
17 Edhe si i la ata, dolli jashtë qytetit ndë
Vithani, edhe natën' e shkoj atje.
18 Edhe ndë mëngjest kur ukthue ndë qytett,

19 i erdhi uri; Edhe kur pa një dru fiku mb'
udhë, erdhi mb' atë, po nukë gjeti gjë mb'
atë, veç fletë vetëmë; edhe i thotë, Mos ubëftë
më pemë prej teje për gjithë jetënë. Edhe
20 drur' i fikut për-një-here utha. Edhe nxënë-
sitë kur panë, uçuditnë, e thanë, Qysh utha
21 drur' i fikut për-një-here! Edhe Jisuj upër-
gjeq e u tha atyre, Me të-vërtetë po u them
juve, ndë paçi besë, edhe të mos jeni me dy
mëndje, jo vetëmë këtë të drurit të fikut kini
për të bërë, po edhe këti mali ndë i thënçi,
22 Ngreu edhe bjerë ndë dett, dotë bënetë. Edhe
gjithë sa të lypni ndë lutjet, dyke pasurë
besë, dot' i merrni.
23 Edhe kur erdhi ndë hieroret, erthnë pë-
ran' ati, atje ku mësonte, krye-priftërit' edhe
pleqt' e llauzit, e thoshinë, Me ç' farë push-
teti bën këto? edhe kush t' a ka dhënë këtë
24 pushtet? Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre,
Dot' u pyes edhe unë juve një fjalë, të-cilënë
ndë m'a thënçi, edhe unë dot' u them juve me
25 ç' fare pushteti bënj këto. Pagëzimi i Joa-
nit nga ishte? nga qielli a nga njerëzitë?
Edhe ata mendoneshinë me vetëhen' e tyre,
dyke thënë, Ndë thënçimë, Nga qielli dotë na
26 thotë, Përse nuk' i mbesuatë pra? Edhe ndë
thënçimë, Nga njerëzitë, kemi frikë prej gjin-
djesë; sepse të-gjithë e kanë Joanë për pro-
27 fit. Edhe i upërgjeqnë Jisujt, e i thanë, Nuk
e dimë. Edhe ay u tha atyre, as unë s' u them
juve me ç' farë pushteti bënj këto.

BKSH

28 Edhe qysh u duketë juve? Një njeri kish-
te dy bij; edhe erdhi tek i-pari e i tha, Bir, shko
29 sot e puno ndë vreshtët t'im. Edhe ay upër-
gjeq e tha, Nukë dua; po pastaj upendua,
30 edhe vate. Edhe erdhi tek i-dyti, e i tha po
ashtu; Edhe ay upërgjeq e tha, unë *vete* Zot;
31 edhe nukë vate. Cili nga këta të dy bëri da-
shurimn' e t'et? I thonë, I-pari. Jisuj u thot'
atyre, Me të-vërtetë po u them juve, se ku-
merqarët' edhe kurvatë venë më përpara se
32 ju ndë mbretërit të Perëndisë. Sepse Joani
erdhi te ju ndë udhë drejtërie, edhe nuk' i
besuatë; po kumerqarët' e kurvatë i besuanë;
edhe ju si patë, nuk' upenduatë pastaj, që
t' i besoni.
33 Dëgjoni një tjatërë paravoli: Një njeri
ishte zot shtëpie, i-cili mbolli një vreshtë,
edhe e thuri me garth, edhe rëmoj mb' atë
një tirë, edhe ndërtoj një pirk; edhe e dha
atë ndër buiqër, edhe iku ndë dhe të-huaj.
34 Edhe kur uafërua koh'e pemëvet, dërgoj shër-
bëtorët' e ti te bujqëritë, që të marrënë pe-
35 mët' e ati. Edhe bujqëritë zunë shërbëtorët' e
ati, e njerin' e rrahnë, e tjetërin' e vranë, e
36 tjetërinë e vranë me gurë. Përsëri dërgoj të-
tjerë shërbëtorë, më tepërë se të-parëtë, po
37 ashtu u'a bënë edhe atyrë. Edhe pastaj dër-
goj të birrë tek ata, dyke thënë, t'im biri dot
38 i kenë turp. Po bujqëritë kur panë të birinë,
thanë njeri tjerërit, Ky është trashëgimtari;

BKSH

ejani t'a vrasëmë, edhe të mbajmë trashëgimn'
39 e ati. Edhe si e zunë, e nxuarnë jashtë vresh-
40 tit, edhe e vranë. Kur të vinjë i zot' i vresh-
tit, ç' dot' u bënjë atyre bujqërvet?
41 I thonë, Keq e më keq dot' i prishnjë, edhe
vreshtinë dot' u'a apë të-tjerë bujqërve, të-
cilëtë dot' j'a apënë pemëtë ndë kohët t' atyre.
42 Jisuj u thot' atyre, Kurrë s' keni kënduarë
ndë shkronjat, „Gurinë, që s' e pëlqyen' ata
që ndërtonjënë, ky ubë për krye çipi; nga
Zoti ubë këjo, edhe ësht' e-çudiçime ndë syt
43 t' anë?" Përandaj po u them juve, se mbre-
tëri' e Perëndisë dotë merretë nga ju, edhe
dotë epetë mbë një komp që bën pemët' e
44 asaj. Edhe ay që të bjerë mbi këtë gur, dotë
copëtonetë; edhe mbi atë që të bjerë dot' a
dërmonjë.
45 Edhe krye-priftërit' edhe Farisenjtë kur
dëgjuanë paravolit' e ati, e kupëtuanë, se
46 thotë për ata; Edhe kërkoninë t' a zënë, po
patnë frikë prej gjindjesë, sepse e kishinë atë
si profit.

Krye 22.

1 Edhe Jisuj upërgjeq përsëri e u tha atyre
me paravolira, dyke thënë,
2 Mbretëri' e qiejvet gjan me një njeri mbret,
3 i-cili bëri dasmë për të birr' e ti; Edhe dër-
goj shërbëtorët' e ti të thërresën' ata që qenë
ftuarë ndë dasmët, po nukë deshnë të vinjë-

4 në. Përsëri dërgoj të-tjerë shërbëtorë, dyke
thënë, thoj-u-ni atyre që janë ftuarë, Ja tek
bëra gati drekënë t'ime; demat'e mi edhe
berrat' e-ushqyera *janë* gati; ejani ndë das-
5 mët. Po ata përtuan'e shkuanë, njeri n' arët
6 të ti, e tjetëri ndë tregëtit të ti; Edhe të-tje-
rëtë zunë shërbëtorët'e ati, e i shanë, e i vranë.
7 Po mbreti kur dëgjoj uzëmërua; edhe
dërgoj ushtërit' e ti, edhe prishi ata gjakso-
8 rëtë, edhe dogji qytetn' e atyre. Atëhere u
thotë shërbëtorëvet të ti, Dasma është gati,
po ata që qenë të-ftuarë nuk' ishinë të-vëjej-
9 turë. Shkoni pra ndëpër të-dalurat të udhë-
vet, edhe sa të gjeni, t' i ftoni ndë dasmët.
10 Edhe ata shërbëtorëtë duallnë ndëpër udhët,
e mblothnë gjitë sa gjetnë, të-liq e të-mirë;
edhe dasma umbush me njerës që rrininë
11 ndë mësallët. Edhe mbreti kur hyri të shohë
ata që rrininë ndë mësallët, pa atje një njeri
12 që s' kishte veshurë rrobë dasme. Edhe i thot'
ati, Mik, si hyre këtu pa pasurë rrobë dasme?
13 Po ay mbëçëli gojënë. Atëhere mbreti u tha
shërbëtorëvet, Lidh-e-ni atë prej këmbësh e
prej duarsh, edhe ngri-e-ni, edhe hidh-e-ni
ndë errësirët të-përjashtësme; atje dotë jetë
14 të-qarët' e të kërcellliturit' e dhëmbëvet. Sepse
shumë veta janë të-thirrurë, po të-pakë të-
sgjedhurë.
15 Atëhere Farisenjtë van' e bënë këshillë, si
16 t'a zënë ndë lak me fjalë. Edhe dërgojnë tek

BKSH

ay nxënësit' e tyre bashkë me Irodhianëtë,
dyke thënë, Mësonjës, e dimë se je i-vërtetë,
edhe mëson udhën' e Perëndisë me të-vërtetë
edhe nukë do të dish as për ndonjë gjë: se-
17 pse nukë shikon mbë faqe njerëzish. Thu-
aj-na pra, Ç' të duketë? është e udhesë t' i
18 apëmë pagesë Qesarit, apo jo? Po Jisuj si
njohu djallëzin' e atyre, tha, Ç' më ngisni, i-
19 pokritër? Dëfte-më-ni monedhën' e pagesësë.
20 Edhe ata i prunë një dinar. Edhe ay u thot'
atyre, E kùjt është këjo fytyrë edhe këjo
21 përmbishkonjë? Ata i thonë, E Qesarit. Atë-
here u thot' atyre, Epni pra Qesarit ç' janë të
Qesarit, edhe Perëndisë ç' janë të Perëndisë.
22 Edhe *ata* kur dëgjuanë uçuditnë; edhe e lan'
atë, e iknë.
23 Nd' atë ditë i erthnë përanë Sadduqenj,
të-cilëtë thonë se nukë ka të-ngjallurë; edhe
24 e pyetnë, dyke thënë, Mësonjës, Moisiu tha,
„Ndë vdektë ndonjë pa pasurë bij, i vëllaj
dotë martonetë me gruan' e ati", edhe dot' i
25 ngjallinë fare të vëllajt të ti. Edhe ishinë ndër
ne shtatë vëllezër; edhe i-pari si umartua,
vdiq; edhe passi nukë kishte bir, j'a la gru-
26 an' e ti të vëllajt të ti; Kështu edhe i-dyti,
27 edhe i-treti, gjer mbë të-shtatëtinë. Edhe më
28 pastaj nga të-gjithë vdiq edhe gruaja. Mbë
të-ngjallurit pra, e kujt nga këta të shtatë
dotë jetë grua? sepse të-gjithë e patnë
marrë atë.

29 Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Jeni të-
gënjyerë, se nukë dini shkronjatë, as fuqin'
30 e Perëndisë. Sepse mbë të-ngjallurit as mar-
tonenë, as martonjënë, po janë posi ëngjëj të
31 Perëndisë ndë qiell. Edhe për të-ngjallurit'e
të-vdekurvet a s'kini kënduarë ç'u është thënë
32 juve prej Perëndisë, kur thotë, „Unë jam Pe-
rëndia i Avraamit, edhe Perëndia i Isaakut,
edhe Perëndia i Jakovit?" Perëndia nuk'është
33 Perëndi të-vdekurish, po të-gjallësh. Edhe
gjindja kur dëgjuanë, tmeroneshinë për më-
simn' e ati.
34 Po Farisenjtë kur dëgjuanë se u mbylli
35 gojënë Sadduqenjvet, umblothnë bashkë. Edhe
një nomtar nga ata e pyeti dyke ngar' atë, e
36 dyke thënë; Mësonjës, cila porosi *ësht* e-ma-
37 dhe ndë nomt? Edhe Jisuj i tha ati, „Të
duash Zotinë Perendinë t'ënt me gjithë zëmë-
rënë t'ënde, edhe me gjithë shpirtinë t'ënt,
38 edhe me gjithë mëndjenë t'ënde. Këjo është
39 porosi e-parë edhe e-madhe. Edhë e-dyta që
është si-një-një me atë *është*. „Të dûash të-
40 afërminë t' ënt posi vetëhenë t' ënde." Gjithë
nomi edhe profitëritë varenë mbë këto të dy
porosira.
41 Edhe tek ishinë mbledhurë Farisenjtë,
42 Jisuj i pyeti, dyke thënë, Ç' u duketë juve
për Krishtinë? i bir' i kujt është? I thonë, I
43 Dhavidhit. U thot' atyre, Qysh pra Dhavidhi
44 me Frymë e quan atë Zot, dyke thënë, „I tha

BKSH

Zoti Zotit t'im, Rri mbë të-djathtët t'im gjërsa
të vë armiqt' e tu ndënë këmbje të këmbë-
45 vet të tua?“ Ndë qoftë pra se Dhavidhi e
46 quan Zot, si ësht' i bir' i ati? Edhe asndonjë
nukë muntte t'i përgjigjej ndonjë fjalë; as
nukë kuxoj ndonjë që mb' atë ditë t'a pyesë
atë më.

Kyre 23.

1 Atëhere Jisuj i foli gjindjesë edhe nxënës-
2 vet të ti, Dyke thënë, Shkronjësit' edhe Fari-
3 senjtë ndënjtnë mbi front të Moisiut; Gjithë
sa t'u thonë pra juve t'i ruani, t'i ruani edhe
t'i bëni; po pas punëravet t'atyre mos bëni;
4 sepse thonë edhe nukë bënjënë. Sepse lith-
njënë barrë të-rënda që nukë mbahenë, edhe
i vënë përmbi kurrist te njerësvet; po me
5 gishtin' e tyre nukë duanë t'i luanjënë. Edhe
gjithë punët' e tyre i bëjnë që të dukenë
ndër njerëzit; edhe sgjeronjënë ruajtjet' a tyre
edhe madhonjënë pëqinjt' e rrobavet të tyre;
6 Edhe duanë kryet' e mësallësë ndëpër darkat,
7 edhe vëndet' e-parë ndëpër sinagogjit; Edhe
të-përshëndoshuratë ndëpër tregjet, edhe të
8 qyhenë nga njerëzitë, Pavvi*). Po ju mos quhi
Pavvi sepse një është mësonjësi juaj, Krishti,
9 edhe të-gjithë ju jeni vëllezër. Edhe mos qu-
ani *ndonjë* atë për ju mbi dhet; sepse një
10 është Ati juaj, ay që është ndë qiejt. As mos

*) Mësonjës

BKSH

quhi mësonjës; sepse një është mësonjësi
11 juaj, Krishti. Po më i-madhi prej jush dotë
12 jetë shërbëtori juaj. Edhe kush të lartësonjë
vetëhen' e ti, dot' unjetë; edhe kush të unjë
vetëhen' e ti, dotë lartësonetë.
13 Po mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipo-
kritër; sepse mbyllni mbretërin'e Perëndisë
përpara njerëzet; sepse ju nukë hyni, edhe
as ata që hynjënë nuk i lini të-hynjënë.
14 Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipo-
kritër; sepse hani shtëpirat' e të-vejavet, edhe
këtë e bëni me shkak se bëni të-falura të-
gjata; përandaj dotë merrni më tepërë mundim.
15 Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokri-
tër; se shetitni detin' edhe tokënë për të bërë
një të-kthyerë; edhe si të bënetë, e bëni atë
bir gjehenne dy herë më tepërë se vetëhe-
në t' uaj.
16 Mjerë ju udhëheqës të-verbërë, që thoni,
Kush të bënjë be mbë tempullinë, nuk'
është gjë; po kush të bënjë be mb' arin' e
17 tempullit, bënetë detuar. Të-marrë edhe të-
verbërë! sepse cili është më i-math, ari, apo
18 tempulli që shënjtëron arinë? Edhe Kush të
bënjë be mbë therorenë, nuk' është gjë; po
kush të bënjë be mbë dhurëtinë që është mbi
19 atë, bënetë detuar. Të-marrë edhe të-verbë-
rë! sepse cila *është* më e-madhe, dhurëtia,
20 apo therorja që shënjtëron dhurëtinë? Ay
pra që të bënjë be mbë therorenë, bën be

BKSH

mb' ate, edhe mbë gjith' ato që janë përmbi
21 atë. Edhe ay që të bënjë be mbë tempullinë,
bën be mb' atë, edhe mb' atë që rri nd' atë.
22 Edhe ay që bën be mbë qiellë, bën be mbë
fron' e Perëndisë, edhe mb' atë që rri mb' atë.
23 Mjerë ju shkronjës e Farisenj, ipokritër;
sepse epni të-dhjettën' e mëndresë, e të ma-
ràjt e të qiminit; edhe kini lënë më të-rën-
dat' e nomit, gjyqin' edhe përdëllimin' edhe
besënë; këto gjan t'i bëni, edhe ato të mos
24 i lini. Udhëheqës të-verbërë, që shtrythni mi-
shkonjënë, edhe kamillën' e përpini.
25 Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokri-
tër; sepse qëroni të-përjashtësmen' e potirit
edhe të kupësë, po përbrenda janë plot me
26 rrëmbyerje e pa-vetëmbajtje. Farise i-verbërë,
qëro më përpara atë që është brënda ndë
potirt edhe ndë kupët, që të bënet' e-qëruarë
edhe e-përjashtësmja e atyre.
27 Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokri-
tër; sepse gjani me varre të-lyerë me kël-
qere, të-cilëtë përjashta dukenë të-bukurë, po
përbrënda janë plot me eshtëra të-vdekurish
28 e çdo farë ndyrësie. Kështu edhe ju, përjashta
dukeni të-drejtë te njerëzitë, po përbrenda
jeni plot me ipokrisi e me panomi.
29 Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokri-
tër; sepse ndërtoni varret' e profitërvet edhe
30 stolisni mnimoret' e të-drejtëvet; Edhe thoni,
Po të ishimë ne ndë ditt të atërvet t' anë,

nukë dotë ishimë pjesëtarë me ata ndë gjakt
31 të profitërvet. Kështu pra dëshmoni për ve-
tëhenë t' uaj, se jeni të bijt' e atyre që vranë
32 profitëritë. Mbushni edhe ju masën' e atërvet
33 tuaj. Gjerpinj, të-pjellë nepërkash, qysh dotë
34 ikëni nga dënimi i gjehennësë? Përandaj, ja
unë tek dotë dërgonj te ju profitër, edhe të-
diturë, edhe shkronjës; edhe *ca* nga ata dot'
i vrisni e dot' i kryqësoni, edhe *ca* nga ata
dot' i rrihni ndëpër sinagogjit t' uaj edhe dot'
35 i ndiqni prej qyteti ndë qytet; Që të vinjë
mbë ju çdo gjak i-drejtë që është derdhurë,
mbë dhet, që nga gjaku i Avelit të-drejtë e
gjer mbë gjakt të Zaharisë, të birit të Vara-
hiut, të-cilin' e vratë ndë mest të tempullit
36 edhe të theroresë. Me të-vërtetë po u them
juve, Gjithë këto dotë vijnë përmbi këtë bres.
37 Jerusalim, Jerusalim, që vret profitëritë,
edhe rreh me gurë ata që janë dërguarë te
ti, sa herë desha të mbleth bijt' e tu, sindë-
kur pula mbleth zoqt' e saj ndënë krahët
38 po nukë deshtë? Ja shtëpia juaj tek po u
39 lihetë e-shkretë. Sepse po u them juve, Nukë
dotë më shihni paskëtaj, gjersa të thoni, I-
bekuar' ësht' ay që vjen mb' emërit të Zotit.

Krye 24.

1 Edhe Jisuj dolli e iku nga hieroreja; edhe
nxënësit' e ati i erthnë përanë që t'i dëfte-
2 njënë ndërtesat' e hieroresë. Po Jisuj u tha a-

tyre, *A* nuk' i shihni gjithë këto? Me të-vër-
tetë po u them juve, *se* nukë dotë mbetetë
3 këtu gur mbi gur që të mos rrëzohetë. Edhe
ay tek ishte dyke ndënjurë mbi malt të Ulli-
njet, nxënësit'i uaferuanë mbë nj' anë, dyke
thënë, thuaj-na, kur dotë bënenë këto? Edhe
cila është shënja e të-ardhurit t'ënt edhe e të-
mbaruarit të jetësë.
4 Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Shikoni,
5 mos u gënjenjë juve ndonjë; Sepse shumë
veta dotë vinjënë mb' emërit t' im, dyke thënë
Unë jam Krishti, edhe dotë gënjenjënë shumë
6 *veta.* Edhe dotë dëgjoni luftëra e zëre luftë-
rash; shikoni, mos trumbullohi, sepse të-gji-
tha këto gjan të bënenë; po e-pastajmja edhe
7 nuk' është. Sepse dotë ngrihetë komp kun-
drë kombi, edhe mbretëri kundrë mbretërie;
edhe dotë jenë zira e murtaja, edhe tërmete
8 vënt mbë vënt. Po gjithë këto *janë* të-ni-
9 surit' e të-dhëmburavet. Atëhere dot' u apënë
juve ndër duar për shtrëngim, edhe dot' u
vrasënë juve; edhe dot' u kenë mëri juve gji-
10 thë kombetë për emërinë t' im. Edhe atëhere
dotë skandhalisenë shumë *veta*, edhe dotë
trathëtonjënë njeri tjatërinë, edhe dotë kenë
11 mëri njëri tjatërit. Edhe shumë profitër të-
rrem dotë ngrihenë, edhe dotë gënjënjënë
12 shumë *veta;* Edhe passi të shumonetë pano-
13 mia, dashuria e të-shumëvet dotë ftohetë. Po
kush të duronjë gjer ndë funt, ky dotë shpë-

14 tonjë. Edhe ky ungjilli i mbretërisë dotë le-
çitetë ndëpër gjithë botënë, për dëshmim mbë
gjithë kombet; edhe atëhere dotë vinjë fundi.
15 Kur të shihni pra „të-ndytët'e të-shkre-
tuarit,“ që është thënë nga profiti Dhaniil,
dyke ndënjurë ndë ventt të-shenjtëruarë, (ay
16 që këndon let' a kupëtonjë;) Atëhere ata që
janë ndë Judhet letë ikëjnë ndëpër malet;
17 Kush të gjendetë mbi kulmit, letë mos sbresë
18 që të marrë gjë nga shtëpi' e ti. Edhe kush të
gjendetë nd' arët letë mos kthenetë prapa, që
19 të marrë rrobat'e tia. Edhe mjerë ato që janë
me barrë, e ato që kanë foshnja mbë gji nd'
20 ato dit. Edhe faluni, që të mos bënetë të-
21 ikuritë t' uaj ndë dimërë, as të-shëtunë. Sepse
atëhere dotë jetë shtrëngim i-math, që nuk'
është bërë i-atillë, që ndë të-nisurit të-botësë
e gjer ndashti, as nuk' është për të bërë.
22 Edhe të mos shkurtoneshin'ato dit, nukë dotë
shpëtonte asndonjë trup; po ato dit dotë
shkurtonenë për të-sgjedhuritë.
23 Atëhere ndë u thëntë juve ndonjë, Ja *tek*
24 *është* këtu Krishti, a aty, mos besoni. Sepse
dotë ngrihenë krishtër të-rrem, edhe profitër
të-rrem, edhe dotë bëjnë shënja të-mëdha
edhe çudira, kaqë sa dotë gënjenjën' edhe të-
25 sgjedhuritë, ndë munçinë. Ja tek u thashë
26 juve më përpara. Ndë u thënçinë pra juve
Ja tek është ndë shkretëtirët, mos dilni, Ja
27 ndë dhomat, mos besoni. Sepse sindëkur ve-

BKSH

tëtima del nga lint djelli, edhe duketë gjer
tek perëndon, kështu dotë jetë edhe t' ardhu-
28 rit' e të birit të njeriut. Sepse ku të jetë kër-
ma, atjë dotë mblidhenë shqiponjatë.
29 Edhe për-një-here pas shtrëngimit t' atyre
ditve, djelli dot' erretë, edhe hëna nukë dotë
apë ndriçimin' e saj; edhe yjtë dotë bjenë
nga qielli, edhe fuqit' e qiejvet dotë tundenë.
30 Edhe atëhere dotë duketë shënja e të Birit
të njeriut ndë qiellt; edhe atëhere dotë bë-
njënë vajë gjithë farat'e dheut, edhe dotë sho-
hënë të Birin' e njeriut dyke ardhurë mbi ret
31 të qiellit me fuqi e me lavdi shumë. Edhe
dotë dërgonjë ëngjëjt' e ti me trumbetë *që
nxjer* zë të-math, edhe dotë mbledhënë të-
zgjedhurit' e ati nga të katrë erëratë, prej
fundit t'anëvet të qiejvet e gjer mbë *funtt* të
anëvet t' atyre.
32 Edhe nga drur' i fikut mësoni paravoli-
në; kur bënetë ndashti deg' e ati e-butë,
edhe nxjer gjethetë, e dini se vera është
33 afërë. Kështu edhe ju kur të shihni gjithë
34 këto, t'a dini se ësht' afërë ndër dyert. Me të-
vërtetë po u them juve, ky bres nukë dotë
35 skkonjë, gjersa të bënenë të-gjitha këto. Qielli
edhe dheu dotë shkonjënë, po fjalët' e mia
36 nukë dotë shkonjënë. Edhe për atë ditë, edhe
për atë orë, asndonjë s' e di, as ëngjëjt' e
qiejvet, veç im Atë vetëmë.
37 Edhe sindëkur *ishinë* ditt' e Noesë, kështu

dotë jetë edhe t' ardhurit' e Birit të njeriut.
38 Sepse sindëkur ishinë *njerëzitë* nd' ato dit
përpara përmbytjesë, që hanin' e pininë, mar-
toneshin' e martoninë, gjer mb' atë ditë që
39 hyri Noeja nd' arkët; Edhe nuk' e kupëtuanë
gjersa erdhi përmbytja, edhe ngriti të-gjithë;
kështu dotë jetë edhe t' ardhurit' e të Birit të
40 njeriut. Atëhere dy *veta* dotë jenë nd' arë;
41 njeri merretë, e tjetëri lihetë. Dy *gra* dotë
bluanjënë ndë mulli; njëra merretë, e tjatëra
lihetë.
42 Rrini sgjuarë pra, sepse nukë dini mbë
43 ç' orë vjen Zoti juaj. Po këtë e dini, se t'a
dinte i-zot' i shtëpisë, mbë ç' kohë *të natësë*
vjen vjedhësi, dotë rrinte sgjuarë, edhe nukë
44 dotë linte të çponej shtëpi' e ati. Përandaj
edhe ju bëhi gati, sepse i Bir' i njeriut vjen
mb' atë orë, që nuk' u'a pret mëndja juve.
45 Vallë cili ësht' ay shërbëtuar besëtar edhe i-
mënçim, të-cilinë i-zoti e vuri përmbi punë-
torët të ti, që t' u apë atyre ushqimnë ndë
46 kohë? Lum ay shërbëtuar, të-cilinë, kur të
47 vinjë i zoti, t'a gjenjë dyke bërë kështu. Me
të-vërtetë po u them juve, se dot' a vërë për-
48 mbi gjithë gjën' e ti. Edhe ay shërbëtor' i-lik
ndë thëntë ndë zëmërët të ti *se*, Im Zot më-
49 non të vinjë; Edhe të zërë të rrahë shokët
e ti shërbëtorë edhe të hajë e të pijë bash-
50 kë me ata që dehenë; I zot' i ati shërbëtori
dotë vinjë nd' atë ditë që *ay* nuk' e pret edhe

51 nd' atë orë që nuk' e di; Edhe dot' a nda-
një mbë nj' anë, edhe dotë vërë pjesën' e ati
bashkë me ipokritëritë; atje dotë jetë të-qa-
rët' e të-kërcëllliturit' e dhëmbëvet.

Krye 25

1 Atëhere mbretëri' e qiejvet dotë gjanjë me
dhjetë vërgjëresha, të-cilatë muarnë llambat'
2 e tyre, e duallnë të presënë dhëndërrinë. Edhe
nga ato pesë ishinë të-mënçime, edhe pesë
3 të-marra. Ato të-marratë, kur muarnë llam-
4 bat' e tyre, nukë muarnë vaj me vetëhe; Po
të-mënçimetë muarnë vaj ndë enët të tyre
5 bashkë me llambat' e tyre. Edhe dhëndërri si
uvonua, i zuri gjumi të-gjitha edhe flininë.
6 Edhe ndë mest të natësë ubë një të-thirrurë,
Ja dhëndëri tek po vjen; dilni për të-pritur'
7 atë. Atëhere, gjith' ato vërgjëreshat' ungritnë,
8 edhe ndreqnë llambat' e tyre. Po të-marrat'
u thanë të-mënçimevet, Ep-na-ni nga vaji juaj;
9 sepse po na shuhenë llambatë. Edhe të-mën-
çimetë upërgjeqnë, dyke thënë, Mos nukë
dotë na dalë neve edhe juve; po më mirë
shkoni tek ata që shesënë, edhe blini për
10 vetëhenë t' uaj. Edhe kur vanë të blenë, dhën-
dërri erdhi; edhe ato që ishinë gati hynë
bashkë me atë ndë dasmët, edhe umbull de-
11 ra. Po pastaj vijn' edhe vërgjëreshat' e-tjera,
12 e thonë, Zot, Zot, hap-na. Po ay upërgjeq
e tha, Me të-vërtetë po u them juve, nuk u
njoh juve.
13 Rrini sgjuarë pra, sepse nuk' e dini ditën'
as orënë, ndë të-cilët vjen 'i Bir' i njeriut.
14 Sepse *dotë vinjë* posi një njeri, *i cili*, kur
dotë ikënte ndë dhe të-huaj, thirri shërbëto-

15 rët'e ti e u dha atyre gjën'e ti; Edhe njërit
i dha pesë tallanda, e tjatërit dy, e tjatërit
një; gjithë-si-cilit si pas fuqis'së ti; edhe për
16 një-here iku ndë dhe të-huaj. Atëhere ay që
mori të pesë tallandatë, vate e punoj me ato,
17 edhe bëri pesë tallanda të-tjera. Kështu edhe
18 ay që mori dy, fitoj edhe ay dy të-tjera. Po
ay që mori njërënë, vate e rëmoj ndë dhet,
19 edhe fshehu ergjëndin'e të zott. Edhe pas
shumë kohë vjen i zoti i atyre shërbëtorëve,
20 edhe sheh llogari me ata. Edhe si i erdhi
përanë ay që pat marrë të pesë tallandatë,
pruri pesë tallanda të-tjera, dyke thënë, Zot,
pesë tallanda më dhe ndë dorë; ja tek fitova
21 prej atyre pesë tallanda të-tjera. Edhe i zoti
i tha, Të lumtë, shërbëtuar i-mirë edhe besë-
tar; mbë të-paka që besëtar, mbi të-shuma
22 dotë të vë; hyrë ndë gëzimt të t' yt zott. Erdhi
përanë edhe ay që pat marrë të dy tallan-
23 datë, edhe tha, Zot dy tallanda më dhe ndë
dorë; ja tek fitova prej atyre dy tallanda të-
të-tjera. I-zoti i tha, Të lumtë, shërbëtuar i-mirë
edhe besëtar: mbi të-paka qe besëtar, mbë të-
shuma dotë të vë; hyrë ndë gëzimt të t' yt zott.
24 Erdhi përanë edhe ay që pat marrë një ta-
llandë, e tha, Zot, të dinja, se je njeri i-ash-
përërë, që korr tek nukë mbolle, edhe mbleth
25 tek nukë përndave; Edhe passi paçë frikë,
vajta e fsheha tallandënë t' ënde ndë dhet;
26 ja tek e ke tëndenë. Edhe i zoti upërgjeq e
i tha, Shërbëtuar i-lik edhe i-përtuarshim, ti
e dinje, se *unë* korr tek nukë mbolla, edhe
27 mbleth tek nukë përndava; Duhej pra të vinje
ërgjëndinë t'im te truvezarëtë; edhe kur të vi-
njam unë, dotë mernja t'imenë bashkë me ka-
28 matënë. Merrni pra prej ati tallandënë, edhe ep-

29 j'a-ni ati që ka të dhjetë tallandatë. Sepse
kujtdo që ka dot'i epetë, edhe dot'i tepë-
ronjë: edhe prej kujdo që s' ka, edhe atë
30 që të ketë, dotë merretë prej ati. Edhe shër-
bëtorin' e pavëjejturë hidh-e-ni ndë errësirët
të-përjashtësme; atje dotë jetë të-qarët' e të-
kërcëllliturit' e dhëmbëvet.
31 Edhe kur të vinj'i Bir' i njeriut ndë lav-
dit të ti, edhe gjithë ëngjëjt' e-shënjtëruarë
bashkë me atë, atëhere dotë rrijë mbi front
32 të lavdis' së ti. Ehde dotë mblidhenë përpara
ati gjithë kombetë; edhe dot' i ndanj' ata një-
rinë nga tjatëri, sindëkur bariu ndan dhëntë
33 nga kecëritë; Edhe dotë vërë dhëntë mb' anë
të-djathtë, edhe kecëritë mb' anë të mëngjërë.
34 Atëhere mbreti dot' u thot' atyre që rrinë
mbë anë të-djathtë të ti, Ejani të-bekuarët'
e t' im Eti, trashëgoni mbretërinë që është
bërë gati për ju që kur se është ngrehurë
35 bota. Sepse pata uri, e më dhatë të ha; pata
et, e më dhatë të pi; i-huaj jeshë, edhe më
36 muartë ndë shëpi; I-sveshurë, edhe më veshtë;
usëmurçë, edhe erthtë të më shihni; jeshë ndë
37 burk, edhe erthtë tek unë. Atëhere të-drejtëtë
dot' i përgjigjenë, dyke thënë, Zot, kur të pamë
ty dyke pasurë uri e të ushqyemë? a dyke
38 pasurë et, e të dhamë të pish? Edhe kur të
pamë të-huaj, e të muarmë ndëpër shtëpirat?
39 a të-sveshurë, e të veshmë? Edhe kur të
pamë të-sëmurë, a ndë burk, edhe erthmë
40 tek ti? Edhe mbreti dotë përgjigjet' e dot' u
thotë atyre, Me të-vërtetë po u them juve,
sado që i bëtë njerit nga këta vëllezërit' emi
më të-vegjëlitë, m'a keni bërë mua.
41 Atëhere dot' u thot' edhe atyre që rrinë
mbë anë të-mëngjërë, Ikëni prej meje, të-

mallëkuarëtë, ndë zjarrt të-pasosurë, që është
42 bërë gati për djallin' e për ëngjëjt'e ati. Se-
pse paçë uri, e s' më dhatë të-ha; paçë et,
43 e s' më dhatë të pi; Jeshë i-huaj, e nukë më
muartë përbrënda; i sveshurë, edhe nukë më
veshtë; i-sëmurë edhe ndë burk, edhe nuk'
44 erthtë të më shihni. Atëhere dot' i përgjigjen'
edhe ata, dyke thënë, Zot, kur të pamë ty
dyke pasur' uri, a dyke pasur 'et, a të-huaj,
a të-sveshurë, a të-sëmurê, a ndë burk, e
45 nukë të shërbyemë? Atëhere dot' u përgjigjet'
e dot' u thot' atyre, Me të-vërtetë po u them
juve, sado që nuk' i bëtë njërit nga këta me
të-vegjëlitë, as mua nukë m' a kini bërë.
46 Edhe këta dotë [venë ndë mundim të-për-
jetëshme; edhe të-drejtëtë ndë jetët të-për-
jetëshmë.

Krye 26

1 Edhe Jisuj kur mbaroj gjithë këto fjalë,
2 u tha nxënësvet të ti, E dini se pas dy ditsh
është pashka, edhe i Bir' i njeriut epetë ndë
3 duar për të kryqëzuarë. Atëhere umblothnë
krye-priftërit' edhe shkronjësit' edhe pleqt' e
llauzit ndë avlit të krye-priftit, që thuej
4 Kaiafë; Edhe bënë këshillë që t' a zënë Jisu-
5 në me kobim, edhe t' a vrasënë. Edhe tho-
shinë, Jo ndë të-kremtet, që të mos bënetë
trazyrë ndë gjindjet.
6 Edhe Jisuj kur ishte ndë Vithani, ndë
7 shtëpit të Simonit të-krromosurë, Erdhi
përan' ati një grua që kishte një allavastrë
me vaj ere shumë të-shtrënjtë, edhe e derthi
mbi kryet t' ati tek ishte dyke ndënjurë ndë
8 mësallët. Edhe nxënësit' e ati kur panë, uzë-
mëruanë, e thanë, Për ç' punë të humbasë

BKSH

9 këjo *gjë?* Sepse ky vaj ere munt të shitej
me shumë *nder*, edhe t' epej ndëpër të vobeqt.
10 Edhe Jisuj si kupëtoj, u tha atyre, Përse i
epni mundime kësaj gruaje? sepse *këjo* bëri
11 punë të-mirë tek unë. Sepse të-vobeqtë i
keni për-herë me vetëhenë t' uaj; po mua
12 nuk më kini përherë. Sepse këjo, kur derdhi
këtë vaj ere mbi trupt t' im, e bëri *këtë* për
13 të kalluritë t' im ndë varr. Me të vërtetë po
u them juve, Kudo që të lëçitetë ky ungjill
ndë gjithë botët, dotë flitetë edhe *ç'punë* bëri
këjo, që të mbahetë mënt.
14 Atëhere një nga të dy-mbë-dbjetë, ay që
quhej Judhë Iskariot, vate te krye-priftërit' e
15 tha, Ç' dotë më epni, edhe unë t' u ap juve
16 atë ndër duar? Edhe ata i dhanë tri-dhjet'
argjënda. Edhe që mb' atëhere kërkonte kohë
të-pëlqyerë t'a epte ndër duar.
17 Edhe të-parënë ditë të të-pabrumjevet,
nxënësit' erthnë përanë Jisuj e i thanë, Ku
do të bëjmë gati për ty të hash pashkënë?
18 Edhe ay tha, Shkoni ndë qytett tek-akëcili, edhe
i thoni, Mësonjësi thotë, Koha ime ësht' a-
fërë; dotë bënj pashkënë të ti bashkë me
19 nxënësit' e mi. Edhe nxënësitë bënë sindë-
kur i porositi Jisuj, edhe bënë gati pashkënë.
20 Edhe kur ungrys, ishte dyke ndënjurë
ndë mësallët bashkë me të dy-mbë-dhjetëtë;
21 Edhe ata tek ishinë dyke ngrënë, tha, Me të-
vërtetë po u them juve, se një nga ju dotë,
22 më trathëtonjë. Edhe ata uhelmuanë fort,
edhe zunë t' i thonë gjithë-si-cili nga ata,
23 Zot, mos jam unë? Edhe ay u përgjeq e tha,
Ay që ngjeu dorënë ndë kupët bashkë me
mua, ky dotë më apë ndër duar.
24 I Bir' i njeriut vete, sindëkur është shkru-

arë për atë; po mjerë ay njeri me anë të të-
cilit epetë ndër duar i Bir'i njeriut; ishte
mirë për atë njeri të mos kishte lindurë.
25 Edhe Judha, ay që e trathëtoj, upërgjeq e
tha, Mos jam unë, Ravvi? I thot ati, Ti po
thua.
26 Edhe ata tek po ishinë dyke ngrënë, Jisuj
mori bukëhë, edhe si e bekoj, e theu, e u' a
27 dha nxënësvet, edhe tha, Merrni e hani; ky
është trupi im. Edhe mori potirinë, edhe si
28 ufal ndersë, u' a dha atyre, dyke thënë, Pini
të-gjithë prej këti; sepse ky është gjaku im
i dhjatës' së-re, që derdhetë për shumë për
29 ndjesën' e fajevet. Edhe po u them juve, se
nukë kam për të pirë që ndashti e tutje nga
këjo pemë, që pjell hardhia, gjer m' atë ditë,
kur t'a pi të-re bashkë me ju ndë mbretë-
rit të t' im Eti.
30 Edhe si psallnë, duallnë ndë malt të ullinjet.
31 Atëhere Jisuj u thot' atyre, Gjithë ju dotë
skandhaliseni mbë mua këtë natë; sepse është
shkruarë, „Dot' i bie bariut, edhe dhënt' e
32 tufësë dotë përndahenë." Edhe passi të ngja-
llem unë, dotë vete përpara jush ndë Gali-
33 let. Edhe Pjetri upërgjeq e i tha, Edhe të-
gjithë ndë uskandhalisçinë mbë ty, unë
nukë dotë skandhalisem kurrë. Jisuj i tha,
34 Me të-vërtetë po të them, se këtë natë, para
se të këndonjë këndesi, tri herë dotë më mo-
35 honjç. Pjetri i thotë, Edhe ndë u ndashtë të
vdes *unë* bashkë me ty, nukë dotë të mohonj.
Kështu thanë edhe gjithë nxënësitë.
36 Atëhere Jisuj vjen bashkë me ata ndë
një fshat që thuhetë Gjethsimani; edhe u thotë
nxënësvet, Rrini aty, gjer sa të vete e të
falem atje.

37 Edhe mori me vetëhe Pjetrin' edhe të dy
bijt' e Zevedheut, e zuri të hidhëronet' e t' i
38 vinje rëndë. Atëhere u thot' atyre, Shpirti im
ësht' i hidhëruarshim gjer mbë vdekje; mbe-
tuni këtu, edhe rrini sgjuarë bashkë me mua.
39 Edhe si vate pakëzë më tej, ra mbë faqe
përmbys, dyke falur' e dyke thënë, Ati im,
ndë qoftë si munt *të bënetë*, letë hiqetë prej
meje këjo kupë; po jo si dua unë, po si *të
duash* ti.
40 Edhe vjen te nxënësitë, e i gjen ata dyke flej-
turë, edhe i thotë Pjetrit, Kështu nukë munttë
të rrini sgjuarë një orë bashkë me mua?
41 Rrini sgjuarë edhe faluni, që të mos hyni
ndë ngasje; sepse shpirti *ësht'* i gatishim, po
mishi *ësht'* i pafuqishim.
42 Prapë për-së dyti vate edhe ufal, dyke
thënë, Ati im, ndë qoftë se nukë munt të
hiqetë prej meje këjo kupë, që të mos e pi
atë, letë bënetë ënda jote.
43 Edhe erdhi e i gjen përsëri dyke flejturë;
sepse syt' e atyre ishinë rënduarë.
44 Edhe si i la ata, vate përsëri e ufal për-
së-treti, dyke thënë po atë fjalë.
45 Atëhere vjen te nxënësit' e ti edhe u thot'
atyre, Flini pra, edhe prëhi; ja tek uafërua
ora, edhe i Bir' i njeriut epetë ndë duar
46 fajtorësh. Ngrehuni letë vemi: ja tek uafë-
rua ay që dotë më apë ndër duar.
47 Edhe ay tek ishte po dyke folurë, ja tek
erdhi Judha, një nga të dy-mbë-dhjetë, edhe
bashkë me atë *erthnë* shumë gjindje me thikë
e me dru nga an' e krye-priftërvet edhe të
48 pleqvet të llauzit. Edhe ay që e epte atë ndër
duar u dha atyre shënjë, dyke thënë, Atë
49 që të puth *unë*, ay është; zir-e-ni atë. Edhe

përnjëhere erdhi përanë Jisujt e tha, Gëzohu,
50 Ravvi; edhe e puthi. Edhe Jisuj i tha, Mik,
përse erdhe? Atëhere uaferuanë e vunë du-
artë mbi Jisunë, edhe e zunë.
51 Edhe ja një nga ata që ishinë bashkë
me Jisunë ngjati dorënë, e nxori thikën' e ti,
edhe i ra shërbëtorit të krye-priftit, e i preu
52 veshnë. Atëhere Jisuj i thot' ati, Kthe thikënë
t' ënde ndë vëntt të saj; sepse gjith' ata që
vënë dorë mbë thikë, prej thike dotë hum-
53 basënë. Apo të duketë se nukë munt ndashti
t' i lutem t' im Eti, edhe të më nxjerrë për-
para më tepërë se dy-mbë-dhjetë legjeona
54 ëngjëjsh? Qysh dotë mbushenë pra shkro-
njatë, se kështu gjan të bënetë?
55 Mb' atë orë Jisuj i tha gjindjesë, Posi
mbë kursar keni dalë me thikë e me dru të
më ziri? për dita rrinjam te ju dyke mësu-
56 arë ndë hieroret, edhe nukë më zutë. Po gji-
thë këjo ubë, që të mbushenë shkronjat' e
profitërvet. Atëhere gjithë nxënësitë e lanë,
e iknë.
57 Edhe ata si zunë Jisunë, e prunë te Kai-
afa kryeprifti, atje ku ishinë mbledhurë skkro-
njësit' edhe pleqtë.
58 Po Pjetri i vate prapa për-së-largu, gjer
ndë avlit të krye-priftit; edhe si hyri brenda,
rrinte bashkë me shërbëtorëtë, që të shihte
fundinë.
59 Edhe krye-prifterit' e pleqt' e gjithë bash-
kë-ndënjja kërkoninë dëshmim të-rrem kun-
drë Jisujt, që t' a vrisninë atë, po nukë gjet-
60 në; Edhe ndonëse erthnë shumë dëshmim-
tare të-rrem, nukë gjetnë. Po pastaj erthnë
61 dy dëshmimtarë të-rrem, e thanë, Ky tha, *se*
Munt të prish tempullin' e Perëndisë, edhe

BKSh

62 për tri dit t' a ndërtonj atë. Edhe krye-prifti
ungrit e i tha, Nukë përgjigjesh fare? ç' dë-
63 shmojnë këta kundrë teje? Po Jisuj nukë
bënte zë.
Edhe krye-prifti upërgjeq e i tha, Të vë
mbë be për Perëndin' e gjallë, të na thuash,
64 ndë je ti Krishti, i Bir' i Perëndisë. Jisuj i
thot' ati, Ti po thua; po *unë* po u them juve,
Që ndashti e paskëtaj dotë shihni të Birr' e
njeriut dyke ndënjurë mb' anë të-djathtë të
fuqisë, e dyke ardhurë mbi ret të qiellit.
65 Atëhere kryeprifti çori rrobat' e tia, dyke thë-
në, Se vllasfimisi; ç' nevojë kemi më për
dëshmimtare? ja ndashti tek e dëgjuatë vlla-
66 sfimin' e ati. Si u duketë juve? Edhe ata
upërgjeqnë e thanë, Eshtë fajtuar për vdekje.
67 Atëhere e pshtynë atë ndër sy, edhe i ranë
me grusht; edhe të-tjerë i ranë me shupla-
68 ka, dyke thënë, Profiteps-na, o Krisht, cili
ësht' ay që të ra?
69 Edhe Pjetri rrinte përjashta ndë avlit;
edhe i erdhi përanë një shërbëtore dyke thë-
në, Edhe ti ishnje bashkë me Jisu Galilea-
70 sinë. Po ay e mohoj përpara të-gjithëve, dyke
71 thënë, Nukë di se ç' thua. Edhe ay kur dolli
ndë derët të avllisë, e pa atë një tjatërë, edhe
u thot' atyre *që ishinë* atje, Edhe ky ish ba-
72 shkë me Jisu Nazareasinë. Edhe përsëri e
73 mohoj me be, Se nuk' e njoh njerinë. Edhe
pas pakëzë erthnë përan' ati ata që ishinë
dyke ndënjurë e i thanë Pjetrit, Me të-vër-
tetë edhe ti je nga ata; sepse edhe të-folu-
74 ritë t' ënt të dëften ty. Atëhere zuri të nem-
një e të bënjë be, Se nuk' e njoh njerinë.
75 Edhe për-një-here këndoj këndesi. Atëhere
i ra ndër mëntt Pjetrit fjal' e Jisujt që i pat

thënë, Se para se të këndonjë këndesi, tri
herë dotë më mohonjç; edhe dolli jashtë, e
qau hidhurë.

Krye 27

1 Edhe si ugdhi, gjithë krye-priftërit' edhe
pleqt' e llauzit dhan' e muarnë këshillë kun-
2 drë Jisujt, që t' a vrasënë. Edhe si e lithnë,
e shpunë edhe e dhanë ndër duart të Pondi
Pillatit, qivernitarit.
3 Atëhere kur pa Judha, ay që e trathëtoj,
se ugjykua për vdekje, upendua, edhe ktheu
prəpë të tri-dhjetë argjëndatë te krye-priftë-
rit' edhe te pleqtë, dyke thënë, Fëjeva që
4 dhashë ndër duar gjak të-pafajm. Edhë ata
thanë, *Ç'punë kemi* neve? ti ke për të parë.
5 Edhe ay si hodhi argjëndatë ndë tempullt,
iku; edhe vate e uvar.
6 Edhe krye-prifteritë si muarnë argjëndatë,
thanë, Nuk' ësht' e udhësë t' i vëm' ato ndë
thesart të tembullit, sepse janë çëmim gjaku.
7 Edhe si dhan' e muarnë këshillë, blenë arën'
e shtëmbarit me ato, për të kallurë ndë varr
8 *atje* të-huajtë. Përandaj ajo arë uquəjt Arë
9 gjaku, gjer mbë *ditet* të-sotme. Atëhere u-
mbush ç' është thënë me anë të profitit Je-
remi, që thotë, „Edhe muarnë të tri-dhjet'
argjëndatë, çëmimn' e të çëmuarit nga të bijt'
10 e Israilit, edhe i dhanë ndë arët të shtëm-
barit, sikundrë më porositi Zoti."
11 Edhe Jisuj ndënji përpara qivernitarit;
edhe qivernitari e pyeti, dyke thënë, Ti je
mbreti i Judhenjvet? Edhe Jisuj i tha, Ti po
12 thua. Edhe kur përflitej nga krye-priftëritë
13 edhe nga pleqtë, nukë përgjigje asfare. Atë-

here Pillati i thotë, Nukë dëgjon sa dëshmojnë
14 kundrë teje? Po ay nuk' i upërgjeq as mbë
ndonjë fjalë, kaqë sa qivernitari çuditej fort.
15 Edbe qivernitari kishe zakon për të-kremte
t' i lëshonte gjindjesë një të-lidhurë, atë qe
16 të donin' *ata*. Edhe atëhere kishinë një të-
17 lidhurë me emërë, që thuhej, Varnava. Ata
pra tek ishinë mbledhurë, Pillati u tha atyre,
Cilinë doni t' u lëshonj juve? Varavvanë,
18 apo Jisunë që thuhetë Krisht. Sepse e dinte,
se e dhanë ndër duar nga çmiri.
19 Edhe ay tek po rrinte mbi front të gju-
qit, gruaja e ati dërgoj tek ay, e i tha, Ti
mos i bëj gjë ati të-drejti, sepse sot pësova
shumë nd' ëndërrë për atë.
20 Edhe krye-priftërit' edhe pleqtë i mbu-
shnë mëndjenë gjindjesë që të lypnjënë
21 Varavvanë, edhe Jisunë t' a prishnjënë. Edhe
qivernitari upërgjeq e u tha atyre, Cilinë
22 doni nga *keta* te dy t' u lëshonj juve? Edhe
ata thanë, Varavvanë. Pillati u thot' atyre,
Ç' t' a bënjë pra Jisunë që thuhetë Krisht?
23 Të-gjith' i thonë, Letë kryqëzonetë. Edhe qi-
vernitari tha, Përse? ç' të-keqe ka bërë? Po
ata bërtitninë më tepërë, dyke thënë, Letë
24 kryqëzonetë. Edhe Pillati si pa se s' ka dobi,
po më tepërë trazyrë bënetë, mori ujë e lau
duartë përpara gjindjesë, dyke thënë, I-pa-
fajm jam nga gjaku i këti të-drejti; ju kini
25 për të parë. Edhe gjithë llauzi upërgjeq e
tha, Gjaku i ati *qofte* mbi ne. edhe mbi bijtë
t' anë.
26 Atëhere u lëshoj atyre Varravanc; edhe
Jisunë si e rrahu me shufrë, e dha ndër duar
që të kryqëzonetë.
27 Atëhere ushtëtarët' e qivernitarit muarnë

BKSH

me vetëhe Jisunë ndë pretorët (guvernatore),
edhe mblothnë mbi atë gjithë tufën' e ushtë-
28 tarëvet. Edhe e sveshnë, e i veshnë ati një
29 rrobë të-gjatë të-kuqe. Edhe gërshëtuanë një
kurorë ferrash, e j' a vunë mbi kryet, edhe
i dhanë një kallam ndë dorët të-djathtë; edhe
ranë mbë gjunjë përpara ati, edhe e përqe-
shninë, dyke thënë, Gëzohu, o mbret i Ju-
30 dhenjvet. Edhe si e pshtynë, muarnë kalla-
31 min' e i bininë krejt t' ati. Edhe passi e për-
qeshnë, i sveshnë rrobën' e-kuqe, edhe i ve-
shnë rrobat' e tia; edhe e shpunë t' a kry-
qëzonjënë.
32 Edhe dyke dalë, gjetnë një njeri Qirine-
as, që e kishte emërinë Simon; këtë e zunë
33 angari që të ngrerë kryqin' e ati. Edhe kur
erthnë ndë një vënt që thuhetë Gollgotha,
34 ay është që thuhetë Vëndi i Kresë, I dhanë të
pijë uthullë të-përzjerë me t' ëmblëth; po ay
si ungjërua, nukë desh të pijë.
35 Edhe si e kryqëzuanë, hothnë shortë, e
ndanë rrobat' e ati; që të mbushetë ç' është
thënë nga profiti. „Ndanë rrobat' e mia ndë
mest të tyre, edhe mbi të-veshurit t' im ho-
36 thnë shortë." Edhe dyke ndënjurë e ruanin'
37 atë atje. Edhe vunë sipërë krejs' s' ati pu-
nën' e ati të-shkruarë, **Ky është Jisuj mbreti i
Judhenjvet.**
38 Atëhere kryqëzonenë bashkë me atë dy
kursarë, një mb' anë të-djathtë, edhe një mb'
anë të mëngjërë.
39 Edhe ata që shkoninë përanë e shaninë
atë dyke tundurë krerët' e tyre, e dyke
40 thënë, Ti që prish tempullinë, edhe për
tri dit e ndërton, shpeto vetëhenë t' ënde;
41 ndë je i Bir' i Perëndisë, sbrit nga kryqi. Kë-

shtu edhe krye-priftëritë bashkë me shkro-
njësit' e pleqtë dyke përqeshurë atë thoshinë,
42 Të-tjerë shpëtoj, vetëhen' e ti nukë munt t' a
shpëtonjë; nd' është mbret' i Israilit, letë sbre-
së ndashti nga kryqi, edhe dot'i besojmë.
43 Shprente mbë Perëndinë; let' a shpëtonjë tani,
ndë e do; sepse tha, Se jam bir Perëndie.
44 Gjithashtu edhe kursarëtë që ishinë kryqe-
zuarë bashkë me atë e shaninë.
45 Edhe që mbë të-gjashttën' orë ubë një errë-
sirë mbi gjithë dhenë gjer mbë të-nënttën' orë.
46 Edhe mbë të-nënttën' orë Jisuj bërtiti me
zë të-math, dyke thënë, „Ili, Ili llama sa-
vahthani? që do me thënë, „Perëndia im,
Perëndia im, përse hoqe dorë prej meje?
47 Edhe ca nga ata që ishinë atje kur dëgju-
48 anë, thanë, se ky po thërret Ilinë. Edhe për-
një-herë ulëshua një nga ata, e mori një sfu-
ngar, edhe e mbushi me uthullë, edhe e vu-
49 ri mbë një kallam, e i epte të pijë. Edhe të-
tjerëtë thoshinë, Letë shohëmë, ndë qoftë se
vjen Ilia t' a shpëtonjë.
50 Edhe Jisuj përsëri bërtiti me zë të-math,
e dha shpirtinë.
51 Edhe ja kurtin' e tempullit tek uça mbë
dy prej së-larti gjer poshtë; edhe dheu utunt;
52 edhe gurëtë plasnë; edhe varret' uhapnë, edhe
shumë trupa shënjtorësh që kishinë vdekurë
53 ungjallnë; Edhe duallnë nga varretë pas të-
ngjallurit t' ati, e hynë ndë qytett të-shënj-
tëruarë, edhe uduknë mbë shumë *veta.*
54 Edhe urdhër-qindësi edhe ata që ishinë
bashkë me atë dyke ruajturë Jisunë, kur pa-
në tërmetin' edhe ç' *punëra* ubënë, ufrikësu-
anë fort, e thanë, Me të-vërtetë ky paska
qënë bir Perëndie.

55 Edhe atje ishinë shumë gra dyke vënë re
prej së-largu; të-cilatë kishinë vaturë prapa
56 Jisujt nga Galilea, dyke shërbyer' ati; ndër
mest t' atyre ishte Maria Magdhalini, edhe
Maria e ëm' e Jakovit edhe e Josiut, edhe e
ëm' e të bijvet të Zevedheut.
57 Edhe si ungrys, erdhi një njeri i-pasurë
nga Arimathea *që e kishte* emërinë Josif, që
edhe ay vetë kishte qënë nxënës te Jisuj.
58 Ky vate te Pillati e lypi trupin' e Jisujt.
59 Atëhere Pillati, urdhëroj t' i epetë trupi. Edhe
Josifi mori trupnë edhe e pshtolli me pëlhu-
60 rë të-pastrëtë; Edhe e vuri ndë varrt të ti
të-ri, që e kishte rëmuarë ndë shkëmpt,
edhe si rrukullisi një gur të-math ndë derët
61 të varrit, iku. Edhe atje ishte Maria Magdha-
lini, edhe Maria tjatërë, dyke ndënjurë kun-
druell varrit.
62 Edhe mbë të-nesërmenë, që është pas së-
prëmtesë, umblothnë krye-priftërit' edhe Fa-
63 risenjtë te Pillati, Dyke thënë, Zot, neve mbaj-
më mënt, se ay gënjeshtari tha kur qe edhe
64 i-gjallë, *se* Pas tri ditsh dotë ngjallem. Urdhëro
pra të ruhetë varri gjer mbë të-tretënë ditë,
semos vijnë nxënësit' e ati natën' edhe e vje-
dhënë, edhe i thonë llauzit, *se* Ungjall nga
të-vdekuritë; edhe gënjeshtr' e-pastajmë dotë
65 jetë më e-keqe se e-para. Edhe Pillati u
tha atyre, Keni ruajtes, shkoni, e siguro-e-
66 ni si të dini. Edhe ata vanë e siguruanë var-
rinë, dyke vulosurë gurinë bashkë me ruajtësitë.

Krye 28

1 Edhe si shkoj e-shëtuna, dyke gdhir' e-
Djele, qe esht' e para dit' e javësë, erdhi Ma

Bksh

ria Magdhalini, edhe Maria tjatërë, që të
2 shihninë varrë. Edhe ja tek ubë një tërmet
i-math; sepse ëngjëll' i Zotit sbriti nga qielli,
edhe erdhi e rrukullisi gurinë nga dera *e*
3 *varrit*, edhe rrinte sipër' ati. Edhe faqeja e
ati ishte posi vetëtimë, edhe rroba e ati e-
4 bardhë posi dëborë. Edhe ata që ruanin' u-
trëmpnë nga frik' e ati; edhe ubënë posi të-
5 vdekurë. Edhe ëngjëlli upërgjeq e u tha gra-
vet, Mos kini frikë; sepse e di se kërkoni
6 Jisunë që ukryqëzua. Nukë është këtu; sepse
ungjall, sindëkur pat thënë. Ejani, shihni
7 vëndinë ku dirgjej Zoti. Edhe shkoni shpejt
e u thoni nxënësvet t' ati, se ungjall nga të-
vdekuritë; edhe ja tek po vete *ay* më përpa-
ra se ju ndë Galilet; atje dot' a shihni atë;
ja tek u thashë juve.
8 Edhe *ato* duallnë shpejt nga varri me
frikë edhe me gëzim të-math, edhe usulnë
t' u apënë zë nxënësvet t' ati.
9 Edhe dyke vaturë t' u epninë zë nxë-
nësvet t' ati, ja Jisuj tek upoq me ato, e u
tha, Gëzohi. Edhë ato i erthnë përanë, e i
zunë këmbëtë, edhe i ufalnë.
10 Atëhere Jisuj u tha atyre, Mos kini frikë,
shkoni, ep-u-ni zë vëllezërvet të mi, që të
shkonjënë ndë Galilet, edhe atje dotë me
shohënë.
11 Edhe ato tek ishinë dyke vajturë, ja ca
nga ruajtësitë tek erthnë ndë qytett, e u
dhanë zë krye-priftëret për gjithë sa ubënë.
12 Edhe ata umblothnë bashkë me pleqtë, edhe
si muarnë *e* dhanë këshillë u dhanë ushtë-
13 tarëvet mjaft argjënda, dyke thënë, Thoni, se
nxënësit' e ati erthnë natën' edhe e vothnë
14 tek po flinimë ne. Edhe ndë udëgjoftë këjo

nga qivernitari, ne dot' i mbushim' ati mën-
djenë, edhe dotë bëjmë që ju të mos kini
15 kujdes. Edhe ata si muarnë argjëndatë, bënë
sikundrë umësuanë. Edhe këjo fjalë upërhap
ndëpër Judhenjt gjer mbë ditet të-sorme.
16 Edhe të një-mbë-dhjetë nxënësitë vanë
ndë Galilet, ndë atë mal që i pat porositur'
17 Jisuj. Edhe kur e panë, i ufaln' ati; po ca
18 *nga ata* ishinë *me* dy mëndje. Edhe Jisuj
erdhi përanë, e u foli atyre, dyke thënë, M'
udha çdo pushtet ndë qiellt edhe mbi dhet.
19 Shkoni pra e mësoni gjithë kombetë, edhe
i pagëzoni mb' emërit të Atit e të Birit e të
20 Frymës' së Shënjtëruarë; Edhe i mësoni ata
të ruanjnë gjithë sa u kam porositurë juve;
edhe ja unë tek jam bashkë me ju gjithë
dittë gjer mbë të-mbaruarët të jetësë. Amin.

BKSH

Ungjilli pas Markut.

Krye 1.

1 Të-nisurit' e ungjillit të Jisu Krishtit, të
2 Birit të Perëndisë; Sikundrë është shkruarë ndë
profitërit, „Na unë tek po dërgonj ëngjëllinë
t'im përpara faqesë s' ate, i-cili dotë ndreq-
3 një udhënë t' ënde përpara teje". Zër' i ati që
bërtet ndë shkretëtirët, Bëni gati udhën' e
Zotit, bëni të-drejta rrugat' e ati."
4 Joani ishte dyke pagëzuarë ndë shkretë-
tirët, edhe dyke lëçiturë pagëzim pendimi për
5 ndjesën' e fajevet. Edhe dilninë tek ay gjithë
vëndi i Judhesë edhe Jerosolimitëtë, edhe të-
gjithë pagëzoneshinë nga ay ndë lumët të
Jordhanit, dyke rrëfyerë fajet' e tyre.
6 Edhe Joani ishte veshurë me qime kamille,
edhe *kishte* bres të-lëkurtë rreth mesit të ti,
7 edhe hante karkaleca e mjaltë t' egërë. Edhe
lëçiste, dyke thënë, Prapa meje vjen më i-
forti se unë, të-cilit s' jam i-zoti të unjem e
8 t' i sgith rripin' e këpucëvet. Unë u pagëzo-
va juve me ujë; po ay dot' u pagëzonjë juve
me Frymë të-Shënjtëruarë.
9 Edhe nd' ato dit erdhi Jisuj nga Nazaret'

i Galilesë edhe upagëzua nga Joani ndë Jor-
10 dhant. Edhe për-një-here, dyke dalë nga u-
jëtë, pa qiejtë dyke hapurë edhe Frymën' *e-*
Shënjtëruarë posi pëllump dyke zbriturë mbi
11 atë. Edhe erdhi një zë nga qiejtë, Ti je Biri
im i-dashurë që e kam pëlqyerë.
12 Edhe për-një-here Fryma e nxjer ndë
13 shkretëtirët. Edhe ish atje ndë shkretëtirët dy-
zet dit, e ngitej nga Satanaj; edhe ish baskkë
me egërsiratë; edhe ëngjëjt' i shërbeninë.
14 Edhe passi udha ndër duar Joani, Jisuj
15 erdhi ndë Galilet, dyke lëçitur' Ungjillin' e
mbretëris' së Perëndisë, dyke thënë, Se u-
mbush koha, edhe uafërua mbretëri' e Perën-
disë; pendohi, edhe i besoni ungjillit.
16 Edhe dyke ecurë ndaj detit të Galilesë,
pa Simonë edhe Andrenë të vëllan' e ati që
po hithninë rrietë ndë dett; sepse ishinë pesh-
17 katarë; Edhe Jisuj u tha atyre, Ejani pas
meje, edhe dot' u bënj juve të bëhi peshka-
18 tarë njerëzish. Edhe *ata* për-një-here lanë
rrietat' e tyre, edhe vanë pas ati.
19 Edhe dyke vaturë prej andej pak më tej
pa Jakovinë të birr' e Zevedheut, edhe Joa-
ninë të vëllan' e ati edhe tek ishinë ndë lun-
20 drët dyke ndrequrë rrietatë. Edhe për-një-
here thirri ata; edhe *ata* lanë t' an' e tyre
Zevedhenë ndë lundrët bashkë me punëtorëtë,
edhe vanë pas ati.
21 Edhe hyjnë ndë Kapernaum; edhe *Jisuj*

BKSH

për-një-here *ditën'* e-shëtunë hyri ndë sina-
22 gogjit, e mësonte. Edhe çuditeshinë për më-
simn' e ati; sepse ishte dyke mësuar' ata si
ndonjë që ka pushtet, edhe jo si shkronjësitë.
23 Edhe ishte ndë sinagogjit t' atyre një njeri
që kish frymë të-ndyrë, edhe bërtiti dyke
24 thënë, Mjerë! ç' ke ti me ne, Jisu Nazarinas?
erdhe të na humbaç? të di cili je, Shenjti i
25 Perëndisë. Po Jisuj e qërtoj, dyke thënë,
26 Mbyll gojënë, edhe dil nga ay. Edhe frym' e-
ndyrë, si e shkleu, edhe bërtiti me zë të-math,
dolli nga ay.
27 Edhe të-gjithë uhabitnë kaqë sa pyesninë
njëri tjatrinë, dyke thënë, Ç' është këjo? ç' është
ky mësim i-ri? sepse me pushtet urdhëron
28 edhe frymat' e-ndyra, edhe i bindenë. Edhe
për-një-here i dolli zëri ndëpër gjithë vëndi-
në rreth Galilesë.
29 Edhe për-një-here duallnë nga sinagogjia
e erthnë ndë shtëpit të Simonit e të Andreut,
30 bashkë me Jakovin' e me Joaninë. Edhe e
vjehërr' e Simonit po dirgjej ndër ethe; edhe
31 për-një-here i thonë për atë. Edhe ay uafë-
rua edhe dyke rrokurë atë prej dore e ngriti;
edhe e lanë ethetë për-një-here, edhë *ajo* u
shërbente atyre.
32 Edhe si ungrys, mbë të-perënduarët të
djellit, prunë tek ay gjith' ata që kishinë keq
33 edhe të-djallosuritë; Edhe tërë qyteti ish mble-
34 dhurë te dera. Edhe shëroj shumë që vua-

BKSH

ninë prej smundjesh të-ndryshme; edhe shu-
më djaj kërreu, edhe s' linte djajtë të flasënë,
sepse e njihninë.
35 Edhe ndë mëngjest fort me natë ungrit e
dolli, edhe vate ndë një vënt të-shkretë, edhe
falej atje.
36 Edhe e ndoqnë prapa Simoni edhe ata që
37 ishinë bashkë me atë; Edhe kur e gjetnë, i
38 thonë, se të-gjithë po të kërkonjënë. Edhe ay u
thot' atyre, Le të vemi ndë kryefshatrat t' Va-
afërma, që të lëçis edhe atje; sepse për këtë
39 *punë* kam dalë. Edhe ishte dyke lëçiturë
ndëpër sinagogjit t' atyre, ndëpër gjithë Ga-
lilenë, edhe dyke kërryerë djajtë.
40 Edhe vjen tek ay një i-krromosur' e i lu-
tetë, edhe bje ndë gjunj përpara ati, e i thotë,
41 Se, po të duash, munt të më qërojsh. Edhe
Jisujt i udhëmp, e ngjati dorënë, edhe e preku
42 e i thotë, Dua, qërohu. Edhe ay posa tha
këtë, për-një-here i shkoj krroma, edhe u-
43 qërua. Edhe si e porositi shtrënguarë, për-
44 një-here e kërreu jashtë, Edhe i thotë, vësh-
tro se mos i thuash gjë ndonjëj, po shko, e
dëfte vetëhenë t' ënde te prifti, edhe bjerë
për të-qëruarëtë t' ënt ato që ka urdhëruarë
45 Moisiu për dëshmim mb' ata. Po ay si dolli
nisi të lëçisë shumë, edhe të përhapnjë fja-
lënë, kaqë sa ay s' munte më të hynte faqeza
ndë qytet, po ishte jashtë ndëpër vënde të-
shkretë, edhe vininë tek ay nga të-gjithë anëtë.

BKSH

Krye 2.

1 Edhe pas *ca* ditsh përsëri hyri ndë Ka-
pernaum; edhe udëgjua se është ndë një
2 shtepi. Edhe për-një-here umblothnë shumë
veta, kaqë sa as vëndetë përanë derësë s' i
nxininë më; edhe ay u lëçiste atyre fjalënë.
3 Atëhere vijnë tek ay, e bjenë *një* ulok
4 ngriturë prej katrë *vetash*. Edhe passi
s'muntninë të afëroneshinë tek ay nga gjin-
dja *e-shumë*, sbuluanë kulminë ku ishte *ay*,
edhe si bënë vërë, sbritnë shtratnë, përmbi
5 të-cilënë dirgjej ulogu. Edhe Jisuj kur pa
besën e atyre, i thot' ulogut, Bir, t' ufalnë
6 fajet' e tu. Edhe ca nga shkronjësit' ishinë a-
tje dyke ndënjurë, edhe dyke menduarë ndë
7 zëmërat të tyre, Ç' flet ky kështu vllasfi-
mira? cili munt të falnjë faje, përveç se një,
8 Perëndia? Edhe Jisuj për-një-here si e mori
vesh me frymën' e ti se po mendonenë kë-
shtu me vetëhen' e tyre, u tha atyre, Përse
mendoni këto *punë* ndë zëmërat t' uajë?
9 Ç' është më kollaj t' i them ulogut, T' ufalnë
fajetë, apo t' i them, Ngreu, e merr shtratnë
10 t' ënt, edhe ecë? Po që t' a dini, se i bir' i
njeriut ka pushtet të falnjë faje mbi dhet,
11 (i thot ulogut) Tyj të them, Ngreu, e merr
shtratnë t' ënt, edhe shko ndë shtëpit t'ënde.
12 Edhe ay ungrit për-një-here edhe mori shtrat-
në edhe dolli përpara të gjithëve; kaqë sa
të-gjithë çuditeshinë, edhe lavduroninë Pë-

BKSH

rëndinë, dyke thënë, Se askurrë s' kemi parë
keshtu.
13 Edhe dolli përsëri ndaj detit; edhe gjithë
gjindja vinte tek ay, edhe *ay* i mësonte.
14 Edhe dyke shkuarë pa Levinë *të birrë* e
Allfeut dyke ndënjurë ndë kumerqt; edhe i
thotë, Eja pas meje. Edhe *ay* ungrit e vate
pas ati.
15 Edhe kur po rrinte ndë mësallët ndë shtë-
pit t' ati, ishin' unjurë ndë mësallët edhe
shumë kumerqarë e fajtorë bashkë me Jisun'
e me nxënësit' e ati; sepse ishinë shumë
16 *veta*, edhe vanë pas ati. Edhe shkronjë-
sit' e Farisenjtë, kur pan' atë dyke ngrënë
bashkë me kumerqarë e me fajtorë, u tho-
shinë nxënëset t' ati, Përse ha e pi *ay* bash-
17 kë me kumerqarë e me fajtorë? Edhe
Jisuj, kur dëgoj, u thot' atyre, Të-shëndo-
shëtë s' kanë nevojë për shëronjës, po ata
që vuanjënë; s' kam ardhurë për të thirrurë
të drejtë, po fajtorë (ndë pendim).
18 Edhe nxënësit' e Joanit edhe ata të Fari-
senjvet agjëroninë; edhe vijnë, e i thonë Për-
se nxënësit' e Joanit e ata të Farisenjvet
agëronjënë edhe nxënësit e tu s' agjëro-
19 njënë? Edhe Jisuj u tha, Mos muntnjë-
në t' agjëronjënë dasmorëtë, gjersa të jetë
dhëndërri bashkë me ata? sa kohë kanë
dhëdërrinë me vetëhen' e tyre, s' muntnjënë
20 t' agjëronjënë; Po dotë vijnë dit, kur dotë

BKSH

merretë dhëndërri, edhe atëhere dot' agjëro-
21 njënë nd' ato dit. Edhe asndonjë s' qep anërë
pëlhure së-re mbë rrobë të-vjetërë; ndë mos
të-mbushurit' e asaj të-ri heq prej së-vjetrësë,
22 edhe të-grisuritë bënetë më të keq. Edhe
asndonjë s' vë verë të-re ndë calikë të-vje-
tërë; ndë mos, ver' e-re gris calikëtë, edhe
vera derdhetë, edhe calikëtë prishenë; po
ver' e-re duhetë të vihetë ndë calikë të-rinj.
23 Edhe ay tek po shkonte një ditë të-She-
tunë ndëpër *ara* të-mbjella, nxënësit' e ati,
dyke bërë udhë, zunë të çkoqnjënë kallinj.
24 Edhe Farisenjt' i thoshinë, Shih, përse bëjnë
ditën e-shëtunë atë që s' ësht' e udhësë?
25 Edhe ay u thosh atyre, Askurrë s' kini kën-
duarë ç' bëri Dhavidhi, kur pat nevojë, edhe
i erdhi uri ati edhe atyreve që ishinë bash-
26 kë me atë? Qysh hyri ndë shtëpit të Pe-
rëndisë ndë *ditët* të Aviathar krye-priftit,
edhe hangri bukët e paravënjesë, të-cilatë
s' ësht' e udhësë t' i hajë *tjetërë njeri*, veç
priftërvet, edhe u dha edhe atyreve që ishi-
27 në bashkë me atë? Pasandaj u thoshte a-
tyre, se e-shëtuna është bërë për njerinë, *e*
28 jo njeriu për të-shëtunënë; Përandaj i bir' i
njeriut ësht' i-zoti edhe i së-shëtunësë.

Krye 3.

1 Pasandaj hyri përsëri ndë Sinagogjit; edhe
atje ish një njeri që kish dorënë të-thatë

BKSH

2 Edhe vininë re atë, a dot' a shëronte atë
3 *ditën'* e-shëtunë, që t'a përflisninë. Edhe ay
i thotë njeriut që kishte dorënë të-thatë,
4 Ngreu *e qëndro* ndë mest. Pasandaj u thot'
atyre, Ësht' e udhësë të bënjë njeriu mirë të-
shëtunatë, apo të-bënjë keq? të-shpëtonjë
shpirt, apo të vrasë? Po ata s' bëninë zë.
5 Atëhere si i vuri re reth me zëmërim, sepse
i erdhi keq për ashpërimn' e zëmërës' s' atyre,
i thotë njeriut, Shtri dorënë t' ënde. Edhe *ay*
e shtriu; edhe dor' e ati ubë e shëndoshë
6 (posi tjetëra). Edhe Farisenjtë si duallnë,
për-një-here bënë këshillë bashkë me Iro-
dhianëtë kundrë ati, që t' a prishnjënë.
7 Edhe Jisuj shkoj bashkë me nxënësit' e ti
mb' anët të detit; edhe i vanë pas shumë
8 shumicë nga Galilea, e nga Judhea, E nga
Jerusalimi, e nga Idhumea, e që përtej Jor-
dhanit; edhe shumë shumicë nga ata që i-
shinë rreth Tyrës' e Sidhonësë, kur dëgjuanë
9 se sa *punëra* bënte, erdhë tek ay. Edhe *ay*
u tha nxënësvet të ti t' a presë atë afërë një
lundrë, për punë të gjindjesë, që të mos e
10 shtrëngonjënë. Sepse shëroj shumë *veta*, ka-
që sa bininë sipër ati, që t' a preknjënë, sa
11 *veta* kishinë smundje. Edhe frymat' e-ndyra,
kur e vështroninë, i bininë përpara, edhe
bërtisninë, dyke thënë, Se ti je i bir' i Pe-
12 rëndisë. Po *ay* shumë i qërtonte, që të mos
e çfaqnjënë.

BKSH

13 Pasandaj hipën ndë malt, edhe thërret pë-
ranë vetëhes sa *njerës* deshi ay; edhe *ata*
14 vanë tek ay. Edhe sgjodhi dy-mbë-dhjetë
veta, që të jenë bashkë me atë, edhe që t'i
15 dërgonjë të lëçisnjënë, Edhe të kenë pushtet
të shëronjënë smundjetë, edhe të kërrenjënë
16 djajtë; Simonnë, që j'a vuri emërin Pjetër;
17 Edhe Jakovinë të birrë e Zevedheut edhe
Joannë të vëllan' e Jakovit, edhe u'a vuri
emërin Voanergjes, që do-me-thënë, Bij bu-
18 bullime; Edhe Andrenë, e Filipnë, e Var-
thollomenë, e Matthenë, e Thomanë, e Jako-
vinë *të birrë* e Allfeut, e Thadhenë, e Simon
19 Kananitinë, Edhe Judhë Iskariotinë, i-cili e-
dhe e trathëtoj.
20 Edhe vijnë ndë *një* shtëpi; edhe mblidhe-
të përsëri gjindje, kaqë sa ata s' muntninë
21 të hanin' as bukë. Edhe kur dëgjuanë njerë-
zit' e ati, duallnë t' a mbajnë, sepse thoshinë,
Se është jashtë mënç.
22 Edhe shkronjësitë, që sbritnë nga Jerusa-
limi, thoshninë, Se ka Veelzevulinë, edhe se
kërren djajtë me anë të të-parit të djajvet.
23 Po *ay*, si i thirri ata përanë, u thoshte
me paravolira, Si munt të kërrejë Satanaj
24 Satananë? Edhe një mbretëri ndë undaftë
kundrë vetëhes' se saj, ajo mbretëri s' munt
25 të qëndronjë; Edhe një shtëpi ndë u ndaftë
kundrë vetëhes' së saj, ajo shtëpi s' munt të
26 qëndronjë. Edhe Satanaj ndë ungrit kundrë

vetëhes' së tij, edhe unda, s' munt të qën-
27 dronjë, po i erdhi fundi. Asndonjë s' munt
të hynjë ndë shtëpit të të-fortit e të rrëm-
benjë enët' e ati, ndë mos e lithtë më për-
para të-fortinë; edhe atëhere do të rrëmbe-
28 një shtëpin' e ati. Me të-vërtetë po u them
juve, Se bijvet të njerësvet dot' u ndjenenë
gjithë fajetë edhe të-sharatë sa që të shanjë-
29 në, Po ay që të shanjë kundrë Frymës' së-
Shënjtëruarë, nukë ka ndjesë për *gjithë* jetë-
në, po është fajtuar për dënim të-pasosurë;
30 Sepse thoshninë, se Ka frymë të-ndyrë.
31 Vijnë pra të vëllezërit' edhe e ëm' e ati,
edhe si qëndruanë jashtë, dërguanë tek ay,
32 që t' a thërresënë. Edhe rreth ati rrinte gjin-
dje; edhe i than' ati, Na jot' ëmë edhe t' ët
33 vëllezër te po të kërkojnë jashtë. Po *ay* u-
përgjeq atyreve, dyke thënë, Cila është im'
34 më a *cilëtë janë* t' ëm vëllezër? Edhe si ho-
dhi sytë rrotullë mb' ata që rrininë përanë
35 ati, tha, Na im' më edhe t' ëm vëllezër Sepse
ay që të bënjë dashurimn' e Perëndisë, ky
është im vëlla, edhe ime motrë, edhe mëmë.

Krye 4

1 Edhe përsëri zu të mësonte ndaj detit;
edhe umbloth përan' ati shumë gjindje, kaqë
sa *ay* hyri ndë lundrët edhe rrinte ndë dett;
2 Edhe tërë gjindja ishte mbi dhet përanë de-
tit edhe i mësonte ata shumë *gjërëra* me

paravolira, edhe u thosh atyre ndë mësimt
të ti.
3 Dëgjoni; na tek dolli mbjellësi të mbjellë;
4 Edhe mbë të-mbjellurit, një pjesë ra mb'
udhët, edhe erthnë shpest' (e qiellit) edhe e
5 hangrrë. Edhe tjatëra ra mbë gurishtet, ku
s' kish dhe shumë, edhe për-një-here biu, se-
6 pse s' kish dhe të-thellë; Po kur leu djelli,
u doq, edhe me-qënë-që s' kish rrënjë, utha.
7 Edhe tjatërë ra ndë drizat; edhe drizatë hip-
8 në edhe e mbytnë, edhe pemë s' dha. Edhe
tjatërë ra ndë dhet të-mirë, edhe epte pemë
dyke hipur' e dyke rriturë, edhe pruri *pemë*
njëra tri-dhjetë, e njëra gjashtë-dhjetë, e një-
9 ra një qint.—Edhe u thoshte atyre, Ay që
ka veshë për të dëgjuarë, letë dëgjonjë.
10 Edhe kur mbeti vetëmë, ata që ishinë
rreth ati bashkë me të dy-mbë-dhjetëtë e
11 pyetnë për paravolinë. Edhe *ay* u thoshte
atyre, Mbë ju është dhënë të njihni fshehesi-
rën' e mbretëris' së Perëndisë; po mb' ata që
janë jashtë, të-gjitha bënenë me paravolira,
12 Që dyke parë të vështronjënë, edhe të mos
shohënë; edhe dyke dëgjuarë të dëgjonjënë,
edhe të mos kupëtonjënë, semos ndonjë-
13 herë kthenen e u falenë fajetë. Pasandaj u
thot' atyre, Nuk' e dini këtë paravoli? edhe
si dotë kupëtoni gjithë paravolitë?
14 Mbjellësi *ësht' ay që* mbjell fjalënë.
15 Edhe ata përan' udhësë janë këta, ndë të-

cilët mbilletë fjala; po kur dëgjonjënë, për-
një-herë vjen Satanaj, e *u* merr fjalënë që
16 është mbjellë ndë zëmërat t' atyre. Edhe gjith-
ashtu ata që mbillenë ndë gurishtet janë
këta, të-cilëtë, kur dëgjonjënë fjalënë, për-
17 një-herë e marrënë me gëzim; Po s' kanë rrë-
një ndë vetëhet të tyre, po janë për pak ko-
hë; pasandaj, kur bënetë shtrëngim a të-
ndjekurë për fjalënë, për-një-here skandha-
18 lisenë. Edhe ata që mbillenë ndë drizat janë
19 këta, të-cilëtë dëgjonjënë fjalënë; Po kujde-
set' e kësaj jete, edhe të-gënjyerët' e pasjesë,
edhe dëshërimetë për të-tjera *gjërëra*, hynjë-
në e mbytnjënë fjalënë, edhe *kjo* bënetë e-
20 papemshime. Po ata që umbollnë ndë dhet
të-mirë janë këta, të-cilëtë dëgjonjënë fjalë-
në, edhe e presënë, edhe bjenë pemë, një
tridhjetë, një gjashtë-dhjetë, edhe një një qint.
21 Edhe u thoshte atyre, Mos vjen kandili,
që të vihetë ndënë shinikt a ndënë shtratt?
22 nukë që të vihetë mbi kandilert' Sepse s' ka
gjë të-fshehëtë që të mos shpalletë; as nuk'
është bërë ndonjë gjë e-fshehurë, që të mos
23 çfaqetë. Ndë ka ndonjë veshë për të dëgju-
arë, letë dëgjonjë.
24 Edhe u thoshte atyre, Vini re ç' dëgjoni;
me ç' matës matni, dot' u matetë *edhe* juve,
25 edhe dotë shtonetë mbë ju që dëgjoni. Sep-
se ati që ka dot' i epet' *edhe tjetërë*, edhe ati
që s' ka, edhe ajo që ka dotë merretë prej ati.

26 Edhe thoshte, kështu është mbretëri' e
Perëndisë, posi një njeri që heth farënë mbë
27 dhet, Edhe fle e ngrihetë nat' e ditë: edhe
fara bin, edhe rritetë, kështu që ay s' e di
28 *se qysh.* Sepse dheu prej vetiu bje pemë,
më parë bar, pastaj kalli, pastaj, të-plottë
29 grurë ndë kallit. Ëdhe kur arrihetë pema,
dërgon drapërinë, sepse arriu të-korrëtë.
30 Edhe thoshte, Me se t' a përgjajmë mbre-
tërin' e Perëndisë? a me ç' farë paravolie t' a
31 mbarasojmë? Eshtë si një koqe sinapi, e-ci-
la, kur mbilletë ndë dhet, është m' e-vogëlë
32 se gjithë faratë që janë mbi dhet; Po si
mbilletë, rritet' e bënetë më e-mathe se gji-
thë lakëratë, edhe bën dega të-mëdha, kaqë
sa shpest' e qiellit munt të rrinë ndënë hijet
t' asaj.
33 Edhe me shumë të-këtilla paravolira u
fliste atyre fjalënë, si kundrë muntninë t' a
34 dëgjoninë. Edhe pa paravolira nuk' u' a flis-
te atyre fjalënë; po veçan nxënëset të ti u'
a sgithte të-gjitha.
35 Edhe mb' atë ditë, si u ngrys, u thot' a-
36 tyre, Letë hidhemi përtej. Edhe *nxënësitë,* si
lanë gjindjenë e marrënë sikundrë ishte ndë
lundrët; edhe të-tjera lundrëza ishinë bashkë
37 me atë. Edhe bënetë një thëllim ere i-math;
edhe valëtë bininë brënda ndë lundrët, kaqë
38 sa ajo tani po mbushej. Edhe ay ishte ndë
të-prapësmet anë *të lundrësë* dyke flejturë

BKSH

mbi ndënëkresët; edhe e sgjojnë e i thonë,
39 Mësonjës, s' do të dish se po humbemi? Edhe
ay ungrit e qërtoj erënë, edhe i tha detit,
40 Pusho, sbutu. Edhe pushoj era, edhe u bë
bunac' e-mathe. Pastaj u tha atyre, çfrika-
41 carë jeni kështu? Si s' kini besë? Edhe ata
ufrikësuanë me frikë të-mathe, edhe i thoshinë
njëri tjatërit, Cili vallë është ky, që edhe era
edhe deti e dëgjonjënë.

Krye 5.

1 Edhe erthnë *nd' anët* të-përtejme të detit,
2 ndë vëntt të Gadharinjvet. Edhe posa dolli
nga lundra, për-një-here i dolli përpara nga
3 vàrretë një njeri me frymë të-ndyrë, Që kish-
te të-ndënjuritë ndër varret, edhe asndonjë
s' muntte t'a lithte as me vargje hekurash;
4 Sepse shumë herë qe lidhurë me hekura ndër
këmbë e me vargje hekurash, po ay i kishte
këputurë vargjet' e hekuravet edhe thyerë he-
kurat' e këmbëvet; edhe asndonjë s' muntte
5 t'a sbutte. Edhe gjithënjë, dit' e natë, ishte
ndëpër varret e ndëpër malet dyke bërtitur
e dyke copëtuarë vetëhen' e ti me gurë.
6 Edhe kur pa Jisunë për së largu, ulëshua
7 me vrap edhe i ufal, Edhe dyke bërtiturë me
zë të-math thotë: ç' ke ti me mua, o Jisu, i
bir'i Perëndis' së-lartë? të vë mbë be mbë Perën-
8 dinë, të mos më mundojsh. Sepse *Jisuj* i thosh-
9 te, Dil nga njeriu, o frym' e ndyrë. Edhe e

BKSH

pyeste, Si t'a *thonë* emërinë? Edhe *ay* upër-
gjeq e tha, Legjeon m'a *thonë* emërinë, sepse
10 jemi shumë. Edhe i lutej shumë, që të mos
e dërgonjë jashtë vëndit.
11 Edhe atje ndaj malit ishte dyke kulloturë
12 një tuf' e madhe derrash; Edhe i u lutnë ati
gjithë djajtë, dyke thënë, Dërgo-na ndër de-
13 rrat, që të hyjmë ndër ata. Edhe Jisuj për-
një-here u dha lejë. Edhe frymat' e ndyra
duallnë, e hynë ndër derrat; edhe tuf' e de-
rravet udruth prej shkëmbit ndë dett, (edhe
ishinë afërë dy mijë), edhe umbytnë ndë dett.
14 Edhe ata që kullotninë derratë iknë, edhe
dhanë zë ndë qytett e ndëpër arat. Edhe
duallnë të shohënë ç' është këjo *punë* që u-
15 bë. Edhe vijnë tek Jisuj, edhe vënë re të
djallosurinë që pat pasurë legjeoninë dyke
ndenjurë, e të-veshurë, e të-urtësuarë; edhe
16 ufrikësuanë. Edhe ata që panë u treguan'
atyreve, si gjajti *puna* mbë të djallosurinë,
17 *si* edhe për derratë. Edhe zunë t' i lutenë të
ikënjë nga sinorët' e atyreve.
18 Edhe kur hynte ay ndë lundrët, ay që pat
qënë i-djallosurë i lutej të jetë bashkë me
19 atë. Edhe Jisuj s' e la, po i thotë, Ecë ndë
shtëpit t' ënde te njerëzit' e tu, edhe ep-u zë
për *gjithë* sa të bëri Zoti edhe të përdëlleu.
20 Edhe ay iku, edhe zuri të lëçisë nde Dhe-
kapolë sa i bëri ati Jisuj; edhe të-gjithë çu-
diteshinë.

BKSH

21 Edhe Jisuj si ukapërxye përsëri me lun-
drë mb' anët të-përtejme, shumë gjindje u-
mbloth tek ay; edhe ay ishte përanë detit.
22 Edhe na tek vjen një nga të-parët' e si-
nagogjisë, *që e kishte* emërinë Jair; edhe *ky*
23 kur pa atë, i bje ndër këmkë; Edhe i lutej
shumë, dyke thënë, se ime bijëzë është mbë
frymët të-pastajme; *të-lutem* të vijsh e të-vësh
duartë mbi atë, që të shpëtonjë; edhe dotë
24 rronjë. Edhe *ay* vate bashkë me atë; edhe
shumë gjindje i vininë pas, edhe e shtrën-
goninë.
25 Edhe një grua që kishte të-rrjedhurë gja-
26 ku dy-mbë-dhjetë vjet, Edhe që kishte he-
qurë shumë nga shumë shëronjës, edhe që
kishte prishurë gjithë ç' kishte pasurë, edhe
që s'kishte parë asndonjë dobi, po ishte bërë
27 edhe më keq, Kur dëgjoj për Jisunë, erdhi
ndë mest të gjindjesë që prapa, e preku ro-
28 bën' e ati; Sepse thoshte, se edhe rrobat' e
29 ati ndë prekça, dotë shpëtonj. Edhe për-një-
here utha burimi i gjakut t' asaj, edhe e
ndjeu ndë trupt të saj se ushërua nga smun-
30 dja. Edhe Jisuj për-një-here, si kupëtoj ndër
vetëhe fuqinë që dolli nga ay, ukëthye te
31 gjindja, e thoshte, Kush më preku rrobetë?
Edhe nxënësit' e ati i thoshinë, She gjëndjenë
se të shtrëngon, edhe thua, Kush më pre-
32 ku? Po ay vinte re përqark që të shohë atë
33 që bëri këtë. Edhe gruaja dyke trëmbur' e

BKSH

dyke dridhurë, sepse e dinte, se ç' ishte bërë
tek ajo, erdhi e i ra *ndër këmbë*, edhe i tha
34 gjithë të-vërtetënë. Edhe ay i tha, Bije, besa
jote të shpëtoj; ecë ndë paqtim, edhe ij e-
shëndoshë nga smundja jote.
35 Ay tek po fliste edhe, vijnë nga i-par' i
sinagogjisë, dyke thënë, Se jot' bijë vdiq;
36 përse më e mundon mësonjësinë? Po Jisuj
posa dëgjoj fjalënë që po flitej, i thotë të-
parit të sinagogjisë, Mos kij frikë, vetëmë
37 beso. Edhe s' la asndonjë të vejë prapa
bashkë me atë, veç Pjetrinë edhe Jakovinë
38 edhe Joaninë të vëllan' e Jakovit. Edhe vjen
ndë shtëpit të të-parit të sinagogjisë, edhe
vështron trazyra, e *njerës* që qanin' e ulurininë
39 shumë. Edhe si hyri, u thot' atyre, Ç' bëni
trazyrë e qani? vashëza nukë vdiq, po po fle.
40 Edhe ata e përqeshninë. Po ay, si nxori jash-
të të-gjithë, merr me vetëhe t' an' e vashëzësë
edhe t' ëmën' edhe ata që ishinë bashkë me atë,
41 edhe hyri *atje* ku ishte dergjurë vashëza. Edhe
dyke rrokurë dorën' e vashëzësë, i tha asaj,
Talitha kumi, që e-kthyerë do me thënë, Va-
42 shëzë, të them, ngreu. Edhe për-një-here va-
shëza ungrit, edhe ecënte; sepse ishte dy-mbë-
dhjetë vjeç. Edhe uçuditnë me çudi të-madhe.
43 Edhe i porositi shumë të mos e marrë vesh
këtë asnjeri; edhe tha t' i epet' asaj të hajë.

BKSH

Krye 6.

1 Edhe dolli andej, edhe erdhi ndë vëntt të ti,
edhe nxënësit' e ti i venë pas.
2 Edhe kur erdhi e-shëtuna, zuri të mësojë
ndë sinagogjit; edhe shumë *veta* kur dëgjo-
ninë, çuditeshinë, e thoshinë, Që ku *i erthnë*
këti këto? edhe ç' është këjo dituri që i
është dhënë këti, edhe të-këtilla çudira bë-
3 nenë nga duart' e ati? Nuk' është ky mje-
shtri, i bir' i Marisë, e i vëllaj i Jakovit e i
Josiut e i Judhësë e i Simonit? edhe nukë
janë të-motrat' e ati këtu ndër ne? Edhe
4 skandhaliseshinë mb' atë. Po Jisuj u thoshte
atyre, Se nukë ka profit të-panderçim, veç
ndë atdhet të ti, edhe ndër njerëzit të ti,
5 edhe ndë shtëpit të ti. Edhe s' muntte të
bënte atje asndonjë çudi, veç mbë pak të-
6 smurë vuri duartë e i shëroj. Edhe çuditej
për pabesërin' e atyre. Edhe shkonte fshat-
ravet rrotullë, dyke mësuarë.
7 Edhe thirri përanë të dy-mbë-dhjetëtë,
edhe zuri t' i dërgonjë dy nga dy; edhe u
8 epte pushtet kundrë frymavet të-ndyra. Edhe i
porositi ata të mos mbanjënë asgjë udhësë, veç
një stap vetëmë; as trajstë, as bukë, as ramë ndë
9 brest; Po të jenë mbathurë me sholëza, edhe
10 të mos veshnjënë dy rroba. Edhe u thoshte
atyre, Mbë ç' shtëpi që të hyni, mbetuni atje
11 gjersa të dilni q' andej. Edhe sa *veta* të mos
u presënë juve, as të mos u dëgjonjënë juve,

BKSH

kur të dilni andej, shkuntni pluhurinë *që*
është përposh këmbëvet t'uaj, për dëshmim
mb' ata; me të-vërtetë po u them juve, Më
i-duruarshim dotë jetë mundimi ndë Sodho-
mat e ndë Gomorrat ndë ditët të gjyqit, se
12 mb' atë qytet. Edhe ata duallnë e lëçitninë
13 që të pendonenë *njerëzitë*; Edhe kërreninë
shumë djaj; edhe lyeninë me vaj shumë te-
sëmurë edhe i shëroninë.
14 Edhe dëgjoj mbreti Irodh, (sepse emër' i
ati kishte dalë i-çfaqurë,) edhe thoshte, Se
Joani që pagëzonte është ngjallurë nga të-
vdekuritë, edhe përandaj fuqit' *e* qiellit pu-
15 nojnë me anë t' ati. Të-tjerë thoshinë, Se
ay ishte Ilia. Po të-tjerë thoshinë, Se është
16 profit a si një nga profitëritë. Po Irodhi, kur
dëgjoj, tha, Se ky është Joani, të-cilit unë i
preva kryetë; ay është ngjallurë nga të-vde-
kuritë.
17 Sepse vetë Irodhi dërgoj e zuri Joaninë,
edhe e lidhi ndë burk për Irodhiadhënë gruan'
e Filipit të vëllat sepse e kishte marrë *për*
18 grua. Sepse Joani i thoshte Irodhit, Se s'ësht' e
19 udhësë të kesh ti gruan'e t'yt vëllaj. Andaj
Irodhiadha e kishte mëri, edhe donte t' a vris-
20 te, po nukë muntte. Sepse Irodhi kishte frikë
nga Joani, dyke ditur' atë *për* njeri të-drejtë
edhe për shënjt; edhe e ruante, edhe bënte shu-
më *punë* dyke dëgjuar' atë, edhe me gëzim
21 e dëgjonte. Edhe kur erdhi *një* dit' e-mbarë

ndë të-cilët Irodhi u bëri darkë për ditën' e
të-lindurit të ti të-mëdhenjvet të ti e krye-
22 miësvet e të-parëvet të Galilesë, Edhe hyri e bij'
e Irodhiadhësë, e kërceu, edhe i pëlqeu Irodhit
edhe atyreve që ishinë ndënjyrë bashkë ndë më-
sallët, mbreti i tha vashëzësë, Lup-më ç'të du-
23 ash, edhe dotë t'a ap. Edhe i bëri be asaj,
Se çdo që të më lypësh dotë t'a ap, gjer mbë
24 gjysmën' e mbretërisë s'ime. Edhe ajo dolli e
i tha s' ëmësë, Ç' të lypënj? Edhe ajo tha,
25 Kryet' e Joan Pagëzorit. Edhe *ajo* për-një-
here hyri me nxitim te mbreti, e lypi, dyke
thënë, Dya· të më apç tani ndë talure
26 kryet' e Joan Pagëzorit. Edhe mbreti u hiðë-
rua fort, po për betë që kishte bërë, edhe
për ata që ishinë ndënjurë bashkë *me atë*
ndë mësallët, nukë deshi t'j'a hedhë poshtë
27 kërkimnë. Edhe për-një-here mbreti dërgoj
një trim, edhe urdhëroj të bihetë kryet' e ati.
28 Edhe ay vate, e i preu kryetë ndë burkt;
edhe e pruri kryet' e ati mbë talyre, edhe
j'a dha vashëzësë; edhe vashëza j'a dha s'
29 ëmësë. Edhe nxënësit' e ati, kur dëgjuanë,
erthnë, edhe ngritnë trupin' e ati, edhe e vunë
ndë varr.

30 Edhe apostojtë mblidhenë te Jisuj, edhe
i rrëfyenë të-giitha, edhe sa bënë, edhe sa
31 mësuanë. Edhe u tha atyre, Ejani ju vetë
veçanë ndë *një* vënt të-shkretë, edhe prëhi
pak; sepse ishinë shumë ata qe vinin' e

shkoninë, edhe as për të ngrënë s'kishinë
32 kohë. Edhe *ata* vatnë me lundrë ndë një vënt
të-shkretë veçanë.
33 Edhe (gindja) pan' ata dyke shkuarë, edhe
shumë *veta* e njohnë; edhe mbë këmbë nga
gjithë qytetetë usulnë atje, edhe arritnë më
përpara se ata, edhe umblothnë për an' ati.
34 Edhe Jisuj, kur dolli, pa shumë gjindje edhe
j' udhëmp për ata, sepse ishinë si dhën që
s' kanë bari; edhe zuri t' i mësonjë shumë.
35 Edhe tani me-qënë-që kishte shkuarë
shumë koha i uafëruan' ati nxënësit' e i tho-
në, se vëndi ësht' i-shkretë edhe tani koha
36 ka shkuarë shumë; Lësho ata, që të vcnë
ndëpër arat e ndëpër fshatrat rrotullë, e të
blenë bukë për vetëhen' e tyre; sepse s' kanë
37 se ç' të hanë. Po ay upërgjeq e u tha atyre,
Ep-u-ni juve atyre të hanë. Edhe *ata* i thonë,
Të vemi e të blemë dy qint dinarë kukë, e t'
38 u apëm' atyre të hanë? Edhe ay u thot' atyre,
Sa bukë kini? shkoni e shihni. Edhe si *van'*
39 *e* panë, i thonë, Pesë, edhe dy pishqe. Edhe *ay*
urdhëroj ata t' i vënë ata të rrinë të gjithë
40 truveza truveza permbi bart të-njohmë. Edhe
ata ndënjnë togje togje, nga një qint e nga
41 pesë-dhjetë. Edhe *ay* si mori të pesë bukët'
e të dy pishqetë, ngriti sytë ndë qiellt, e be-
koj, edhe theu bukëtë edhe u'a dha nxënës-
vet të ti, që t' i vënë përpara atyreve; edhe
42 të dy pishqetë u'a ndau të-gjithëve. Edhe të-

43 gjithë hangrrë e ungjijnë. Edhe ngritnë dy-
mbë-dhjetë kofinë plot më copëra, edhe nga
44 pishqetë. Edhe ata që hangrrë bukëtë ishinë
si ndonja pesë mijë.
45 Edhe për-një-here shtrëngoj nxënësit' e
ti të hyjnë ndë lundrët, edhe të venë më parë
se ay mb' at' anë nde Vithsaida, gjersa ay
46 të lëshonte gjindjenë. Edhe si i lëshoj vate
ndë malt të faletë.
47 Edhe kur ungrys, lundra ish ndë mest të
48 detit edhe ay vetëmë mbi tokët. Edhe pa ata
që po mundoneshinë mbë të-vozitur‍it; sepse
era ishte kundrë atyre; edhe mbë të-katërtë-
në ruajtje të natësë vjen tek ata, dyke ecurë
49 mbi dett; edhe donte t' i kapërxente. Po ata
kur pan' atë që po ecënte mbi dett, pandeh-
50 në, se ishte hije, edhe bërtitnë. Sepse të-gjithë
e panë, edhe udrothnë. Edhe për-një-here foli
bashkë me ata, e u thot' atyre, Kini zëmërë;
unë jam, mos ufrikësoni. Edhe hipi tek ata
51 ndë lundrët; edhe era pushoj. Edhe me ve-
tëhen' e tyre habiteshinë fort tepërë, edhe
52 çuditeshinë, Sepse nuk' e muarnë vesh nga
bukëtë; sepse zëmër' e atyre ish e-ashpëruarë.
53 Edhe si ukapërxyenë, erthnë ndë dhet
Gjenisaret, edhe hothnë hekurë ndë liman.
54 Edhe ata kur duallnë nga lundra, për-një-
55 here e njohnë, Edhe uturnë ndëpër gjith' ata
vënde rrotullë, e zunë të bininë mbi shtratëra
ata që kishinë keq atje ku dëgjoninë se është.

BKSH

56 Edhe kudo që hynte ndër fshatëra, a ndër
qytete, a ndër ara, vininë të-smurëtë ndëpër
tregjet, edhe i luteshinë të preknjënë vetëmë
pëqin' e rrobës' s' ati; edhe *gjithë* sa e prek-
ninë, shëroneshinë.

Krye 7.

1 Atëhere mblidhenë tek ay Farisenjtë, edhe
disa nga shkronjësitë, që kishin' ardhurë nga
2 Jerusalimi. Edhe kur panë, se disa nga nxë-
nësit' e ati haninë bukë me duar të-fëlliqura,
3 do-me-thënë të-palara, i përfolnë. (Sepse Fa-
risenjt' edhe gjithë Judhenjtë, ndë mos laf-
shinë duartë gjer ndë bryllt, nukë hanë, sepse
4 mbajnë fjalënë qe u kanë lënë pleqtë; Edhe *kur
kthenenë* nga tregu, ndë mos u lafshinë, nukë
hanë; edhe shumë të-tjera ka që kanë marrë
për të mbajturë, *si* të-lara potirësh, e limash,
5 e enësh të-ramta, e shtratërash.) Pasandaj Fa-
risenjt' e shkronjësit' e pyesënë, përse nxë-
nësit' e tu nuk' ecëjnë sipas fjalëvet që kanë
lënë pleqtë, po me duar të-palara hanë bukë?
6 Po ay upërgjeq e u tha atyre, Se mirë
profitepsi Isaia për ju ipokritëritë, sikundrë
është shkruarë, „Ky llaus me buzëtë më nde-
ron, po zëmër' e atyre është lark prej meje;
7 Edhe kot më nderonjënë, dyke mësuarë më-
8 sime porosi njerëzish.“ Sepse kini lënë poro-
sin' e Perëndisë, e mbani fjalëtë që kanë

lënë njerëzitë, të-lara limash e potirësh, edhe
bëni shumë të-tjera të-tilla si këto.
9 Edhe u thosh atyre, Mirë e hithni poshtë,
porosin' e Perëndisë, që të mbani fjalënë që
10 kini lënë. Sepse Moisiu ka thënë, „Ndero
t' ët atë e t' ët ëmë;“ edhe, „kush flet keq
për t' an' a për t' ëmënë pa fjalë të vritetë.“
11 Po ju thoni, Njeriu ndë i thëntë t' et a s' ë-
mësë, kurban, që do me thënë dhurëti, është
çdo e-mirë që dotë shohç prej meje, *është*
12 *mjaft*; Edhe s' e lini më t' i bënjë asgjë t'
13 et a s' ëmësë, Edhe shkelni fjalën' e Perën-
disë për fjalënë t' uaj që kini lënë; edhe
bëni shumë të-tilla *punë* si këto.
14 Edhe si thirri përanë gjithë gjindjenë, u
thosh atyre, Dëgjo-më-ni të-gjithë, edhe merni
15 vesh; S' ka asgjë që përjashta njeriut që hyn
tek ay që munt t'a ndynjë, po ato që dalënë
16 prej ati, ato janë që e ndynjënë njerinë. Ay
që ka veshë për të dëgjuarë letë dëgjonjë.
17 Edhe kur hyri ndë *një* shtëpi prej gjin-
djesë, e pyesninë nxënësit' e ti për paravolinë.
18 Edhe *ay* u tha atyre, Kësktu edhe ju jini të-
pamarrë vesh? s' merrni vesh se çdo gjë që
i hyn njeriut që përjashta nukë munt t'a ndy-
19 një? Sepse nukë hyn ndë zëmërët t' ati, po
ndë barkut; edhe del ndë të-dalët, dykë që-
20 ruarë gjithë të-ngrënatë. Po thoshte, se ç'
21 del nga njeriu, ajo ndyn njerinë. Sepsé që
përbrënda nga zëmër' e njerësvet dalënë men-

22 dimet' e-liq, ndyrësira, kurvërira, vrasje, Vje-
dhje, lakmime, ligësira, kobim, tepërë-ndyrësi,
të-shikuarë me sy të-lik, vllasfimi, madhë-
23 shti, marrësi. Gjithë këto të-liga që përbrënda
dalënë, edhe ndynjënë njerinë.
24 Edhe ungrit prej andej, e vate ndë sino-
rët të Tyres' e të Sidhonësë, edhe si hyri
ndë një shtëpi, nukë deshi t'a marrë vesh
asnjeri; po s' mundi të fshihetë.
25 Sepse një grua, së-cilësë e bijëza kishte
frymë të-ndyrë, kur dëgjoj për atë, erdhi e
26 i ra ndër këmbë. Edhe gruaja ishte greke,
Syrofinike nga kombi; edhe i lutej të kërre-
27 një djallinë prej së bijësë. Po Jisuj i tha
asaj, Le të të nginjenë më përpara djemtë;
sepse s' është mirë të marrë ndonjë bukën'
e djemvet, edhe t' u' a hedhë këlyshvet *të*
28 *qënvet.* Po ajo upërgjeq e i tha, Po, Zot, *po*
edhe këlushëtë përposh truvezësë hanë nga
29 thërrimet' e çunavet të-vegjëlë. Edhe ay i tha
asaj, për këtë fjalë shko; djalli dolli nga jot'
30 bijë. Edhe *ajo* kur vate ndë shtepit të saj,
gjeti të bijënë rënë mbë shtratt edhe djallinë
të-kërryerë.
31 Edhe përsëri dolli nga sinorët' e Syrës'
e të Sidhonësë, edhe erdhi ndaj detit të Ga-
lilesë ndëpër mest të sinorëvet të Dhekapolësë.
32 Edhe i sjellënë një të-shurdhërë belbacuk,
33 edhe i lutenë të vërë dorënë mbi atë. Edhe
ay e mori prej gjindjesë veçanë, edhe vuri

gishtërit' e ti ndë veshët t' ati, edhe si pshty-
34 ti, i preku gjuhënë; edhe si ngriti sytë ndë
qiellt, psherëtiti, edhe i thotë ati, Effatha, që
35 do me thënë, Hapu. Edhe për-një-here uhap-
në veshët' e ati, edhe usgith të-lidhurit' e gju-
hës' s' ati, edhe fliste drejt.
36 Edhe i porositi të mos i thonë asnjeriu; po
sa më *tepërë* i porositte ay, kaqë më tepërë
37 ata e lëçitninë. Edhe çuditeshinë fort tepërë
e thoshinë, Mirë i ka bërë të-gjitha; edhe
të-shurdhërit' i bën të dëgjonjënë, edhe me-
mecëtë të flasënë.

Krye 8

1 Nd' ato dit, passi ishte shumë gjindje,
edhe s' kishinë se ç' të haninë, *Jisuj* thërriti
2 përanë nxënësit' e ti, e u thot' atyre, Më
dhëmbetë për gjindjenë, sepse tani *janë* tri
dit që rrinë përanë meje, edhe s' kanë se
3 ç' të hanë; Edhe ndë i lëshofsha të-pangrënë
për ndë shtëpit *të* tyre, dotë këputenë mb'
udhe; sepse ca nga ata kanë ardhurë prej
4 së-largu. Edhe nxënësit' e ati i upërgjeqnë,
Nga dotë muntnjë njeriu t' i nginjë këta me
5 bukë këtu ndë shkretëtirët? Edhe *ay* i pyeti,
6 Sa bukë kini? Edhe ata i thanë, Shtatë. Edhe
porositi gjindjenë të unjenë përdhe; edhe si
mori të shtatë bukëtë, e ufal ndersë, i theu,
edhe u'a dha nxënësvet të ti, që t' i vënë
përpara *gjindjesë*; edhe *ata* i vunë përpara

7 gjindjesë. Edhe kishinë pak pishqe të-vegjëlë;
edhe si bekoj, tha të vënë përpara edhe ata.
8 Edhe hangrrë e unginjnë; Edhe gritnë tepë-
9 rica copash, shtatë çporta. Edhe ata që han-
grrë ishinë sinja katrë mijë *veta*; pasandaj
i lëshoj ata.

10 Edhe për-një-here hyri ndë lundrët bashkë
me nxënësit' e ti, edhe erdhi nd' anët Dhall-
manutha.

11 Edhe duallë Farisenjtë e zunë të bishë-
toninë me atë, edhe të lypnjënë nga ay shë-
12 një prej qiellit, dyke ngar' atë. Po *ay* si
psherëtiti ndë shpirt të ti, thotë; Përse lypën
shënjë ky bres? me të-vërtetë po u them
juve, se Nukë dot' i epetë shënjë këti brezi.
13 Edhe si i la, hyri përsëri ndë lundrët, e shkoj
nd' *anët* të-përtejme.

14 Edhe ata harruanë të marrënë bukë, edhe
s' kishinë me vetëhe ndë lundrët veç një
15 bukë. Edhe ay i porosiste, dyke thënë, Shi-
koni, ruhi nga brumi i Farisenjvet edhe nga
16 brumi i Irodhit. Edhe *ata* mendoneshinë ndër
mest të tyre, dyke thënë, Se s' kemi bukë.
17 Edhe Jisuj si e kupëtoj, u tha atyre, Ç' men-
doneni, se s' keni bukë? Edhe s' merrni vesh
e as kupëtoni? edhe po t' ashpërë e keni
18 zëmërënë t' uaj? Dyke pasurë sy, nukë shih-
ni? edhe dyke pasurë veshë, nukë dëgjoni?
19 edhe nukë mbani mënt? Kur theva të pesë

BKSH

bukëtë mbë të pesë mijët, sa kofinë plot
me copëra ngrittë? I thonë, Dy-mbë-dhjetë.
20 Edhe kur të shtatë *bukëtë* ndë të katrë
mijët, sa çporta plot me copëra ngrittë? Edhe
21 ata thanë, Shtatë. Edhe u thoshte atyre, Qysh
nukë kupëtoni?
22 Pasandaj vjen ndë Vithsaidha; edhe i bje-
në *një* të-verbërë, edhe i lutenë t' a preknjë.
23 Edhe si e preku prej dore të-verbërinë, e
nxori jashtë fshatit; edhe si pshtyti ndër syt
t' ati, vuri duartë mbi atë, edhe e pyeste, ndë
24 sheh gjë. Edhe *ay* si hapi sytë, tha, Shoh
25 njerëzitë se ecëjnë posi drurë. Pasandaj për-
sëri vuri duartë mbi syt' t' ati, edhe e bëri
atë të hapnjë sytë, edhe u shërua, edhe shih-
26 te kthjellëtë të-gjitha. Edhe e dërgoj ndë
shtëpit t' ati, dyke thënë, As ndë fshatt të
hyjsh, as t' j' a thuash këtë njeriu ndë fshatt.
27 Pasandaj dolli Jisuj edhe nxënësit' e ti
ndëpër fshatrat të Qesaris' së Filipit; edhe
udhësë pyeste nxënësit' e ti, dyke thënë a-
28 tyre, Cili thonë njerëzitë se jam unë? Edhe
ata i upërgjeqnë, Joan Pagëzori; edhe të-tjerë
thonë, Ilia; edhe të-tjerë, një nga profitëritë.
29 Edhe ay u thot' atyre, Po ju cili thoni
30 se jam unë? Edhe Pjetri upërgjeq, e i tho-
të, Ti je Krishti. Edhe i porositi ata ashpë-
rë që të mos i thonë njëriu për atë.
31 Edhe zuri t' i mësonjë ata, se i bir' i nje-
riut duhetë të pësonjë shumë, edhe të mos

pëlqenetë nga pleqt' e nga kryepriftëritë e
nga shkronjësitë, edhe të vritetë, edhe pas
tri ditsh të ngjalletë. Edhe e fliste fjalënë
32 faqeza. Edhe Pjetri e mori veçanë, e zuri t'
33 a qërtonjë. Po ay si ukthye e vuri re nxë-
nësit' e ti, qërtoj Pjetrinë, dyke thënë, Ikë
prej meje, Satana; sepse s'ke ndër mënt pu-
nët' e Perëndisë, po punët' e njerësvet.
34 Edhe si thirri përanë gjindjenë bashkë me
nxënësit' e ti, u tha atyre, Kush të dojë të
vinjë prapa meje, letë mohonjë vetëhen' e ti,
edhe letë ngrerë kryqin' e ti, edhe letë më
35 vinje pas. Sepse kush të dojë të shpëtonjë
jetën' e ti, dot' a humbasë; po kush të hum-
basë jetën' e ti për punë t' ime edhe të un-
36 gjillit, ky dot' a shpëtonjë. Sepse ç' dobi do-
të ketë njeriu, ndë fitoftë gjithë botënë, edhe
37 të dëmtonjë shpirtin e ti? Apo ç' dotë apë
38 njeriu për këmbyerje të shpirtit të ti? Se-
pse cilitdo që t'i vinjë turp për mua edhe
për fjalët' e-mia mbë këtë bres kurvar edhe
fajtuar, edhe të birit të njeriut dot' i vinjë
turp për atë, kur të vinjë ndë lavdit të t' Et
bashkë me ëngjëjt' e-shënjtëruarë.

Krye 9

1 Edhe u thosh atyre, Me të-vërtetë po uthem
juve, se janë disa prej këtyre që rrinë këtu, që
nukë dotë ngjëronjënë vdekje, gjersa të shohë-
në mbretërin' e Perëndisë t' ardhurë me fuqi.

2 Edhe pas gjashtë ditsh Jisuj merr Pjetrin'
e Jakovin' e Joaninë, edhe i hipën ata vetë-
më mbë një mal të-lartë veçanë; edhe ndë-
3 rroj fytyrënë përpara atyre. Edhe rrobat' e
ati ubënë të-çkëlqyera të-bardha fort posi
dëbora, t' atilla që robësbardhës mbi dhet
4 s' munt t' i sbarthnjë kështu. Edhe u duk a-
tyre Ilia bashkë me Moisinë; edhe ishinë dy-
5 ke folurë bashkë me Jisunë. Edhe Pjetri u-
përgjeq e i tha Jisujt, Ravvi, mir' është të
jemi ne këtu; edhe letë bëjmë tri tenda,
një për ty, edhe një për Moisinë, edhe një
6 për Ilinë. Sepse s' dinte se ç' të fliste, sepse
7 ishinë tremburë keq. Edhe një re i mbuloj,
edhe erdhi një zë prej resë dyke thënë, Ky
8 është biri im i-dashurë, ati i dëgjoni. Edhe
befas kur vunë re perqark, s' panë më as-
ndonjë, po Jisunë vetëmë bashkë me vetëhen'
e tyre.
9 Edhe ata tek ishinë dyke sbriturë nga
mali, i porositi ata të mos i tregonjën' as ŋe-
riut sa panë, veç kur të ngjalletë i Bir' i nje-
10 riut prej së-vdekurish. Edhe ata e ruajtnë fja-
lënë *ndër vetëhe*, dyke bishëtuarë njëri me
tjatrinë, Ç' është këta të-ngjallurë prej së-
vdekurish.
11 Edhe e pyesnin' atë, dyke thënë, Përse
thone shkronjësitë, se duhetë të vinjë më
12 përpara Ilia? Edhe ay upërgjeq e u tha aty-
re, Ilia vjen më përpara, edhe vë mbë vënt

BKSH

të-gjitha *punëratë*; edhe si është shkruarë për
të birin' e njeriut se duhetë të pësonjë shu-
13 më, edhe të çnderonetë. Po u them juve, Se
edhe Ilia erdhi, edhe *se* i bënë sa deshnë,
sikundrë është shkruarë për atë.
14 Edhe kur erdhi te nxënësitë, pa shumë
gjindje rreth atyreve, edhe shkronjësitë dyke
15 bishëtuarë me ata. Edhe për-një-here gjithë
gjindja, kur e pan' atë, uhabitnë, edhe dyke
16 nxituar' e përshëndoshninë. Edhe *ay* pyeti
17 shkronjësitë, Ç' bishëtoni me ata? Edhe një prej
gjindjesë upërgjeq, e tha, Prura te ti t' im
18 bir që ka frymë të-pagojë. Edhe kudo t' a
zërë, e heth poshtë; edhe shkumbëzon, e kër-
cëllin dhëmbët' e ti, edhe thahetë; edhe u
thashë nxënëset të tu t' a kërrenjënë, po nu-
19 kë muntnë. Edhe ay i upërgjeq e tha, O
bres i-pabesë, gjer kur dotë jem bashkë me
ju? gjer kur dot' u duronj juve? sill-e-ni atë
20 tek unë. Edhe e prunë tek ay; edhe kur pa
atë, për-një-here fryma e çkleu; edhe ra për-
dhe, edhe rungullisej dyke shkumbëzuarë.
21 Edhe *ay* pyeti t' anë, sa kohë ka që kur se
i gjau këjo? Edhe ay, tha, Që kur se ishte djal'
22 i-vogëlë. Edhe shumë herë e hodhi edhe ndë
zjarr edhe nd' ujëra, që t' a humbasë; po
ndë munt *të bësh* gjë, letë të dhëmbetë për
23 ne edhe ndih-na. Edhe Jisuj i tha këtë, Ndë
munt të besojsh, të-gjitha *janë* të-mundura
24 për atë që beson. Edhe për-një-here i at' i

BKSH

djalit të-vogëlë thëriti me lot, dyke thënë,
25 Besonj, Zot; ndihi pabesërisë s' ime. Edhe
Jisuj kur pa, se po rrudhetë gjindje, qërtoj
frymën' e-ndyrë, dyke i thënë, Frym e-pagojë
edhe e-shurdhërë, unë të urdhëronj, dil nga
26 ay, edhe mos hyjsh më tek ay. Edhe *Fryma*
dyke bërtitur' e dyke shklyer' atë fort, dolli;
edhe *djali* ubë posi i-vdekurë, kaqe sa shu-
27 më *veta* thoshinë se vdiq. Edhe Jisuj e kapi
prej dore, edhe e ngriti; edhe u ngrit.
28 Edhe kur hyri ndë *një* shtëpi, nxënësit' e
ti e pyesninë veçanë, Përse nukë muntmë
29 neve t'a kërrejmë. Edhe *ay* u tha atyre, ky
farë kombi s' munt të dalë *me tjetërë gjë*,
veç me të-falur'e me agjërim.
30 Edhe si duallnë andej, shkoninë ndëpër
Galilet, edhe s' donte t'a marrë vesh njeri.
31 Sepse mësonte nxënësit' e ti, e u thosh
atyre, se i Bir'i njeriut epetë ndër duar të
njerësve, edhe do t' a vrasënë, edhe si të
32 vritetë, të-tretënë ditë dotë ngjalletë. Po ata
nuk' e kupëtoninë fjalënë, edhe kishinë frikë
t' a pyesënë.
33 Edhe erdhi ndë Kapernaum; edhe kur
hyri ndë shtëpit, pueste ata, Ç' mendoneshitë
34 udhësë ndë mest t' uaj? Po ata s' bëninë
zë; sepse udhësë flisninë ndë mest të tyre,
35 cili është m' i-math. Edhe si ndënji thirri të
dy-mbë-dhjetëtë, edhe u thot' atyre, kush të
dojë të jet' i-parë, dotë jetë i-prapësm i

të-gjithëve, edhe shërbëtuar i të-gjithëve.
36 Edhe mori një djalë të-vogëlë, edhe e
qëndroj ndë mest t'atyreve, edhe si e mori
37 ndë krah, u tha atyre, Kush të presë një
nga të-këtillëtë djem të-vegjëlë mb' emërit
t' im, ka priturë mua; edhe kush të presë
mua, s' ka priturë mua, po atë që më ka
dërguarë.
38 Edhe Joani i upërgjeq, dyke thënë, Më-
sonjës, pamë një *njeri* që kërren djaj mb' emë-
rit t'ënt, i-cili nukë na vjen pas; edhe e
39 ndalmë sepse nukë na vjen pas. Po Jisuj
tha, Mos e ndalni, sepse s'ka asndonjë i-cili
dotë bënjë çudira mb'emërit t' im, edhe dote
muntnjë për-një-here të flasë keq për mua;
40 Sepse kush nuk është kundrë nesh, është
41 bashkë me ne. Sepse kush t'u apë juve një
potir ujë mb'emërit t'im, sepse jeni të Kri-
shtit, me të vërtetë po u them juve, *se* nukë
42 do t'a humbasë pagën'e ti; Edhe kush të
skandhalisnjë një nga këta të-vegjëlitë
që më besojnë, është më mirë për atë, ndë
i ulithtë një gur mulliri ndë qafët të ti, edhe
të hidhetë ndë dett.
43 Edhe ndë të skandhalistë dora jote, pre-e;
është më mirë për ty të hynjç, ndë jetët dorac,
se dyke pasurë të dy duartë të shkojsh ndë
44 gjehenët, ndë zjarrt të-pashuarë, Ku „krimb' i
atyre s' ka të-mbaruarë, edhe zjarri s' ka
45 të-shuarë". Edhe ndë të skandhalistë ty këmba

BKSH

jote, pre-e; sepse është më mirë për ty të
hynjç ndë jetët i-çalë, se duke pasurë të dy
këmbëtë të hidhesh ndë gjehenët, ndë zjarrt
46 të-pashuarë, Ku „krimb'i atyre s' ka të-mba-
47 ruarë, edhe zjarri s'ka të-shuarë.“ Edhe ndë
të skandhalistë syri yt, nzir-e; është më mi-
rë për ty të hynjç me një sy ndë mbretërit
të Perëndisë, se dyke pasurë dy sy të hidhesh
48 ndë gjehenët të zjarit, Ku „krimb'i atyre s'ka
të-mbaruarë, edhe zjarri s'ka të-shuarë.“
49 Sepse çdo njeri me zjarr dotë kripetë, edhe
50 çdo kurban me kripë dotë kripetë. E-mirë
është kripa, po ndë ubëftë kripa ë-pashëllir-
shime, me se do t'a ndreqni? Kini kripë
ndë vetëhet t'uaj, edhe kini paqtim njeri
me tjatrinë.

Krye 10

1 Edhe si ungrit andej, vjen ndë sinorët
të Judhesë, më anë të-përtejme të Jordhanit,
edhe prapë gjindje mblidhenë përan'ati,
edhe sikundrë e kishte zakon, përsëri i
mësonte.
2 Edhe si i erdhë peranë Farisenjtë, e
pyetnë dyke ngar'atë, A ësht'e udhësë burri
3 t'a lëshonjë gruanë? Edhe ay upërgjeq e u
tha atyre, Ç'u ka porositurë juve Moisiu?
4 Edhe ata thanë, Moisiu dha lejë të shkruanjë
5 kartë ndarjeje edhe t'a lëshonjë. Edhe Jisuj
upërgjeq e u tha atyre, Për zëmërënë t' uaj

6 të-ashpërë u shkroj juve këtë porosi; Po që
ndë kryet të krijesësë mashkull edhe femërë
7 i bëri ata Perëndia. „Për këtë punë njeriu
8 dotë lërë t' an' e t' ëmënë, Edhe dotë ngjitetë
pas gruas' së tij, edhe dotë jenë të-dy ndë
një mish;" kaqë sa nukë janë më dy, po një
9 mish. Atë pra që Perëndia e bëri par, njeriu
letë mos e ndanjë.
10 Edhe ndë shtëpit përsëri e pyetnë nxë-
11 nësit' e ti për gjithatë *gjë*. Edhe *ay* u thot
atyre, Kush të lëshonjë gruan' e ti e të mar-
12 tonetë me tjatërë, kurvëron mb' atë. Edhe
gruaja ndë lëshoftë burrin' e saj, edhe të
martonetë me tjatërë, kurvëron.
13 Edhe i prunë ati çuna të-vegjëlë, që t' i
preknjë; edhe nxënësit' i qërtonin' ata që i
14 bininë. Po Jisuj kur pa, uzëmërua, edhe u
tha atyre, Lini çunat' e-vegjëlë të vijnë tek
unë, edhe mos i dalni; sepse e të-këtillëvet
15 është mbretëri' e Perëndisë. Me të-vërtetë po
u them juve, Kush të mos presë mbretërin' e
Perëndisë posi një çun i-vogëlë nukë dotë
16 hynjë nd' atë. Edhe si i mori ndë krah, vuri
duartë mbi ata, edhe i bekoj.
17 Edhe tek po dilte mb' udhë, një njeri u
lëshua me vrap, edhe ra mbë gjunj përpara
ati, edhe e pyeste, Mësonjës i-mirë, ç' të bënj
18 që të trashëgonj jetën' e-përjetëshme? Edhe
Jisuj i tha, Ç' më thua i-mirë? Asndonjë s'
ës 6lht' i-mirë, përveç një, Perẹndia. Porositë i

BKSH

di, „Mos kurvërojsh; Mos vraç; Mos vjethç;
Mos apç dëshmim të-rrëm; Mos bëjsh dëm;
20 Ndero t'ët atë e t'ët ëmë". Edhe ay i upër-
gjeq, e i tha, Mësonjës, këto i kam ruajturë
21 që mbë të-rit t'im. Edhe Jisuj shtyri sytë mb'
atë, edhe e deshi, edhe i tha, Një gjë të mun-
gon, shko e shit sa ke, edhe ep-u'a të-vo-
begjet, edhe dotë kesh thesar ndë qiell, edhe
22 eja, ngri kryqnë, e ecë pas meje. Po ati i
erdhi liksht për fjalënë, edhe iku i-hidhëru-
arë, se kishte gjë shumë.
23 Edhe Jisuj si hodhi sytë përqark, u tha
nxënëset të ti, Sa me të-vështirë dotë hynjë-
në ndë mbretërit të Perëndisë ata që kanë
24 pasje! Edhe nxënësitë tmeroneshinë për fja-
lët' e ati. Po Jisuj përsëri upërgjeq e u tha
atyre, Djem, sa e-vështirë gjë është të hy-
njënë ndë mbretërit të Perëndisë ata që be-
25 sonenë mbë pasjet! Më kollaj është të shko-
një kamilla ndëpër vërët të gjilpërësë, se i-
pasuri të hynjë ndë mbretërit të Perëndisë.
26 Edhe ata tepërë çuditeshinë, dyke thënë me
vetëhen' e tyre, Edhe cili munt të shpëtonjë?
27 Edhe Jisuj si shtyri sytë mb' ata, tha, Te nje-
rëzitë *është punë* e-pamundurë, po jo te Pe-
rëndia; sepse të-gjitha janë të-mundura te
Perëndia.
28 Edhe Pjetri zuri t'i thotë, Na neve tek
29 lamë të-gjitha, edhe erthmë pas teje. Edhe
Jisuj upërgjeq, e tha, Me të-vërtetë po u them

juve, se s' ësht' as ndonjë, që la shtëpi, a
vëllezër, a motra, a atë, a mëmë, a grua, a
30 djem, a ara, për punë t' ime edhe t' ungjillit, që
të mos marrë për një një qint tani ndë këtë
kohë, shtëpi, e vëllezër, e motra, e mëmë, e
bij, e ara, bashkë me të-ndjekura, edhe ndë
31 jetët që vjen jetë të-përjetëshme. Po shumë
të-parë dotë jenë të-prapësm, edhe të-pra-
pëshm të-parë.
32 Edhe ishinë mb' udhët dyke hipurë ndë
Jerusalim; edhe Jisuj ishte dyke shkuarë për-
para atyreve, edhe *ata* çuditeshinë, edhe vi-
ninë prapa dyke pasurë frikë. Edhe *ay* mori
përanë përsëri të dy-mbë-dhjetëtë, edhe zuri
33 t' u thotë ato *punë* që dot' i gjanin' ati, Se
na tek po hipëjmë ndë Jerusalim, edhe i Bir'i
njeriut dotë epetë ndër duart të kryeprif-
tërvet edhe të shkronjëset, edhe dota gjyko-
njënë për vdekje, edhe dot' a apënë ndër
34 duart të kombevet; Edhe dot' a përqeshnjë-
në, edhe dot' a rrahënë, edhe dot' a pshty-
njënë, edhe dot' a vrasënë, edhe të-tretënë
ditë dotë ngjalletë.
35 Edhe *atëhere* vijnë tek ay Jakovi edhe
Joani, të bijt' e Zevedheut, dyke thënë, Më-
sonjës, duamë të na bejsh atë që të lypëjmë.
36 Edhe ay u tha atyre, Ç' doni t' u bënj unë
37 juve? Edhe ata i thanë, Ep-na të rrimë, një-
ri prej së-djathtësë s' ate, edhe njëri prej së-
38 mëngjërësë s' ate, ndë lavdit t' ënde. Po Jisuj

BKSH

u tha atyre, S' dini se ç' lypni; a muntni të
pini potirrë që pi unë, edhe të pagëzoneni
39 me pagëzimnë që pagëzonem unë? Edhe
ata i thanë, Muntmë. Edhe Jisuj u tha aty-
re, Potirrë, që pi unë, dot' a pini, edhe me
pagëzimnë, që pagëzonem unë, dotë pagëzo-
40 neni; P otë rrini prej së-djathtësë s'ime e prej
së-mëngjërësë s'ime, nuk' është puna ime t'a
ap, po *dot' u epetë atyre*, për të-cilëtë është
bërë gati.
41 Edhe të dhjetëtë kur dëgjuanë, zunë të
zëmëronenë për Jakovin' edhe për Joaninë.
42 Po Jisuj si i thirri përanë, u thot' atyre, E
dini se ata që numëronenë *për* të-parë të
kombevet me shtrëngim zotërojnë mbi ata,
edhe të-mëdhenjt' e atyre me pushtet i urdhë-
43 rojn' ata. Po nukë dotë jetë kështu ndër ju,
po kush të dojë të bënetë i-math ndër ju,
44 dotë jetë shërbëtori juaj; Edhe kush të dojë
prej jush të bënet' i-parë, dotë jetë shërbë-
45 tuar i të-gjithëve; Sepse edhe i Bir' i njeriut
nuk' erdhi të shërbenetë, po të shërbenjë,
edhe të apë jetën' e ti çpërblim për shumë
veta.
46 Pastaj vijnë ndë Jeriho; edhe tek dilte
prej Jerihosë ay edhe nxënësit' e ti, edhe
mjaft gjindje, Vartimeu i-verbërë, i bir' i
Timeut, rrinte përan' udhësë dyke lypurë:
47 Edhe kur dëgjoj, se është Jisu Nazoreasi, zu
të bërtasë e të thotë, Jisu, i bir' i Davidhit,

BKSH

48 përdëlle-më. Edhe shumë veta e qërtoninë,
që të mos bënjë zë; po ay shumë më tepër
49 bërtiste, I bir' i Dhavidhit, përdëlle-më. Edhe
Jisuj qëndroj, e tha të thërritetë; edhe *ata*
e thërresënë të-verbërinë, e i thonë, Merr
50 zëmërë, ngreu; po të thërret. Edhe ay si ho-
51 dhi rrobën' e ti, ungrit, e erdhi te Jisuj. Edhe
Jisuj upërgjeq, e i thotë, Ç' do të të bënj?
Edhe i-verbëri i tha, Ravvuni, të hap sytë.
52 Edhe Jisuj i tha, Shko; besa jote të shpëtoj.
Edhe për-një-here hapi sytë, edhe vinte pas
Jisujt mb' udhët.

Krye 11.

1 Edhe kur afëronenë ndë Jerusalim, ndë
Vithfagji edhe ndë Vithani, ndaj malit të
2 Ullinjet, dërgoj dy nga nxënësit' e ti, edhe
u thot' atyre, Shkoni ndë fshatt *që është* kun-
druell jush, edhe për-një-here posa të hyni
mb' atë, dotë gjeni një pulisht lidhurë, të-
cilit s' i ka hipurë asndonjë prej njerëzet;
3 sgjidh-e-ni edhe sill-e-ni; Edhe ndë u thëntë
ndonjë juve, Ç' bëni kështu? thoni, se Zoti
ka nevojë për atë; edhe për-një-here dot'a
dërgonjë këtu.

4 Edhe *ata* vanë, edhe gjetnë pulishtinë li-
dhurë ndaj derësë jashtë ndë udhët; edhe e
5 sgidhnjënë. Edhe disa nga ata që rrininë atje
u thoshinë atyre, Ç' bëni kështu që sgithni
6 pulishtinë? Edhe u thon' atyre sikundrë i pat

7 porositurë Jisuj; edhe *ata* e lanë. Edhe prunë
pulishtinë te Jisuj, edhe vunë rrobat' e tyre
mbi atë; edhe *ay* i hipi.
8 Edhe shumë *veta* shtruanë rrobat' e tyre
mb' udhët; edhe të-tjerë këputninë dega prej
9 drurëvet, e i shtroninë mb' udhët. Edhe ata
që shkoninë përpara, *si* edhe ata që vininë
prapa, bërtisninë, dyke thënë, Hosanna, i-
bekuar' *ësht'* ay që vjen mb' emërit të Zotit.
10 E-bekuarë *është* mbretëria (që vjen mb' emë-
rit të Zotit,) e atit t' ënë Dhavidh; Hosanna
11 mbë të lartat. Edhe Jisuj hyri ndë Jerusalim,
edhe ndë hieroret; edhe si vuri re përqark
të-gjitha, me-qënë-që ishte tani vonë, dolli
ndë Vithani bashkë me të dy-mbë-dhjetëtë.
12 Edhe mbë të-nesërmet, si duallnë nga
13 Vithania, i erdhi uri. Edhe kur pa një dru
fiku për-së-largu që kish fletë, erdhi, semos
gjente gjë mb' atë; edhe si erdhi mb' atë, s'
gjeti gjë, veç fletë; sepse s'ish kohë fiqsh.
14 Edhe (Jisuj) u-përgjeq e i tha *drurit të fikut*,
Asndonjë mos hëngërtë më pemë prej teje
për jetë. Edhe nxënësit' e ati e dëgjoninë.
15 Edhe vijnë ndë Jerusalim; edhe Jisuj, si
hyri ndë hieroret, zuri të kërrenjë jashtë ata
që shisninë e blininë ndë hieroret; edhe tru-
vezat' e truvezarëvet, edhe fronet' e atyreve
16 që shisninë pëllumbatë i përmbysi; Edhe
nukë linte asndonjë të shkonjë enë ndëpër
17 hieroret. Edhe mësonte, dyke u then' atyre,

Nuk' është shkruarë, „Se shtëpia ime dotë
quhetë shtëpi lutjeje për gjithë kombetë?" po
18 ju e bëtë „shpellë kursarësh."—Edhe dëgju-
anë shkronjësit' e kryepriftëritë, edhe kërko-
ninë qysh t'a prishnjënë; sëpsë kishinë frikë
prej ati, se gjithë gjindja çuditej për më-
simn' e ati.
19 Edhe kur ungrys, dilte jashtë qytetit.
20 Edhe ndë mëngjest dyke shkuarë, panë
21 dryrin' e fikut të-tharë që nga rrënja. Edhe
Pjetri si ukujtua i tha ati, Ravvi, shih, drur'
22 i fikut, që mallëkove, utha. Edhe Jisuj upër-
gjeq, e u tha atyre, Kini besë mbë Perëndinë.
23 Sepse me të-vërtetë po u them juve, se kush
t' i thotë këti mali, Ngreu, edhe hidhu ndë
dett'; edhe të mos jetë me dy mëndje ndë
zëmërët të ti, po të besonjë, se sa thotë bë-
24 nenë, dot' i bënet' ati çdo që të thotë. Përan-
daj po u them juve, gjithë sa të lypni dyke
falurë, besoni, se *dot'* i merrni, edhe dot' u
25 bënenë juve. Edhe kur të rrini të faleni, ndje-
ni, ndë paçi gjë kundrë ndonjëj, që edhe Ati
juaj që është ndë qiejt t' u ndjenjë juve fa-
26 jetë t' uaj. Po ndë mos *u'a* djefshi ju, as Ati
juaj që është ndë qiejt nukë dotë ndjenjë
fajetë t' uaj.
27 Edhe vijnë përsëri ndë Jerusalim; edhe
ay tek ishte dyke ecurë ndë hieroret, vijnë
tek ay kryepriftërit' edhe shkronjësit' edhe
28 pleqtë, E i thonë, Me ç' farë pushteti bën

BKSH

këto? edhe cili të ka dhënë këtë pushtet që
29 të bëjsh këto? Edhe Jisuj upërgjeq, e u tha
atyre, Edhe unë dot' u pyes juve një fjalë;
edhe përgjiq-m'-uni, edhe *atëhere* dot' u them
30 juve, me ç' farë pushteti bënj këto; Pagëzimi
i Joanit prej qielli ishte, a po prej njerësve?
31 përgjiq-m'-uni. Edhe *ata* mendoneshinë me
vetëhen' e tyre, dyke thënë, Ndë thënçimë
Prej qielli, dotë thotë, Përse pra s' i besuatë
32 ati? Po ndë thënçimë, Prej njerësve, kishinë
frikë nga llauzi; sepse të-gjith' e kishninë
33 Joaninë, se ishte me të-vërtetë profit. Edhe
ata upërgjeqnë e i thanë Jisujt, Nukë dimë.
Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, As unë
s' u them juve me ç' farë pushteti bënj këto.

Krye 12.

1 Pasandaj zuri t' u flasë atyre me paravo-
lira. Një njeri beltoj një veshtë, edhe e thuri
me garth, edhe rëmoj një tirë, edhe ndërtoj
një pirk, edhe e pajtoj ndër bujqër, edhe iku
2 ndë dhe të-huaj. Edhe ndë kohët *të pemëvet*
dërgoj një shërbëtuar te bujqëritë, që të ma-
3 rrë prej bujqërvet nga pem'e veshtit; Po ata
e zun' edhe e rrahnë, edhe e dërguanë pra-
4 pë sbrazëtë. Edhe përsëri dërgoj një tjatërë
shërbëtuar tek ata; po edhe atë e rahnë me
gurë, edhe i çanë kryetë, edhe e dërguanë
5 prapë të-turpëruarë. Edhe përsëri dërgoj një
tjatërë; po edhe atë e vranë; edhe shumë të-

BKSh

tjerë dërgoj, po disa i rrahnë, edhe disa i
6 vranë. Dyke pasurë pra edhe një bir, të-da-
shurin' e ti, e dërgoj edhe atë tek ata mbë
ndë funt, dyke thënë, Se dotë kenë turp prej
7 t' im biri. Po ata bujqëritë thanë njëri me
tjatrinë, Se ky është trashëgimtati; ejani, let'a
8 vrasimë, edhe trashëgimi dotë jetë yni. Edhe
e muarnë, edhe e vranë, edhe e hothnë jashtë
9 veshtit. Ç' dotë bënjë pra i zot' i veshtit?
Dotë vinjë, e dotë prishnjë bujqëritë, edhe
10 veshtinë dot' u'a apë të-tjerëve.—As këtë shkro-
një s' e keni kënduarë, „gurinë që s'e pël-
qyen' ata që ndërtonjënë, ky ubë krye çipi;
11 prej Zotit ubë këjo, edhe ësht' e-çud*i*çime ndë
syt t' anë.“
12 Edhe *ata* kërkoninë t'a zënë; po patnë
frikë nga gjindja; sepse e kupëtuanë, se për
ata e tha paravolinë; edhe e lan' e iknë.
13 Edhe dërgonjënë tek ay ca nga Farisenj-
të edhe nga Irodhianëtë, që t'a zënë me fialë;
14 Edhe ata erthnë, e i thonë, E dimë se je i-
vërtetë edhe se s' do të dish as prej njeriu;
sepse nukë shikon mbë faqe njerësve, po
mëson udhën' e Perëndisë me të-vërtetë; Esht'
e udhësë t' i apëmë Qesarit pagesë, apo jo?
15 të apëmë, a të mos apëmë? Edhe ay dyke
njohurë ipokrisin' e atyre, u tha, Ç' më ngisni?
16 bi-më-ni një dinar që t'a shoh. Edhe ata i
prunë.Edhe *ay* u thot' atyre, E kujt *është* këjo
fytyrë, edhe këjo përmbishkronjë? Edhe ata i

BKSH

17 thanë, E Qesarit. Edhe Jisuj upërgjeq e u
tha atyre, Epni Qesarit ato që janë të Qe-
sarit, edhe Perëndisë ato që janë të Perën-
disë. Edhe *ata* uçuditnë për atë.
18 Pastaj vijnë tek ay Sadduqenj, të-cilëtë
thonë, se s'ka të-ngjallurë; edhe e pyetnë,
19 dyke thënë, Mësonjës, Moisiu na ka shkru-
arë, se ndë i vdektë ndonjëj i vëllaj, edhe të
lërë grua, edhe të mos lërë bij, i vëllaj të
marrë gruan' e ati, edhe të ngjallnjë farë për
20 të vëllan' e ti. Ishinë pra shatë vëllezër; edhe
i-pari mori një grua, edhe kur vdiq nukë la
21 farë; Edhe i-dyti e mori atë, edhe vdiq, po
22 as ky s'la farë; edhe i-treti gjithashtu. Edhe
të shatë e muarnë atë, edhe nukë lanë farë;
23 më prapa nga gjithë vdiq edhe gruaja. Mbë
të-ngjallurit pra, kur të ngjallenë, e cilit nga
ata dotë jetë gruaja? sepse *që* të shtatë e
patnë atë grua.
24 Po Jisuj upërgjeq, e u tha atyre, A nukë
gënjeneni për këtë, sepse nukë dini shkro-
25 njatë, as fuqin' e Perëndisë? Sepse kur të
ngjallenë prej së vdekurish, as martojnë, as
martonjenë, po janë posi ëngjëjtë që janë
26 ndë qiejt. Edhe për të-vdekuritë se ngjallenë,
nukë kini kënduarë ndë vivllët të Moisiut,
si i tha ati Perëndia ndë ferrët, dyke thënë,
„Unë jam Perëndia i Avraamit, edhe Perëndia
27 i Isaakut, edhe Perëndia i Jakovit?" Perëndia
nuk është *Perëndi* i të-vdekurve, po i të-
gjallëve; ju pra gënjeneni shumë.

28 Atëhere një nga shkronjësitë, që dëgjoj
ata se po haheshinë me fjalë, dyke diturë,
se mirë upërgjeq atyre, u afërua, edhe e pyeti,
29 Cila porosi ësht' e-para e të-gjithave? Edhe
Jisuj i upërgjeq, Se e-para e gjithë porosivet
është, „Dëgjo, Israil, Zoti Perëndia ynë është
30 një Zot; Edhe të duash Zotinë Perëndinë
t' ënt me gjithë zëmërënë t' ënde, edhe me
gjithë shpirtinë t' ënt, edhe me gjithë mën-
djenë t' ënde, edhe me gjithë fuqinë t'ënde."
31 Këjo është e-para porosi. Edhe e-dyta që gjan
me këtë *është* këjo, „Të duash të-afërminë
t' ënt posi vetëhenë t' ënde." Tjatërë porosi
32 më të-madhe nga këto nukë ka. Edhe shkro-
njësi i tha, Mirë, Mësonjës, me të-vërtetë the,
se një Perëndi ka, edhe s' ka tjetërë veç ati;
33 Edhe se t'a dojë njeriu atë me gjithë zëmë-
rënë, edhe me gjithë mëndjenë, edhe me gji-
thë shpirtinë, edhe me gjithë fuqinë, edhe të
dojë të-afërminë posi vetëhen'e ti, është më
tepërë se gjithë të-gjithëdjeguratë edhe se
34 kurbanëtë. Edhe Jisuj kur pa atë, se upër-
gjeq me mënt, i tha, Nukë je lark nga mbre-
tëria e Perëndisë. Edhe asndonjë më s' ku-
xonte t'a pyesë.

35 Edhe Jisuj upërgjeq e tha, dyke mësuarë
ndë hieroret, Qysh thonë shkronjësitë, se
36 Krishti është bir' i Dhavidhit? Sepse vetë
Dhavidhi ka thënë me anë të Frymës' së-
Shenjteruarë, „I tha Zoti Zotit t' im, Rri prej

se-djathtësë s' ime, gjersa të vë armiqt' e tu
37 ndënëkëmbje të këmbëvet të tua." Vetë Dha-
vithi pra i thotë Zot; edhe nga është bir i
ati? Edhe gjithë gjindjesë i kishte ënda t' a
38 dëgjonjë atë. Edhe u thoshte atyre ndë më-
simt të ti, Ruhi nga shkronjësitë, të-cilëtë
duanë të ecëjnë me stolira, edhe të-përshën-
39 doshura ndëpër tregjet, Edhe frone' të-parë
ndëpër sinagogjit, edhe vënde të-parë ndëpër
40 darkat; Të-cilëtë hanë shtëpit' e *gravet* të-va,
edhe *këtë e bëjnë* dyke shtyrë shkak, se falenë
shumë; këta dotë marrënë më tepërë mundim.
41 Edhe Jisuj ndënji kundruell arkës' s' as-
pravet, edhe vinte re qysh gjindja hithte të-
holla ndë arkët të aspravet; edhe shumë të-
42 pasurë hithninë shumë. Edhe erdhi një e-ve
e-varfërë, edhe hodhi dy të-imëta, do-me-
43 thënë një kodhrant. Edhe Jisuj thirri përanë
nxënësit' e ti, e u tha atyre, Me të-vërtetë po
u them juve, se kjo e-ve e-varfërë hodhi më
tepërë se të-gjith' ata që hothnë ndë arkët t'
44 aspravet. Sepse të-gjithë prej tepëricës' së
tyre hothnë; po kjo prej skamjes, së saj hodhi
gjithë sa kishte, gjithë gjën' e saj.

Krye 13.

1 Edhe tek po dilte nga hieroreja, i thotë
një nga nxënësit' e ti, Mësonjës, shih ç' farë
2 gurë e ç' farë ndërtesa! Edhe Jisuj upërgjeq,
e i tha, Sheh këto ndërtesa të-mëdha? nukë

BKSH

dotë mbesë gur mbi gur që të mos rrëzonetë.
3 Edhe tek po rrinte ndë malt t'Ullinjët,
kundruell hieroresë, e pyetninë atë veçanë
Pjetri edhe Jakovi edhe Joani edhe Andreu,
4 Thuaj-na, kur dotë bënenë këto, edhe ç'shë-
një *dotë jetë,* kur dotë mbaronenë këto të-
5 gjitha? Edhe Jisuj, dyke përgjegjurë, zuri t'u
thot' atyre, Vini re, se mos u gënjenjë ndonjë
6 juve. Sepse shumë veta dotë vijnë mb'emë-
rit t' im, dyke thënë, Se unë jam; edhe dotë
7 gënjenjënë shumë *veta.* Edhe kur të dëgjoni
luftëra, edhe zëra luftërash, mos ufrikësoni;
sepse duhetë të bënenë *këto,* po edhe nuk'
8 *është* fundi. Sepse dotë ngrihetë komp kundrë
kombi, edhe mbretëri kundrë mbretërie;
edhe dotë bënenë tërmete vënde mbë vën-
de, edhe dotë bënenë zira e trazyra. Këto
9 janë të-nisurat' e të-dhëmburavet. Po juve
vështroni vetëhenë t' uaj, sepse dot' u apënë
juve ndër duar ndëpër bashkëndënje, e ndë-
për sinagogjira dotë rriheni, edhe përpara qi-
vernitarëve e mbretërve dotë rrini për punë
10 t' ime, për dëshmim mb' ata. Edhe duhetë të
lëçitetë Ungjilli më përpara ndëpër gjithë
11 kombet. Edhe kur t'u shpienë që t' u apënë
juve ndër duar, mos ukujdesni që më parë,
se ç' dotë flisni, as mos umendoni; po ç' t'u
epetë juve nd' atë orë, këtë flisni; sepse s'
jini ju ata që flisni, po Frym' e-Shënjtëruarë.
12 Edhe i vëllaj dotë apë ndër duar të vë-

llanë për vdekje, edhe i ati të birrë; edhe
djemtë dotë ngrenë krye kundrë përintvet,
13 edhe dot' i vrasënë. Edhe të-gjithë dot' u kenë
mëri për emërinë t'im; po kush të duronjë
gjer ndë funt, ky dotë shpëtonjë.
14 Edhe kur të shihni ndyrësin' e të shkre-
tuarit, që është thënë nga profiti Dhaniil, ndë-
njurë tek nukë duhetë, (ay që këndon letë
kupëtonjë), atëhere ata *që të jenë* ndë Judhet,
15 letë ikëjnë ndëpër malet; Edhe ay *që të jetë*
mbi kulmt të shtëpisë, letë mos sbresë ndë
shtëpit, as letë mos hynjë të marrë gjë nga
16 shtëpi' e ti; Edhe ay që të jetë nd'arët, letë
mos kthenetë prapa që të marrë rrobën' e ti.
17 Po mjer' ato që janë me barrë, edhe ato që
18 kanë foshnjë ndë gji nd'ato dit. Edhe faluni
që të mos bënetë të-ikuritë t'uaj ndë dimërë.
19 Sepse *nd'* ato dit dotë jetë i-këtillë shtrëngim,
që i-atillë nuk' është bërë që ndë kryet të
kriesësë, që krioj Perëndia, *e* gjer tani, edhe
20 as është për të bërë. Edhe Zoti të mos i
kishte shkurtuar' *ato* dit, s' kishte për të
shpëtuarë asndonjë mish; po për të-sgjedhu-
ritë që i ka sgjedhurë shkurtoj dittë.
21 Edhe atëhere ndë u thëntë juve ndonjë,
Na këtu është Krishti, a, Na, atje mos besoni.
22 Sepse dotë ngrihenë krishtër të-rrem e pro-
fitër të-rrem, edhe dotë bëjnë shënja e çudira,
që të gënjenjërë, ndë mundetë, edhe të-sgje-
23 dhuritë. Po ju vini re; na tek u'a thashë juve
të-gjitha që përpara.

24 Po nd' ato dit, pas ati shtrëngimi, djelli
25 dot' erretë, edhe hëna nukë dotë apë dritën'e
saj, E yjt' e qiellit dotë bjenë, edhe fuqitë që
26 janë ndë qjejt dotë tundenë. Edhe atëhere
dotë shohënë te Birin' e njeriut dyke ardhu-
27 rë ndër re me fuqi shumë e me lavdi. Edhe
atëhere dotë dërgonjë ëngjëjt' e ti, edhe dotë
mbledhë të-sgjedhurit' e ti nga të katrë erë-
ratë, prej këndit të dheut e gjer mbë këntt
të qiellit.

28 Edhe prej drurit të fikut mirrni vesh pa-
ravolinë; kur deg' e atij bënetë e butë, edhe
29 nxjer fletëtë, dini, se vera ësht' afërë; Kë-
shtu edhe ju, kur të shihni këto se bënenë,
30 di-e-ni se ësht' afërë, ndë dyert. Me të-vër-
tetë po u them juve, se ky bres nukë dotë
31 shkonjë, gjersa të bënenë këta të-gjita. Qielli
edhe dheu dotë shkonjënë; po fjalët e mija
nukë dotë shkonjënë.

32 Edhe për atë ditë a orë as ndonjë nukë
di, as ëngjëjtë që janë ndë qiellt, as Biri,
veç Ati.

33 Vini re, rrini sgjuarë edhe faluni, sepse
34 nuk' e dini kur është koha. *Sepse këjo dotë
jetë* posi një njeri i ikurë, i-cili la shtëpin' e
ti, edhe u' a dha pushtetnë shërbëtorëvet të
ti, edhe si cilit punën' e ti, edhe portarin' e
35 porositi të rrijë sgjuarë. Rrini sgjuarë pra;
(sepse s' dini kur vjen i zot' i shtëpisë, mbë
të-ngrysurë, a ndë mest të natësë, a ndë

36 këndimt të kokoshit, a ndë mëngjest;) Se mos
vinjë papandehuraj e u gjenjë juve dyke
37 flejturë. Edhe ato që po u them juve, u' a
them të-gjithëve, Rrini sgjuarë.

Krye 14

1 Edhe pas dy ditsh ishte pashka edhe pa
brumjetë; edhe kryepriftërit' edhe shkronjë-
sitë kërkoninë, si t' a zënë me kobim, edhe
2 t'a vrasënë. Edhe thoshinë, Mos ndë të krem-
tet, se mos bënetë trazyrë nga llauzi.

3 Edhe tek ishte ay ndë Vithani, ndë shtë-
pit të Simonit të-krromosurë, dyke ndënjurë
ndë mësallët, erdhi një grua që kish një
allavastrë me vaj ere prej nardhe së-thjeshtë
e shumë së-shtrënjtë; edhe si e theu alla-
vastrënë, e derdhi vajnë përmbi kryet t' ati.
4 Edhe ishinë ca *veta* që zëmëroneshinë ndër
vetëhet të tyre, e thoshinë, Përse të humba-
5 së ky vaj ere? Sepse ky munt të shitej për-
mbi tre qint dinarë, edhe të epeshinë ndë-
për të-vobeqt; edhe zëmëroneshinë kundrë
asaj.

6 Po Jisuj tha, lër-e-ni; përse i epni mun-
7 dime? punë të-mirë bën mbë mua. Sepse të-
vobeqtë i kini gjithënjë me vetëhenë t' uaj,
edhe kur të doni, muntni t' u bëni mirë aty-
8 re; po mua nukë më kini gjithënjë. Atë që
mundi ajo, e bëri; i arriu që përpara të ly-

BKSH

enjë me vaj ere trupnë t' im për të-varrosu-
9 ritë *t' im.* Me të-vërtetë po u them juve, Kudo
të lëçitetë ky ungjill ndë gjithë botënë, edhe
puna që bëri kjo dotë flitetë për kujtim t'asaj.
10 Edhe *atëhere* Judhë Iskarioti, një nga të
dy-mbë-dhjetëtë, vate te kryepriftëritë që t'u'a
11 apë atë atyreve ndër duart. Edhe ata kur
dëgjuanë, ugëzuanë; edhe i u zotuanë t' i a-
pënë ergjënde. Edhe ay kërkonte, si mbë kohë
të-pëlqyerë t' a trathëtonjë atë.
12 Edhe të-parënë ditë *të së-kremtes'* së pa
brumjevet, kur bëninë kurban pashkënë, nxë-
nësit' e ati i thonë, Ku do të vemi e të bëj-
13 më gati që të hash pashkënë? Edhe ay dër-
gon dy nga nxënësit' e ti, edhe u thot' atyre,
Ecëni ndë qytett, edhe dot' u pjekë juve një
njeri dyke mbarturë një shtëmbë uje; ecëni
14 pas ati, Edhe ku të hynjë ay, tho-i-ni të zott
të shtëpisë, Se Mësonjësi thotë, Ku është
të-dënjuritë ku dotë ha pashkënë bashkë
15 me nxënësit' e mi? Edhe ay dot' u dëftenjë
juve mbë të-lartë një dhomë të-mathe të-
16 shtruarë gati; atje bëni gati për mua. Edhe
nxënësit' e ati duallnë edhe erdhnë ndë qy-
tett, edhe gjetnë sikundrë u kishte thënë,
edhe bënë gati pashkënë.
17 Edhe kur ungrys, vjen me të-dymbë-dhje-
18 tëtë; edhe tek po rrininë ndë mësallet e po
haninë, Jisuj tha, Me të-vërtetë po u them
juve, Se një prej jush dotë më trathëtonjë,

BKSH

19 ay që ha bashkë me mua. Edhe atyre zuri
t' u vinjë keq, edhe t'i thonjë një nga një,
Mos *jam* une? edhe tjateri, Mos *jam* unë?
20 Edhe ay upërgjeq e u tha atyre, Një nga të
dy-mbë-djetëtë, ay që ngjyen bashkë me
21 mua ndë kupët. I Bir' i njeriut vete, si kun-
drë është shkruarë për atë, po mjerë mb' a-
të njeri, me anë të të-çilit trathëtonetë; mirë
ishte për atë njeri të mos kishte lindurë.
22 Edhe tek po haninë, Jisuj mori bukë,
edhe si bekoj, e theu, edhe u' a dha atyre-
ve, edhe tha, Merrni, (hani); Ky është trupi
23 im. Edhe mori potirrë, edhe si ufal ndersë,
u' a dha atyre, edhe pinë prej ati të-gjithë.
24 Edhe u tha atyre, Ky është gjaku im, ay i
dhjatës' së-re, që derdhetë për shumë *veta*.
25 Me të-vërtetë po u them juve, Se nukë
dotë pi më nga pem' e hardhisë gjer mb' atë
ditë kur dot' a pi të-re ndë mbretërit të Pe-
rëndisë.
26 Edhe si psallnë, duallnë ndë malt t'Ulinjet.
27 Edhe Jisuj u thot' atyre, Se të-gjithë dotë
skandhaliseni mbë mua këtë natë; sepse ësh-
të shkruarë, „Dot' i bje bariut, edhe dhënj-
28 të dotë përndahenë." Po passi të ngjallem,
29 dotë vete më përpara se ju ndë Galilet. Po
Pjetri i tha, Edhe të-gjithë ndë uskandhali-
30 çinë, po unë jo. Edhe Jisuj u thot' atyre, Me
të-vërtetë po të them, se sot këtë natë, para
se të këndonjë këndesi dy herë, tri herë do-

31 të më mohojsh. Po ay edhe më tepërë tho-
shte, Se ndë udashtë të vdes unë bashkë
me ty, nukë dotë të mohonj. Gjithashtu edhe
të-gjithë *të-tjerëtë* thoshinë.
32 Pastaj vijnë ndë një vënt që thuhetë
Gjethsimani; edhe u thotë nxënësvet të ti,
Rrini këtu gjërsa të falem.
33 Edhe merr me vetëhe Pjetrin' edhe Jako-
vin' edhe Joaninë, edhe zuri të frikësonet' e
34 t' i vinjë rëndë. Edhe u thot' atyre, Shpirti
im ësht i-hidhëruarë gjer mbë vdekje; mbe-
35 tuni këtu, edhe rrini sgjuarë. Edhe ay si
shkoj pak përpara, ra përdhe, edhe falej që,
ndë qoftë se ësht' e-mundurë, të shkonjë prej
36 atij *kjo* orë. Edhe thoshte, Avva, o Atë, të-
gjitha janë të mundura tek ti; mërgo-e prej
meje këtë potir; po letë bënetë jo ç' dua
unë, po ç' *do* ti.
37 Edhe vjen, edhe gjen ata dyke flejturë;
edhe i thotë Pjetrit, Simon, po fle? s' mun-
38 de një orë të rrish sgjuarë? Rrini sgjuarë,
edhe faluni, që të mos hyni ndë ngasje; se-
pse shpirti është gati, po mishi është i-do-
39 bëtë. Edhe përsëri vate, e ufal dyke thënë
po atë fjalë.
40 Edhe kur ukthye i gjet' ata përsëri dyke
flejturë; sepse syt' e atyreve ishinë rënduarë,
edhe nukë dininë ç' t' i përgjigjen' ati.
41 Pastaj vjen të-tretënë herë, e u thot' aty-
re, Flini pra, edhe prëhi; mjaft; erdhi ora;

BKSH

na i Bir' i njeriut tek epetë ndër duart të
42 fajtorëvet; sgjohi, letë vemi; na ay që më
trathëton tek uaferua.
43 Edhe për-një-here, tek ishte ay edhe dy-
ke folurë, vjen Judha, që ishte një nga të
dy-mbë-dhjetëtë, edhe bashkë me atë shumë
gjindje me thika e me dru, prej anës' së
kryepriftëret e të shkronjësvet e të pleqet.
44 Edhe ay që e trathëton u kishte dhënë aty-
re shënjë, dyke thënë, *se* Atë që të puth,
ay është; zir-e-ni, edhe shpi-e-ni siguruar-
45 shim. Edhe kur erdhi, për-një-here uaferua
tek ay, e i thotë, Ravvi, Ravvi; edhe e pu-
46 thi. Edhe ata vunë duart' e tyre mbi atë,
edhe e zunë.
47 Edhe një nga ata që rrinin' atje hoqi thi-
kënë, e i ra shërbëtorit të kryepriftit, edhe i
preu veshnë.
48 Edhe Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Posi
mbë kursar kini dalë me thika e me dru të
49 më zini? Përdita kam qënë ndër ju ndë hie-
roret dyke mësuarë, edhe nukë më zutë; po
këjo ubë që të mbushenë shkronjatë.
50 Edhe të-gjith' e lan' e iknë.
51 Edhe një farë djaloshi i vinte prapa dyke
qënë i-pshtjellë mbë lakuriq me një pelhu-
52 rë; edhe djaloshët' e zënë. Po ay e la pelhu-
rënë; edhe iku nga ata lakuriq.
53 Edhe prunë Jisunë te kryeprifti; edhe mbli-
dhenë tek ay gjithë kryepriftërit' e shkronjësitë.

BKSH

54 Edhe Pjetri i vate pas prej se-largu gjer
brënda ndë hoborrt të kryepriftit; edhe ishte
dyke ndënjurë bashkë me shërbëtorëtë, edhe
po ngrohej ndë zjarrt.
55 Edhe kryepriftërit'edhe gjithë bashkë-ndë-
nja kërkoninë dëshmim kundrë Jisujt që t' a
56 vrasënë, po nukë gjeninë. Sepse shumë *veta*
dhanë dëshmim të-rrem kundrë ati; po dë-
57 shmimetë nuk' ishinë si-një-një. Edhe ca un-
gritnë e epninë dëshmim të-rrem kundrë ati,
58 dyke thënë, Se neve e degjuam' atë të thotë,
Se unë dot' a prish këtë tempullë të-bërë
me dorë, edhe për tri dit dotë ndërtonj një
59 tjetërë të-pabërë me dorë. Po as kështu dë-
60 shmim' i atyre s' ishte si-një-një. Atëhere
kryeprifti ungrit ndë mest, e pyeti Jisunë,
dyke thënë, Nukë përgjigjesh asgjë? ç' dë-
61 shmim apënë këta kundrë teje? Po ay s' bën-
te zë, edhe nukë përgjigjej asgje.
Përsëri kryeprifti e pyeti atë dyke thënë
62 ati, Ti je Krishti, i Bir' i të-Bekuarit? Edhe
Jisuj tha, Unë jam; edhe dotë shihni të Birr'e
njeriut dyke ndënjurë prej së-djathtës' së fu-
qisë, edhe dyke ardhurë bashkë me ret' e
63 qiellit. Atëhere kryeprifti çori rrobat' e tia,
e thotë, Ç' nevojë kemi më për dëshmimta-
64 rë? E degjuatë vllasfiminë; ç' u duketë juve?
Edhe ata të-gjithë e gjykuanë, se është faj-
65 tuar për vdekje. Edhe ca zunë t' a pshtynjë-
në, edhe t' i mbulonjënë fytyrënë, edhe t' i

bjenë shuplaka, edhe t' i thonë, Profiteps.
Edhe shërbëtorëtë i bininë me purteka.
66 Edhe Pjetri tek po ishte poshtë ndë ho-
borrt, vjen një nga shërbëtoret' e kryepriftit;
67 Edhe kur e pa Pjetrinë dyke ngrohurë, shty-
ri sytë mb' atë, e tha, Edhe ti jeshe bash-
68 kë me Jisu Nazarinasinë. Po ay e mohoj,
dyke thënë, Nukë di, as nukë marr vesh,
Ç' thua ti. Edhe dolli jashtë ndë vëntt për-
69 para hoborrit; edhe këndesi këndoj. Edhe
shërbëtoreja kur e pa atë përsëri, zuri t' u
thot' atyre që ishinë dyke ndënjur' atje, Se
70 ky është nga ata. Po ay përsëri e mohonte.
Edhe pas pak herë ata që ishinë dyke ndë-
njur' atje përsëri i thanë Pjetrit, Me të-vër-
tetë je nga ata; sepse je Galileas, edhe të-
71 foluritë t' ënt gjan. Po ay zuri të nemnjë
edhe të bënjë be, Se nuk' e di këtë njeri që
72 thoni. Edhe këndesi këndoj për-së-dyti. Edhe
Pjetrit i ra ndër mëntt fjala që i pat thënë
Jisuj, Se para se të këndonjë këndesi dy he-
rë, dotë më mohojsh tri herë. Edhe zuri të
qanjë.

Krye 15

1 Edhe për-një-here ndë mëngjest kryepri-
ftëritë bashkë me pleq' e me shkronjësitë,
edhe gjithë bashkë-ndënja mbajtnë këshillë,
edhe si e lithnë Jisunë, e prunë, edhe e dha-
në ndër duart të Pillatit.

2 Edhe Pillati e pyeti, Ti je mbreti i Judhe-
njvet? Edhe ay upërgjeq e i tha, Ti po thua.
3 Edhe kryepriftëritë e përflisninë shumë.
4 Edhe Pillati përsëri e pyeti, dyke thënë, Nukë
përgjigjesh asgjë? shiko sa dëshmonjënë kun-
5 drë teje. Po Jisuj më nuk' upergjeq asgjë,
kaqë sa Pillati çuditej.
6 Edhe për të-kremte u lëshonte atyre një
7 të-lidhurë, cilinë të lypnin' *ata*. Edhe *një*,
që thuhej Varavva, ish lidhurë bashkë me
shokët' e ti trazim-nxjerës të-cilëtë ndë tra-
8 zimt kishinë bërë vrasje. Edhe gindja bërtiti,
e zuri të lypënjë *të bënjë* sikundrë përherë
9 bënte mb' ata. Edhe Pillati upërgjeq atyre,
dyke thënë, Doni t'u lëshonj juve mbretin' e
10 Judhenjvet? Sepse dinte se për cmir e kishinë
dhënë ndër duar kryepriftëritë.
11 Po kryepriftëritë shtynë gjindjenë të *ly-
pëjnë* më tepërë t' u lëshonjë atyre Varavvanë.
12 Edhe Pillati upërgjeq përsëri, e u tha atyre,
Ç'doni pra t' i bënj *këti* që i thoni mbret' i
13 Judhenjvet? Edhe ata përsëri bërtitnë, Kryqë-
14 zo-e. Edhe Pillati u thosh atyre, Përse, ç' të-
keqe ka bërë? Po ata më tepërë bërtitnë,
Kryqëzo-e.
15 Edhe Pillati, passi donte t'i bënte zëmë-
rënë gjindjesë, u lëshoj Varavvanë, edhe Ji-
sun' e dha ndër duar, passi e rahu me frush-
kullë, që të kryqëzonetë.
16 Atëhere ushtëtarëtë e prunë përbrënda ho-

borrit, që është pretoreja(*), edhe mbledhënë
17 gjithë tufën' e ushtëtarëvet. Edhe i veshnjënë
një rrobë të-kuqe, edhe gërshetuanë një ku-
18 rorë ferrash, e j'a vënë rreth kresë. Edhe zu-
në t'a përshëndoshnjënë, *dyke thënë*, Gëzohu,
19 o mbret' i Judhenjvet. Edhe i bininë kresë me
kallam, edhe e pshyninë, edhe bininë mbë
20 gjunj, e i faleshinë. Edhe si e përqeshnë, i
sveshnë rrobën' e-kuqe, edhe i veshnë rrobat'
e tia, edhe e shpunë jashtë, që t'a kryqë-
zonjënë.
21 Edhe zënë angari, për të ngriturë kryqin
e ati, një farë Simon Qyrineas, t' an' e Alek-
sandrit edhe të Rufit, i-cili shkonte *andej*,
22 dyke ardhurë nga ara. Edhe e bjenë ndë vëntt
Gollgotha, qe e-kthyerë do me thënë, Vend'
23 i kresë. Edhe i epninë të pijë verë të-përzjerë
me smirnë; po ay nuk' e mori.
24 Edhe si e kryqëzuanë, ndanë rrobat' e ati
dyke shtyrë shortë mbi ato, ç' të marrë sicili.
25 Edhe ish ora tri, edhe e kryqëzuanë.
26 Edhe përmbishkronja e fajit t' ati ish shkru-
arë përsipër, **Mbreti i Judhenjvet.**
27 Edhe bashkë me atë kryqëzonjënë dy
kursarë, një prej së-djathtësë, e një prej së-
28 mëngjërës' s' ati. Edhe umbush shkronja që
thotë, „Edhe me të-paudhëtë unumërua".
29 Edhe ata që shkoninë *andej* e shaninë,

*) Pretore ishte pallati a shtëpi e qivernitarit.

dyke tundurë krerët' e tyre, e dyke thënë, Ua,
ti që prish tempullinë, edhe për tri dit e ndër-
30 ton, Shpëto vetëhenë t' ënde, edhe sbrit nga
31 kryqi. Kështu edhe kryepriftërit' e përqesh-
ninë ndë mest të tyre bashkë me shkronjë-
sitë, e thoshinë, Të-tjerë shpëtoj, vetëhen' e
32 ti s' munt t'a shpëtonjë. Krishti mbreti i Isra-
ilit letë sbresë tashi nga kryqi, që të shohëmë
edhe të besojmë. Edhe ata që ishinë kryqë-
zuarë bashkë me atë e shaninë.
33 Edhe kur ubë ora gjashtë, ubë një errë-
sirë mbë gjithë dhenë, gjer mbë të nëntën' orë.
34 Edhe mbë të-nënttën' orë Jisuj bërtiti me
zë të-math, dyke thënë, „Elloi, Elloi, llama
Sabahthani?" që e-kthyerë do me thënë,
„Perëndia im, Perëndia im, përse hoqe dorë
35 prej meje?" Edhe disa nga ata që ishinë dyke
ndënjurë atje, kur dëgjuanë, thoshninë, Na tek
36 po thërret Ilinë. Edhe një usul, e mbushi një
sfungar me uthullë, edhe e vuri mbi një ka-
llam, e i tha të pijë, dyke thënë, Lini, letë
shohëmë, ndë vjen Ilia t'a sbresë.
37 Edhe Jisuj nxori një zë të-math, edhe dha
shpirtinë.
38 Edhe kurtina e tempullit uça mbë dy, prej
së-larti gjer poshtë.
39 Edhe urdhër-qindësi, që ish ndënjurë kun-
druell, ati, kur pa, se dyke bërtiturë kështu dha
shpirtinë, tha, Me të-vërtetë ky njeri paska
qënë Bir Perëndie.

BKSH

40 Ishinë edhe gra dyke vënë re prej së-lar-
gu; ndër atu ish edhe Maria Magdhalini, edhe
Maria e ëm' e Jakovit të-vogëlë edhe e Jo-
41 siut, edhe Salloma, Të-cilatë, edhe kur ish
ndë Galilet, i vininë pas, edhe i shërbeninë;
edhe shumë të-tjera që patnë hipurë bash-
kë me atë ndë Jerusalim.

42 Edhe tani si ungrys, (sepse ishte e-prëmte,
43 do-me-thënë *dita* para së-shëtunësë), Erdhi
Josifi që ishte nga Arimathea, *një* i-nderçim
këshillës, që edhe ay priste mbretërin' e Pe-
rëndisë; *edhe* kuxoj e hyri te Pillati, edhe
44 lypi trupin' e Jisujt. Edhe Pillati uçudit, ndë
qoftë se kishte vdekurë tani; edhe thërriti
përanë krye-qindësinë, edhe e pyeti, ndë ka
45 kohë që vdiq. Edhe si mori vesh prej krye-
46 qindësit, i fali trupinë Josifit. Edhe *ky* bleu
pëlhurë, edhe e sbriti, edhe e pshtolli me
pëlhurënë, edhe e vuri ndë *një* varr, që ishte
latuarë prej një shkëmbi; edhe rrukulisi një
gur ndë derët të varrit.

47 Edhe Maria Magdhalini edhe Maria e
ëm' e Josiut vininë re ku po vihetë.

Krye 16.

1 Edhe si shkoj e-shëtuna, Maria Magdha-
lini, edhe Maria *e ëm'* e Jakovit, edhe Sallo-
ma, blenë erëra, që të vijn' e t'a lyenjënë.
2 Edhe shumë çpejt ndë mëngjest të-parënë

ditë të javësë vijnë ndë varrt, tek po linte
3 djelli. Edhe thoshninë ndë mest të tyre, Cili
dotë na rrukullisnjë gurinë prej derës' së va-
4 rrit? Edhe kur shtynë sytë, shohënë se guri
ish rrukullisurë; sepse ishte fort i-math.
5 Edhe si hynë ndë varrt, panë një djalosh
dyke ndënjurë mb' anë të-djathtë, të-veshurë
6 me rroba të-bardha; edhe utrëmpnë. Po ay
u thot' atyre, Mos utrëmpni; kërkoni Jisu Na-
zarinasinë, që ukryqëzua; ungjall, nuk' është
7 këtu; na vëndi ku e vunë. Po shkoni, e u thoni
nxënëset t' ati, edhe Pjetrit, se *ay* vete më
përpara se ju ndë Galilet; atje dot'a shihni,
8 sikundrë u tha juve. Edhe *ato* duallnë *çpejt*,
e iknë nga varri; sepse i kish *zënë* të-dri-
dhur' e të-habiturë; edhe asnjeriu s'i thanë
gjë; sepse kishinë frikë.
9 Edhe si ungjall ndë mëngjest të-parënë
ditë të javësë, i uduk të-parënë herë Marisë
Magdhalini, prej së-cilësë kishte kërryerë
10 shtatë djaj. Ajo vate, e u dha zë atyreve që ki-
shinë qënë me atë, *atje* tek ishinë dyke bë-
11 rë vajë e dyke qarë. Edhe ata kur dëgjuanë,
se rron, edhe se upa nga ajo, nukë zunë besë.
12 Edhe pastaj udëftye mbë tjetërë formë
mbë dy *veta* nga ata, tek po ecninë dyke
13 vaturë nd'arë. Edhe ata vanë e u dhanë zë
të-tjerëvet; po as atyreve s'u zunë besë.
14 Pastaj udëftye mbë të një-mbë-dhjetët, tek
ishinë dyke ndënjurë ndë mësallët, edhe i

shau për pabesërin'e atyre, edhe për zëmë-
rën' e-ashpërë, sepse nuk' u zunë besë aty-
reve, që e panë të-ngjallurë.
15 Edhe u tha atyre, Shkoni ndëpër gjithë
botënë, edhe lëçiti ungjilinë ndëpër gjithë
16 kriesënë. Kush të besonjë edhe të pagëzo-
netë; dotë shpëtonjë; po kush të mos beso-
17 një dotë dënonetë. Edhe shënja mb' ata që
dotë besonjënë dotë jenë këto, Mb' emërit
t' im dotë kërrenjënjë djaj, gjuhëra të-ra dotë
18 flasënë; gjërpënj dotë zënë; Edhe ndë pifshi-
në ndonjë farë gjëje që sjell vdekje, nukë
dot' u bënjë dëm atyreve; përmbi të-smurë
dy duar dotë vënë, edhe dotë shëronenë.
19 Zoti pra, passi u foli atyre, hipi ndë qiellt
edhe ndënji mbë anë të-djathë të Perëndisë.
20 Edhe ata duallë e lëçitnë kudo, edhe Zoti
ishte dyke punuarë bashkë me ata edhe dyke
vërtetuarë fjalënë me çuditë që e shoqëro-
ninë. Amin.

BKSH

Ungjilli Pas Llukajt

Krye 1

1 Passi shumë *veta* vunë dorë të radhitnjë-
në rrëfim për ato punë, që me të-plottë janë
2 vërtetuarë ndër ne, Si kundrë na i kanë lë-
në ata, të-cilëtë që ndë kryet; të herësë i
panë me sy, edhe ubënë shërbëtorë të fjalë-
3 së, M' uduk e udhësë edhe mua, që u kam
rënë prapa të-gjithave që ndë kryet hollë
hollë, të të shkruanj me radhë *për këto*, o i
4 pushteçim fort Theofil, Që të njohç të-vër-
tetuarët' e atyre punëve që u mësove.
5 Ndë ditt të Jrodhit, mbretit të Judhesë,
ishte një prift, *që j' a thoshin'* emërinë Zaha-
ri, prej fëmijës' s' Aviajt; edhe gruaja e ati
ishte prej të bijavet t' Aaronit, edhe emëri-
6 në *j' a quanin'* Elisavetë. Edhe që të dy ishi-
në të-drejtë përpara Perëndisë, dyke ecurë
pa të-metë ndër gjithë porosit, e drejtërimet
7 të Zotit. Edhe ata s' kishinë djalë, sepse
Elisaveta ishte beronjë, edhe të dy ishinë
të-shkuarë ndë ditt të tyre.
8 Edhe ay tek ishte dyke bërë punët' e
priftërisë përpara Perëndisë ndë radhët të
9 fëmijës' së ti, Pas zakonit të punës' së prif-
tërisë, i ra shorta të hynjë ndë tempullt të

BKSH

10 Zotit e të djegë thimjamë. Edhe gjithë shu-
mica ishte dyke falurë përjashta ndë kohët
të të-djegurit të thimjamësë.
11 Edhe i uduk ati një ëngjëll i Zotit dyke
12 ndënjurë nb'anët të-djathtë të therores' së
13 thimjamësë; Edhe Zaharia kur pa, udroth,
edhe frikë ra mbi atë. Po ëngjëlli i tha, Mos
ufrikëso, Zahari, sepse lutja jote udëgjua,
edhe gruaja jote Elisavetë dotë të pjellë
djalë, edhe dot' j' a quanjç emërinë Joan.
14 Edhe dotë jetë mbë ty gëzim e gas; edhe
shumë *veta* dotë gëzonenë për lindjen' e ati.
15 Sepse dotë jet' i-math përpara Zotit, edhe
ver' e të-pira të-forta nukë dotë pijë, edhe
me Frymë të-Shënjtëruarë dotë mbushetë qe
16 nga barku i s' ëmës' së ti. Edhe shumë nga
të bijt' e Israilit i ka për të kthyerë mbë
17 Zonë Perëndin' e tyre. Edhe ay dotë vinjë
përpara ati me frymë e me fuqi të Illiut,
për të kthyerë zëmërat' e atërvet mbë bijt,
edhe të-pabinduritë ndë urtësit të të-drejtë-
vet, për të bërë gati Zotit *një* llaus të-ndre-
qurë.
18 Edhe Zaharia i tha ëngjëllit, Si dot' e
marr vesh këtë *punë*; sepse unë jam plak,
edhe gruaja ime e-lashtë ndë ditt të saj.
19 Edhe ëngjëlli u-përgjeq e i tha, Unë jam
Gavriili që rri përpara Perëndisë; edhe u-
dërguashë që të të flas tyj, edhe të t' ap zë-
20 rin' e-mirë për këto *punë*. Edhe na tek dotë

BKSH

jesh pa gojë e dotë mos munç të flaç gjer
mb' atë ditë që dotë bënenë këto; sepse nuk' u
zure besë fjalëvet të mia, të-cilatë dotë mbu-
shenë ndë kohët të tyre.
21 Edhe llauzi po priste Zaharinë, edhe çu-
diteshinë për të-mënuarit' e ati ndë tempullt.
22 Edhe kur dolli, nukë muntte t' u fliste aty-
re; edhe e kupëtuanë, se kishte parë të-fani-
turë ndë tempullt; edhe ay u bënte me shë-
nja, edhe mbeti i-shurdhërë.
23 Edhe si umbushnë ditt' e shërbesës' s' ati,
24 shkoj ndë shtëpit të ti. Edhe pas këtyre dit-
ve Elisaveta, gruaj' e ati, umbars; edhe e
25 fshihte vetëhenë pesë muaj, dyke thënë, Se
kështu bëri Zoti mbë mua ndër *këto* dit që
hodhi syt' e ti *mbi mua*, që të heqnjë të-për-
qeshuritë t' im ndër mest të njerësvet.
26 Edhe mbë të-gjashtinë muaj, ëngjëlli Ga-
vriil udërgua prej Perëndisë ndë *një* qytet
27 të Galilesë, që *e kishte* emërinë Nazaret, Te
një vërgjëreshë, që ishte vluarë me *një* bu-
rrë, që quhej Josif, prej shtëpis' së Dhavi-
dhit; edhe emër'i vërgjëreshësë *ishte* Mariam.
28 Edhe ëngjëlli kur hyri tek ajo, tha, gëzohu,
o e-mbushurë me hire; Zoti *është* bashkë me
29 ty; e-bekuarë *je* ti ndë mest të gravet. Edhe
ajo, kur pa, utrumbullua për fjalën' e ati;
edhe mendonej ç' dotë jetë vallë këta të-
30 përshëndoshurë. Edhe ëngjëlli i tha, Mos u-
trëmp, Mariamë; sepse gjete hir peranë Pe-

BKSH

31 rëndisë. Edhe na tek dotë mbarsesh ndë bark,
edhe dotë pjellç djalë, edhe dot' j' a quanjç
32 emërinë Jisu. Ky dotë jet' i-math, edhe Bir
i të-Lartit dotë quhetë; edhe Zoti Perën-
dia dot' i apë ati fron' e Dhavidhit, atit t' ati;
33 Edhe dotë mbretëronjë ndë shtëpit të Jako-
vit ndë jetët *të jetëvet*, edhe mbretëria e ati
nukë dotë ketë të-mbaruarë.
34 Edhe Mariama i tha ëngjëllit, Qysh dotë jetë
35 këjo *punë*, sepse *unë* burrë s' njoh? Edhe ën-
gjëlli upërgjeq e i tha, Frym' e-Shënjtëruarë
dotë vinjë mbë ty, edhe fuqi' e të-Lartit dotë
të hiesonjë; përandaj edhe ajo *foshnj'* e-shënj-
tëruarë që len *prej teje* dotë quhetë Bir
36 Perëndie. Edhe na Elisaveta, far' e fisi yt,
edhe ajo umbars *me* bir ndë pleqërit të saj,
edhe ky muaj ësht' i-gjashtti i asaj që qu-
37 hetë beronjë. Sepse s' ka punë që të jet' e-
38 pamundurë te Perëndia. Edhe Mariama tha,
Na shërbëtoreja e Zotit; ubëftë mbë mua pas
fjalësë s' ate.
Edhe ëngjëlli iku prej asaj.
39 Edhe nd' ato dit Mariama ungrit, e vate
me nxitim ndë malësit, ndë *një* qytet të Ju-
40 dhësë; Edhe hyri ndë shtëpit të Zaharisë,
41 edhe përshëndoshi Elisavetënë. Edhe posa
dëgjoj Elisaveta të-përshëndoshurit' e Mari-
së, këceu foshnjeja ndë barkt t' asaj; edhe
Elisaveta umbush me Frymë të-Shënjtëruarë,
42 Edhe thërriti me zë të-math, e tha, E-beku-

arë je ti ndë mest të gravet, edhe e-beku-
43 arë *është* pem' e barkut t' ënt. Edhe nga më
ngjau kjo, të vinj' e ëm' e Zotit t' im tek
44 unë? Sepse na posa erdhi zëri i të-përshën-
doshurit t' ënt ndë veshët t' im, këceu fosh-
45 njeja me gëzim ndë barkt t' im. Edhe lum
ajo që besoj, se dotë mbushenë tek ajo ç'ja-
në folurë prej Zotit.
46 Edhe Mariama tha,
47 Shpirti im madhëron Zonë, Edhe fryma
ime ugëzua mbë Perëndinë shpëtimtarinë t'im;
48 Sepse shtyri sytë mbë të-përunjurit të shër-
bëtores' së ti; sepse na që tashi *e paskëtaj*
gjithë brezatë dotë më lumëronjënë; Sepse
49 i Forti bëri *punë* të-mëdha tek unë, edhe i-
50 shënjtëruarë *është* emër' i ati; Edhe përdë-
llim' i ati *është* breza pas brezash mb' ata
51 që i kanë frikë. Bëri pushtet me krahun' e
ti; përndau madhështorë me mendimn' e zë-
52 mërës' s' atyre. Rrëzoj fuqitarë prej fronesh,
53 edhe lartësoj *njerës* të-përunjurë. Të-uriturë
i mbushi së-mirash, edhe të-pasurë i dërgoj
54 jashtë sbrazëtë. I ndihu Israilit shërbëtorit
të ti, dyke sjellë ndër mëntt përdëllimn' *e ti*,
55 Sikundrë foli mb' atëritë t' anë, mb' Avraam-
në e mbë farën' e ati, për jetën' *e jetësë.*
56 Edhe Mariama ndënji bashkë me atë afë-
ro tre muaj; pastaj ukthye ndë shtëpit të saj.
57 Edhe Elisavetës' i umbush koha për të
58 pjellë; edhe polli djalë. Edhe fqinjt' e farëfi-

sasit' e asaj dëgjuanë, se Zoti madhëroj për-
dëllimn' e ti tek ajo; edhe gëzoneshinë ba-
shkë me atë.
59 Edhe mbë té-tettënë ditë erdhe, që të
rrethpresënë djalënë, edhe e quaninë Zahari,
60 mb' emërit të t' et. Po e ema upërgjeq e tha,
61 Jo, po dotë quhetë Joan. Edhe *ata* i than' a-
saj, Se s' ka ndonjë ndë fist t' ënt që të qu-
62 hetë me këtë emërë. Edhe bëninë me shë-
nja t' et t' ati, ç' emërë donte t' i epetë ati.
63 Edhe ay kërkoj një dërrasë të-shkruari, edhe
shkroj, dyke thënë, Joan ësht' emër' i ati.
64 Edhe të-gjith' uçuditnë, Edhe për-një-here
u hap goj' e ati edhe gjuh' e ati; edhe fliste
dyke bekuarë Perëndinë.
65 Edhe ra frikë mbë gjith' ata që rrininë
rrotull' atyre. Edhe të-gjitha këto fjalë flite-
66 shinë ndëpër gjithë malësit të Judhësë. Edhe
gjith' ata që i dëgjuanë i vunë *këto* ndë zë-
mërat të tyre, dyke thënë, Vallë ç' dotë jetë
ky djalë? Edhe dor' e Zotit ishte bashkë me
atë.
67 Edhe Zaharia i ati umbush me Frymë të-
Shënjtëruarë; edhe profitepsi, dyke thënë,
68 I-bekuarë qoftë Zoti Perëndia i Israilit,
sepse erdhi edhe bëri çpërblim mbë llausn'
69 e ti; Edhe ngriti bri shpëtimi mbë ne ndë
70 shtëpit të Dhavidhit shërbëtorit të ti, Sikundrë
foli me anë të gojës' së shënjtorëvet profitër
71 vet të ti prej jete, Shpëtim prej armiqvet

t' anë edhe prej dorës' së gjith' atyreve që
72 na kanë mëri; Për të mbushurë përdëllimn'
e ti mb'atëritë t' anë, edhe për të përmën-
73 durë dhjatën' e ti të-shënjtëruarë; Pas besë
74 që i ubetua Avraamit atit t' ënë, Se dotë na
apë të shpëtojmë prej dorës' s' armiqvet t'a-
75 në, edhe t' i shërbejmë ati pa frikë, Me shënj-
tëri e me drejtëri përpara ati gjithë ditt' (e
jetësë s' onë).
76 Edhe ti, o djalë, profit i të-Lartit dotë
quhesh; sepse dotë shkonjç përpara faqes'
77 së Zotit, për të bërë gati udhët' e ati, Për të
dhënë mënt shpëtimi llauzit t' ati, me anë të
78 ndjesës' së fajevet, Për përdëllimn' e-thellë të
Perëndisë t' ënë, me të-cilinë na erdhi agjim
79 prej së-larti, për të ndritur' ata që rrinë nd'
errësirë e ndë hie vdekjeje, që të bënjë këm-
bëtë t' ona t' ecëjnë drejtë nd' udhë paqtimi.
80 Edhe çuni rritej e forconej ndë frymë,
edhe ishte ndë shkretëtirët gjer mb' atë ditë
që dotë dëftehej te Israili.

Krye 2.

1 Edhe nd' ato dit dolli urdhër prej Qesa-
2 rit August të shkruhenë gjithë bota. Këta të-
shkruarë ubë për të-parënë *herë*, kur ishte
3 Qyrini qivernitar i Syrisë. Edhe vininë të-
gjithë të shkruheshinë, sicili ndë qytett të
4 ti. Hipi edhe Josifi prej Galilesë, prej qyte-
tit Nazaret, ndë Judhet, ndë qytett të Da-

vidhit, që quhetë Vithleem, (Sepse ay ishte
5 prej shtëpis' e prej atëris' së Davidhit), Që
të shkruhetë bashkë me Mariamënë, që ishtë
vluarë me atë për grua, e-cila ishte me ba-
6 rrë. Edhe ata tek ishin' atje, asaj i umbushnë
7 dittë që të pjellë; Edhe polli birr' e saj të-
parëlindurinë, edhe e pshtolli ndë shpërgënj,
edhe e vuri ndë grashtt, sepse nukë kishte
vënt për ata atje ku kishinë rënë.
8 Edhe nd' atë vënt ndëpër arat ishinë *ca*
barinj, dyke ruajturë me radhë natënë tu-
9 fën' e tyre. Edhe javoka një ëngjëll i Zotit
erdhi mb' ata, edhe lavdi Zoti ndriti rrotull'
10 atyre, edhe ufrikësuanë frikë të-madhe. Edhe
ëngjëlli u tha atyre, Mos frikësohi, sepse na
tek po u ap juve zë të-mirë për një gëzim
të math, që dotë jetë mbë gjithë llauzinë;
11 Sepse sot u lindi juve ndë qytett të Dhavi-
dhit një shpëtimtar, i-cili është Zoti Krisht.
12 Edhe këjo *dotë jetë* shënja ndër ju, Dotë
gjeni një foshnjë pshtjellë ndë shpërgënj,
dergjurë ndë grashtt.
13 Edhe papandehuraj bashkë me ëngjëllinë
uduk një shumicë ushtërie qiellore, dyke
14 lavduruarë Perëndinë, e dyke thënë, Lavdi
mbë Perëndinë *që është* mbë të-lartat, edhe
paqtim mbi dhet, pëlqim ndë njerëzit.
15 Edhe ëngjëjtë si iknë prej atyreve ndë
qiellt, njerëzitë, barinjtë i thanë njeri tjatë-
rit, Letë vemi tani gjer ndë Vithleem, e te

BKSH

shohëmë këtë punë që është bërë, të-cilënë
16 Zoti na e dëfteu. Edhe erdhë me vrap, e
gjetnë Mariamën' edhe Josifnë edhe foshnjë-
17 në dërgjurë ndë grashtt. Edhe si panë, dë-
ftyenë për fjalënë që ufol mb' ata për këtë
djalë.
18 Edhe gjith' ata që dëgjuanë uçuditnë për
19 ato që ufolnë barinjtë. Edhe Mariama i ruante
me vetëhe gjithë këto fjalë, dyke menduarë
për ato ndë zëmërët të saj. Edke barinjtë
20 ukthyenë dyke lavduruarë e dyke nderuarë
Perëndinë për gjith' ato që dëgjuan' e panë,
sikundrë ufol mb' ata.
21 Edhe kur umbushnë të tetë dittë për të
rrethprerë djalënë, emër' i ati uquajt Jisu, që
ishte quajturë prej ëngjëllit para se të zihej
ndë barkt.
22 Edhe kur umbushnë ditt' e të-pastruarit
t' asaj, pas nomit të Moisiut, e prunë ndë
23 Jerusalim, që t' e nxirninë përpara Zotit Si-
kundrë është shkruarë ndë nomt të Zotit,
„Se çdo mashkullë që hap shtrat *barku*,
24 shënjt te Zoti dotë quhetë;“ Edhe që të bi-
ninë kurban, sikundrë është thënë ndë nomt
të Zotit, „Një par turtujsh a dy zoq pëllum-
bash.“
25 Edhe na tek ishte ndë Jerusalim një njeri,
që *e kishte* emërinë Simeon; edhe ky njeri
ishte i-drejtë edhe me frikë Perëndie, dyke
26 priturë ngushullimin' e Israilit. Edhe ish sbu-

luarë tek ay prej Frymës' së-Shënjtëruarë, se
nukë dotë shihte vdekje, para se të shihte
27 Krishtin' e Zotit. Edhe erdhi me anë të Fry-
mës' *së-Shënjtëruarë* ndë hieroret; edhe prin-
dëritë kur prunë brënda djalënë Jisu, që të
28 bëninë për atë pas zakonit të nomit, Ay e
mori ndër duart të ti, edhe bekoj Perën-
dinë, e tha,
29 Tashi, o Zotëri, lëshon shërbëtorinë t' ënt,
30 pas fjalësë s' ate, me paqtim; Sepse panë
31 syt' e mi shpëtimnë t' ënt, Që bëre gati për-
32 para sysh të gjithë llauzëvet, Dritë për të
ndriturit' e kombevet, edhe lavdi për llauzinë
t' ënt Israil.
33 Edhe Josifi edh' e ëm' e ati po çuditeshi-
34 në për ato që fliteshinë për atë. Edhe Sime-
oni i bekoj ata, edhe i tha Mariamësë, s'
ëmës' s' ati, Na ky tek është vënë për të-rë-
nit' e për të-ngriturit' e shumë *vetave* ndë
35 Israilt, edhe për shënjë të-kundrëfoluri; (Edhe
tyj vetë shpirtinë një shpatë t' a ka për të
depërtuarë); që të sbulonenë mendimet' e
shumë zëmërave.
36 Edhe *atje* ishte Anna, një profitëreshë, e
bij' e Fanuilit, prej farës' s' Asirit; këjo ishte
shum' e shkuarë ndë dit, edhe kishte rruarë
me burrinë shtatë vjet pas vërgjëris' së saj;
37 Edhe këjo *ishte grua* e-ve sindonja tetë-dhjet'
e katrë vjeç, e-cila nukë ndahej prej hiero-
resë, dyke luturë me agjërime e me të-falura

BKSH

38 nat' e ditë. Edhe kjo, passi arriti nd' atë orë,
lavdëronte Zonë, edhe u fliste për atë gjith'
atyreve që prisninë çpërblim ndë Jerusalim.
39 Edhe si mbaruanë gjithë *punëtë* pas no-
mit të Zotit, ukthyenë ndë Galilet, ndë qy-
tett të tyre Nazaret.
40 Edhe djali rritej e forconej ndë frymë,
dyke mbushurë me urtësi; edhe hir' i Perën-
disë ishte mbi atë.
41 Edhe prindërit' e ati vininë për mot ndë
42 Jerusalim për të-kremten' e pashkësë. Edhe
kur ubë dy-mbë-dhjetë vjeç, ata hipnë ndë
43 Jerusalim pas zakonit të së-kremtesë; Edhe
si mbaruanë dittë, mbë të-kthyerit të tyre,
djali Jisu mbeti prapa ndë Jerusalim; edhe
44 Josifi edh' e ëma nukë dijnë. Po dyke pan-
dehurë, se ay ishte mb' udhë me shokëtë,
ecnë një dit' udhë; edhe e kërkoninë ndëpër
45 far' e fist e ndëpër të-njohurit. Edhe passi
nuk' e gjetnë, ukthyenë prapë ndë Jerusa-
46 lim dyke kërkuar' atë. Edhe pas tri ditsh e
gjetnë ndë hieroret, dyke ndenjurë ndë mest
të mësonjësvet, e dyke dëgjuar' ata, e dyke
47 pyetur' ata. Edhe gjith' ata që e dëgjoninë
maniteshinë për mëndjen' e për të-përgjegju-
rat e ati.
48 Edhe kur e pan' atë, uhabitnë; edhe e
ëma i tha, O bir, ç' na bëre kështu? na yt
atë edhe unë tek po të kërkojmë me pikë-
49 llim. Edhe *ay* u tha atyre, Përse më kërko-

BKSH

nitë? nuk' e dinitë, se unë duhetë të jem ndë
50 punët të t' im et? Po ata nuk' e kupëtuanë
fjalënë që u tha atyre.
51 Edhe sbriti bashkë me ata, edhe erdhi
ndë Nazaret; edhe ishte dyk' ubindurë nd' ata.
52. Edhe e ëma ruante gjithë këto fjalë ndë zë-
53 mërët të saj. Edhe Jisuj vinte mbarë nd' ur-
tësi e ndë moshë e ndë hir përpara Perën-
disë e njerëzet.

Krye 3

1 Edhe mbë të-pesë-mbë-dhjettinë vit të
mbretëris' së Tiver Qesarit, kur Pillat Pon-
diu ishte qyvernitar i Judhesë, edhe Irodhi
katrurdhëratës i Galilesë, e Filipi i vëllaj i ati
katrurdhëratës i Ituresë edhe i vëndit të Tra-
2 honitisë, edhe Lysania katrurdhëratës i Avi-
linisë, Ndë ditt të kryepriftërvet Annë e Ka-
iafë, erdhi fjal' e Perëndisë mbë Joaninë të
birrin' e Zaharisë ndë shkretëtirët.
3 Edhe erdhi mbë gjithë vëndinë rrotullë
Jordhanit, dyke lëçiturë pagëzim pendimi për
4 ndjesën' ë fajevet, Sikundrë është shkruarë
ndë vivlit të fjalëvet të profitit Isai, që thotë,
„Zër' i ati që bërtet ndë shkretëtirët, Bëni
gati udhën' e Zotit, bëni të-drejta rrugat' e
5 ati. Çdo vënt i-thellë dotë mbushetë, edhe
çdo mal e kodrë dotë unjetë, edhe të-shtrëm-
bëratë dotë bënenë të-drejta, edhe udhët' e-
6 ashpëra të-sheshme; Edhe çdo mish dotë
shohë shpëtimn' e Israilit.“

7 U thoshte pra gjindjevet që vininë jashtë
që të pagëzoneshinë prej ati, Të-pjellë ne-
përkash, kush u dëfteu juve të ikëni prej
8 zëmërimit që ka për të ardhurë? Bëni pra
pemë të-vëjejtura për pendim, edhe mos ziri
të thoni me vetëhenë t'uaj, *se* Atë kemi A-
vraaminë; sepse po u them juve, se Perëndia
munt prej këtyre gurëve t'i ngrerë djem Avra-
9 amit. Edhe tashi edhe sëpata gjëndetë ndë
rrënjët të drurëvet; çdo dru pra që nukë bën
pemë të-mirë, pritetë edhe hidhetë ndë zjarr.
10 Edhe gjindja e pyesninë, dyke thënë, Ç'
11 të bëjmë pra? Edhe ay upërgjeq e u thot'
atyre, kush ka dy rroba let' i apë pjesë ati
që s'ka; edhe kush ka të-ngrëna, gjithashtu
letë bënjë.
12 Erdhë edhe kumerqarë që të pagëzone-
shinë, edhe i thanë, Mësonjës, ç' të bëjmë?
13 Edhe ay u tha atyre, Mos merrni gjë më te-
përë veç asaj që është urdhëruarë mbë ju.
14 Edhe e pyesnin' atë edhe t'atillë që venë
ushtëtarë, dyke thënë, Edhe na ç' të bëjmë?
Edhe u tha atyre, Mos bëni shtrëngim as
njeriu, as mos kallëzoni keq *për njeri*; edhe
let' u jenë mjaft pagatë t' uaj.
15 Edhe llauzi tek po ishte dyke priturë,
edhe të-gjithë mendoneshinë ndë zëmërat të
tyre për Joaninë, vallë mos ësht' ay Krishti,
16 Joani upërgjeq të-gjithëve, dyke thënë, Unë
u pagëzonj juve me ujë; po vjen më i-forti

se unë, të-cilit s'jam i-zoti t'i sgjith rripn'e
shollavet t' ati; ay dot' u pagëzonjë juve me
17 Frymë të-Shënjtëruarë e me zjarr; I-cili *mban*
lopatënë ndë dorët të ti, edhe dotë qëronjt
lëmën' e ti, edhe dotë mblethnjë grurëtë ndë
grunart të ti, edhe kashtënë dot'a djegë ndë
zjarr të-pashuarë.
18 Edhe shumë të-tjera dyke mësuarë llau-
zit i epte ati zën' e-mirë.
19 Edhe Irodhi katrurdhëratësi, passi qërto-
nej prej ati për Irodhiadhënë gruan'e të vë-
llat të ti (Filip), edhe për gjithë të-këqiatë
që pat bërë Irodhi, Shtoj edhe këtë përmbi
20 të-gjitha, edhe mbylli Joannë ndë burgt.
21 Edhe passi u pagëzua gjithë llauzi, upa-
gëzua edhe Jisuj, edhe tek ishte dyke falurë,
22 uhap qielli, Edhe Frym' e-Shënjtëruarë sbriti
mbi atë me një farë trupi posi pëllump, edhe
erdhi një zë nga qielli, dyke thënë, Ti je Biri
im i-dashuri, ty të kam pëlqyerë.
23 Edhe vetë Jisuj zuri të jetë afëro tri-dhjetë
vjeç, edhe ishte (si e pandehninë *bota*) i bir'
24 i Josifit, i Iliut, I Matthatit, i Leviut, i Mel-
25 hiut, i Annajt, i Josifit, I Matthiut, i Amosit,
26 I Naumit, i Esliut, i Naggajt, I Maathit, i Ma-
27 ttathiut, i Semejt, i Josifit, i Judhësë, I Jon-
28 najt, i Risajt, i Zorovavelit, i Sallathiilit, i Ni-
29 riut, I Melhiut, i Adhdhiut, i Kosamit, i El-
30 modhamit, i Irit, I Josiut, i Eliezerit, I Joreimit, i
Matthatit, i Leviut, I Simeonit, i Judhesë, i Josifit,

31 Jonanit, i Eliaqimit, I Meleajt, i Mainanit, i
32 Mattathajt, i Nathanit, i Dhavidhit, I Jesseut,
33 i Ovidhit, i Voozit, i Sallmonit, i Naasonit, I
34 Aminadhavit i Aramit, i Esromit, i Faresit, i
35 Judhesë, I Jakovit, i Isaakut, i Avraamit, i
Tharajt, i Nahorit, I Saruhut, i Ragavit, i Fa-
lekut, i Everit, i Sallajt, I Kainanit, i Arfak-
36 sadhit, i Simit, i Noesë, i Ilamehut, I Mathu-
37 sallësë, i Enohut, i Jaredit, i Maleleilit, i Kai-
38 nanit, I Enosit, i Sithit, i Adhamit, I Pe-
rëndisë.

Krye 4.

1 Edhe Jisuj plot me Frymë të-Shënjtërua-
rë ukthye nga Jordhani; edhe upru me anë
të Frymësë ndë shkretëtirët, *Ku ishte* dyke
2 ngarë nga djalli dy-zet dit; Edhe nukë hën-
gri asgjë nd'ato dit; edhe si umbushnë ato,
3 pastaj i erdhi uri. Edhè djalli i tha, Ndë je
i Bir'i Perëndisë, thua-i këti guri të bënetë
4 bukë. Edhe Jisuj i upërgjeq ati, dyke thënë,
Eshtë shkruarë, „Se njeriu nukë dotë rronjë
vetëmë me bukë, po me çdo fjalë të Perën-
5 disë." Edhe djalli e hipi mbë *një* mal të-lartë,
e i dëften ati gjithë mbretërit' e botësë për
6 *një* grimë here. Edhe djalli i tha, Tyj dotë t'a
ap tërë këtë pushtet edhe lavdin' e atyre se-
pse mua m'është dhënë, edhe kujt të dua ja
7 ap; Ti pra ndë ufalç përpara meje, të-gjitha
8 dotë jenë t' ëndetë. Po Jisuj upërgjeq e i tha,

(Çporu prapa meje, Satana, sepse) është
shkruarë, „Zotit Perëndisë t'ënt dot'i falesh,
9 edhe vetëm'atij dot'i lutesh.“ Edhe ay e pru-
ri atë ndë Jerusalim, edhe e qëndroj mbi fle-
tëzët të hieroresë, edhe i tha, Ndë je i Bir'i
Perëndisë, hith vetëhenë t'ënde së-këtejmi
10 poshtë; Sepse është shkruarë, „Se dotë ur-
dhëronjë ëngjëjt' e ti për ty, që të të ruanjë-
11 në;“ Edhe „Se dotë të ngrenë ty mbi duart,
që të mos përpjekç këmbënë t'ënde mbë
12 gur.“ Edhe Jisuj upërgjeq e i tha, Se është
thënë, „Nukë ke për të ngarë Zotinë Perën-
dinë t' ënt.“

13 Edhe djalli passi mbaroj çdo ngasje, u-
largua prej ati gjer mbë një kohë.

14 Edhe Jisuj ukthye me fuqin' e Frymësë ndë
Galilet; edhe dolli zë për atë mbë gjithë vën-
15 dinë rrotullë. Edhe ay mësonte ndëpër sina-
gogjit t'atyreve, dyke lavduruarë prej të-
gjithëve.

16 Edhe erdhi ndë Nazaret, atje ku ishte rri-
turë; edhe pas zakonit të ti hyri ndë sina-
gogjit ditën' e-shëtunë, edhe ungrit të këndo-
17 një. Edhe *ata* i dhanë, vivllin' e profitit Isai;
edhe si hapi vivlinë gjeti vëndinë, ku ishte
18 shkruarë, Frym' e Zotit *është* mbë mua; për-
andaj më leu *me vaj*; më dërgoj t'u ap zën'
e-mirë të-vobeqvet, të shëronj ata që kanë
zëmërënë të-thyerë, t' u lëçis skllevet liri, edhe
të-verbërvet të-hapurë të syvet, edhe të dër-

BKSH

19 gonj ata që janë ndënë mundim ndë liri; Të
lëçis mot të-pëlqyerë te Zoti."
20 Edhe si mbylli vivllënë, j'a dha shërbëto-
rit, edhe ndënji; edhe syt' e gjith' *atyreve që*
ishinë ndë sinagogjit ishinë dyke shikuarë
mbi atë.
21 Edhe zuri t'u thoshte atyre, Se sot um-
22 bush kjo shkronjë ndë veshët t' uaj. Edhe të-
gjithë dëshmoninë mb' atë, edhe çuditeshinë
për fjalët' e hirit që dilninë prej gojës s'ati,
edhe thoshinë, Nuk' është ky i bir' i Josifit?
23 Edhe *ay* u tha atyre, pa fjalë dotë më thoni këtë
paravoli, Mjekës, shëro vetëhenë t' ënde; sa
dëgjuamë që janë bërë ndë Kapernaum, bëj-i
24 edhe këtu ndë atdhet t' ënt. Po ay tha, Me
të-vërtetë po u them juve, se asndonjë profit
25 nuk' është i-pëlqyerë ndë atdhet të ti. Edhe
me të-vërtetë po u them juve, Shumë *gra* të-
va ishinë ndë Israilt ndë ditt të Illiut kur
umbyll qielli tre vjet e gjashtë muaj, ndë të-
cilët kohë ubë një zi e-madhe mbë gjithë
26 dhenë; Po as mbë ndonjë nga ato nuk' udër-
gua Illiu, përveç ndë Sareptë të Sidhonësë
27 ndë një grua të-ve. Edhe shumë të-krromo-
surë ishinë ndë Israilt ndë ditt të profitit E-
lisse; po asndonjë nga ata nuk' uqërua, për-
veç Neeman Syriani.
28 Edhe gjith' *ata që ishinë* ndë Sinagogjit, kur
29 dëgjuanë këto, umbushnë me zëmërim. Edhe
ungritnë edhe e nxuarrë jashtë qytetit; edhe

BKSH

e prunë gjer ndë buzët të malit, përmbi të-
cilinë ishte ndërtuarë qytet' i atyre, që t'a
30 rrëzoninë përposh. Po ay shkoj ndëpër mest
t'atyreve, edhe iku.
31 Edhe sbriti ndë Kapernaum, q' është një
qytet i Galilesë; e-ishte dyke mësuarë ata
32 të-shëtunatë. Edhe maniteshinë për mësimn'
e ati; sepse fjal' e ati ishte me pushtet.
33 Edhe ndë sinagogjit ishte një njeri që
kishte frymë djalli të-ndyrë, edhe bërtiti me
34 zë të math, Dyke thënë, Mjerë! ç' ke me ne
ti, Jisu Nazarinas? erdhe të na humbaç? Të
35 njoh cili je, Shënjti i Perëndisë. Po Jisuj e
qërtoj, dyke thënë, Pusho, edhe dil prej ati.
Edhe djalli si e hodhi ndë mest, dolli prej
36 ati, pa bërë asfare dëm ati. Edhe të-gjithë
uhabitnë, edhe flisninë njëri me tjatrinë, dyke
thënë, Ç' *është* këjo fjalë, që me pushtet e me
fuqi urdhëron frymat' e-ndyra, edhe dalënë?
37 Edhe përhapej zë për atë ndë çdo anë të
vëndit rrotullë.
38 Edhe si ungrit prej sinagogjisë, hyri ndë
shtëpit të Simonit, edhe të vjehërrën' e Simo-
nit e kishinë zënë ethe të-mëdha; edhe i ulut-
39 në për atë. Edhe *ay* si ndënji sipër' asaj, i
qërtoj ethetë, edhe e lanë; edhe *ajo* për-një-
here ungrit e u shërbente.
40 Edhe kur po perëndonte djelli, gjithë sa
kishinë të-sëmurë prej çdo farë lëngatash, i
prunë tek ay; edhe ay dyke vënë duartë mbi

BKSH

41 sicilinëdo nga ata, i shëroj ata. Edhe prej
shumë vetave dilninë edhe djaj dyke klithur'
e dyke thënë, Se ti je Krishti i bir'i Perën-
disë. Edhe *ay* dyke qërtuarë s'i linte të flis-
ninë, sepse e njihninë se ay ish Krishti.
42 Edhe si ubë ditë, dolli e vate ndë një
vënt të-shkretë; edhe gjindja e kërkonin' atë,
edhe erdhë gjer aty; edhe e mbaninë, që të
43 mos ikënte prej atyreve. Po ay u tha atyrë,
Se edhe ndëpër të-tjerët qytete duhetë të ap
zën' e-mirë për mbretërin' e Perëndisë; sepse
44 për këtë jam dërguarë. Edhe ishte dyke lë-
çiturë ndëpër sinagogjit të Galilesë.

Krye 5.

1 Edhe gjindja tek po ishte dyke shtrën-
guar' atë që të dëgjoninë fjalën' e Perëndisë
ay qëndronte përanë lëqerit Gjenisaret;
2 Edhe pa dy lundra dyke qëndruarë përanë
buzës' së lëqerit; edhe peshkatarëtë duallë
3 nga ato, e laninë rrietatë. Edhe *ay* hyri mbë
njerënë nga lundratë, mb' atë që ishte e Si-
monit, edhe i ulut ati të largonej pak prej
tokësë. Edhe si ndënji mësonte gjindjenë
nga lundra.
4 Edhe si pushoj së-foluri, i tha Simonit,
sill *lundrënë* ndë *ujërat* të-thella, edhe hithni
5 rrietatë t'uaj, që të zini pishq. Edhe Simoni
upërgjeq e i tha, Mësonjës, gjithë natën' u-
munduamë, edhe nukë zumë gjë; po për

6 fjalënë t'ënde dot' e heth rrietënë. Edhe si
bënë këtë, mbyllnë brënda një shumicë pish-
qesh të-madhe, edhe rrieta e atyreve po çirej.
7 Edhe u bënë me shënjë shokëvet që ishinë
ndë lundrët tjetërë, që të vinin' e t' u ndih-
ninë; edhe *ata* erdhë, edhe mbushnë të dy
lundratë, kaqë, sa ato *zunë të* fundoseshinë.
8 Edhe Simon Pjetri, kur pa, ra ndër gjunjët të
Jisujt, dyke thënë, Dil prej meje, Zot, sepse
9 jam njeri fajtuar. Sepse të-habiturë e pushtoj
atë edhe ata që ishinë bashkë me atë, për
10 gjahun' e pishqvet që zunë; Gjithashtu edhe
Jakovin' e Joannë, të bijt' e Zevedheut, të-ci-
lëtë ishinë shokë të Simonit. Edhe Jisuj i tha
Simonit, Mos ki frikë, se paskëtaj dotë gju-
11 anç njerës. Edhe si suallë lundratë mbë to-
kët, i lanë të-gjitha edhe vanë pas ati.
12 Edhe ay kur ishte ndë një nga qytetetë,
javoka një njeri plot me krromë; i-cili, kur
pa Jisunë, ra përmbys, edhe i ulut, dyke thë-
13 në, Zot, ndë do, munt të më qërojsh. Edhe
ay ndejti dorënë, e e preku, edhe tha, Dua,
Qërohu. Edhe sa-kaqë-herash krroma iku
14 prej ati. Edhe ay e porositi të mos i thotë
asnjeriu; po ecë, *thotë*, e dëfte vetëhenë t'ën-
de te prifti, edhe bjerë dhuratë për të-që-
ruarëtë t' ënt, sikundrë ka urdhëruarë Moisiu,
për dëshmim mb' ata.
15 Po fjala dilte më tepërë për atë. Edhe shumë
gjindje përmblidheshinë për të dëgjuar' e për

16 të shëruarë prej ati nga smundjet' e tyre. Po
ay hiqej ndë shkretëtirat, edhe falej.
17 Edhe një ditë, tek ay ishte dyke mësu-
arë, rrininë Farisenj e nommësonjës, të-cilëtë
kishin'ardhurë nga çdo fshat i Galilesë e i
Judhesë e i Jerusalimit; edhe fuqi' e Zotit
18 ishte për të shëruar' ata. Edhe Javoka, *ca*
njerës sillninë mbë shtrat një njeri, i-cili ishte
ulok; edhe kërkoninë t'a sillninë brënda, e
19 t' a vininë përpara ati. Edhe passi s' gjetnë
prej ç' ane t' a bininë brënda nga gjindja
e-shumë, hipnë mbi shtëpit, edhe e sbritnë
nga qeramidhetë bashkë me shtratinë ndë
20 mest përpara Jisujt. Edhe *ay* kur pa besën'
e atyre, i tha ati, O njeri, të janë ndjerë
21 fajet' e tu. Edhe shkronjësit' e Farisenjtë zunë
të mendoneshinë, dyke thënë, Cili është ky
që flet vllasfimira? kush munt të ndjenjë faje,
22 përveç vetëmë Perëndia? Po Jisuj si kupë-
toj mendimet' e atyreve, upërgjeq e u tha
23 atyre, Ç' mendoni ndë zëmërat t' uaj? Ç' është
më kollaj të them, Të janë ndjerë fajet' e
24 tu, apo të them, Ngreu edhe ecë? Po që të
dini, se i Bir' i njeriut ka pushtet mbi dhet
të ndjenjë faje, (i tha ulogut); Tyj të them,
Ngreu, edhe ngri shtratinë t' ënt, edhe ecë
25 ndë shtëpit t' ënde. Edhe për-një-here ungrit
përpara atyreve, edhe ngriti shtratinë, mbë
të-cilinë dergjej, edhe shkoj ndë shtëpit të
26 ti, dyke lavduruarë Perëndinë. Edhe *një* të-

BKSH

maniturë pushtoj të-gjithë, edhe lavduroninë
Perëndinë; edhe umbushnë me frikë, dyke
thënë, Se sot pamë *punë* të maniçime.
27 Edhe pasandaj dolli, edhe pa *një* kumerqar,
që *e kishte* emërinë Levi, dyke ndënjurë ndë
28 kumerqt, edhe i tha, Eja pas meje. Edhe ay
la të-gjitha, edhe ungrit e vate pas ati.
29 Edhe Leviu i bëri një të-priturë të-math
ndë shtëpit të ti; edhe ishte shumë gjindje
kumerqarësh edhe të-tjerësh, që kishinë ndë-
30 njurë ndë mësallët bashkë me ata. Edhe shkro-
njësit' e atyre e Farisenjtë murmurisninë te
nxënësit' e ati, dyke thënë, Përse hani e pini
31 bashkë me kumerqar' e me fajtorë? Edhe Ji-
suj upërgjeq e u tha atyre, Nukë kanë ne-
vojë të-shëndoshëtë për shëronjës, po ata që
32 kanë keq. S' kam ardhurë të gërshes të-drej-
të, po fajtorë ndë pendim.
33 Edhe ata i thanë, Përse nxënësit' e Joanit a-
gjëronjënë dëndurë, edhe bëjnë të-lutura, gjith-
ashtu edhe ata të Farisenjvet, po të-tutë han'
34 e pinë? Edhe ay u tha atyre, Mos muntni të
bëni dasmorëtë të agjëronjënë gjer sa të jetë
35 dhëndërri bashkë me ata? Po kanë për të
ardhurë dit, kur dotë merretë dhëndërri prej
atyreve; atëhere nd' ato dit dot' agjëronjënë.
36 Edhe u thoshte atyre edhe *një* paravoli, Se
asndonjë nukë vë andërrë rrobe së-re mbi
rrobë të-vjetërë; ndë mos, edhe të-renë e çjer,
edhe andërri prej së-resë s' vjen një me të-

BKSH

37 vjetrënë. Edhe asndonjë nukë vë verë të-re
ndë calikë të-vjetërë; ndë mos, ver' e-re dot'
i plasnjë calikëtë, edhe ajo dotë derdhetë,
38 edhe calikëtë dotë prishenë. Po ver' e-re du-
hetë të viretë ndë calikë të-rinj, edhe *kështu*
39 të dyja ruhenë. Edhe asndonjë, passi të pijë
verë të-vjetërë, do sa-kaqë-herash të-re, sepse,
thotë, e-vjetëra është më e-mirë.

Krye 6

1 Edhe të-shëtunën' e-dytë pas së-parësë ay
po shkonte ndëpër të-mbjellat; edhe nxënë-
sit' e ati këputinë kallinj, e i haninë, dyke
2 fërkuarë me duartë. Edhe ca nga Farisenjtë
u than' atyre, Përse bëni atë që nuk' ësht' e
3 udhësë t'a bëni të-shëtunatë? Edhe Jisuj u-
përgjeq e u tha atyre, Nuk' e kini kënduarë
as këtë që bëri Dhavidhi, kur i erdhi uri ati
4 edhe atyre që ishinë bashkë me atë? Qysh
hyri ndë shëpit të Perëndisë, edhe mori bu-
kët' e parëvënjesë, edhe hëngri, edhe u dha
edhe atyreve që ishinë bashkë me atë, të-ci-
latë nuk' ësht' e udhësë t'i hanë përveç ve-
5 tëmë priftëritë? Edhe u thoshte atyre, Se i Bir'
i njeriut ësht' i zoti edhe i së-shëtunësë.
6 Edhe përsëri *një* tjetërë të-shëtunë hyri
ndë sinagogjit, edhe mësonte; edhe atje ishte
7 një njeri që kishte dorën' e ti të-thatë. Edhe
shkronjësit' e Farisenjt' e vështroninë, ndë dotë
shëronjë të-shëtunë, që të gjeninë *çkak* të-

BKSH

8 përfoluri kundrë ati. Po ay i dinte mendimet'
e atyreve, e i tha njeriut, që kishte dorën' e
thatë, Ngreu, edhe qëndro ndë mest. Edhe
9 ay ungrit edhe qëndroj. Jisuj u tha pra atyre,
Dot' u pyes juve një gjë, Esht' e udhësë të-
shëtunatë të bënjë njeriu mirë, a po të bënjë
keq? të shpëtonjë shpirt, a po të humpnjë?
10 Edhe passi vuri re rrotullë gjith' ata, i tha
njeriut, Ndej dorënë t'ënde. Edhe ay bëri
ashtu, edhe dor'e ati ubë e-shëndoshë posi
11 tjetëra. Po ata u-mbushnë mëri, edhe flisni-
në njëri me tjatrinë, ç' t' i bënjënë Jisujt.
12 Edhe nd' ato dit dolli ndë malt të falej,
edhe e shkoj natënë dyke falurë mbë Pe-
rëndinë.
13 Edhe kur ubë ditë, thirri nxënësit' e ti,
edhe sgjodhi nga ata dy-mbë-dhjetë, edhe i
14 quajti apostoj; Simoninë, të-cilinë edhe e qu-
ajti Pjetër, edhe Andrenë të vëllan' e ati, Ja-
15 kovin' edhe Joaninë, Filipin' e Varthollomenë,
Matthenë edhe Thomanë, Jakovin' e Alfeut,
16 edhe Simoninë që u-quajt Zilloti, Judhënë *të
vëllan'* e Jakovit, edhe Judhë Iskariotinë, i-cili
ubë edhe trathëtuar.
17 Edhe sbriti bashkë me ata, e qëndroj mbë
një vënt të-sheshm; edhe *ishinë* gjindje nga
nxënësit' e ati, edhe shumë shumicë llauzi
nga gjithë Judhea edhe nga Jerusalimi, edhe
nga an' e detit të Tyrës' e të Sidhonësë, të-
cilëtë erdhë të dëgjonin' atë, edhe të shëro-

BKSH

18 neshinë nga smundjet' e tyre; Edhe ata që
mundoneshinë prej frymave të-ndyra, edhe
19 shëroneshinë. Edhe gjithë gjindja kërkoninë
t'a prekninë; sepse dilte fuqi prej ati, edhe
shëronte të-gjithë.
20 Edhe ay, si ngriti syt' e ti mbë nxënësit'
e ti, thoshte,
Lum *ju* të-vobeqtë, sepse juaja është mbre-
21 tëri' e Perëndisë. Lum *ju* që keni uri tashti,
22 sepse dotë nginjeni. Lum *ju* që qani tashti,
sepse dotë qeshni. Të-lumurë jeni *ju*; kur
t' u kenë çmir juve njerëzitë, edhe kur t'u ve-
çonjënë, edhe t' u shanjënë, edhe t' u nxjerën'
emërinë për të-keq, për punë të Birit të një-
23 riut. Gëzohi nd' atë ditë edhe këceni; sepse
na paga juaj tek *është* e-shumë ndë qiellt;
sepse kështu u'a bëninë *edhe* profitërvet atë-
24 rit' e atyreve. Po mjerë ju të-pasuritë, sepse
25 e muartë ngushulliminë t' uaj. Mjerë ju të ngi-
njuritë, se dotë keni uri. Mjerë ju që qeshni
26 tashti, se dotë mbani zi e dotë qani, Mjerë ju,
kur (gjithë) njerëzitë të flasënë mirë për ju;
sepse kështu u'a bëninë edhe profitërvet gë-
njeshtarë atërit' e atyre.
27 Po u them juve që dëgjoni, Doni armiqtë
t' uaj; bëj-u-ni mirë atyreve që u kanë çmir;
28 Bekoni ata që u mallëkonjënë; edhe faluni
29 për ata që u dëmëtonjënë. Ati që të të bjerë
shuplakë ndë faqet, kthe-i edhe tjatrënë, edhe
ati që të merr rrobënë t' ënde, mos *i* ndalo

30 edhe këmishënë. Edhe kujdo që lypën prej
teje ep-i, edhe ati që merr të-tuatë, mos j'a
31 lyp prapë. Edhe sikundrë doni t'u bënjënë
juve njerëzitë, edhe ju bëni atyreve gjithashtu.
32 Edhe ndë daçi ata që u duanë juve, ç' farë
hiri kini ju? sepse edhe fajtorëtë duan' ata
33 që i duanë. Edhe ndë u bëfshi mirë atyreve
që u bënjënë mirë juve, ç'farë hiri keni ju? sepse
34 edhe fajtorëtë gjithatë bënjënë. Edhe ndë u
dhënçi hua *atyreve*, prej të-cilëvet shpreni t'i
merrni prapë, ç' farë hiri keni ju? sepse edhe
fajtorëtë u apënë hua fajtorëvet, që t'i ma-
35 rrënë prapë një për një. Po doni armiqtë
t'uaj, edhe bëni mirë, edhe epni hua, pa pa-
surë ndonjë shpresë më; edhe *atëhere* paga
juaj dotë jet' e-shumë, edhe dotë jini të bijt'
e të-Lartit; sepse ay ësht' i-mirë mb' ata që
nuk' j'a njohënë të-mirënë edhe mbë të-kë-
36 qinjtë. Bëhi pra të-përdëllyershim, sikundrë
edhe ati juaj ësht' i-përdëllyershim.
37 Edhe mos gjykoni, edhe nukë dotë gjy-
kohi; mos dënoni, edhe nukë dotë dënohi;
38 ndjeni, edhe dotë ndjehi. Epni, edhe dot' u
epetë juve; masë të-mirë, të-ngjeshur' e të-
tundur' e të-derdhurë prej buze dot' u apënë
ndë gjit t'uaj; sepse me gjith atë masë që
matni, dot' u matetë edhe juve.
39 Edhe u tha atyre *një* paravoli: mos munt
i-verbërë t'i heqë udhënë të-verbërit? a nukë
40 dotë bjenë që të dy ndë gropë? Nukë ka

nxënës përmbi mësonjësin' e ti; po çdo i-
mbaruarë *nxënës* dotë jetë si mësonjësi i ti.
41 Edhe përse shikon lëmishtenë që është
ndë syt të t' yt vëllaj, edhe tranë që është
42 ndë syt t' ënt nuk' e ndjen? Apo si munt
t'i thuash t' yt vëllaj, Vëlla, dal të nxjer lë-
mishtenë që ke ndë syt t' ënt, kur ti nukë
sheh tranë që *është* ndë syt t' ënt? Ipokrit,
nxir më përpara tranë prej syrit t' ënt, edhe
atëhere dotë shohç mirë të nxjerç lëmishte-
në që *është* ndë syt të t' yt vëllaj.
43 Sepse nukë ka dru të-mirë që të bënjë
pemë të-kalburë; as dru të-kalburë që të bë-
44 një pemë të-mirë. Sepse çdo dru njihetë prej
pemës' së ti; sepse nukë mbledhënë fiq nga
drizatë, as nukë vjelënë rrush nga ferratë.
45 Njeriu i-mirë nxjer të-mirënë prej thesarit të-
mirë të zëmërës' së ti; edhe njeriu i-lik nxjer
të-ligënë prej thesarit të-lik të zëmërës' së ti;
sepse goj' e ati flet nga të-tepërët' e zëmërësë
46 Edhe përse më thërritni, Zot, Zot, edhe
47 nukë bëni sa them? Kushdo që vjen tek unë,
edhe dëgjon fjalët' e mia, edhe i bën, dot' u
48 dëftenj juve me cilinë gjan; Gjan me *një*
njeri që ndërtonte *një* shtëpi, i-cili mihu e
thelloj, edhe shtyri themeli mbi shkëmpt; edhe
kur rrudhë ujëratë, upërpoq lumi kundrë a-
saj shëpie, edhe nukë mundi t'a tuntnjë; se-
49 pse ishte themelosurë mbi shkëmpt. Po ay që
te dëgjonjë e të mos bënjë, gjan me një njëri

që ndërtoj shëpi mbi dhet pa themeli; kun-
drë së-cilësë u-përpoq lumi, edhe për-një-here
ra, edhe të-rrëzuarët'e asaj shëpie ubë të-math

Krye 7

1 Edhe passi mbaroj gjithë fjalët' e ti ndë
veshët të llauzit, hyri ndë Kapernaum.
2 Edhe shërbëtori i një krye-qindësi, që e
kishtë shumë të-vëjyerë, ishte keq për të vde-
3 kurë. Edhe kur dëgjoj për Jisunë, dërgoj pleqt'
e Judhenjvet tek ay dyke lutur'ati të vint'e t'i
4 shpëtonte shërbëtorinë. Edhe ata erdhe te Jisuj
e i luteshinë me të-tepërë, dyke thënë, Se
ësht' i-vëjejturë ay, të-cilit dot' j'a bësh këtë;
5 Sepse ay e do kombinë t'ënë, edhe sinago-
6 gjinë ay na e ka ndërtuarë. Edhe Jisuj ecën-
te bashkë me ata.
Edhe atje tek ishte jo lark shtëpisë, krye-
qindësi dërgoj miq tek ay, dyke thënë ati,
Zot, mos u-mundo, sepse nukë jam i-zoti që
7 të hynjç ndënë strehët t' ime; Përandaj as
vetëhenë t'ime s'e gjeta të-vëjejturë të vinj
tek ti; po thuaj një fjalë, edhe shërbëtori im
8 dotë shëronetë. Sepse edhe unë jam një njeri
ndënë urdhër, edhe kam ndënë vetëhenë t'ime
shërbëtorë; edhe i them këti, Ecë, edhe vete;
edhe tjatërit, Eja, edhe vjen; edhe shërbëto-
9 rit t'im, Bëj këtë, edhe e bën. Edhe Jisuj kur
dëgjoj këto, uçudit për atë, edhe ukthye, e i
tha gjindjesë që i vinte pas, Po u them juve,

se as ndë Israilt s'kam gjeturë kaqë besë.
10 Edhe ata që ishinë dërguarë, kur ukthyenë
ndë shëpit, gjetnë shërbëtorin' e-smurë të-
shëndoshurë.
11 Edhe mbë të-nesërmet *Jisuj* vinte ndë *një*
qytet që quhej Nain; edhe vininë bashkë me
atë *edhe* mjaft nga nxënësit' e ti, edhe shumë
12 gjindje. Edhe kur uafërua ndë portët të qy-
tetit, ja tek sillninë përjashta një të-vdekurë,
të-cilinë e ëma *e kishte* bir të-vetëmë, edhe
ajo *ishte* e-ve; edhe shumë gjindje *prej* qy-
13 tetit ishte kashkë me atë. Edhe Zoti kur pa
atë, i erdhi keq për atë, edhe i tha asaj, Mos
14 qaj. Edhe uafërua e zuri shtratinë; edhe ata
që e mbaninë qëndruanë; edhe tha, Djalosh,
15 po të them, ngreu. Edhe i-vdekuri ungrit e
ndënji, edhe zuri të flasë. Edhe j'a dha s'
16 ëmësë. Edhe të-gjithëve u hyri frikë, edhe
lavduroninë Perëndinë, dyke thënë, Se profit
i-math është ngriturë ndër ne, edhe se Pe-
17 rëndia vuri re llauzin' e ti. Edhe dolli kjo
fjalë për atë ndëpër gjithë Judhenë, edhe ndë-
për gjithë vëndetë rrotullë.
18 Edhe nxënësit' e ti i dhanë zë Joanit për
gjithë këto.
19 Edhe Joani thirri përanë dy *veta* nga nxë-
nësit' e ti, e i dërgoj te Jisuj, dyke thënë, Ti
je ay që ka për të ardhurë, apo presmë tje-
20 tërë? Edhe njerëzitë, si erdhë tek ay, thanë,
Joan Pagëzori na ka dërguarë te ti, dyke

thënë, Ti je ay që ka për të ardhurë, apo
21 presmë tjetërë? Edhe nd' atë ore *ay* shëroj
shumë *veta* nga smundjet' e nga mundimet'
e nga frymat' e-liga, edhe shumë të-verbërve
22 u fali të-parëtë. Edhe Jisuj upërgjeq e u tha
atyre, Ecëni e epni zë Joanit për gjithë sa
patë e dëgjuatë, se të-verbërë shohënë, të-
çalë ecëjnë, të-krromosurë qëronenë, të-shur-
dhërë dëgjonjënë, të-vdekurë ngjallenë, të-
23 vobeq dëgjonjënë zën' e-mirë; Edhe lum ay
që të mos skandhalisetë mbë mua.
24 Edhe passi iknë ata që ishinë dërguarë
nga Joani, zuri t' i thoshte gjindjesë për Joa-
ninë, Ç' kini dalë ndë shkretëtirët të shihni?
25 kallam që tundetë nga era? Po ç' kini dalë të
shihni? njeri të-veshurë *me* rroba të-buta?
na ata që janë veshurë me rroba të-ndritura
e që rrojnë ndër të-kënaqura tek janë ndëpër
26 *dyert* të mbretërvet. Po ç' kini dalë të shih-
ni? profit? Po, u them juve, edhe më tepërë
27 se profit. Ky ësht' *ay*, për të-cilinëështё
shkruarë, „Na unë tek po dërgonj ëngjëlinë
t' im përpara faqesë s' ate, ay dotë ndreq-
28 një udhënë t' ënde përpara teje.“ Sepse po u
them juve, ndë mest t' atyre që kanë lindurë
prej grash asndonjë nuk' është më i-math
profit se Joan pagëzori; po m' i-vogëli ndë
mbretërit të Perëndisë eshte më i-math se ay.
29 Edhe gjithë llauzi që dëgjuan' *atë*, edhe
kumerqarëtë, drejtëruanë Perëndinë, dyke pa-

BKSh

gëzuarë vetëhen' e tyre me pagëzimn' e Joa-
30 nit. Po Farisenjt' edhe nomtarëtë e hodhë tej
prej vetëhes' së tyre andën' e Perëndisë, sepse
nuk' upagëzuanë prej ati.
31 (Edhe Zoti tha), Me se t' i përgjanj pra
njerëzit' e këti brezi? edhe me se gjanjënë?
32 Gjanjenë me çuna që rrinë ndë trekt edhe që
thërresënë njeri tjatrit, dyke thënë, I ramë
fyellit për ju, edhe nukë këcyetë; u bëmë
33 vajë, edhe nukë qatë. Sepse erdhi Joan Pa-
gëzori, që as bukë ha, as verë pi, edhe tho-
34 ni, *se* ka djallë. Erdhi i Bir' i njeriut dyke
ngrën' e dyke pirë, edhe thoni, Na njeri ha-
mës e verë-pirës, mik i kumerqarëve e i faj-
35 torëve. Edhe udrejtërua urtësia prej gjithë
bijvet të saj.
36 Edhe një nga Farisenjtë i lutej të hajë
bashkë me atë; edhe *ay* hyri ndë shtëpit të
të Fariseut, edhe ndënji ndë mësallët.
37 Edhe javoka një grua nd' *atë* qytet, e-ciia
ishte fajtore, kur mori vesh, se kishte rënë
ndë shtëpit të Fariseut, pruri *një* allavastrë
38 me vaj erërash; Edhe ndënji prapa piranë
këmbëvet t'ati dyke qarë, edhe zuri e lakte
këmbët' e ati me lottë, edhe j'a fshinte me
flokët'e kres'së saj, edhe puthte këmbët' e
39 ati, edhe *j'a* lyente me vajn'e erëravet. Edhe
Fariseu që e kish thërriturë, kur pa, tha me
vetëhen' e ti, dyke thënë, Ky po të ishte pro-

BKSH

fit, dotë njihte cila edhe ç'farë gruaje *ësht'*ajo
që e prek, se është fajtore.
40 Edhe Jisuj upërgjeq e i tha ati, Simon,
diç kam të të them. Edhe ay i thotë, Mëso-
41 njës, thuaj. Një hua-dhënës kishte dy detorë;
njëri i kishte detyrë pesë qint dinarë, edhe
42 tjatëri pesë-dhjetë. Edhe passi nukë kishinë
t'j'a lajnë, u'a fali të dyve. Thuaj pra, cili
43 nga ata dot'e dojë më tepërë? Edhe Simoni
upërgjeq e tha, Më duketë, se ay, të-cilit i
fali më të-shumatë. Edhe ay i tha, Drejtë
gjykove.
44 Edhe si ukthye nga gruaja, i tha Simonit,
A e sheh këtë grua? Hura ndë shtëpit t'ën-
de, *edhe ti* nukë më dhe ujë *për të larë* këm-
bëtë; po ajo me lottë me lagu këmbëtë, edhe
45 me flokët' (e kres'së saj) i fshiu. *Ti* nuke
më puthe; po ajo, që kur hyra, nukë pushoj
46 dyke puthurë këmbët'e mia. *Ti* me vaj nukë
më leve kryetë; po ajo me vaj erërash më
47 leu këmbëtë. Përandaj, po të them, janë ndje-
rë fajet'e asaj të-shumë; sepse deshi shumë;
48 po ati që i ndjenenë pak, pak do. Pastaj i
49 tha asaj, Të janë ndjerë fajetë. Edhe ata që
kishinë ndënjurë ndë mësallët zunë të thonë
me vetëhen'e tyre, Cili është ky që edhe
50 faje ndjen? Edhe ay i tha gruasë, Besa jote
të shpëtoj; hiq ndë paqtim.

Krye 8

1 Edhe pastaj ay vij qytet mbë qytet e
fshat mbë fshat, dyke lëçitur'e dyke dhënë
zën'e-mirë për mbretërin'e Perëndisë; edhe
2 të dy-mbë-dhjetët' *ishinë* bashkë me atë, Edhe
ca gra që ishinë shëruarë nga fruma të-kë-
qia e nga smundje, Maria, që quhej Magdha-
linë, prej së-cilësë patnë dalë shtatë djaj,
3 Edhe Joana e shoqeja e Huzajt, kujdestarit
të Irodhit, edhe Susanna, edhe shumë të-tje-
ra, të-cilat'i shërbeninë me pasjen'e tyre.
4 Edhe si umbloth shumë gjindje, edhe vi-
ninë tek ay prej ç'do qyteti, foli me paravoli.
5 Dolli mbjellësi të mbillte farën'e ti; edhe
ay tek po mbillte, ca ra përanë udhësë, edhe
6 ushkel, edhe shpest'e qiellit e hëngrrë. Edhe
tjatërë ra mbi gur, edhe posa mbiu utha
7 sepse nukë kishte lagësirë. Edhe tjatërë ra
ndë mest të drizavet, edhe si mbinë drizatë
8 bashkë me atë, e mbytnë. Edhe tjatërë ra
mbë dhe të-mirë, edhe si mbiu, dha pemë
për një një qint. Dyke thënë këto, thërriste,
Kush ka veshë për të dëgjuarë letë dëgjonjë.
9 Edhe nxënësit' e ti e pyetninë, dyke thë-
10 në, Ç'do të jetë këjo paravoli? Edhe ay tha,
Juve u është dhënë të njihni fshetësirat'e
mbretëris'së Perëndisë; po të-tjerëvet me pa-
ravoli, që dyke parë të mos shohënë, edhe
11 dyke dëgjuarë të mos kupëtonjënë. Edhe pa-
ravolia është këjo:

BKSH

12 Fara është fjal'e Perëndisë; Ato përanë
udhësë jan'ata që dëgjonjénë; pastaj vjen
djalli, edhe ngre fjalënë prej zëmërës' s'atyre,
13 që të mos besonjënë e të shpëtonjënë. Edhe
ato mbi gurt *jan' ata,* të-cilëtë, kur dëgjonjë-
në, me gëzim e presënë fjalënë; po këta
s' kanë rrënjë; sepse ata besonjënë për ca
kohë, po ndë kohët të ngasjesë hiqenë lark.
14 Edhe ajo që ra ndër drizat, këta janë ata
që dëgjuanë, po nga kujdesetë e nga pasja
e nga kënaqjet'e *këtij* jetë shkonjën' e mby-
15 tenë, e nukë bënjënë pemë. Edhe ajo *që ra*
ndë dhet të-mirë, këta jan'ata që dëgjuanë
fjalënë, edhe e mbanjënë ndë zemërë të-mir' e
të-qëruarë, edhe bënjënë pemë me durim.
16 Edhe as ndonjë kur ndes kandile nuk'e
mbulon me enë, a e vë ndënë shtrat; po e
vë mbi kandiler, që të shohënë dritënë ata
17 që hynjënë. Sepse nukë ka ndonjë të-fshehu-
rë që nuku dotë çfaqetë; as të-fshehëtë që
nukë dotë merretë vesh, e të dalë për faqe
18 Vështroni pra qysh dëgjoni; sepse ati që ka,
dot' i epetë; po ati që s'ka, edhe ajo që pan-
deh se ka dotë merretë prej ati.
19 Edhe erdhë tek ay e ëma edhe të vëlle-
zërit'e ti, edhe nukë muntninë për gjindjenë
20 t'i afëroneshinë. Edhe i dhanë zë, dyke thë-
në, Jot'ëmë edhe t' ët vëllezër po rrinë jash-
21 të, edhe duanë të të shohënë. Po ay upër-

BKSH

gjeq e u tha atyre, Mëmë e vëllezër më janë
këta që dëgjonjënë fjalënë edhe e bënjënë.
22 Edhe një ditë hyri ndë lundrë ay edhe
nxënësit'e ti, edhe u tha atyre, Letë shkojmë
23 nd'*anët* të-përtejme të lëqerit. Edhe lëshuanë.
Edhe ata tek ishinë dyke lundruarë, e zuri
gjumi. Edhe sbriti një thëllim ere ndë lëqert;
edhe *lundra* po mbushej me ujë, edhe ishinë
24 ndë rrëzik. Edhe *ata* erdhë përan'ati, edhe
e sgjuanë, dyke thënë, Mjeshtër, mjeshtër, po
humbemi. Edhe ay ungrit e qërtoj erënë edhe
valët'e ujit; edhe pushuanë, e ubë bunacë.
25 Edhe u tha atyre, ku është besa juaj? Edhe
ata ufrikësuan'e uçuditnë, dyke thënë njëri
tjatërit, Vallë cili është ky që urdhëron edhe
erërat'edhe ujëtë, edhe e ndigjonjënë.
26 Edhe me lundrënë arritnë ndë véntt të
27 gadharinëvet, që është përtej Galilesë. Edhe
kur dolli mbë tokët, i dolli përpara një nje-
ri prej qytetit, që kishte djaj prej shumë vjet-
ve, edhe rrobë nukë vishte, edhe ndë shtëpi
28 nukë rrinte, po ndëpër varret. Edhe kur pa
Jisunë, bërtiti e i ra ndër këmbë, e me zë
të-math tha, ç'ke me mua, Jisu, i bir' i Perën-
29 dis' së-Lartë? të lutem, mos më mundo. Sepse
ay urdhëroj frymën' e-ndyrë të dalë nga nje-
riu; sepse prej shumë vjetve e kishte rrëm-
byerë, edhe lidhej me vargje, edhe ruhej me
hekura këmbësh; po ay i këputte të-lidhura-
të, edhe sillej prej djallit ndëpër shkretëtirat.

BKSH

30 Edhe Jisuj e pyeti, dyke thënë, Ç' t'a *thonë*
emërinë? Edhe ay i tha, Legjeon; sepse ki-
31 shinë hyrë tek ay shumë djaj. Edhe i lute-
shinë të mos i urdhëronte të shkoninë ndë
32 pafundjet. Edhe atje ishte një tuf'e madhe
derrash dyke kuloturë ndë malt; edhe i lu-
teshinë t'i lij të hynjënë ndër ata; edhe *ay*
33 i la. Edhe djajtë si duallë prej njeriut, hynë
ndë derrat; edhe tuf'e derravet udruth prej
34 shkëmbit ndë lëqert, edhe umbyt. Edhe kullo-
tësitë kur panë se ç'ubë iknë; edhe van' e
35 dhanë zë ndë qytett e ndëpër arat. Edhe
duallë të shihninë se ç'ubë; edhe erdhë te
Jisuj, edhe e gjetnë njerinë, prej të-cilit kishi-
në dalë djajtë, dyke ndënjurë përanë këm-
bëvet të Jisujt, të-veshur'e të-urtësuarë; edhe
36 u frikësuanë. U treguan' edhe ata që e pa-
në, qush shpëtoj i-djallosuri.
37 Edhe gjithë shumica e vëndevet rrotullë
Gadharinëvet i luteshinë të ikënjë nga ata,
sepse i kishte zënë frik' e-madhe; edhe ay
hyri ndë lundrët, e ukthye.
38 Edhe njeriu, prej të-cilit kishinë dalë djajtë
i lutej të jetë bashkë me atë; po Jisuj e lë-
39 shoj, dyke thënë, Kthehu ndë shtëpi t' ënde,
edhe rrëfe *gjithë* Sa bëri Perëndia mbë ty.
Edhe ay shkoj dyke lëçiturë ndëpër gjithë
qytetnë sa bëri Jisuj mb' atë.
40 Edhe kur ukthye Jisuj, gjindja e priti *me gë-
zim*; sepse të-gjithë ishinë dyke pritur' atë.

41 Edhe ja tek erdi një njeri që quhej Jair, (e-
dhe ky ishte i-pari i sinagogjisë), e ra ndër
këmbët të Jisujt, e i lutej të hynte ndë shtëpit
42 t'àti; Sepse kishte një bijë tëve-tëmë, sindonja
dy-mbë-dhjetë vjeç, edhe ajo po vdiste.
Edhe ay tek ishte dyke vaturë, gjindja
43 po e shtrëngoninë. Edhe një grua, që kishte
të-rrjedhurë gjaku dy-mbë-djetë vjet, e-cila
kishte prishur gjithë gjënë ndëpër mjekësit,
po nukë mundi të shëronej as prëj ndonjëj,
44 Uafërua së-prapësmi, edhe preku pëqin' e
rrobës' s' ati; edhe sa-kaqë-herash i unda-
45 lua të-rrjedhurit' e gjakut. Edhe Jisuj tha,
Kush qe ay që më preku? Edhe tek po
mohoninë të-gjithë, Pjetri edhe ata që ishinë
bashkë me atë thanë, Mjeshtër, gjindja të
46 shtypnjën' e *të* shtrëngonjënë, edhe *Ti* thua,
kush qe ay që me preku? po Jisuj tha, Di-
kush më preku, sepse unë mora vesh, se
47 fuqi dolli prej meje. Edhe gruaja kur pa se
nuk' ufsheh *dot*, erdhi dyke dridhurë, edhe i
ra ndër këmbë, e i rrëfeu përpara gjithë lla-
uzit për ç'farë pune e preku, edhe se ushë-
48 rua për-një-here, Edhe ay i tha asaj, kij
Zëmërë, bijë, besa jote të shpëtoj; hiq ndë
paqtim.
49 Edhe ay kur po fliste edhe, vjen një njeri
prej tëparit të sinagogjisë, e i thotë, Se jot'
50 bijë vdiq; mos e mundo mësonjësinë. Po Ji-
suj kur dëgjoj, upërgjeq, Mos kij frikë; veç

BKSH

51 beso, edhe dotë shpëtonjë. Edhe si hyri ndë
shtëpit, nukë la asnjë të hynte brënda, për-
veç Pjetrin' edhe Jakovin' edhe Joaninë, edhe
52 t'an' e vashësë edhe t'ëmënë. Edhe të-gjithë
po qanin' e ulërininë për atë. Edhe ay tha,
53 Mos qani; nukë vdiq, po po fle. Edhe e
54 qeshninë, dyke diturë se vdiq. Po ay si nxori
jashtë të-gjithë, e kapi prej dore, edhe thë-
55 rriti dyke thënë, O vashëzë, nrgeu. Edhe asaj
i erdhi fryma prapë, edhe ungrit për-një-here;
edhe *Jisuj* urdhëroj t'i epnin' asaj të hajë.
56 Edhe prindërit' e asaj uhabitnë; po ay i po-
rositi të mos i thonë njeriu se ç'ubë.

Krye 9.

1 Edhe *Jisuj* si thirri përanë të dy-mbë-dhjetë
nxënësit e ti, u dha fuqi e pushtet mbi gjithë
2 djajt, edhe të shëroninë smundje. Edhe i dër-
goj që të lëçisinë mbretërin' e Perëndisë, e
3 të shëroninë të smurëtë. Edhe u tha atyre,
Mos mbani gjë udhësë, as stëpinj, as trajstë,
as bukë, as ergjënt, as të kini nga dy *palë*
4 rroba. Edhe nd'atë shtëpi që të hyni, mbe-
5 tuni atje, edhe delni andej, Edhe sa *veta* që
të mos u presënë juve, kur të delni prej ati
qyteti, shkuntni edhe pluhurinë prej këmbë-
6 vet t'uaj, për dëshmi kundr' atyreve. Edhe
ata si duallë, shkoninë fshatravet, dyke dhë-
në zën'e-mirë, e dyke shëruarë tek do.
7 Edhe Irodhi katrurdhëratësi dëgjoj gjith'ato

që bëneshinë prej ati; edhe manitej, sepse
disa thoshinë, se Joani është ngjalurë prej
8 së-vdekurish; Edhe disa *thoshinë,* se Ilia u
duk; edhe të-tjerë, se është ngjalurë ndo një
9 prej profitërvet të-moçim. Edhe Irodhi tha,
Joanit un'i preva kryetë; po ky cili është, për
të-cilinë dëgjonj të-këtilla punë? edhe kërkon-
te t' e shihte.
10 Edhe apostojtë si ukthyenë i treguanë
gjithë sa bënë; edhe *ay* i mori me vetëhe,
edhe u hoq veçanë ndë një vënt të-shkretë
11 të një qyteti që quhej Vithsaidha. Edhe gjin-
dja kur e kupëtuanë, i vanë pas; edhe *ay*
si i priti, u fliste për mbretërin' e Perëndisë,
edhe ata që kishinë nevojë shërimi i shëronte.
12 Edhe dita zuri të thyhej; edhe të dy-mbë-
dhjetët' erdhë përanë e i thanë, Lësho gjin-
djenë të venë ndëpër fshatërat e ndëpër arat
rrotullë, e të rrinë, e të gjenjënë të-ngrëna;
13 sepse këtu jemi ndë vënt të-shkretë. Po *ay*
u tha, Ep-u-ni ju atyreve të hanë. Edhe ata
thanë, Ndër ne nukë gjëndenë më tepërë se
pesë bukë edhe dy pishqe; veç ndë vafshimë
na të blemë të-ngrëna për gjithë këtë llaus.
14 Sepse ishinë sindonja pesë mijë burra. Edhe
ay u tha nxënësvet të ti, Vini ata të rrinë
15 togje togje nga pëse-dhjetë. Edhe *ata* bënë
16 kështu, edhe i vunë të-gjithë të rrinë. Edhe
ay si mori të pesë bukëtë edhe të dy pish-
qetë, ngriti sytë ndë qiejt, edhe i bekoj, e i

BKSH

theu, edhe u'a dha nxënësvet t' i vënë për-
17 para gjindjesë. Edhe të-gjithë hëngrrë, e un-
gijnë; edhe ngritnë tepëricën' e copavet dy-
mbë-dhjetë kofinë.
18 Edhe ay tek falej veçanë, nxënësit' ishinë
bashkë me atë; edhe i pyeti, dyke thënë,
19 Cili thonë gjindja se jam unë? Edhe ata upër-
gjeqnë e thanë, Joan pagëzori; edhe të-tjerë,
Ilia; edhe të-tjerë, se është ngjallurë ndonjë
20 prej profitërvet të-moçim. Edhe *ay* u tha aty-
re, Po ju cili thoni se jam unë? Edhe Pjetri
21 u përgjeq e tha, Krishti i Perëndisë. Edhe ay i
qërtoj e i porositi të mos j' a thonë njeriu
22 këtë, Dyke thënë, se i Bir' i njeriut duhetë
të heqë shumë, edhe nukë dotë pëlqenetë
nga pleqt' e nga kryepriftërit' e nga shkro-
njësitë, edhe dotë vritetë, edhe të-tretënë ditë
dotë ngjalletë.
23 Pastaj u thoshte të-gjithëve, Kush të dojë
të vinjë prapa meje, letë mohonjë vetëhen' e
ti edhe letë ngrerë kryqin' e ti përdita, edhe
24 letë vinjë pas meje. Sepse kush do të shpë-
tonjë jetën' e ti, dot' a humpnjë; edhe kush të
humpnjë jetën' e ti për mua, ky dot' a shpë-
25 tonjë. Sepse ç' dobi ka njeriu, ndë fitoftë
gjithë botënë, e të humpnjë vetëhen' e ti a
26 t' a dëmëtonjë? Sepse kush të ketë turp për
mua edhe për fjalët' e mia, edhe i Bir' i nje-
riut dotë ketë turp për këtë, kur të vinjë ndë
lavdit të ti e të Atit e të ëngjëjvet të-shënj-

BKSH

27 tëruarë. Edhe po u them juve me të-vërtetë,
se Janë ca prej këtyre që rrinë këtu, të-cilë-
të nukë dotë ngjëronjënë vdekje, gjersa të
shohënë mbretërin' e Perëndisë.
28 Edhe pas këtyre fjalëve shkuanë sindo-
nja tetë dit, edhe *ay* mori me vetëhe Pjetrin'e
Joanin'e Jakovinë, edhe hipi ndë malt të falej.
29 Edhe tek falej i undërrua fytyr'e faqes'së ti
edhe rrobat'e ti ishinë të-bardha edhe vetë-
30 tininë. Edhe javoka dy burra tek po flisninë
bashkë me atë, të-cilët' ishinë Moisiu edhe
31 Ilia; Këta uduknë me lavdi, e thoshinë për
vdekjen' e ati që kishte për të mbushurë ndë
32 Jerusalim. Po Pjetri edhe ata qe ishinë ba-
shkë me atë ishinë rënduarë nga gjumi; edhe
kur usgjuanë, panë lavdin'e ati, edhe *ata* të
dy burratë qe rrijnë bashkë me atë.
33 Edhe tek ndaheshin' ata prej ati, Pjetri
i tha Jisujt, Mjeshtër, është mirë të jemi këtu;
edhe letë bëjmë tri tenda, një për ty, e një
për Moisinë, e një për Ilinë; pa diturë se
34 ç' thoshte. Edhe ay tek thoshte këto, erdhi
një re, e i mbuloj me hie; edhe ata ufrikë-
35 suanë, kur hynë ndë rët. Edhe erdhi një zë
nga qielli, dyke thënë. Ky është biri im i-
36 dashuri; dëgjoni atë. Edhe ndë të-ardhurit
të zërit, Jisuj ugjënt vetëmë. Edhe s'bënë zë
edhe asndonjëj nuk' i thanë ato dit për ndo-
një gjë nga ato që panë.
37 Edhe ditënë tjetërë, si sbritnë ata nga mali,

38 shumë gjindje i dolli përpara. Edhe na një
njeri prej gjindjesë tek bërtiti, dyke thënë
Mësonjës, të lutem, shtjerë sytë mbi t' im bir,
39 se e kam të-vetëmë. Edhe na tek e kap *një*
frymë, edhe bërtet papandehuraj, edhe e për-
pjek me shkumbë, edhe me zi ndahetë prej
40 ati dyke dërmuar'atë. Edhe u luçë nxënëset
të tu, që t' j' a nxjerrënë, po nukë muntnë.
41 Edhe Jisuj upërgjeq e tha, O bres i-pabesë
e i-shtrëmbërë, gjer kur dotë jem me ju,
edhe t' u duronj juve? bjerë t' ët bir këtu.
42 Edhe ay tek po vinte përanë, djalli e hodhi
poshtë edhe e përpoqi. Edhe Jisuj e qërtoj
frymën' e-ndyrë, edhe e shëroj djalënë, edhe
43 j' a dha prapë t'et. Edhe të-gjithë maniteshi-
në për madhërin' e Perëndisë.
Edhe tek çuditeshinë të-gjithë për gjithë
44 sa bëri Jisuj, u tha nxënëset të ti, Ju viri
ndë veshët t' uaj këto fjalë; sepse i Bir' i
45 njeriut dot' epetë ndër duart të njerëzet. Po
ata nuk' e kupëtoninë këtë fjalë, edhe ishte
e-fshehurë prej atyre që të mos e kupëtoni-
në; edhe kishinë frikë t' a pyetninë për këië
fjalë.
46 Pastaj hyri një mendim ndër ata, cili vallë
47 nga ata ishte më i-math. Edhe Jisuj kur pa
mendimin' e atyre, zuri *prej dore* një çun,
48 edhe e qëndroj përanë vetëhes' së ti, Edhe
u tha atyre, Ay që të presë këtë çun mb'e-
mërit t' im, mua më ka priturë; edhe ay që

të presë mua, ka pritur' atë që më dërgoj;
sepse ay që është më i-vogëlë ndër gjithë ju,
ky dotë jetë më i-math.
49 Edhe Joani upërgjeq e tha, Mjeshtër, pa-
më një njeri që nxjer djajtë mb' emërit t' ënt;
edhe e ndaluamë, sepse nukë vjen pas ba-
50 shkë me ne. Edhe Jisuj i tha, Mos e ndalni,
sepse ay që s'është kundrë nesh, është ba-
shkë me ne.
51 Edhe kur po mbusheshinë dittë që dotë
merrej lart *nde qiejt*, atëhere ay shtyri syn'e
52 ti të vejë ndë Jerusalim. Edhe dërgoj zë-
dhënës përpara vetëhes' së ti, të-cilëtë van' e
hynë ndë një fshat të Samaritëvet, për të
53 bërë gati *vënt* per atë. Edhe nuk' e pritn'atë,
sepse e kishte synë për të vaturë ndë Jeru-
54 salim. Edhe nxënësit' e ti Jakov e Joan kur
panë, thanë, Zot, a do të themi të sbresë
zjarr nga qielli edhe t' i përvëlonjë, sikun-
55 drë bëri edhe Ilia? Po ay ukthye e i qërtoj,
56 edhe tha, Nuke dini e ç' farë frymë jini ju; Se-
pse i Bir' i njeriut nuk'erdhi të humpnjë shpir-
te njerëzish, po të shpëtonjë. Edhe vanë mbë
tjatërë fshat.
57 Edhe ata kur po ecëninë, një njeri i tha
udhësë, Zot, dotë të vinj pas kudo të veç.
58 Edhe Jisuj i tha ati, Dhelpëratë kanë shtrof-
ka, edhe shpest' e qiellit të-ndënjura; po i
Bir' i njeriut s' ka ku të pshetnjë kryetë.
59 Edhe i tha një tjatëri, Eja pas meje. Edhe

BKSH

ay i tha, Zot, lërë-më më përpara të vete e
60 të kllas ndë dhet t' im atë. Po Jisuj i tha, Lërë
të-vdekuritë të kllasënë ndë dhet të-vdeku-
rit' e tyre; po ti ecë, e ep zë për mbretërin'
e Perëndisë.
61 Po edhe një tjetërë tha, Zot, dotë vinj
pas teje; po lërë-më më përpara të vete t'u
lë shëndet atyre që janë ndë shtëpit t' ime
62 Po Jisuj i tha, Kush vë dorën' e ti mbi par-
mëndë, edhe vështron prapa, nuk' është i-vë-
jyerë për mbretërin' e Perëndisë.

Krye 10

1 Edhe paskëtaj Zoti vuri edhe të-tjerë shta-
të-dhjetë *nxënës*, edhe i dërgoj dy nga dy
përpara ti, mbë çdo qytet e vënt, ku kishte
për të vatur' ay.
2 U thoshte atyre pra, Të-korrët' *është* të-
shumë, po punëtorëtë të-pakë; lutuni pra të
zott të të-korrit të nxjerrë punëtorë për të-
3 korrët' e ti. Ecëni; na unë tek po u dërgonj
4 juve posi shqera ndë mest të ujqërvet. Mos
mbani kuletë. as trajstë, as sholla; edhe as-
ndonjë mos përshëndoshni udhësë.
5 Edhe nd' atë shtëpi që të hyni, më për-
6 para thoni, Paqtim ndë këtë shtëpi. Edhe ndë
qoft' atje bir paqtimi, paqtimi juaj dotë prë-
hetë mb' atë; ndë mos, dotë kthenetë ndër ju.
7 Edhe mbetuni nd' atë shtëpi dyke ngrën' e
dyke pirë nga ato që *t' u apënë juve* ata; se-

BKSH

pse punëtori ësht' i zot' i pagës' së ti, mos
shkoni prej shtëpie mbë shtëpi.
8 Edhe nd' atë qytet që të hyni, edhe t' u
presënë juve, hani ato që t' u vënë përpara,
9 Edhe shëroni të-smurëtë që *gjendenë* nd' atë,
edhe thoni atyre, Mbretëri' e Perëndisë uafë-
10 rua te ju. Po nd' atë qytet që të hyni, edhe
të mos u presënë juve, kur të delni ndë-
11 për rugat, t' ati thoni, U shkuntmë juve edhe
pluhurinë që na u ngjit prej qytetit t'uaj; po
këtë të dini, se mbretëri' e Perëndisë uafërua
12 te ju. Edhe po u thom juve, se nd' atë ditë
më i-duruarshim dotë jetë mundimi ndë So-
dhomat, se nd' atë qytet.
13 Mjerë ti Horazin! mjerë ti Vithsaidha!
sepse po të ishinë bërë ndë Tyrët e ndë Si-
dhonët ato çudira që ubënë ndër ju, që kur
dot' ishinë penduarë dyke ndënjurë ndë thes
14 e ndë hi. Po ndë Tyrët e ndë Sidhonët më
i-duruarshim dotë jetë mundimi ndë *ditët* të
15 gjyqit se mbë ju. Edhe ti Kapernaum, që u-
lartësove gjer ndë qiellt, dotë sbreç gjer ndë
hadht.
16 Ay që u dëgjon juve, dëgjon mua; edhe
ay që nuk' u zë për gjë juve, nukë zë për
gjë mua; edhe ay që nukë zë për gjë mua,
nukë zë për gjë atë që më ka dërguarë.
17 Edhe të-shtatë-dhjetët' ukthyenë me gëzim,
dyke thënë, Zot, edhe djajtë na dëgjonjënë
18 mb' emërit t' ënt. Edhe *ay* u tha atyre, Vësh-

tronjam Satananë dyke rënë nga qielli posi
19 vetëtimë. Na tek po u ap juve pushtet që të
shkelni përmbi gjërpënj e përmbi përçollakë,
edhe mbi gjithë fuqin' e armikut; edhe as-
20 ndonjë gjë s'u ka për të bërë keq juve. Po
mos ugëzoni për këtë, se u ndigjonjënë juve
frymat' e-ndyra; po gëzohi më tepërë, se e-
mëratë t'uaj ushkruajtnë ndë qiejt.
21 Edhe nd' atë orë Jisuj ugëzua ndë shpirt,
edhe tha, Të falem ndersë, o Atë, Zot i qiellit
edhe i dheut, se fsheve këto nga të-diturit' e
nga të-mënçimitë, edhe u'a sbulove foshnjavet;
po, o Atë, se kështu upëlqye përpara teje.
22 Të-gjitha m' udhanë ndë dorë prej t' im Et;
edhe asndonjë nukë di cili është Biri, veç
Ati; edhe cili është Ati, veç Biri, edhe ay, të-
cilit të dojë biri t' j'a sbulonjë.
23 Edhe ukthye te nxënësitë, e tha veçanë,
24 Lum ata sy që shohënë këto që shihni. Se-
pse po u thëm juve, se shumë profitër edhe
mbretër deshnë të shihnin' ato që shihni ju,
po nuk' i panë; edhe të dëgjonin' ato që dë-
gjoni ju, po nuk' i dëgjuanë.
25 Edhe na tek ungrit një nomtar, dyke ngar'
atë, e dyke thënë, Mësonjës, ç' të bënj, që të
26 trashëgonj jetën' e-përjetëshme? Edhe ay i tha,
Ç' është shkruarë ndë nomt; qysh këndon?
27 Edhe ay upërgjeq e tha, „Të duash Zonë Pe-
rëndinë t' ënt me gjithë zëmërë t' ënde, edhe
me gjithë shpirtinë t' ënt, edhe me gjithë fu-

BKSH

qinë t' ënde, edhe me gjithë mëndjenë t' ën-
de;" edhe „të-afërminë t' ënt posi vetëhenë
28 t' ënde." Edhe ay i tha, upërgjegje drejtë; bëj
29 këtë, edhe dotë ronjç. Po ay, dyke dashurë
të nxjerrë vetëhen' e ti të-drejtë, i tha Jisujt,
E cili më ësht' i-afërm?
30 Edhe Jisuj upërqjeq e tha, Një njeri sbriste
nga Jerusalimi ndë Jeriho edhe ra ndër duar
kursarësh; të-cilëtë si e sveshnë, edh' e bënë
me plagë, ikn' edhe e lanë për gjysmë të-
31 vdekurë. Edhe qëlloj të shkonj' asaj udhe një
prift; edhe kur pa atë, shkoj nga ana tjatërë.
32 Kështu edhe një Levit, posa arriti nd' *atë* vënt,
33 erdhi e pa, edhe shkoj nga ana tjatërë. Po
një Samarit, dyke udhëtuarë, erdhi ndë véntt,
34 tek ishte *ay*, edhe kur e pa, i udhëmp; Edhe
erdhi përanë, e i lidhi plagëtë, dyke der-
dhurë *mbi ato* vaj e verë; edhe e hipi ndë
kafshët të ti, edhe e solli ndë një huajpritje,
35 edhe ukujdes për atë. Edhe mbë të-nesërmet
kur dotë dilte, nxori dy dinare, edhe j'a dha
huajpritësit, edhe i tha, Kujdesu për këtë njeri;
edhe ç' të prishç më tepërë, unë, kur të kthe-
36 nem, t'i kam për të dhënë. Cili nga këta të
tre të duketë se ubë i-afërm' i ati që ra ndë
37 duart të kursarëvet? Edhe ay i tha, ay që bëri
përdëllim mb' atë. Jisuj pra i tha, Ecë, edhe
ti bëj kështu.
38 Edhe ata kur po shkoninë, ay hyri ndë
një fshat; edhe një grua *që e kishte* emërinë
39 Marthë, e priti ndë shtëpit të saj. Edhe ajo

kish një motërë që quhej Marie, e-cila ndënji
përanë këmbëvet të Jisujt, edhe dëgjonte fja-
40 lën' e ati. Edhe Martha mundonej shumë dyke
shërbyerë; edhe pastaj erdhi përpara ati, e
tha, Zot, nukë do të dish, se ime motrë më
la vetëmë të shërbenj? thuaj pra asaj të më
41 ndihnjë. Edhe Jisuj upërgjeq e i tha asaj,
Marthe, Marthe, përpiqesh e mundonesh për
42 shumë *punë*; Po për një është nevojë; edhe
Maria sgjodhi pjesën' e mirë, e-cila nukë dotë
merretë prej asaj.

Krye 11

1 Edhe ay tek po falej ndë një vënt, si pu-
shoj, një nga nxënësit' e ti i tha, Mëso-na
të falemi, sikundrë edhe Joani mësoj nxënë-
sit' e ti.
2 Edhe ay u tha atyre, kur të faleni, thoni,
Ati ynë, që *je* ndë qiejt, ushënjtëroftë e-
mëri yt; arthtë mbretëria jote; ubëftë dashu-
3 rimi yt, si ndë qiell, edhe mbi dhet. Bukënë
4 t'ënë të-përditëshmen' ep na neve përdita; E-
dhe fal-na fajetë t'anë, sepse edhe neve j' a
falmë kujdo që na fëjen; edhe mos na shtjerë
ndë ngasje, po spëto-na prej të-ligut.
5 Pastaj utha atyre, Cili prej jush, ndë pastë
një mik, edhe të vejë tek ay ndë mest të
natësë, e t' i thotë, Mik, huaj-më tri bukë;
6 Sepse erdhi një miku im prej udhësë tek unë,
7 edhe s'kam ç't'i vë përpara; Edhe ay të për-

BKSH

gjigjetë që brënda e t'i thotë, Mos më ep
mundim; dera tashi është mbyllurë, edhe çu-
nat' e mi janë ndë shtrat bashkë me mua;
8 S'munt të ngrihem e të t'ap? Po u them
juve, Edhe ndë mos ungrittë e t'i apë, sepse
është miku i ati, për të-mosturpëruarët' e ati
9 dotë ngrihet' e dot' i apë sa i duhenë. Edhe
unë po u them juve, Lypni, edhe dot' u e-
10 petë juve; kërkoni, edhe dotë gjeni; troko-
llini, edhe dot' u hapetë juve. Sepse kushdo
që lypën merr; edhe ay që kërkon gjen; e-
dhe ati që trokëllin dot' i hapetë.
11 Edhe ndë *është* ndonjë prej jush atë, edhe
i biri ndë i kërkoftë bukë, mos dot' i apë
gur? a po ndë *i lyptë* peshk, mos dot' i apë
12 gjarpér ndë vëntt të peshkut? Apo ndë i kër-
13 koftë ve, mos dot' i apë përçollak? Ndë ju
pra që jini të-liq dini t' u epni bijvet t' uaj
të-dhëna të-mira, sa më tepërë Ati që *është*
prej qielli dot' u apë Frymë të-Shënjtëruarë
atyre që të lypnjënë prej ati?
14 Edhe ishte dyke nxjerë një djall, edhe ay
ishte i-shurdhërë; edhe djalli kur dolli, i-
15 shurdhëri foli; edhe gjindja uçuditnë. Po ca
nga ata thanë, *Se* nxjer djajtë me anë të
16 Veelzevulit, të-parit të djajvet. Edhe ca të-
tjerë dyke ngar' atë kërkoninë prej ati Shë-
17 një nga qielli. Po ay si kupëtoj mendimet'
e atyre, u tha, Çdo mbretëri, që ndahetë
kundrë vetëhes' së saj, shkretonetë; edhe një

shtëpi, *që* ndahetë kundrë vetëhes' së saj,
rrëzonetë. Edhe Satanaj pra ndë qoftë se u-
18 nda kundrë vetëhes' së ti, qysh dotë qëndro-
një mbretëri' e ati? sepse thoni se unë nxjer
19 djajtë me anë të Veelzevulit. Edhe ndë nxjer
unë djajtë me anë të Veelzevulit, bijtë t'uaj
me anë të cilit i nxjernjënë? përandaj ata
20 dotë jenë gjykatësitë t'uaj. Po ndë nxjer *unë*
djajtë me gishtin e Perëndisë, pa fjalë mbre-
21 tëri' e Perëndisë arriu mbë ju. I-forti kur
ruan i-armatosurë avllin' e ti, *gjithë* gjëj' e ati
22 është ndë paqtim; Po kur vjen m' i-forti se
ay e munt, i mer gjithë armët' e ati, mbë të-
cilat shprente, edhe ndan plaçkat' e ati,
23 Kush nuk' është me mua, është kundrë meje;
edhe kush nukë përmbleth bashkë me mua,
24 përndan. Frym' e-ndyrë kur del prej njëriut.
vete ndëpër vënde të-thatë, *pa ujë*, edhe
kërkon të-prëjturë; edhe dyke mos gjeturë,
thotë, Le të kthenem ndë shtëpit t' ime, prej
25 së-cilësë dolla. Edhe kur vjen, e gjen fshir'
26 e stolisurë. Atëhere vete e merr me vetëhe
shtatë fryma të-tjera më të-këqia se vetëhen'
e saj, edhe hynjën' e rrin' atje; edhe të-pastaj-
met'e ati njeriu bënenë më të-këqia se të-paratë.
27 Edhe ay kur po thoshte këto, një grua
prej gjindjesë ngriti zë e i tha, Lum barku që
të ka mbajturë, edhe gjijtë që ke thëthiturë.
28 Po ky tha, Lum më tepërë ata që dëgjonjënë
fjalën' e Perëndisë edhe e ruanjënë.

BKSh

29 Edhe gjindja tek po mblidhej, zuri të
thotë, ky bres ësht' i keq; shënje kërkon;
edhe shënjë nukë dot' i epetë përveç shënjës
30 së profitit Jona. Sepse sikundrë Jonaj ubë
shënjë ndë Ninevitët, kështu edhe i Bir' i nje-
31 riut do të jetë ndë këtë bres. Mbretëresh' e
mesditësë do të ngrihetë ndë *ditët të* gjyqit
bashkë me njerëzit' e këti brezi, edhe dot' i
dënonjë; sepse erdhi nga anët' e të-mbaruarit
të dheut që të dëgjonjë urtësin' e Sollomonit;
edhe na këtu *ka* më tepërë se Sollomoni.
32 Burrat' e Ninevisë dotë ngjallenë ndë gjyqt
bashkë me këtë bres, edhe dot' e dënonjënë;
sepse upenduanë ndë të lëçiturit të Jonajt;
edhe na këtu *ka* më tepërë se Jonaj.
33 Edhe as ndonjë, kur ndes kandile nuk' e
vë *ndë vënt* të fshehurë, as ndënë shënikt, po
e ve mbi kandilert, që të shohënë dritënë ata
34 që hynjënë brënda. Kandil' i trupit është syri:
syri yt pra kur ësht' i qëruarë, edhe gjithë
trupi yt ësht' i-ndriturë; po kur' ësht' i-keq,
35 edhe trupi yt *ësht'* i-errëtë. Vështro pra drita
36 që është te ti se mos jetë errësirë. Ndë qoftë
pra gjithë trupi yt i-ndriturë, pa pasurë ndo-
një anë t' errëtë, dotë jetë i-tër' i-ndriturë,
posi kandileja kur të ndrit me dritën' e saj
të-fortë.
37 Edhe si foli *këto* një Farise i lutej ati të
vejë për drekë tek ay; edhe *ay* hyri e ndë-
nji ndë mësallët.

38 Edhe Fariseu uçudit, kur pa, se nuk' u la
39 përpara drekësë. Edhe Zoti i tha, Tashi ju
Farisenjtë qëroni të-përjashtësmen' e qeftit e
të kupësë; po e-përbrëndëshmja juaj është
40 plot me rrëmbim e me të-keq. Të-marrë, ay
që bëri të-përjashtësmenë, a nukë bëri edhe
41 të-përbrëndëshmenë? Veç epni eleimosinë
gjënë *t'uaj*, edhe na të-gjitha tek janë të-që-
42 ruara te ju. Po mjerë ju Farisenjtë! sepse
epni të-dhjetën' e mëndres' e të piganit e të
çdo lakre, edhe lini mbë nj' anë gjyqin' e da-
shurin' e Perëndisë. Këto duhej të bënitë, e-
43 dhe ato të mos i linitë. Mjerë ju Farisenjtë!
sepse doni vëndin' e-parë ndëpër sinagogjit,
edhe të-përshëndoshuratë ndëpër tregjet.
44 Mjerë ju shkronjës e Farisenj, ipokritër, se
jini po si varretë që s'dukenë, edhe njerëzitë
që ecëjnë përsipërë nukë dinë.
45 Edhe një nga nomtarëtë upërgjeq e i tha,
Mësonjës, dyke thënë këto shan edhe neve,
46 Edhe ay tha, Mjerë edhe ju nomtarëtë! sepse
ngarkoni njerëzitë me barrë të-rënda që s'
mbahenë, edhe ju *as* me njërin' e gishtërvet
47 t'uaj nuk' i prekni barëtë. Mjerë ju! sepse
ndërtoni varret' e profitërvet, edhe atëritë t'
48 uaj i vranë. Me të vërtetë dëshmoni edhe
pëlqeni punët' e atërvet t' uaj; sepse ata i
49 vranë, edhe ju ndërtoni varret' e atyreve. Pë-
randaj edhe urtësi' e Perëndisë tha, Do të
dërgonj ndër ata profitër e apostoj, edhe *disa*

BKSH

prej atyreve dot' i vrasënë, edhe dot' i ndje-
50 kënë; Që të kërkonetë prej këti brezi gjaku
i gjithë profitërvet që është derdhurë që kur
se është ngrehurë bota, që prej gjakut t'A-
51 velit *e* gjer mbë gjakt të Zaharisë, Që uvra
ndë mest të therores' e të tempullit; vërtet,
po u them juve, dotë kërkonetë prej këti
52 brezi. Mjerë ju nomtarëtë! sepse ngrittë ha-
pësin' e ditjesë; ju nukë hytë, po edhe ata që
hynjënë i ndaluatë.
53 Edhe ay tek u thoshte atyre këto, shkro-
njësit' edhe Farisenjtë zunë t' a ndisninë te-
përë, edhe t' a shtrëngoninë të fliste për shu-
54 më *punë*, Sepse kishinë ngrehurë lak për
atë, edhe kërkoninë të rëmbeninë ndonjë
fjalë prej gojës' s'ati, që ta përflasënë.

Krye 12

1 Ndë mest të këtyre *fjalëve*, si umblothnë
shumicat' e gjindjesë, kaqë sa shkelninë njëri
tjatërinë, zuri t' u thoshte nxënëset të ti, Më
parë *nga gjithë* ruani vetëhenë t' uaj nga
2 brum' i Farisenjet, që është ipokrisi. Po nukë
ka gjë të-mbuluarë, që s' është për të sbulu-
arë, edhe të-fshehurë, që s'është për të ma-
3 rrë vesh. Përandaj sa thatë nd' errësirët, dotë
dëgjonenë ndë dritët; edhe ç' foltë ndë vesht
ndëpër dhomat, dotë lëçitetë mbi kulmet *të-*
shtëpivet.
4 Edhe po u them juve miqvet të mi, Mos

kini frikë nga ata që vrasënë trupnë, edhe
pastaj s'kanë se ç'të bënjënë gjë më tepërë.
5 Po dot' u dëftenj juve prej cilit të kini frikë;
të kini frikë prej ati, i-cili passi të vrasë, ka
pushtet të hedhë ndë gjehenët. Me të-vërtetë
6 po u them juve, prej këti të kini frikë. A nukë
shitenë pesë zoq për dy aspre? edhe një
nga ata nuk' ësht' i-haruarë përpara Perën-
7 disë; Po edhe qimet' e kresë s' uaj janë nu-
mëruarë të-gjitha. Mos kini frikë pra; ju nda-
ni prej shumë zoqsh.
8 Edhe po u them juve, Kushdo që të më
rrëfenjë përpara njerësvet, edhe i Bir' i Pe-
rëndisë dot' e rrëfenjë përpara ëngjëjvet të
9 Perëndisë. Edhe kushdo që të më mohonjë
përpara njerësvet, dotë mohonetë përpara ën-
gjëjvet të Perëndisë.
10 Edhe kushdo që të thotë fjalë kundrë të
Birit të njeriut, dot' i faletë; po ati që të sha-
një kundrë Frymës' së-shënjtëruarë nukë dot'
i faletë.
11 Edhe kur t' u sjellënë juve ndëpër sina-
gogjit, e *ndëpër* urdhëratat, e *ndëpër* pushte-
tet, mos mendoni qysh a ç' të përgjigji, a ç'
12 të thoni; Sepse Frym' e-Shënjtëruarë dot' u
mësonjë juve nd' atë orë ç' duhetë të thoni.
13 Edhe një prej gjindjesë i tha, Mësonjës,
thuaj t' im vëllaj të ndanjë trashëgimnë bash-
14 kë me mua. Po ay i tha, O njeri, kush më
15 vuri gjykatës a ndanjës mbi ju? Pastaju tha

atyre, Vështroni edhe ruhi nga lakmimi; Se-
pse ndë pastë tepërë ndonjë, jet' e ati nukë
është bërë prej gjës' s'ati.
16 Edhe u tha atyre një paravoli, dyke thënë,
Një njeriu të-pasurë i erdhë mbarë aratë;
17 Edhe mendonej ndë vetëhet të ti, dyke thënë,
Ç' të bënj? se s' kam ku të mbleth pemët e
18 mia. Pastaj tha, Këtë kam për të bërë; dotë
prish grunarët' e mi, edhe dot' i bënj më të-
mëdhenj, edhe dotë mbleth atje gjithë dri-
19 thëtë t' im, edhe të-mirat' e mia; Edhe dot' i
them shpirtit t' im, O shpirt, ke shumë të-
mira që gjendenë për shumë vjet; prëhu, *e*
20 ha, *e* pi, e gëzohu. Po Perëndia i tha, I-ma-
rrë, këtë natë dotë lypnjënë prej teje shpir-
tinë t' ënt; edhe sa bëre gati, të kujt dotë
21 jenë? Kështu dotë jetë ay që mbleth the-
sarë për vetëhen' e ti, e nuk' bënetë i-pasurë
mbë Perëndinë.
22 Pastaj u tha nxënëset të ti, Përandaj po
u them juve, Mos kini kujdes për jetënë t' uaj,
ç' të hani; as për trupnë t' uaj, ç' të vishni.
23 Jeta është më e-vyerë se ushqimi, edhe tru-
24 pi se të-veshuritë. Viri re korbatë, se nukë
mbjellënë, as nukë korrnjënë; ata nukë kanë
as qilar as grunar, edhe Perëndia i ushqen;
25 sa më tepërë ndani ju nga shpestë? Edhe
cili prej jush dyke pasurë kujdes munt të
26 shtonjë një kut ndë shtatt të ti? Ndë *ju* pra
nukë muntni as më të-vogëlënë *gjë*, përse

BKSH

27 kini kujdes për të-tjeratë? Viri re luletë, qysh
rritenë; nukë mundonenë, as nukë drethnjë-
në; edhe po u them juve, *se* as Sollomoni me
gjithë lavdin' e ti nuk' ishte veshurë si një
28 nga këto. Po ndë qoftë se barinë, që sot është
nd' arë, edhe nesërë hidhetë ndë furrë, Pe-
rëndia e vesh kështu, sa më tepërë juve, o
29 besë-pakë? Edhe ju mos kërkoni ç' të hani
30 a ç' të pini; as mos jini me dy mëndje. Sepse
gjithë këto kërkonjënë kombet' e botësë; edhe
31 Ati juaj e di, se keni nevojë për këto. Po
kërkoni mbretërin' e Perëndisë, edhe këto të-
gjitha dot' u shtonenë juve.
32 Mos ki frikë, o tuf' e-vogëlë; sepse Atit
33 t' uaj i pëlqeu t' ua apë juve mbretërinë. Shitni
pasjetë t' uaj, edhe epni eleimosinë. Bëni për
vetëhenë t' uaj kuleta që nukë vjetëronenë,
thesar ndë qiejt që nukë shteretë, atje ku
kursari nuk' afëronetë, as krimbi nukë prish.
34 Sepse ku është thesari juaj, atje dotë jetë
35 edhe zëmëra juaj. Letë jenë mezetë t' uaj
36 ngjeshurë, edhe kandiletë ndezurë; Edhe ju
jini gati posi njerës që presënë të zon' e tyre,
kur dotë kthenetë nga dasma, që, kur të vinj'
37 e të trokëlinjë, për-një-here t'i hapnjënë. Lum
ata shërbëtorë, të-cilëtë, kur të vinj' i zoti,
dot' i gjenjë sgjuarë; vërtet po u them juve,
se dotë ngjishetë, e dot' i vërë të rrinë ndë
mësallët, edhe dotë vinjë përanë e dot' u shër-
38 benjë atyre. Edhe nd' arthtë ndë të-dytënë

ruajtje, edhe ndë të-tretënë ruajtje ndë arth-
të, edhe t'i gjenjë kështu, të-lumurë jan' ata
39 shërbëtorë. Edhe këtë e dini, se, po t'e dinte
i zot' i shtëpisë, mbë ç' orë vjen kursari, dotë
rrinte sgjuarë, edhe nukë dotë linte t' i çpo-
40 nej shtëpia. Edhe ju pra bëhi gati; sepse i bir'
i njeriut vjen nd'atë orë që nuk' e mendoni.
41 Atëhere Pjetri i tha, Zot, për neve e thua
42 këtë paravoli, apo për të-gjithë. Edhe Zoti
tha, Vallë cili ësht' ay kujdestar besëtar edhe
i-mënçim, të-cilinë dot'a vërë i zoti mbi shër-
bëtorët' e ti, që t'u apë mbë kohë ushqimin'
43 e-ndarë *për sicilinë*. Lum ay shërbëtuar, të-
cilinë, kur të vinj' i zoti, dot' e gjenjë dyke
44 bërë kështu. Vërtet po u them juve se e ka
45 për të vënë mbi gjithë gjën' e ti. Po ndë thënt'
ay shërbëtuar ndë zëmërët të ti, *se* Im Zot
mënon të vinjë; edhe të zërë të rrahë shër-
bëtorët' e shërbëtoretë, e të hajë e të pijë e
46 të dehetë; I zot' i ati shërbëtori dotë vinj' atë
ditë që s' e pret, edhe atë orë që s' e di; edhe
dot' e ndanjë, edhe dot' e vërë pjesën' e ati
47 bashkë me të-pabesëtë. Edhe ay shërbëtuar
që e dinte andën' e të Zotit, edhe nukë bëri
gati, as nukë bëri sipas andës' s' ati, dotë rri-
48 hetë shumë. Po ay që nuk' e diti, edhe bëri
punë për të rrahurë, dotë rrihetë pak. Edhe
gjithë-kujt që i udhá shumë, shumë dotë kër-
konetë prej ati; edhe ati që i ulëshuanë shu-
më, më shumë dotë kërpnjënë prej ati.

49 Erdha të vë zjar mbë dhet; edhe ç'*tjetërë*
dua, ndë qoftë se undes tashi?
50 Edhe kam një pagëzim të pagëzonem, edhe
51 sa shtrëngonem gjersa të mbaronetë? Pan-
dehni, se kam ardhurë t'ap paqtim mbë dhe?
52 jo, po u them juve, po ndarje. Sepse që ta-
shi e paskëtaj pesë vetë ndë një shtëpi dotë
jenë të ndarë *ndë mest të tyre*, tre kundrë
53 dyve, edhe dy kundrë treve. Dotë ndaletë i
ati kundrë të birit, edhe i biri kundrë t'et;
e ëma kundrë së bijësë, edhe e bija kundrë
s' ëmësë; vjehërra kundrë nuses' së saj, edhe
nusja kundrë së vjehërësë.
54 I thoshte edhe gjindjesë, Kur shihni renë
se del prej perëndimit, për-një-herë thoni, Po
55 vjen shi; edhe bënetë kështu; Edhe kur *shih-
ni*, se fryn erë mesdite, thoni, Se dotë bënjë
56 vapë; edhe bën. Ipokritër, faqen' e dheut e të
qiellit dini t'e shquani; po këtë kohë si nuk'
e shquani?
57 Edhe si nukë gjykoni edhe prej vetëhesë
58 s'uaj të drejtënë? Kur vete pra tek urdhëra-
tësi bashkë me kundrëgjyqësinë t'ënt, përpiqu
udhësë të shpëtonjç prej ati, semos të heqë
te gjykatësi, edhe gjykatësi të apë ndë dorët
të shërbëtorit, edhe shërbëtori të hedhë ndë
59 burk. Po të them tyj, Nukë ke për të dalë
andej, gjersa të lajsh edhe asprën' e fundit.

BKSH

Krye 13

1 Edhe nd' atë kohë ishin' atje përpara disa
veta dyke dëftyer' ati për Galileanëtë, gjaknë e
të cilëvet Pillati e përzjeu bashkë me kur-
2 banet' e tyre. Edhe Jisuj upërgjeq e u tha a-
tyre, Pandehni, se këta Galileanë ishinë më
fajtorë se gjithë Galileanëtë, sepse pësuanë
3 të-këtilla *punë?* Jo, po u them juve; po ndë
mos u-pendofshi, të-gjithë kështu kini për të
4 humburë. Apo ata të tetë-mbë-dhjetëtë; mbi
të-cilët ra pirgu ndë Siloam, edhe i vrau,
pandehni, se këta ishinë fajtorë më tepërë se
5 gjithë njerëzitë që rrinë ndë Jerusalim? Jo, po
u them juve; po ndë mos upendofshi, kështu
të-gjithë kini për të humburë.

6 Edhe thoshte këtë paravoli: Një njeri kish-
te mbjellë një dru fiku ndë vreshtët të ti; edhe
erdhi të marë pemë prej ati, po nukë gjeti.
7 Edhe i tha Vreshtarit, Na tek po vinj tre vjet
të marr pemë prej këti druri të-fikut, edhe
nukë gjenj; pre-e; përse të zërë edhe vëndi-
8 në mbë kot? Po ay upërgjeq e i tha, zot,
lër-e edhe këtë mot, gjersa të rëmih rrotull'
9 ati, e t'i shtie plehë; Edhe ndë bëftë pemë,
mirë; po ndë mos *bëftë*, dot' e preç pastaj.
10 Edhe një të-shëtunë ishte dyke mësuarë
11 *njerëzitë* ndë një sinagogji; Edhe ja një grua
që kishte frymë smundjeje tetë-mbë-dhjetë
vjet, edhe ishte kurusurë, e nukë munttë as-

12 fare të ngrihej përpjetë. Edhe Jisuj kur e pa,
e thirri, edhe i tha, Grua, e-liruarë je prej
13 smundjesë s' ate. Edhe vuri duartë mbi atë;
edhe ajo për-një-here udrejtua, edhe lavdu-
ronte Perëndinë.
14 Po i-par' i sinagogjisë upërgjeq me zëmë-
rim, sepse Jisuj *ditën'* e-shëtunë e shëroj, e i
thoshte gjindjesë, Gjashtë dit janë, ndë të-ci-
latë duhetë të punoni; ndër këto pra ejani e
15 shërohi, e jo ditën' e-shëtunë. Zoti pra upër-
gjeq e i tha, Ipokrit, gjithë-sicili prej jush
ditën' e-shëtunë a nukë sgith kan' e ti, a go-
marin' e ti nga grashti, edh' e sjell e i ep ujë?
16 Edhe këjo që ësht' e bij e Avraamit, të-cilënë
na tek e pat lidhurë Satanaj tetë-mbë-dhjetë
vjet, a nukë duhej të sgidhej prej këti të-li-
dhuri ditën' e-shëtunë?
17 Edhe ay tek po thoshte këto, gjith' ata që
i dilninë kundrë turpëroneshinë; edhe gjithë
gjindja gëzonej për gjithë punët' e-lavduruar-
shimë që bëneshinë prej ati.
18 Edhe *ay* thoshte, Me se përgjan mbretëri'
19 e Perëndisë? edhe me se t'a përgjanj? Për-
gjan me një koqe sinapi, të-cilën' e mori një
njeri edhe e hodhi ndë kopshtët të ti; edhe
urrit, e ubë dru i-math, edhe shpest' e qie-
llit erdh' e bënë të-ndënjura ndë degat t' ati.
20 Edhe përsëri tha, Me se t'a përgjanj mbre-
21 tërin' e Perëndisë? Përgjan me brumë, të-ci-

lin' e mori një grua, edhe e fshehu ndë tri
masa mjelli, gjersa umbrujt gjithë.
22 Edhe shkonte ndëpër qytete e ndëpër fsha-
tëra dyke mësuarë, edhe dyke bërë udhë për
ndë Jerusalim.
23 Edhe një njeri i tha, Zot, vallë të-pakë
24 *jan'* ata që shpëtonjënë? Edhe ay u tha atyre,
Mundohuni të hyni ndëpër derët të-ngushtë;
sepse shumë *veta*, po u them juve, dotë kër-
konjënë të hynjënë, edhe nukë dotë munt-
25 njënë. Passi të ngrihet' i zot' i shtëpisë, e të
mbylnjë derënë, atëhere dotë zini të rrini jash-
të, e të trokëllini ndë derët, dyke thënë, Zot,
Zot, hap-na; edhe ay dotë përgjigjet' e dot'
26 u thotë juve, Nuk' u di juve se nga jini; Atë-
here dotë zini të thoni, Hëngrëm' e pimë për-
para teje, edhe mësove ndëpër rrugat t' ona.
27 Po ay dotë thotë, Po u them juve, nuk' u di
juve se nga jini; ikëni prej meje gjithë ju
28 punëtorët' e paudhësisë. Atje dotë jetë të-qa-
rët' e të-kërcëllit urit' e dhëmbëvet, kur të shihni
Avraamin' e Isaakun' e Jakovin' e gjithë pro-
fitëritë ndë mbretërit të Perëndisë, edhe ve-
29 tëhenë t' uaj të-nxjerrë jashtë. Edhe dotë vi-
njënë nga lindja e nga perëndimi, e nga an'
e borës' e nga an' e shiut, edhe dotë *unjenë*
30 *të* rrinë ndë mbretërit të Perëndisë. Edhe na
tek janë të-prapësm që dotë jenë të-parë, edhe
të-parë që dotë jenë të-prapësm.
31 Atë ditë erdhë disa Farisenj, dyke thën'

BKSH

ati, Dil e ikë së-këtejmi, sepse Irodhi do të
32 të vrasë. Edhe ay u tha atyre, Hiqni e i tho-
ni kësaj dhelpëre, Na tek nxjer djaj, edhe
bënj shërime sot edhe nesërë, edhe të-tretënë
33 *ditë* dotë mbaronem. Po unë duhetë sot edhe
nesërë edhe tjetrënë ditë të vete; sepse nuk'
është gjë e-mundurë profit të prishetë jash-
34 të Jerusalimit. Jerusalim, Jerusalim, që vret pro-
fitëritë edhe rreh me gurë ata që janë dërguarë
te ti, sa herë kam dashurë të mbleth djemt'e
tu, posi pula zoqt' e saj ndënë krahët, edhe
35 nukë deshtë! Na shtëpia juaj tek po u lihetë
(e-shkretë). Edhe me të vërtetë po u them
juve, se nukë dotë më shihni gjersa të vinjë
koha, kur të thoni, I-bekuarë *ësht'* ay që vjen
mb' emërit të Zotit.

Krye 14

1 Edhe një ditë të-shëtunë, kur erdhi ay
ndë shtëpit të një nga të-parët' e Farisenj-
vet për të ngrënë bukë, ata ishinë dyke vë-
në re atë.
2 Edhe ja një i-idhropikasurë tek ishte për-
3 para ati. Edhe Jisuj upërgjeq e u tha nom-
tarëvet edhe Farisenjvet, dyke thënë, A ësht'e
udhësë *njeriu* të shëronjë ditën' e-shëtunë?
4 Edhe ata nukë bënë zë. Atëherë *ay* e zuri
5 edhe e shëroj, edhe e lëshoj. Pastaj upërgjeq
e u tha atyre, Kujt prej jush t' i bjerë go-
mari a kau ndë pus, edhe nuk' e nxjerrë sa-

6 kaqë-herash ditën' e-shëtune? Edhe ata nukë
muntnë t' i përgjigjeshinë mbë këto *fjalë.*
7 Edhe atyreve që ishinë ftuarë u thoshte
një paravoli, (sepse vinte re, qysh sgjithni-
8 në vëndet' e-parë,) dyke thënë atyreve, Kur
të ftonesh nga ndonjëj ndë dasmë, mos rri
ndë kryet të mësallësë, semos është ftuarë
prej ati ndonjë *tjetërë* m' i-nderçim se ti,
9 Edhe vjen ay qe ka ftuarë ty edhe atë, e të
thotë, Ep-i vëndinë këtij; edhe atëhere dotë
zësh me turp të rrish ndë vëntt të fundit.
10 Po kur të ftonesh, shko e rri ndë vëntt të
fundit, që, kur të vinj' ay që të ka ftuarë,
të të thotë, Mik, hipë më sipërë. Atëhere dotë
jetë lavdim për ty përpara atyreve që rrinë
11 ndë mësallë bashkë me ty. Sepse kushdo që
ngre lart vetëhen' e ti dotë përunjetë, edhe
ay që përunj vetëhen' e ti dotë ngrihetë lart.
12 I thoshte edhe ati që e kishte ftuarë, kur
të bënjç drek' a darkë, mos thirrë miqt' e tu,
as vëllezërit' e tu, as njerëzit' e tu, as fqinj-
të-pasurë; semos të thërresënë prapë dhe
13 ata, edhe bënetë çpagim mbë ty. Po Kur të
bënjç gosti, thirrë të-vobeq, ulokë, të-çalë,
14 të-verbërë; Edhe dotë jesh i-lumurë; Sepse
ata nukë kanë të t' a çpaguanjënë; edhe do-
të të çpaguhetë ndë ngjalljet të të-drejtëvet.
15 Edhe një nga ata që kishinë ndënjurë
bashkë ndë mësallët, kur dëgjoj këto fjalë,

BKSh

i tha, Lum ay që të hajë bukë ndë mbretë-
16 rit të Perëndisë. Edhe ay i tha ati.
Një njeri bëri një darkë të-madhe, edhe
17 ftoj shumë *veta*; Edhe ndë kohët të darkësë
dërgoj shërbëtoriu' e ti që t' u thoshte aty-
reve që ishinë ftuarë, Ejani, se tashti të-gji-
18 tha janë gati. Po të-gjithë zunë si prej një
mëndjeje të hiqeshinë mbë-nj'-anë. I pari i
tha, Bleva një arë, edhe kam nevojë të dal
19 e t' e shoh; të lutem, kij-më të-hequrë. Edhe
një tjetërë tha, Bleva pesë pëndë qe, edhe
po vete t' i provonj; të lutem, kij-më të-he-
20 qurë. Edhe një tjetërë tha, Mora grua; edhe
21 përandaj nukë munt të vinj. Edhe ay shër-
bëtori erdhi, edhe i dëfteu të zott këto. Atë-
here i zot' i shtëpisë u zëmërua, e i tha shër-
bëtorit të ti, Dil çpejt ndëpër rrugat e ndë-
për udhët të qytetit, edhe bjerë këtu brënda
të-vobeqt' e ulokët' e të-çalët' e të-verbëritë.
22 Edhe shërbëtori tha, Zot, ubë sikundrë ur-
23 dhërove, po edhe ka vënt. Edhe zotënia i tha
shërbëtorit, Dil ndëpër udhët e ndëpër gjer-
dhet, edhe ngut të hynjënë, që të mbushetë
24 shtëpia ime. Sepse po u them juve, se as-
një nga ata njerëzitë që qenë ftuarë nukë
dotë ngjëronjë darkënë t' ime.
25 Edhe shumë gjindje shkoninë bashkë me
26 atë; edhe *ay* ukthye e u tha atyre, Ndë ar-
thtë ndonjë tek une, edhe nukë mërzit t' an'e
t' ëmën' e gruan' e djemt' e vëllezërit' e motë-

ratë, po edhe jetën' e ti, nukë munt të jetë
27 nxënësi im. Edhe ay që nukë mban mbë
krahë kryqn' e ti, e *s'* vjen prapa meje nukë
28 munt të jetë nxënësi im. Sepse cili prej jush
do të ndërtonjë një pirk, edhe nukë rri më
përpara të bënjë llogari sa ka për të prishu-
rë, ndë ka ato *që duhenë* për të mbaruar'*atë?*
29 Semos, si të hedhë themelinë, e të mos munt-
një t' *e* mbaronjë, gjith' ata që e shohënë
30 zënë të qeshnjënë me atë, Dyke thënë, Se
Ky njeri zuri të ndërtonjë, edhe nukë mundi
31 të mbaronjë. Apo cili mbret, dyke vaturë të
luftonjë me tjetërë mbret, nukë rri më për-
para edhe nukë mendonetë, ndë është i-fortë
me dhjetë mijë t' i dalë përpara atij që vjen
32 kundrë ti me një-zet mijë? se ndë mos, tek
ësht' ay edhe po lark, dërgon lajmësi, e kër-
33 kon paqtim. Kështu pra gjithë-sicili prej
jush që nukë mohon pasjen' e ti, nukë munt
të jetë nxënësi im.
34 Kripa ësht' e-mirë; po ndë uprishtë kripa,
me se dotë ndreqetë. Nuk' është më e-vejy-
ershime as për dhe as për plehë; *po* e he-
dhënë jashtë. Ay që ka veshë për të dëgju-
arë letë dëgjonjë.

Krye 15

1 Edhe gjithë kumerqarët' e fajtorëtë i u
2 aferoneshinë, që t' e dëgjoninë. Edhe Fari-
senjt' e shkronjësitë murmurisninë, dyke thë-

në, Se ky pret fajtorë, edhe ha bashkë me
3 ata. Edhe ay u tha atyre këtë paravoli dyke
thënë,
4 Cili njeri prej jush, ndë pastë një qint
dhën, edhe të hympnjë një prej atyreve, nu-
kë le të nëntë-dhjet' e nëntatë ndë shkretë-
tirët, edhe vete të kërkonjë atë që ka hnm-
5 burë, gjersa t' e gjenjë? Edhe si t' e gjenjë,
6 e merr mbi supat të ti dyke gëzuarë; Edhe
kur vjen ndë shtëpit, thërret miqt' edhe fqinj-
të, e u thot' atyre, Gëzohi bashkë me mua,
7 se gjeta delenë t' ime që pat humburë. Po u
them juve, se kështu dotë jetë gëzim ndë
qiellt për një fajtuar që pendonetë, se për
nëntë-dhjet' e nëntë të-drejtë, të-cilëtë s' kanë
nevojë për pendim.
8 A cila grua që ka dhjetë dhrahmi, ndë
i humptë një dhrahmi, nukë ndes kandilenë,
edhe fshin shtëpinë, edhe kërkon me kujdes,
9 gjer sa t' e gjenjë? Edhe si t' a gjenjë, thërret
miqeshat' e fqinjatë, dyke thënë, gëzohi ba-
shkë me mua, se gjeta dhrahminë që hum-
10 ba. Kështu, po u them juve, bënetë gëzim
përpara ëngjëjvet të Perëndisë për një fajtu-
ar qe pendonetë.
11 Përsëri tha,
12 Një njeri kishte dy bij; edhe më i-vogë-
li nga ata i tha t' et, Atë, ep-më pjesën' e
13 gjësë që më bje *për-të-marrë.* Edhe ay u' a
ndau atyre gjënë. Edhe pas pak ditsh më

i-vogëli mblodhi gjithë *ç' pat,* edhe iku ndë
dhe të-huaj mbë një vënt të-largë; edhe atje
çpërndau gjën' e ti dyke shkuarë jetë plank-
14 prishësi. Edhe ay si prishi të-gjitha, ubë
një zi e-madhe mb' atë vënt, edhe ay zuri të
15 mos kishte më. Atëhere vate e u ngjit pas
një qytetari t' ati vëndi; edhe *ky* e dërgoj
16 nd' arat të ti të kullotte derra. Edhe dëshë-
ronte të mbushte barkun' e ti me harupetë
qe haninë derratë; po as ndonjë nuk' i epte.
17 Edhe si erdhi ndë vetëhet të ti, tha, Sa pu-
nëtorëve të t' im et u tepëron bukë, e unë
18 po humbas nga uria! Dotë ngrihem e dotë
vete tek im atë, edhe dot' i them, O Atë,
19 fëjeva ndë qiellt edhe përpara teje; Edhe nu-
kë jam më i vëjyerë të quhem biri yt; bëj-
20 më posi një nga punëtorët' e tu. Edhe ungrit
e erdhi tek i ati. Edhe Ay tek po ishte edhe
lark, i ati e pa edhe i erdhi keq, edhe usul
21 e ra mbi qafët t' ati, edhe e puthi. Edhe i
biri i tha, O Atë, fëjeva ndë qiellt edhe për-
para teje, edhe nukë jam më i-vëjyerë të
22 quhem biri yt. Po i ati u tha shërbëtorëvet
të ti, Nxirni jashtë stolin' e parë edhe vish-
j' ani, edhe i viri unazë ndë dorët, edhe kë-
23 pucë ndë këmbët; Edhe bini viçin' e-ushqyerë,
edhe ther-e-ni, edhe letë ham' e të gëzone-
24 mi; Sepse ky biri im qi i-vdekurë, e ungjall
përsëri; edhe qe i-humburë, e ugjënt. Edhe
25 zunë të gëzoneshinë. Edhe m' i-madhi bir

ishte nd' arët; edhe kur erdhi e u afërua ndë
26 shtëpit, dëgjoj kënk' e valle. Edhe thirri një
nga shërbëtorëtë edhe e pyeste, ç' janë këto.
27 Edhe ay i tha, Se ka ardhur' yt vëlla; edhe
yt atë theri viçin' e-ushqyerë, sepse e priti
28 të-shëndoshë. Edhe *ay* uzëmërua, edhe nukë
donte të hynte brënda. I ati pra dolli, e i
29 lutej. Edhe ay upërgjeq e i tha t' et, Na tek
po të shërbenj kaqë vjet, edhe kurrë nukë
dolla nga urdhëri yt; edhe kurrë nukë më
dhe një kec, që të gëzonem bashkë me miqt'
30 e mi. Po kur erdhi ky yt bir që hëngri gjë-
në bashkë me kurvatë, i there viçin' e-ush-
31 qyerë. Edhe ay i tha, O djalë, ti je përherë
bashkë me mua, edhe gjithë të-miatë janë
32 të-tuatë; Edhe duhej të gëzoneshim' e të
ngazëlloneshimë, sepse ky yt vëlla qe i-vde-
kurë, e ungjall përsëri; edhe qe i-humburë,
e ugjënt.

Krye 16

1 U thoshte edhe nxënësvet të ti,
Ishte një njeri i-pasurë që kishte një kuj-
destar; edhe i kallëzuanë keq për atë, se
2 çpërndau gjën' e ati. Edhe *ay* e thirri e i tha,
Ç' *është* këjo që dëgjonj për ty? Ep llogarin'e
kujdesësë s' ate; sepse nukë mundetë më të
3 jesh kujdestar. Atëhere kujdestari tha me
vetëhen' e ti, Ç' dotë bënj, që im zot po më
heq nga kujdesa? të rëmonj nukë munt, të

BKSH

4 lypënj kam turp. Ukujtuashë ç' *duhetë* të bënj,
që të më presënë ndëpër shtëpirat të tyre,
5 kur të nxirem nga kujdesa. Edhe thirri pë-
ranë një nga një detorët' e të zot, e i tho-
6 shte të-parit, Sa detyrë i ke t' im zott? Edhe
ay i tha, Një qint bucela vaji edhe ay i
tha, Merr të-shkruarënë t' ënde, edhe rri
7 e shkruaj çpejt pesë-dhjetë. Pastaj i tha
një tjetëri, po ti sa detyrë *i* kë? Edhe ay i
tha, Një qint matës gruri. I thot' edhe ati,
Merr të-shkruarënë t' ënde, edhe shkruaj
8 tetë-dhjetë. Edhe i zoti e lëvdoj kujdestarin'
e-paudhë, sepse punoj me mënt; sepse të
bijt' e kësaj jete janë më të-mënçim ndë brest
të tyre, se të bijt' e dritësë.
9 Edhe unë po u them juve, Bëni miq për
vetëhenë t' uaj nga mamonaj i paudhërisë
që t' u presënë juve ndë tendat të-përjetësh-
10 me, kur të ngrihi së-këtejmi. Ay që është
besëtar mbë të-pakënë, është besëtar edhe
mbë të-shumënë; edhe ay që është i-paudhë
mbë të-pakënë, është i-paudhë edhe mbë të
11 shumënë. Ndë qoftë pra se s' ubëtë besëtarë
mbë të-paudhinë mamona, kush dot' u be-
12 sonetë juve të-vërtetënë gjë? Edhe ndë qof-
të, se nukë ubëtë, besëtarë mbë *gjën'* e-huaj,
13 kush dot' u apë juve t' uajnë? Asndonjë shër-
bëtuar nukë munt t' u shërbenjë dy zotërinj-
ve; sepse a njërinë dot' e mërzitnjë, edhe tja-
trinë dot' e dojë; a pas njërit dotë ngjitetë,

edhe tjatrinë dot' e hedhë tej. Nukë muntni
t' i shërbeni Perëndisë edhe mamonajt.
14 Edhe Farisenjtë që ishinë dorë-shtrëngu-
arë këto të-gjitha i dëgjoninë, edhe e për-
qeshninë.
15 Edhe *ay* u tha atyre, Ju jini ata që nxir-
ni vetëhenë t' uaj të-drejtë përpara njerësvet;
po Perëndia njeh zëmëratë t' uaj; sepse ajo
gjë që ësht' e-lartë ndër njerëzit, ndyrësi
16 është përpara Perëndisë. Nomi edhe profi-
tëritë *kanë qënë* gjer *ndë kohët* të Joanit; që
atëhere epetë zër' i-mirë për mbretërin' e
Perëndisë, edhe gjithë-sicili nxitonetë *të*
17 *hynjë* ndë atë. Edhe më kollaj është qielli
edhe dheu të shkonjënë, se të bjerë *poshtë*
18 një pikë nga nomi. Kushdo që lëshon gru-
an' e ti edhe martonetë me tjetërë, kurvëron;
edhe kushdo që martonetë me grua të-lëshu-
arë prej burrit, kurvëron.
19 Edhe një njeri ishte i-pasurë, edhe vishej
me porfirë e me stoli të-kuqe, dyke gëzuarë
20 përdita ndriçim. Ishte edhe një i-vobek që
e kish emërinë Llazar, i-cili dergjej peranë
21 portës' s' ati plot me plagë, Edhe dëshëronte
të nginjej me thërrimetë që bininë nga tru-
vez' e të-pasurit; po edhe qëntë vinin' e lë-
22 pininë plagët' e ati. Edhe i-vobeku vdiq, edhe
upru nga ëngjëjtë ndë gjit t' Avraamit. Vdiq
23 edhe i-pasuri edhe ukall ndë varr. Edhe ndë
hadht, tek ishte ndë mundime, ngriti syt' e ti,

BKSH

e sheh Avraaminë së-largu, edhe Llazarinë
24 ndë gjit t' ati. Edhe ay thërriti e tha, O atë
Avraam, përdëlle-më, edhe dërgo Llazarinë,
që të ngjyenjë majën' e gishtit të ti ndë ujë,
edhe të më ftohnjë gjuhënë; sepse po mun-
25 donem ndë këtë flakë. Po Avraami i tha, O
djalë, kujtohu, se ti more të-mirat' e tua ndë
jetët t' ënde, edhe Llazari gjithashtu të-keqi-
26 atë; po tashi ky prëhetë, e ti mundone. Edhe
mbi gjithë këto, ndër mest nesh e jush është
ngulurë një pafundje e-madhe, që kështu ata
që duanë të shkonjënë së-këtejmi ndër ju,
të mos muntnjënë, as t' andejmitë të shkojnë
27 ndër ne. Edhe *ay* tha, Të lutem pra, o atë,
28 të dërgonjç atë ndë shtëpit të t' im et; Sepse
kam pesë vëllezër; që të apë dëshmim ndër
ata, që të mos vinjënë edhe ata ndë këtë
29 vënt të mundimit. Avraami i thotë, kanë
Moisinë edhe profitëritë; letë ndigjonjën' ata.
30 Edhe ay tha, Jo, o atë Avraam; po ndë vaf-
të ndonjë nga të-vdekuritë tek ata, dotë pen-
31 donenë. Edhe *ay* i tha, Ndë qoftë, se nukë
ndigjonjënë Moisinë edhe profitërit, as ndë
ungjalltë ndonjë nga të-vdekuritë, s' janë për
të bindurë.

Krye 17

1 Edhe u tha nxënëset, Është *gjë* e-pamun-
durë të mos vinjënë skandhalitë; po mjer' ay,
2 me anë të të-cilit vinjënë. Më mirë është për

atë t' i varetë një gur mulliri rreth qafës' s'ati,
edhe të hidhetë ndë dett, se të skandhalis-
3 një një nga këta të-vegjëlitë. Vini re vetë-
henë t' uaj. Edhe ndë të bëftë faj yt vëlla,
4 qërto-e; edhe ndë upendoftë, fal-j' a. Edhe
ndë të bëftë faj shtatë herë ndë ditet, edhe
të kthenetë shtatë herë ndë ditët tek ti, e të
thotë, Pendonem, t' j' a falç.
5 Edhe apostoj' i thanë Zotit, Shto-na besënë.
6 Edhe Zoti tha, Po të kishitë besë sa një ko-
qe sinapi, dot' i thoshitë këti druri të manit,
Shkulu *së-këtejmi*, edhe mbillu ndë dett, edhe
7 dot' u ndigjonte juve. Edhe cili prej jush, që
ka një shërbëtuar që lëron, a ruan dhëntë,
dot' i thotë këti për-një-here, posa të kthe-
8 netë nga ara, Shko e rri të hash? Apo nukë
dot' i thotë, Bëj gati ç' të ha për darkë, edhe
përvishu e shërbe-më, gjersa të ha e të pi,
9 edhe pastaj dotë hash e dotë pish ti? Mos
j' a njeh për hir ati shërbëtori, sepse bëri
10 ato që e urdhëroj? Nukë më duketë. Kështu
edhe ju, kur të bëni gjithë sa u janë urdhë-
ruarë, thoni, Se jemi shërbëtorë të-pavëjyerë;
sepse bëm' atë që kishimë detyrë të bënimë.
11 Edhe ay kur po vinte për ndë Jerusalim,
12 shkonte përmes Samarisë e Galilesë. Edhe
kur po hynte ndë një fshat, përpoqnë me
atë dhjetë burra të-krromosurë, të-cilëtë qën-
13 druanë prej së-largu; Edhe ata ngritnë zënë,
14 dyke thënë, Jisu, mjeshtër, përdëlle-na. Edhe

ay kur i pa, u tha atyre, Shkoni e dëfteni
vetëhenë t' uaj te priftëritë. Edhe ata dyke
15 vaturë uqëruanë. Edhe një nga ata, kur pa
se ushërua, ukthye dyke lavduruarë Perën-
16 dinë me zë të-math; Edhe ra përmbys ndër
këmbët t' ati, e i ufal ndersë; edhe ay ishte
17 Samarit. Edhe Jisuj upërgjeq e tha, A nuk'u-
qëruanë të dhjetëtë? po të nëntëtë ku janë?
18 Nuk' ugjëntnë *të-tjerë* të kthenenë që t' i a-
pënë lavdi Perëndisë, veç ky tjatërë-kombës?
19 Edhe i tha, Ngreu, e shko; besa jote të shpëtoj.
20 Edhe kur upyet nga Farisenjtë, kur vjen
mbretëri' e Perëndisë, upërgjeq atyre e tha,
Mbretëri' e Perëndisë nukë vjen me të-duku-
21 rë; As s' kanë për të thënë, Na këtu *është*, a,
Na atje; sepse na mbretëri' e Perëndisë tek
është ndë mest t' uaj.
22 Edhe *ay* u tha nxënëset, Dotë vinjënë dit,
kur dotë dëshëroni të shihni një nga ditt' e
të Birit të njeriut; edhe nukë dotë muntni.
23 Edhe dot' u thonë juve, Na këtu *është*, a, Na
24 atje; mos ecëni, as mos vini pas. Sepse si-
kundrë vetëtima që vetëtin prej njërësë anë
ndënë qiellt ndrit gjer mbë tjatrënë anë ndënë
qiellt, kështu dotë jetë edhe i Bir' i njeriut
25 ndë ditët të ti. Po më përpara ay duhetë të
pësonjë shumë, edhe të mos pëlqenetë prej
26 këti brezi. Edhe sikundrë ubë ndë ditt të
Noesë, kështu dotë jetë ndë ditt të Birit të
27 njeriut; hanin' *e* pinin' *e* martonin' *e* marto-

neshinë, gjer mb'atë ditë që hyri Noeja nd'
arkët; edhe erdhi përmbytja, edhe prishi të-
28 gjithë. Kështu sikundrë ubë edhe ndë ditt të
Llotit; hanin'*e* pinin'*e* blinin'*e* shisnin'*e* mbill-
29 nin'*e* ndërtoninë shtëpi; Edhe që mb' atë di-
të që dolli Lloti nga Sodhoma, ra shi zjarri
e shqufuri nga qielli, edhe prishi të-gjithë;
30 Posi këto dotë jetë nd'atë ditë që dotë çfa-
31 qet'i Bir' i njeriut. Nd'atë ditë kush të gjen-
detë mbë dhomët, edhe enët'e ati brënda
ndë shtëpit, letë mos sbresë t' i ngrerë; edhe
ay që të gjendetë nd'arët, gjithashtu letë mos
32 kthenetë prapa. Bini ndër mëntt gruan e Llo-
33 tit. Ay që dotë kërkonjë të shpëtonjë jetën'
e ti, dot'e humpnjë; edhe ay që t'e hump-
34 një; dot'e ruanjë. Po u them juve, Nd'atë
natë dotë jenë dy *veta* mbë një shtrat;
35 njëri dotë merretë, e tjatëri dotë lihetë. Dy
gra dotë jenë dyke bluarë bashkë; njëra
dotë merretë, e tjatëra dotë lihetë. Dy veta
36 dotë jenë nd'arët; njëri dotë merretë, e tja-
tëri dotë lihetë.
37 Edhe *ata* upërgjeqnë e i thonë, ku o Zot?
Edhe ay u tha atyre, Ku *është* trupi, atje dotë
mblidhenë shqiponjatë.

Krye 18.

1 U thoshte atyre edhe një paravoli, që *t'u
tregonte*, se duhetë të falenë gjithënjë, edhe
2 të mos lodhenë, Dyke thënë.

Ndë një qytet ishte një gjykatës, i-cili s'
kishte frikë nga Perëndia, edhe s' kishte turp
3 nga njeri. Ishte edhe një e-ve nd' atë qytet;
edhe vinte tek ay, dyke thënë, Ep-më të-drej-
4 tënë prej kundrëgjyqësit t' im. Edhe ay gjer
mbë një kohë nukë donte; po pastaj tha me
vetëhe, Ndonëse s' kam frikë nga Perëndia;
5 edhe s' kam turp nga njeri, Pak-së-paku, se-
pse këjo e-ve më bënetë barrë, let' ja ap të-
drejtënë, që të mos vinjë gjithënjë e të më
çajë kryetë.
6 Edhe Zoti tha, Dëgjoni ç' thotë gjykatësi
7 i-paudhë. Po Perëndia a nukë dot' u apë të-
drejtënë të-sgjedhurvet të ti që thërresënë tek
ay dit' e natë, kur edhe zëmërënë e ka të-
8 gjerë për ata? Po u them juve, se dot' u'a
apë atyre të-drejtënë për-së-çpejti. Po kur
të vinj' i Bir' i njeriut, vallë a dot' e gjenjë
besënë mbi dhet?
9 Edhe cave nga ata që besoneshinë mbë
vetëhen' e tyre, se janë të-drejtë, edhe nuk' i
zininë për gjë të-tjerëtë, u tha këtë paravoli.
10 Dy njerës hipnë ndë hieroret, që të fale-
shinë; njeri ishte Farise edhe tjatëri kumer-
11 qar. Fariseu ndënji e falej me vetëhen' e ti,
dyke thënë, O Perëndi, të falem ndersë, se
nukë jam posi njerëzit' e-tjerë, rrëmbenjës, të-
paudhë, kurvarë, a edhe posi ky kumerqar.
12 Agjëronj dy herë ndë javët, ap të-dhjetënë
13 nga gjithë ç' kam. Edhe kumerqari kishte

BKSH

ndënjurë prej së-largu e nukë donte as sytë
të-ngrij përpjetë ndë qiellt, po rrihte krahë-
rorin' e ti, dyke thënë, O Perëndi, përdëlle-
14 më mua fajtorinë. Po u them juve, *se* ky
sbriti ndë shtëpit të ti *m'* i drejtëruarë se ay,
sepse kushdo që ngre lart vetëhen' e ti, dotë
përunjetë: edhe ay që përunj vetëhen' e ti,
dotë ngrihetë lart.
15 Edhe i prunë ati edhe foshnjatë që t' i
zinte me dorë; edhe nxënësitë kur panë, i
16 qërtuanë. Po Jisuj si i thërriti përanë, tha,
Liri çunat' e-vegjëlë të vijnë tek unë edhe
mos i ndalni; sepse e të-këtillëvet është mbre-
17 tëri' e Perëndisë. Me të-vërtetë po u them juve,
se Ay që të mos presë mbretërin' e Perëndisë
posi një çun i-vogëlë, nukë dotë hynjë nd' atë,
18 Edhe një i-parë e pyeti, dyke thënë, Më-
sonjës i-mirë, ç' të bënj që të trashëgonj jetë
19 të-përjetëshme? Edhe Jisuj i tha, Ç' më thua
i-mirë? asnjë nuk' ësht' i-mirë, përveç një,
20 Perëndia, *Ti* i di porositë, „Mos kurvëronjç;
Mos vraç; Mos vjethç; Mos apç dëshmim të-
21 rrem; Ndero të t' at' e t' ët ëmë." Edhe ay tha,
Të-gjitha këto i kam ruajturë që mbë të-rit
22 t' im. Edhe Jisuj, kur dëgjoj këto, i tha. Edhe
një punë të mungon; shit gjithë ç' ke, edhe
i ndaj ndëpër të-vobeq, edhe dotë kesh the-
23 sar ndë qiell; edhe eja, e ngjit-m'-u pas. Po
ay kur dëgjoj këto, u hidhërua; sepse ishte
fort i-pasurë.

24 Edhe Jisuj kur pa, se uhidhërua, tha, Sa
me të-vështirë dotë hynjënë ndë mbretërit të
25 Perëndisë ata që kanë gjë! Sepse më kollaj
është të hynjë kamilla ndëpër vrimët të gjël-
përësë, se *një* i-pasurë të hynjë ndë mbretë-
26 rit të Perëndisë. Edhe ata që dëgjuanë thanë,
27 E kush munt të shpëtonjë? Edhe ay tha, Të-
pamunduratë te njerëzitë janë të-mundura te
Perëndia.

28 Edhe Pjetri tha, Ja neve tek lamë të-gji-
29 tha, edhe të erthmë pas. Edhe ay u tha a-
tyre, Me të-vërtetë po u them juve, se nuk'
është asnjë që la shtëpi, a prindër, a vëlle-
zër, a grua, a djem, për punë të mbretërisë
30 Perëndisë, I-cili të mos trashëgonjë për një
shumë ndë këtë kohë, edhe ndë jetët që vjen
jetë të-përjetëshme.

31 Pastaj mori mbë nj' anë të dy-mbë-dhje-
tëtë, e u tha atyre. Na tek po hipëjmë ndë
Jerusalim, edhe dotë mbushenë gjithë sa janë
shkruarë me anë të profitërvet për të Birin'
32 e njeriut; Sepse dotë epetë ndër duart të
kombevet, e dotë përqeshetë, e dotë shahetë
33 e dotë pshtyhetë; Edhe si t'a frushkullonjënë
dot' e vrasënë; edhe të-tretënë ditë dotë
34 ngjalletë. Po ata nukë muarnë vesh asnjë nga
këto *fjalë*; edhe këjo fjalë ishte e-fshehurë
nga ata, edhe nukë merrninë vesh ato që u
thuheshin' atyre.

35 Edhe ay kur uafërua ndë Jeriho, një i-

verbërë po rrinte përan' udhësë dyke lypurë;
36 Edhe kur dëgjoj gjindjenë dyke shkuarë, py-
37 este, Ç'është këjo? Edhe i dëftyenë, se po
38 shkon Jisu Nazoreasi. Edhe *ay* thirri dyke
39 thënë, Jisu, bir' i Dhavidhit, Përdëlle-më. Edhe
ata që shkoninë përpara e qërtoninë që të
pushonjë; po ay shumë më tepërë thërriste,
Bir' i Dhavidhit, përdëlle-më.
40 Edhe Jisuj qëndroj, edhe urdhëroj t'e bjenë
41 tek ay; edhe ay si uafërua, e pyeti, Dyke
thënë, Ç' do të të bënj? Edhe ay tha, Zot, të
42 hap sytë e të shoh. Edhe Jisuj i tha, Hap
43 sytë e shih; besa jote të shpëtoj. Edhe sa-
kaqë-herash hapi sytë e pa, edhe i vinte pas
dyke lavduruarë Perëndinë; edhe gjithë lla-
uzi kur pa, i dha lavdi Perëndisë.

Krye 19.

1 Edhe Jisuj hyri e shkonte ndëpër Jiriho.
2 Edhe na një njeri që quhet Zakhe, i-cili
ishte i-par' i kumerqarëvet, edhe ky ishte i-
3 pasurë; Edhe kërkonte të shihte Jisunë cili
është; po nukë munte nga gjindja, sepse ishte
4 i-vogëlë ndë shtat. Edhe usul përpara, e hipi
mbë një dru mani, që t'e shihte, sepse nga
5 ajo *udhë* dotë shkonte. Edhe Jisuj si erdhi
nd' *atë* vënt, ngriti sytë edh' e pa atë, edhe
i tha, Zakhe, sbrit çpejt; sepse sot duhetë
6 unë të mbetem ndë shtëpit t' ënde. Edhe *ay*
sbriti çpejt, edhe e priti dyke gëzuarë.

7 Edhe të-gjithë kur panë murmurisninë,
dyke thënë, Se hyri të rrijë te një fajtuar
njeri.
8 Edhe Zakheu qëndroj e i tha Zotit, Na, o
Zot, gjysmën' e gjësë s'ime tek po u'a ap të-
vobeqvet, edhe ndë i kam marrë gjë njeriu
9 me përdhunë, j'a kthenj për një katrë. Edhe
Jisuj i tha, Se sot ubë shpëtim ndë këtë shtë-
10 pi, sepse edhe ky është i bir' i Avraamit. Se-
pse i Bir' i njeriut erdhi të kërkonj' e të-shpë-
tonjë të-humburënë.
11 Edhe ata kur dëgjoninë këto, Jisuj shtoj e
tha një paravoli, sepse ishte afërë Jerusali-
mit, edhe ata pandehninë, se sa-kaqë-herash
12 dotë dukej mbretëri' e Perëndisë. Tha pra.
Një njeri i-fisçim vate mbë një vënt të-
largë, për të marë një mbretëri për vetëhen'
13 e ti, e pastaj të kthenetë. Edhe thirri dhjetë
shërbëtorë të ti, e u dha dhjetë mna, edhe u
14 tha, Punoni këto gjer sa të vinj. Po qyteta-
rët' e ati e kishinë çmir edhe dërguanë laj-
mësi pas ati, dyke thëne, Nukë duamë këtë
15 të mbretëronjë mbi ne. Edhe si mori mbretë-
rinë ukthye prapë, edhe tha të thëritenë tek
ay ata shërbëtorëtë të-cilëvet u pat dhënë
ergjëndinë, për të marrë vesh ç' kishte fitu-
16 arë gjithë-sicili. Edhe erdhi i pari, dyke thë-
17 në, Zot, mnaja jote fitoj dhjetë mna. Edhe ay
i tha, Të lumtë, shërbëtuar i-mirë; me-qënë-
që ubëre besëtar ndë të-pakënë, ki pushtet

18 përmbi dhjetë qytete. Erdhi edhe i-dyti, dyke
thënë, Zot, mnaja jote bëri pesë mna. I tha
19 edhe këti, Edhe ti bënu *zot* përmbi pesë qy-
20 tete. Erdhi edhe tjetëri, dyke thënë, Zot, na
mnaja jote të-cilën' e pata ruajturë ndë një
21 rizë; Sepse të pata frikë, se je njeri i ashpë-
rë; merr atë që s' ke vënë, edhe korr atë që
22 s' ke mbjellë. Edhe *ay* i thotë, Prej gojësë
s' ate të kam për të gjykuarë, shërbëtuar i-
keq; ti e dinje, se unë jam njeri i-ashpërë,
edhe marr atë që s' kam vënë, edhe korr atë
23 që s' kam mbjellë; Përse pra nukë dhe er-
gjëndinë t' im ndë truvezët, që, kur të vinjam
24 unë, t'a merrnjam bashkë me kamatënë.? Atë-
here u tha atyre që rrininë përpara, Merrni
mnanë prej ati, edhe ep-j' a-ni ati që ka të
25 dhjetë mnatë. (Edhe ata i thanë, Zot, *ay* ka
26 dhjetë mna.) Sepse po u them juve, se kuj-
do që ka dot' i epetë; edhe prej ati që s' ka,
27 edhe ajo që ka dotë merretë prej ati. Po ata
armiqt' e mi që s' më deshnë të mbretëronj
mbi ata, birni këtu, edhe therni ata përpa-
ra meje.

28 Edhe si tha këto, shkonte përpara, dyke
hipurë ndë Jerusalim.

29 Edhe si uafërua ndë Vithfagji edhe ndë
Vithani, ndaj malit që quhetë i Ullinjet, dër-
30 goj dy *veta* nga nxënësit' e ti, Dyke thënë
atyre, Shkoni ndë fshat të-përtejm; ndë të-
cilët kur të hyni, dotë gjeni një pulisht li-

BKSh

dhurë, përmbi të cilënë asnjeri kurrë s' ka
31 hipurë; sgidh-e-ni edhe sill-e-ni. Edhe ndë
u pyetë juve ndonjë, Përse e sgithni? kështu
t' i thoni, Se Zoti ka nevojë prej ati.
32 Edhe si vanë ata që udërguanë, gjetnë
33 sikundrë u tha atyre. Edhe ata kur po sgith-
ninë pulishtinë, të zotërit' e ati u than' atyre,
34 Përse sgithni pulishtinë? Edhe ata thanë, Zoti
35 ka nevojë prej ati. Edhe e prunë te Jisuj.
Edhe si hodhë rrobat' e tyre mbi pulishtinë,
36 hipnë Jisunë mbi atë. Edhe tek po shkonte,
gjindja shtroninë rrobat' e tyre udhësë.
37 Edhe ay kur uafërua ndashti mbë të-sbri-
turit të malit t' Ullinjet, gjithë shumica e nxë-
nëset zunë të gëzoneshin' e të lavduroninë
Perëndinë me zë të math për gjithë çuditë
38 që panë, Dyke thënë, I-bekuarë *qoftë* mbreti
që vjen mb'emërit të Zotit; paqtim ndë qiell,
edhe lavdi mbë të lartat.
36 Edhe ca Farisenj prej gjindjesë i thanë,
40 Mësonjës, qërto nxënësit' e tu. Edhe ay upër-
gjeq e u tha atyre, Po u them juve, se ndë
pushofshinë këta, gurëtë dotë thërresënë.
41 Edhe kur uafërua, e pa qytetnë, qau për
42 atë, Dyke thënë, Se sikur të dinje edhe ti,
pak së-paku *sot* ndë këtë ditët t' ënde, ato
që *janë* për paqtimnë t' ënt, *sa mirë do ishte?*
43 Po tashi ufshehnë prej syvet të ty, Sepse
kanë për të ardhurë dit mbi ty, edhe armiqt'
e tu kanë për të bërë hendek rreth teje, edhe

BKSH

të kanë për të rrethuarë, edhe të kanë për
44 të shtrënguarë nga të gjith' anëtë; Edhe kanë
për të rrëzuarë poshtë ty edhe djemt' e tu
që gjendenë brënda tek ti, edhe nukë kanë
për të lënë tek ti gur mbi gur; sepse nukë
njohe kohënë që *erdhë* për të parë ty.
45 Edhe si hyri ndë hieroret, zuri t'i nxirte
46 jasht' ata që shitnin' e blininë nd' atë, Dyke
thën' atyre, Është shkruarë, „Shtëpia ime
është shtëpi lutje;" po ju e bëtë „shpellë
kursarësh."
47 Edhe ishte dyke mësuarë përdita ndë hi-
eroret; edhe kryepriftërit' e shkronjësitë edhe
të-parëtë e llauzit kërkoninë t'e prishninë;
48 po nukë gjeninë se ç' t'i bëninë; sepse gjithë
llauzi ishte varurë pas ati për të dëgjuar' atë.

Krye 20

1 Edhe ndë një nga ato dit, tek mësonte
ay llauzinë ndë hieroret, edhe epte zën' e-
mirë, kryepriftërit'edhe shkronjësitë bashkë
2 me pleqtë erdhë eipër' *ati*, E i folnë, dyke
thënë, Thuajna, me ç' pushtet bën këto? a
cili ësht' ay që të ka dhënë këtë pushtet?
3 Edhe *ay* upërgjeq e u tha atyre, Edhe unë
dot' u pyes juve një fjalë, edhe thoj-më-ni,
4 Pagëzimi i Joanit prej qielli ishte a prej nje-
5 rëzish? Edhe ata mendoneshinë me vetëhen'
e tyre, dyke thënë, Se ndë thënçimë, Prej
6 qielli, dotë thotë, Përse s'i besuatë pra? Po

ndë thënçimë, Prej njerëzish, gjithë llauzi dotë
na rrahë me gurë, sepse i është mbushurë
7 mëndja, se Joani është profit. Edhe upërgjeq-
8 në, se nukë dinë nga *ishte*. Edhe Jisuj u tha
atyre, As unë nuk' u them me ç'farë push-
teti bënj këto.

9 Pastaj zuri t'i thoshte llauzit këtë para-
voli: Një njeri beltoj një veshtë, edhe e dha
ndër bujqër, edhe vate ndë dhe të-huaj për
10 shumë kohë. Edhe ndë kohët *të pemëvet* dër-
goj një shërbëtuar te bujqëritë, që t'i epninë
prej pemës' së veshtit; po bujqërit' e rrahnë,
11 edhe e dërguanë sbrazëtë. Edhe përsëri dër-
goj një tjatërë shërbëtuar; po ata edhe atë
e rahnë, edhe e turpëruanë, edhe e dërguanë
12 zbrazëtë. Edhe përsëri dërgoj një të-tretë; po
ata edhe këtë e bënë me plagë edhe e dë-
13 buanë. Edhe i zot' i veshtit tha, Ç' të bënj?
letë dërgonj birinë t' im të-dashurinë; mbase,
14 kur të shohënë këtë, dotë kenë turp. Po buj-
qëritë kur e panë, mendoneshinë me vetëhe,
dyke thënë, Ky është trashëgimtari; ejani, le
t'a vrasmë, që të na mbetetë trashëgimi.
15 Edhe e nxuarë jashtë veshtit, edhe e vranë.
16 Ç' dot' u bënjë pra atyre i zot' i veshtit? Dotë
vinjë e dot' i prishnjë këta bujqër, edhe vesh-
tinë dot' u' a apë të-tjerëve.

17 Po *ata* kur dëgjuanë, thanë, Qoftë lark!
Edhe ay shtyri sytë mb' ata e tha, Ç' është
pra këjo që është shkruarë, "Gurinë që nuk'

e pëlqyenë ata që ndërtonjënë, ky ubë për
18 krye çipi?“ Kushdo që të bjerë mbi atë gur
dotë copëtonetë; edhe mb' atë që të bjerë,
dot' e dërmonjë.
19 Edhe kryepriftërit' e shkronjësitë kërkuanë
të vënë duartë mbi atë nd' atë orë; po pat-
në frikë nga llauzi; sepse e muarnë vesh, se
20 për ata e tha këtë paravoli. Edhe dyke
ruajturë atë për së-afërmi, dërguanë për-
gjonjës, të-cilëtë shtiheshinë se janë të-drejtë,
me qëllim që ta zininë prej fjale, që t'a ep-
ninë ndë dorët të urdhërit edhe ndë pushtet
të qivernitarit.
21 Edhe e pyetnë, dyke thënë, Mësonjës, e di-
më se flet e mëson drejtë, edhe nuk' i mban
anë njeriu, po mëson udhën' e Perëndisë me
22 të-vërtetë, A ësht' e udhësë t' i apëmë neve
23 Qesarit page, a po jo? Edhe *ay* si mori vesh
dinakërin'e atyre, u tha atyre, përse më ngitni?
24 Dëfte-më-ni një dinar. Të kujt ka fytyrë e
përmbishkronjë? Edhe ata upërgeqnë e thanë,
25 Të Qesarit. Edhe ay u tha atyre, Ep-ni pra
Qesarit ato që janë të Qesarit, edhe Perën-
26 disë ato *që janë* të Perëndise. Edhe nukë
muntnë t' e zininë prej fjale përpara llauzit;
edhe uçuditnë për të-përgjegjurit'e ati, edhe
s' bënë zë.
27 Uafëruan' edhe disa veta prej Saduqenjet,
të-cilëtë mohonjënë, se ka të-ngjallurë, edhe
28 e pyetnë, Dyke thënë, Moisiu na ka shkruarë

Ndë i vdektë ndonjëj vëllaj që ka grua, edhe
ky të vdesë pa lënë fëmijë, i vëllaj i ati të
marrë gruanë, edhe të ngjallnjë farë për të
29 vëllan' e ti. Ishinë pra shtatë vëllezër; edhe
i-pari mori grua, edhe vdiq pa *lënë* fëmijë.
30 Edhe i-dyti mori gruanë; edhe ky vdiq pa
31 *lënë* fëmijë. Edhe i-treti e mori atë; gjitha-
shtu edhe të shtatëtë; edhe nukë lanë fëmijë,
32 edhe vdiqnë, Edhe më pas nga të-gjithë vdiq
33 edhe gruaja. Ndë të-ngjallurit pra, e kujt nga
ata dotë jetë grua? sepse edhe të shtattë e
34 patnë atë grua. Po Jisuj upërgjeq e u tha a-
tyre. Të-bijt' e kësaj jete martonjën' e marto-
35 nenë; Po ata që ubënë të-zotër të fitonjën' atë
jetë edhe të-ngjalluritë prej së-vdekurish as
35 martonjën' as martonenë; Sepse as të vdesë-
në nukë muntnjënë më; sepse janë si-një-një
me ëngjëjtë; edhe janë bij të Perëndisë, kur
37 janë bij të të-ngjallurit. Edhe se ngjallenë të-
vdekuritë, edhe Moisiu e dëfteu ndë ferrët,
kur thotë, Zotinë Perëndin' e Avraamit edhe
Perëndin' e Isaakut edhe Perëndin' e Jakovit.
38 Edhe Perëndia nuk'është *Perëndi* të-vdekurish,
po të-gjallësh; sepse të-gjithë rronjënë mb'
39 atë. Edhe disa nga shkronjësit' upërgjeqnë, e
40 thanë. Mësonjës, mirë the. Edhe nukë kuxo-
ninë më t'a pyetninë për asgjë.
41 Edhe ay u tha atyre, Qysh thonë, se Krishti
42 është bir' i Dhavidhit? Edhe Dhavidhi vetë
thotë ndë vivlit të Psallmavet, „I tha Zoti

BKSH

43 Zotit t'im, Pri mbë të-djathtët t'im, Gjersa
të vë armiqt' e tu ndënëkëmbje të këmbëvet
44 të tua.“ Dhavidhi pra e quan atë Zot, e qysh
45 është i bir' i ati? Edhe tek po dëgjonte gji-
46 thë llauzi, u tha nxënëset të ti, Ruhi nga
shkronjësitë që duanë të ecënjënë të-stolisurë,
edhe duanë të-përshëndoshura ndëpër tregjet,
edhe fronet' e-parë ndëpër sinagogjit, edhe
47 vëndet' e-parë ndëpër darkat; Të-cilëtë hanë
shtëpit' e të-vavet, dyke shtyrë shkak se fa-
lenë shumë. Këta dotë marrënë më tepërë
mundim.

Krye 21

1 Edhe shtyri syt' e pa të-pasuritë që hith-
2 ninë dhuratat' e tyre ndë thesart. Pa edhe
një grua të-ve e të-vobektë dyke hedhurë
3 atje dy të-imëta; Edhe tha, Me të-vërtetë po
u them juve, se këjo grua e-ve edhe e-vo-
4 bektë hodhi më shumë se të-gjithë; Sepse
gjithë këta prej tepëricës' së tyre hothnë ndë
dhuratat të Perëndisë, po kjo prej skamjes'
së saj hodhi gjithë gjën' e saj që pat.
5 Edhe disa tek po flisninë për hierorenë,
se ësht' e-stolisurë me gurë të-bukur' e me
6 dhurata, tha, Këto që vini re, dotë vinjënë
dit, ndë të-cilat nukë dotë mbetetë gur mbi
gur, që të mos rrëzonetë.
7 Edhe e pyetnë, dyke thënë, Mësonjës, kur
pra dotë bënenë këto? edhe ç' shënjë *dotë jetë*,
kur dotë bënenë këto?

8 Edhe ay tha, Shikoni të mos gënjehi; se-
pse shumë veta dotë vinjënë mb' emërit t' im,
dyke thënë, Se unë jam; edhe, se Koha ua-
9 fërua. Mos shkoni pra prapa atyreve. Edhe
kur të dëgjoni luftëra e trazyra, mos ufrikë-
soni; sepse këto duhetë të bënenë më për-
para; po nuk' *është* për-një-herë fundi.
10 Atëhere u thoshte atyre, Dotë ngrihetë komp
kundrë kombi, edhe mbretëri kundrë mbretërie;
11 Edhe dotë bënenë tërmete të-mëdhenj vënde
mbë vënde, edhe zira e murtaja,edhe dotë jenë
gjërra të-frikçime e shënja të mëdha prej qiellit.
12 Po para gjithë këtyreve dotë vënë duart'
e tyre mbi ju, edhe dot' u ndjekënë, e dot' u
apënë ndër duar ndëpër sinagogji e ndë-
për burgje, dyke prurë juve përpara mbre-
tërve e qivernitarëve për punë t' emërit t' im.
13 Edhe *Këjo* dot' u jetë juve për dëshmim.
14 Viri pra ndë zëmërat t' uaj *këtë,* të mos men-
15 dohi më përpara me ç' fjalë të përgjigji; Se-
pse unë dot' u ap juve gojë e urtësi, ndë të-
cilët nukë dotë muntnjënë të flasënë kundrë,
as të rrinë kundrë gjithë kundrështarëtë t' uaj.
16 Edhe dotë epeni ndë dorë edhe prej prindërsh
e prej vëllezërish e prej njerëzish t' uaj e prej
miqsh; edhe dotë vrasënë *disa* prej jush;
17 Edhe të-gjithë dot' u kenë çmir juve për e-
18 mërinë t' im; Po *asnjë* qime prej krejt t' uaj
19 s' është për të humburë. Me durimnë t' uaj
dotë fitoni shpirtetë t' uaj.

20 Edhe kur të shihni Jerusalimënë të-rrethuarë
prej ushtërive, atëhere di-e-ni, se uafërua të-
21 shkretuarët' e asaj. Atëhere ata *që të jenë* ndë
Judhe, letë ikëjnë ndëpër malet; edhe ata *që
të jenë* brënda nd'atë, letë dalënë jashtë;
edhe ata që të jenë ndëpër fshatërat, letë mos
22 hynjënë brënda nd'atë. Sepse dit çpagimi
jan' ato, që të mbushenë gjith' ato që janë
23 shkruarë. Edhe mjer' ato gra që janë me ba-
rrë e që kanë foshnjë mbë gji nd' ato dit se-
pse dotë jetë shtrëngim i-math mbi dhet, edhe
24 zëmërim mbë këtë llaus. Edhe dotë bjenë me
gojë thike, edhe dotë skllavosenë ndëpër gji-
thë kombet; edhe Jerusalima dotë shkeletë
prej kombesh, gjersa të mbushenë kohërat'
e kombevet.
25 Edhe dotë jenë shënja ndë djellët e ndë
hënët e ndë yjt; edhe mbi dhet shtrëngim
kombesh që nukë dinë *ç' dotë bënenë*; edhe
26 dotë buçinjë deti edhe valëtë; Njerëzet dot'
u dalë shpirti nga frika e nga të-priturit' e
të-këqiavet që po vinjënë mbi botët; sepse
27 fuqit' e qiellit dotë tundenë. Edhe atëhere dotë
shohënë të Birin' e njeriut dyke ardhurë ndë
28 re me fuqi e me lavdi të-madhe. Edhe kur
të zënë këto të bënenë, shikoni lart edhe
ngrini krerëtë t' uaj; sepse po afëronetë çpër-
blimi juaj.
29 Edhe u tha atyre një paravoli. Sihni dru-
30 rin' e fikut edhe gjithë drurëtë; tashti kur të

çelenë, dyke parë prej vetiu merrni vesh, se
31 tashti vera është afërë. Kështu edhe ju, kur
të shihni këto se bënenë, t' a dini, se mbre-
32 tëri e Perëndisë është afërë. Me të-vërtetë
po u them juve, se ky bres nukë dotë shko-
33 një, gjersa të bënenë të-gjitha *këto.* Qielli
edhe dheu dotë shkonjënë, po fjalët' e mia
nukë dotë shkonjënë.
34 Edhe vini re vetëhenë t'uaj, se mos u rën-
donenë zëmëratë prej të-dejturit e prej të-
pirit e prej kujdesevet të jetësë, e vinjë për-
35 mbi ju papandehuraj ajo ditë; Sepse posi lak
dotë vinjë përmbi gjith' ata që rrinë mbi fa-
36 qet të gjithë dheut. Rrini sgjuarë pra dyke
luturë mbë çdo kohë, që të bëneni të-zotër të
shpëtoni nga gjithë këto që janë për të bërë.
edhe të rrini përpara të Birit të njeriut.
37 Edhe ditënë mësonte ndë hieroret, po na-
tënë dilte jashtë, e e shkonte natënë ndë malt
38 që quhetë i Ullinjet. Edhe gjithë llauzi vinte
që me natë tek ay ndë hieroret për të dë-
gjuar' atë.

Krye 22

1 Edhe po afëronej e-kremtja e të-pabru-
2 mjevet, që quhetë Pashkë. Edhe kryepriftërit
e shkronjësitë kërkoninë se qysh t' a vris-
ninë; sepse kishinë frikë prej llauzit.
3 Edhe Satanaj hyri te Judha që quhej I-
skariot, i-cili ishte nga numëri i të dy-mbë-

4 djetët; Edhe vate e foli me kryepriftërit' e
me të-parët' e ushtëtarëvet, se qysh t' u'a apë
5 ndër duar. Edhe ata ugëzuanë, edhe bënë
6 fjalë t' i apënë ergjënt. Edhe *ay* uzotua edhe
kërkonte kohë të-pëlqyerë që t'u'a ipte nder
duar pa bërë trazyrë.
7 Edhe erdhi dit' e të-pabrumjevet, ndë të
8 cilët duhej të therej kurban' i pashkësë. Edhe
Jisuj dërgoj Pjetrin' edhe Joaninë, dyke thënë,
Ecëni edhe na bëni gati pashkënë, që të ha-
9 më. Edhe ata i thanë, ku do të bëjmë gati?
10 Edhe ay u tha atyre, kur të hyni ju ndë qy-
tet, na tek dot' u pjekë juve një njeri dyke
mbajturë një shtémbë uji; hiqni pas ati ndë
11 shtëpit, ku të hynjë; edhe dot' i thoni të
Zotit të shtëpisë, Mësonjësi të thotë ty, ku
është vëndi, ku dotë ha pashkënë bashkë me
12 nxënësit' e mi. Edhe ay dot' u dëftenjë juve
një dhomë të-madhe të shtruarë; atje bëni
13 gati. Edhe ata si vanë, gjetnë sikundrë u tha
atyre; edhe bënë gati bashkënë.
14 Edhe kur erdhi ora ndënji ndë mësallët,
edhe të dy-mbë-dhjetët' apostoj bashkë me
15 atë. Edhe u tha atyre, Me dëshërim dëshë-
rova të ha këtë pashkë me ju, para se të
16 pësonj; Sepse po u them juve, se s'kam për
të ngrënë më prej asaj, gjersa të mbushetë
17 ndë mbretërit të Perëndisë. Edhe si mori,
ufal ndersë, e tha, Merni këtë edhe nda-e-ni
18 ndër mest t' uaj; Sepse po u them juve, se

s'kam për të pirë prej pemës' së hardhisë,
gjersa të vinjë mbretëri' e Perëndisë.
19 Pastaj mori bukë, e ufal ndersé, edh' e
theu, e u'a dha atyre, dyke thënë, Ky ëstë
trupi im, që epetë për ju; këtë bëni për të
20 përmëndurë mua. Kështu, passi udarkuanë
mori edhe potirinë, dyke thënë, Ky potir është
djata e-re ndë gjakt t'im, që derdhetë për
21 ju, Po na dor' e ati që më trathëton *tek* është
22 bashkë me mua·mbi truvezët. Edhe i Bir' i
njeriut vete sikundrë është urdhëruarë *për
atë*, po mjer' ay njeri, me anë të të-cilit tra-
23 thëtonetë. Edhe ata zunë të bishëtoninë ndër
mest të tyre, se, vallë cili prej atyre dotë
jet' ay që dotë bënjë këtë.
24 Ubë edhe një bishëtim ndër mest t' atyre,
vallë cili prej atyre duketë, se është më i-
25 math. Edhe ay u tha atyre, Mbretërit' e kom-
bevet zotëronjënë mbi ata, edhe ata që kanë
26 pushtet mbi ata quhenë mirëbërës. Po ju
nukë *dotë jini* kështu; po më i-madhi ndër
ju letë bënetë posi më i-vogëli, edhe ay që
27 është i-parë posi ay që shërben. Sepse cili
është më i-math, ay që ka ndënjurë ndë më-
sallët, apo ay që shërben? a jo ay që ka
ndënjurë ndë mësallët? Po unë jam ndër
28 mest t'uaj posi ay që shërben. Edhe ju jini
ata që keni qëndruarë bashkë me mua ndë
29 ngasjet të mia. *Përandaj* edhe unë bënj gati
për ju një mbretëri, sikundrë im Atë për mua,

BKSH

30 Që të hani e të pini mbë truvezët t' ime ndë
mbretërit t'ime, edhe të rrini mbi frone, dyke
gjykuarë të dy-mbë-dhjetë farat' e Israilit.
31 Edhe Zoti tha, Simon, Simon, na Satanaj
tek u kërkoj juve, që t' u shoshnjë posi gru-
32 rëtë. Po un' u luta për ty, që të mos të shte-
retë besa; edhe ti, kur të kthenesh, forco vë-
33 llezërit' e tu. Po ay i tha, Zot, jam gati të vete
bashkë me ty edhe ndë burk edhe ndë vde-
34 kje. Po ay tha, Pjetër, po të them tyj, nukë
dotë këndonjë sot këndesi, para se të më
mohonjç tri herë, se nukë më njeh.
35 Pastaj u tha atyre, kur u dërgova juve
pa kuletë e pa trajshtë e pa këpucë, mos u
36 shteri gjë juve? Edhe ata thanë, Asgjë. U
tha pra atyre, Po tashi ay që të ketë kuletë,
le t'a marrë *me vetëhe*; kështu edhe trajshtë;
edhe ay që të mos ketë, le të shesë rrobën'
37 e ti, edhe letë blerë thikë. Sepse po u them
juve, se edhe këjo e-shkruarë duhetë të mbu-
shetë mbë mua, se, „Edhe mé të-paudhëtë
unumërua;“ sepse të shkruaratë për mua po
38 marrënë funt. Edhe ata thanë, Zot, na tek
janë këtu dy thikë. Edhe ay u tha atyre,
Mjaftështë.
39 Pastaj dolli e vate, sikundrë e kishte za-
kon ndë malt të Ullinjet; edhe i vanë pas
40 edhe nxënësit' e ti. Edhe si erdhi ndë vëntt,
u tha atyre, Fali për të mos hyrë ndë ngasje.
41 Edhe ay unda nga ata sa një të-hedhurë

BKSH

42 guri, edhe ra mbë gjunjë e falej, Dyke thënë,
O Atë, ndë daç të largonjç këtë potir prej
meje; përveç jo dashurimi im, po yti le të
43 bënetë. Edhe i uduk *një* ëngjëll prej qielli
44 dyke dhënë fuqi ati. Edhe si erdhi ndë shtrën-
gim shpirti falej më tepërë. Edhe djersa e
ati ubë posi të-ngrira pika gjaku dyke rënë
mbi dhet.
45 Edhe si ungrit nga të-faluritë, erdhi te
nxënësit' e ti, e i gjeti dyke fjeturë nga hi-
46 dhërimi, E u tha atyre, Ç' flini? ngreuni e
fali, që të mos hyni ndë ngasje.
47 Edhe ay tek po fliste, na gjindja, edhe ay që
thuhej Judhë, një nga të dy-mbë-dhjetëtë, tek
po vinte përpara atyreve, edhe uafërua te
48 Jisuj, që t' e puthte. Edhe Jisuj i tha, Judhë,
me të-puthurë trathëton të Birin' e njeriut?
49 Edhe ata *që ishinë* rreth ati kur panë, se
ç'dotë bënej, i thanë, Zot, t' u bjemë me thikë?
50 Edhe një nga ata i ra shërbëtorit të krye-
51 priftit, edhe i preu veshn' e djathtë. Po Jisuj
upërgjeq e tha, Ler-e-ni gjer këtu; edhe zuri
veshn' e ati, edhe e shëroj:
52 Edhe Jisuj u tha kryepriftëret e të- parë-
vet të hieroresë e pleqet që kishinë ardhurë
mbi atë, Posi mbi kursar keni dalë me thikë
53 e me dru? Unë përdita jeshe me ju ndë hie-
roret, edhe nukë shtritë duartë mbi mua. Po
këjo është ora juaj, edhe pushteti i errësirësë.
54 Edhe si e zunë, e shpunë, edhe e prunë

BKSH

ndë shtëpit të kryepriftit. Edhe Pjetri i vinte
pas për së-largu.
55 Edhe ata si ndezë zjarr ndë mest të ho-
borit, edhe ndënjnë bashkë, rrinte *edhe* Pje-
56 tri ndë mest t'atyreve. Edhe një shërbëtore,
kur e pa atë dyke ndënjurë drejt dritësë, e
dyke shtyrë sytë mb' atë tha, Edhe ky ishte
57 baskë me atë. Po ay e mohoj, dyke thënë,
58 O grua, nuk' e njoh. Edhe pas pakëzë e pa
atë një tjetërë, edhë tha, Edhe ti je prej a-
59 tyreve. Po Pjetri tha, O njeri, nukë jam. Edhe
passi shkoj si ndonjë orë, një tjetërë qën-
dronte me fuqi, dyke thënë, Me të-vërtetë
edhe ky ishte bashkë me atë; sepse edhe
60 Galileas është. Po Pjetri tha, O njeri, nukë
di se ç'thua. Edhe për-një-here, tek ishte ay
61 edhe dyke folurë, këndoj këndesi. Edhe Zoti
ukthye e shtyri sytë mbi Pjetrinë; edhe Pje-
trit i ra ndër mënt fjal' e Zotit që i pat thënë
se, para se të këndonjë këndesi, dotë më mo-
62 honjç tri herë. Edhe Pjetri dolli jashtë, edhe
qau hidhurë.
63 Edhe ata burratë që mbaninë Jisunë e
64 përqeshninë edhe e rrihninë; Edhe dyke mbu-
luarë syt'e ati i bininë faqesë edhe e pyet-
ninë, dyke thënë, Profiteps, cili është ay që
65 të ra? Edhe i thoshninë shumë të-tjera dyke
sharë.
66 Edhe si ubë ditë, umbloth pleqësi' e lla-
uzit e kryepriftërit' [e shkronjësitë, edhe e

prunë lart ndë bashkëndënjet të tyre, dyke
67 thënë, Ndë je ti Krishti, thua-na. Edhe ay u tha
atyre, Ndë u thënça juve, nukë dotë besoni;
68 Edhe ndë u pyeça, nukë dotë më përgjigji,
69 as nukë dotë *mè* lëshoni. Që tashi i Bir' i
njeriut dotë jetë dyke ndënjurë prej së djath-
70 tës' së fuqis' së Perëndisë. Atëhere të-gjithë
thanë, Ti pra je i Bir' i Perëndisë? Edhe ay
71 u tha atyre, Ju po thoni se unë jam. Edhe
ata thanë, Ç' nevojë kemi më për dëshmim,
sepse *neve* vetë e dëgjuamë prej gojës' s' ati.

Krye 23.

1 Atëhere gjithë shumica e atyreve ungritnë,
edhe e prunë te Pillati.
2 Edhe zunë t'e përflisninë, dyke thënë, se
këtë e gjetmë dyke prishurë kombinë, edhe
dyke ndaluarë *njerëzitë* t'i apënë pagesa Qe-
sarit, dyke thënë për vetëhen' e ti se është
3 Krishti mbreti. Edhe Pillati e pyeti, dyke
thënë, Ti je mbreti i Judhenjet? Edhe ay u-
përgjeq e i tha, Ti po thua.
4 Edhe Pillati u tha kryepriftërvet edhe
gjindjesë, Asndonjë faj nukë gjenj te ky njeri.
5 Po qëndroninë me fuqi dyke thënë, Se tra-
zon llauzinë, dyke mësuarë ndëpër gjithë Ju-
dhenë, dyke zënë që nga Galilea e gjer këtu.
6 Edhe Pillati kur dëgjoj *fjalënë* Galilea, pyeti,
7 ndë është njeriu Galileas. Edhe kur e mori
vesh, se ishte prej *vëndit të* pushtetit të Iro-

dhit, e dërgoj te Irodhi, i-cili edhe ay ato dit
ishte ndë Jerusalim.
8 Edhe Irodhi kur pa Jisunë, ugëzua shumë;
se kish mjaft kohë që doj t' a shihte, sepse
kishte dëgjuarë shumë *gjërra* për atë; edhe
shprente të shihte ndonjë shënjë të bënej
9 prej ati. Edhe e pyeste me shumë fjalë; po
10 ay nuk' i përgjigjej asgjë. Edhe kryepriftërit'
e shkronjësitë rrininë dyke përfolur' atë me
11 nxehtësirë të-madhe. Edhe Irodhi bashkë me
ushtëtarët' e ti e bëri për asgjë, edhe e për-
qeshi, edhe i veshi një rrobë të-ndriçime,
12 edhe e dërgoj përsëri te Pillati. Edhe nd' atë
ditë Pillati edhe Irodhi u bënë miq njeri me
tjatrinë; sepse më përpara ishinë nd' armi-
qësi njeri me tjatrinë.
13 Edhe Pillati si thirri bashkë kryepriftërit
14 edhe të-parët' edhe llauzinë, U tha atyre,
Prutë këtë njeri tek unë, se sikur trazon lla-
uzë; edhe na unë përpara jush e pyeta hollë
hollë, edhe nukë gjeta ndonjë faj te ky njeri
15 nga sa të-përfolura thoni kundr' ati; Po as
Irodhi; sepse u dërgova juve tek ay; edhe
na asgjë të-vëjejturë për vdekje s'ka bërë.
16 Passi t'a mundonj pra, dot' e lëshonj.
17 Edhe prej nevoje duhej t' u lëshonte atyre
18 një *nga të-burgosuritë* për të-kremte. Po të-
gjithë bashkë bërtitnë, dyke thënë, Ngrej-e
19 këtë, edhe na lësho Varavvanë, I-cili ishte
hedhurë ndë burk për një trazirë që ishte
bërë ndë qytett, edhe për vrasje.

20 Përsëri pra Pillati u foli *atyre*, sepse donte
21 t'a lëshonte Jisunë. Po ata thërritninë, dyke
22 thënë, Kryqëzo-e, kryqëzo-e. Edhe ay për të-tre-
tënë herë utha atyre, Përse, ç'të-keqe ka bërë?
asndonjë faj për vdekje s' gjeta tek ay; passi
23 t'e mundonj pra, dot' e lëshonj. Po ata qën-
droninë me zë të-math, dyke kërkuarë të
kryqëzonetë; edhe zëret' e atyre e të krye-
priftëret po forconeshinë shum' e më shumë.
24 Edhe Pillati vendosi të bënetë kërkimi i a-
25 tyre. Edhe u lëshoj atyre atë që ishte he-
dhurë ndë burkt për trazirë e për vrasje, të-
cilënë e kërkoninë, po Jisun' e dha ndë da-
shurimt t'atyre.
26 Edhe si e nxuarnë jashtë, zunë një farë
Simon Qirineas, që ishte dyke ardhurë nga
ara, edhe i vunë kryqnë mbë krahë, që t'e
sillte prapa Jisujt.
27 Edhe i vininë prapa shumë shumicë llauzi,
e grash, të-cilatë edhe çireshin' e ulërininë
28 për atë. Po Jisuj u kthye e u tha atyre, Bija
të Jerusalimit, mos qani për mua, po qani
për vetëhenë t' uaj edhe për fëmijënë t' uaj.
29. Sepse na tek po vinjënë dit, ndë të-ciiat
dotë thonë, Lum beronjatë, edhe ata barke
që nukë puallë, edhe ata gjij që nukë dhanë
30 sisë. Atëhere dotë zënë t' u thonë malevet
Bini mbi ne; edhe kodravet, Mbulo-nà-ni.
31 Sepse ndë mbë drun'e-njomë bënjënë këto,
mbë të-thatënë ç'dotë bënetë?

32 Po silleshinë edhe dy të-tjerë keq-bërës,
që të vriteshinë bashkë me atë.
33 Edhe kur erdhë ndë vëntt që quhetë
vënd' i Kresë, atje kryqëzuan' atë, edhe keq-
bërësitë, njërinë mbë të-djathtë, edhe tjatri-
34 në mbë të-mëngjërë. Edhe Jisuj thoshte, O
Atë, ndje-i ata; sepse nukë dinë se ç'bënjënë.
Edhe dyke ndarë rrobat' e ati, shtynë shortë.
35 Edhe llauzi rrij e po vështronte. Edhe të-
parët' e përqeshninë bashkë me ata, dyke
thënë, Të-tjerë shpëtoj; letë shpëtonjë vetë-
hen' e ti, ndë është ky Krishti, i-sgjedhuri i
36 Perëndisë. Edhe e përqeshnin' atë edhe u-
shtëtarëtë, dyke afëruarë e dyke dhënë atij
37 uthullë, Edhe dyke thënë, Ndë je ti mbreti i
Judhenjet, shpëto vetëhenë t' ënde.
38 Edhe ishte shkruarë mbi atë edhe një për-
mbishkronjë me shkronja Gërqishte e Lla-
tinishte e Ebraishte, **Ky është mbreti i
Judhenjet.**
39 Edhe një nga ata keq-bërësitë që ishinë
varurë e shante atë, dyke thënë, Ndë je ti
Krishti, shpëto vetëhenë t' ënde edhe neve.
40 Po tjatëri upërgjeq, edh' e qërtoj atë, dyke
thënë, As nga Perëndia s' ke frikë ti, i-cili
41 je ndë një dënim me atë? Edhe neve me të-
drejtë *jemi dënuarë;* sepse marrmë çpagim
sikundrë na vjen për sa punuamë; po ky as
42 ndonjë të-keqe nukë bëri. Pastaj i thoshte Kri-
shtit, Kujto-më, o Zot, kur të vish ndë mbretë-

BKSH

43 rit t'ënde. Edhe Jisuj i tha, Me të-vërtetë po të
them, sot dotë jesh bashkë me mua ndë para-
dhist.
44 Edhe ora ishte sindonja gjashtë, edhe ubë
errësirë mbë gjithë dhenë gjer mbë të-nënt-
45 tënë orë. Edhe djelli uerr; edhe kurtina e
tempullit uça për mesi.
46 Edhe Jisuj thirri me zë të-math, e tha,
O Atë, ndër duart të tua ap shpirtinë t' im.
Edhe si tha këto, dha shpirtinë.
47 Edhe krye-qindësi, kur pa se ç' ubë, lav-
duroj Perëndinë, dyke thënë, Me të-vërtetë
ky njeri paskërka qënë i-drejtë.
48 Edhe gjithë gjindja që kishin' ardhurë
bashkë për të vënë re, kur panë se ç' ubë,
ktheheshinë dyke rrahurë krahërorët' e tyre.
49 Edhe rrininë gjithë të-njohurit' e ti për së-
largu, *si* edhe gratë që kishin' ardhurë bashkë
me atë nga Galilea, dyke shikuarë këto *punë*.
50 Edhe navoka një burrë që quhej Josif, i-
cili ishte an' e këshillësë, njeri i-mir' e i-drej-
51 të, (Ky nukë pat qënë ndë një mëndje ndë
këshillët e ndë punët t' atyre;) nga Arimathea,
një qytet i Judhenjet, i-cili edhe vetë priste
52 mbretërin' e Perëndisë. Ky erdhi përanë Pi-
53 llatit, edhe lypi trupin' e Jisujt. Edhe si e sbri-
ti, e pshtolli me pëlhurë, edhe e vuri ndë një
varr të-gdhëndurë ndë gur, ku asndonjë ku-
54 rrë s' ishte vënë. Edhe ishte dit' e-prëmte,
edhe gdhihej e-shëtunë.

55 Edhe i vanë prapa edhe gra, të-cilatë ki-
shin' ardhurë bashkë me atë nga Galilea, e
panë varrinë, edhe se si uvu trup' i ati' *atje.*
56 Edhe ukthyen' e bënë gati erëra të-mira e
vajra ere; edhe të-shëtunën' uprëjtnë pas po-
rosis' *së nomit.*

Krye 24

1 Edhe ditën' e-parë të javësë, fort që me
natë, erthnë mbi varrt, e prunë ato erërat'e-
mira, të-cilatë kishinë bërë gati; *ishinë* edhe
2 ca veta bashkë me ato. Edhe gjetnë gurrë të-
3 rrukullisurë prej varrit. Edhe si hynë brën-
4 da, nuk' e gjetnë trupin' e Zotit Jisu. Edhe
këto tek po vrisninë mëndjenë për këtë punë,
na tek qëndruanë përpara atyre dy burra
5 me rroba që vetëtininë. Edhe me-qënë-që ato
ufrikësuanë, edhe ulnë faqenë mbë dhet, *ata*
u than' atyre, Ç' kërkoni të-gjallinë ndër të-
6 vdekurit? Nuk' është këtu, po ungjall. Kujto-
hi, si u pat folë juve, kur qe edhe ndë Ga-
7 lilet, Dyke thënë, Se duhetë i Bir' i njeriut
të epetë ndër duar njerëzish fajtorë, edhe të
kryqëzonetë, edhe të-tretënë ditë të ngjalletë.
8 Edhe u ranë ndër mëntt atyre fjalët' e ati,
9 Edhe si ukthyenë nga varri, u dhanë zë
për gjithë këto të një-mbë-dhjetët edhe gji-
10 thë të-tjerëvet. Edhe ishinë Maria Magdha-
linë, edhe Joana, edhe Maria e ëm'e Jakovit,
edhe të tjeratë bashkë me ato, të cilatë u

11 thoshnin' apostojvet këto *fjalë*. Po fjalët' e a-
tyreve u-duknë përpara atyreve posi fjalë të-
sbrazëta, edhe nuk' u zininë besë atyre.
12 Edhe Pjetri ungrit e vate me vrap ndë
vartt; edhe uunj e pa pëlhuratë që ishinë për-
dhe vetëmë; Edhe iku dyke çuditurë me ve-
tëhen' e ti për këtë punë.
13 Edhe na dy veta prej atyreve tek ishinë
dyke vaturë atë ditë ndë një fshat që quhej
Emmaus, që ishte gjashtë-dhjetë stadhe lark
14 nga Jerusalimi. Edhe ata flisninë ndër mest
15 të-tyre për gjithë këto që kishinë ngjarë. Edhe
kur po flisnin' e haeshinë njëri me tjetrinë
uafërua edhe vetë Jisuj, e ecënte bashkë me
16 ata. Po syt' e atyre mbaheshinë për të mos
njohur' atë.
17 Edhe *ay* u tha atyre, *Ç' janë* këto fjalë
që flitni njëri me tjatrinë dyke ecurë, edhe
18 përse jini të vrërëtë? Edhe njëri, që e kishte
emërinë Kleopë, upërgjeq e tha, Vetëmë ti
qënke i huaj ndë Jerusalim, edhe s' paske
marrë vesh se ç' janë bërë nd' atë ndër këto
19 dit? Edhe ay u tha atyre, Cilatë? Edhe ata
i thanë, Punët' e Jisu Nazoreasit, i-cili qe
njeri profit, i fortë ndë punë e ndë fjalë për-
20 para Perëndisë edhe gjithë llauzit; edhe si
kryepriftërit' edhe të-parëtë t'anë e dhanë ndër
duar për dënim vdekjeje, edhe e kryqëzuanë.
21 Edhe neve shprenimë, se ay ishte ay që ki-
shte për të çpërblyerë Israilinë. Po mbi gjithë

BKSH

këto, sot ësht' e treta ditë që kur se ubënë
22 këto; Po edhe ca gra prej nesh na habitnë,
të cilatë vanë çpejt që me natë ndë varrt;
23 Edhe passi nukë gjetnë trupin' e ati, erthnë
dyke thënë, se kishınë parë edhe një të-du-
24 kur' ëngjëjsh, të-cilëtë thanë, se ay rron. Edhe
ca nga t' anëtë vanë ndë varrt, edhe gjetnë
kështu, sikundrë than' edhe gratë; po atë
25 nuk e panë. Atëhere ay u tha atyre, O të
marrë edhe të-mënuarë ndë zëmërët për të-
26 besuarë gjith' ato që folnë profitëritë. Nukë
duhej të pësonte këto Krishti, edhe të hynte
27 ndë lavdit të ti? Edhe dyke zënë që nga Mo-
isiu edhe që nga gjithë profitëritë, u sgithte
atyre ato *që ishinë shkruarë* për atë ndëpër
gjithë shkronjat.
28 Edhe uafëruanë ndë fshatt, që po vininë;
Edhe ay ubë sikur kishte për të vaturë më
29 tej. Po ata e shtrënguanë tepërë, dyke thënë,
Mbetu bashkë me ne, sepse është ndaj të-
ngrysurë, edhe dita uthye. Edhe ay hyri për
30 të mbeturë bashkë me ata. Edhe si ndënji
ndë mësalët bashkë me ata, mori bukënë, e
bekoj, edhe e theu, edhe u' a ndau atyre.
31 Atëhere uhapnë syt' e atyre, edhe e njohnë;
32 po ay humbi prej sysh t' atyre. Edhe ata i
thanë njëri tjatërit, Nukë digjej zëmëra jonë
ndër ne, kur na fliste udhësë edhe na sgith-
te shkronjatë.
33 Edhe ungritnë nd' atë orë, edhe ukthyenë

BKSH

ndë Jerusalim, edhe gjetnë mbledhurë bash-
kë të dy-mbë-dhjetëtë, edhe ata që ishinë
34 bashkë me ata, Të-cilëtë thoshinë, Se me të-
vërtetë Zoti ungjall, edhe uduk te Simoni.
35 Edhe ata *prapë* dëfteninë ç' *punë u* ngjanë
udhësë, edhe si unjoh tek ata ndë të-thye-
rët të bukësë.
36 Edhe ata tek po flisninë këto, vetë Jisuj
qëndroj ndë mest t' atyreve, edhe u thotë,
37 Paqtim mbë ju. Po ata utrëmpnë e ufrikë-
suanë, sepse u dukej, se po shihninë *ndonjë*
38 frymë. Edhe ay u tha atyre, Përse jini të-
trumbulluarë? edhe përse hipnjënë ndë zëmë-
39 rat t' uaj mendime? Shihni duart' e mia edhe
këmbët' e mia, se unë jam ay; zë-më-ni edhe
shihni; se fryma s' ka mish e eshtëra, sikun-
40 drë sihni mua se kam. Edhe si tha këtë, u
41 dëfteu duart' edhe këmbëtë. Po tek nukë be-
soninë ata nga gëzimi edhe çuditeshinë, u
tha atyre, A kini gjë për të ngrënë këtu?
42 Edhe ata i dhanë një copë peshku të-pjeku-
43 rë edhe hoj mjaltë. Edhe ay mori e hëngri
përpara atyreve.
44 Pastaj u tha atyre, Këto *jan' ato* fjalë, që
u fola juve, kur ishnjam bashkë me ju, se
duhetë të mbushenë gjith' ato që janë shkru-
arë ndë nomt të Moisiut edhe ndë profitërit
45 edhe ndë Psallmat për mua. Atëhere u hapi
mëndjen' atyre, që të merrninë vesh shkro-
46 njatë. Edhe u tha atyre, Se kështu është shkru-

arë, edhe kështu duhej të hiqte Krishti, edhe
të ngjallej prej së-vdekurish të-tretënë ditë,
47 Edhe të lëçitej mb'emërit t' ati pendim edhe
ndjesë fajesh mbë gjithë kombet, dyke zënë
48 nga Jerusalimi. Edhe ju jeni dëshmimtarë
49 për këto. Edhe na unë tek po dërgonj të-zo-
tuarat'e t'im Et mbi ju; edhe ju 'rrini ndë
qytett Jerusalim, gjersa të vishi me fuqi prej
së-larti.
50 Pastaj i nxori jashtë gjer ndë Vithani;
51 edhe ngriti duart' e tia e i bekoj. Edhe ay
dyke bekuar' ata unda nga ata, edhe birej
52 lart ndë qiellt. Edhe ata si i ufalnë ati, ukthy-
53 enë ndë Jerusalim me gëzim të-math. Edhe
ishinë gjithënjë ndë hieroret, dyke lavduruarë
e dyke bekuarë Perëndinë. Amin.

BKSH

Ungjilli pas Joanit.

Krye 1

1 Që përpara herësë ishte Fjala, edhe Fjala
ishte me Perëndinë, edhe Fjala ishte Perëndi,
2 Këjo ishte që përpara herësë me Perëndinë.
3 Të-gjitha u bënë me anë t' asaj; edhe pa
atë nuk' ubë as ndonjë *gjë* që është bërë.
4 Nd' atë ishte jetë, edhe jeta ishte drita e
5 njerësvet. Edhe drita ndrit nd' errësirët, edhe
errësira nuk' e kupëtoj.
6 Qe *një* njeri dërguarë nga Perëndia, i-
7 cili *e kishte* emërinë Joan. Ky erdhi për dësh-
mim, që të apë dëshmim. Dritënë, që të be-
8 sonjënë të-gjithë me anë t' ati. Ay nuk' ishte
Drita, po *qe dërguarë* që të apë dëshmim
për Dritënë.
9 Ishte Drita e-vërtetë, që ndrit çdo njeri,
10 kur vjen ndë botët. Ishte ndë botët, edhe
bota ubë me anë t' ati; po bota nuk' e njohu
11 atë. Erdhi ndë të-tijt, edhe të-tijtë nuk' e
12 pritnë atë. Edhe sa e pritnë, atyre u dha
pushtet të bënenë bij Perëndie, atyreve që
13 besonjënë me anë t' ati; Ata nukë lintnë
brej gjakesh, as prej dashurimi mishi, as
prej dashurimi burri, po prej Perëndie.

BKSH

14 Edhe Fjala ubë mish, edhe ndënji ndër
ne, (edhe pamë lavdin' e ati, lavdi posi të-
vetëmlinduri prej Atit,) plot me hir e me të-
vërtetë.
15 Joani ep dëshmim për atë, edhe bërtiti, dy-
ke thënë, Ky është ay për të-cilinë thashë,
Ay që vjen pas meje është më i-math se unë,
sepse ishte përpara meje.
16 Edhe të-gjithë ne muarmë prej të-mbushu-
17 rit t' ati, ethe hir ndë vënt hiri. Sepse
nomi udha me anë të Moisiut, po hiri edhe
18 e-vërteta ubë me anë të Jisu Krishtit. As-
ndonjë kurrë s' e ka parë Perëndinë; *veç* i-
Uetëmlinduri Bir, që është ndë gjit të Atit
ay *na* e dëfteu.
19 Edhe ky është dëshmimi i Joanit, kur
dërguanë Judhenjtë nga Jerusalimi priftër edhe
20 Levitër që t'a pyesënë, Gili je ti? Edhe
rrëfeu, edhe nukë mohoj; edhe rrëfeu, Se
21 unë nukë jam Krishti. Edhe e pyetnë Çë pra?
Jlia je ti? edhe thotë, Nukë jam. Profiti je ti?
22 edhe upërgjeq, Jo. I thanë pra, Cili je? që t'
u përgjigjemi atyreve që na kanë dërguarë?
23 ç' thua për vetëhenë t'ënde? Tha, „unë *jam*
zër' i ati që bërtet ndë shkretëtirët, Drej-
toni udhën' e Zotit." sikundrë tha profiti Isai.
24 Edhe ata që qenë dërguarë ishinë prej
25 Farisenjet; Edhe e pyetnë e i thanë, Përse
26 pra pagëzon, kur nukë je ti Krishti, as Ilia,
as profiti? Joani u upërgjeq atyrë, dyke thë-

BKSH

në, Unë pagëzonj me ujë; po ndër mest t'
27 uaj rri ay që ju nuk' e njihni; Ay është ay
që vjen pas meje, i-cili është më i-math se
unë; të-cilit unë s' jam i-zoti t' i sgith rripin'
28 e shollësë. Këto ubënë ndë Uithavara përtej
Jorthanit, *atje* ku isthe Joani dyke pagëzuarë.
29 Ndë të-nesërmet Joani sheh Jisunë dyke
ardhurë tek ay, edhe thotë, Na Qëngji i Pe-
30 rëndisë, që ngre fajin' e botësë. Ky ësht' ay,
për të-cilinë unë *u* thashë, *se* Pas meje vjen
një burre, i-cili është më i-math se unë, se-
31 pse ishte përpara meje. Edhe unë s' e njo-
ha; po që të dëftenetë ndë Israilt, përandaj
erdha unë dyke pagëzuarë me ujë.
32 Edhe Ioani dha pëshmim, dyke, thënë, Se
pashë Frymën' *e-Shënjtëruarë* dyke sbriturë
nga qielli posi pëlump, edhe ndënji mbi atë.
33 Edhe unë nuk' e njoha; po ay që më dërgoj të
pagëzonj me ujë, ay më tha, *Ay* përmbi të-
cilinë të shohç Frymën' *e-Shënjtëruarë* dyke
sbritur' e dyke ndënjurë mbi atë, ky ësht' ay
34 që pagëzon me Frymë të-Shënjtëruarë. Edhe
un' e pashë, edhe dhashë dëshmim, se ky
është i Bir' i Perëndisë.
35 Ndë të-nesërmet përsëri Joani ishte dyke
36 ndënjurë, edhe dy prej nxënëset të ti; Edhe
kur shtyri sytë e pa Jisunë dyke ecurë, thotë,
37 Na Qëngji i Perëndisë. Edhe të dy nxënësitë
dëgjuanë atë dyke folurë, edhe vanë pas Ji-
38 sujt. Edhe Jisuj kur ukthye, edhe pa ata dyke

BKSH

vaturë pas ati, u thot' atyre, Ç' kërkoni?
39 Edhe ata i thanë, Ravvi, (që e-kthyerë do
40 me thënë, Mësonjës,) ku e ke të-ndënjuritë?
41 U thot' atyre, Ejani ethe shihni. Erthnë edhe
panë ku e kishte të-ndënjuritë; edhe mbetnë
përan' ati atë ditë; edhe ora ishte sindonja
dhjetë.
42 Andhreu, i vëllaj i Simon Pjetrit, ishte një-
ri nga ata të dy që dëgjuanë prej Joanit
43 *për atë*, edhe vanë pas ati. Ky më përpara
gjen të vëllan' e ti Simoninë, edhe i thotë,
gjetmë Messinë, që e-kthyerë domethënë Kri-
44 shti. Edhe e pruri te Jisuj. Edhe Jisuj shtyri
sytë mb' atë, edhe tha, Ti je Simoni, i bir' i
Jonajt; ti dotë quhesh Qifa, që e-kthyerë do
methënë Pjetër (gur).
45 Ndë të-nesërmet Jisuj deshi të dalë ndë
46 Galilet; edhe gjen Filipinë, e i thotë, Eja pas
meje. Edhe Filipi ishte nga Uithsaidhaja,
nga qyteti i Andhreut edhe i Pjetrit.
47 Filipi gjen Nathanailinë, edhe i thotë;Ke-
mi gjetur' *atë* që shkroj Moisiu ndë nomt,
edhe profitëritë, të birin' e Josifit *që është*
48 nga Nazareti. Edhe Nathanaili i tha, Amunt
të dalë ndonjë gjë e-mirë nga Nazareti? Fi-
49 lipi i thotë, Eja edhe shih. Jisuj pa Natha-
nailinë dyke ardhurë tek ay, edhe thotë për
atë, Shih *një* Israilit me të-vërtetë, tek i-cili
50 gënjeshtrë nukë ka. Nathanaili i thotë, Që
ku më njeh? Jisuj upërgjeq e i tha, Para se

BKSH

të të thërresë Filipi, kur ishnje ndënë drut
51 të fikut, *unë* të pashë. Nathanaili upërgjeq e
i thotë, Ravvi, ti je i Bir' i Perëndisë, ti je
52 mbreti i Israılit. Jisuj upërgjeq e i tha, Sepse
të thashë, *se* Të pashë ndënë drut të fikut
beson? dotë shohç më të mëdha se këto.
53 Pastaj i thotë, Me të-vërtetë, me të - vërtetë
po u them juve, Që ndashti e paskëtaj dotë
shihni qiellinë të-hapurë, edhe ënqjëjt' e Pe-
rëndisë dyke hipur' e dyke sbriturë mbi të
Birin' e njeriut.

Krye 2.

1 Edhe të-tretënë ditë ubë dasmë ndë Ka-
na të Galilesë; edhe e ëm' e Jisujt ishte a-
2 tje. Edhe uftua ndë dasmët edhe Jisuj edhe
3 nxënësit' e ati. Edhe si umbarua vera, e ëm'
4 e Jisujt i thotë, Verë s' kanë. Jisuj i thotë, Ç'
ke ti me mua, o grua? ora ime edhe s' ka
5 ardurë. E ëm' e ati u thotë sherbëtorëvet,
6 Bëni ç't'u thotë juve. Edhe atje ishinë gja-
shtë enë të gurta vënë për të pastruarëtë
pas zakonit të Judhenjvet, që nxininë sicila
7 nga dy a tri masa. Jisuj u thot' atyre, Mbu-
8 shni enëtë më ujë. Edhe *ata* i mbushnë gjer
sipërë. Pastaj u thot' atyre, Nxirni ndashti,
edhe shpini të-parit të mësallësë. Edhe *ata*
9 shpunë. Edhe i-par' i mësallësë si ungërua
ujëtë që ishte bërë verë, edhe nukë dinte
nga është, (po shërbëtorëtë që kishinë nxje-

10 rrë ujëtë e dinine,) i-par' i mësallësë thë-
rret dhëndërrinë, Edhe i thotë, Çdo njeri më
përpara nxjer verën' e-mirë, edhe si të de-
henë, atëhere *nxjer* të-poshtërënë; *po* ti ke
ruajturë verën' e-mirë gjer ndashti.
11 Këta të-nisurit' e çudiravet Jisuj e bëri
ndë Kana të Galilesë, edhe çfaqi lavdin' eti;
edhe nxënësit' e ati i besuanë.
12 Pastaj sbriti ndë Kapernaum, ay edhe e
ëm' e ati edhe të Vëllezërit' e ati, edhe nxë-
nësit' e ati; edhe mbetnë atje jo shumë dit.
13 Edhe pashka e Judhenjet ishte afërë, edhe Ji-
suj hipi ndë Jerusalim.
14 Edhe gjeti ndë hieroret ata që shisninë
qe e dhën e pëllumba, edhe truvezarëtë dyke
15 ndënjurë. Edhe si bëri një fruskullë, tërkuzësh,
i nxori të-gjithë nga hieroreja, edhe dhëntë edhe
qetë; edhe derdhi asprat' e truvezarëvet,
16 edhe truvezat' i përmbysi; Edhe atyreve që
shisninë pëllumbatë u tha, Ngrini këto
këtej; mos bëni shtëpin' e t' im Et shtëpi tre-
17 gëtie. Atëhere u ra ndër mëntt nxënëset t'
ati se është shkruarë "Zilia për shtëpinë t'
ënde më hëngri.„
18 Judhenjtë pra upërgjeqnë e i thanë, Ç'
19 shënjë na dëften që bën këto? Jisuj upërgjeq
e u tha atyre, Prishni këtë tempull, edhe
për tri dit dot'a ngre.
20 Edhe Judhenjtë thanë, Ky tempull është
ndërtuarë ndë dyzet e gjashtë vjet, e ti dot'a

BKSh

21 ngresh atë për tri dit? Po ay thoshte
22 për tempullin' e trupit të ti, Kur ungjall pra
prej së-vdekurish, u ra ndër mëntt nxënë-
set t'ati, se *për* këtë u thoshte atyre: edhe i
besuanë shkronjësë, edhe *asaj* fjalësë që u
tha Jisuj.
23 Edhe kur qe ndë Jerusalim për të-krem-
ten' e pashkësë, shumë *veta* besuanë mb'
24 emërit t' ati, dyke vështruarë çudirat' e ati
që bënte. Po vetë Jisuj nuk' u zinte besë a-
25 tyre, sepse i njihte të-gjithë; Edhe sepse s'
kishte nevojë që t' *i* epte *ati* dëshmim ndonjë
për njerinë, sepse e dinte ç' ishte për brën-
da njeriut.

Krye 3

1 Edhe ishte një njeri nga Farisenjtë, që e
kishte emërinë Nikodhim, *që isthe* një nga
2 të-parët' e Judhenjet. Ky erdhi natënë te Ji-
suj, edhe i tha, Ravvi, e dimë, se nga Pe-
rëndia ke ardhurë Mësonjës; sepse asndonjë
s' munt të bënjë këto shënja që bën ti, ndë
mos qoftë Perëndia bashkë me atë.
3 Jisuj upërgjeq e i tha, Me të-vërtetë, me
të-vërtetë po të them, ndë mos linttë njeriu
prej së-larti, s' munt të shohë mbretërin' e
Perëndisë.
4 Nikodhimi i thotë, Si munt të lintnjë nje-
riu dyke qënë plak? mos munt të hynjë për së-
dyti ndë barkt të s' ëmës së ti e të lintnjë.

BKSH

5 Jisuj upërgjeq, Me të-vërtetë, me të-vër-
tetë po të them, ndë mos linttë njeriu prej
uji e prej Fryme, s' munt të hynjë ndë mbre-
6 tërit të Perëndisë. Ç' ka lindurë prej mishit,
është mish, edhe ç'ka lindurë prej Frymësë,
7 është frymë. Mos uçudit sepse të thashë, *se*
8 Duhetë të lintni ju prej së-larti. Era ku të
dojë fryn, edhe i dëgjon zënë, po s' di nga
vjen, e ku vete; kështu është edhe kushdo
që ka lindurë prej Frymësë.
9 Nikodhimi upërgjeq e i tha, qysh munt të
bënenë këto?
10 Jisuj upërgjeq e i tha, Ti je mësonjës' i
11 Israilit, edhe nukë di këto? Me të-vërtetë, me
të-vërtetë po të them, se atë që dimë flasëmë
edhe për atë që pamë apëmë dëshmim, po
12 dëshmimnë t' ënë nuk' e prisni. Ndë u thashë
juve punërat' e dheut, edhe nukë besoni,qysh
dotë besoni, ndë u thënça juve punërat' e
13 qiellit? Edhe asndonjë s' ka hipurë ndë qi-
ellt, veç ay që ka sbriturë nga qielli, i Bir'
14 i njeriut, që është ndë qiellt. Edhe sikundrë
Moisiu ngriti lart qjarpërinë ndë shkretëti-
rët, kështu duhetë të ngrihetë lart **edhe** i
15 Bir' i njeriut; Që të mos humbasë kushdo që
t' i besonjë, po të ketë jetë të-përjetëshme.
16 Sepse Perëndia kaqë e deshi botënë, sa dha
Birin' e ti të-vetëmlindurinë, që të mos hum-
basë kushdo që t'i besonjë ati, po të ketë jetë
17 të-përjetëshme. Sepse Perëndia nukë dërgoj

BKSH

të Birrë ndë botët, që të gjykonjë botënë, po
18 që të shpëtonjë bota me anë t' ati. Ay që i
beson ati, nukë gjykonetë; po ay që nukë
beson, që ndashti ësthë dënuarë, sepse nukë
besoj mb' emërit të të-vetëmlindurit Bir të
19 Perëndisë. Edhe ky është gjyqi, se drita er-
dhi ndë botët, edhe njerëzitë deshnë më te-
përë errësirënë se dritënë; sepse punërat' e
20 atyreve ishinë të-liga. Sepse kushdo që pu-
non *punëra* të-këqia, i ka mëri dritësë, edhe
nukë vjen te drita, që të mos sbulonenë
21 punërat' e ati. Po ay që bën të-vërtetënë,
vjen te drita, që të dëftenenë punërat' e ati,
se janë punuarë mbë Perëndinë.
22 Pastaj erdhi Jisuj edhe nxënësit' e ti ndë
dhet të Judhësë, edhe atje shkonte kohënë
23 bashkë me ata, edhe pagëzonte. Ishte edhe
Joani dyke pagëzuarë nd' Enon, afërë Sali-
mit, sepse atje ishinë shumë ujëra; edhe vi-
24 ninë e pagëzoneshinë. Sepse Joani edhe s'
25 ishte hedhurë ndë burkt. Ubë pra një të-kër-
kuarë për *punë* pastrimi prej nxënëset të
26 Joanit me *ca* Judhenj; Edhe erthnë te Joani
edhe i than' ati' Ravvi, ay që ishte baskë
me ty përtej Jordhanit, për të-cilinë ti dësh-
move, ja ky tek po pagëzon, edhe të-gjithë
vijnë tek ay.
27 Joani upërgjeq e tha, Njeriu nukë munt
të marrë asgjë, nde mos i është dhënë nga
28 qielli. Ju vetë dëshmoni për mua se thashë,

Unë nukë jam Krishti, po se jam dërguarë për-
29 para ati. Ay që ka nusenë, është dhëndërri;
edhe miku i dhëndërrit, ay që rri e dëgjon atë;
qëzonetë me gëzim të-math për zërin' e
30 dhëndërrit. Ky pra gëzimi im umbush. Ay
31 duhetë të shtonetë, e unë të pakësonem. Ay
që vjen prej së-larti, është sipërë të-gjithave.
Ay që është prej dheut, prej dheut është,
edhe prej dheut flet; ay që vjen prej qiellit,
32 është sipërë të-gjithave. Edhe atë që pa edhe
dëgjoj, për këtë dëshmon; po asndonjë nuk'
33 e pret dëshmimn' e ati. Ay që pret dëshmimn'
e ati, ka vënë vulë se Perëndia ësht' i-
34 vërtetë. Sepse ay që ka dërguarë Perëndia;
fjalët' e Perëndisë flet; sepse Perëndia nuk'
35 e ep Frymën' *e ti* me masë. Ati do Birinë,
36 edhe të gjitha j'a ka dhënë ndë dorët. Ay që
i beson Birit ka jetë të-përjetëshme; po ay
që nukë bindetë te Biri, nukë dotë shohë je-
të, po zëmërat' e Perëndisë mbetetë mb' atë.

Krye 4.

1 Zoti pra si e mori vesh, se Farisenjtë dë-
gjuanë, se Jisuj bën e pagëzon më tepërë nxë-
2 nës se Joani, (Ndonëse Jisuj vetë nukë pagë-
3 zonte, po nxënësit' e ati;) La Judhenë, edhe
4 vate përsëri ndë Galilet. Edhe duhej të shkon-
te ndëpër Samarit.
5 Vjen pra ndë një qytet të Samarisë që thu-
hetë Sihar, afër' *ati* vëndit qe j'a dha Jakovi

BKSh

6 Josifit birit të ti. Edhe atje ishte një pus i
Jakovit. Jisuj pra passi ishte lodhurë nga
udha, kështu ndënjti përanë pusit; *edhe* ora
7 ishte sindonja gjashtë. Vjen një grua nga
Samaria të nxjerrë ujë. Jisuj i thot' asaj, Ep-
8 më të pi. Sepse nxënësit' e ati kishinë va-
9 turë ndë qytett, për të blerë të- ngrëna. I
thotë pra ati gruaja Samarite, Qysh ti, dyke
qënë Judhe, kërkon të pish prej meje, që jam
një grua Samarite? - Sepse Judhenjtë nukë
shoqëronjënë me Samaritëtë.
10 Jisuj upërgjeq e i tha asaj, Po të dinje
dhurëtin' e Perëndisë, edhe cili ësht' ay që
të thotë, Ep-më të pi, ti kishnje për të ly-
purë prej ati, edhe *ay* kishte për të dhënë
11 ty ujë të-gjallë. Gruaja i thotë, Zot, as kovë
ke, edhe pusi ësht' i-thellë; nga e ke ti pra
12 ujët' e-gjalle? Mos je ti më i-math se ati y-
në Jakov, i-cili na ka dhënë këtë pus, edhe
vët' ay pinte nga ky, edhe të bijt' e ati, edhe
13 bagëtit' e ati? Jisuj upërgjeq e i tha asaj,
Kushdo qe pi nga këta ujë, dot' i vinjë et
14 përsëri; Po ay që pi nga ujëtë qe dot' i ap
unë, nukë dot' i vinjë et për *gjithë* jetënë;
po ujëtë, që dot' i ap unë, dot' i bënetë bu-
rim uji që buron për jetë të-përjetëshme.
15 Gruaja i thotë, Zot, ep-më këta ujë, që të
mos më vinjë et, as të mos vinj këtu të
nxjer ujë.
16 Jisuj i thot asaj, Ecë, thirrë burrinë t'

17 ënt, edhe eja këtu. Gruaja upërgjeq e tha, S'
kam burrë. Jisuj i tha asaj, Mirë the, se s'
18 kam burrë; Sepse ke marrë pesë burra, edhe
ay, që ke ndashti, nuk është burri yt; këtë
e fole me të-vërtetë.

19 Gruaja i thotë, Zot, po shoh, se ti je pro-
20 tit. Atëritë t' anë ndë këtë mal ufalnë; e ju
thoni, se ndë Jerusalim është vëndi, ku du-
21 hetë të falemi. Jisuj i thot' asaj, Grua, beso-
më, se vjen një orë, kur nukë dot' i faleni
22 Atit as ndë këtë mal, as ndë Jerusalim. Ju
i faleni ati që nukë dini; neve i falemi ati që
dimë; sepse shpëtimi është nga Judhenjtë.
23 Po vjen një orë, edhe ndashti është, kur fa-
lëtorët' e-vërtetë dot' i falenë Atit me frymë
e me të-vërtetë; sepse edhe Ati të-këtillë
24 kërkon *të jenë* ata që i falenë ati. Perëndia
është frymë, edhe ata që i falenë duhetë të
falenë me frymë e me të-vërtetë.

25 Gruaja i thotë, E di se vjen Messia, ay
që thuhetë Krisht; ay kur të vinjë, dotë na
26 apë zë për të-gjitha. Jisuj i thot' asaj, Unë
që të flas jam *ay*.

27 Edhe mbi këto *fjalë* erthnë nxënësit' e
ati, edhe uçuditnë se fliste me grua; po asndo-
një s' tha, Ç' kërkon? a, Ç flet me atë?

28 Gruaja pra la shtëmbën' e saj, edhe vate
29 ndë qytett, edhe u thotë njerëzet, Ejani e
shihni *një* njeri, që më tha gjithë sa kam

BKSH

30 bërë; vallë mos është ky Krishti ? Duallnë
pra nga qyteti, edhe erthnë tek ay.
31 Edhe ndër mest *të këtyre fjalëve* nxënë-
32 sit' i luteshinë, dyke thënë, Ravvi, ha. Po ay
u tha atyre, Unë kam të ha *një* të-ngrënë,
33 që ju nuk' e dimi. Nxënësitë pra i thoshinë
njëri tjatërit, Mos i pru njeri të hajë ?
34 Jisuj u thot' atyre, Të-ngrënëtë t' im është
të bënj dashurimn' e ati që më ka dërguarë,
35 edhe të mbaronj punën' e ati. Nukë thoni
ju, Se jan' edhe katrë muaj, edhe vjen të-
korrëtë? Na tek po u them juve, Ngrini për-
pjetë sytë t' uaj, edhe shihni aratë, se janë
36 tashi të-bardha për të korrë. Edhe ay që
korr merr pagë, edhe mbleth pemë për jetë
të përjetëshme, që të gëzonetë bashkë edhe
37 ay që mbjell edhe ay që korr. Sepse mbë
këtë e-vërtetë është fjala, Se tjatër' ësht' ay
38 që mbjell, edhe tjatër' ay që korr. Unë u
dërgova juve të korrni atë, për të-cilënë juve
s' jeni munduarë; të-tjerë umunduanë, edhe
ju hytë ndë mundimt t' atyreve.
39 Edhe prej ati qyteti shumë nga Samarī-
tëtë besuanë për fjalën' e gruasë që dëshmoj,
40 Se më tha gjithë sa kam bërë. Samaritëtë
pra si erthnë tek ay, i luteshinë të mbesë
41 përan' atyreve. Edhe mbeti atje dy dit. Edhe
shumë më tepërë *njerës* besuanë për fjalën'
42 e ati; Edhe gruasë i thoshinë, Se nukë be-
sojmë më për fjalënë t' ënde; sepse neve e

BKSH

dëgjuamë, edhe e njohmë se ky është me të-
vërtetë Shpëtimtari i botësë, Krishti.
43 Edhe pas dy ditsh dolli prej andej, edhe
44 vate ndë Galilet. Sepse vetë Jisuj dëshmoj ,se
asndonjë profit s' ka nder ndë dhet të ti.
45 Kur erdhi pra ndë Galilet, Galileasit' e pritnë,
passi kishinë parë gjithë sa bëri ndë Jeru-
salim ndë të-kremtet; sepse edhe ata kishin'
46 ardhurë për të-kremtenë. Jisuj pra erdhi përsëri
ndë Kana të Galilesë, ku kishte bërë ujëtë
verë.
Edhe ishte një njeri mbretërie, djal' i të-
47 cilit ishte i-sëmurë ndë Kapernaum. Ky
kur dëgjoj, se Jisuj erdhi nga Judhea ndë
Galilet, vate tek ay, edhe i lutej të sbresë e
të shëronjë të birr' e ati; Sepse ishte për të
48 vdekurë. Jisuj pra i tha. Ndë mos pafshi shë-
49 nja e çudira, s' kini për të besuarë. Njeriu
i mbretërisë i thotë, Zot, sbrit para se të vdesë
50 çuni im. Jisuj i thotë, Ecë, se yt bir rron.
Edhe njeriu i besoj fjalësë që i tha Jisuj, edhe
51 iku. Edhe tek po sbriste, shërbërorët' e ati
upoqnë me atë, edhe i dhanë zë, Se yt bir
52 rron. I pyeti pra mbë ç' orë ubë më mirë.
Edhe i thanë, Se dje mbë të-shtattënë orë e
53 lanë ethetë. I ati pra e kupëtoj se *këjo ubë*
mb' atë orë që i tha Jisuj, Se yt bir rron;
edhe besoj ay edhe gjithë shtëpi' e ati.
54 Jisuj bëri përsëri këtë çudi të-dytë, si er-
dhi nga Judhea ndë Jerusalim.

Krye 5.

1 Pas këtyreve ishte *një* e-kremte e Judhe-
2 njet; edhe Jisuj hipi ndë Jerusalim. Edhe ndë
Jerusalim afërë *derës'* së dhënet është një
pellk *uji* që quhetë Ebraisht Vithesdha, edhe
3 ka pesë kamare. Ndër këto dirgjej shumë
shumicë të-sëmurësh, të-verbërësh, të-çalësh
4 të-thatësh, që pritninë të-luajturit' e ujit. Sepse
kohë mbë kohë sbriste një ëngjëll ndë pellkt,
edhe trazonte ujëtë; cili pra të hynte më për-
para, pas të-trazuarit t' ujit, bënej i-shëndoshë
prej çdo farë smundjeje që të kishte.
5 Edhe atje ishte një njeri, që ishte i-
6 sëmurë tri-dhjet' e tetë vjet. Jisuj kur e pa
këtë së po dirgjej, edhe mori vesh se prej
shumë kohe ndashti ishte *i-sëmurë,* i thotë,
7 A do të bënesh i-shëndoshë? I sëmuri i upër-
gjeq, Zot, s' kam njeri të më vërë ndë pellkt,
kur trazonet' ujëtë; sepse tek po vinj unë,
8 tjetërë sbret përpara meje. Jisuj i thotë, Çohu,
9 ngri shtratinë t' ënt, edhe ecë. Edhe për-një-
here njeriu ubë i-shëndoshë, edhe ngriti
shtratin' e ti, edhe ecënte. Edhe atë ditë ishte
e-shëtunë.
10 Judhenjtë pra i thoshin' ati që ushërua
Esht' e-shëtunë; nuk ësht' e udhësë të ngresh
11 shtratinë. Ay u upërgjeq atyre, Ay që më shëroj
12 me tha, Ngri shtratinë t' ënt, edhe ecë. E
pyetnë pra, Cili është ay njeri që të tha,

BKSH

13 Ngri shtratinë t' ënt' edhe ecë? Po ay që
ushërua nukë dinte cili është; Sepse Jisuj
ushtëmenk, sepse kishte shumë gjindje nd'
atë vënt.
14 Pastaj Jisuj e gjen atë ndë hieroret, edhe i
tha, Na tek ubëre i-shëndoshë; mos bëj më
faj, që të mos të bënetë ndonjë gjë m' e-
15 keqe. Njeriu pra shkoj, edhe u dha zë Judhe-
njet, se ay që e bëri të-shëndoshë është Jisuj.
16 Edhe përandaj Judhenjtë e ndiqninë Jisunë,
dhe kërkoninë t'a vritninë, sepse bënte këto
17 ditën e-shëtunë. Po Jisuj u upërgjeq atyre, Im
Atë punon gjer ndashti, edhe unë punonj.
18 Përandaj Judhenjtë më tepërë kërkoninë t'a
vritninë, sepse jo vetëmë e prishte të-shëtu-
nënë, po edhe *se* thoshte, se Perëndia ësht'
i ati, duke bërë vetëhen' e ti si-një-një me
Perëndinë.
19 Jisuj pra upërgjeq e u tha atyre,
Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them
juve, Biri s' munt të bënjë asgjë prej vetin,
ndë mos paftë Atinë dyke bërë ketë; sepse
ato që bën ay, këto i bën gjithashtu edhe
20 Biri. Sepse Ati e do Birinë, edhe i dëften
gjith' ato që bën vetë; edhe dot' i dëftenjë
punëra më të-mëdha se këto, që të çuditeni
21 ju. Sepse sikundrë Ati ngjall të-vdekuritë edhe
ep jetë, kështu edhe Biri u ep jetë atyreve
22 që të dojë. Sepse Ati nukë gjykon asdonjë,
po gjithë gjyqinë j'a dha Birit, që të-gjithë.

BKSh

të nderonjënë Birinë, sikundrë nderonjën'
Atinë. Ay që nukë nderon Birinë, nukë nde-
ron Atinë që e ka dërguarë.
24 Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them
juve, se ay që dëgjon fjalënë t' ime, edhe i
beson ati që më ka dërguarë, ka jetë të-
përjetëshme, edhe ndë gjyq nukë vjen, po
25 shkoj prej vdekjesë ndë jetët. Me të-vërtetë,
me të-vërtetë po u them juve, se vjen një
orë, edhe ndashti është, kur të-vdekuritë kanë
për të dëgjuarë zërin' e të Birit të Perën-
disë, edhe ata që dëgjonjënë dotë rronjënë.
26 Sepse sikundrë Ati ka jetë ndë vetëhet të ti,
kështu i dha edhe të Birit të ketë jetë ndë
27 vetëhet të ti; Edhe i dha pushtet të bënjë
28 edhe gjyq, sepse është Bir njeriu. Mos uçu-
ditni për këtë; se vjen një orë, ndë të-cilët
gjith' ata *që janë* ndëpër varret dotë dëgjo-
29 njënë zërin' e ati; Edhe dotë dalënë ata që
kanë bërë të-mira ndë të-ngjallurë jetë; po
ata që kanë punuarë të-liga, ndë të-ngja-
llurë gjyqi.
30 Unë s' munt të bënj asgjë prej vetëhesë
s' ime. Sikundrë dëgjonj, gjukonj; edhe gjyqi
im ësht' i-drejtë; sepse s' kërkonj dashurimnë
t' im, po dashurimn' e (Atit) që më dërgoj.
31 Unë ndë dëshmofsha për vetëhenë t' ime,
32 dëshmimi im nuk' është i-vërtetë. Tjetërë ësht'
ay që dëshmon për mua; edhe e di, se dësh-
33 mimi që dëshmon për mua ësht' i-vërtetë. Ju

dërguatë te Joani, edhe *ay* dëshmoj të-vër-
34 tetënë. Edhe unë nuk' e marr dëshmimnë
prej njeriu; po them këto, që të shpëtoni ju.
35 Ay ishte kandili që digjetë e bën dritë; edhe
ju deshtë të gëzoneni për pak kohë ndë dritët
t' ati.
36 Po unë e kam dëshmimnë më të-math se
të Joanit; sepse ato punëra që më dha Ati
që t' i mbaronj, ato punëratë që bënj unë,
dëshmonjënë për mua, se Ati më ka dër-
37 guarë. Edhe Ati që më dërgoj, ay dëshmon
për mua. As zërin' e ati s' e keni dëgjuarë
38 kurrë, as faqen' e ati s' e kini parë. Edhe
fjal' e ati s' ka të-ndënjurë ndër ju, sepse
39 ju nuk' i besoni këti që dërgoj ay. Vëzhgoni
shkronjatë, sepse ju kujtoni se ndër ato keni
jetë të-përjetëshme; edhe ato jan' ato që
40 dëshmonjënë për mua. Po s' doni të vini
41 tek unë, që të keni jetë. Nukë marr lavdi
42 prej njerëzish; Po u njoha juve, se s' keni
dashurin' e Perëndisë ndër vetëhet t' uaj.
43 Unë kam ardhurë mb' emërit të t' im Eti, e
nukë më prisni; nd' arthtë *ndonjë* tjetërë mb'
44 emërit të ti, dot' e prisni atë. Qysh muntni
të besoni ju që merrni lavdi njeri prej tje-
tërit, edhe nukë kërkoni lavdinë që është
prej të-vetëmit Perëndi?
45 Mos kujtoni, se unë dot' u përflas juve
tek Ati; ka kush t' u përflasë juve, Moisiu,
46 mbë të-cilinë ju shpryetë. Sepse po t' i kishi-

të besuarë Moisiut, dotë më besonit' edhe
47 mua; sepse ay shkroj për mua. Po ndë
qoftë se nuk' u besoni të-shkruaravet t' ati,
qysh dot' u besoni fjalëvet të mia?

Krye 6

1 Pastaj Jisuj shkoj përtej detit të Galilesë,
2 të Tiveriadhësë: Edhe shumë gjindje i vanë
pas, sepse shihninë çudirat' e ati që bënte mbi
3 të-sëmurët. Edhe Jisuj hipi ndë malt, edhe
rrinte atje bashkë me nxënësit' e ti.
4 Edhe ishte afërë pashka, e-kremteja e
Judhenjet.
5 Jisuj pra kur ngriti sytë, edhe pa se po
vinte shumë gjindje tek ay, i thotë Filippit,
6 Nga dotë blemë bukë, që të hanë këta? (Edhe
thoshte këtë, që *t'*a provonte; sepse ay e
7 dinte seç dotë bënte.) Filippi i upërgjeq, Dy
qint dinarë bukë nuk' u dalën' atyre, që të
marrë nga një çikë gjithë-si-cili nga ata.
8 Andhreu i vëllaj i Simon Pjetrit, një nga
9 nxënësit' e ati, i thotë, Këtu është një çun
i-vogëlë që ka pesë bukë të-elpta, edhe dy
pishqe; Po ç' janë këto për kaqë *veta*?
10 Edhe Jisuj tha, Thoj-u-ni njerëzet të rrinë
përdhe. Edhe ishte shumë bar nd' atë vënt.
Ndënjnë pra burratë sindonja pesë mijë veta
11 me numërë. Edhe Jisuj mori bukëtë, edhe si
ufal ndersë, u'a ndau nxënëset, edhe nxënësitë
atyre që kishinë ndënjurë përdhe; kështu

BKSH

12 edhe prej pishqevet sa deshnë. Edhe si un-
ginjnë, u thotë nxënëset të ti, Mblithni
copatë që kanë tepëruarë, që të mos hum-
13 basë gjë. I mblothnë pra, edhe mbushnë
dy-mbë-dhjetë kofinë me copa nga të pesë
bukët' e-elpta që u tepëruanë atyreve që
hëngrrë.
14 Njerëzitë pra, kur panë çudinë që bëri
Jisuj, thoshinë, Se me të-vërtetë ky është *ay*
profiti që ka për të ardhurë ndë botët.
15 Jisuj pra si e kupëtoj, se doninë të vininë,
e t'a rrëmbeninë, që t'a bëninë mbret, iku
përsëri ndë malt ay vetëmë.
16 Edhe si ungrys, nxënësit' e ati sbritnë
17 ndë dett; Edhe hynë ndë lundrët, edhe shku-
anë përtej detit ndë Kapernaum. Edhe ndash-
ti ishte bërë errëte, edhe Jisuj s' kishte ar-
18 dhurë tek ata; Edhe deti po ngrihej, se po
19 frynte er' e-madhe. Passi vozitnë pra sindo-
nja një-zet e pesë a tridhjetë stadhe, shohënë
Jisunë dyke ecurë mbi dett, edhe dyke ardhurë
20 afërë lundrësë; edhe ufrikësuanë. Po ay u
21 thot' atyre, Unë jam, mos ufrikësoni. Deshnë
pra t'a marrënë ndë lundrët; edhe për-një-
here lundra ugjënt mb' atë dhe që vininë.
22 Mbë të-nesërmet gjindja që kishte ndënju-
rë përtej detit, kur panë, se s' ishte atje
tjetërë lundrëzë, veç një, ajo, ndë të-cilët
hynë nxënësit' e ti, edhe se nukë hyri Jisuj
ndë lundrëzët bashkë me nxënësit' e ti, po

23 vetëmë nxënësit' e ati, shkuanë; (Edhe të-
tjera lundrëza erthnë nga Tiveriadha afër'
ati vëndi ku hëngrrë bukënë, passi ufal
24 ndersë Zoti;) Gjindja pra kur pa, se Jisuj
nuk është atje, as nxënësit' e ati, hipnë edhe
ata ndëpër lundrat, edhe erthnë ndë Kaper-
naum dyke kërkuarë Jisunë.
25 Edhe si e gjetnë përtej detit, i thanë,
26 Ravvi, kur erdhe këtu? Jisuj u upërgjeq a-
tyre e tha, Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u
them juve, më kërkoni, jo sepse patë çudira,
po sepse hengrëtë nga bukëtë edhe unginjtë.
27 Mos punoni për ushqiminë që prishetë, po
për ushqiminë që mbëtetë për jetë të përje-
tëshme, të-cilinë dot' u apë juve i Bir' i nje-
riut; sepse këtë e vulosi Ati, Perëndia.
28 I thanë pra, Ç' të bëjmë, që të punojmë
29 punërat' e Perëndisë? Jisuj upërgjeq e u tha
atyre, Kejo është pun' e Perëndisë, t' i be-
soni ati që ka dërguar' ay.
30 I thanë pra, Ç' shënjë bën pra ti, që të
31 shohëmë, e të të besojmë ty? ç punon? Atë-
ritë t' anë hëngrrë mannënë ndë shkretëtirët,
sikundrë është shkruarë, " Bukë nga qielli
32 u dha atyre të hanë.„ Jisuj pra u tha atyre,
Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them juve,
Moisiu nuk' u dha juve bukënë nga qielli;
po im Atë u ep juve bukën' e-vërtetë nga
33 qielli. Sepse buk' e Perëndisë ësht' ay që
sbret nga qielli, edhe qe i ep jetë botësë.

34 I thanë pra, Zot, ep-na përherë këtë bukë.
35 Edhe Jisuj u tha atyre, Unë jam buk' e
jetësë; ay që vjen tek unë, nukë dotë ketë
uri; edhe ay që më beson, nukë dotë ketë
36 et kurrë. Po u thashë juve, se edhe më patë
37 edhe nukë besoni. Gjithë ç' më ep Ati, dotë
vinjë tek unë; edhe atë që të vinjë tek unë,
38 nukë dot' e nxjer jashtë; Sepse kam sbri-
turë nga qielli, jo për të bërë dashurriminë
t' im, po dashurimin' e ati që më ka dërgu-
39 arë. Edhe ky është dashurimi i Atit që më
ka dërguarë, *prej* gjithë ç' më ka dhënë të
mos humbas asgjë, po t'a ngjall ndë ditët
40 të-pastajme. Edhe ky është dashurimi i ati
që më ka dërguarë, kushdo që sheh Birinë
e i beson, të ketë jetë të-përjetëshme; edhe
unë dot'a ngjall ndë ditët të-pastajme.
41 Judhenjtë pra murmurisninë për atë, se
42 tha, Unë jam buka që sbrita nga qielli; Edhe
thoshinë, Nuk' është ky Jisuj i bir' i Josifit,
të-cilit neve i njohëmë t' an' edhe t' ëmënë;
qysh thotë pra ky, Se kam sbriturë nga
qielli?
43 Jisuj pra upërgjeq e u tha atyre, Mos
44 murmurisni ndë mest t' uaj. Asndonjë s' munt
të vinjë tek unë, ndë mos e heqtë Ati që
më ka dërguarë; edhe unë dot'a ngjall atë ndë
45 ditët të-past'ajme. Është shkruarë ndë pro-
fitërit, "Edhe të-gjithë dotë jenë të-mësuarë
nga Perëndia.„ Kushdo pra që ka dëgjuarë

BKSh

prej Atit, edhe është mësuarë, vjen tek uuë.
46 Jo se ka parë ndonjë Atinë, veç ay që është
nga Perendia; ky e ka parë Atinë. Me të-
47 vërtetë po u them juve, Ay që më beson ka
48 jetë të-përjetëshme. Unë jam buk' e jetësë.
49 Atëritë t' uaj hëngrrë mannënë ndë shkretë-
50 tirët, edhe vdiqnë. Kejo është buka që sbret
nga qielli, që të haje ndonjë prej asaj, edhe
51 te mos vdesë. Unë jam buk' e-gjallë që sbriti
nga qielli. Nde hëngretë njeri prej kësaj buke,
dotë rronjë për gjithë jetënë. Edhe buka qe
dot' ap unë, është mishi im, të-cilinë unë
dot'a ap për jetën' e botësë.

52 Judhenjtë pra haheshinë njëri me tjatrinë,
dyke thënë, Qysh munt të na apë ky të hamë
mishin' *e ati*?

53 Jisuj pra u tha atyre, Me të-vërtetë, me
të-vërtetë po u them juve, Ndë mos hëngrëshi
mishin' e të Birit të njeriut, edhe ndë mos
pifshi gjakun' e ati, s' keni jetë ndë vetëhet
54 t' uaj. Ay që ha mishinë t' im, edhe pi gja-
kunë t' im, ka jetë të-përjetëshme, edhe unë
55 dot'a ngjall ndë ditët të-pastajme. Sepse mi-
shi im është me të-vërtetë ushqim, edhe
56 gjaku im është me të-vërtetë të-pirë. Ay që
ha mishinë t' im, edhe pi gjakunë t' im, mbe-
57 tetë tek unë, edhe unë tek ay. Sikundrë më
dërgoj Ati që rron, edhe unë rronj për Atinë,
kështu edhe ay që ha mua, dotë rronjë edhe
58 ay për mua. Këjo është buka që sbriti nga

BISH

qielli; jo sikundrë atëritë t' anë hëngrrë man-
nënë, edhe vdiqnë; ay që ha këtë bukë,
dotë rronjë për gjithë jetënë.
59 Këto tha ndë sinagogjit dyke mësuarë
ndë Kapernaum.
60 Shumë *veta* pra nga nxënësit' e ati kur
dëgjuanë, thanë, Këjo fjalë ësht' e-ashpërë;
61 cili munt t'a dëgjonjë? Edhe Jisuj si e ku-
pëtoj ndë vetëhet, se nxënësit' e ti po mur-
murisninë për këtë *fjalë,* u tha atyre, Këjo
62 uskandhalis juve? *Ç' dotë thoni* pra, ndë
qoftë se shihni të Birin' e njeriut dyke hi-
63 purë atje ku ishte më përpara? Fryma ësht'
ajo që ep jetë; mishi nukë vëjen asgjë; fja-
64 lëtë qe u flas unë juve, janë frymë, edhe janë
jetë. Po janë ca prej jush që nukë beso-
njënë. Sepse Jisuj e dinte që ndë kryet, cilëtë
jan' ata që s' besonjënë, edhe cili ësht' ay
65 që dot'a trathëtonte. Edhe thoshte, Përandaj
u thashë juve, se asndonje s' munt të vinjë
tek unë, ndë mos i është dhënë prej t' im
Eti.
65 Që mb' atë herë pra shumë nga nxë-
nësit' e ti ukthyenë prapa, edhe nuk' ecninë
më bashkë me atë.
67 Jisuj pra u tha të dy-mbë-dhjetëvet, Mos
68 doni të ikëni edhe ju? Simon Pietri i upër-
gjeq pra ati, Zot, Te cili të vemi? *ti* ke fjalë jete
69 së-përjetëshme. Edhe neve kemi besuarë,
edhe e kemi njohurë, se ti je Krishti i Bir' i

BKSH

70 Perëndisë (së-gjalë). Jisuj u upërgjeq atyre, A
nuk' u sgjodha unë juve të dy-mbë-dhjetëtë?
71 Po një prej jush është djall. Edhe thoshte
për Judhë Jskariotinë, *të birin'* e Simonit;
sepse ky, ndonëse ishte një prej të dy-mbë-
dhjetëvet, e kishte për të trathëtuar' atë.

Krye 7.

1 Edhe pas këtyre *fjalëve* Jisuj ecënte ndë
Galilet; sepse s' donte të ecënte ndë Judhet,
sepse Judhenjtë kërkoninë t'a vrisninë.
2 Edhe ishte afër' e-kremteja e Judhenjet,
3 tendë-ngrehëja. Të vëllezërit' e ti pra i thanë,
Ikë së-këtejmi, edhe ecë ndë Judhet, që të
shohën' edhe nxënësit' e tu punërat' e tua që
4 bën; Sepse asndonjë s' bën gjë fshehurazi,
edhe kërkon vetë të jet' i-çfaqurë. Ndë bën
5 këto, çfaq vetëhenë t' ënde ndë botët. Sepse
6 as të vëllezërit' e ti nuk' i besoninë. Jisuj u
thotë pra atyre, Koha ime edhe s' ka ardhurë,
7 po koha juaj është përherë gati. Bota s'
munt t' u ketë mëri juve; po mua më ka
mëri, sepse unë dëshmonj për atë, se punë-
8 rat' e asaj janë të-liga. Ju hipni ndë këtë
të-kremtë; unë (edhe) nukë vete nde këtë
të-kremte, sepse koha ime edhe s' është
mbushurë.

9 Edhe si u tha atyre këto, mbeti ndë Ga-
10 lilet. Edhe si hipnë të vëllezërit' e ati, hipi

edhe ay ndë të-kremtet, jo faqeza, po si
fshehurazi.
11 Judhenjtë pra e kërkoninë ndë të-kremtet,
12 edhe thoshinë, Ku ësht' ay? Edhe ishte për
atë shumë murmuri ndër mest të gjindjesë;
Ca thoshinë, Se ësht' i-mirë; e të-tjerë tho-
13 shinë, Jo; po gënjen gjindjenë. Po asndonjë
nukë fliste sheshit për atë, nga frika e Judhe-
njet.
14 Edhe ndashti tek ishte përgjusmë e-krem-
15 tja, Jisuj hipi ndë hieroret, edhe mësonte.
Edhe Judhenjtë çuditeshinë, dyke thënë, Qysh
di ky dituri pa mësuarë?
16 Jisuj u upërgjeq atyre, e tha, [Mësimi im
nuk' është imi, po i ati që më ka dërguarë.
17 Ndë do ndonjë të bënjë dashurimn' e ati,
dotë njohë për mësimnë, nd' është nga Pe-
rëndia, apo ndë flas unë prej vetëhesë s' ime.
18 Ay që flet prej vetëhes' së ti, kërkon lavdin'
e ti; po ay që kërkon lavdin' e ati që e ka
dërguarë, ky ësht' i-vërtetë, edhe shtrëmbëri
19 tek ay nukë ka. A nuk' u dha juve nominë
Moisiu? edhe asnjë prej jush s' bën nominë·
Përse kërkoni të më vrisni?
20 Gjindja upërgjeq e tha, ke djallinë. Cili
kërkon të të vrasë?
21 Jisuj upërgjeq e u tha atyre, Një punë
22 bëra, edhe të-gjithë çuditeni. Përandaj Moi-
siu u ka dhënë juve rrethpresjenë, (jo se
është nga Moisiu, po nga atëritë,) edhe të-

23 shëtunë rrethprisni njeri. Ndë qoftë se njeriu
merr rrethpresje *ditën'* e-shëtunë, që të mos
prishetë nom' i Moisiut, mbë mua zëmëro-
neni, sepse një njeri të-tërë e bëra të-shën-
24 doshë ditën' e-shëtunë? Mos gjykoni për fa-
qe, po gjykoni gjyqin' e-drejtë.
25 Ca pra prej Jerosolimitëvet thoshinë, Nuk'
26 është ky që kërkoninë t'a vrasënë? Po na
tek po flet ndër sy, edhe s' i thonë asgjë.
Mos e njohnë me të-vërtetë të-parëtë, se ky
27 është me të-vërtetë Krishti? Po këtë e dimë
nga është; po kur vjen Krishti, asndonjë s'e
di nga është.
28 Jisuj pra thërriti dyke mësuarë ndë hie-
roret, edhe tha, Edhe mua më dini, edhe
nga jam e dini; edhe s' kam ardhurë prej
vetiu, po ësht' i vërtetë ay që më ka dërguarë,
29 të-cilinë ju nuk'e dini; Po un' e di atë, sepse
jam prej ati, edhe ay më dërgoj.
30 Kërkoninë pra t'a zënë; po asndonjë s'
vuri dorënë mbi atë, sepse edhe s' i kishte
ardhurë ora.
31 Edhe shumë *veta* prej gjindjesë i besu-
anë, edhe thoshinë, Se kur të vinjë Krishti,
mos dotë bënje më shumë shënja se këto
që bëri ky?
32 Farisenjtë dëgjuanë gjindjenë se po pishpë-
llinjënë këto për atë; edhe dërguanë Fari-
senjt' edhe kryepritëritë shërbëtorë që t'a zënë.
33 Jisuj pra u tha (atyre), Edhe pak kohë jam

BKSH

bashkë me ju, edhe vete tek ay që më dër-
34 goj. Dotë më kërkoni, e nukë dotë më gjeni;
Edhe *atje* ku jam unë ju s' munt të vini.
35 Judhenjtë pra thanë me vetëhen' e tyre, Ku
dotë vejë ky, që neve nukë dot'a gjejmë? Mos
dotë vejë ndër ata që janë përndarë ndër
36 Grekërit, e të mësonjë Grekëritë? Ç' është
këjo fjalë qe tha, Dotë më kërkoni, e nukë
dotë më gjeni? edhe, *Atje* ku jam unë, ju s'
munt të vini?
37 Edhe të-pastajmenë ditë, *ditën'* e-madhe
e së-kremtesë, Jisuj qëndroj e thërriti, dyke
thënë, Kush të ketë et, letë vinjë tek unë, e
38 letë pijë. Ay që më beson mua, sikundrë tha
Shkronja, lumënj uji të-gjallë dotë rrjedhënë
39 nga barku i ati. (Edhe këtë e tha për Fry-
mënë që kishinë për të marrë ata që dot' i
besoninë; sepse edhe s' ishte *dhënë* Frym' e-
Shënjtëruarë; sepse Jisuj edhe s' ishte lav-
duruarë.)
40 Shumë *veta* pra prej gjindjesë kur dëgju-
anë këtë fjalë, thoshinë, Ky është me të-
41 vërtetë profiti. Të-tjerë thoshinë, Ky është
Krishti. Po të-tjerë thoshinë, Mos vjen Kri-
42 shti nga Galilea? Nukë tha shkronja, se Kri-
shti vjen nga far' e Dhavidhit, edhe nga
43 fshati Vithleem, *që* ku ishte Davidhi? Ubë
44 pra një çarje ndër gjindjet për atë. Edhe ca
prej atyreve doninë t'a zininë; po asndonjë
s' vuri duartë mbi atë.

BKSH

45 Erthnë pra shërbëtorëtë te kryepriftërit'e
46 te Farisenjtë, edhe ata u than' atyre, Përse
s' e prutë? Shërbëtorëtë upërgjeqnë, Askurrë
ndonjëherë s' ka folurë njeri kështu, posi ky
47 njeri. Farisenjtë pra u upërgjeqnë atyre, Mos
48 ugënjyet' edhe ju? Mos i ka besuarë ati
49 ndonjë prej të-parëvet a prej Farisenjvet? Po
këjo gjindje që s' di nomnë, janë të mallë-
kuarë.
50 U thot' atyre Nikodhimi, (ay që pat ar-
dhurë natënë tek ay, i-cili ishte një prej a-
51 tyre,) Mos e gjykon njerinë nomi ynë, pa
dëgjuarë më përpara prej ati, e pa marrë
52 vesh seç bën. Upërgjeqnë e i thanë, Mos je
edhe ti nga Galilea? vëzhgo e shih, se pro-
fit nga Galilea nuk' është ngriturë.
53 Edhe gjithë-sicili vate ndë shtëpit të ti.

Krye 8

1 Edhe Jisuj vate ndë malt t' ullinjvet.
2 Edhe mbë të-vagulluarët erdhi përsëri
ndë hieroret, edhe gjithë llauzi vinte tek ay;
edhe *ay* ndënji e i mësonte.
3 Edhe shkronjësit' e Farisenjtë i bjenë një
grua të-zënë ndë kurvëri, edhe si e vunë ndë
4 mest, I thonë, Mësonjës, këjo grua është zënë
5 mbi punët dyke kurvëruarë. Edhe Moisiu
ndë nomt na ka porositurë të-tillatë *gra* të
6 vritenë me gurë; ti pra ç' thua? Edhe këtë
e thoshinë dyke ngarë atë, që të kenë me se

BKSH

t'a përflasënë. Po Jisuj uunjt, e skruante me
7 gishinë mbë dhet. Edhe passi qëndroninë
dyke pyetur' atë, ungrit, e u tha atyre, I-
pafajmi prej jush, *ky* më përpara letë hedhë
8 gurinë mbi atë. Edhe përsëri uunjt, e shkru-
9 ante mbë dhet. Edhe ata kur dëgjuanë, edhe
pasi qërtonëshinë prej ndërgjegjesë, zunë të
dilninë jashtë një nga një, që prej pleqvet e
gjer mbë të-fundëshmit; edhe Jisuj mbeti
vetëmë, edhe gruaja ishte dyke ndënjurë ndë
10 mest. Edhe Jisuj si ungrit, edhe nukë pa
asdonjë veç gruasë, i tha asaj, Grua, ku jan'
ata që të përflisninë? asndonjë s' të dënoj?
11 Edhe ajo tha, Asndonjë, Zot. Edhe Jisuj i tha,
As unë nukë të dënonj; shko, edhe mos
fëje më.

12 Jisuj pra përsëri u foli atyre, dyke thënë, Unë
jam drit' e botësë; ay që më vjen pas, nukë
dot' ecënjë nd' errësirët, po dotë ketë dritën'
e jetësë.

13 Farisenjtë pra i thanë, Ti dëshmon për
vetëhenë t' ënde; dëshmimi yt nuk' ësht' i-
14 vërtetë. Jisuj upërqjeq e u tha atyre, Edhe
ndë dëshmofsha unë për vetëhenë t' ime,
dëshmimi im ësht' i-vërtetë, sepse e di nga
erdha, e ku vete; po ju s' e dini nga erdha,
15 e ku vete. Ju gjykoni pas mishit; unë nukë
16 gjykonj asnjeri. Po edhe ndë gjukofsha unë,
gjyqi im ësht' i-vërtetë; sepse nukë jam ve-
17 tëmë, po unë edhe Ati që më dërgoj. Edhe ndë

nomt t' uaj është shkruarë, Se dëshmimi i
18 dy njerësve ësht' i-vërtetë. Unë jam ay që
dëshmonj për vetëhenë t'ime, edhe Ati që
19 më dërgoj dëshmon për mua. I thoshinë pra,
Ku është yt Atë? Jisuj upërqjeq. As mua s'më
dini, as t' im Atë; po të më dinitë mua, dotë
dinit' edhe t'im Atë.
20 Këto fjalë i foli Jisuj ndë vëntt të the-
sarit, dyke mësuarë ndë hieroret; edhe as-
ndonjë nuk' e zuri, sepse edhe s' i kishte
ardhur' ora.
21 Jisuj pra përsëri u tha atyre, Unë po vete,
edhe dotë më kërkoni, edhe dotë vdisni ndë
fajt t' uaj. Ku vete unë, ju nukë munt të vi-
22 ni. Judhenjtë pra thoshinë, Mos dotë vrasë
vetëhen' e ti, e përandaj thotë, *Atje* ku vete
23 unë, ju s' munt të vini? Edhe *ay* u tha a-
tyre, Ju jeni prej atyre që janë poshtë, unë
jam prej atyre që janë lart. Ju jeni prej kë-
24 saj bote; unë nukë jam prej kësaj bote. U
thashë pra juve, se dotë vdisni ndë fajet t' uaj;
sepse ndë mos besofshi se unë jam, dotë
vdisni ndë fajet t' uaj.
25 I thoshinë pra, Cili je ti? Edhe Jisuj u
tha atyre, *Unë jam ay* që u thashë juve që
26 ndë kryet. Shumë kam për të thënë, e për
të gjykuarë për ju; po ay që më dërgoj ësht'
i-vërtetë; edhe unë sa dëgjova prej ati, këto
27 i them botësë.—Nukë kupëtuanë, se u thoshte
për Atinë.

28 Jisuj pra u tha atyre, Kur të ngrini lart
të Birin' e njeriut, atëhere dotë njihni se unë
jam, edhe nukë bënj asgjë prej vetëhesë s'
ime, po sikundrë më mësoj im Atë, këto flas.
29 Edhe ay që më dërgoj është bashkë me
mua; Ati nukë më la vetëmë; sepse unë bënj
përherë ato që i pëlqenjënë.
30 Ay tek ishte dyke folurë këto, shumë *veta*
i besuanë.
31 Jisuj pra u thoshte atyre Judhenjet që
i kishinë besuarë, Ndë qoftë se besoni ju
ndë fjalët t' ime, jeni me të-vërtetë nxënës
32 të-mi; Edhe dotë njihni të-vërtetënë, edhe e-
vërteta dot' u lironjë juve.
33 I upërgjeqnë ati, Jemi far' e Avraamit, edhe
asnjeriu nuk' i jemi bërë kurrë shërbëtorë;
34 qysh thua ti, Se dotë bëheni të-liruarë? Ji-
suj u upërgjeq atyre, Me të-vërtetë, me të-
vërtetë po u them juve, Se kushdo që bën
35 fajnë, shërbëtuar' i fajit është. Edhe shër-
bëtori nukë mbetetë ndë shtëpit për gjithë
36 jetënë; po biri mbetetë për gjithë jetënë. Ndë
u liroftë pra juve Biri, me të-vërtetë dotë
37 jeni të-liruarë. E di se jeni far' e Avraamit;
po kërkoni të më vrisni, sepse fjala ime
38 nukë zë vënt ndër ju. Unë flas ç' kam parë
përanë t' im Eti; edhe ju gjithashtu bëni ç'
39 keni parë përanë atit t' uaj. I upërgjeqnë e
i thanë, Ati ynë është Avraami. Jisuj u thot'
atyrë, Po të ishitë bij t' Avraamit, punërat' e

BKSH

40 Avraamit dotë bënitë. Po ndashti kërkoni të
më vrisni, njeri që u kam folurë të-vërtetënë,
që dëgjova prej Perëndisë; Avraami këtë nuk'
41 e bëri. Ju bëni punërat' e atit t' uaj.
I thanë pra ati, Neve s'kemi lindurë prej
42 kurvërie; një atë kemi, Perëndinë. Jisuj pra
u tha atyre, Po të ishte Perëndia ati juaj,
dotë më donitë; sepse unë prej Perëndisë
dolla, edhe *prej ati* vinj; sepse nuk'arthçë prej
43 vetëhesë s' ime, po ay më dërgoj. Përse nukë
njihni të-folouritë t, im? sepse nukë munt të
44 dëgjoni fjalënë t' ime. Ju jeni prej djallit, atit
t' uaj edhe doni të bëni dëshërimet' e atit
t' uaj. Ay ishte që ndë kryet njeri-vrasës,
edhe nukë qëndron ndë të-vërtetët; sepse
të-vërtetë nukë ka tek ay. Kur flet gënje-
shtrënë, flet nga të-tijatë; sepse është gënje-
45 shtar, edhe i at' i asaj, *i gënjeshtrësë*. Po mua,
46 sepse them të-vërtetënë, nukë më besoni. Cili
prej jush më shan për faj? po ndë them të-
47 vërtetënë, përse s' më besoni ju? Ay që është
prej Perëndisë, fjalët' e Perëndisë dëgjon;
përandaj ju nukë dëgjoni, sepse prej Perën-
disë nukë jeni.
48 Judhenjtë pra upërgjeqnë e i thanë, Nukë
themi mirë ne, se ti je Samarit, edhe diall
49 ke? Jisuj upërgjeq, Unë djall s' kam, po nde-
50 ronj t' im Atë, edhe ju më çnderoni. Edhe
unë s' kërkonj lavdinë t' ime; është ay që
51 kërkon e që gjykon. Me të-vërtetë, me të-

vërtetë po u them juve, Ndë ruajtë ndonjë
fjalënë t' ime, nukë dotë shohë vdekje për
52 gjithë jetënë. Judhenjtë pra i thanë, Ndashti
e muarmë vesh, se ke djall. Avraami vdiq
edhe profitëritë, edhe ti thua, Ndë ruajtë
ndonjë fjalënë t' ime, nukë dotë ngjëronetë
53 vdekje për gjithë jetënë. Mos je ti më i-math
se ati ynë Avraam, i-cili vdiq? edhe profi-
tëritë vdiqnë; ti cilinë e bën vetëhenë t' ënde?
54 Jisuj upërgjeq, Unë ndë lavduronj vetëhenë
t' ime, lavdia ime s' ësht' asgjë; im Atë ësht'
ay që me lavduron, për të-cilinë ju thoni se
55 është Perëndia juaj; Edhe s' e keni njohurë,
po un' e njoh; edhe ndë thënça se nuk' e
njoh, dotë jem posi ju, gënjeshtar; po e njoh,
56 edhe ruanj fjalën' e ati. Avraami ati juaj gë-
zonej të shohë ditënë t' ime; edhe e pa, e
ugëzua.
57 Judhenjtë pra i thanë, Pesë-dhjetë vjet edhe
58 s'i ke, edhe Avraaminë e ke parë? Jisuj u tha
atyre, Me të-vërtetë me të-vërtetë, po u them
juve, Para se të lintnjë Avraami, unë jam.
59 Ngritnë pra gurë që t' i hithninë kundr'
ati; po Jisuj ufsheh, edhe dolli nga hieroreja,
edhe shkoj ndëpër mest t' atyreve; edhe
kështu iku.

Krye 9.

1 Edhe dyke shkuarë, pa një njeri të-ver-
2 bërë që prej të-lindurit. Edhe nxënësit' e ati

BKSH

e pyetnë, dyke thënë, Ravvi, cili fëjeu, ky
apo prindërit' e ati, që të lintnjë i-verbërë?
3 Jisuj upërgjeq, As ky fëjeu, as prindërit' e
ati; po që të dëftenenë punërat' e Perëndisë
4 tek ay. Unë duhetë të punonj punërat' e ati
që më dërgoj, gjersa është ditë: vjen natë,
kur asdonjë s' munt të punonjë. Sa të jem
ndë botët, jam drit' e botësë.
6 Passi tha këto, pshtyti përdhe, edhe bëri
baltë prej pshtymësë, edhe leu syt' e të-verbërit
7 me baltënë; Edhe i tha ati, Shko e lahu ndë
pellkt të Silloamit, (që e-kthyarë do më thënë
i-Dërguarë). Vate pra e ula, edhe erdhi dy-
8 ke parë. Fëqinjtë pra, edhe ata që e shihninë
më përpara se ishte i-verbërë, thoshinë, Nuk'
9 është ky ay që rrinte e lypënte? Të-tjerë
thoshinë, Se ky është; edhe të-tjerë, Se i
10 shëmbëllen; *po* ay thoshte, Se unë jam. I
11 thoshinë pra, Qysh t' uhapnë sytë? Ay upër-
gjeq e tha, *Një* njeri që thuhetë Jisu bëri
baltë, edhe më leu sytë, edhe me tha, Shko
ndë pellkt të Silloamit, edhe lahu. Edhe si
12 vajta e ulava, hapa sytë. I thanë pra, Ku
ësht' ay? Thotë, Nukë di.
13 E bjenë te Farisenjtë atë që *ishte* njëherë
14 i-verbërë. Edhe ishte e-shëtunë, kur bëri
15 baltënë Jisuj, edhe i hapi ati sytë. Përsëri
pra e pyetnin' edhe Farisenjtë, Qysh hapi
sytë? Edhe ay u tha atyre, Vuri baltë mbi
16 syt të mi, edhe ulava, edhe shoh. Ca pra

prej Farisenjet thoshinë, Ky njeri nuk' është
nga Perëndia, sepse nukë ruan të-shëtunënë.
Të- tjeıë thoshinë, Qysh munt të bënjë të-
tilla çudira *një* njeri fajtuar? Edhe ishtë një
17 çarje ndër mest t' atyreve. I thonë përsëri
të-verbërit, Ti ç' thua për atë, sepse te hapi
sytë? Edhe ay tha, Se është profit.
18 Judhenjtë pra nukë besuanë për atë, se
ishte i-verbërë, edhe hapi sytë, gjersa thë-
19 rritnë prindërit' e ati që i uhapnë sytë; Edhe
i pyetnë dyke thënë, Ky është biri juaj, për
të-cilinë ju thoni se ka lindurë i-verbërë?
20 qysh sheh pra ndashti? Prindërit' e ati u
upërgjeqnë atyre, e thanë, E dimë se ky është
21 biri ynë, edhe se ka lindurë i-verbërë; Po qysh
sheh ndashti nukë dimë; a cili i hapi sytë,
neve nukë dimë; ay ınoshë ka, pyet-e-ni; ay
dotë flase për vetëhen' e ti.
22 Këto thanë prindërit' e ati, sepse kishinë
frikë nga Judhenjtë; sepse Judhenjtë ndashti
kishinë lidhurë fjalë, që ay që t'a rrëfenjë
23 për Krisht të bënetë jashtë sinagogjisë. Përan-
daj prindërit' e ati thanë, Se moshë ka, py-
et-e-ni.
24 Thirrnë pra për-së-dyti njerinë, që kishte
qënë i-verbërë, edhe i thanë, Ep-i lavdi Perën-
disë; neve e dimë se ky njeri është fajtnar.
25 Ay pra upërgjeq e tha, Nd' është fajtuar, nuk'
e di; një di, se qeshë i-verbërë, edhe ndashti
26 shoh. Edhe i thanë përsëri, Ç' të bëri? qysh

27 t' i apë sytë? U upërgjeq atyre, Ndashti u
thashë juve, edhe nukë dëgjuatë; ç' doni
përsëri të dëgjoni? mos edhe juve doni të
bëhi nxënës t' ati?
28 E shanë pra, edhe thanë, Ti je nxënës i
29 ati; po neve jemi nxënës të Moisiut. Neve
dimë se Perëndia i foli Moisiut; po këtë
30 nuk' e dimë nga është. Njeriu upërgjeq e
u tha atyre, Ndë këtë me të-vërtetë është
çudia, se ju s' e dini nga është, edhe mua
31 më hapi sytë. Edhe e dimë, se Perëndia
nukë dëgjon fajtorë; po ndë pastë ndonjë
frikë Perëndie, edhe të bënjë dashurimn'
32 e ati, këtë e dëgjon. Që prej *kryes' së* jetësë
nuk' është dëgjuarë, se hapi njeri syt' e njëj
33 që ka lindur' i-verbërë. Ndë mos ishte ky
nga Perëndia, nukë dotë muntte të bënte
34 asgjë. Upërgjeqnë e i thanë, Ti ke lindur' i-
tërë ndë faje, edhe ti na mëson? edhe e
nxuarnë jashtë.
35 Jisuj dëgjoj, se e nxuarnë jashtë; edhe si
e gjeti, i tha, I beson të Birit të Perëndisë?
36 Ay upërgjeq e tha, Ciliesht' *ay*, Zot, që t' i
37 besonj? Edhe Jisuj i tha, Edhe e ke parë,
38 edhe ay është që flet baskë me ty. Edhe ay
tha, Besonj o Zot, edhe i ufal.
39 Pastaj Jisuj tha, Unë për gjyq kam ar-
dhurë ndë këtë botë, që të shohën' ata që
nukë shohënë, edhe të bënenë të-verbërë
40 ata që shohënë. Edhe prej Farisenjet sa ishi-

në bashkë me atë i dëgjuanë këto, edhe i
41 thanë, Mos jemi edhe neve të-verbërë? Jisuj
u tha atyre, Po të ishitë të-verbërë, nukë
dotë kishitë faj; po tas iti thoni, Se shohëmë;
faji juaj pra mbetetë.

Krye 10.

1 Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them
juve, Ay që nukë hyn nga dera ndë oborrt
të dhënvet, po hipën që gjetkë, ay është vje-
2 dhës edhe kursar. Po ay që hyn nga dera,
3 eshte bariu i dhënvet. Këti i hap derënë por-
tari; edhe dhëntë dëgjonjënë zërin' e ati; edhe
thërret dhënt' e ti me emërë, edhe i nxjer.
4 Edhe kur nxjer dhënt' e ti, vete përpara a-
tyreve; edhe dhënt' i venë prapa, sepse e
5 njohënë zërin' e ati. Po të-huajit nukë dot' i
venë prapa, po dot' ikënjënë prej ati; sepse
nuk' e njohënë zërin' e të-huajvet.
6 Këtë paravoli u tha atyre Jisuj; po ata
nukë kupëtuanë ç' ishinë këto që u fliste
atyre.
7 Jisuj pra u tha atyre përsëri, Me te-vër-
tetë, me të-vërtetë po u them juve, se unë
8 jam dera e dhënvet. Gjithë sa erthnë para
meje janë vjedhës edhe kursarë; po dhëntë
9 nuk' u dëgjuan' atyre. Unë jam dera; me anë
t' ime ndë hyftë ndonjë, dotë shpëtonjë, edhe
dotë hynjë edhe dotë dalë, edhe dotë gjenjë
10 të-kullloturë. Vjedhësi nukë vjen, veç për të

vjedhur' e për të therur' e për të prishurë;
un' arthçë, që të kenë jetë, edhe t'a kenë me
11 të-tepërë. Unë jam bariu i-mirë; bariu i-mirë
12 vë jetën' e ti për dhëntë. Po ay që ësht' i-
pajtuarë, edhe që s' është bari, të-cilit dhëntë
s' janë të-tijatë, sheh ujkunë dyke ardhurë,
edhe lë dhënt' e ikën, edhe ujku i rrëmben
13 ato, edhe përndan dhëntë. Edhe i-pajtuari
ikën, sepse është i-pajtuarë, edhe s' do të
14 dijë për dhëntë. Unë jam bariu i-mirë, edhe
njoh të-mijatë, edhe njihem prej të-mijavet,
15 Sikundrë me njeh Ati, edhe un' e njoh A-
16 tinë; edhe vë jetënë t' imë për dhëntë. Kam
edhe të-tjera dhën, të-cilatë s' janë prëj këti
oborri; duhetë t' i mbleth edhe ato; edhe
dotë dëgjonjënë zënë t' im; edhe dotë bënetë
17 një tufë *e* një bari. Përandaj Ati më do, sepse
unë vë jetënë t' ime, që t'a marr përsëri.
18 Asndonjë s' e ngre prej meje, po un' e ve
prej vetiu; kam pushtet t'a vë, edhe kam
pushtet t'a marr përsëri. Këtë porosi mora
prej t' im Eti.
19 Përsëri pra ubë një çarje ndër mest të
20 Judhenjet për këto fjalë. Edhe shumë *veta*
prej atyreve thoshinë, Djall ka, edhe ësht' i-
21 shkalluarë; ç' e dëgjoni? Të-tjerë thoshinë,
Këto fjalë nukë janë *fjalë* të-djallosuri; mos
mund djalli t' u hapnjë sytë të-verbëret?
22 Edhe ubë *e-kremteja* e të-shënjtëruarit të
hieroresë ndë Jerusalim, edhe ishte dimër.

23 Edhe Jisuj ecënte ndë hieroret, ndë ka-
24 maret të Sollomonit. Judhenjtë pra e qerthë-
lluanë, edhe i thoshinë, Gjer kur mban ndë
dyshim shpirtinë t' ënë? ndë je ti Krishti, na
thuaj ndër sy.
25 Jisuj u upërgjeq atyre, U thashë juve,
edhe nukë besoni. Punëratë që bënj unë mb'
emërit të t' im Eti, këto dëshmonjënë për
26 mua. Po ju nukë besoni; sepse nukë jini
27 prej dhënvet të mia. Sikundrë u thashë juve,
dhënt' e mia dëgjonjënë zënë t' im, edhe un'
28 i njoh; edhe më vinjenë pas. Edhe un' u ap
atyre jetë të-përjetëshme; edhe nukë dotë
humbasënë për *gjithë* jetënë, edhe nukë dot'
i rrëmbenjë njeri ato prej dorësë s' ime.
29 Im Atë, që m' i ka dhënë, është më i-
math se të-gjithë; edhe asnjë s' munt t' i
30 rrëmbenjë prej dorës' së t' im Eti. Unë edhe
Ati jemi një.
31 Përsëri pra Judhenjtë rroknë gurë, që t' i
bininë me gurë.
32 Jisuj u upërgjeq atyre, Shumë punëra të-
mira u rrëfeva juve prej t' im Eti; për ç'
33 punë nga ato më bini me gurë? Judhenjtë i
upërgjeqnë, dyke thënë, Nukë të bjemë me
gurë për punë të-mirë, po për vllasfimi,
edhe sepse ti, ndonëse je njeri, e bën vetëhenë
34 t' ënde Perëndi. Jisuj u upërgjeq atyre, Nuk'
është shkruarë ndë nomt t' uaj, „Unë thashë,
35 Jeni perëndira?“ Ndë qoftë, se quajti perëndira

BKSH

ata, mbë të-cilët ubë fjal' e Perëndisë, (edhe
36 shkronja s' munt të bjerë poshtë), Për atë
që e shënjtëroj Ati, edhe e dërgoj ndë botët,
ju thoni, Se *ti* vllasfimis, sepse thashë, Jam i
37 Bir' i Perëndisë? Ndë mos bënj punërat' e t'
38 im Eti, mos më besoni; Po ndë bënj, edhe
ndë mos më besoni mua, beso-u-ni punëravet;
që të njihni e të besoni, se Ati *është* tek
unë, edhe unë tek ay.
39 Kërkoninë pra përsëri t'a zënë; po dolli
nga dora e atyreve.
40 Edhe shkoj përsëri përtej Jordhanit, ndë
vëntt ku ishte Joani përpara dyke pagëzuarë;
41 edhe mbeti atje. Edhe shumë *veta* erthnë
tek ay, edhe thoshinë, Se Joani nukë bëri
asndonjë çudi; po gjithë sa tha Joani për
këtë, ishinë të-vërteta. Edhe atje shumë *veta*
i besuan' ati.

Krye 11.

1 Edhe ishte një *njeri* i-sëmurë, *që quhej*
Llazar, nga Vithania, nga fshati i Mariësë
2 edhe i Marthësë së motrës' s' asaj. (Edhe
Maria ishte ajo që leu Zotinë me vaj ere,
edhe fshiu këmbët' e ati me flokët' e saj,
3 se-cilësë i vëllaj, Llazari, ishte sëmurë). Të
motëratë pra dërguanë, dyke thënë, Zot, na
ay që do *ti* tek është sëmurë.
4 Edhe Jisuj kur dëgjoj tha, Këjo sëmun-
dje nuk' është për vdekje, po për lavdin' e

Perëndisë, që të lavduronet' i Bir' i Perën-
disë me anë t' asaj.
5 Edhe Jisuj donte Marthën' edhe të motë-
6 rën' e asaj edhe Llazarinë. Kur dëgjoj pra
se është sëmurë, atëhere mbeti dy dit mb'
7 atë vënt ku ishte. Pastaj pas kësaj u thotë
8 nxënëset, Letë vemi prapë ndë Judhe. Nxënë-
sit' i thonë, Ravvi, ndashti Judhenjtë kërko-
ninë të të vrisinë me gurë, edhe përsëri vete
9 atje? Jisuj upërgjeq, A nukë ka dy-mbë-dhje-
të orë dita? nd' ectë ndonjë ditënë, nukë
pengonetë, sepse sheh dritën 'e kësaj bote.
10 Po nd' ectë ndonjë natënë, pengonetë, sepse
s' ka dritë nd' atë.
11 Këto tha, edhe pastaj u thot' atyre, Llazari
12 miku ynë flejti; po vete që t'a sgjonj. Nxënësit'
e ti i thanë pra, Zot, ndë flejti, dotë shpëto-
13 një. Po Jisuj kishte thënë për vdekjen' e a-
ti; po ata pandehnë se thotë për të-flejturit'
14 e gjumit. Atëhere pra Jisuj u tha atyre fa-
15 qeza, Llazari vdiq. Edhe gëzonem për ju, që
të besoni, sepse nukë qesh' atje; po letë ve-
16 mi tek ay. Thomaj pra, që thuhetë binjak,
u tha bashkë-nxënëset të ti, Letë vemi edhe
neve, që të vdesëmë bashkë me atë.
17 Kur erdhi pra Jisuj, e gjeti se kishte
ndashti katrë dit ndë varrt.
18 Edhe Vithania ishte afërë Jerusalimit si-
19 ndonja pesë-mbë-dhjetë stadhe. Edhe shumë
veta prej Judhenjet kishin' ardhurë te Mar-

tha e te Maria, që t' i ngushëllonin͡ë për të
20 vëllan' e atyreve. Martha pra kur dëgjoj, se
po vjen Jisuj, i dolli përpara; edhe Maria
rrinte ndë shtëpit.
21 Martha pra i tha Jisujt, Zot, t' ishnje këtu
22 im vëlla nukë dotë vdiste. Po edhe ndashti
e di, se sa t' i lypënjç Perëndisë, dotë t' i
23 apë Perëndia. Jisuj i thot' asaj, Yt vëlla dotë
24 ngjalletë. I thot' ati Martha, E di se dotë
ngjalletë ndë të-ngjallurit ndë ditët të-pastaj-
25 me. Jisuj i tha, Unë jam të-ngjallurit' edhe
jeta; ay që më beson, edhe ndë vdektë, dotë
26 rronjë. Edhe kushdo që rron edhe më beson,
nukë dotë vdesë për gjithë jetënë. A e beson
27 këtë? I thot' ati, Po, Zot, unë kam besuarë,
se ti je Krishti, i Bir' i Perëndisë, që ke ar-
dhurë ndë botët.
28 Edhe *ajo* si tha këto, vate e thërriti
fshehuraj Mariënë të motërën' e saj, e i tha,
Mësonjësi është këtu, edhe po të thërret.
29 Ajo kur dëgjoj, ngrihetë çpejt, edhe vjen tek
30 ay. (Jisuj edhe s' kishte ardhurë ndë fshatt,
po ishte ndë atë vënt që i dolli përpara
31 Martha.) Judhenjtë pra që ishinë bashkë me
atë ndë shtëpit edhe e ngushëllonin͡ë, kur
panë Mariënë se ungrit çpejt e dolli, i vanë
prapa, dyke thënë, Se po vete ndë varrt për
të qar' atje.
32 Maria pra si erdhi atje ku ishte Jisuj,
kur e pa atë, i ra ndër këmbë, dyke thën'

ati, Zot, nd' ishnje këtu, vëllaj nukë dotë
33 më vdiste. Jisuj pra kur pa atë dyke qarë,
edhe ata Judhenjtë që kishin' ardhurë bashkë
me atë dyke qarë, psherëtiti ndë shpirtt të
34 ti, edhe utrumbullua, E tha, Ku e keni vënë?
35 I thonë, Zot, eja e shih. 36) Jisuj derdhi lot.
37 Judhenjtë pra thoshinë, Shih sa e donte. Po ca
prej atyre thanë, Nukë muntte ky që hapi syt' e
të-verbërit të bënte, që edhe ky të mos vdiste?
38 Jisuj pra përsëri dyke psherëtiturë ndër
vetëhe vjen ndë varrt. Edhe ishte një shpe-
39 llë, edhe mbi atë ishte vënë një gur. Jisuj
thotë, Ngrini gurinë. Martha, e motëra e të-
vdekurit, i thotë, Zot, qelbetë ndashti; sepse
40 është katrë ditsh. Jisuj i thot' asaj, Nukë të
thashë, se ndë besofsh, dotë shohç lavdin' e
41 Perëndisë? Ngritnë pra gurinë, (ku ishte vë-
në i-vdekuri). Edhe Jisuj ngriti sytë përpjetë,
e tha, Atë, të falem ndersë, se më dëgjove.
42 Edhe un' e dinjam, se përherë më dëgjon;
po *këtë* e thashë për *këtë* llauzinë që rri *këtu*
rreth, që të besonjënë, se ti më dërgove.
43 Edhe si tha këto, thërriti me zë të-math,
44 Llazar, dil jashtë. Edhe i-vdekuri dolli, lidhu-
rë këmbët' e duartë me rripa pëlhure; edhe
faqeja e ati ishte pshtjellë me rizë. Jisuj u
thot' atyre, Sgjidh-e-ni, edhe lër-e-ni të vejë.
45 Shumë *veta* pra prej Judhenjvet, që ki-
shin' ardhurë te Maria, edhe panë sa bëri
46 (Jisuj), i besuanë. Po ca prej atyre vanë të

BKSH

Farisenjtë, edhe u than' atyre sa bëri Jisuj.
47 Kryepriftëritë pra edhe Farisenjtë mblo-
thnë bashkëndënje, edhe thoshinë, Ç' të bëj-
48 në? se ky njeri bën shumë çudira. Ndë e lën-
çim' atë kësotu, të-gjithë dot' i besonjënë; edhe
dotë vijnë Romanëtë, edhe dotë prishnjënë
49 edhe vëndinë t' ënë edhe kombinë. Edhe një
nga ata, Kaiafa, që ishte kryeprift i ati viti, u
50 tha atyre, Ju nukë dini asgjë, As nukë men-
doneni, se është mirë për ne të vdesë një
njeri për llauzinë, edhe të mos humbasë gji-
51 thë kombi. Edhe këtë nuk' e tha prej vetëhes'
së ti, po dyke qënë kryeprift i ati viti, pro-
fitepsi se Jisuj kishte për të vdekurë për
52 kombinë; Edhe jo për kombinë vetëmë, po
edhe që të mbledhë mbë një të bijt' e Perën-
disë që ishinë përndarë.
53 Që mb' atë ditë pra bënë këshillë që t' a
54 vrasënë. Përandaj Jisuj nuk' ecënte më fa-
qeza ndëpër Judhenjtë, po shkoj s' andejmi
ndë një vënt afërë shkretëtirësë, ndë një qy-
tet që thuhetë Efraim, edhe atje shkonte ko-
hënë bashkë me nxënësit' e ti.
55 Edhe ishte afërë pashka e Judhenjet; edhe
shumë *veta* prej *ati* vëndi hipnë ndë Jeru-
salim përpara pashkësë, që të qëroninë ve-
56 tëhen' e tyre. Kërkoninë pra Jisunë, edhe i
thoshinë njëri tjaterit dyke ndënjurë ndë
hieroret, Ç' u duketë juve? se nukë dotë vi-
57 një ndë të-kremtet? Edhe kryepriftërit' e Fa-

risenjtë kishinë porositurë, ndë e marrtë
vesh ndonjë se ku është, t'apë zë, që t'a zënë.

Krye 12.

1 Jisuj pra gjashtë dit përpara pashkësë
erdhi ndë Vithani, ku ishte Llazari që pat
vdekurë, të-cilin' e kishte ngjallurë prej së-
2 vdekurish. Edhe i bënë darkë atje; edhe
Martha shërbente; edhe Llazari ishte një prej
atyre që rrininë ndë mësallët bashkë me atë.
3 Atëhere Maria mori një litrë vaj ere prej
nardhi të-papërzjerë shumë të-shtrënjtë, edhe
leu këmbët' e Jisujt, edhe me flokët' e saj
fshiu këmbët' e ati; edhe stëpia umbush me
erën' e vajit të erësë.
4 Një pra nga të dy-mbë-dhjetë nxënësit'e
ati, Judhë Iskarioti, *i bir'* i Simonit, ay që
5 dot' a trathëtonte, thotë, Përse të mos shitej
këta vaj ere tre qint dhinarë, e të epej ndë-
6 për të-vobeqt? Edhe këtë e tha, jo se donte
të dinte për të-vobeqtë, po sepse ishte vje-
dhës, edhe kishte kuletën' e aspravet, edhe
7 mbante ç' viheshinë *nd' atë.* Jisuj pra tha,
Lër-e; *se* e ruajti për ditën' e të-kallurit t'im
8 ndë varrt. Sepse të vobeqtë i keni përherë
bashkë me vetëhenë t' uaj, po mua nukë më
keni përherë.
9 Shumë gjindje pra prej Judhenjet muar-
në vesh se ësht' atje; edhe erthnë jo për Ji-
sunë vetëmë, po që të shohën' edhe Llazari-

në, të-cilin' e kishte ngjallurë prej së-vde-
10 kurish. Po kryepriftëritë bënë këshillë, që të
11 vrasën' edhe Llazarrë; Sepse shumë veta prej
Judhenjet vininë për atë, edhe i besoninë
Jisujt.
12 Mbë të-nesërmet shumë gjindje që kishin'
ardhurë ndë të-kremtet, kur dëgjuanë, se
13 vjen Jisuj ndë Jerusalim, Muarnë dega hur-
mash, edhe duallnë përpara t' a presënë,
edhe thërrisninë, Hosanna, i-bekuar' *ësht'* ay
që vjen mb' emërë të Zotit, mbreti i Israilit.
14 Edhe Jisuj gjeti një pulisht, edhe ndënji
15 mbi atë, sikundrë është shkruarë, „Mos ki
frikë, bij' e Sionësë, na mbreti yt tek po
vjen dyke ndënjurë mbi pulisht gomareje.“
16 Edhe nxënësitë nukë kupëtuanë këto ndë
kryet; po kur ulavdurua Jisuj, atëhere u ra
ndër mëntt atyre, se këto ishinë shkruarë
për atë, edhe *se* këto j' a bënë ati.
17 Gjindja pra që ishte bashkë me atë dë-
shmonte, se thirri Llazarinë nga varri, edhe e
18 ngjalli nga të-vdekuritë. Përandaj edhe gjin-
dja i dolli përpara, sepse dëgjoj, se ay kishte
19 bërë këtë çudi. Farisenjtë pra i thanë njëri
tjatërit, A shihni ju, se nukë bëni as një
dobi? na bota tek vate prapa ati.
20 Edhe ishinë ca Grekër ndër mest t' atyre-
ve që kishinë hipurë për të falurë ndë të-krem-
21 tet. Këta pra erthnë te Filippi *që ishte* prej
Vithsaidhas' së Galilesë, edhe i luteshinë,

BKSH

dyke thënë, Zot, duamë të shohëmë Jisunë.
22 Filippi vjen e i thotë Andhreut; edhe përsëri
23 Andhreu edhe Filippi i thonë Jisujt. Edhe
Jisuj u upërgjeq atyre, dyke thënë, Erdhi ora
24 që të lavduronet' i Bir' i ŋeriut. Me të-vërtetë,
me të-vërtetë po u them juve, Ndë mos rëntë
koq' e grurit ndë dhet e të vdesë, ajo mbetetë
25 e-vetëmë; po ndë vdektë, bie shumë pemë. Ay
që do jetën' e ti dot'a humbasë; po ay që mër-
zit jetën' e ti ndë këtë botë, dot'a ruanjë për
26 jetë të-përjetëshme. Ndë më shërben ndonjë,
letë më vinjë pas; edhe ku të jem unë, atje
dotë jetë edhe shërbëtori im; edhe ndë qoftë
se më shërben ndonjë, Ati dot'a nderonjë.
27 Ndashti shpirti im ësht' i-trumbulluarë; edhe
ç' të them? Atë, shpëto-më nga kjo orë. Po
28 përandaj erdha ndë këtë orë. Atë, lavduro
emërinë t' ënt.

Erdhi pra *një* zë nga qielli, Edhe *e* lav-
29 durova, edhe përsëri dot'a lavduronj. Gjindja
pra që kishe ndënjurë edhe dëgjoj *zënë*,
thoshte, se ubë bumbullimë; të-tjerë thoshi-
në, *se* ëngjëll i foli ati.
30 Jisuj upërgjeq e tha, ky zë nuk' ubë për
mua, po për ju. Ndashti është gjyqi i kësaj
bote; ndashti urdhërtari i kësaj bote dotë hi-
32 dhetë jashtë. Edhe unë nd' ungriça lart nga
ðeu, dot' i heq të-gjithë pas vetëhesë s'ime.
33 —(Edhe këtë e thoshte dyke dëftyerë me ç'
farë vdekjeje dotë vdiste.)

BKSH

34 Gjindja i upërgjeq, Neve kemi dëgjuarë
nga nomi, se Krishti mbetetë për jetën' *e*
jetësë; qysh thua pra ti, se i Bir' i ŋeriut
duhetë të ngrihetë lart? cili është ky i Bir'
35 i njeriut? Jisuj pra u tha atyre, Edhe pakëzë
kohë është drita bashkë me ju. Ecëni gjersa
keni dritënë, që të mos u zërë juve errësira;
sepse ay që ecën nd' errësirët, nukë di se
36 ku vete. Gjersa kini dritënë, t'i besoni dri-
tësë, që të bëneni bij të dritësë — Këto foli
Jisuj, edhe iku e ufsheh prej atyreve.
37 Po ndonëse bëri kaqë çudira përpara aty-
38 reve, nuk' i besuanë; Që të mbushetë fjal' e
profitit Isai që tha, „Zot, kush i besoj lëçi-
tjesë s' anë? edhe mbë cilinë krahu i Zotit
39 usbulua?" Përandaj nukë munt të besoninë,
40 sepse përsëri Isaia tha, „Verboj syt' e atyreve,
edhe ashpëroj zëmërën' e atyreve, që të mos
shohënë me sytë, edhe të mos kupëtonjënë
me zëmërnë, edhe të kthenenë, e t'i shëronj
41 ata." Këto tha Isaia, kur pa lavdin' e ati,
edhe foli për atë.
42 Po edhe prej të-parëvet shumë *veta* be-
suanë; po nga *frik' e* Farisenjet nukë rrëfe-
ninë, që të mos bënenë jashtë sinagogjisë;
43 Sepse deshnë lavdin' e njerëzet më tepërë se
lavdin' e Perëndisë.
44 Edhe Jisuj bërtiti e tha, Ay që më beson
mua, nukë më beson mua, po ati që më
45 dërgoj; Edhe ay që më vë re mua, vë re

BKSH

46 atë që më dërgoj. Unë kam ardhurë dritë ndë
botët, që të mos mbetetë nd' errësirët kush-
47 do që të më besonjë. Edhe ndë dëgjoftë
ndonjë fjalët' e mia, edhe të mos besonjë,
unë nuk' e gjykonj; sepse nuk' erdha të gjy-
48 konj botënë, po që të shpëtonj botënë. Ay
që më heth poshtë, edhe nukë pret fjalët' e
mia, ka se kush t'a gjukonjë; fjala që fola,
ajo dot'a gjykonjë ndë ditët të-pastajme.
49 Sepse unë nukë fola prej vetiu, po Ati që
më dërgoj, ay më dha porosi, ç'të them, e
50 ç'të flas; Edhe e di, se porosia e ati është
jet' e-përjetëshme; sa pra flas unë, sikundrë
më ka thënë Ati, kështu flas.

Krye 13.

1 Edhe përpara së-kremtes' së pashkësë
Jisuj dyke diturë se i erdhi ora, që të shkonjë
prej kësaj bote tek Ati, passi deshi të-tijtë
që ishinë ndë botët, gjer ndë funtt i deshi ata.
2 Edhe si shkoj darka, (edhe djalli ndashti
kishte vënë ndë zëmërët të Judhë Iskariotit,
3 *të birit* të Simonit, që t'a trathëtonjë;) Jisuj,
dyke diturë se Ati j'a ka dhënë ndë duart
të-gjitha, edhe se nga Perëndia dolli edhe te
4 Perëndia vete, Ngrihetë nga darka, edhe
svesh rrobat' *e tia*, edhe mori një *pëlhurë* të-
5 lirtë e ngeshi vetëhen' e ti. Pastaj vë ujë
ndë legen, edhe zuri t' u lanjë këmbëtë

nxënëset, edhe t' u'a fshinjë me pëlhurën' e-
lirtë, me të-cilënë ishte ngjeshurë.
6 Vjen pra te Simon Pjetri; edhe ay i thote,
7 Zot, ti më lan këmbëtë? Jisuj upërgjeq e i
tha, Atë që bënj unë ti nuk' e di ndashti,
8 po dot'a njohç paskëtajthi. Pjetri i thotë,
Nukë dotë më lanjç këmbëtë për *gjithë* je-
tënë. Jisuj i upërgjeq, Nde mos t' i lafsha,
9 nukë ke pjesë me mua. Simon Pjetri i thotë,
Zot, jo këmbët' e mia vetëmë, po edhe duartë,
10 edhe kryetë. Jisuj i thotë, Ay që ësht' i-larë
s' ka nevojë veç të lanjë këmbëtë, po është
gjith' i-qëruarë; edhe ju jini të-qëruarë, po
11 jo të-gjithë.—Sepse e dinte atë që dot'a trathë-
tontë; përandaj tha, Nukë jeni të-gjithë të-
qëruarë.
12 Passi u lau pra atyre këmbëtë, edhe mori
rrobat' e tia, ndënji përsëri, e u tha atyre, E
13 dini se ç u bëra juve? Ju më thërrisni, Mëso-
njës edhe Zot; edhe mirë thoni, sepse Jam.
14 Nd' u lava pra juve këmbetë unë Zoti edhe
Mësonëjsi, edhe ju duhetë t' i lani këmbëtë
15 njëri tjatërit. Sepse u lashë shëmbëllë juve,
që të bëni edhe ju, sikundrë u bëra unë ju-
16 ve. Me të-vërtetë, me te-vërtetë po u them
juve, se shërbëtori nuk' është më i-math se i
zoti, as i-dërguari më i-math se ay që e ka
17 dërguarë. Ndë i dini këto, jeni të-lumurë,
18 ndë i bëni. Nukë them *këto* për ju të-gjithë;
unë di cilëtë kam sgjedhurë; pa që të mbu-

shetë shkronja „Ay qe hante bukënë bashkë
me mua, ngriti thënbrën' e ti kundrë meje."
19 Që tashti po u'a them juve *këtë*, përpara se
të bënetë, që të besoni, kur të bënetë, se
20 unë jam. Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u
them juve, ay që pret atë që të dërgonj *unë*,
ka priturë mua; edhe ay që të presë mua,
ka pritur' atë që më dërgoj.
21 Jisuj passi tha këto, utrumbullua ndë
shpirtt, edhe dëshmoj e tha, Me te-vërtetë, me
të-vërtetë po u them juve, se një prej jush
22 dotë më trathëtonjë. Nxënësitë pra shikoninë
njëri tjatrinë, e s' dininë për cilinë thotë.
23 Edhe një nga nxënësit' e ati ishte pshteturë
24 ndë gjit të Jisujt, të-cilinë Jisuj e donte. Si-
mon Pjetri pra i bëri me shënjë, që t'a pyesë,
25 cili ësht' *ay*, për të-cilinë thotë. Edhe ay ra
mbë krahëruart të Jusujt. e i thotë, Zot, cili
26 ësht' *ay?* Jisuj përgjigjetë, Ay është, që unë
kur të ngjyenj kafshitënë t' j'a ap. Edhe
ngjeu kafshitënë e j'a ep Judhë Iskariotit, *të*
27 *birit* të Simonit. Edhe pas kafshitësë, atëhe-
re Satanaj hyri tek ay. Jisuj pra i thotë, Ç'
28 ke për të bërë, bëj-e më çpejt. Po këtë
asndonjë prej atyreve qe kishinë ndënjurë
ndë mësallët nuk' e kupëtoj përse i tha ati.
29 Sepse ca pandehninë se Jisuj i thotë, Blij ç'
na duhetë për të-kremtenë, a t' u apë gjë
të-vobeqvet; sepse Judha kishte kuletën' e
aspravet.

BKSH

30 Ay pra si mori kafshitënë, dolli jashtë
31 për-një-here; edhe ishte natë. Si dolli pra *ay*,
Jisuj thotë, Ndashti ulavdurua i Bir' i njeriut,
32 edhe Perëndia ulavdurua nd' atë. Ndë ulav-
durua Perëndia nd' atë, edhe Perëndia dot'a
lavduronjë mbë vetëhet të ti, edhe për-një-
33 here dot'a lavduronjë. Djemthit' *e mi*, edhe
pakëzë jam bashkë me ju. Dotë më kërko-
ni; edhe sikundrë u thashë Judhenjet, Se, ku
vete unë, ju s' munt të vini, po edhe juve
34 u'a them ndashti. Një porosi të-re u lë juve,
Të doni njëri tjatërinë; sikundrë un' u desha
35 juve, edhe ju të doni njëri tjatërinë. Prej
kësaj dot' u njohëuë juve të-gjithë, se jeni
nxënësit' e mi, ndë qoftë se kini dashuri
njëri mbë tjatërinë.
36 Simon Pjetri i thotë, Zot, ku vete? Jisuj
i upërgjeq, *Atje* ku vete *unë, ti* s' munt ndashti
të më vinjç prapa; po pastaj dotë më vinjç
37 prapa. Pjetri i thotë, Zot, përse nukë munt
të të vinj prapa ndashti? jetënë t' ime dot'a
38 vë për ty. Jisuj i upërgjeq, Jetënë t' ënde
dot'a vësh për mua? Me të-vërtetë, me të-
vërtetë po të them ty, Nukë dotë këndonjë
gjeli, gjersa të më mohonjç tri herë.

Kye 14.

1 Letë mos trumbullonetë zëmëra juaj; besoni
2 Perëndisë, besoni edhe mua. Ndë shtëpi të
t' im Eti ka shumë të-ndënjura; ndë mos, dot' u

BKSH

thoshnjam juve, Vete t' u bënj juve gati vënt.
3 Edhe si të vete e t' u bënj juve gati vënt, *dotë*
vinj përsëri, edhe dot' u marr juve përanë
vetëhesë s' ime, që të jeni edhe ju *atje* ku jam
4 unë. Edhe ku vete unë e dini edhe udhën'e dini,
5 Thomaj i thotë, Zot, nuk' e dimë se ku
6 vete; edhe si munt t' a dimë udhënë? Jisuj i
thotë, Unë jam udha edhe e-vërteta edhe
jeta; asndonjë s' vjen tek Ati, veç me anë
7 t'ime. Ndë qoftë se më njihnitë mua, dotë
njihnitë edhe t' im Atë: edhe që ndashti e
njihni, edhe e kini parë.
8 Filippi i thotë, Zot, dëfte-na Atinë, edhe na
9 është mjaft. Jisuj i thotë, Kaqë kohë jam
bashkë me ju, edhe s' më ke njohurë, Filipp?
ay që më ka parë mua, ka parë Atinë; edhe
10 qyɢ thua ti, Dëfte-na Atinë? Nukë beson
se unë *jam* tek Ati, edhe Ati është tek unë?
fjalëtë që u flas unë juve, nuk' janë prej ve-
tiu; po Ati që rri tek unë, ay bën punëratë.
11 Beso-më-ni se unë *jam* tek Ati, edhe Ati
është tek unë; ndë mos, beso-më-ni për vetë
12 punëratë. Me të vërtetë, me të vërtetë po u
them juve, Ay që më beson mua, dotë bënjë
edhe ay punëratë që bënj unë, edhe dotë bë-
një edhe më të mëdha se këto; sepse unë vete
13 tek im Atë. Edhe ç' të lypni mb' emërit' im,
14 dot' a bënj, që të lavduronetë Ati te Biri. Ndë
lypçi gjë mb' emërit t' im, unë dot' a bënj.
15 Ndë më doni, ruani porosit' e mia.

BKSH

16 Edhe unë dot'i lutem Atit, edhe dot' u apë juve
një tjatër Ngushullimtar, që të mbetetë bashkë
17 me ju për *gjithë* jetënë, Frymën e së-vërte-
tësë, të-cilënë bota s' munt t' a marrë, sepse
nuk' e sheh, as nuk e njeh ; po ju e njihni,
sepse mbetetë bashkë me ju, edhe dotë jetë
18 ndër ju. Nukë dot' u lë juve të-varfërë; *dotë*
19 vinj te ju. Edhe pak, edhe bota nukë më sheh
më; po ju më shihni; sepse unë rronj, edhe ju
20 dotë rroni. Nd' atë ditë ju dot' a njihni, se
unë *jam* tek im Atë, edhe ju tek unë, edhe
21 unë te ju. Ay që ka porosit e mia edhe i ruan,
ky ësht' ay që më do; edhe ay që më do,
dotë duhetë prej t' im Eti; edhe unë, dot' a
dua, edhe dotë dëftenj vetëhenë t' ime tek ay.
22 I thotë Judha (jo Iskarioti,) Zot, ç' ubë që
dotë dëftenjç vetëhenë t' ënde te neve, e jo
23 te bota? Jisuj upëgjeq e i tha, Ndë më do
ndonjë, fjalënë t' ime dot' a ruanjë, edhe im
Atë dot' a dojë, edhe dotë vijmë tek ay, edhe
24 dotë bëjmë të ndënjurë tek ay. Ay që s' më do,
fjalët e mija nuk' i ruan, edhe fjala që dë-
gjoni, nuk'është imja, po e Atit që më dër-
25 goj. Këto u fola juve, gjersa gjëndem bashkë
26 me ju. Po Ngushullimtari, Frym e-Shënjtëru-
arë, të cilënë Ati dot' a dërgonjë mb' emërit
t' im, ay dot' u mësonjë juve të-gjitha edhe dot' u
bierë juve ndër mënt gjithë sa u kam thënë
27 juve. Paqtim po u lë juve, paqtimnë t' im po
u ap juve; jo sikundrë e ep bota, u' a ap

juve. Letë mos trumbuλonetë zëmra juaj, as të
28 mos frikësonetë. Dëgjuatë se un' u thasë juve,
Vetë edhe *dotë* vinj *prapë* te ju. Po të më
donitë, dotë gëzoneshitë se (thashë), Vete tek
Ati; sepse im Atë është më i-math se unë.
29 Edhe ndashti u thashë juve, përpara se të
30 bënetë, që të besoni kur të bënetë. Më nukë
dotë flas bashkë me ju; sepse po vjen ur-
dhërtari i kësaj bote, edhe nukë ka të bënjë
31 asgjë me mua. Po që të njohë bota, se dua
Atinë, edhe sikundrë më porositi Ati, kështu
bënj. Ngrihi, letë shkojmë së-këtejmi.

Krye 15.

1 Unë jam veshti i-vërtetë, edhe im Atë
2 është bujku. Çdo hardhi që nukë bie pe-
më, e këput; edhe çdo që bie pemë, e qëron,
që të bierë më tepërë pemë.
3 Ndashti ju jeni të-qëruarë, për fjalënë që
4 u kam folurë juve. Mbetuni tek unë, edhe
unë te ju. Sikundrë hardhia s' munt të bë-
një pemë prej vetiu, ndë mos mbettë ndë
veshtët, këɵtu as ju, ndë mos mbeçi tek unë.
5 Unë jam veshti, ju *jeni* hardhitë; ay që
mbetetë tek unë, edhe unë tek ay, ky bën
pemë shumë; sepse pa mua s'munt të bëni
6 asgjë. Ndë mos mbettë ndonjë tek unë, hi-
dhetë jashtë posi hardhia, edhe thahetë; pas-
taj i mbledhën' e i hedhënë ndë zjarr, edhe
7 digjenë. Ndë mbeçi tek unë, edhe fjalët' e

BKSH

mia ndë mbeçinë te ju, dotë lypni ç'të doni,
8 edhe dot' u bënetë juve. Im Atë ndë këtë
lavduronetë, të bini shumë pemë; edhe *kështu*
dotë jini nxënës të mi.
9 Sikundrë më deshi Ati, edhe un' u desha
10 juve; mbetuni ndë dashurit t'ime. Ndë ruajçi
porosit' e mia, dotë mbeteni ndë dashurit t'
ime; sikundrë unë ruajta porosit' e t'im Eti,
11 edhe mbetem ndë dashurit t'ati. U fola juve
këto, që të mbetetë gëzimi im mbë ju, edhe
gëzimi juaj të jet' i-plottë.
12 Këjo është porosia ime, të doni njëri tja-
13 tërinë, sikundrë un' u desha juve. Asndonjë
s'ka dashuri më të-madhe se këtë, të vërë
14 ndonjë jetën' e ti për miqt' e ti. Ju jini miqt'
e mi, ndë qoftë se bëni sa u porosit juve.
15 Nuk' u them juve më shërbëtorë, sepse shër-
bëtori nukë di se ç'bën i zoti; po u thashë
juve miq, sepse u dëfteva juve gjithë sa dë-
16 gjova prej t'im Eti. Ju nukë më sgjothtë mua,
po un' u sgjodha juve, edhe u urdhërova juve
të shkoni e të bëni pemë, edhe pema juaj
të mbesë; që çdo që t' i lypni Atit mb' emë-
17 rit t'im t'u'a apë juve. Këto u porosit juve,
të doni njëri tjatërinë.
18 Ndë u ka mëri juve bota, di-e-ni se mua
19 më ka pasurë mëri me përpara se juve. Të
ishitë prej botësë, bota dotë donte të-sajnë;
po me-qënë-që nukë jini nga bota, po un' u
sgjodha juve nga bota, përandaj u ka mëri

20 juve bota. Mbani mënf fjalënë që u thashë
unë juve, Nukë ka shërbëtuar më të-math
se i zoti. Ndë ndoqnë mua, dot' u ndjekënë
edhe juve; ndë ruajtnë fjalënë t'ime, dotë
21 ruanjënë edhe t'uajnë. Po të-gjitha këto dot'
u'a bënjënë juve për emërinë t'im, sepse nuk'
e dinë atë që më dërgoj.
22 Të mos kishnjam ardhurë e të mos u
kishnjam folur' atyre, nukë dotë kishinë faj;
po ndashti nukë kanë ç'të thonë për fajin'
23 e tyre. Ay që më ka mëri mua, e ka mëri
24 edhe t'im Atë. Të mos kishnjam bërë ndër
ata ato punë që s' i ka bërë asndonjë tjatërë,
nukë dotë kishinë faj; po ndashti edhe panë,
edhe *na* patnë mëri edhe mua edhe t'im Atë.
25 Po *këjo ubë*, që të mbushetë fjala që është
shkruarë ndë nomt t'atyreve, „Më patnë mëri
pa ndonjë farë punë.“
26 Po kur të vinjë Ngushullimtari, të-cilinë
dot' u'a dërgonj unë juve prej Atit, Fryma e
së-vërtetësë, që del nga Ati, ay dotë dë-
27 shmonjë për mua. Po edhe ju dëshmoni, sepse
që ndë kryet jeni bashkë me mua.

Krye 16.

1 U fola juve këto, që të mos skandhali-
2 seni. Dot' u nxjerrënë juve nga sinagogjitë;
vërtet vjen një orë ndë të-cilët kushdo që
t' u vrasë juve dotë pandehnjë se i shërben
3 Perëndisë. Edhe këto dot' u'a bënjënë juve,

BKSH

4 sepse nukë e njohnë Atinë, as mua. Po u
fola juve këto, që t'i sillni ndër mëntt, kur
të vinjë ora, se un' u'a thashë juve. Edhe
nuk' u'a thashë juve këto që ndë kryet, sepse
ishnjam bashkë me ju.
5 Po ndashti po vete tek ay që më dërgoj,
edhe asndonjë prej jush s' më pyet, Ku vete?
6 Po sepse u fola juve këto, hidhërimi mbushi
zëmërënë t' uaj.
7 Po unë po u them juve të-vërtetënë, *se*
është mirë për ju të shkonj unë; sepse ndë
mos shkofsha, Ngushullimtari nukë dotë vi-
8 një te ju. Edhe ay kur të vinjë, dotë qërto-
një botënë për faj, edhe për drejtëri, edhe
9 për gjyq; Për faj, sepse nukë më bësonjënë;
10 Edhe për drejtëri, sepse vete tek im Atë,
11 edhe më nukë më shihni; Edhe për gjyq, se-
pse urdhërtari i kësaj bote është gjykuarë.
12 Edhe shumë u kam për të thënë juve, po
13 ndashti nukë munt t' i mbani; Po kur të vinj'
ay, Frym' e së-vërtetësë, dot' u heqnjë juve
udhënë mbë gjithë të-vërtetënë; sepse nukë
dotë flasë prej vetiu, po dotë flasë sa që të
dëgjonjë, edhe dot' u dëftenjë juve ato *pu-*
14 *nëra* që kanë për të ardhurë. Ay dotë më
lavduronjë, sepse prej s' imesë dotë marrë,
15 edhe dot' u dëftenjë juve. Gjithë sa ka Ati,
janë të mijatë; përandaj thashë, se dotë ma-
rrë prej s' imesë, edhe dot' u dëftenjë juve.
16 *Edhe* pak, edhe nuke *dotë* më shihni; edhe

BKSH

përsëri *edhe* pak, edhe dotë më shihni; se-
pse unë po vete tek Ati.
17 Atëhere *ca* nga nxënësit' e ati i thanë
njëri tjatërit, Ç'është këjo që na thotë, *Edhe*
pak, edhe nukë dotë më shihni; edhe përsëri
edhe pak, edhe dotë më shihni? edhe se unë
18 vete tek Ati? Thoshinë pra, Ç' është këjo që
thotë, *Edhe* pak? Nukë dimë se ç' flet.
19 JisuJ pra kupëtoj, se doninë t'a pyesënë,
edhe u tha atyre, Për këtë haheni njëri me
tjatërinë, se thashë, *Edhe* pak, edhe nukë dotë
më shihni, edhe përsëri, *edhe* pak, edhe dotë më
20 shihni? Me të-vërtetë, me të-vërtetë po u them
juve, se ju dotë qani, edhe dotë ulërini, po
bota dotë gëzonetë; edhe ju dotë hidhërohi,
po hidhërimi juaj dotë kthenetë mbë gëzim.
21 Gruaja, kur pjell, ka hidhërim, se i erdhi ora;
po si të pjellë foshnjenë, s' kujton më shtrën-
gimnë, për gëzimnë se njeri lindi ndë botët.
22 Edhe ju pra ndashti kini hidhërim; po për-
sëri dot' u shoh juve, edhe zëmëra juaj dotë
gëzonetë, edhe asndonjë nukë ngre gëzi-
23 mnë t' uaj prej jush. Edhe nd' atë ditë nukë
dotë lypni prej meje asgjë. Me të-vërtetë, me
të-vërtetë po u them juve, se sa t' i lypni
24 Atit mb' emërit t' im, dot' u'a apë juve. Gjer
ndashti nukë lyptë asgjë mb' emërit t' im;
lypni, edhe dotë merrni, që të jetë i-plotë
gëzimi juaj.
25 U fola juve këto me të-përgjajtura; po

BKSH

vjen një orë, kur nukë dot' u flas më juve
me të-përgjajtura, po faqeza dot' u dëftenj
26 juve për Atinë. Nd' atë ditë dotë lypni mb'
emërit t' im; edhe nuk' u them juve, se dot'
27 i lutem Atit për ju; Se vetë Ati u do juve,
sepse ju më keni dashurë, edhe keni besu-
28 arë, se unë dolla prej Perëndisë. Dolla prej
Atit, edhe erdha ndë botët; përsëri lë botënë,
edhe vete tek Ati.
29 Nxënësit' e ati i thonë, Na ndashti tek
flet faqeza, edhe nukë thua asndonjë të-për-
30 gjajturë. Ndashti e njohëmë se i di të-gjitha,
edhe s' ke nëvojë të të pyesë ndonjë. Përan-
daj besojmë se dolle nga Perëndia.
31 Jisuj u upërgjeq atyre, Ndashti besoni?
32 Na tek vjen një orë, edhe ndashti erdhi, që
të përndaheni gjithë-sicili mbë të-tiat, edhe
të më lini vetëmë; po s' jam vetëmë, sepse
33 Ati është bashkë me mua. U fola juve këto,
që të keni paqtim mbë mua. Ndë botët dotë
keni shtrëngim; po kini zëmërë, un' e kam
mundurë botënë.

Krye 17.

1 Këto foli Jisuj; pastaj ngriti syt' e ti ndë
qiellt, e tha,
Atë, erdhi ora, lavduro t' ët Bir, që të të
2 lavduronjë edhe yt Bir; Sikundrë i dhe pu-
shtet mbë çdo mish, që t' u apë jetë të-për-
3 jetësme gjith' atyreve që j'a ke dhënë. Edhe

BKSH

kējo ështē jet' e-përjetëshme, të njohënë ty
të-vetëminë *e* të-vërtetinë Perëndi; edhe Jisu
4 Krishtinë që dërgove. Unë të lavdurova mbi
dhet; atë punë që më dhe të bënj e mba-
5 rova. Edhe ndashti lavduro-më ti, o Atë,
përanë teje, me lavdinë që pata përanë teje
para se të bënej bota.
6 Emërinë t'ënt u'a dëfteva njerëzet që më
dhe prej botësë. Të-tutë ishinë, edhe m' i
7 dhe, edhe fjalënë t' ënde e ruajtnë. Ndashti
e njohnë se gjithë sa më ke dhënë janë prej
8 teje; Sepse fjalëtë që më dhe, u'a dhashë a-
tyre; edhe ata i muarnë, edhe e njohnë me
të-vërtetë se prej teje dolla; edhe bësuanë se
9 ti më dërgove. Unë lutem për ata; nukë lu-
tem për botënë, po për ata që më dhe; sepse
10 janë të-tutë. Edhe gjithë të-mijatë janë të-
tuatë, edhe të-tuatë janë të-mijatë; edhe u-
11 lavduruashë nd' ato. Edhe nukë jam më ndë
botët, po këta janë ndë botët, edhe unë po
vinj te ti. At' i-shënjtëruarë, ruaj-i mb' emë
rit t' ënt ata që më dhe, që të jenë një si-
12 kundrë neve. Kur ishnjam bashkë me ata
ndë botët, un' i ruanjam mb' emërit t' ënt;
ata që më dhe i ruajta, edhe asnjë nga ata
s' humbi, veç i bir' i humbjesë, që të mbu-
13 shetë shkronja. Edhe ndashti po vinj te ti,
edhe flas këto ndë botët, që të kenë gëzimnë
14 t'im të-plottë ndë vetëhet të tyre. Un' u dhash'
atyre fjalënë t' ënde; edhe bota i mori mëri,

sepse nukë janë nga bota, sikundrë unë nukë
15 jam nga bota. Nukë të lutem t' i ngresh ata
16 nga bota, po t' i ruanjç nga i-ligu. Nukë
janë nga bota, sikundrë unë nukë jam nga
17 bota. Shënjtëro-i ata me të-vërtetënë t' ënde;
18 fjala jote ësht' e-vërteta. Sikundrë më dër-
gove mua ndë botët, edhe un' i dërgova ata
19 ndë botët. Edhe unë për ata shënjtëronj ve-
tëhenë t' ime, që të jenë edhe ata të-shënjtëru-
20 arë me të-vërtetënë. Edhe nukë të lutem vetë-
më për këta, po edhe për ata që dotë më be-
21 sonjënë mua me anë të fjalës' s' atyreve; Që
të-gjithë të jenë një; sikuhdrë ti, o Atë, *je*
tek unë, edhe unë tek ti, edhe ata të jenë një
te neve; që të besonjë bota se ti më dërgove.
22 Edhe un' u dhashë atyre lavdinë që më dhe, që
23 të jenë një, sikundrë edhe neve jemi një. Unë
tek ata, edhe ti tek unë, që të jenë të-sosurë
mbë një, edhe bota t'a njohë se ti më dërgove,
edhe *se* i deshe ata sikundrë më deshe mua.
24 O Atë, dua të jenë bashkë me mua *atje*
ku jam unë edhe ata që më dhe; që të
vështronjënë lavdinë t' ime, që më ke dhënë,
sepse më deshe para se të ngrihetë bota .
25 O At' i-drejtë, bota nukë të njohu, po unë
të njoha, edhe këta e njohnë se ti më dër-
26 gove. Edhe u dëfteva atyre emërinë t' ënt,
edhe dot'a dëftenj, që të jetë ndër ata da-
shuria, me të-cilënë më deshe, edhe unë tek
ata .

Kye 18.

1 Jisuj passi tha këto, dolli bashkë me nxë-
nësit' e ti përtej përrojt të Qedhronit, ku ish-
te një kopësht, ndë të-cilët hyri ay edhe
nxënësit' e ati.
2 Edhe e dinte vëndinë edhe Judha, ay që
e trathëtoj; sepse Jisuj shumë herë umbloth
3 atje me nxënësit' e ti. Judha pra, passi mori
tufën' e ushtëtorëvet, edhe shërbëtorë nga
kryepriftërit' e nga Farisenjtë, vjen atje me
4 fenerë e me pishtarë e me armë. Jisuj pra
dyke diturë gjithë ç' dotë vininë mbi atë, dolli,
5 e u tha atyre, Cilinë kërkoni? I upërgjeqnë,
Jisu Nazoreasinë. Jisuj u thot' atyre, Unë jam.
Edhe bashkë me ata rrinte edhe Judha, ay
6 që e trathëtoj. Passi pra u tha atyre, Se unë
7 jam, uhoqnë prapa, edhe ranë përdhe. Për-
sëri pra i pyeti, Cilinë kërkoni? Edhe ata
8 thanë, Jisu Nazoreasinë. Jisuj upërgjeq, U tha-
shë juve, se unë jam. Ndë më kërkoni mua
9 pra, lini këta të venë; Që të mbushetë fjala
që tha, Se prej atyre që më dhe nukë hum-
ba asnjë.
10 Atëhere Simon Pjetri, i-cili kishte një
thikë, e hoqi, e i ra shërbëtorit të kryepriftit,
edhe i preu ati veshn' e-djathtë; edhe emër' i
11 shërbëtorit ishte Mallko. Jisuj pra i tha Pje-
trit, Vër'-e thikënë t' ënde ndë millr. Kupënë
që më dha Ati të mos e pi?
12 Tufa e ushtëtorëvet pra edhe urdhërmi-

jësi edhe shërbëtorët' e Judhenjvet zunë Jisunë,
edhe e lithnë, edhe e shpunë atë më përpara
13 te Anna; Sepse ish i vjehërri i Kaiafësë, i-cili
14 ishte kryeprift i ati viti. Edhe Kaiafa ishte
ay që këshilloj Judhenjtë, se është mirë të
humbasë një njeri për llauzinë.
15 Edhe Simon Pjetri i vinte prapa Jisujt,
edhe *ay* nxënësi tjatërë; edhe ay nxënësi
ishte i-njohurë te kryeprifti, edhe hyri ba-
16 shkë me Jisunë ndë avllit të kryepriftit. Po
Pjetri rrinte jashtë përanë derësë. Dolli pra
ay nxënësi tjatërë që ishte i-njohurë te krye-
prifti, edhe i tha portaresë, edhe e kalli bren-
17 da Pjetrinë. Atëhere shërbëtoreja portare i
thotë Pjetrit, Mos je edhe ti nga nxënësit'e
18 këti njeriu? Ay i thotë, Nukë jam. Edhe
punëtorët' edhe shërbëtorëtë kishinë bërë
zjarr, sepse ishte ftohëtë, edhe po ngroheshinë;
edhe bashkë me ata ishte *edhe* Pjetri dyke
ndënjur' e dyke ngrohurë.
19 Kryeprifti pra pyeti Jisunë për nxënësit' e
20 ati edhe për mësimn' e ati. Jisuj i upërgjeq,
Unë faqeza fola ndë botët; unë përhere më-
sova *njerëzitë* ndë sinagogjit edhe ndë hiero-
ret, ku nga të gjithë anëtë mblidhenë Ju-
dhenjtë, edhe mbë të-fshehëtë nukë fola as-
21 gjë. Ç' me pyet? pyet ata që kanë dëgjuarë
ç' ufola atyre; na këta dinë sa thash' unë.
22 Edhe ay kur tha këto, një nga shërbëto-
rëtë që rrinte përanë i ra një shuplakë Jisujt,

dyke thënë, Kështu i përgjigjesh kryepriftit?
23 Jisuj i upërgjeq, Ndë fola keq, dëshmo për
të-keqenë; po ndë *fola* mirë, përse më rreh?
24 Edhe Anna e dërgoj lidhurë te kryeprifti
Kaiafë.
25 Edhe Simon Pjetri ishte dyke ndënjurë
edhe dyke ngrohurë; i thanë pra, Mos je
edhe ti nga nxënësit' e ati? Ay e mohoj, e
26 tha, Nukë jam. Një nga shërbëtorët' e krye-
priftit, që ishte farëfisas i ati, të-cilit Pjetri
i preu veshnë, thotë, Nukë të pash' unë ndë
27 kopështt bashkë me atë? Pjetri pra e mohoj
përsëri, edhe për-ŋë-here gjeli këndoj.
28 Bienë pra Jisunë prej Kaiafësë ndë vëntt
të gjyqit; edhe ishte mëngjes, edhe ata nukë
hynë ndë vëntt të gjyqit, që të mos ndyrenë,
po të hanë pashkënë.
29 Pillati pra dolli, edhe tha, Ç'farë përfolje-
30 je bini kundrë këti njeriu? Upërgjeqn' e i
thanë, Ky të mos ishte keq-bërës, nukë dotë
31 t'a epnimë ty ndër duar. Pillati pra u tha
atyre, Merr-e-ni ju edhe pas nomit t'uaj gjy-
ko-e-ni. Judhenjtë pra i thanë, S' ësht' e-ndjerë
32 ndër ne të vrasëmë asnjeri. Që të mbushetë
fjal' e Jisujt që tha, dyke shënuarë me ç'farë
vdekjeje kishte për të vdekurë.
33 Pillati pra hyri përsëri ndë vëntt të gjy-
qit, edhe thërriti Jisunë, e i tha, Ti je mbre-
34 ti i Judhenjet? Jisuj upërgjeq, Prej vetiu e
thua ti këtë, apo të-tjerë të thanë për mua?

BKSH

35 Pillati upërgjeq, Mos jam unë Judhe? kom-
bi yt edhe kryepriftëritë të dhanë ndër du-
36 art t' ime; ç' ke bërë? Jisuj upërgjeq, Mbre-
tëria ime nuk' është prej kësaj bote; mbretë-
ria ime po të qe prej kësaj bote, shërbë-
torët' e mi dotë përpiqeshinë, që të mos e-
pem ndë duart të Judhenjvet. Po tashi mbretë-
37 ria ime nuk është së-këtejmi. Pillati pra i
tha, Mbret je ti pra? Jisuj upërgjeq, Ti po
thua, se unë jam mbret. Unë përandaj linda,
edhe përandaj erdha ndë botët, që të dësh-
monj për të-vërtetënë. Kushdo që është prej
38 së vërtetësë, dëgjon zënë t' im. Pillati i thotë,
Ç' ësht' e-vërteta?
Edhe si tha këtë, dolli përsëri te Judhenj-
të, e u thot' atyre, Unë nukë gjenj ndonjë faj
39 tek ay. Po është zakon ndër ju, t' u lëshonj
juve një për pashkë; doni pra t' u lëshonj
40 juve mbretin' e Judhenjvet? Atëhere të-gjithë
bërtitnë përsëri, dyke thënë, Mos këtë, po
Varavvanë. Edhe Varavvaj ishte kursar.

Krye 19.

1 Atëhere pra Pillati mori Jisunë, edhe e
2 rrahu. Edhe ushtëtorëtë gërshetuanë një ku-
rorë prej ferrash, e j'a vunë mbi kryet, edhe
3 i veshnë një rrobë të-kuqe, Edhe thoshinë,
Gëzohu, o mbret' i Iudhenjvet! edhe i bininë
me shuplaka.
4 Pillati pra dolli përsëri jashtë, edhe u thot'

BKSH

atyre, Na tek po u'a bie atë jashtë, që t'a
5 dini, se asndonjë faj nukë gjenj tek ay. Ji-
suj pra dolli jashtë veshurë kurorënë prej
ferrash edhe rrobën' e-kuqe. Edhe *Pillati*
6 u thot' atyre, Na njeriu! Kur e pan' atë krye-
priftërit' edhe shërbëtorëtë, bërtitnë, dyke
thënë, Kryqëzo-*e*, kryqëzo-*e*. Pillati u thot'
atyre, Merr-e-ni ju atë, edhe kryqezo-e-ni;
7 sepse unë nukë gjenj faj tek ay. Judhenjtë
i upërgjeqnë, Neve kemi nom, edhe pas no-
mit t' ënë *ky* duhetë të vdesë, sepse bëri
vetëhen' e ti Bir të Perëndisë.
8 Pillati pra kur dëgjoj këtë fjalë, më te-
9 përë ufrikësua, Edhe përsëri hyri ndë vëntt
të gjyqit, edhe i thotë Jisujt, Nga je ti? Po
10 Jisuj nuk' i dha të-përgjegjurë. Pillati pra i
thotë, Mua nukë më flet? nuk' e di *ti* se *unë*
kam pushtet të të kryqëzonj, edhe kam pu-
11 shtet të të lëshonj? Jisuj upërgjeq, Nukë *dotë*
kishnje asndonjë pushtet kundrë meje, po
të mos të qe dhënë prej së-larti; përandaj
ay që më ep ndër duart të tua ka më të-
math faj.
12 Që atëhere Pillati kërkonte t' a lëshonte,
po Judhenjtë thërrisninë dyke thënë, Ndë lë-
shofsh këtë, nukë je miku i Qesarit; gjithëkush
që bën vetëhen' e ti mbret, flet kundrë Qesa-
13 rit. Pillati pra kur dëgjoj këtë fjalë, solli ja-
shtë Jisunë, edhe ndënji mbi front të gjyqit, që
thuhetë Gur-shtruarë, edhe Evraisht Gavvatha.

BKSH

14 Edhe ishte kanon' i pashkësë, edhe ora
sindonja gjashtë; edhe u thot' Judhenjvet, Na
15 mbreti juaj. Po ata bërtitnë, Ngri-*e*, ngri-*e*,
kryqezo-e. Pillati u thot' atyre, Mbretnë t' uaj
të kryqëzonj? Kryepriftërit' upërgjeqnë, S' ke-
16 mi *tjatërë* mbret veç Qesarinë. Atëhere pra
u'a dha atyre ndër duar, që të kryqëzonetë.
Edhe *ata* muarnë Jisunë, edhe e shpunë.
17 Edhe *Jisuj* dyke mbajturë kryqin' e ti dolli
nd' *atë* vënt që thuhetë vënd' i Kresë, që
18 Evraisht thuhetë Gollgotha; Atje kryqëzuan'
atë edhe dy të-tjerë bashkë me atë andej
edhe këtej, edhe Jisunë ndë mest.
19 Pillati shkroj edhe një titllë, edhe e vuri
mbi kryqt; edhe ishte shkruarë *Jisu Nazo-*
20 *reasi mbreti i Judhenjvet.* Edhe këtë titllë e
kënduanë shumë *veta* prej Judhenjet; sepse
ishte shkruarë Evraisht, Gërqisht *edhe* Lla-
21 tinisht. Edhe kryepriftërit' e Judhenjvet pra i
thoshinë Pillatit, Mos shkruaj, Mbreti i Ju-
dhenjvet, po se ay tha, Jam mbreti i Judhenj-
22 vet. Pillati upërgjeq, Atë që shkrova e shkrova.
23 Ushtëtorëtë pra, passi e kryqëzuanë Ji-
sunë, muarnë rrobat' e ati, edhe i bënë katrë
pjesë, për gjithë-si-cilinë ushtëtuar një pje-
së, edhe petkunë; edhe petku ishte i-paqe-
24 purë, endur' i-tërë që së-sipërmi. Thanë pra
ndër mest të tyre, Letë mos e grisınë atë,
po letë shtjemë shortë për atë, kujt t' i bjerë;
—që të mbushetë shkronja që thotë, „Ndanë

rrobat' e mia ndër mest të tyre, edhe shtynë
shortë mbi petkunë t' im." Ushtëtorëtë pra
bënë këto.
25 Edhe përanë kryqit të Jisujt ishinë dyke
ndënjurë e ëma edhe e motër' e s' ëmës s' ati,
Maria *gruaja* e Kllopajt, edhe Maria Mag-
26 dhalinë. Jisuj pra kur pa t' ëmënë edhe *atë*
nxënësinë që donte dyke ndënjurë përanë,
27 i thotë s' ëmësë, Grua, na yt bir. Pastaj i
thotë nxënësit, Na jot' ëmë. Edhe nxënësi që
atëhere e mori ndë shtëpit të ti.
28 Pas kësaj Jisuj dyke diturë, se ndashti
umbaruanë të-gjitha, që të mbushetë shkro-
29 nja, thotë, Kam et. Edhe ishte *atje* një enë
plot me uthullë; edhe ata mbushnë një sfun-
gar me uthullë, edhe e vunë mbë një hyssop,
30 e j'a prunë ndë gojët. Jisuj pra kur mori
uthullënë, tha, Umbarua, edhe unji kryetë,
e dha frymënë.
31 Judhenjtë pra, për të mos mbeturë tru-
patë mbi kryqt për *ditën'* e-shëtunë, sepse
ishte e-prëmte, (sepse ajo dit' e-shëtunë ishte
e-madhe,) i ulutnë Pillatit t' u thyhenë kër-
32 cinjt' e *këmbëvet*, edhe të ngrihen' *andej*. Erth-
në pra ushtëtorëtë, edhe thyenë kërcinjt' e
të-parit, edhe t' ati tjetërit që ukryqëzua
33 bashkë me atë. Po kur erthnë te Jisuj, edhe
e panë, se më kishte vdekurë, nuk' i thye-
34 në kërcinjtë; Po një nga ushtëtorëtë i çpoj
brinjënë me shtijzë, edhe për-një-here i dolli

BKSh

35 gjak edhe ujë. Edhe ay që pa dëshmoj, edhe
dëshmim' i ati ësht' i-vërtetë, edhe ay e di
36 se thotë të-vërtetënë, që të besoni ju. Sepse
këto ubënë që të mbushetë shkronja, „Eshtër
37 nukë dot' i thyhetë." Edhe përsëri *një* tjatërë
shkronjë thotë, „Dotë vështronjënë mb'atë qe
çpuanë."

38 Edhe pas këtyre Josifi që ishte nga Ari-
mathea, (i-cili ishte nxënës i Jisujt, po i fshe-
hurë nga frik' e Judhenjvet,) i ulut Pillatit që
të ngrerë trupin' e Jisujt; edhe Pillati i dha
lejë. Erdhi pra edhe ngriti trupin' e Jisujt.
39 Erdhi edhe Nikodhimi, (ay që pat ardhurë
te Jisuj një herë më parë natënë,) edhe pruri
të-përzjerë mirë edhe alloe, sindonja një qint
40 litra. Muarnë pra trupin' e Jisujt, edhe e
pshtuallnë me pëlhurëra bashkë me erëratë,
sikundrë e kanë zakon Judhenjtë të kllasënë
ndë varr.

41 Edhe nd' *atë* vënt që ukryqëzua ishte një
kopësht, edhe ndë kopështt një varr i-ri, ndë
42 të-cilët edhe s' ishtë vënë asndonjë *njeri.* Atje
pra vunë Jisunë, për të-prëmten' e Judhenjet,
sepse varri ishte afërë.

Krye 20.

1 Edhe *ditën'* e-parë të javësë vjen Maria
Magdhalinë te vari ndë mëngjest, dyke qënë
edhe po errëtë, edhe sheh gurinë ngriturë
2 nga varri. Suletë pra edhe vjen te Simon

BKSH

Pjetri, edhe tek *ay* nxënësi tjetërë që donte
Jisuj, edhe u thot' atyre, E ngritnë Zotinë nga
varri, edhe nukë dimë se ku e kanë vënë.
3 Dolli pra Pjetri edhe nxënësi tjetërë, edhe
4 vininë ndë varrt. Edhe suleshinë të dy bashkë;
edhe *ay* nxënësi tjetërë usul përpara më
çpejt se Pjetri edhe erdhi më përpara ndë
5 varrt; Edhe si uunj, sheh pëlhuratë ku ishinë,
6 po nukë hyri. Vjen pra Simon Pjetri dyke
ardhurë pas ati, edhe hyri ndë varrt, edhe
7 vë re pëlhuratë ku ishinë; Edhe riza që ishte
mbi kryet t' ati nuk' ugjënt bashkë me pël-
huratë, po ishte pshtjellë veç mbë një vënt.
8 Atëhere pra hyri edhe *ay* nxënësi tjetërë
që erdhi më përpara ndë varrt, edhe pa,
9 edhe besoj; Sepse edhe s'kupëtoninë shkro-
njënë, se ay duhetë të ngjalletë prej së-vde-
10 kurish. Nxënësitë pra vanë përsëri ndëpër
shtëpirat të tyre.
11 Edhe Maria rrinte përanë varrit dyke qarë
përjashta; edhe tek po qante, uunj ndë varrt;
12 Edhe vë re dy ëngjëj me rroba të-bardha
dyke ndënjurë njeri nga krej e tjatëri nga
13 këmbëtë, *atje* ku qe trupi i Jisujt. Edhe ata
i thonë asaj, Grua, përse qan? U thot' atyre,
Sepse ngritnë t'im Zot, edhe nukë di ku e
14 kanë vënë. Edhe si tha këto, ukthye prapa,
edhe vë re Jisunë dyke ndënjurë, edhe nuk'
15 e dinte se ësht' Jisuj. Jisuj i tha asaj, Grua,
përse qan? cilinë kërkon? Po ajo dyke pan-

dehurë, se është kopshtari, i thotë, Zot, ndë
e ngrite ti, thuaj-më ku eke vënë, edhe unë
16 dot'a ngre atë.. Jisuj i thot' asaj, Marie! Ajo
kthenet' e i thotë, Ravuni! që do me thënë,
17 Mësonjës. Jisuj i thot' asaj, Mos m' upshet;
sepse edhe s'kam hipurë tek im Atë; po shko
te vëllezërit' e mi, edhe u thuaj atyre, Po
hipënj tek im Atë edhe tek Ati juaj, edhe
18 te Perëndia im edhe te Perëndia juaj. Vjen
Maria Magdhalinë, e u ep zë nxënëset, se
pa Zotinë, edhe se i tha asaj këto *fjalë*.
19 Nd' atë ditë pra, të-parënë *ditë* të javësë,
si ungrys, edhe dyert' ishinë mbyllur' atje ku
ishin mbledhurë nxënësitë nga frik' e Judhenj-
vet, erdhi Jisuj, edhe ndënji ndë mest, edhe
20 u thot' atyre, Paqtim mbë ju. Edhe si tha
këtë, u dëfteu atyre duart' edhe brinjën' e ti.
Ugëzuanë pra nxënësitë, kur panë Zonë.
21 Edhe Jisuj u tha atyre përsëri, Paqtim mbë
ju; sikundrë më dërgoj Ati, edhe un' u dër-
22 gonj juve. Edhe si tha këtë, fryjti, edhe u
23 thot' atyre, Merni Frymë të-Shënjtëruarë. Kuj-
ve t' u falni fajetë, u janë falur' atyre; kujve
t'u'a mbani, u janë mbajtur' atyre.
24 Po Thomaj, një nga të dy-mbë-dhjetëtë,
që thuhetë Binjak, nuk' ishte bashkë me ata,
25 kur erdhi Jisuj. Nxënësit' e-tjerë pra i tho-
shinë, Pamë Zotinë. Po ay u tha atyre, Ndë
mos pafsha ndë duart t'ati shënjën' e pero-
navet, edhe të vë gishtinë t'im ndë shënjët

BKSH

të peronavet, edhe të vë dorënë ndë brinjët
t' ati, s' kam për të besuarë.
26 Edhe pas tetë ditsh përsëri ishinë brënda
nxënësit' e ati, edhe Thomaj me ata. Vjen
Jisuj, ndonëse dyertë ishinë mbyllurë, edhe
ndënji ndë mest, edhe tha, Paqtim mbë ju.
27 Pastaj i thotë Thomajt, Bierë gishtinë t'ënt
këtu, edhe shih duart' e mia; edhe bierë do-
rënë t'ënde, edhe vër'-e ndë brinjët t'ime,
28 edhe mos ubëj i-pabesë, po besëtar. Edhe
Thomaj upërgjeq, e i tha, Zoti im edhe Pe-
29 rëndia im. Jisuj i thotë, Sepse më pe, (o Thoma,)
besove; lum ata qe nukë panë, edhe besuanë.
30 Edhe shumë çudira të-tjera bëri Jisuj
përpara nxënëset të ti, të-cilatë nukë janë
31 shkruarë ndë këtë vivli. Po këto ushkruanë
që të besoni se Jisuj është Krishti, i Bir' i
Perëndisë, edhe dyke besuarë të keni jetë
mb' emërit t'ati.

Krye 21.

1 Pastaj Jisuj u'a dëfteu vetëhen' e ti për-
sëri nxënëset ndë dett të Tiveriadhësë; edhe
e dëfteu kështu.
2 Ishinë bashkë Simon Pjetri edhe Thomaj
që thuhetë Binjak, edhe Nathanaili *që është*
nga Kanaja e Galilesë, edhe *të bijt* e Zeve-
dheut, edhe dy të-tjerë nga nxënësit' e ati.
3 Simon Pjëtri u thot' atyre, Vete të gjuanj
pishqe. I thonë, Vijmë edhe neve bashkë

BKSH

me ty. Duallnë edhe hipnë ndë lundrët për-
një-here, edhe atë natë nukë zunë asgjë.
4 Po tani si ubë mëngjes, Jisuj ndënji ndë
buzët *të detit*; po nxënësitë nuk' e njohnë se
5 është Jisuj. Jisuj pra u thot' atyre, Djemthit'
e mi, mos keni ndonjë gjë për të ngrënë?
6 I upërgjeqnë, jo. Edhe ay u tha atyre, Hithni
rrietënë mb' anët të-djathtë të lundrësë, edhe
dotë gjeni. E hothnë pra, edhe s'muntnë më
7 t'a hiqninë nga shumica e pishqevet. Ay nxë-
nësi pra, që donte Jisuj, i thotë Pjetrit, Është
Zoti. Edhe Simon Pjetri, kur dëgjoj se është
Zoti, upshtuall me petkunë, (sepse iste la-
8 kuriq,) edhe uhoth ndë dett. Edhe nxënësit'
e-tjerë erthnë me lundrëzënë, (sepse nuk'
ishte lark tokësë, po sindonja dy qint kut,)
dyke hequrë rrietën' e pishqevet.
9 Edhe si sbritnë pra mbë tokët, shohënë,
se *atje* ishte një zjarr i-ndezurë, edhe një
10 peshk vënë mbi atë, edhe bukë. Jisuj u thot
11 atyre, Bini nga pishqetë që zutë tashi. Simon
Pjetri hipi edhe hoqi rrietënë mbi tokët plot
me pishke të mëdhenj, një qint e pesë-dhjet'
12 e tre. Jisuj u thot' atyre, Ejani e drekohi. Po
asndonjë nga nxënësitë nukë kuxonte t'a py-
esë, Cili je ti? sepse e dininë se është Zoti.
13 Vjen pra Jisuj edhe merr bukënë e u'a ep,
edhe peshkunë gjithashtu.
14 Këjo ësht' e-treta herë që udëftye tashi

BKSh

Jisuj te nxënësit' e ti, passi ungjall prej së-
vdekurish.
15 Passi udrekuanë pra, Jisuj i thotë Simon
Pjetrit, Simon *i bir'* i Jonajt, A më do më
tepërë se këta? I thotë, Po, Zot; ti e di se
16 të dua. I thot' ati, kullot shqerat' e mi. I tho-
të prapë përsë-dyti, Simon *i bir'* i Jonajt, a
më do? I thotë, Po, Zot; ti e di se të dua.
17 I thotë, Ruaj dhënt' e mia. I thotë për-së-
treti, Simon *i bir'* i Jonajt, a më do? Pjetrit
i erth keq, se i tha për-së-treti, A më do?
edhe i tha, Zot, ti i di të-gjitha; ti e di se të
18 dua. Jisuj i thotë, Kullot dhënt' e-mia. Me të-
vërtetë, me të-vërtetë po të them, Kur ishnje
ti më i-ri, ngjishnje vetëhenë t' ënde, edhe
ecënje ku të donje; po kur të mblakesh,
dotë ndejsh duart' e tua, edhe tjatërë *njeri*
dotë të ngjeshnjë ty, edhe dotë *të* shpjerë
19 ku të mos duash. Edhe tha këtë, dyke shë-
nuarë me ç' farë vdekjeje kishte për të lav-
duruarë Perëndinë.
20 Edhe si tha këtë, i thotë, Eja pas meje.
Edhe Pjetri ukthye, edhe sheh *atë* nxënësinë
që donte Jisuj dyke ardhurë prapa, i-cili ndë
darkët i pat rënë mbë krahëruart, e i tha,
21 Zot, cili ësht' ay që të trathëton? Pjetri pra
kur pa këtë, i thotë Jisujt, Zot, po ky ç' *dotë*
22 *bënetë?* Jisuj i thotë, Ndë dua të mbesë ay
gjersa të vinj *unë,* ti ç' *ke*? ti eja pas meje.
23 Dolli pra këjo fjalë ndër vëllezërit, se ay

BKSH

nxënësi nukë vdes. Po Jisuj nuk' i tha, se
nukë vdes; po, Ndë dua të mbesë gjersa të
vinj *unë,* ti ç' *ke?*
24 Ky është ay nxënësi qe dëshmon për këto,
edhe që shkroj këto; edhe e dimë se dë-
shmim' i ati ësht' i-vërtetë.
25 Janë edhe shumë të-tjera sa bëri Jisuj,
të-cilatë ndë ushkrofshinë një nga një, kuj-
tonj se as bota vetë nukë dot' i nxintë vi-
vllatë që ishinë për të shkruarë. Amin.

BKSH

Punët' e Apostojvet.

Krye 1.

1 Fjalën' e-parë, o Theofil, e bëra për gjithë
2 sa zuri Jisuj të bënjë e të mësonjë, Gjer mb'
atë ditë që hipi lart *ndë qiellt*, passi me anë
të Frymës' së-Shënjtëruarë u la porosi apo-
3 stojvet që pat sgjedhurë; Mbë të-cilët edhe e
dëfteu vetëhen' e ti të-gjallë me shumë shënja
pas të-pësuarit të ti, dyke dukurë ndër ata
dyzet dit, e dyke folurë për punët' e mbre-
4 tëris' së Perëndisë. Edhe dyke umbledhurë ba-
shkë me ata i porositi të mos ndahenë nga
Jerusalimi, po të presënë të-zotuarët' e Atit,
5 që dëgjuatë, *u tha*, prej meje. Sepse Joani pa-
gëzoj me ujë, po ju dotë pagëzoneni me Fry-
më të-Shënjtëruarë jo pas shumë ditve pas
këtyre.

6 Ata pra kur umblothnë bashkë me atë
mbë një vënt, e pyesninë, dyke thënë, Zot,
vallë mbë këtë kohë dot' j'a apç mbretërinë
7 Israilit? Edhe ay u tha atyre, Nuk' është puna
juaj të njihni kohërat' a motetë, të-cilëtë i ka
8 vënë Ati ndë pushtett të ti; Po dotë merrni
fuqi, kur të vinjë Frym' e-Shënjtëruarë mbi
ju; edhe dotë më jeni dëshmimtarë edhe ndë

BKSH

Jerusalim edhe ndë gjithë Judhet edhe ndë
Samarit edhe gjer ndë funtt të dheut.
9 Edhe si tha këto, tek po shihninë ata
ungrit lart, edhe një re e mori nga syt' e
10 atyreve. Edhe *ata* tek ishinë dyke vështru-
arë ndë qiellt, kur po shkonte ay *lart*, na dy
burra me rroba të-bardha tek qëndruanë pë-
11 ran' atyreve; Të-cilëtë edhe *u* thanë, O burra
Galileas, përse rrini e vështroni ndë qiellt?
ky Jisuj që hipi prej jush lart ndë qiellt
dotë vinjë kështu, sikundrë e patë atë dyke
vajturë ndë qiellt.
12 Atëhere ukthyenë ndë Jerusalim nga mali
që thuhetë Ullishte, i-cili është afërë Jerusa-
limit, edhe mban lark *sa* një udhë së-shëtune.
13 Edhe kur hynë, hipnë ndë dhomët të-sipërme,
ku kishinë të-ndënjuritë Pjetri e Jakovi e Jo-
ani e Andreu, Filippi edhe Thomaj, Vartho-
llomeu edhe Mattheu, Jakovi *i bir'* i Alfeut
edhe Simon Zillotiu, edhe Judha *i vëλaj* i
14 Jakovit. Këta të-gjithë ishinë dyke qëndru-
arë me një zëmërë mbë të-falurit e mbë të-
luturit, bashkë me gratë, edhe me Mariënë
t' ëmën' e Jisujt, edhe bashkë me të vëllezë-
rit' e ati.
15 Edhe ndër këto dit ungrit Pjetri ndë mest
të nxënëset, e tha, (edhe shumic' e të-mble-
dhurëvet atje ishte sindonja një qint e një-
zet *veta.*)
16 O burra vëλezër, duhej të mbushej këjo

BKSH

shkronjë, të-cilënë e tha më përpara Frym' e-
Shënjtëruarë me anë të Dhavidhit për Judhë-
në që ubë udhëheqës i atyreve që zunë Jisunë;
17 Sepse qe i-nunëruarë bashkë me ne, edhe
pat marrë pjesën' e kësaj shërbese.
18 Ky pra fitoj një arë nga pag' e paudhë-
risë, edhe dykd rënë përmbys plasi ndë mest,
edhe i uderthnë gjithë të-përbrëndëshmetë;
19 Edhe këjo ubë e-diturë ndër gjith' ata që
rrininë ndë Jerusalim, kaqë sa ajo arë uquajt
ndë gjuhët t' atyreve Akeldhama, që do me
thënë, Arë gjaku.
20 Sepse është shkruarë ndë vivlit të Psall-
mavet, „Ushkretoftë shtëpia e ati edhe mos
ndënjtë njeri nd' atë;" edhe, „Tjetërë e marrtë
21 punën' e ati". Duhetë pra nga ata burratë që
umblothnë bashkë me ne tërë kohënë, ndë
22 të-cilët Zoti Jisu hyri e dolli ndër ne, Dyke
zënë që nga pagëzimi i Joanit e gjer mb' atë
ditë ndë të-cilët hipi lart prej nesh, një nga
këta të bënetë dëshmimtar bashkë me ne për
të-ngjallurit' e ati.
23 Edhe ndanë dy *veta*, Josifnë që quhej
Varsava, i-cili upërmbiquajt Just, edhe Mat-
24 thinë. Edhe dyke falurë thanë, Ti, o Zot, zë-
mërë-njohës i të-gjithëve, dëfte një nga këta
25 të dy, atë që ke sgjedhurë, Që të marrë pje-
sën' e kësaj shërbese e apostolie, prej së-ci-
26 lësë ra Judha, që të vejë ndë véntt të ti. Edhe
u dhan' atyre shorta; edhe shorta i ra Mat-

BKSH

thisë, edhe unumërua bashkë me të një-mbë-
dhjetëtë apostoj.

Krye 2.

1 Edhe kur erdhi dit' e Pentikostisë, ishinë
2 të-gjithë me një zëmërë mbë një vënt. Edhe
papriturë ubë një oshëtimë nga qielli posi
oshëtima e një ere që fryn me fuqi, edhe
mbushi gjithë shtëpinë tek ishinë dyke ndë-
3 njurë. Edhe uduknë mb' ata gjuhëra dyke
undarë posi prei zjarri, edhe ndënjnë mbë
4 gjithë-sicilinë nga ata. Edhe umbushnë të-
gjithë me Frymë të-Shënjtëruarë, e zunë të
flisninë me gjuhëra të-tjera, sikundrë Fryma
u epte të flisninë.
5 Edhe ishinë dyke ndënjurë ndë Jerusalim Ju-
dhenj, burra me frikë Perëndie prej çdo kombi
6 ndënë qiellt. Edhe kur ubë ky zë, umbloth gjin-
dja edhe utrumbullua; sepse gjithë-sicili *nga
ata* dëgjonte ata dyke folurë ndë gjuhët të ti.
7 Edhe të-gjithë maniteshin' e çuditeshinë, dyke
thënë njeri tjatërit, Na, nukë janë Galileas
8 këta të-gjithë që flasënë? Edhe qysh gjithë-
sicili nga ne dëgjojmë ndë gjuhët t' ënë, ndë
9 të-cilët kemi lindurë? Parthë e Midhë e Ella-
mitë, edhe ata që rrinë ndë Mesopotamit e ndë
Judhet e ndë Kappadhoqit, ndë Pontt e nd'
10 Asit, Ndë Frygjit e ndë Pamfilit, nd' Egjyptët
e nd' anët të Livisë përanë Qyrinësë, edhe
të-ardhuritë nga Roma Judhenj e të-kthyerë,

BKSH

11 Kritas e Arapë, dëgjojm' ata dyke folurë ndë
12 gjuhërat t' ona madhëriat' e Perëndisë. Edhe
të-gjithë maniteshinë edhe vrisninë mëndjenë
dyke thënë njeri tjatërit, Vallë ç' dotë jetë
13 këjo? Edhe të-tjerë dyke përqeshurë thoshinë,
Se janë mbushurë me verë t' ëmbëlë.
14 Po Pjetri qëndroj bashkë me të një-mbë-
dhjetëtë, edhe ngriti zën' e ti edhe u ligjëroj
atyre,
O burra Judhenj edhe gjithë sa rrini ndë Je-
rusalim,letë jet' e-diturë këjo ndër ju, e vi-u-ni
15 veshnë fjalëvet të mia. Sepse këta nukë janë
të-dejturë, sikundrë pandehni ju; sepse *tashi*
16 është or' e-tret' e ditësë; Po këjo ësht' ajo që
17 është thënë me anë të profitit Joil: „Edhe
ndë ditt të-pastajme, thotë Perëndia, dotë
derth nga Fryma ime mbë çdo mish; edhe dotë
profitepsenë bijtë t' uaj edhe bijatë t'uaj, edhe
djaloshëtë t' uaj dotë shohënë të-fanitura,
edhe pleqtë t' uaj dotë ëndërrinjënë ëndërra;
18 Edhe mbi shërbëtorët të mi edhe mbi sbër-
bëtoret të mia nd' ato dit dotë derth nga
19 Fryma ime, edhe dotë profitepsënë; Edhe dotë
bënj çudira lart ndë qiellt edhe shënja poshtë
20 mbi dhet, gjak e zjarr e avullë tymi; Djelli
dotë kthenetë mb' errësirë, edhe hëna mbë
gjak, para se të vinjë e-madhja e e-çquara
21 dit' e Zotit. Edhe kushdo që të thërresë mb'
emërit të Zotit, dotë shpëtonjë."
22 O burra Israilitë, pa dëgjoni këto fjalë;

Jisu Nazoreasinë, njeri të-dëftyerë mbë ju nga
Perëndia me fuqira e me çudira e me shë-
nja, të-cilatë bëri Perëndia me anë t'ati ndër
23 mest t'uaj, sikundrë edhe vetë e dini, Këtë
që qe dhënë pas ëndës' s'urdhëruarë edhe
pas parënjojtjes' së Perëndisë *ju* e zutë edhe
me duar paudhërie e mbërthyetë edhe e vratë:
24 Këtë Perëndia e ngjalli, passi sgidhi dhëm-
bjet' e-këqia të vdjekjesë, sepse nukë munt
25 të mbahej ay prej asaj. Sepse Dhavidhi thotë
për atë' „Shihnjam Zotinë përpara meje gji-
thënjë, sepse është prej së-djathtësë s' ime,
26 që të mos tundem. Përandaj ugëzua zëmëra
ime, edhe gjuha ime ugazëllua; po edhe mishi
27 im dotë prëhetë mbë shpresë. Sepse nukë
dotë lësh shpirtinë t' im ndë hadht, as dotë
28 lësh Shënjtinë t'ënt të shohë prishje. Më dë-
fteve udhë jete; dotë më mbushç gëzim me
faqenë t' ënde."
29 O burra vëllezër, munt t'u them me ku-
xim për krye-atinë Dhavidh, se *ay* edhe vdiq
edhe ukall ndë varr, edhe varr' i ati është
30 ndër ne gjer mbë këtë ditë. Po dyke qënë pro-
fit, edhe dyke diturë se Perëndia me be i u-
përgjërua, se nga pema e mezit t' ati, pas
mishit, dotë ngjallnjë Krishtinë, që t'a vërë
31 të rrijë mbi front t' ati, E pa që më përpara
edhe foli për të-ngjallurit' e Krishtit, se shpirti
i ati nuk' ula ndë hadht, as mishi i ati nukë
32 pa prishje. Këtë Jisu e ngjalli Perëndia, për

33 të-cilinë neve të-gjithë jemi dëshmimtarë. Si
ungrit pra lart me *dorën'* e-djathtë të Perën-
disë, edhe mori nga Ati të-zotuarët' e Fry-
mës' së-Shënjtëruarë, derdhi këtë që ju nda-
34 shti shihni e dëgjoni. Sepse Dhavidhi nukë
hipi ndë qiejt; po ay thotë, „I tha Zoti Zo-
35 tit t'im, Rri prej së-djathtësë s' ime, Gjersa
të vë armiqt' e tu ndënëkëmbje të këmbëvet
të tua."
36 Let'a dijë pra fort mirë gjithë shtëpia e
Israilit, se këtë Jisunë, të-cilinë ju e kryqë-
zuatë, Perëndia e bëri Zot edhe Krisht.
37 Edhe si dëgjuanë *këto*, umallënjyenë ndë
zëmërët, edhe i thanë Pjetrit edhe apostoj-
vet të-tjerë, Ç' të bëjmë, o burra vëllezër?
38 Atëhere Pjetri u tha atyre, Pendohi, edhe
gjithëkush prej jush letë pagëzonetë mb' emërit
të Jisu Krishtit, për ndjesën' e fajevet; edhe
dotë merrni dhurëtin' e Frymës' së-Shënjtëru-
39 arë; Sepse të-zotuarët' është mbë ju edhe mbë
djemtë t'uaj, edhe mbë gjith' ata *që janë* lark,
40 sa ka për të thirrurë Zoti Perëndia ynë. Edhe
me shumë fjalë të-tjera dëshmonte edhe i
nguste *ata*, dyke thënë, Shpëtoni nga ky bres
i-shtrëmbërë.
41 Ata pra që pritnë me gëzim fjalën' e ati
upagëzuanë; edhe atë ditë ushtuanë sindonja
tri mijë shpirte.
42 Edhe ishinë dyke priturë ndë mësimt të
apostojvet, e ndë shoqërit, e ndë të thyerët

BKSH

43 të bukësë, e ndë të-falurat. Edhe çdo shpirti
i hyri frikë; edhe shumë çudira e shënja bë-
44 neshinë me anë t' apostojvet. Edhe gjith' ata
që besoninë ishinë bashkë, edhe të-gjitha i
45 kishinë të-bashkëta. Edhe shisninë kamjet' e
gjënë, e i ndaninë ndëpër të-gjithë, sipas ne-
46 vojësë që të kishte gjithë-sicili. Edhe përdita
ishinë dyke priturë me një zëmërë ndë hie-
roret, e thyeninë bukë prej shtëpie mbë shtëpi,
e haninë me gëzim e me kthjellësirë zëmëre,
47 Dyke lavduruarë Perëndinë, e dyke pasurë
hir përpara gjithë llauzit. Edhe Zoti shtonte
përdita ndë kishët ata që shpëtoninë.

Krye 3.

1 Edhe Pjetri e Joani po hipninë bashkë
ndë hieroret ndë të-falurit mbë të-nënttënë
2 orë. Edhe një njeri që ishte i-çalë që nga
barku i s'ëmësë po e siλninë; këtë e vininë
përdita ndë derët të hieroresë që thuhej e-
Bukurë, që të lypëntë eleimosinë nga ata që
3 hyninë ndë hieroret. Ky, kur pa Pjetrin' edhe
Joaninë se dotë hyninë ndë hieroret, lypte
4 të marrë eleimesinë *nga ata*. Po Pjetri ba-
shkë me Joaninë shtyri sytë mb' atë e tha,
5 Shiko mbë ne. Edhe ay i shikonte ata me
kujdes, dyke shpëryerë të marrë gjësendi
6 nga ata. Atëhere Pjetri tha, Ergjënt edhe ar
nukë kam; po atë që kam, këtë t'a ap; Mb'
emërit të Jisu Krisht Nazoreasit, ngreu edhe

BKSH

7 ecë. Edhe si e kapi atë prej dorës' së-djathtë
e ngriti; edhe për-një-here i uforcuanë gjur-
8 mët' e koçkorët' *e këmbëvet;* Edhe dyke këcy-
erë përpjetë qëndroj *mbë këmbë* edhe ecënte;
edhe hyri bashkë me ata ndë hieroret, dyke
ecur' e dyke këcyer' e dyke lavduruarë Pe-
9 rëndinë. Edhe gjithë llauzi e pa atë dyke
10 ecur' e dyke lavduruarë Perëndinë. Edhe e
njihnin' atë, se ky ishte ay që rrinte mbë de-
rët të-Bukurë të hieroresë për eleimosinë;
edhe umbushnë me të-çuditur' e me të-habi-
turë për këtë *punë* që i gjau ati.
11 Edhe tek mbante i-çali që ushërua Pje-
trin' edhe Joaninë, gjithë llauzi rrudhi pas a-
tyreve ndë kamaret që quhet' e Sollomonit,
dyke habiturë.
12 Edhe Pjetri kur pa, i upërgjeq llauzit,
O burra Israilitë, përse çuditeni për këtë
punë? apo përse shtini sytë mbë ne, sikurse
ne me fuqinë t'ënë a me besënë *t' ënë* e kemi
13 bërë këtë *njeri* të ecënjë? Perëndia i Avra-
mit edhe i Jakovit, Perëndia i atërvet t' anë,
lavduroj Birin' e ti Jisu, të-cilinë ju e dhatë
ndër duar, edhe e mohuatë përpara Pillatit,
14 ndonëse ay e pa të udhësë t'a lëshonte. Po
ju mohuatë Shënjtinë edhe të-Drejtinë, edhe
kërkuatë t' u epetë juve një burrë vrasës;
15 Edhe *kështu* vratë Kryen' e jetësë, *po* të-ci-
linë Perëndia e ngjalli prej së-vdekurish, të-
16 cilit ne jemi dëshmimtarë. Edhe me anë të

BKSH

besësë mb' emërit' t' ati, këtë që shihni edhe
e njihni, emër' i ati e forcoj; edhe besa që
është me anë t' ati i dha këti shëndet të-
plottë përpara gjithë jush.
17 Edhe ndashti, o vëllezër, e di se e pu-
nuatë nga paditja, sikundrë edhe të-parëtë
18 t' uaj. Po Perëndia sa tha që përpara me anë
të gojës' së gjithë profitërvet të ti, se Krishti
kishte për të pësuarë, i mbushi kështu.
19 Pendohi pra edhe kthehi, që të shuhenë
fajetë t' uaj, që të vinjënë kohëra të-
20 prëjturi prej faqes' së Zotit, Edhe të dër-
gonjë Jisu Kristinë, qëështë lëçiturë që për-
21 para mbë juve; Të-cilinë duhetë t'a mbanjë
qielli gjer mb' ato kohëra që dotë vinjënë
mbë vënt gjith' ato që foli Perëndia që ndë
kryet të jetësë me anë të gojës' së gjithë
shënjtorëvet të ti profitër.
22 Sepse Moisiu u tha atërvet, „Se Zoti Pe-
rëndia dotë ngrerë ndër ju nga vëllezëritë
t' uaj një profit posi mua; ati t'i dëgjoni mbë
23 të-gjitha sa që t' u flasë juve; Edhe çdo spirt
që të mos i dëgjonjë ati profiti, dotë shu-
24 hetë nga llauzi." — Edhe gjithë profitëritë sa
folnë që nga Samuili e paskëtaj dhanë zë
25 (që përpara) edhe për këto dit. Ju jeni bijt'
e profitërvet, edhe të dhjatësë që bëri Perën-
dia me atëritë t' anë, dyke thënë Avramit,
„Edhe ndë farët t'ënde dotë bekonenë gjithë
26 kombet' e dheut." Të ju më parë Perëndia,

passi ngjalli Birin' e ti Jisu, e dërgoj që t' u
bekojë juve, dyke kthyerë gjithë-sicilinë *prej
jush* nga ligësitë t' uaj.

Krye 4.

1 Edhe tek po ishinë ata dyke folurë llauzit,
erthnë mbi ata priftërit' edhe i-par' i hiero-
2 resë edhe Sadduqenjtë, Dyke uzëmëruarë, se-
pse mësoninë llauzinë, edhe lëçitninë të-ngja-
lluritë prej së-vdekurish me anë të Jisujt;
3 Edhe vunë duartë mbi ata, edhe i vunë ndënë
ruajtje gjer mbë të-nesërmet; sepse më ishte
4 ndaj të-ngrysurë. Edhe shumë *veta* nga ata
që dëgjuanë fjalënë besuanë: edhe ubë nu-
muri i njerëzet sindonja pesë mijë.
5 Edhe mbë të-nesërmet umblothnë ndë Je-
rusalim të-parët' e atyreve edhe pleqt' edhe
6 shkronjësitë, Edhe Anna kryeprifti e Kaiafa
e Joani e Aleksandri, edhe gjithë sa ishinë
7 prej fare kryepiftërie. Edhe si i vunë ata ndë
mest, i pyesninë, Me ç' farë fuqie, a me ç'farë
8 emëri e bëtë këtë ju? Atëhere Pjetri umbush
me Frymë të-Shënjtëruarë, e u tha atyre, O
9 të-parët' e llauzit, edhe *ju* pleqt' e Israilit, Ndë
qoftë se neve pyetemi sot për një të-mirë
që ubë mbë një njeri të-sëmurë, me ç' farë
10 *fuqie* ugërua ky, Letë jetë e-diturë mbë gjithë
ju edhe mbë gjithë llauzin' e Israilit, se mb'
emërit të Jisu Krisht Nazoreasit, të-cilinë ju
e kryqëzuatë, *po* të-cilinë Perëndia e ngjalli

prej së-vdekurish, me anë të këti qëndron
11 ky *ndasti* përpara jush i-shëndoshë. Ky është
guri që s'uzu për gjë prej jush që ndërtoni,
12 i-cili ubë krye çipi. Edhe nukë ka shpëtim
me anë të asndonjë tjetëri; sepse as tjetërë
emërë ndënë qiellt s' është dhënë ndër mest
të njerëzet, me anë të të-cilit duhetë të-shpë-
tojmë.
13 Edhe dyke vështruarë kuximn' e Pjetrit
edhe të Joanit, edhe dyke kupëtuarë, se ishi-
në njerës të-padituré edhe prej dorës' së-
poshtërë, çuditeshinë, po i njihninë se ki-
14 shinë qënë bashkë me Jisunë. Edhe si shih-
ninë të-shëruarinë njeri dyke ndënjurë ba-
shkë me ata, s' kishinë seç të thoshinë kun-
15 drë. Atëhere urdhëruan' ata të dalënë jashtë
bashkë-ndënjesë, edhe dhan' e muarrë ndër
16 mest të tyre, Dyke thënë, Ç' t' u bëjmë kë-
tyre njerësve? sepse se ubë një e-shënuarë
çudi me anë t' atyreve, *kjo* ësht' e-çfaqurë
mbë gjith' ata që rrinë ndë Jerusalim, edhe
17 nukë munt t' a mohojmë; Po që të mos për-
hapetë me tepërë ndë mest të llauzit, let' i
frikësojmë ashpërë, që të mos i flasënë më
18 mbë këtë emërë asndonjë njeriu. Edhe i thë-
rritn' e i porositnë të mos flasënë asfare,
as të mos mësonjënë mb' emërit të Jisujt.
19 Po Pjetri e Joani u upërgjeqnë atyreve, e u
thanë, Ndë ësht' e udhësë përpara Perëndisë
t' u dëgjomë juve me tepërë se Perëndisë,

20 gjykoni. Sepse ne nukë muntmë të mos fla-
21 sëmë për sa pam' e dëgjuamë. Edhe ata, si
i frikësuanë përsëri, i lëshuanë, sepse nukë
gjeninë, se qysh t' i mundonin' ata, për llau-
zinë; sepse të-gjithë lavduroninë Perëndinë
22 për atë që ubë. Sepse njeriu, mbë të-cilinë
ubë këjo çudi e shërimit, ishte më tepërë se
dyzet vjeç.
23 Edhe si ulëshuanë, erthnë te të-tyretë,
edhe dhanë zë për gjithë sa u than' atyreve
24 kryepriftërit' edhe pleqtë. Edhe ata kur dëgju-
anë, me një zëmërë ngritnë zënë mbë Perën-
dinë, edhe thanë, O zotëri, ti *je* Perëndia, që
bëre qiellin' edhe dhenë edhe detinë, edhe
25 gjithë sa janë nd' ata; *Ti* që ke thënë me
anë të gojës' së shërbëtorit t' ënt Dhavidh,
„Përse çfrytnë kombetë edhe shkuanë ndër
26 mëntt *punëra* të-kota? Mbretërit' e dheut
ndënjnë përpara, edhe të-parët' umblothnë
bashkë kundrë Zotit, edhe kundrë të-Lyerit
27 t' ati. „Sepse me të-vërtetë umblothnë kun-
drë shënjtit djalit t' ënt Jisu, të-cilinë e leve
me vaj, edhe Irodhi edhe Pondiu Pilat bash-
28 kë me kombet' e me llauzet' e Israilit, Që të
bënjënë gjithë sa urdhëroj që përpara dora
29 jote edhe këshilla jote të bënenë. Edhe tashi, o
Zot, vështro ndë të-frikësuarat t' atyre, edhe
ep-u shërbëtorevet të tu të flasënë fjalënë
30 t' ënde me çdo kuxim, Dyke sgjaturë dorë-
në t' ënde të bënenë shërime e shënja e çu-

dira mb' emërit të shënjtit djalit t' ënt Jisu.
31 Edhe si ulutnë ata, utunt vëndi ku ishinë
mbledhurë, edhe umbushnë që të-gjithë me
Frymë të-Shënjtëruarë, edhe flisninë fjalën' e
Perëndisë me kuxim.
32 Edhe zëmëra e shpirti i shumicës' s' aty-
reve që kishinë besuarë ishte një; edhe as-
ndonjë nukë thoshte për ndonjë gjë nga pa-
sjet' e tia se ësht' e tia, po të-gjitha i kishinë
33 të-bashkëta. Edhe me fuqi të-madhe epnin'
apostojtë dëshmimin' e të-ngjallurit të Zotit
Jisu; edhe hir i-math ishte mbë gjith' ata.
34 Sepse asndonjë ndër mest t' atyre ishte ndë
nevojë; sepse gjithë sa kishinë ara a shtë-
pira, i shisin' edhe bininë të-çëmuarat' e a-
35 tyre që shisinë, Edhe i vininë ndër këmbët
t' apostojvet; edhe i epninë gjithë-sicilit si
pas nevojësë që të kishte.
36 Edhe Josiu, i-cili prej apostojvet upër-
mbiquajt Varnavë (që këjo e-kthyerë do me
thënë, Bir ngushëllimi), *i-cili ishte* Levit
37 Qyprian nga kombi, Shiti *një* arë që kish-
te, edhe pruri aspratë e i vuri ndër këmbët
t' apostojvet.

Krye 5.

1 Po një burrë që e kishte emërinë Anani,
bashkë me gruan' e ti Sapfirë, shiti një gjë;
2 Edhe fshehu nga të-çëmuarëtë, dyke ditur'
edhe gruaja e ti; edhe pruri një pjesë *nga as-*

BKSH

3 *pratë*, edhe e vuri ndër këmbët t' apostojvet. Po
Pjetri tha, Anani, përse mbushi Satanaj zëmë-
rënë t' ënde që të gënjenjç ti Frymën' e-Shenj-
tëruarë, edhe të fshehç nga të-çëmuarët' e
4 arësë? Gjersa mbeteshe *e-pashiturë*, a nuk'
ishte jotja? edhe si ushit, a nuk' ishte ndë
pushtett t' ënt? ç' pate që vure ndë zëmërët
këtë punë? nukë gënjeve njerës, po Perën-
5 dinë. Edhe Anania, dyke dëgjuarë këto fjalë,
ra *përdhe* edhe dha shpirtinë; edhe u hyri frik'
e-madhe gjith' atyreve që dëgjuanë këto. Edhe
6 më të-rinjtë ungritnë, edhe e mbështuallnë,
edh' e nxuarnë jashtë edhe e kallnë ndë dhet.
7 Edhe si shkuanë sindonja tri orë, hyri
edhe gruaja e ati pa diturë seç ishte bërë.
8 Edhe Pjetri i upërgjeq asaj, Thuaj-më, ndë
për kaqë e shittë arënë? Edhe ajo tha, Po,
9 për kaqë. Atëherë Pjetri i tha asaj, Përse
lithtë fjalë të ngisni Frymën' e Zotit? ja ndë
derët *janë* këmbët' e atyreve që kallnë ndë
dhet burrinë t' ënt, edhe dotë nzjerrënë ja-
10 shtë *edhe* ty. Edhe për-një-here *ajo* ra për-
anë këmbëvet t' ati, edhe dha shpirtinë; edhe
djaloshëtë, kur hynë, e gjetnë të-vdekurë,
edhe si e nxuarnë jashtë, e kallnë ndë dhet
11 peranë burrit të saj. Edhe i hyri frik' e-ma-
dhe gjithë kishësë, edhe gjith' atyreve që
dëgjoninë këto.
12 Edhe me anë të duarvet t' apostojvet
bëneshinë shumë shënja e çudira ndë mest

BKSH

të llauzit; (edhe ishinë me një zëmërë të-
13 gjithë ndë kamaret të Sollomonit. Edhe nga
të-tjerëtë asndonjë s' kuxonte të bashkonej
14 me ata; po llauzi i madhëronte ata. Edhe
shtoneshinë më shumë dyke besuarë mbë
15 Zotinë, shumica burrash e grash;) Kaqë sa
nxirninë jashtë ndëpër rrugat të-sëmurëtë,
edhe i vininë mbi shtresa e mbi shtrate, që
kur të shkonte Pjetri pak së-paku hieja e
16 ati të zinte ndonjë nga ata. Edhe mblidhej
ndë Jerusalim edhe shumica e qytetevet rro-
tullë, edhe bininë të-sëmurët' edhe ata që
ngiteshinë prej frymërash të-pëgëra, të-cilëtë
shëroneshinë që të-gjithë.
17 Atëhere ungrit kryeprifti edhe gjith' ata
që ishinë bashkë me atë, të-cilët' ishinë prej
sektës' së Sadduqenjet, edhe umbushnë me
18 smir; Edhe vunë duart' e tyre mbi apostojtë,
19 edhe i vunë ndë burkt të gjindjesë. Po një
ëngjell i Zotit natënë hapi dyert' e burgut,
20 edhe si i nxori jashtë, u tha Shkoni, edhe
rrini e flisni-i ndë hieroret llauzit gjithë fja-
21 lët' e kësaj jete. Edhe si dëgjuanë, hynë ndë
hieroret mbë të-sbardhëlluerët, edhe mëso-
ninë. Po kur erdhi kryeprifti edhe ata që i-
shinë bashkë me atë, thërritnë bashkë-ndë-
njen' edhe gjithë pleqësin' e të bijvet të Is-
railit, edhe dërguanë ndë burkt, që t'i binin
22 ata. Po shërbëtorëtë, kur vanë, nuk' i gjetnë
ata ndë burkt; edhe ukthyen' e u dhanë zë

BKSH

23 atyre, Dyke thënë, Se burgun' e gjetmë të-
mbyllurë me çdo siguri, edhe ruajtësitë dyke
ndënjurë jashtë përpara dyervet; po kur hap-
më, brënda nukë gjetmë asnjeri.
24 Edhe kur dëgjuanë këto fjalë prifti edhe
i-par' i hieroresë edhe kryepriftëritë, vrisninë
mëndjenë për ata, se si dotë bënetë këjo
25 *punë.* Atëhere erdhi një njeri e u dha zë aty-
reve, dyke thënë, Se ata burra që vutë ndë
burkt ja tek janë dyke ndënjurë ndë hiero-
ret, e po mësonjënë llauzinë.
26 Atëhere vate i-par' *i hieroresë* bashkë me
shërbëtorëtë, e i prunë, *po* jo me shtrëngatë,
sepse kishinë frikë nga llauzi semos i vris-
27 ninë me gurë. Edhe si i prunë, i nxuarnë
përpara bashkë-ndënjesë; edhe kryeprifti i
28 pyeti ata, Dyke thënë, Nuk' u porositmë juve
shtrënguarë të mos mësoni mbë këtë emërë?
edhe *ju* ja tek mbushtë Jerusalimnë me më-
simnë t' uaj, edhe doni të bini mbi ne gja-
kun' e këti njeriu.
29 Atëhere Pjetri edhe apostojt' *e-tjerë* upër-
gjeqn' e thanë, Duhetë t' i bindemi Perëndisë
30 më tepërë se njerëzet. Perëndia i atërvet t'anë
ngjalli Jisunë, të-cilinë ju e vratë edhe e
31 vartë mbi dru. Këtë Perëndia e lartësoj me
anë të së-djathtës' së ti, *edhe e bëri* të-parë
edhe shpëtimtar, që t' i apë pendim Israilit,
32 edhe ndjesë fajesh. Edhe ne jemi dëshmim-
tarët' e ati për këto fjalë, edhe Frym' e-Sënj-

tëruarë, të-cilënë Perëndia u'a dha atyreve
që i binden' ati.
33 Edhe ata kur dëgjuanë, kërcëllininë dhëm-
34 bëtë, edhe bëninë këshillë t' i vrasënë. Atëhere
ungrit ndë bashkë-ndënjet një Farise, që qu-
hej Gamaliil, mësonjës i nomit, edhe i-nder-
çim mbë gjithë llauzinë, edhe urdhëroj t' i
nxjerrënë jashtë apostojtë për një çopë herë,
35 Edhe u tha atyre, O burra Israilitë, Vësh-
troni mirë ç' u kini për të bërë këtyre nje-
36 rësve. Sepse përpara këtyre ditve ungrit
Thevdhau, dyke thënë për vetëhen' e ti se
diç është, edhe i ungjitnë prapa sindonja
katrë qint burra; ay uvra edhe gjithë sa i
bindeshin' ati upërndanë, edhe ubënë për as-
37 gjë. Pas këti ungrit Judhë Galileasi, ndë ditt
të të-shkruarit *të njerësvet,* edhe hoqi pas
vetiu mjaft llaus; edhe ay humbi, edhe gjithë
38 sa i ubintnë ati upërndanë. Edhe tashi po u
them juve, Largohi nga këta njerës, edhe lir-
i-ni; sepse ndë është kjo këshillë a këjo punë
39 prej njerëzish, dotë prishetë; Po ndë është
nga Perëndia, nukë muntni t'a prishni atë;
edhe vështroni semos gjëndeni ndë luftë edhe
me Perëndinë.
40 Edhe ata i ubintn' ati: edhe si thërritnë
apostojtë, i rrahnë e i porositnë të mos fla-
sënë mb' emërit të Jisujt, edhe i lëshuanë.
41 Ata pra iknë dyke ugëzuarë nga faqeja e
bashkë-ndënjesë, se ubënë të-vëjejturë të

BKSH

42 çpërnderonenë për emërin' e ati. Edhe përdita
ndë hieroret e ndëpër shtëpit nukë pusho-
ninë dyke mësuarë e dyke dhënë zën' e-mirë
për Jisu Krishtinë.

Krye 6.

1 Edhe nd' ato dit kur po shumoneshinë
nxënësitë, ubë një murmuri prej Gërqish-
tarëvet kundrë Ebrenjet, se të-vat' e tyre nu-
kë shikoneshinë ndë shërbesët të-përditëshme
2 *të ushqimevet.* Atëhere të dy-mbë-dhjetëtë thë-
rritnë shumicën' e nxënëset, e thanë, Nuk'
ësht' e-pëlqyerë mbë ne të lëmë fjalën' e Pe-
3 rëndisë, e të shërbejmë ndëpër truvezat. Men-
dohi pra, o vëllezër, e sgjithni prej jush shtatë
burra me dëshmim *të-mirë e* të-mbushurë me
Frymë të-Shënjtëruarë e me urtësi, të-cilëtë t'i
4 vëmë mbë këtë punë. Po neve dotë qëndroj-
më mbë të-falurit e mbë shërbesët të fjalësë.
5 Edhe *këjo* fjalë upëlqye përpara gjithë
shumicësë; edhe sgjothnë Stefaninë, *që ishte*
një burrë plot me besë e me Frymë të-Shënj-
tëruarë, edhe Filippin' e Prohorin' e Nikano-
rin' e Timonin' e Parmenanë, edhe Nikollënë
6 që ishte i-kthyerë Antioheas; të-cilët' i qën-
druanë përpara apostojvet; edhe passi ufalnë,
7 vunë duartë mbi ata. Edhe fjal' e Perëndisë
shtonej, edhe numuri i nxënëset shumonej
fort ndë Jerusalim; edhe shumic' e-maðe nga
priftëritë i dëgjoninë besësë.

BKSh

8 Edhe Stefani, plot me besë e me fuqi,
bënte çudira e shënja të-mëdha ndë llaust.
9 Po ungritnë ca nga sinagogjia që thuhet' e
Libertinëvet, edhe e Qyrineaset, edhe e Alek-
sandreaset, edhe nga ata *që ishinë* nga Qiliqia
e nga Asia, e haheshinë me fjalë me Stefa-
10 ninë; Edhe s' muntninë të dilninë kundrë ur-
11 tësisë edhe Frymësë, me të-cilënë fliste. Atë-
here vunë e gënjyenë *ca* njerës të thonë, Se
e dëgjuam' atë dyke folurë fjalë sharjeje kun-
12 drë Moisiut edhe Perëndisë. Edhe ngritnë mbë
këmbë llauzin' e pleqt' e shkronjësitë, edhe
dyke uhedhurë mbi atë e rrëmbyenë, edhe e
13 prunë ndë bashkë-ndënjet. Edhe nxuarnë
përpara dëshmimtarë gënjeshtarë, që thoshinë,
Ky njeri nukë pushon së foluri fjalë sharjeje
kundrë këti vëndi të-shënjtëruarë, edhe kun-
14 drë nomit. Sepse e dëgjuam' atë dyke thënë,
se Jisu Nazoreasi dotë prishnjë këtë vënt,
edhe dotë ndërronjë zakonetë që na ka lënë
15 Moisiu. Edhe gjith' ata që rrininë ndë ba-
shkë-ndënjet, kur shtynë sytë mb' atë, panë
faqen' e ati posi faqe ëngjëlli.

Krye 7.

1 Atëhere kryeprifti tha, Vallë me të-vër-
tetë janë këto kështu?
2 Edhe ay tha, O burra vëllezër edhe atër,
pa dëgjoni; Perëndia i lavdisë i uduk atit t'ënë
Avraamit, kur ishte ndë Mesopotami, para se

BKSH

3 të vinj' e të rrijë ndë Harran, Edhe i tha, „Dil
prej dheut t' ënt, edhe prej far' e fisit t' ënt,
edhe eja ndë atë dhe që dotë të dëftenj ty."
4 Atëhere *ay* dolli nga dheu i Halldhenjvet, e
vate e ndënji ndë Harran. Edhe që andej, pas
vdekjes' së t' et, e pruri të rrijë ndë këtë dhe,
5 ndë të-cilët rrini ju tashi. Edhe nuk' i dha
ati trashëgim nd' âtë *dhe* as një çap këmbe;
po i uzotua se dot' j'a apë për kamje ati,
edhe farës' s' ati pas ati, ndonëse s' kishte
6 *edhe* fëmijë. Edhe Perëndia foli kështu, „Se
far' e ati dotë vejë e të rrijë për një kohë ndë
dhe të-huaj, edhe dot'a bënjënë rop edhe
7 dot'a mundonjënë katrë qint vjet. Edhe kom-
binë, tek i-cili dotë jenë robër dot'a gjy-
konj unë, tha Perëndia; edhe pastaj dotë
dalënë edhe dotë më adhuronjënë ndë këtë
8 vënt." Edhe i dha ati dhjatën' e rrethpresjesë;
edhe kështu i lindi Isaaku, edhe e rrethpreu
mbë të-tettënë ditë; edhe Isaakut *i lindi* Ja-
kovi, edhe Jakovit të dy-mbë-dhjetë krye-
atëritë.
9 Edhe krye-atëritë, passi e kishinë cmir
Josifnë, e shitnë nd' Egjyptë; po Perëndia ishte
10 bashkë me atë, Edhe e shpëtoj nga gjithë
shtrëngimet' e ati, edhe i dha hir e dituri
përpara Faraonit, mbretit t' Egjyptësë, i-cili e
vu atë të-parë përmbi Egjyptënë edhe përmbi
gjithë shtëpin' e ti.
11 Edhe ubë një zi mbë gjithë dhen' e Egjy-

ptësë edhe të Hanaanit, edhe një shtrëngim i-
math; edhe atëritë t'anë nukë gjeninë ç' të
12 haninë. Po Jakovi kur dëgjoj se kishtë grurë
nd' Egjyptë, dërgoj të-parënë herë atëritë t'
13 anë. Edhe të-dytënë herë Josifi unjoh te të
vëllezërit' e ti, edhe ubë e-çfaqurë te Faraoni
14 far' e Josifit. Edhe Josifi dërgoj e thërriti t' an'
e ti Jakovinë, edhe gjithë njerëzin' e ti, shtatë-
15 dhjet' e pesë shpirt. Edhe sbriti Jakovi nd' E-
gjyptë, edhe vdiq *atje* ay edhe atëritë t'anë.
16 Edhe uprunë ndë Shihem edhe uvunë nd' atë
varr që pat blerë Avraami me çëmim ergjëndi
prej të bijvet t'Emmorit t' et të Shihemit.
17 Po kur uafërua koha e të-zotuarit që i pat
bërë be Perëndia Avraamit, ushtua llauzi edhe
18 ushumua nd' Egjyptë; Gjersa ungrit një tje-
19 tërë mbret, i-cili nuk'e njihte Josifnë. Ky, dyke
përdorurë dinakërira kundrë kombit t' ënë, i
mundoj atëritë t' anë, kaqë sa të hethnjënë
foshnjat' e tyre, që të mos mbetenë të-gjallë.
20 Ndë këtë kohë lindi Moisiu edhe kishte
bukuri Perëndie; i-cili uushqye tre muaj ndë
21 shtëpit të t' et. Edhe kur uhoth, e mori atë
e bija e Faraonit, edhe e rriti për bir të saj.
22 Edhe Moisiu umësua ndë gjithë diturit të
Egjyptianëvet, edhe ishte i-fortë ndë fjalë e
ndë punëra.
23 Edhe tek po ishte dyke mbushurë dyzet
vjet, i erdhi ndë zëmërët të vej' e të shohë
24 vëllezërit' e ti, të bijt' e Israilit. Edhe kur pa

një që po i bënej keq, i dolli për zot, edhe
mori çpagim për atë që mundonej, dyke vrarë
25 Egjyptianinë. Edne pandehte, se të vëllezërit'
e ti dotë kupëtoninë se Perëndia u ep atyre
shpëtim me anë të dorës' s' ati; po ata nukë
26 kupëtuanë. Edhe ditënë tjetërë uduk mb' ata
tek po ziheshinë, edhe i nguti ndë paqtim,
dyke thënë, O burra, ju jeni vëllezër; përse
27 i bëni keq njeri tjatërit? Po ay që i bënte
keq të-afërmit e shtyti, edhe tha, Cili të vuri
28 të-parë edhe gjykatës mbi ne? Mos do ti të më
vraç, sikundrë vrave dje *atë* Egjyptianinë?
29 Atëhere Moisiu iku për këtë fjalë, edhe ndënji
i-huaj ndë dhet Madhiam, ku i lintnë dy bij
30 Edhe passi umbushnë dyzet vjet, i uduk
ati ndë shkretëtirët të malit Sina një ënjgjëll
31 i Zotit ndë flakët të një zjarri ferre. Edhe
Moisiu kur pa, uçudit për *këtë* të-pamë; edhe
tek afëronej që të vështronjë, erdhi zë prej
32 Zotit tek ay, „Unë *jam* Perëndia i atërvet të
tu, Perëndia i Avraamit, edhe Perëndia i Isa-
akut, edhe Perëndia i Jakovit." Edhe Moisiu
33 utrëmp, e s' kuxonte të vështronjë. Atëhere
Zoti i tha, „Sgith sholëzën' e këmbëvet të
tua, sepse vëndi, përmbi të-cilinë ke ndënjurë,
34 është dhe i-shënjtëruarë." Pashë, pashë të-
hequritë keq të llauzit t'im nd'Egjyptë, edhe
dëgjova psherëtimën' e atyre, edhe sbrita që
t' i shpëtonj; edhe ndashti eja, dotë të dër-
gonj ty nd' Egjyptë."

35 Këtë Moisinë që e mohuanë, dyke thënë,
Cili të vuri të-parë edhe gjykatës? këtë Pe-
rëndia e dërgoj të-parë edhe shpërmblimtar
me anë të dorës' s' ëngjëllit që i uduk ati
36 ndë ferrët. Ky i nxori ata, passi bëri çudira
e shënja ndë dhet t' Egjyptësë, edhe ndë Dett
37 të-Kuq, edhe ndë shkretëtirët dyzet vjet. Ky
ësht' *ay* Moisiu që u tha të bijvet të Israilit,
se „Zoti Perëndia juaj dot' u ngrerë juve prej
vëllezërvet t' uaj *një* profit posi mua; ati t'i
38 dëgjoni." Ky ësht ay që qe ndë përmble-
dhjet ndë shkretëtirët bashkë me ëngjëllinë
që i fliste ati ndë malt Sina, edhe me atë-
ritë t'anë, i-cili priti fjalë të-gjalla, për të
39 dhënë neve. Atëritë t' anë nukë deshnë t'i dë-
gjonjënë, po e hothnë tej, edhe me zëmërat'
40 e tyre ukthyenë nd' Egjyptë, Dyke thënë Aa-
ronit, „Bë-na perëndira, të-cilëtë të ecënjënë
përpara nesh; sepse këti Moisiut, që na nxori
nga dheu i Egjyptësë, nukë dimë seç i gjau."
41 Edhe bënë një viç nd' ato dit, edhe i prunë
kurban idhullit, edhe gëzoneshinë mbë pu-
42 nërat të duarvet të tyre. Përandaj Perëndia
ukthye edhe i la t' adhuronjënë ushtërin' e
qiellit, sikundrë është shkruarë ndë vivlit të
profitërvet, „Mos më prutë mua të-therura
edhe kurbanë ndë shkretëtirët dyzet vjet, o
43 shëpi' e Israilit? Po ngrittë lart tendën' e Mo-
llohut, edhe yllin' e perëndisë s' uaj Remfan,
figuratë që bëtë që t' u faleni atyreve; përan-

BKSH

daj dot' u ngre e dot' u shpie më tej Vavi-
llonësë."
44 Tend' e dëshmimit ishte ndër atërit t'anë
ndë shkretëtirët, sikundrë porositi ay që i
fliste Moisiut t' a bënjë atë pas shëmbëlle-
45 sësë që kishte parë, Të-cilënë edhe e muarnë
atëritë t' anë me vetëhe, edhe bashkë me
Jisun' *e Naviut* e prunë ndë dhet të kombe-
vet, të-cilëtë Perëndia i përzuri prej faqes'
s' atërvet t' anë, gjer ndë ditt të Davidhit;
46 I-cili gjeti hir përpara Perëndisë, edhe kër-
koj të gjenjë të-ndënjurë për Perëndin' e
47 Jakovit. Edhe Sollomoni i ndërtoj ati shtëpi.
48 Po i-Larti nukë rri ndër tempuj që bënenë
49 me dorë, sikundrë thotë profiti, „Qielli është
froni im, edhe dheu ndënëkëmbje e këm-
bëvet të mia; ç' farë shtëpie dotë ndërtoni
për mua? thotë Zoti; a cili *është* vëndi i të-
50 prëjturit t' im? A nuk' i ka bërë dora ime
këto të-gjitha?„
51 O sverk-ashpërë edhe të-parrethprerë
ndë zëmërët e ndë veshët, ju gjithënjë i
rrini kundrë Frymës' së-Shënjtëruarë; sikun-
52 drë atëritë t' uaj, *kështu* edhe ju. Cilinë nga
profitëritë nukë ndoqnë atëritë t' uaj? po
edhe i vran' ata që dhanë zë që përpara
për të-ardhurit' e të-Drejtit, të-cilit ju nda-
53 shti ubëtë trathëtorë edhe vrasës; *Ju* që muar-
të nomnë prej porosirash ëngjëjve, edhe nuk'e
ruajttë.

BKSH

54 Edhe *ata* kur dëgjoninë këto, u priste
ndë zëmërat të tyre, edhe kërcëllininë dhëm-
55 bëtë kundrë ati. Po ay, që ishte plot me
Frymë të-Shënjtëruarë, shtyri sytë ndë qiellt,
e pa lavdin' e Perëndisë, edhe Jisunë dyke
56 ndënjurë prej së-djathtës' së Perëndisë, Edhe
tha, Ja tek po shoh qiejtë të-hapurë, edhe
të Birr' e njeriut dyke ndënjurë prej së-
57 djathtës' së Perëndisë. Atëhere *ata* bërtitnë
me zë të-math, e zunë veshët' e tyre, edhe
58 me një zëmërë udruthnë mbi atë; Edhe pas-
si e nxuarnë jashtë qytetit, i shtininë me
gurë. Edhe dëshmimtarëtë lanë rrobat' e tyre
përanë këmbëvet të një djaloshi që quhej
59 Savëll. Edhe i shtininë Stefanit me gure tek
lutej e thoshte, O Zoti Jisu, prit frymënë
60 t' ime. Edhe si uunj mbë gjunjë, thërriti
me zë të-math, O Zot, mos u' a zërë atyre
këtë faj; edhe dyke thënë këtë flejti.

Krye 8.

1 Edhe Savlli e pëlqente vrasjen'e ati. Edhe
atë ditë ubë një ndjekje e-madhe kundrë
kishësë që ishte ndë Jerusalim; Edhe të-
gjithë upërndanë ndëpër vëndet të Judhesë
e të Samarisë, përveç apostojvet.
2 Edhe *ca* burra besëtarë e ngritnë Stefa-
ninë, edhe bënë vajë të-madhe mbi atë.
3 Edhe Savlli i bënte keq kishësë, dyke
hyrë ndëpër shtëpirat, e dyke hequrë svarë

4 burra e gra i hithte ndë burk. Ata pra që
upërndanë shkuanë vënt mbë vënt, dyke
ungjillëzuarë fjalënë.
5 Edhe Filippi sbriti ndë qytett të Sama-
6 risë, e u lëçiste atyre Krishtinë. Edhe gjin-
dja me një zëmërë u vininë veshnë atyre që
thoshte Filippi, sepse dëgjonin' e shihninë
7 çuditë qe bënte. Sepse prej shumë *vetash*
që kishinë frymë të-pëgëra dilninë *këto* dyke
thërriturë me zë të-math; edhe shumë ulogë
8 e të-çalë ushëruanë. Edhe ubë gëzim i-math
nd' atë qytet.
9 Edhe ishte që më përpara nd' atë qytet
një njeri që quhej Simon, i-cili bënte magji
edhe e nxirte mënç llauzin' e Samarisë,
dyke thënë për vetëhen' e ti se është një
10 *njeri* i-math; Të-cilit të-gjithë, i-math e i-
vogëlë, i vininë veshnë, e thoshinë, Ky është
11 fuqi'e-madhe e Perëndisë. Edhe i vininë vesh-
në, sepse mjaft kohë i kish nxjerrë mënç
12 me magjitë. Po kur i besuanë Filippit
që epte zën' e-mirë për punët' e mbretëris'se
Perëndisë, edhe për emërin' e Jisu Krishtit,
13 pagëzoneshinë burra e gra. Po edhe Simoni
vetë besoj, edhe si upagëzua, rrinte bashkë
me Filippinë, edhe dyke parë se bëneshinë
çudira të-medha manitej.
14 Edhe apostojtë që ishinë ndë Jerusalim,
kur dëgjuanë se Samaria e priti fjalën' e
Perëndisë, dërguanë tek ata Pjetrin'edhe Joa-

BKSH

15 ninë; Të-cilëtë sbritnë e ufalnë për ata, që
16 të marrënë Frymë të-Shënjtëruarë. (Sepse
edhe s'kishte sbriturë as mbë ndonjë nga ata,
po vetëm' ishinë pagëzuarë mb' emërit të
17 Zotit Jisu.) Atëhere vininë duartë mbi ata,
edhe merrninë Frymë të-Shënjtëruarë.
18 Edhe Simoni kur pa, se me të-vënët' e
duarvet t' apostojvet epetë Frym' e-Shënjtë-
19 ruarë, u pruri atyre aspra, Dyke thënë, Ep-
më-ni edhe mua këtë pushtet, që mbi cilinë-
do që të vë duartë, të marrë Frymë të-Shënj-
20 tëruarë. Po Pjetri i tha ati, Ergjëndi yt hump-
të bashkë me ty, sepse pandehve, se dhurë-
21 tia e Perëndisë fitonetë me aspra. Ti s' ke
pjesë as shortë ndë këtë fjalë; sepse zëmë-
ra jote s' ësht' e-drejtë përpara Perëndisë.
22 Pendohu pra nga këjo e-liga jote, edhe lut-
i-u Perëndisë, mbase të ndjenetë këjo çpi-
23 kje e zëmërësë s'ate; Sepse po të shoh se je
ndë vërer hidhërie edhe ndë lidhje paudhë-
24 rie. Atëhere Simoni upërgjeq e tha, Lutuni
ju Zotit për mua, që të mos vinjë mbi mua
asndonjë nga ato që thatë.
25 Ata pra, passi dhanë dëshmim edhe fol-
në fjalën' e Zotit, ukthyenë ndë Jerusalim,
edhe dhanë zën' e-mirë ndëpër shumë ka-
tunde të Samaritëvet.
26 Edhe një ëngjëll i Zotit i foli Filippit
dyke thënë, Ngreu e shko nga an' e mes-
ditësë, mb' udhët që sbret prej Jerusalimit

27 ndë Gazë; (këjo është shkretëtirë). Edhe ay
ungrit e vate.
Edhe ja një njeri Ethiop, i-dredhurë, i-
fortë zotëni i Kandhakësë, mbretëreshës' s'
Ethiopëvet, i-cili ishte mbi gjithë thesarët
t' asaj; ky kishte ardhurë që të faletë ndë
28 Jerusalim. Edhe mbë të-kthyerë, dyke ndë-
njurë mbë qeret të ti, po këndonte profi-
29 tin' Isai. Edhe Fryma i tha Filippit, Afërohu
30 e i ungjit kësaj qereje. Edhe Filippi vate
me vrap afërë, e dëgjoj atë dyke kënduarë
profitin' Isai, edhe tha, A kupëton vallë ato
31 që këndon? Edhe ay tha, E qysh munt *të
kupëtonj*, ndë mos më dëfteftë njeri? Edhe i
ulut Filippit të hipënjë e të rrijë bashkë me
32 atë. Edhe vëndi i shkronjësë që po këndonte
ishte ky, "Upru posi berr për të therurë,
edhe posi qënq pa zë përpara ati që e qeth.
33 kështu nukë hap gojën' e ti. Ndë të-unjurit
t' ati ungrit gjyqi i ati; edhe brezin' e ati
kush dot' a dëftenjë? sepse ngrihetë prej
34 dheut jeta e ati. „Edhe i-dredhuri upërgjeq
e i tha Filippit, Të lutem, për cilinë profiti
thotë këtë? për vetëhen' e ti, apo për ndonjë
35 tjatërë? Atëhere Filippi hapi gojën' e ti, edhe
dyke zënë nga këjo shkronjë i dha ati zën' e-
mirë për Jisunë.
36 Edhe tek po bëninë udhë, erthnë mbë
një ujë; edhe i-dredhuri thotë, Ja ujë; ç'farë
gjëje më ndalon të pagëzonem? (Edhe Fi-

lippi tha, Ndë beson me gjithë zëmërë, munt
37 *të pagëzonesh*. Edhe *ay* upërgjeq e tha, Be-
sonj se Jisu Krishti ësht' i Bir' i Perëndisë).
38 Edhe urdhëroj të qëndronjë qereja; edhe
sbritnë të dy ndë ujët, Filippi edhe i-dre-
38 dhuri; edhe e pagëzoj. Edhe kur duallnë nga
ujëtë, Frym' e Zotit rrëmbeu Filippinë, edhe
i-dredhuri s'e pa më, po shkonte udhës' së
39 ti dyke ugëzuarë. Edhe Filippi ugjënt nd' Azotë,
edhe mbë të-shkuarë epte zën' e-mirë ndëpër
gjithë qytetet, gjersa erdhi ndë Qesari.

Krye 9.

1 Edhe Savlli, edhe po dyke çfryturë të-fri-
kësuarë e vrasje kundrë nxënëset të Zotit, er-
2 dhi te kryeprifti, Edhe lypi prej ati kartëra
për sinagogjitë ndë Dhamaskë, që ndë gjettë
ca prej *kësaj* udhe, burra e gra, t' i bjerë liaurë
3 ndë Jerusalim. Edhe dyke vaturë tek afëro-
nej ndë Dhamaskë, papandehuraj vetëtiti rreth
4 ati një dritë prej qiellit; Edhe *ay* si ra për-
dhe dëgoj një zë dyke thën' ati, Saull, Saull,
5 përse më ndjek? Edhe *ay* tha, Cili je *ti*, o Zot?
Edhe Zoti tha, Unë jam Jisuj qe ndjek ti;
keq *ëshë* për ty t' u bjesh me shkelme gëm-
6 bavet. Edhe ay dyke udridhur' e dyke uhabi-
turë tha, Zot, ç' do *ti* të bënj unë? Edhe Zoti
i *tha*, Ngreu e hyrë ndë qytett, edhe dotë të
7 flitetë ç' duhetë të bënjç. Edhe burratë qe bë-
ninë udhë bashkë me atë rrininë të-habiturë,

BKSH

sepse zën' e dëgjoninë, po asndonjë nukë
8 shihninë. Edhe Savlli ungrit nga dheu, edhe
ndonëse kishte sytë të-hapurë, nukë shihte
asndonjë; edhe dyke hequrë atë prej dore,
9 e prunë ndë Damaskë. Edhe tri dit nukë
shihte; edhe as hëngri, as piu.
10 Edhe ishte një nxënës ndë Dhamaskë që
quhej Anani, edhe Zoti i tha nd' ëndërrë, Anani.
11 Edhe ay tha, Ja unë *këtu jam*, o Zot. Edhe
Zoti i tha, Ngreu e shko nd' *atë* udhët që
quhetë e-Drejtë, edhe kërko ndë shtëpit të
Judhësë një Tarsiot që quhetë Savell; sepse
12 ja tek po faletë; Edhe ka parë nd' ëndërrë
një njeri që quhet' Anani, se hyri edhe vuri
dorënë mbi atë, që t'i vinjënë sytë për-
13 sëri. Atëhere Anania upërgjeq, Kam dëgjuarë
prej shumë *vetash* për këtë njeri, sa të-këqia
14 u bëri shënjtorëvet t'ënt ndë Jerusalim ; Edhe
këtu ka pushtet nga kryepriftëritë të lithnjë
gjith' ata që thërresënë mb' emërinë t'ënt.
15 Po Zoti i tha, Ecë, se ky më ësthë një enë
e-sgjedhurë për të mbajturë emërinë t'im për-
para kombevet, e mbretërvet, edhe të bijvet
16 të Israilit. Sepse unë dot' i dëftenj ati sa
duhetë të pësonjë për emërinë t'im.
17 Edhe Anania vate e hyri ndë shtëpit;
edhe si vuri duartë mbi atë, tha, Saull vëlla,
Zoti më ka dërguarë, *ay* Jisuj që t'uduk u-
dhësë, kur ishnje dyke ardhurë, që të të hapenë
sytë përsëri, edhe të mbushesh me Frymë

18 të-Shënjtëruarë. Edhe për-një-here ranë nga
syt' e ati posi folla *peshku*, edhe i erdhë sytë
19 për-një-here; edhe ungrit e upagëzua. Edhe
si hëngri, mori fuqi.
Edhe (Savlli) ndënji ca dit bashkë me
20 nxënësitë që ishinë ndë Dhamaskë. Edhe për-
një-here lëçiste Krishtinë ndëpër sinagogjit,
21 se ky ësht' i Bir' i Perëndisë. Edhe gjith' ata
që dëgjoninë maniteshin' e thoshninë, Nuk'
është ky ay që prishi ndë Jerusalim ata që
thërrisninë mbë këtë emërë, edhe këtu për
këtë *qëllim* kishte ardhurë, që t'i shpjerë ata li-
22 dhurë te kryepriftëritë? Po Savlli më tepërë
forconej, edhe i trumbullonte Judhenjtë që
rrininë ndë Dhamaskë, dyke dëftyerë, se ky
është Krishti.
23 Edhe si shkuanë mjaft dit, Judhenjtë bënë
24 këshillë t'a vrasënë. Po kundrëkëshilla e aty-
reve i ra ndër veshë Savllit; edhe ruaninë dy-
25 ertë dit' e natë, që t'a vrisninë. Atëhere nxë-
nësit' e muarnë natënë, edhe e sbritnë nga
muri, dyke varurë atë ndë një çportë.
26 Edhe Savlli, si erdhi ndë Jerusalim, përpiqeshe
të bashkonetë me nxënësitë; po të-gjithë ki-
shinë frikë prej ati, sepse nukë besoninë se
27 është nxënës. Po Varnava e mori, edhe e
pruri tek apostojtë edhe u dëfteu atyre qysh
pa Zonë mb' udhët, edhe se i foli ati, edhe
qysh ndë Dhamaskë fliste me kuxim mb'
28 emërit të Jisujt. Edhe ishte dyke hyr' e dyke

BKSH

dalë bashkë me ata ndë Jerusalim, edhe dyke
folurë me kuxim mb'emërit të Zotit Jisu.
29 Edhe fliste e hahej me Greqishtarëtë; po ata
30 kërkoninë t'a vrisninë. Edhe vëllezëritë kur
e muarnë vesh, e sbritnë ndë Qesari, edhe e
dërguanë ndë Tarsë.
31 Kishëtë pra ndëpër gjithë Judhënë e Ga-
lilenë e Samarinë kishinë paqtim, edhe ishinë
dyke undërtuar' e dyke eçurë ndë frikët të
Perëndisë, edhe me anë të ngushëllimit të
Frymës' së-Shënjtëruarë shumoneshinë.
32 Edhe Pjetri, dyke shkuarë ndëpër gjithë
ata vënde, sbriti edhe te shënjtorëtë që
33 ishinë ndë Lydhë. Edhe atje gjeti një njeri
që e quaninë Ene, i-cili ishte ulok që der-
34 gej tetë vjet ndë shtratt. Edhe Pjetri i tha,
Ene, Jisu Krishti të shëron; ngreu edhe shtro
shtratinë t' ënt. Edhe *ay* për-një-here ungrit.
35 Edhe e pan' atë gjith' ata që rrininë ndë
Lydhë e ndë Saron, edhe ukthyenë mbë
Zotinë.
36 Edhe ndë Joppë ishte një nxënëse që
quhej Tavitha, që e-kthyerë do me thënë.
Zarkadhe; ajo ishte plot me punëra të-mira
37 e me eleimosina që bënte. Edhe nd' ato dit
goditi të sëmuretë, edhe të vdesë; edhe si
e lanë e vunë ndë një dhomë të-sipërme.
38 Edhe Lydha passi ishte afërë Joppësë, nxë-
nësitë, kur dëgjuanë se Pjetri është nd' atë,
dërguanë dy burra tek ay, dyke lutur' ati

39 të mos përtonjë të vinjë gjer tek ata. Edhe
Pjetri ungrit e vate bashkë me ata; të-
cilinë posa erdhi e hipnë ndë dhomët të-
sipërme; edhe i duallnë përpara gjithë *grat'*
e-veja dyke qarë, e dyke dëftyerë këmi-
shë e rroba, të-cilatë i bënte Zarkadhja,
40 kur ishte bashkë me ato. Po Pjetri, passi i
nxori të-gjithë jashtë, uunj mbë gunjë edhe
ufal; edhe si ukthye nga trupi, tha, Tavitha,
ngreu. E ajo hapi syt' e saj, edhe kur pa
41 Pjetrinë, ungrit e ndënji. Edhe ay i dha do-
rënë, edhe e ngriti; edhe passi thërriti shënj-
torët' e të-vejatë, e nxori përpara të-gjallë.
42 Edhe *këjo* umuar vesh ndëpër gjithë Joppë-
në; edhe shumë *veta* besuanë mbë Zotinë.
43 Edhe *Pjetri* mbeti mjaft dit ndë Joppë, pë-
ranë një farë Simoni lëkurëregjës.

Krye. 10

1 Edhe ishte një njeri ndë Qesari që quhej
Kornil, krye-qindës prej tufës' *s' ushtëtorëvet* që
2 quhej Italiane; *Ky ishte* besëtar edhe kishte
frikë nga Perëndia bashkë me gjithë shtëpin' e
tij, edhe i bënte shumë eleimosina llauzit,
3 edhe i lutej Perëndisë gjithënjë. Ky sindonja
mbë të-nënttënë orë të ditësë pa ndë të-
faniturë kthjellëtë një ëngjëll të Perëndisë,
4 se hyri tek ay, e i tha, Kornil. Edhe ay kur
shtyri sytë mb' atë, e mori frika, edhe tha,
Ç' është, o Zot? Edhe ay i tha ati, Të-falu-

rat' e tua edhe eleimosinat' e tua hipnë për
5 kujtim përpara Perëndisë. Edhe ndashti dër-
go njerës ndë Joppë, edhe thirrë Simoninë
6 që përmbiemëronetë Pjetër; Ky ka rënë ndë
një farë Simoni lëkurëregjës, i-cili e ka
shtëpinë përanë detit; (ky dotë të flasë ç'
7 duhetë të bënjç.) Edhe si iku ëngjelli që
ishte dyke folurë (Kornilit), thërriti dy *veta*
nga shërbëtorët' e ti, edhe një ushtëtuar be-
sëtar nga ata që rrininë përherë përan' ati;
8 Edhe si u dëfteu atyre të-gjitha, i dërgoj
ndë Joppë.
9 Edhe mbë të-nesërmenë, tek ishinë ata
dyke bërë udhë e po afëroneshinë ndë qytett,
Pjetri hipi ndé dhomët të faletë, afëro mbë
10 të-gjashtëtën' orë. Edhe e mori uria, edhe
donte te hajë; po tek po bëninë gati, i erdhi
11 një të-habiturë; Edhe sheh qiellinë të-hapurë,
edhe një enë dyke sbriturë mbi atë posi një
pëlhur' e-madhe, lidhurë nga të katrë çipetë,
12 edhe dyke rënë mbi dhet; Brënda nd' atë
ishinë gjithë shtëzatë e dheut katrë-këmbë-
se, e bishatë, e shtërpinjtë, e shpest' e qie-
13 llit. Edhe erdhi një zë tek ay, Ngreu, Pjeter,
14 ther e ha. Po Pjetri tha, Qoftë lark, o
Zot! sepse kurrë s' kam ngrënë gjë të-ndyr'
15 a të-pëgërë. Po përsëri për së-dyti erdhi
një zë tek ay, Ato që ka qëruarë Perëndia,
16 ti mos i quaj të-ndyra. Edhe këjo ubë tri
herë; edhe përseri ena umuar lart ndë qiellt.

17 Edhe Pjetri tek po ishte dyke vrarë mën-
djenë me vetëhen'e ti, vallë ç'dotë jetë këta
të-parë qe pa, ja burratë, që ishinë dër-
guarë nga Kornili, passi pyetnë për shtëpin'e
18 Simonit, arritnë ndë portët: Edhe dyke thi-
rrurë pyetninë, ndë ka rënë këtu Simoni që
përmbiquhetë Pjetër.
19 Edhe Pjetri *atje* tek ishte dyke menduarë
për të parëtë *qe pa*, Fryma i tha, Ja tek po
20 të kërkoŋënë tre burra; Ngreu pra e sbrit, e
shko bashkë me ata, pa mos pasurë ndoŋë
farë dyshimi; sepse un' i kam dërguar' ata.
21 Edhe Pjetri, passi sbriti tek *ata* njerëzitë që
ishinë dërguarë tek ay nga Kornili, tha, Ja,
unë jam ay që kërkoni; për ç' punë keni ar-
22 dhurë? Edhe ata thanë, Kornili, krye-qindësi,
që është ŋeri i-drejtë edhe ka frikë nga Pe-
rëndia, edhe për të-cilinë ep dëshmim të-
mirë gjithë kombi i Juðenjet, uurdhërua nga
Perëndia me anë një ëngjëlli të-shënjtëruarë,
që të të thërresë ndë shtëpit të ti, edhe të dë-
23 gjonjë fjalë prej teje. *Ay* pra i thërriti ata
brënda, e i gostiti. Edhe mbë të-nesërmenë
dolli Pjetri bashkë me ata, edhe ca nga vë-
llezëritë që *ishinë* nga Joppa erdhë bashkë
24 me atë; Edhe mbë të-nesërmenë hynë ndë
Qesari; edhe Kornili ishte dyke pritur' ata,
edhe kishte mbledhurë far' e fisn' e ti edhe
miqt' *e-ti* të-ngushtë.
25 Edhe Pjetri posa hyri brënda, Kor-

BKSH

nili i dolli përpara, e i ra ndër këmbë, edhe
26 i ufal. Po Pjetri e ngriti, dyke thënë, Ngreu;
27 *sepse* edhe unë jam njeri. Edhe dyke folurë
bashkë me atë hyri brënda, edhe gjen mble-
dhurë shumë *veta.*
28 Edhe u tha atyre, Ju e dini se s'ësht' e-
ndjerë për një njeri Judhe të shoqëronjë a të vejë
mbë njeri prej tjetërë kombi: po Perëndia
më dëfteu të mos them as për ndonjë njeri
29 se është i-ndyrë a i-pëgërë. Përandaj, posa
uthërriçë, edhe erdha pa bërë fjalë; pyes pra,
30 për ç'fjalë dërguat' e më prutë? Edhe Kornili
tha, Katrë dit më parë gjer mbë këtë orë
ishnja dyke agjëruarë, edhe mbë të-nënttënë
orë po faleshe ndë shtëpit t'ime; edhe ja një
njeri me rroba të-ndritura tek qëndroj për-
31 para meje, Edhe thotë, Kornil, udëgjua të-
faluritë t' ënt, edhe eleimosinat' e tua upër-
32 mëntnë përpara Perëndisë. Dërgo pra ndë
Joppë, e thirrë Simoninë, që përmbiquhetë Pje-
tër; ky ka rënë ndë shtëpit të Simon lëkurë-
regjësit përanë detit; ay kur të vinjë dotë të
33 flase. Për-një-here pra dërgova te ti; edhe ti
bëre mirë që erdhë. Ndashti pra neve të-gji-
thë jemi përpara Perëndisë, që të dëgjojmë
gjithë ç' janë urdhëruarë te ti prej Perëndise.
34 Atëhere Pjetri hapi gojën' e tha. Me të-
vërtetë po e marr vesh, se Perëndia s'mban
35 anë njeriu; po mbë çdo komp ay që ka frikë
prej ati edhe punon drejtëri, ësht'i-priturë tek

BKSH

36 ay. Fjalënë që u dërgoj bijvet të Israilit, dyke
ungjillëzuarë paqtim me anë të Jisu Krishtit;
37 (ky është Zoti i të-gjithëve;) *Këtë* fjalë ju e
dini, që upërhap ndëpër gjithë Judhënë, dyke
zënë nga Galilea, pas pagëzimit që lëçiti Jo-
38 ani; Qysh leu Perëndia Jisunë nga Nazareti
me Frymë të-Shënjtëruarë e me fuqi, i-cili
shkoj vënt mbë vënt dyke bërë mirë e dyke
shëruarë gjith' ata që mundonëshinë prej dja-
39 llit; sepse Perëndia isthe bashkë me atë. Edhe
neve jemi dësmimtarë për gjith' ato që bëri
edhe ndë dhet të Judhenjyet edhe ndë Jeru-
salim; të-cilin' e vranë dyke varurë mbë dru;
40 Këtë Perëndia e ngjalli të-tretënë ditë, edhe
41 e bëri atë të duketë, Jo mbë gjithë llausnë,
po mb ëdëshmimtarët'e-sgjedurë që përpara
prej Perëndisë, *do-me-thënë* mbë neve që hën-
grëm'e pimë bashkë me atë, pasi ungjall prej
42 së-vdekurish; Edhe na porositi neve të lë-
çisëmë te llauzi, edhe të dëshmojmë, se ay
është ay që qe urdhëruarë prej Perëndisë
43 gjykatës i të-gjallëve e të-vdekurve. Për këtë
dëshmonjënë gjithë profitëritë, se me anë të
emërit t' ati dotë marrë ndjesë fajesh kushdo
që i beson ati.

44 Pjetri tek po ishte edhe dyke folurë këto
fjalë, ra Frym'e Shënjtëruarë mbi gjith' ata
45 që dëgjoninë fjalënë. Edhe umanitnë ata be-
sëtarëtë që ishinë prej rrethpresjesë, sa kishinë
ardhurë bashkë me Pjetrinë, se edhe mbë kom-

BKSH

47 bet' uderthka Frym' e-Shënjtëruarë. Sepse dë-
gjonin'ata dyke folurë gjuhëra, e dyke madhë-
47 ruarë Perëndinë. Atëhere Pjetri upërgjeq, Mos
munt të ndalonjë ujëtë ndonjë që të mos pa-
gëzonenë këta, të-cilëtë muarnë Frymën' e-
48 Shënjtëruarë, sikundrë edhe neve? Edhe i ur-
dhëroj ata të pagëzonenë mb'emërit të Zotit.
Atëherɛ i ulutnë të mbetetë pak dit *tek ata*.

Krye 11

1 Edhe apostojt'e vëllezëritë që ishinë ndë
Judhet dëguanë, se edhe kombetë pritnë fja-
2 lën'e Perëndisë. Edhe kur hipi Pjetri ndë Je-
rusalim, haheshinë me atë ata që *ishinë* prej
3 rrethpresjesë, Dyke thënë, Se hyre ndër nje-
rës të-parethprerë, e hëngre bashkë me ata.
4 Po Pjetri zuri e u dëfteu atyre *sa ubënë*
5 një nga një, dyke thënë, Unë ishhjam dyke
falurë ndë qytett të Joppësë; edhe pashë një
pamje ndë të-habiturë, një enë që sbriste
posi *një* pëlhur' e-madhe, e-cila *lidhurë* nga
të katrë çipetë lëshonej poshtë nga qielli,
6 edhe erdhi gjer tek unë; Ndë të-cilët, kur ho-
dha sytë, vura re e pashe shtëzët' e dheut ka-
tër-këmbëse, e bishatë, e shtërpinjtë, e shpest'
7 e qiellit. Edhe degjova një zë që më thoshte,
8 Ngreu Pjetër, ther e ha. Po *unë* thashë, Qoftë
lark, o Zot! se gjë e-ndyrë a e-pëgërë, as-
9 kurrë s'ka hyrë ndë gojët t'ime. Po zëri m'
upëgjeq për-së-dyti nge qielli, Ato që i ka që-

BKSH

10 ruarë Perëndija, ti mos i thuaj të-ndyra. Edhe
këjo ubë tri herë; edhe përsëri uhoqnë të gji-
11 thë ndë qiellt. Edhe na ndë gjithatë orë tek
arritnë tre burra ndë shtëpit që ishnjam, të-
12 dërguarë nga Qesaria tek unë. Edhe Fryma më
tha të vete baskë me ata pa mos pasurë as-
ndonjë dyshim; edhe erthnë bashkë me mua
edhe këta të gjashtë vëllezër, edhe hymë ndë
13 shtëpit t'ati njeriu. Edhe *ay* na dëfteu, qysh
pa ëngjëllinë ndë shtëpit të ti, se ndënji e i
tha ati, Dërgo ndë Joppë, e thirrë Simoninë
14 që përmbiquhetë Pjetër; Edhe ay dotë të
flasë ty fjalë, me anë të të-cilavet dotë shpë-
15 tonjç ti edhe gjithë stëpia jote. Edhe unë
posa zura të flas, Frym' e-Shënjtëruarë ra
mbi ata, sikundrë edhe mbë ne herën' e-parë.
16 Atëhere më ra ndër mëntt fjal'e Zotit që tho-
shte, Joani pagëzoj me ujë, po ju dotë pagë-
17 zohi me Frymë të-Shënjtëruarë. Ndë u dha
pra Perëndia atyre dhurëtinë sinjënjë, sikun-
drë edhe neve, sepse i besuanë Zotit Jisu
Krisht, unë cili ishnjam që të munt të nda-
lonj Perëndinë?
18 Edhe *ata* si dëgjuanë këto fjalë, uqetuanë
edhe lavduroninë Perëndinë, dyke thënë, Edhe
kombevet pra u paskërka dhënë Perëndia
pendimnë për jetë.
19 Ata pra që upërndanë nga ndjekja që ubë
për Stefaninë vatnë gjer ndë Finikë e ndë
Qyprë e ndë Antiohi, edhe asnjeriu s'ja lë-

20 çisninë fjalënë, veç vetëmë Judhenjet. Edhe ca
nga ata ishinë njerës Qyprianë e Qyrineas,
të-cilëtë, si hynë ndë Antiohi, u flisninë Gre-
qishtarëvet, dyke dhënë zën' e-mirë për Zotinë
21 Jisu. Edhe dor' e Zotit ishte bashkë me ata;
edhe shumë numër *njerëzish* besuanë, e u-
22 kthyenë mbë Zotinë. Atëhere fjala për ata u-
dëgjua ndë veshët të kishësë që ishte ndë
Jerusalim; edhe dërguanë Varnavënë të shko-
23 një gjer ndë Antiohi. Ay si erdhi, edhe pa
hirin'e Perëndisë, ugëzua edhe nguste të-gji-
thë të qëndroninë me dëshërim zëmëre mbë
24 Zotinë; Sepse ishte njeri i-mirë edhe plot me
Frymë të-Shenjtëruarë e me besë. Edhe u-
shtua mjaft gjindje mbë Zotinë.
25 Atëhere Varnava dolli ndë Tarsë, për të
kërkuarë Savllinë; edhe si e gjeti, e pru nd'
26 Antiohi. Edhe një mot të-tërë mblidheshinë
ndë kishët, edhe mësuanë mjaft gjindje; edhe
nxënësitë ndë Antiohi për të-parënë herë u-
quajtnë të-Krishterë.
27 Edhe nd' ato dit sbritnë nga Jerusalimi
28 profitër ndë Antiohi. Edhe ungrit një nga ata
që quhej Agaf, e shënoj me anë të Fry-
mësë, se dotë bënej një zi e-madhe mbë
gjithë dhenë, e-cila edhe ubë ndë kohët të
29 Qesar Kllavdiut. Përandaj nxënësitë vendos-
në që gjithë-sicili nga ata, sipas gjëndjes së
ti, t' u dërgonjënë ndihmë vëllezëret që rri-
30 ninë ndë Judhë; të-cilënë *gjë* edhe e bënë,

BKSH

dyke dërguarë *atë* pleqvet me dorë të Var-
navës' e të Savliit.

Krye 12.

1 Nd' atë kohë mbreti Irodh vuri duartë t' u
2 bënjë keq cave prej kishësë. Edhe vrau me
3 thikë Jakovinë të vëllan' e Joanit. Edhe kur
pa se këjo është e-pëlqyerë te Judhenjtë, vuri
ndër mëntt të zërë edhe Pjetrinë; (edhe *atë-*
4 *here* ishinë ditt'e pabrumjevet;) Të-cilinë edhe
e zuri edh' e vuri ndë burk, edhe e dha nder
duar të katrë palëve ushtëtoresh prej katrë
vetash sicila, që t' a ruanjënë, sepse pas
pashkësë donte t' a nxirte përpara llauzit.
5 Pjetri pra po ruhej ndë burkt; po prej ki-
shësë bënej pa pushim të-falurë për atë.
6 Edhe kur dot' a nxirte atë Irodhi për-
para, atë natë Pjetri lidhurë me dy vargje
ishte dyke flejturë ndër mest dy ushtëtorë-
ve, edhe ruajtësitë ruaninë burgunë përpa-
7 ra derësë. Edhe ja një ëngjëll i Zotit tek
erdhi papandehuraj, edhe dritë ndriti nd' atë
vënt; edhe si i ra Pjetrit ndë brinjët, e sgjoj,
dyke thënë, Ngreu çpejt. Edhe i ranë var-
8 gjetë nga duartë. Edhe ëngjëlli i tha, Ngji-
shu, edhe mbath këpucët' e tua; edhe *ay*
beri ashtu. Edhe i thotë, Vish rrobënë t' ën-
9 de, edhe eja pas meje. Edhe *ay* si dolli i
vinte pas, edhe nukë dinte, se ishte e-vër-
tetë këjo që bënej prej ëngjëllit, po pandeh-

10 te se sheh të-faniturë. Edhe si shkuanë të-
parënë edhe të-dytënë ruajtje, erdhë ndë
portët të-hekurtë, që shpie ndë qytett, e-ci-
la u uhap atyreve prej vetiu; edhe si duall-
në, shkuanë ndëpër një rrugë; edhe për-një-
11 here ëngjëlli unda nga ay. Edhe Pjetri, si
erdhi ndër vetëhe, tha, Ndashti e di me të-
vërtetë, se Zoti dërgoj ëngjëllin' e ti, edhe më
shpëtoj nga dor' e Irodhit, edhe nga gjithë
12 shpresa e llauzit të Judhenjvet. Edhe passi
umëndua me vetëhe, erdhi ndë shtëpit të
Marisë s'ëmës' së Joanit që përmbiquhej
Mark, *atje* tek ishinë mjaft *veta* mbledhurë
13 edhe po faleshinë. Edhe kur trokëlliti (Pjet-
ri) ndë portët të avllisë, erdhi një shërbëtore
14 që quhej Rodhë, për të dëgjuarë; edhe *ajo*
kur njohu zën' e Pjetrit, nga gëzimi nukë hapi
portënë, po shkoj me vrap brënda edhe dha
15 zë, se Pjetri po rri përpara portësë. Edhe
ata i than' asaj, Shkallove; po ajo qëndronte
dyke thënë, se kështu është. Edhe ata thosh-
16 ninë, *se* Është ëngjëll'i ati. Po Pjetri po qën-
dronte dyke trokëlitururë, edhe si *i* hapnë,
17 e pan' atë edhe umanitnë. Po ay u bëri a-
tyre shënjë me dorë të mos bënjënë zë, e u
tregoj atyre, qysh e nxori Zoti nga burgu;
edhe tha, Epni zë Jakovit edhe vëllezëret për
këto. Edhe dolli e vate mbë *një* tjatërë vënt.
18 Edhe si ubë ditë, ubë shumë trazyrë ndër
19 ushtëroret, vallë ç' ubë Pjetri. Edhe Irodhi kur

BKSH

e kërkoj e s'e gjeti, passi pyeti ruajtësitë, ur-
dhëroj të vritenë, edhe sbriti nga Judhea ndë
Qesari, e shkonte kohënë *atje.*
20 Edhe Irodhi ishte fort zëmëruarë me Ty-
rasit'e me Sidhonasitë; po ata erdhë me një
zëmërë tek ay, edhe si i mbushnë mëndjenë
Vllastit, kamarierit të mbretit, lypninë *të*
bëninë paqtim; sepse vëndi i atyreve usqenej
21 prεj vendit të mbretit. Edhe një ditë të-ndarë
Irodhi veshi rrobë mbretërie, edhe ndënji ndë
22 front, e u ligjëronte atyre. Edhe llauzi me zë
të-math thoshte, *Ky zë është* zë Perëndie, e
23 jo njeriu. Edhe për-një-here një ëngëll i Zo-
tit e goditi atë; sepse nuk'i dha lavdinë Pe-
rëndisë; edhe si e hëngrrë krimbatë dha
shpirtinë.
24 Edhe' fjal' e Perëndisë shtonej e shumohej.
25 Edhe Varnava e Savlli, passi mbaruanë shër-
besënë *që patnë,* ukthyenë nga Jerusalimi, passi
muarnë me vetëhe Joaninë që upërmbiquajt
Mark.

Krye 13.

1 Edhe ndë kishët që ishte ndë Antiohi i-
shinë ca profitër e mësonjës, Varnava edhe
Simeoni që quhej Nigjer, edhe Lluqi Qyri-
neasi, edhe Manaini që ishte rriturë bashkë
me Irodhinë katrurdhëratësinë, edhe Savlli.
2 Edhe tek ishinë ata dyke i shërbyerë Zotit
edhe dyke agjëruarë, Frym' e-Shënjtëruarë

tha, Nda-më-ni veç Varnavën' edhe Savllinë
3 për atë punë që i kam thërritur' ata. Atëhere
si agjëruan' e ufalnë, edhe vunë duartë mbi
ata, i lëshuanë.
4 Këta pra passi udërguanë nga Frym' e-
Shënjtëruarë, sbritnë ndë Selefqi, edhe prej
5 andej lundruanë për ndë Qyprë. Edhe kur
erthnë ndë Salaminë, lëçitnë fjalën' e Perën-
disë ndëpër sinagogjit të Judhenjet; edhe ki-
6 shin' edhe Joaninë shërbëtuar. Edhe si kapë-
tuan' ujdhezënë gjer ndë Pafë, gjetnë një farë
magistari profit të-rrem Judhe, që e kishte
7 emërinë Var-jisu, I-cili ishte bashkë me gu-
vernatorinë Sergji Pavlinë, *që ishte* një burr'
i-mënçim. Qy thërriti Varnavën' edhe Savllinë,
edhe kërkoj të dëgjonjë fjalën' e Perëndisë.
8 Po Elyme magjistari, (sepse kështu kthenet'
emer' i ati,) rrinte kundrë atyre, e kërkonte
t'a kthenjë guvernatorinë nga besa.
9 Po Savlli, (që quhej edhe Pavël), umbush
me Frymë të-Shënjtëruarë, e shtyri sytë mbi
10 atë, Edhe tha, O *ti që je* plot me çdo
kobim e me çdo farë intrige, i bir' i diallit,
e armiku i çdo drejtërie, nukë dotë pushonjç
11 së prishuri udhët' e-drejta të Zotit? Edhe
ndashti ja dor' e Zotit tek është mbi ty; edhe
dotë mbetesh i-verbërë, e nukë dotë shohç
djellinë gjer mbë një kohë. Edhe për-një-here
ra mbi atë një *si* mjegullë e errësirë, edhe dyke
ardhurë rrotullë kërkonte *njerës* që t'a hiq-

12 ninë prej dore. Atëhere kur pa guvernatori
seç ubë, besoj, e çuditej për mësimn' e Zotit.
13 Edhe Pavli edhe ata që ishinë rreth ati,
passi ungritnë me anije nga Pafa, erthnë ndë
Pergët të Pamfylisë; edhe Joani unda nga ata,
edhe ukthye ndë Jerusalim.
14 Edhe ata passi shkuanë nga Perga, er-
thnë ndë Antiohi të Pisidhisë, edhe si hynë
15 ndë sinagogjit ditën' e-shëtunë, ndenjnë. Edhe
pas të-kënduarit të nomit edhe të profitërvet,
të-parët' e sinagogjisë dërguanë tek ata, dyke
thënë, O burra vellezër, ndë kini ndonjë fjalë
për të mësuarë llauzit, thoni.
16 Atëhere Pavli si ungrit e bëri shënjë me
dorë, tha, O burra Israilitë, edhe ju që i kini
17 frikë Perëndisë, pa dëgjoni. Perëndia i këti
llauzi, i Israilit, sgjodhi atëritë t'anë, edhe
ngriti llauzinë që rrinte i-huaj ndë dhet t'
Egjyptësë, edhe me krahë të-lartë i nxori ata
18 prej asaj. Edhe gjer mbë dyzet vjet duroj
19 mëndyrat' e atyre ndë shkretëtirët; Edhe
passi prishi shtatë kombe ndë dhet të Ha-
naanit, u ndau atyre me shortë dhen' e aty-
20 reve. Edhe pastaj për sindoŋa katrë qint e
pesë-dhjetë vjet u dha atyre gjykatës gjer
21 mbë kohët të profitit Samuil. Edhe pastaj
lypnë mbret, edhe Perëndia u dha atyre Sa-
ullinë të birr' e Qisit, një burrë prej farës' së
22 Veniaminit, për dyzet vjet. Edhe si e hoqi
atë, u ngriti atyre Dhavidhinë për mbret, për

të-cilinë edhe dëshmoj, dyke thënë, „Gjeta
Dhavidhinë *të birr'* e Jesseut, njeri pas zëmë-
rësë s'ime, i-cili dotë bënjë dashurimet' e mi.“
23 Prej farës' së këti Perëndia pas të-zotuarit
të ti, ngriti mbë Israilinë shpëtimtar Jisunë,
24 Passi Joani lëçiti, para se të vinte ay, pa-
gëzim pendimi mbë gjithë llauzin' e Israilit;
25 Edhe Joani kur po mbaronte udhën' e ti, tho-
shte, Cili pandehni se jam unë? unë nukë jam
ay; po ja tek vjen pas meje ay, të-cilit *unë*
nukë jam i-zoti t' i sgith këpucën' e këmbëvet.
26 O burra vëllezët, të bijt' e farës' s' Avraa-
mit, edhe sa janë ndër ju që i kanë frikë Pe-
rëndisë, mbë ju udërgua fjal' e këti shpëtimi.
27 Sepse ata që rrinë ndë Jerusalim, edhe të-
parët' e atyre, passi nuk' e njohnë këtë, as
fjalët' e profitërvet që këndonenë çdo të-shë-
28 tunë, i mbushnë *ato*, kur e gjykuanë; Edhe
ndonëse s'gjetnë asndonjë faj për vdekje,
29 lypnë prej Pillatit që të vritetë. Edhe passi
mbaruanë gjith'ato që ishinë shkruarë për
atë, e sbritnë prej drurit, edhe e vunë ndë
30 var. Po Perëndia e ngjalli prej së-vdekurish.
31 Edhe ay uduk për shumë dit mb'ata që hi-
pnë bashkë me atë prej Galilesë ndë Jerusa-
lim, të-cilëtë janë dëshmimtarë të ati te
32 llauzi. Edhe neve po u apëmë juve zën' e-
mirë për të-zotuarëtë që qe bërë mb'atëritë,
33 Se këtë Perëndia e mbushi mbë ne bijt' e
atyre, dyke ngjallurë Jisunë; sikundrë edhe

BKSh

ndë Psallmët të-dytë është shkruarë „Ti je
34 Biri im; unë sot të kam pjellë.“ Edhe se e-
ngjalli prej së-vdekurish, që të mos kthenetë
më ndë prishje, ka thënë kështu, „Se dot' u ap
juve të-zotuarat' e Dhavidhit që *uzotuashë*
35 më besë.“ Përandaj edhe ndë një tjatërë
Psallmë thotë, „Se nukë dotë lesh Sënjtinë
36 t'ënt të shohë prishje.“ Sepse Dhavidhi, passi
ndë brest të ti i shërbeu andës' së Perëndisë,
37 fjeti, edhe uvu tek atërit' e ti, edhe pa pri-
shje; Po Ay,të-cilin' e ngjalli Perëndia, nukë
pa prishje.
38 Letë jetë pra e-diturë mbë ju, o burra vë-
llezër, se me anë të këti lëçitetë mbë ju ndjesë
39 fajesh, edhe prej gjith' atyre *punërave* që nukë
munttë të drejtërohi me anë të nomit të Moisiut,
me anë të këti kushdo që beson drejtëronetë.
40 Shikoni pra semos vinjë mbë ju ajo që është
41 thënë prej profitërvet; „Shikoni ju që nukë
më zini për gjë, edhe çuditunì, edhe humbis-
ni ; sepse unë *dotë* punonj një punë ndër
ditt t' uaj, një punë që nukë dot' a besoni,
ndë u' a tregoftë ndonjë juve.“
42 Edhe kur po dilninë (nga sinagogjia e Ju-
dhenjvet), u luteshinë (kombetë) t'u flitenë
edhe atyreve këto fjalë të-shëtunënë që vjen.
43 Edhe si upërnda sinagogjia, shumë prej Ju-
dhenjet edhe prej besëtarëvet të-kthyerë vanë
prapa Pavlit edhe Varnavësë; të-cilëtë dyke
folur' atyreve u mbushninë mëndjenë te mbe-

44 tenë ndë hirt të Perëndisë. Edhe të-shëtunënë
tjetërë umbloth po-thua gjithë qyteti, që të
45 dëgjoninë fjalën' e Perëndisë. Po Judhenjtë,
kur panë gjindjenë, umbushnë me cmir, edhe
flisninë kundrë të-thënuravet prej Pavlit, dyke
46 folurë kundrë e dyke sharë. Atëhere Pavli
edhe Varnava folnë me kuxim edhe thanë,
Mbë ju ishte nevojë më parë të flitej fjal' e
Perëndisë; po passi e hithni poshtë, edhe nuk'
e gjykoni vetëhenë t' uaj të-vëjejturë për jetën'
e-përjetëshme, ja tek po kthenemi ndër kom-
47 bet; Sepse kështu na ka porositurë Zoti, *dyke*
thënë, „Të kam vënë për dritë të kombevet, që
të jesh ti për shpëtim gjer ndë anë të dheut.“
48 Edhe kombetë, kur dëgjuanë, gëzoneshinë,
edhe lavduroninë fjalën' e Zotit; edhe sa i-
ishin' urdhëruarë për jetën' e-përjetëshme be-
49 suanë. Edhe fjal' e Zotit përhapej ndëpër
50 gjith' atë vënt. Po Judhenjtë shtyninë gratë që
ishinë të-nderçura e me të-sjella të-mira, *si*
edhe të-parët' e qytetit, edhe ngritnë ndjekje
kundrë Pavlit edhe Varnavësë, edhe i nxuarnë
51 nga sinorët' e tyre. Po ata shkuntnë pluhu-
rin' e këmbëvet të tyre kundrë atyreve edhe
52 erthnë ndë Ikoni. Edhe nxënësitë mbushe-
shinë me gëzim e me Frymë të-Shënjtëruarë.

Krye 14.

1 Edhe ndë Ikoni hynë bashkë ndë sinago-
gjit të Judhenjvet, edhe folnë kështu, sa be-

BKSH

suanë një shumic' e-madhe prej Judhenjvet e
2 prej Grekërvet. Po ata Judhenjtë që nukë
bindeshinë ndesnë edhe prishnë shpirtërat' e
3 kombevet kundrë vëllezërvet. Mjaft kohë pra
ndëjnë *atje*, dyke folurë me kuxim për Zotinë,
i-cili dëshmonte për fjalën' e hirit të ti, edhe
epte të bënenë shënja e çudira me anë të
4 duarvet t' atyre. Edhe shumica e qytetit u-
nda *mbë dy*; e ca ishinë me Judenjtë, e ca
5 me apostojtë. Edhe kur udruthnë kombet' e
Judhenjtë bashkë me të-parët' e tyre, që t' i
6 shanjën' e t' i vrasënë me gurë, *Ata* e muarnë
vesh, edhe iknë ndë qytetet të Lykaonisë, Lys-
7 trë e Dervë, edhe ndë fshatërat rrotullë; Edhe
atje lëçisninë Ungjillinë.
8 Edhe ndë Lystre rrinte një njeri i-dobëtë
nga këmbëtë, sepse ishte i-çalë që nga barku
9 i s'ëmësë, i-cili kurrë s' kishte ecurë. Ky dë-
gjonte Pavlinë dyke folurë; i-cili, si shtyri
sytë mb' atë edhe pa se kishte besë për të
10 shpëtuarë, Tha me zë të-math, Ngreu mbë
këmbë *edhe rri* drejt. Edhe *ay* këcente edhe
11 ecënte. Edhe gjindja kur panë seç bëri Pavli,
ngritnë zën' e tyre, dyke thënë Lykaonisht,
Perënditë ushëmbëllyenë mbë njerës e sbrit-
12 në ndër ne. Edhe quaninë Varnavënë Ënjët,
edhe Pavlinë Mërkur; sepse ky ishte i-pari
13 që fliste. Atëhere prifti i Ënjëtit që ishte për-
para qytetit t'atyre pruri dema e kurora
përpara dyervet, edhe bashkë me gjindjenë

14 donte të bënjë kurban. Po apostojtë Varnavë
eđe Pavël kur dëgjuanë, çuarnë rrobat' e tyre,
e uhothnë ndë mest të gjindjesë, dyke thërri-
15 turë, E dyke thënë, O burra, përse bëni këto?
edhe neve jemi njerës që pësojmë si edhe
ju, edhe u lëçisëmë juve të кtheneni nga këto
të-kota mbë Perëndin' e-gjallë, që bëri qje-
llin' edhe dhenë edhe gjithë ç'*janë* nd' ata;
16 I-cili ndë brezat që shkuanë la gjithë kom-
17 betë të ecënjënë nd' udhët të tyre; Ndonëse
nuk' e la vetëhen' e ti pa dëshmim, dyke
bërë mirë, e dyke dhënë neve nga qielli shira
e kohëra pemësjellëse, e dyke mbushurë zë-
18 mëratë t'ona me ushqim e me gëzim. Edhe
dyke thënë këto, mezi ndaluanë gjindjenë që
të mos u bënjënë atyre kurban.
19 Edhe mbi këto e sipërë erthnë *ca* Judhenj
nga Antiohia e nga Ikonia, edhe i mbushnë
mëndjenë gjindjesë, e rrahnë me gurë Pav-
linë, edhe e hoqnë *svarë* jashtë qytetit, sepse
20 pandehnë se vdiq. Po kur e qarkuanë nxë-
nësitë, ungrit e hyri ndë qytett, edhe mbë
të-nesërmet dolli bashkë me Varnavënë ndë
Dervë.
21 Edhe passi lëçitnë ungjillinë nd' atë qy-
tet, edhe bënë mjaft nxënës, ukthyenë ndë
22 Lystrë e ndë Ikoni, e ndë Antiohi, Dyke for-
cuarë shpirtërat' e nxënëset, e dyke shtyturë
ata të qëndronjënë ndë besët, edhe *dyke thënë
atyre* se me shumë sbtrëngime duhetë të

BKSH

23 hyjmë ndë mbretërit të Perëndisë. Edhe si u
urdhëruanë atyre me të vënë duartë pleq mbë
çdo kishë, edhe ufalnë me agjërime, i lanë
24 te Zoti që i kishinë besuarë. Edhe si shkuanë
25 ndëpër Pisidhi, erdhë ndë Pamfyli; edhe si
folnë fjalënë ndë Pergë, zbritnë nd' Attali;
26 Edhe s'andejmi lundruanë për ndë Antiohi,
atje ku ishinë dhënë ndë hirt të Perëndisë
për punënë që mbaruanë.
27 Edbe si erthnë, mblothnë kishënë, edhe
u dëftyen' atyre sa bëri Perëndia me anë t'
atyreve, edhe se hapi ndër kombet derën' e
28 besësë. Edhe ndënjnë atje ϭumë kohë bashkë
me nxënësitë.

Krye 15.

1 Edhe ca *veta* që sbritnë nga Judhea mëso-
ninë vëilezëritë, Se ndë mos urrethprefshi pas
2 zakonit të Moisiut, s'munt të shpëtoni. Po
passi Pavli edhe Varnava u ndënjnë kundrë
edhe uhëngrrë me fjalë jo pak me ata, ven-
dosnë që Pavli edhe Varnava edhe ca të-
tjerë nga ata të hipënjënë te apostojt' edhe
3 te pleqtë ndë Jerusalim për këtë çështje. Ata
pra si upërcuallnë nga kisha, shkoninë ndë-
për Finikë e ndëpër Samari, dyke treguarë
të kthyerët' e kombevet; edhe u bininë gë-
4 zim të-maδ gjithë vëllezëret. Edhe kur erthnë
ndë Jerusalim, upritnë prej kishës' e prej a-
postojvet e prej pleqvet, edhe dhanë zë për

BKSH

gjithë sa bëri Perëndia me anë t' atyreve
5 Po ungritnë ca nga sekt' e Farisenjvet që ki-
shinë besuarë, e thoshinë, Se duhetë të reth-
presëm' ata e t'i porositmë të ruanjënë nomn'
e Moisiut.
6 Edhe umblothnë apostojt' e pleqtë të shi-
konjënë për këtë punë.
7 Edhe passi ubë shumë të-ngrënë me fjalë,
ungrit Pjetri, e u tha atyre, O burra vëllezër,
e dini se që ndë ditt të-lashta Perëndia ndër
mest t' ënë sgjodhi, që me anë të gojës' s'ime
të dëgjonjënë kombetë fjalën' e ungjillit edhe
8 të besonjënë. Edhe zëmërë-njohësi Perëndi dha
dëshim mbë ata,dyke dhënë atyre Frymën' e-
9 Shënjtëruarë sikundrë edhe neve. Edhe nukë
bëri ndonjë të-çquarë ndër mest t'ënë e t'
atyreve, dyke qëruarë zëmërat' e atyre me
10 anë të besësë. Tashi pra përse ngisni Pe-
rëndinë, *e kërkoni* të vini mbë qafët të nxë-
nëset një sgjedhë, të-cilënë as atëritë t' anë
11 as neve nukë muntmë t' a mbajmë? Po me
anë të hirit të Zotit Jisu (Krishtit) besojmë
se dotë shpëtojmë, sikundrë edhe ata.
12 Edhe gjithë shumica pushoj, edhe dëgjo-
ninë Varnavën' edhe Pavlinë që dëfteninë sa
shënja e çudira bëri Perëndia me anë t' a-
tyre ndër mest të kombevet.
13 Edhe si pushuanë ata, upërgjeq Jakovi,
14 dyke thënë; O burra vëllezër, pa më dëgjoni;
Simeoni dëfteu, me ç' farë mënyrë Perëndia

të-parënë herë shtyri sytë mbi kombetë, që të
marrë prej atyre *një* llaus për emërin' e ti.
15 Edhe me këtë janë një fjalët' e profitërvet,
16 sikundrë është shkruarë, „Pas këtyre dotë
kthehem e dotë ndërtonj përsëri tendën' e
Dhavidhit që është rrëzuarë; edhe të-rrëzu-
arat' e asaj dot'i ndërtonj përsëri, edhe dot'a
17 ngre atë mbë këmbë; Që të kërkonjënë Zo-
tinë njerëzit' e-tjerë, edhe gjithë kombetë, mbë
të-cilëtë thërritetë emëri im, thotë Zoti që bën
18 këto të-gjitha.“ Që prej jete janë të-njohura
19 te Perëndia gjithë punët' e tia. Përandaj un'
e shoh të udhësë të mos i ngasëm' ata që
20 kthenenë nga kombetë te Perëndia; Po t'u
shkruajm' atyre të heqënë dorë nga ndyrësi-
rat' e idhujvet, edhe nga kurvëria, edhe nga
21 gjëj' e-mbyturë, edhe nga gjaku. Sepse Moisiu
që prej brezash të-lashtë ka mbë çdo qytet
ata që e lëçisën' atë udëpër sinagogjit, ku
këndonetë çdo të-shëtunë.

22 Atëhere uduk *pun*' e-pëlqyerë te apostojt'
edhe te pleqtë bashkë me gjithë kishënë të
sgjedhënë burra nga mezi i tyre, edhe t'i dër-
gonjënë ndë Antiohi bashkë me Pavlin' e
me Varnavënë; *edhe sgjodhë* Judhënë që për-
mbiquhej Varsava, edhe Sillënë, njerës të-
23 parë ndër vëllezërit. Edhe u shkruanë me anë
të dorës' s' atyre këto:

Apostojt' edhe pleqt' edhe vëllezëritë *mbë*
ja vëllezëritë prej kombeve *që gjëndeni* ndë-

për Antiohinë e ndëpër Syrin' e ndëpër Qili-
24 qinë, gëzuashi. Passi dëgjuamë se erthnë ca
veta prej nesh, e u trumbulluanë juve me
fjalë, edhe prishnë shpirtëratë t'uaj, dyke
thënë të rrethpriti e te ruani nomnë, të-cilëtë
25 neve nuk' i porositmë *për këtë*; Na uduk e-
pëlqyerë neve që jemi mbleđurë bashkë më
një zëmërë, the sgjedhëmë njerës, edhe t'i
'ërgojmë te ju bashkë me të-dashuritë t' anë
26 'arnavë edhe Pavel, Njerës që kanë dhënë
.tët' e tyre për emërin' e Zotit t' ënë Jisu
27 Þisht. Dërguamë pra Judhën' edhe Sillënë,
28 qt' u thonë edhe ata me gojë po ato. Sepse
i uduk e-pëlqyerë Frymës' së-Shënjtëruarë
ece neve, të mos u vëmë juve më *tjetërë*
bëë përveç këtyreve që janë të-nevojshime,
29 Tëhiqni dorë nga kurbanët' e idhujvet, edhe
nggjaku, edhe nga gjëj' e-mbyturë, edhe
ngäkurvëria; nga këto ndë ruajçi vetëhenë
t'uadotë bëni mirë. Qofshi me shëndet.
30 'ta pra si ulëshuanë, erthnë nd' Antiohi;
edhmblothnë sumicënë, e u dhan' atyre ndër
31 duarartënë. Edhe ata, si e kënduanë, ugë-
32 zuanpër ngushëllimnë *që u dha*. Edhe Ju-
dha ne Silla, që edhe ata ishinë profitër,
ngusluanë vëllezëritë me shumë fjalë, e i
33 forcua. Edhe si ndënjnë *atje ca* kohë, u-
dërgua prapë me paqtim nga vëllezëritë tek
34 aposto Po Sillësë i uduk mirë të mbetetë
35 aty. E Pavli e Varnava rrininë ndë Anti-

BKSH

ohi, dyke mësuar' e dyke lëçiturë fjalën' e
Zotit, bashkë me shumë të-tjerë.
36 Edhe pas ca ditsh Pavli i tha Varnavës,
Letë kthenemi tashi të shohëmë vëllezërië
t' anë mbë çdo qytet që dhamë zën' e-mië
37 për Zotinë, *vallë* si janë. Edhe Varnava dore
të marrë me vetëhe Joaninë që quhej Mar;
38 Po Pavli s' e gjente për mirë të marrë ıe
vetëhe atë, që qe ndarë prej atyreve ŋa
Pamfylia, edhe nuk' erdhi me ata ndë punët.
39 Gjau pra një qartë, kaqë sa undanë ata ηëri
prej tjetërit; edhe Varnava mori me vehe
Markunë, edhe lundroj për ndë Qyprë.
40 Po Pavli sgjodhi Sillënë, edhe dol si
udha prej vëllezërvet ndë hirt të Perërisë.
41 Edhe shkuanë ndëpër Syri e ndëpër Qiqi,
dyke forcuarë kishëtë.

Krye 16.

1 Edhe arriu ndë Dervë e ndë Lystrëedhe
ja tek ishte atje një nxënës që quh Ti-
mothe, i bir' i një gruaje Judheonë bëtare,
2 edhe i një ati grek; Për të-cilinë ej dë-
shmim i-mirë prej vëllezërvet që ish ndë
3 Lystrë e ndë Ikomi. Këtë e deshi Pa që të
dalë bashkë me atë; edhe si e more reth-
preu, për punë të Judhenjet që islë ndër
ata vënde, sepse të-gjithë e dininë n' e ati
4 se ishte Grek. Edhe dyke shkuaı ndëpër
qytetet, u lininë atyre *porosi* të ruanë dho-

gmatë qe ishinë urdhëruarë nga apostojt' e
5 nga pleqtë që ishinë ndë Jerusalim. Kishëtë
pra forconëshinë ndë besët, edhe përdita shto-
neshinë nga numëri.
6 Edhe passi shkuanë ndëpër Frygjit e ndë-
për dhet të Gallatisë, sepse undaluanë nga
Frym' e-Shënjtëruarë të lëçisninë fjalënë nd'
7 Asi, erthnë ndë Mysi, Edhe kërkoninë të venë
8 ndë Vithini, po Fryma nuk' i la. Edhe si shku-
9 anë ndëpër Mysit, sbritnë ndë Troadhë. Edhe
Pavlit i uduk natënë një të-fanlturë, se një
njeri Maqedhonas rrinte *përpara* dyke lu-
tur' e dyke thënë ati, Shko ndë Maqedhoni,
10 e ndih-na. Edhe posa pa të-fanituritë, për-
një-here kërkuamë të vemi ndë Maqedhoni,
sepse e muarmë me mënt se Zoti po na thë-
rret t'u apëmë atyre zën' e-mirë.
11 Si lundruamë pra nga Troadha, muar-
më udhënë drejt për ndë Samothrakë, edhe
12 mbë të-nesërmet për ndë Neapolë, Edhe s'
andejmi për ndë Filippë, që është qytet i-
parë i asaj ane së Maqedhonisë, një e-për-
ngulurë *Romanësh;* edhe ndënjmë ca dit ndë
këtë qytet.
13 Edhe ditën' e-shëtunë duallmë jashtë qy-
tetit përanë një lumi, ku ishte zakon të bë-
netë të-falurë, edhe ndënjmë, edhe flisnimë
14 me gratë që ishinë mbledhurë *atje.* Edhe
një grua që quhej Lydhi, nga qytet'i Thya-
tirësë, e-cila shishte porfirëra, e druante

Perëndinë, po dëgjonte; sepse Zoti i hapi
zëmërënë t' u mbanjë vesh fjalëvet që flishte
15 Pavli. Edhe si upagëzua *ajo* edhe shtëpi' e
asaj, *na* lutej, dyke thënë, Ndë më paçi gjy-
kuarë se jam besëtare mbë Zotinë, hyni ndë
shtëpit t' ime, edhe rrini; edhe na shtrëngoj
shumë.
16 Edhe kur po vinimë neve për të falurë,
upoq me ne një shërbëtore që kishte frymë
Pythoni, e-cila u epte shumë fitim zotërinjvet
17 të saj dyke rrëfyerë *njerësvet* fatinë. Ajo vate
prapa Pavlit e nesh, edhe bërtiste, dyke thë-
në, Këta njerës janë shërbëtorë të Perëndis'
së-lartë, të-cilëtë na dëftenjën' udhën' e shpë-
18 timit. Edhe këtë e bënte shumë dit me ra-
dhë. Edhe Pavli si urëndua, ukthye e i tha
frymësë, Të urdhëronj mb' emërit të Jisu Kri-
shtit të dalç prej asaj. Edhe dolli që atë orë.
19 Edhe zotërinjt' e asaj, kur panë, se u
humbi shpresa e fitimit të tyre, zunë Pavlin'
edhe Sillënë e i hoqnë ndë trekt te të-pa-
20 rëtë; Edhe si i prunë ata përpara të-mëdhenj-
vet, thanë, Këta njerës, dyke qënë Judhenj,
21 trumbullonjënë qytetinë t' ënë; Edhe mëso-
njënë zakonë që s' ësht' e udhësë t' i presë-
më ne, as t' i bëjmë, sepse jemi Romanë.
22 Edhe gjindja për së-bashkëti usulnë mbi ata,
edhe të-mëdhenjtë u grisnë rrobatë, e urdhë-
23 ruanë t' i rrahënë me shkopinj. Edhe si i bënë
me shumë plagë, i vunë ndë burk, edhe po-

BKSh

rositnë ruajtësin' e burgut t' i ruanjë me si-
24 guri; I-cili si mori të-këtillë porosi, i vuri
ndë burkt të-përbrëndëshm, e u shtrëngoj
këmbëtë ndë drut.
25 Edhe ndë mest të natësë Pavli edhe Si-
lla faleshin' e këndoninë lavdurime mbë Pe-
rëndinë; edhe të-lidhuritë u mbaninë vesh
26 atyre. Edhe papandehuraj ubë një tërmet i-
math, kaqë sa utuntnë themelet' e burgut;
edhe për-një-here uhapnë gjithë dyertë, edhe
27 të-gjithëve u usgjithnë hekuratë. Edhe ruaj-
tësi i burgut kur usgjua, edhe pa dyert' e
burgut të-hapura, nxori thikënë, e donte të
vriste vetëhen' e ti, sepse pandehte se ki-
28 shinë ikurë të-lidhuritë. Po Pavli thërriti me
zë të-math, dyke thënë, Mos i bëj ndonjë
të-keqe vetëhesë s' ate; sepse të-gjithë jemi
29 këtu. Atëhere ay lypi dritë, e këceu brënda,
edhe dyke dridhurë u ra ndër këmbë Pavlit
30 edhe Sillësë; Edhe si i nxori ata jashtë, tha,
Zotërinj, ç' duhetë të bënj unë, që të shpë-
31 tonj? Edhe ata i thanë, Beso-i Zotit Jisu
Krisht, edhe dotë shpëtonjç ti edhe shtëpia
32 jote. Edhe i folnë fjalën' e Zotit ati edhe
gjith' atyreve që ishinë ndë shtëpit t' ati.
33 Edhe ay i mori me vetëhe që nd' atë orë
të natësë, e u lau plagëtë; edhe për-një-here
34 upagëzua ay edhe gjithë të-titë; Edhe si i
hipi sipërë ndë shtëpit të ti, u vuri përpara

BKSH

truvezë, edhe ugëzua me gjithë shtëpinë, se-
pse i besoj Zotit.
35 Edhe si ugdhi, të-mëdhenjtë dërguanë
shkopmbanjësitë, dyke thënë, Lësho ata
36 njerës. Edhe ruajtësi i burgut i dha zë Pav-
lit për këto fjalë, Se të-mëdhenjtë kanë dër-
guarë që të lëshohi; tashi pra dilni, e shko-
37 ni ndë paqtim. Po Pavli u tha atyre, Passi
na rrahnë ndër sy të botësë pa gjykuarë,
neve që jemi njerës Romanë, e *na* vunë ndë
burk, edhe tashi na nxjerrënë fshehurazi?
38 Edhe shkopmbanjësitë u dhanë zë të-mëdhenj-
vet për këto fjalë; edhe *ata* ufrikësuanë,
39 kur dëgjuanë se janë Romanë; Edhe erthnë
e u ulutnë atyre, edhe si i nxuarnë, u lute-
40 shinë të dalënë nga qyteti. Edhe *ata* si duall-
në nga burgu, hynë *ndë shtëpit* të Lydhisë;
edhe kur panë vëllezëritë, i ngushëlluan' e
iknë.

Krye 17.

1 Edhe si bënë udhë ndëpër Amfipolë e
ndëpër Apolloni, erthnë ndë Thessallonikë,
2 ku ishte sinagogjia e Judhenjet. Edhe Pavli
sipas zakonit *të ti* hyri tek ata, edhe tri të-
shëtuna me radhë fliste me ata prej shkro-
3 njavet, Dyke sgjidhur' e dyke dëftyerë, se
Krishti duhej të pësonte e të ngjallej prej
së-vdekurish, edhe se ky është Krishti Jisuj,
4 që po u lëçis unë juve. Edhe cave nga ata

BKSH

umbush mëndja, edhe ubashkuanë me Pav-
lin' e me Sillënë, *si* edhe nga ata Grekëritë
që ndruaninë nga Perëndia një shumic' e-
madhe, edhe nga grat' e-para jo të-paka.
5 Po ata Judhenj, të-cilëvet s' u mbushej
mëndja, ucmiruanë, edhe muarnë me vetëhe
ca njerës të-këqinj nga ata *të rrugavet* të
tregut, edhe mblothnë gjindje, edhe përzje-
ninë qytetinë; edhe usulnë ndë shtëpit të
Jasonit, edhe kërkonin' ata, që t' i bininë te
6 llauzi. Po passi s' i gjetnë, hoqnë svarë Ja-
sonin' edhe ca vëllezër te të paret' e qytetit,
dyke bërtiturë, se këta që ngritnë mbë këm-
7 bë botënë, kanë ardhurë edhe këtu, Të-ci-
lëtë Jasoni i priti ndë shtëpit; edhe të-gjithë
këta punonjënë kundrë urdhëratavet të Qe-
sarit, dyke thënë, Se është një tjetërë mbret,
8 Jisuj. Edhe përzjenë gjindjenë edhe të-parët' e
9 qytetit që dëgjoninë këto *fjalë*. Edhe si usi-
guruanë prej Jasonit edhe prej të-tjerëvet,
i lëshuanë.
10 Edhe vëllezëritë për-një-here natënë dër-
guanë jashtë Pavlin' edhe Sillënë ndë Verje:
të-cilëtë kur erthnë *atje*, vanë ndë sinagogjit
11 të Judhenjet. Po këta ishinë më të-fisçim se
ata të Thessallonikësë, sepse pritnë fjalënë
me gjithë zëmërë, dyke vëzhguarë përdita
shkronjatë, ndë janë kështu këto *punëra*.
12 Shumë *veta* pra nga ata besuanë, si edhe
nga grat' e-nderçime të Grekërvet, edhe nga

13 burratë jo të-pakë. Po kur muarnë vesh Ju-
dhenjtë nga Thessallonika, se edhe ndë Verje
prej Pavlit ulëçit fjal' e Perëndisë, erthnë
14 edhe atje edhe trumbulluanë gjindjenë. Edhe
atëhere për-një here vëllezëritë Pavlinë e dër-
guanë jashtë që të vejë gjer ndë dett; po
15 Silla edhe Timotheu mbetnë atje. Edhe ata
që i hiqninë udhënë Pavlit e shpunë gjer
nd' Athinë; edhe si muarnë porosi për Si-
llën' e për Timothenë, që të vinjënë tek ay
sa mundetë me çpejt, shkuanë.
16 Edhe Pavli tek ishte dyke priturë ata
nd' Athinë, i përvëlonte brënda ndë shpirtt,
17 kur shikonte qytetnë plot me idhuj. Fliste
pra ndë sinagogjit me Judhenjtë edhe me
ata që ndruaninë prej Zotit, edhe nde trekt
18 çdo ditë me ata që goditte *të piqej*. Edhe
ca fillosofë nga Epikurianët' e nga Stoikëtë
bininë ndë fjalë me atë; edhe ca thoshninë,
Vallë ç' do të thotë ky llomatar? edhe të-
tjerë thoshinë, Duketë, se është zë-dhënës i
perëndirave të-huaja; sepse u lëçiste atyre
19 Jisunë, edhe të- ngjalluritë. Edhe ata e zunë,
edhe e shpunë nd' Areopagt, dyke thënë, A
munt te marrëmë vesh, ç' është ky mësim
20 i-ri që flitetë prej teje? Sepse *ti na* bje ca
gjërëra të-çudiçime ndë veshët t' anë. Dua-
më pra të marrëmë vesh, ç'do të jenë këto.
21 Sepse gjith' Athinasit' edhe të-huajtë që
rrinin' atje nukë kishinë nge për ndonjë tje-

tërë gjë, veç të thonë e të dëgjonjënë ndo-
një fjalë më të-re.
22 Atëhere Pavli qëndroj ndë mest të Areo-
pagut, e tha, O burra Athinas, mbë gjithë
punërat u shoh juve se jini me të-tepërë
23 hie-lutës. Sepse, dyke shkuarë e dyke vënë
re vëndet' e adhurimit t' uaj, gjeta edhe një
alltar, permbi të-cilinë është shkruarë, Mbë
Perëndin' e-Panjohurë. Atë pra që nuk' e
njihni edhe e adhuroni, këtë po u dëftenj
24 unë juve. Perëndia që bëri botënë edhe gji-
thë sa *janë* nd' atë, ky, dyke qënë Zot i
qiellit edhe i dheut, nukë rri ndër tempuj
15 të-bërë me dorë, As nukë shërbenetë prej
duarsh njerësve, sikurse ka nevojë për ndo-
një gjë, sepse ay u ep të-gjithëve jetë edhe
26 frymë edhe të-gjitha. Edhe bëri prej një
gjaku çdo komp njerëzish, që të rrinë mbi
gjithë faqen' e dheut, edhe urdhëroj kohëratë
që i ka vënë ndë radhë që përpara, edhe
27 sinorët' e të-ndënjurit t' atyre; Që të kërko-
njënë. Zotinë, mbase muntnjënë t'a pjekën'
edhe t' a gjenjënë, ndonëse *ay* s' është lark
28 prej sicilitdo prej nesh; Sepse me anë t'
ati rrojmë, edhe lëvizimë, edhe jemi, sikun-
drë edhe ca nga vjershëtorëtë t' uaj kanë
29 thënë, „Sepse edhe jemi far' e ati.“ Dyke
qënë pra far' e Perëndisë, nukë duhetë të
pandejmë se Perëndia ka të-gjarë me ar a
me ergjënt a me gur, latuarë me mjeshteri

30 e çpikje njeriu. Perëndia pra, i-cili nukë
vuri re kohërat' e paditjesë, tashi porosit
gjithë njerëzitë mbë çdo vënt të pendonenë;
31 Sepse ndau një ditë, mbë të-cilënë dotë gjy-
konjë botënë me drejtëri me anë të një nje-
riu, të-cilinë e ndau *për këtë*, edhe dha të-
vërtetuarë mbë të-gjithë për këtë, dyke ngja-
llur' atë prej së-vdekurish.
32 Edhe ata kur dëgjuanë të-ngjallurë prej
së-vdekurish, ca e përqeshninë, po ca thanë,
33 Dotë të dëgjojmë përsëri për këtë *gjë.* Edhe
34 kështu Pavli dolli nga mezi i atyreve. Edhe
ca burra i ungjitnë, edhe besuanë; ndër mest
t' atyre ishte edhe Dhionis Areopagjiti, edhe
një grua që quhej Dhamaridhë, edhe të-tjerë
bashkë me ata.

Krye 18.

1 Edhe pas këtyre Pavli si iku nga Athi-
2 na, erdhi ndë Korinthë; edhe si gjeti një
Judhe që quhej Aqillë, lindurë ndë Pont,
e ardhurë rishtazi nga Italia me gruan' e ti
Prisqillë, (sepse Kllavdiu kishte urdhëruarë
të ikënjënë gjithë Judhenjtë nga Roma,) er-
3 dhi tek ata; Edhe passi kishte gjithatë mje-
shtëri, mbeti përan' atyreve edhe punonte; sep-
se mjeshtëria e atyre ishte të bënjënë tenda.
4 Edhe fliste ndë sinagogjit çdo të-shëtunë,
edhe u mbushte mëndjenë Judhenjve e Gre-
5 kërve. Edhe Sila e Timotheu kur sbritnë

BKSH

nga Maqedhonia, Pavli shtrëngonej ndë
shpirtt, e epte dëshmim mbë Judhenjtë, se Jisuj
është Krishti.
6 Po me-qënë-që ata i rrininë kundrë edhe
shaninë, shkundi rrobat' e tia, e u tha atyre,
Gjaku juaj *qoftë* mbi kryet t' uaj; unë jam i-
kulluarë; që tashi *e tutje* dotë vete ndëpër
kombet.
7 Edhe si iku s' andejmi, erdhi ndë shtë-
pit të një *njeriu* që quhej Just, i-cili druan-
te nga Perëndia, edhe shtëpi' e ati ishte ngji-
8 turë për krahë me sinagogjinë. Edhe Krispi
i-par' i sinagogjisë, i besoj Zotit me gjithë'
shtëpin' e ti; edhe shumë veta prej Korin-
thianëvet dyke dëgjuarë besonin' edhe pagëzo-
9 neshinë. Edhe Zoti i tha Pavlit natënë me anë
të-fanituri, Mos ufrikëso, po folë, edhe mos
10 pusho; Sepse unë jam bashkë me ty, edhe
asndonjë nukë dotë vërë dorë mbi ty, që të të
bënjë keq; sepse kam shumë llaus ndë këtë qy-
11 tet. Edhe ndënji *atje* një mot e gjashtë muaj,
dyke mësuarë atyre fjalën' e Perëndisë.
12 Edhe kur ishte Galileoni guvernator i
Ahaisë, Judhenjtë me një zëmërë ungritnë
kundrë Pavlit, edhe e prunë ndë gjykatoret,
13 Dyke thënë, Se ky u mbush mëndjenë nje-
rësvet të adhuronjënë Perëndinë kundrë no-
14 mit. Edhe kur Pavli dotë hapënte gojënë
Galileoni u tha Judhenjet, Po të ishte ndo-
një punë paudhërie a *ndonjë* pun' e-keqe, o

Judhenj, dotë kishnjam ngajë t'u duronj juve;
15 Po ndë është çështje për fjalë e për emëra
e për nomnë t' uaj, vështro-e-ni ju vetë;
sepse unë s' dua të jem gjykatës i këtyre
16 *punërave.* Edhe i përzuri ata nga gjykatoreja.
17 Edhe gjithë Grekëritë zunë Sostheninë, të-
parin' e sinagogjisë, edhe e rrihninë, përpara
gjykatoresë; Edhe Galileoni asfare s' donte
të dinte për këto.

18 Edhe Pavli, passi priti edhe mjaft dit,
u la shëndet vëllezërvet, edhe lundroj për
ndë Syri, edhe bashkë me atë Prisqilla edhe
Aqilla, passi qethi kryetë ndë Qenhre; sep-
19 se e kishte bërë kusht(*). Edhe arriti nd'
Efesë, edhe ata i la aty, po vetë hyri ndë
20 sinagogjit, e fliste me Judhenjtë. Edhe ata
i ulutnë të mbetetë më tepërë kohë përan'
21 atyreve, po nuk' ubint; Po u la shëndet aty-
re, dyke thënë, Pa fjalë duhetë t' a bënj të-
kremtenë që vjen ndë Jerusalim, edhe dotë
kthenem përsëri te ju, ndë dashtë Perëndia.
22 Edhe lundroj prej Efesësë. Edhe si dolli mbë
tokë ndë Qesari, hipi *ndë Jerusalim,* edhe si
përshëndoshi kishënë, sbriti ndë Antiohi.
23 Edhe passi ndënji ca kohë *atje,* dolli e
shkonte me radhë ndëpër gjithë vëndin' e
Gallatisë edhe të Frygjisë, dyke forcuarë
gjithë nxënësitë.

(*) = e kishte taksurë.

BKSH

24 Edhe një Judhe që quhej Apollo, lindurë
nd'Aleksandri, i-cili ishte njeri i-zoti ndë
fjalët edhe i-fortë ndë shkronjat, sbriti ndë E-
25 fesë. Ky ishte i-mësuarë ndë udhët të Zotit,
edhe, i-nxehëtë ndë shpirtt, fliste e mësonte
hollë hollë punërat'e Zotit, dyke diturë ve-
26 tëmë pagëzimn'e Joanit. Edhe ky zuri të
flasë me kuxim ndë sinagogjit. Edhe Aqilla
e Prisqilla, kur e dëgjuan'atë, e muarnë me
vetëhe, edhe i dëftyen' udhën' e Perëndisë
27 më çkoqurë. Edhe passi donte të shkonjë nd'
Ahai, vëllezërit'u shkruanë nxënëset e i këshi-
lloninë t'a presënë; i cili, kur erdhi, u ndihu
shumë atyreve që kishinë besuarë me anë
28 të hirit. Sepse me shume fuqi u'a sbulonte
Judhenjvet ndër syt të botësë, dyke dëftyerë
me anë të shkronjavet, se Jisuj është Krishti.

Krye 19.

1 Edhe kur ishte Apolloj ndë Korinthë, Pavli,
passi shkoj ndëpër anët të-sipërme, erdhi
2 ndë Efesë; edhe si gjeti *atje* ca nxënës, U tha
atyre, A muartë Frymë të-Shënjtëruarë, kur
besuatë? Edhe ata i thanë, Po as nukë kemi
3 dëgjuarë ndë ka Frymë të-Shënjtëruarë. E-
dhe ay u tha atyre, Mbë se pra upagëzuatë?
Edhe ata i thanë, Ndë pagëzimt të Joanit.
4 Edhe Pavli tha, Joani pagëzoj pagëzim
pendimi, dyke thënë lauzit t'i besonjënë
ati që dotë vinte pas ati. do-me-thënë, Jisu

BKSH

5 Krishtit. Edhe ata si dëgjuanë, upagëzuanë
6 mb'emërit të Zotit Jisu. Edhe si vuri Pavli
duartë mbi ata, erdhi Frym' e-Shënjtëruarë
mbi ata, edhe flisninë gjuhëra e profitepsninë.
7 Edhe gjithë këta ishinë sindonja dy-mbë-
dhjetë burra.
8 Edhe si hyri ndë sinagogjit, u fliste me
kuxim, dyke kuvënduarë tre muaj me radhë,
e dyke mbushurë mëndjen' atyre për punët'
9 e mbretëris' së Perëndisë. Po ca nga ata
passi ashpëroneshinë e s'u mbushej mëndja,
edhe flisninë keq për udhën' e Zotit përpara
gjindjesë, ulargua nga ata, edhe ndau nxë-
nësitë, dyke kuvënduarë përdita ndë skolit
10 të njëj *që quhej* Tyran. Edhe kjo ubë dy
vjet me radhë; kaqë sa gjith' ata që rrininë
nd'Asi, Judhenj e Grekër, dëgjuanë fjalën' e
11 Zotit (Jisu). Edhe çudira të-mëdha bënte Perën-
12 dia me anë të duarvet të Pavlit, Kaqë sa edhe
mbi të-sëmurët shpininë mafesë a përparje
nga trupi i ati, edhe sëmundjetë ikninë nga
ata, edhe frymat' e-liga dilninë nga ata.
13 Edhe ca nga ata Judhenjtë përgjërimtarë
që vininë vënt mbë vënt zunë të zënë n'
gojë emërin' e Zotit mb'ata që kishinë fry-
ma të-liga, dyke thënë, U përgjërojmë juve
14 mbë atë Jisunë që lëçit Pavli. Edhe ata që
bëninë këtë ishinë shtatë bij të një Judheu
15 kryeprift *që quhej* Sqeva. Edhe frym' e-ligë
upërgjeq e tha, Jisun' e njoh, edhe Pavlin' e

16 di; po ju cilëtë jini? Edhe ay njeriu, tek i-
cili ishte frym' e-ligë, uhoth mbi ata, edhe
si i mundi, dolli i-fortë kundr' atyreve kaqë
sa *ata* lakuriq e të-plagosurë iknë prej shtë-
17 pis' s'ati. Edhe këjo ubë e-diturë mbë të-gjithë
Judhenjt'e Grekëritë që rrininë nd'Efesë: edhe
ra frikë mbë gjith' ata, edhe madhëronej e-
18 mëri i Zotit Jisu. Edhe shumë nga ata që
kishinë besuarë vininë dyke rrëfyerë e dyke
19 treguarë punët' e tyre, Edhe mjaft veta nga
ata që bëninë magjitë bininë librat' e tyre,
e i diqninë përpara të gjithëve; edhe passi
numëruanë të-çëmuarat' e atyreve, i gjetnë
se vëjeninë pesë-dhjetë mijë *copë* ergjëndi.
20 Kështu fort shtonej e forconej fjal'e Zotit.
21 Edhe si umbaruanë këto, Pavli e vuri
ndër mëntt, passi të shkonjë ndëpër Maqe-
dhoni e ndëpër Ahai, të vejë ndë Jerusalim,
e tha, Se si të vete atjë, duhetë të shoh e-
22 dhe Romënë. Edhe dërgoj ndë Maqedhoni dy
veta nga ata që i shërbeninë, Timothenë
edhe Erastinë, po ay vetë mbeti ca kohë nd
Asi.
23 Edhe nd' atë kohë ubë jo pak trazyrë
24 për *këtë* udhë. Sepse një argjëndar që qu-
hej Dhimitër, dyke bërë tempuj t'ergjënttë
të Artemidhësë, u epte mjeshtërvet jo pak
25 fitim. *Ky* si mblodhi këta, edhe ata që pu-
noninë të-këtillatë, tha, O burra, dini mirë
26 se prej kësaj pune është pasja jonë; Edhe

vini re e dëgjoni, se shumë llauzi jo vetëmë
të Efesësë, po edhe të gjithë Asisë po-thua,
ky Pavli u mbushi mëndjenë e i ktheu, dyke
thënë, se nukë janë perëndira ata që bënenë
27 me duar. Edhe jo vetëmë këjo mjeshtëria
jonë është mbë rrëzik të bjerë poshtë, po
edhe tempulli i perëndeshës' së-madhe Ar-
temidhë të mos zihetë për gjë, edhe dotë
humbasë madhëria e asaj, të-cilënë gjith'
Asia edhe bota e nderon.
28 Edhe *ata* kur dëgjuanë, umbushnë me
zëmërim, e bërtisninë dyke thënë, E-ma-
29 dhe *ësht'* Artemidha e Efesianëvet. Edhe tërë
qyteti umbush me trazyrë; edhe si rrëmbyenë
Gainë edhe Aristarhunë, *njerës* Maqedhonas
që ishinë shokë të-Pavlit ndë *këtë* udhë, u-
30 sulnë me një zëmërë ndë theatrët. Edhe Pavli
kur donte të hynjë ndë mest të gjindjesë,
31 nxënësitë nuk' e lininë. Edhe ca nga të-
mëdhenjt' e Asisë, që ishinë miq t'ati, dër-
guanë tek ay edhe i luteshinë të mos dalë
32 ndë theatrët. Të-tjerë pra thërrisninë *për* një
gjë, e *të-tjerë për tjetërë*; sepse përmbledhja
ishte trazuarë fort, edhe më të-shumëtë nukë
dininë për se ishinë mbledhurë.
33 Edhe prej gjindjesë nxuarnë përpara Ale-
ksandrinë *që të fliste*, sepse Judhenjtë e ki-
shinë vënë përpara, edhe Aleksandri tundi
34 dorënë e deshi t'i apë fjalë gjindjesë. Po passi
e njohnë se është Judhë, ubë një zë nga të-

BKSH

gjithë, dyke bërtiturë afëre dy orë, E-madhe
është Artemidha e Efesianëvet.
35 Edhe shkronjësi i *qytetit*, si sbuti gjindjenë,
thotë, O burra Efesianë, cili njeri ësht' ay që
nukë di, se qytet' i Efesianëvet i shërben
tempullit të perëndeshës' së-madhe Artemidhë
36 edhe idhullit që sbriti nga Ënëti? Passi pra
këto janë të-pakundrështuarshimë, ju duhetë
të rrini urtë, e asgjë të mos bëni me të-
37 rrëmbyerë. Sepse keni prurë këta njerës, të-
cilëtë as gjë kishe kanë vjedhurë, as perën-
38 deshënë t'uaj kanë sharë. Ndë qoftë pra se
Dhimitri edhe mjeshtëritë që janë bashkë
me atë kanë fjalë kundrë ndonjë *njeriu*, ka
dit gjyqi, ka edhe gjykatës; letë ngrenë njeri
39 tjatërinë. Po ndë kërkoni gjë për të-tjera
çështje, *këjo* dotë sgjidhetë ndë përmbledhjet
40 që është pas nomit. Sepse jemi ndënë rrëzik
të përflitemi si krye-ngritës për trazyrën' e-
sorme, sepse s'ka ndonjë farë ngaje me anë
të së-cilësë të muntnjëmë të apëmë fjalë për
41 këtë trazyre. Edhe dyke thënë këto, lëshoj
përmbledhjenë.

Krye 20.

1 Edhe passi pushoj trumbullimi, Pavli thë-
rriti nxënësit' e upërshëndosh me ata, edhe
2 dolli të vejë ndë Maqedhoni. Edhe si shkoj
ndëpër ato anë, e i ngushëlloj me shumë
fjalë, erdhi ndë Greqi.

3 Edhe bëri atje tre muaj. Edhe passi ubë
kundr' ati prej Judhenjet një pritë, kur ishte
për të lundruarë për ndë Syri, uvendos të
4 kthenetë me anë të Maqedhonisë. Edhe i
vate pas gjer nd'Asi Sopatër Verieasi; edhe
nga Thessallonikasitë Aristarhu edhe Sekundi
edhe Gaiu nga Derva, edhe Timotheu; edhe
5 nga Asianëtë Tyhiku edhe Trofimi. Këta vanë
më parë, edhe na prisninë ndë Troadhë.
6 Edhe neve lundruamë nga Filippëtë pas dit-
vet të pabrumjevet, edhe për pesë dit erthmë
tek ata ndë Troadhë, ku ndënjmë shtatë dit.
7 Edhe *ditën'* e-parë të javësë, kur ishinë
mbledhurë (nxënësitë) për të thyerë bukënë,
Pavli kuvëndonte me ata, sepse kishte për
të ikurë mbë të-nesërmet; edhe e sgjati
8 fjalënë gjer ndë mest të natësë. Edhe ndë
dhomët të-sipërme, *atje* ku ishinë mbledhurë,
9 ishinë mjaft qirinj të-ndezurë. Edhe një dja-
losh që quhej Eftyh, dyke ndënjurë mbi pa-
rathiret, e mori një gjum' i-rëndë, tek po
kuvëndote Pavli gjer' e gjatë, edhe si e zuri
gjumi, ra përposh prej patit të-tretë, edhe e
10 ngritnë të-vdekurë. Edhe Pavli, si sbriti, ra
mbi atë, edhe, si e pushtoj, tha, Mos trum-
bullohi; sepse shpirti i ati është nd' atë.
11 Edhe si hipi e theu bukë e hëngri, e foli
mjaft gjer mbë të-sbadhëlluerit, pastaj shkoj.
12 Edhe prunë djalinë të-gjallë, edhe ungushë-
lluanë fort tepërë.

BKSh

13 Edhe neve vamë më -parë ndë lundrët,
edhe lundruamë për ndë Assë, edhe andej
dotë merrnimë Pavlinë; sepse kështu kishte
porositurë, sepse ay donte të vij mbë këmbë.
14 Edhe si upoq me ne nd'Assë, e muarm' e
15 erthmë ndë Mitylinë; Edhe që andej lundru-
amë, edhe mbë të-nesërmet erthmë kundruell
Hiosë; edhe *ditënë* tjetërë arritmë ndë Samë;
edhe si mbetnë ndë Trogjyli, mbë të-nesër-
16 met erthmë ndë Militë. Sepse Pavli e kishte
parë të udhësë të lundronjë ndëpër anët të
Efesësë *pa dalë atje*, që të mos e humpte
kohënë nd'Asi; sepse nxitonte, ndë ishte
e-mundurë *punë* për atë, ditën'e Pentikostisë
të gjendetë ndë Jerusalim.
17 Edhe prej Militësë dërgoj nd'Efesë, e thi-
18 rri pleqt' e kishësë. Edhe *këta* kur erthnë tek
ay, u tha atyre, Ju e dini që ditën'e parë që
shkela ndë Asi, se qysh e shkova gjithë ko-
19 hënë bashkë me ju, Dyke shërbyerë Zotit me
çdo zëmërë të-përunjurë e me shumë lot e me
ngasje, të-cilatë më gjanë me anë të këshilla-
20 vet të-liga të Judhenjet kundrë meje; *Edhe* se
nukë fsheha gjë nga ato që ishinë për të-
mirënë *t'uaj*, po u'a dëfteva juve, e u'a më-
sova juve ndër syt të botësë e ndëpër shtë-
21 pirat, Dyke dhënë dëshmim mbë Judenj e mbë
Grekër për pendimnë mbë Perëndinë, edhe
për besënë mbë Zotinë t'ënë Jisu Krisht.
22 Edhe tashi ja unë tek po vete ndë Jerusalim

BKSH

lidhurë ndë shpirtt, pa mos diturë seç pu-
23 nëra më kanë për të gjarë nd' atë, Përveç
se Frym' e-Shënjtëruarë ep dëshmim mbë çdo
qytet, dyke thënë, se po më presënë të-li-
24 dhura e shtrëngime. Po s' dua të di asfare
për ndonjë *nga këto*, as jetënë t'ime s'e
kam të-çëmuarë ndë vetëhet t'ime *kaqë*, sa
të mbaronj udhënë t'ime me gëzim, edhe atë
shërbesënë që mora prej Zotit Jisu, të ap dë-
25 shmim për ungjillin' e hirit të Perëndisë. Edhe
tashi ja unë tek e di, se më s' e kini për të
parë faqenë t' ime ju të-gjithë, ndë mest te
të-cilëvet shkova dyke lëçiturë mbretërin' e
26 Perëndisë. Përandaj ap dëshmim mbë ju sot
mbë këtë ditë, se unë jam i-qëruarë nga
27 gjaku i të-gjithëve. Sepse unë nuk' uhoqa që
të mos u rrëfenj juve gjithë ëndën' e Perën-
28 disë. Kini pra kujdes për vetëhenë t' uaj, edhe
për gjithë tufënë, mbë të-cilënë Frym' e-Shënj-
tëruarë u vuri juve kujdestarë, që të kullotni
kishën' e Perëndisë, të-cilën' e fitoj me gja-
29 kun' e ti. Sepse un' e di këtë, se pas të-iku-
rit t' im kanë për të hyrë ndër ju ujqër të-
këqinj, të-cilëtë s' e kanë për të kursyerë tu-
30 fënë. Edhe prej jush vetë dotë ngrihenë nje-
rës dyke folurë *gjërëra* të-shtrëmbëra, që të
31 heqnjënë nxënësitë pas vetëhes' së tyre. Për-
andaj rrini sgjuarë, e sillni ndër mëntt, se tre
vjet nat' e ditë s' pushova dyke mësuarë me
32 lot gjithë-sicilinë. Edhe tashi, o vëllezër, u

lë juve te Perëndia, edhe te fjal' e hirit t'ati,
i-cili munt t'u ndërtonjë e t'u apë juve tra-
shëgim ndër mest të gjith' atyreve që janë të
33 shënjtëruarë. Ergjënt a ar a rrobë as prej
34 ndonjëj *prej jush* nukë dëshërova. Edhe ju
vetë e dini, se këto duart' e mia kanë pu-
nuarë për nevojat' e mia edhe për ata që
35 ishinë bashkë me mua, Mbë të gjithë *punë-
rat* u dëfteva juve, se kështu dyke mundu-
arë duhetë t' u ndihni të-pafuqishimvet, edhe
të kujtoni fjalët' e Zotit Jisu, se ay vetë tha,
„M'e-madhe lumëri është të apë *njeriu* se
të marrë."
36 Edhe si tha këto, uunj mbë gjunjë, e u-
37 fal bashkë me ata të-gjithë. Edhe ata të-gji-
thë qanë mjaft, edhe ranë mbë qafët të Pav-
38 lit, edhe e puthninë; Edhe hidhëroneshinë
fort për fjalënë që kishte thënë, Se s' kanë
për te parë më faqen' e ati. Edhe e përcill-
ninë ndë lundrët.

Krye 21.

1 Edhe si undamë nga ata, lundruam'e dyke
marrë udhënë drejt erthmë ndë Ko, edhe di-
tënë tjetërë ndë Rodhë, edhe që andej ndë
2 Patara. Edhe si gjetmë një lundrë që kishte
për të shkuarë ndë Finikë, hipmë *mb' atë* e
3 lundruamë. Edhe kur pamë për së-largu
Qyprënë, edhe e lamë mbë të-mëngjërë, lun-
druamë për ndë Syri, edhe duallmë ndë Tyrë;

BKSH

sepse atje lundra kishte për të çkarkuarë
4 barrën' *e saj*. Edhe si gjetmë nxënësitë, mbetm'
atje shtatë dit; edhe ata i thoshinë Pavlit me
anë të Frymësë, të mos hipënjë ndë Jerusa-
5 lim. Edhe si mbaruam' *ato* dit, duallm' e
shkonimë, edhe *ata* të-gjithë me gra e me fë-
mijë na përcillninë gjer jashtë qytetit; edhe
si uunjmë mbë gjunjë ndë buzët të detit,
6 ufalmë. Edhe si përshëndoshmë njëri tjatrinë
hipmë ndë lundrët, edhe ata ukthyenë ndë-
për *shtëpirat* të tyre.
7 Edhe neve si mbaruamë të-lundruarëtë
prej Tyrësë arritmë ndë Ptolemaidhë, edhe
si përshëndoshmë vëllezëritë, mbetmë një ditë
8 përan' atyreve. Edhe mbë të-nesërmet (neve
që ishimë bashkë me Pavlinë) duallm' e erth-
më ndë Qesari, edhe si hymë ndë shtëpit të
Filipp Ungjilltarit, që ishte një nga të shta-
9 tëtë, mbetmë përan' ati. Edhe ky kishte katrë
10 bija vërgjëresha që profitepsninë. Edhe tek
ishimë ne dyke mbeturë *atje* mjaft dit, sbriti
11 nga Judhea një profit që quhej Agaf; Edhe
si erdhi ndër ne, mori brezin'e Pavlit, edhe
si lidhi duart' e këmbët' e tia tha, Këto thotë
Frym' e-Shënjtëruarë, Kështu dota lithnjënë
Judhenjtë ndë Jerusalim atë burrë, i të-cilit
është ky bres, edhe dot' a apënë ndër duart
12 të kombevet. Edhe kur dëgjuamë këto, i lute-
shimë edhe ne edhe vëndësitë të mos hipë-
13 një ay ndë Jerusalim. Po Pavli upërgjeq,

Ç' bëni *kështu* dyke qarë e dyke copëtuarë
zëmërënë t' ime? sepse unë jam gati jo ve-
tëmë të lidhem, po edhe të vdes ndë Jerusa-
14 lim për emërin' e Zotit Jisu. Edhe passi nuk'
i mbushej mëndja, pushuamë, dyke thënë,
15 Letë bënetë dashurimi i Zotit. Edhe pas kë-
tyre ditve bëmë gati plaçkatë e hipmë ndë
16 Jerusalim. Edhe erthnë bashkë me ne edhe
ca nxënës nga Qesaria, edhe prunë një farë
Mnasoni Qyprian, një nxënës të-vjeterë, ndë
shtëpit të të-cilit dotë binimë.
17 Edhe neve si erthmë ndë Jerusalim, vë-
18 llezëritë na pritnë me gëzim. Edhe *ditënë*
tjatërë Pavli vate bashkë me ne te Jakovi;
19 edhe erthnë gjithë pleqtë. Edhe si përshën-
doshi ata, u dëftente atyre një nga një *gji-*
thë sa bëri Perëndia ndër kombet me anë
20 të shërbesës' s' ati. Edhe ata kur dëgjuanë,
lavduroninë Zotinë; edhe i thanë, Sheh, o
vëlla, sa shumë mijëra Judhenjç janë që kanë
besuarë; edhe të-gjithë janë zilitarë të no-
21 mit. Edhe muarnë vesh për ty, se mëson
gjithë Judhenjtë që janë ndër kombet të lar-
gonenë prej *nomit të* Moisiut, dyke thënë, të
mos rrethpresnjënë djemtë, as të mos ecë-
22 njënë pas zakonëvet. Çë pra? Pa fjalë shu-
mica dotë mblidhetë, sepse dotë dëgjoniënë,
23 se ke ardhurë. Bëj pra këtë që të themi.
Janë ndër ne katrë burra, që kanë kusht
24 mbi vetëhet të tyre; Merr këta edhe që-

rohu bashkë me ata, edhe prish për ata,
që të rruanjënë kryetë, edhe të-gjithë t' a
dinë se s' janë gjë ato që kanë dëgjuarë për
ty, po *se* edhe *ti* vetë je dyke ruajturë gji-
25 thënjë nomnë? Sa për ata kombetë që kanë
besuarë, neve u shkruajtmë, passi e pamë
të udhësë ata të mos ruanjenë asgjë të-
këtillë, veç se të ruhenë prej kurbanëvet të i-
dhujvet edhe prej gjakut edhe prej gjës' së-
26 mbyturë edhe prej kurvërisë. Atëhere Pavli
mori me vetëhe *ata* burratë, edhe ditënë tje-
tërë, si uqërua bashkë me ata, hyri ndë hie-
roret, edhe ep ze, kur mbushenë ditt' e të-
qëruarit, kur dotë bihej dhurëti për sicilinë-
do nga ata.
27 Edhe kur ishinë për të mbushurë të shta-
të dittë, ata Judhenjtë që ishinë nga Asia,
kur e pan' atë ndë hieroret, përzjenë gjithë
28 gjindjenë, edhe vunë duartë mbi atë, Dyke
bërtiturë, O burra Israilitë, ndih-na-ni; ky
ësht' ay njeriu që mëson kudo gjithë *njerëzi-
të* kundrë llauzit edhe nomit edhe këti vën-
di; edhe përmbi këto edhe Grekër kalli ndë
hieroret, edhe pëgëri ketë vënt të-shënjtëru-
29 arë. (Sepse) kishinë parë më parë Trofim
Efesianinë bashkë me atë ndë qytett, të-cilinë
pandehninë se Pavli e kishte kallurë ndë hie-
30 roret.) Edhe utunt gjithë qyteti, edhe umbloth
llauzi; edhe si zunë Pavlinë, e hoqnë jashtë
hieroresë; edhe për-një-here umbyllnë dyertë.

31 Edhe tek kërkoninë t'a vrisninë, vatë fjala
te kryemijësi i tufës' s' ushtëtorevet, se gji-
32 thë Jerusalimi është përzjerë; I-cili për-një-
here mori me vetëhe ushtëtorë e kryeqin-
dës, e usul poshtë mbi ata. Edhe ata kur
panë kryemijësin' edhe ushtëtorëtë, pushu-
33 anë se-rrahuri Pavlinë. Atëhere kryemijësi
uaférua, edhe e zuri, edhe urdhëroj të lidhe-
të me dy vargje *hekurash*, edhe pyeste, cili
34 ishte *ay*, edhe ç' kishte bërë. Edhe ndër mest
të gjindjesë bërtisninë *ca për një*, e të-tjerë
për-tjetërë *punë*; edhe passi nukë mundi të
marrë vesh të-vërtetënë për trazyrënë, urdhë-
35 roj të silletë ndë fortesët. Edhe kur erdhi
ndë shkallët, për shtrëngatënë nga an' e gjin-
djese gjau ushtëtorëtë t' a mbanjë ndër
36 duart. Sepse shumic' e llauzit vinte pas dyke
bërtiturë, Ngrij-e atë.
37 Edhe Pavli kur dotë hynjte ndë fortesët,
i thotë kryemijësit, A më ndjenetë diç të të
38 them? Edhe ay tha, A di Gërqisht? Vallë
mos je ti ay Egjyptiani, që ngriti krye para
këtyre ditve edhe nxori ndë shkretëtirët ka-
39 trë mijë njerës gjakësore? Edhe Pavli tha,
Unë jam një njeri Judhe nga Tarsa, qytetës
i një qyteti me emërë të Qiliqisë; edhe të
40 lutem, ep-më lejë t' i flas llauzit. Edhe ay si
i dha lejë, Pavli qëndroj mbi shkallët, i beri
llauzit; shënjë me dorë edhe si ubë pushim
i-math, foli ndë gjuhë Ebraishte, dyke thënë,

BKSH

Krye 22.

1 O burra vëllezër edhe atër, pa më dë-
gjoni dyke drejtëruarë vetëhenë t'ime përpara
2 jush. (Edhe kur dëgjuanë, se u fliste atyre
ndë gjuhë Ebraishte, pushuanë më tepërë;
edhe thotë,)
4 Unë jam një njeri Judhë, lindurë ndë Tar-
së të Qiliqisë, edhë rriturë ndë këtë qytet pë-
ranë këmbëvet të Gamaliilit, mësuarë me
kujdes ndë nomt të atërvet, edhe ishnjam
zilitar për Perëndinë, sikundrë ju të-gjithë
4 jeni sot; Edhe këtë udhë e ndoqa gjer mbë
vdekje, dyke lidhurë e dyke dhënë ndër
5 burgje burra e gra; Sikundrë edhe kryeprifti
ep dëshmin për mua, edhe gjithë pleqësia;
prej të-cilëvet mora edhe kartëra për vëlle-
zëritë, e vinja ndë Dhamaskë, që të binja të-
lidhurë edhe ata që ishin' atje, që të mun-
6 doneshinë. Edhe dyke bërë udhë tek afëro-
nesha ndë Dhamaskë, afëro nga mesi i
ditësë, papandehuraj prej qielli vetëtiti një
7 drit' e-madhe rreth meje; Edhe *unë* rashë
përdhe, edhe dëgjova një zë që më thoshte
Saull, Saull, përse më ndjek? Edhe un' u-
8 përgjeqçë, Cili je *ti*, o Zot? Edhe ay më tha,
Unë jam Jisu Nazoreasi, të-cilinë ti ndjek.
9 Edhe ata që ishinë me mua dritën' e panë
edhe utrëpnë fort; po zën' e ati që më fliste
10 nuk' e dëgjuanë. Edhe *unë* thashë, Ç'të bënj

BKSH

o Zot? Edhe Zoti më tha, ngreu edhe shko
ndë Dhamaskë; edhe atje dotë të flitetë për
11 gjithë sa jan' urdhëruarë të bënjç. Edhe passi
nukë shihnjam nga ndriçim' i asaj drite,
dyke uhequrë prej dore nga ata që ishinë
bashkë me mua erdha ndë Dhamaskë.
12 Edhe një farë Ananie, njeri besëtar pas
nomit, e me dëshmim të-mirë prej gjithë Ju-
13 dhenjvet që rrinin' *atje*, Erdhi tek unë edhe
ndënji përpara, e më tha, Saull, o vëlla, hap
sytë; edhe unë ndë gjithatë orë hapa sytë
14 edhe e pash' atë. Edhe ay tha, Perëndia i
atërvet t'anë të sgjodhi të njohç dashurimn'
e ati, edhe të shohç të-Drejtinë, edhe të dë-
15 gjonjç zë prej gojës' s' ati; Sepse dotë jesh
dësmimtar i ati mbë gjithë njerëzitë për sa
16 pe e dëgjove. Edhe tashi ç'sillesh? ngreu e
pagëzohu, e lahu nga fajet' e tu, dyke thë-
rriturë emërin' (e Zotit).
17 Edhe passi ukthyeshë ndë Jerusalim, tek
ishnjam dyke faluré ndë hieroret, arçë mbë
18 të-habiturë, Edhe e pash' atë dyke thënë
mua, Nxito, edhe dil çpejt nga Jerusalimi;
sepse s' e kanë për të priturë dëshmimnë
19 t'ënt për mua. Edhe unë thashë, Zot, ata e
dinë, se unë ishnjam ay që vinjam ndë burk
e që rrihnjam ndëpër sinagogjit ata që be-
20 soninë mbë ty. Edhe kur derdhej gjaku i
Stefanit, dëshmimtarit t'ënt, edhe unë vetë
ishnjam atje përpara, e dyke pëlqyerë vra-

sjen' e ati, edhe ruanjam rrobat' e atyreve
21 që e vrisninë. Edhe më tha, Shko; se unë
të kam për të dërguarë ndër kombe lark.
22 Edhe gjer mbë këtë fjalë e dëgjoninë; po
atëhere ngritnë zën' e tyre, dykë thënë, Ngrij-e
prej dheut të-tillinë *njeri*; sepse nukë duhetë
23 të rronjë. Edhe me-qënë-që ata bërtisninë,
edhe shkuntninë rrobat' *e tyre* edhe hithninë
24 pluhurë ndëpër erët, Kryemijësi urdhëroj të
silletë ndë fortesët, edhe tha t'a pyesënë me
të-rrahura, që të marrë vesh për ç'ngajë
25 bërtisninë kështu kundrë ati. Edhe si e shtriti
të-lidhurë me ripa, Pavli i thotë kryeqindësit
që rrinte atje, Eshtë vall' e udhësë mbë ju
26 të rrihni një njeri Roman, edhe pa gjykuarë?
Edhe kryeqindësi kur dëgjoj *këto*, vate e i
dëfteu kryemijësit, dyke thënë, (Shiko) ç'je
27 dyke bërë; sepse ky njeri është Roman. Edhe
kryemijësi erdhi e i tha, Thuaj-më, Ro-
28 man je ti? Edhe ay tha, Po. Edhe kryemi-
jësi upërgjeq, Unë me shumë aspra e fitova
të-drejtën' e të-qënurit qytetës *Roman*. Edhe
Pavli tha, Po unë edhe kam lindurë *Roman*.
29 Për-një-here pra uhoqnë prej ati ata që dot'a
mundoninë. Po edhe kryemijësi ufrikësua,
se mori vesh, se është Roman, edhe sepse
e kishte lidhurë.

30 Edhe mbë të-nesërmet dyke dashurë të
marrë vesh të-vërtetënë, për ç'punë përflitetë
nga Judhenjtë, e sgidhi (nga të-lidhuratë),

edhe urdhëroj të vinjënë kryepriftërit' edhe
gjithë bashkëndënja e atyreve; edhe sbriti
Pavlinë, edhe e vuri përpara atyreve.

Krye 23.

1 Edhe Pavli shtyri sytë ndë bashkëndë-
njet, e tha, O burra vëllezër, unë gjer *sot*
mbë këtë ditë kam ecurë përpara Perëndisë
2 me çdo ndërgjegje të-mirë. Edhe kryeprifti
Anani urdhëroj ata që rrininë përan' ati t' i
3 bjenë gojësë. Atëhere Pavli i tha, Perëndia
dotë të bjerë, o mur i-lyerë me këlqere; e ti
rri të më gjykonjç pas nomit, edhe dyke
4 shkelurë nomnë urdhëron të më bjenë? Edhe
ata që rrininë peranë thanë, Kryepriftin' e
5 Perëndisë shan *ti*? Edhe Pavli tha, Nuk' e
dinja, o vëllezër, se është kryeprift; sepse
është shkruarë, „Mos flaç keq për të-parin'
e llauzit t'ënt".
6 Edhe Pavli si e kupëtoj. se njëra pjesë
ishte prej Sadduqenjsh, edhe tjatëra prej Fa-
risenjsh, bërtiti ndë bashkëndënjet, O burra
vëllezër, Unë jam Farise, *e* bir Fariseu; unë
po gjykonem për shpresë e për të-ngjallu-
7 rit' e të-vdekurvet. Edhe si foli ay këtë, ubë një
zënje ndë mest të Farisenjvet e të Saddu-
8 qenjet, edhe shumica unda *mbë dy*. Sepse
Sadduqenjtë thonë se s' ka të-ngjallurë, as
ëngjëll, as frymë; po Farisenjtë i rrëfenjënë
9 që të dyja. Edhe ubë një trazyr' e-madhe; edhe

shkroηësit' e anës' së Farisenjet ungritnë e
ziheshinë, dyke thënë, Asgjë të-keqe *s'*gjejmë
te ky njeri; po ndë i foli ati *ndonjë* frymë a
ëngjell, letë mos luftojmë kundrë Perëndisë.
10 Edhe passi ubë trazyr' e-madhe, kryemijësi
pati frikë se mos çqyhetë Pavli prej atyre,
edhe urdhëroj të sbresë ushtëria e t'a rrëm-
benjë nga mezi i atyreve, edhe t'a shpjerë
ndë fortesët.
11 Edhe natënë pas *asaj dite* i uduk Zoti e
i tha, Kij zëmërë, Pavel; sepse sikundrë dësh-
move për mua ndë Jerusalim, kështu duhetë
të dëshmojsh edhe ndë Romë.
12 Edhe si ubë ditë, ca nga Judhenjtë ulithnë
me be ndë mest të tyre e nëmnë vetëhen'
e tyre, dyke thënë, as të mos hanë as të
13 mos pinë, gjersa të vrasënë Pavlinë. Edhe
ata që kishinë bërë këtë lidhje me be ishinë
14 më shumë se dyzet *veta*; Të-cilëtë erthnë
te kryepriftërit' edhe te pleqtë, e thanë, Me
nëmë kemi nëmurë vetëhenë t' ënë të mos
ngjëronemi asgjë, gjersa të vrasëmë Pavlinë.
15 Tashi pra ju me bashkëndënjenë epni zë krye-
mijësit t' a sbresë nesërë te ju, sikurse doni
të merrni vesh më mirë punërat' e ati; edhe
neve, para se të afëronet' ay, jemi gati t' a
vrasënë.
16 Po si dëgjoj këtë pritë i bir' i së motrës'
së Pavlit, vate e hyri ndë fortesët, e i dëfteu
17 Pavlit. Edhe Pavli thërriti një nga kryeqin-

dësitë, e tha, Shpier-e-ni këtë djalosh te
kryemijësi; sepse diç i ka për të thënë ati.
18 Ay pra si e mori me vetëhe, e pruri te kry-
emijësi, edhe thotë, Pavli që është ndë burk
më thirri, e *m'* ulut të bje këtë djalosh te ti,
19 sepse diç të ka për të folurë ty. Edhe krye-
mijësi si e mori prej dore, edhe uhoq mbë
nj' anë, e pyeste, Ç' ësht' *ajo* qe më ke për
20 të dëftyerë? Edhe ay tha, Se Judhenjtë lithnë
fjalë të të lutenë që nesërë t' a sbreç Pavlinë
ndë bashkëndënjet, sikurse kanë për të pye-
21 turë gjë më çkoqurë për atë; Po ti mos u
dëgjo atyre: sepse e presënë ndë pritë atë
më shumë se dyzet *veta* prej atyreve, të-
cilëtë kanë nëmurë vetëhen' e tyre, as të mos
hanë as të mos pinë, gjersa t'a vrasën' atë;
edhe tashi janë gati dyke priturë fjalë
prej teje.
22 Kryemijësi pra e lëshoj djaloshinë, dyke
porositurë atë, Mos i thuajsh asnjeriu se
23 më dëfteve këto. Edhe thirri dy veta nga
kryeqindësitë, e u tha atyre, Bëni gati dy
qint ushtëtorë për të vajturë gjer ndë Qesari,
edhe shtatë-dhjetë kalorës, edhe dy qint shti-
24 zorë, që mbë të-tretënë orë të natësë. Bëni
gati edhe kafshë, që të hipnjënë Pavlinë, e
t' a shpjenë me siguri te Filik qivernitari.
25 Edhe shkroj një kartë që kishte këto fjalë:
26 „Kllavdiu Lysi mbë të-pushteçiminë qi-
27 vernitar Filik, gëzuash. Këtë njeri që uzu prej

Judhenjet, edhe dotë vritej prej atyre, *unë*
arrita bashkë me ushtërinë edhe e shpëtova,
28 sepse mora vesh se është Roman. Edhe dyke
dashurë të marr vesh për ç'ngajë e përflisninë,
29 e sbrita ndë bashkëndënjet t'atyre; Edhe gjeta
se përflitej për çështje të nomit t' atyre, po
s' ka ndonjë faj për vdekje a për të li-
30 dhurë me hekura. Edhe passi më dhanë zë,
se dotë bënej pritë prej Judhenjet kundrë
njeriut, për-një-here e dërgova te ti, edhe po-
rosita edhe ata që e përflasën' ate të thonë
përpera teje ç' fjalë kanë kundr' ati. Qofsh
me shëndet."
31 Ushtëtorëtë pra, sikundrë qenë urdhëruarë,
muarnë Pavlinë, edhe e prunë natënë ndë
32 Antipatridhë. Edhe mbë të nesërmet, si lanë
kalorësitë të venë bashkë me atë, ukthyenë
33 ndë fortesët; Të-cilëtë si hynë ndë Qesari
edhe dhanë kartënë ndë dorët të qivernarit,
34 nxuarnë përpara ati edhe Pavlinë. Edhe qi-
vernitari si këndoj *kartënë*, edhe pyeti nga ç'
vënt është, edhe kur dëgjoj, se është nga Qi-
35 liqia, Dotë të dëgjonj, tha, kur të vinjën' edhe
ata që të përflasënë. Edhe urdhëroj të ruhetë
ndë gjykatoret të Irodhit.

Krye 24.

1 Edhe pas pesë ditsh sbriti kryeprifti Anani
bashkë me pleqtë e me një farë fjalori *që quhej*
Tertyl, të-cilëtë duallnë përpara qivernitarit

2 kundrë Pavlit. Edhe si uthirr ay, Tertyli zuri
3 të përflasë, dyke thënë, O i-pushteçim Filiks,
shumë prëhje kemi me anë t' ënde, edhe
punëra të-mëdha bënenë mbë këtë komp
me anë të parëkupëtimit t' ënt përherë
edhe mbë çdo vënt, edhe përandaj presëmë
4 *këto* me shumë të-falura ndersë. Po që të mos
të rëndonj tepërë, të lutem të na dëgjonjç pak
5 fjalë me butësirënë t'ënde. Passi e gjetmë
këtë njeri *se është* murtajë, edhe se ngre tra-
zyrë ndër mest të gjithë Judhenjvet që janë
ndëpër botët, edhe se ësht' i-pari i sektës'
6 së Nazoreaset, I-cili edhe hieroranë deshi
t'a ndyrnjë; të cilën' edhe e zumë, edhe
7 deshmë t'a gjykojmë pas nomit t' ënë. Po erdhi
Lysi kryemijësi, edhe na e rrëmbeu prej
8 duarvet me shumë shrtëngim, Dyke urdhëru-
arë që përfolësit' e ati të vinjënë përpara
teje; prej të-cilit ti vetë si t'a pyeç dotë munç
të marrç vesh për gjithë këto që e përflasë-
9 më neve. Rrëfyenë bashkë *me atë* edhe Ju-
dhenjtë, dyke thënë, se këto kështu janë.
10 Atëhere Pavli, passi i bëri shënjë qiver-
nitarit të flasë, upërgjeq, Passi e di, se prej
shumë vietve je gjykatës ndë këtë komp, me
zëmërë më të-gëzuarë ap fjalë për vetëhenë
11 t' ime; Sepse mùnt të marrç vesh, se nukë
janë më tepërë se dy-mbë-dhjetë dit që kur
12 se hipa ndë Jerusalim për të falurë. Edhe as
ndë hieroret më gjetnë dyke kuvënduarë me

BKSH

ndonjë *njeri*, a dyke ngriturë mbë këmbë gjin-
13 djenë, as ndëpër sinagogjit, as ndë qytett; As
munt t'i vërtetonjënë ato gjërëra për të-cilatë
14 më përflasënë ndashti. Po rrëfenj këtë të ti,
se pas udhësë, që *këta* i ɑonë eresi, kështu a-
dhuronj Perëndin' e atërvet të mi, dyke be-
suarë mbë gjith' ato që janë shkruarë ndë
15 nomt e ndë profitërit; Edhe kam mbë Pe-
rëndinë shpresë, të-cilënë edhe këta vetë e
presënë, se dotë bënetë të-ngjalurit' e të-vde-
16 kurvet, të-drejtëvet e të-shtrëmbërvet. Edhe
për këtë unë po përpiqem, që të kem për-
herë ndërgjegje pa faj përpara Perëndisë
17 edhe përpara njerësvet. Edhe *tashi* pas shu-
më vjetve erdha për të bërë kombit t'im ele-
18 imosina edhe dhurata. Po ndër mest të këtyre
gjërërave ca Judhenj nga Asia me gjetnë të-
qëruarë ndë hieroret, jo me shumë gjindje,
19 as me trazyrë; Të cilëtë duhej të dilninë për-
para teje e të më përflisninë, ndë kishinë gjë
20 kundrë meje. A këta vete letë thonë, ndë
gjetnë ndojë të-shtrëmbërë tek unë, kur dolla
21 përpara bashkëndënjesë, Veç *ndë qoftë se më*
përflasënë për këtë të-vetëmë zë, që thërrita
ndër mest t'atyreve, Se për të-ngjallurit' e të-
vdekurvet po gjykonem unë sot prej jush.
22 Edhe Filiku (si dëgjoj këto), e la gjyqin' e
atyre për një tjetërë ditë, sepse i dinte më,
hoλë punërat' e *kësaj* udhe, edhe tha, Kur të
sbresë Lysi kryemijësi, dotë marr vesh

23 mirë punëratë t'uaj. Edhe urdhëroj kryeqin-
dësinë të ruhetë Pavli, edhe të ketë të prëj-
turë, edhe të mos ndalonjënë ndonjë prej
njerëzet të ti t'i shërbenjë a të vinjë tek ay.
24 Edhe pas ca ditsh erdhi Filiku bashkë
me gruan' e ti Drusillë, e-cila ishte Jude-
onjë, edhe dërgoj e thërriti Pavlinë, edhe
dëgjoj nga ay për besënë mbë Krishtinë.
25 Edhe tek po fliste ay për drejtëri e për të-
përmbajturë të vetëhesë edhe për gjyqinë që
ka për te ardhurë, Filikut i hyri frikë, e
upërgjeq, Tashi shko, pa kur të kem kohë,
26 dotë të thërres prapë. Sepse mbë gjithatë
kohë edhe shprenjte, se Pavli dot' i epte as-
pra, që t'a lëshonjë; përandaj edhe më dën-
durë e thërriste edhe fliste më atë.
27 Po passi umbushnë dy vjet, Porqiu Fisti
erdhi ndë këmbët të Filikut; edhe Filiku,
dyke dashurë t' u bënjë hir Judhenjet, e la
Pavlinë të-lidhurë.

Krye 25.

1 Fisti pra si erdhi ndë vëntt qe ishte dhënë
ndënë urdhërit *të ti*, pas tri ditsh hipi nga
2 Qesaria ndë Jerusalim. Edhe kryeprifti edhe
të-parët' e Judhenjet *që ishinë* kundrë Pavlit
3 udruknë përpara ati, Edhe i luteshinë, dyke
lypurë hir kundr' ati, që të dërgonjë e t'a
bjerë atë ndë Jerusalim, sepse kishinë bërë
4 pritë që t'a vrasënë udhësë. Edhe Fisti u-

përgjeq, se Pavli ruhetë ndë Qesari, edhe
se ay vetë kishte për të vaturë çpejt *atje*.
5 Letë sbresënë pra, tha, ata që muntnjënë
prej jush bashkë me mua, edhe ndë ka gjë
të-keqe te ky njeri, let' a përflasënë.
6 Edhe passi ndënji ndër ata me tepërë se
dhjetë dit, sbriti nde Qesari, edhe mbë të-
nesërmet, si ndënji mbë gjykatët, urdhëroj të
7 bihetë Pavli. Edhe si erdhi ay, duallnë për-
para ata Judhenjtë që kishinë sbriturë nga
Jerusalimi, edhe thoshinë kundrë Pavlit shu-
më edhe të-rënda të-përfolura, të-cilatë s'
8 muntninë t' i vërtetoninë, Sepse ay për të
mbrojturë vetëhenë thoshte, Se as mbë nomn'
e Judhenjvet, as mbë hierorenë, as mbë Qe-
9 sarinë bera ndonjë faj. Po Fisti passi donte
t' u bënjë hir Judhenjet, i upërgjeq Pavlit,
e tha, A do të hipënjç ndë Jerusalim, edhe
atje të gjykonesh për këto *punëra* përpara
10 meje? Edhe Pavli tha, Unë po qëndronj për-
para gjykatës' së Qesarit, ku duhetë të gjy-
konem. Judhenjvet asndonjë të-keqe s' u
kam bërë, sikundrë edhe ti e di fort mirë;
11 Sepse, ndë qoftë se kam faj edhe ndë kam
bërë ndonjë *punë* për vdekje, nuk' i trëmbem
vdekjesë; po ndë mos ka asndonjë gjë nga
ato që më perflasënë këta, asndonjë nukë
munt të me falnjë tek ata; thërres mbë Qe-
12 sarinë. Atëhere Fisti si foli me bashkëndë-

BKSH

njenë, upërgjeq, Mbë Qesarinë thërrite *ti*?
te Qesari dotë veç.
13 Edhe si shkuanë ca dit, mbreti Agrippë
edhe Vernika erthnë ndë Qesari, për të për-
14 shëndoshurë Fistinë. Edhe si ndënjnë atje më
shumë dit, Fisti i zuri n' gojesh mbretit pu-
nën' e Pavlit, dyke thënë, Është një njeri që
15 është lënë këtu i-lidhurë prej Filikut; Për
të-cilinë, kur vajta ndë Jerusalim, uduknë
përpara meje kryepriftërit' edhe pleqt' e Ju-
16 dhenjet, e lypnë dënim kundrë ati; Të-cilëvet
upërgjeqçë, se nukë është zakon ndër Roma-
nët të epetë për hir ndonjë njeri ndë vde-
kje, para se të ketë përpara faqesë ay që
përflitetë ata që e përflasënë, edhe para se
të marrë kohë të apë fjalë për fajinë e ti.
17 Passi umblothnë pra ata këtu, pa mënuarë
fare mbë të-nesërmet ndënja mbë gjykatët,
18 edhe urdhërova të bihetë njeriu; Për të-ci-
linë ata që e përflisninë, si duallnë përpara
meje, nukë prunë ndonjë të-përfolurë nga
19 ato qe mendonjam unë. Po kishinë kundr'
ati ca çështje për hie-lutjen' e tyre, edhe për
një farë Jisuj që kishte vdekurë, per të-cilinë
20 Pavli thoshte se rron. Edhe unë, passi s' din-
jam seç të bënj mbë një të-tillë çështje, i tha-
shë, ndë do të vejë ndë Jerusalim, edhe atje
21 të gjykonetë për këtë. Po passi Pavli thirri
të ruhetë për të gjykuarë te Perandori, ur-
dhërova te ruhet' ay, gjersa t' a dërgonj te

BKSH

22 Qesari. Edhe Agrippa i tha Fistit, Desha
edhe unë t' a dëgjonj këtë njeri. Edhe ay
tha, Nesërë dot' a dëgjonjç.
23 Mbë të-nesërmet pra, kur erdhi Agrippa
edhe Vernika me shumë madhështi, edhe
hynë ndë sallët të gjykatoresë bashkë me
kryemijësit' e me burrat' e-çquarë të qytetit,
24 Fisti urdhëroj, e upru Pavli. Atëhere Fisti
thotë, O mbret Agrippë, edhe gjithë *ju* bu-
rratë që jeni këtu bashkë me ne, e shihni këtë
njeri, për të-cilinë gjithë shumica e Judhenj-
vet më folnë edhe ndë Jerusalim edhe këtu,
dyke bërtiturë, se ay nukë duhetë më të
25 rronjë. Po unë passi gjeta se s' ka punuarë
gjë për vdekje, edhe ay vetë thirri mbë Pe-
26 randorinë, e pashë të udhësë ta dërgonj. Për
të-cilinë s' kam asgjë të-vërtetë t' i shkruanj
t' im Zoti; përandaj e prura *atë* përpara jush,
edhe më tepërë përpara teje, o mbret Agrip-
pë, që të kem seç të shkruanj, passi të bënetë
27 të pyeturitë. Sepse më duketë punë pa mënt
të dërgonj një njeri të-lidhurë, pa shënuarë
edhë të-përfoluratë kundrë ati.

Krye 26.

1 Edhe Agrippa i tha, pavlit, Ke lëjë të flaç
për vetëhenë t' ënde. Atëhere Pavli shriti do-
rënë edhe epte fjalë;
2 O mbret Agrippë, e numëronj vetëhenë
t' ime të-lumurë, sepse kam për të dhënë

BKSH

fjalë përpara teje sot për githë sa përflitem
3 nga Judhenjtë, Po më tepërë sepse ti i di
githë zakonët' edhe çëstitjet' e Judhenjet;
përandaj të lutem të më dëgjonjç me zëmërë
4 të-gjerë. Jetënë t'ime që prej djalërisë, të-ci-
lënë rrojta që ndë kryet ndër mest të kombit
t'im ndë Jerusalim, e dinë gjithë Judhenjtë,
5 Sepse më dinë që nde kryet, (ndë qoftë se
duanë të dëshmonjënë,) se rrojta Farise
sipas më së-drejtësë sektë të fesë s' onë.
6 Ede ndashti rri përpara e giykonem për
shpresën' e të-zotuarit që ubë nga Perëndia
7 mbë atëritë t'anë; Ndë të-cilët *të-zotuarë* të
dy-mbë-dhjetë farat' *e kombit* t' ënë, dyke
adhuruarë *Perëndinë* pa pushim dit' e natë,
shprenjënë të arrinjënë; për këtë shpresë për-
8 flitem, o mbret Agrippë, prëj Judhenjvet. Çë?
gjë e-pabesuarë gjykonetë ndër ju, se Perën-
9 dia gjall të-vdëkurë? Sa për mua, unë men-
donesha me vetëhenë t'ime, se duhej të bënj
shumë punëra kundrë emërit të Jisu Nazo-
10 reasit; Te-cilënë *gjë* edhe e bera ndë Jeru-
salim, edhe shumë nga shënjtorëtë un' i mby-
lla ndër burgje, passi mora pushtet nga krye-
priftëritë; edhe kur vriteshinë, ipnja zë kundrë
11 *atyreve*. Edhe shumë herë ndëpër gjithë si-
nagogjit, dyke munduar' ata, i shtrëngonja të
vllasfimisninë; edhe dyke tërbuarë pa masë
kundrë atyreve, i ndiqnjam edhe gjer ndër të
jashtëshmit qytete.

12 Ede mbi këto e sipërë, kur po ishnjam
dyke vajturë ndë Dhamaskë me pushtet e
13 me porosi nga an'e kryepriftërvet, Ndë mest
të ditësë udhësë pahsë, o mbret, se prej qje-
lli një dritë që e shkonte të ndriturit' e djellit
ndriti qark meje edhe atyreve që bëninë
14 udhë bashkë me mua. Edhe si ramë të-gji-
thë poshtë, përdhe, dëgjova një zë që më
fliste mua e që thoshte ndë gjuhët Ebraishte,
Saull, Saull, përse më ndjëk? keq për ty
15 është t'u bjesh me shkelme gjëmbavet. Edhe
unë thashë, Cili je *ti*, o Zot? Edhe ay tha, Unë
16 jam Jisuj, të-cilinë ti po ndjek. Po ngreu, edhe
qëndro mbë këmbë të tua; sepse për këtë u-
dukçë tek ti, që të të vë shërbëtuar edhe dësh-
mimtar edhe t' atyreve që pe edhe t' atyreve
17 me të-cilatë dotë dëftenem mbë ty, Dyke
sgjedhurë ty nga llauzi e nga kombetë, ndër
18 të-cilët ndashti po të dërgonj, Qe të hapç
syt' e atyre, që *kështu* të kthenenë nga errë-
sira ndë dritët, edhe nga pushteti i Satanajt
te Perëndia, që të marrënë ndjesë fajesh, edhe
trashëgim ndër mest të të-shënjtëruarëvet, me
anë të besësë mbë mua.

19 Përandaj, o mbret Agrippë, nuk' ubëshë
i-pabindurë ndë këtë të-dukurë prej qiellit,
20 Po lëçisnjan më parë mb' ata të Dhamaskës'
e të Jerusalimit, edhe ndëpër gjithë dhën'
e Judhesë, edhe *pastaj* ndër kombet, të pen-
donenë, edhe të kthenenë te Perëndia, dyke

21 punuarë punëra të-vëjyera për pendim. Për
këto *punëra* Judhenjtë më zunë ndë hieroret
22 e doninë të *më* vrisninë. Po me ndihmënë
që m'udha prej Perëndisë po qëndronj gjer
mbë këtë ditë, dyke dhënë dëshmim mbë të-
math e mbë të-vogëlë, pa thënë gjë *tjetërë*
veç ato që folnë profitërit' edhe Moisiu se
23 ishinë për të bërë, Se Krishti kishte për të
pësuarë, *edhe* së i-parë dotë ngjallej prej
së vdekurish, edhe se dotë lëçiste dritë ndër
llaust e ndër kombet.
24 Edhe tek po epte ay fjalë kështu për ve-
tëhen' e ti, Fisti tha me zë të-math, Je i-shka-
lluarë, o Pavel; mësimet' e-shumë të bënë
25 të shkallonjç. Edhe ay tha, Nukë jam i-shka-
lluarë, o i-pushteçim Fist, po flas fjalë të-
vërteta edhe prej mëndjeje së-shëndoshë.
26 Sepse i di këto *pnnëra* mbreti, të-cilit edhe
i flas me kuxim; sepse jam i-bindurë, se
s' ka asndonjë nga këto që të mos e dijë;
sepse këjo nuk' është bërë mbë ndonjë çip.
27 A u beson profitërvet, o mbret Agripë? e di
28 se u beson. Edhe Agrippa i tha Pavlit, për
pakëzë mënt më mbush mëndjenë të bënem
29 i-krishterë. Edhe Pavli tha, I lutem Perëndisë
të apë, që jo vetëmë ti, po edhe gjith' ata
që më dëgjonjënë sot të bënenë nga pak e
nga shumë të-tillë si jam edhe unë, përveç
këtyre hekurave.
30 Edhe (si tha ay këto), ungrit mbreti, edhe

BKSH

qivernitari, edhe Vernika, edhe ata që kishinë
31 ndënjurë bashkë me ata. Edhe si iknë flis-
ninë njëri me tjetërinë, dyke thënë, Se ky
njeri s'ka bërë asndonjë punë për vdekje a
32 për hekura. Edhe Agrippa i tha Fistit, Ky njeri
munt të lëshonej, po të mos kishte thirrurë
mbë Qesarinë.

Krye 27.

1 Edhe passi upa e udhësë të lundrojmë
për ndë Itali, dhanë Pavlinë edhe ca të-li-
dhurë të-tjerë te një kryeqindës që quhej Jul,
2 prej tufës' së Avgustit. Edhe si hipmë ndë
një lundrë Adhramitine, ungritmë me mendim
të lundrojmë afërë vëndevet t' Asisë; edhe
Aristarh Maqedhonasi prej Thessallonikësë
3 ishte bashkë me ne; Edhe *ditënë* tjatërë a-
rritmë ndë Sidhonë; edhe Juli usuall njerë-
zish mbë Pavlinë, edhe e la të vejë te miqt'
4 *e ti* e të prëhetë. Edhe si ungritmë që andej
lundruamë ndënë Qyprënë, sepse erëratë i-
5 shinë të-kundrejta. Edhe si kapëtuamë detn'
e Qiliqis' edhe të Pamfylisë, erthmë ndë Myra
5 të Lyqisë. Edhe atje kryeqindësi gjeti një
lundrë Aleksandriane, që lundronte për ndë
7 Itali, ëdhe na vuri brënda nd' atë. Edhe mjaft
dit dyke lundruarë nga dalë mezi arritmë
ndë Knidhë, edhe pasi nukë na linte era,
lundruamë ndënë Kritënë nga an'e Sallomësë;
8 Edhe passi e kaptuam' atë me mundim, erth-

më mbë një vënt që quhetë Limanët' e-Mirë,
ku afërë ishte qyteti Llasea.
9 Edhe passi pat shkuarë mjaft kohë, edhe
të-lundruarëtë ndashti ishte të-rrëzikshim, se-
pse edhe agjërimi ndashti kishte shkuarë, Pa-
10 vli i këshiλonte, Dyke thënë atyre, O burra,
shoh, se këta të-lundruarë dotë bënetë me
të-hequrë keq e me shumë dëm, jo vetëmë
të barrës' e të lundrësë, po edhe të jetëvet
11 t'ona. Po kryeqindësi i dëgjonte më tepërë
kapedanit edhe të zot të lundrësë se fjalë-
12 vet të Pavlit. Edhe passi limani s'ishte i-
mirë për të dimëruarë, më të-shumëtë dhanë
këshillë të-ngrihen' edhe që andej, që të a-
rrinjënë, ndë qoftë se muntninë, ndë Finikë, që
është një liman i Kritësë që sheh nga jugë-
perëndimi e nga veri-perëndimi, edhe *atje* të
13 dimëronjënë. Edhe kur fryti pak erë shiu, pa-
ndehnë, se arritnë dëshirënë, ungritnë, edhe
lundroninë përanë *tokës' së* Kritësë.
14 Po pas pakëzë *here* dolli kundrë asaj
një erë thëllimi, ajo që quhetë Evroklidhon.
15 Edhe passi urrëmbye lundra, edhe s' muntte
t'i qëndronte erësë, ulam'e biheshimë prej e-
16 rësë andej e këtej. Edhe si shkuamë ndënë
një ujdhezë të-vogëlë që quhetë Kllavdhë,
mezi muntmë të vëmë ndënë pushtett t'ënë
17 govatënë; Të-cilënë si e ngritnë, përdorinë
çdo farë ndihme dyke ngjeshurë lundrënë
që përposh; edhe me-qënë-që kishinë frikë

semos bjenë ndë shtresë rëre, sbritnë pël-
huratë, edhe kështu biheshinë andej e këtej.
18 Edhe passi motinë e kishimë fort të-keq,
19 *ditënë* tjetërë derthmë gjënë ndë dett; Edhe
ditën' e-tretë i hothmë plaçkat' e lundrësë
20 me duartë t' ona. Edhe me-qënë-që për shumë
dit nukë dukëshinë as djelli as yjtë, edhe
moti ishte fort i-keq, më çdo shpresë shpë-
timi uhoq prej nesh.
21 Edhe si kishinë shumë dit pa ngrënë, a-
tëhere Pavli qëndroj ndë mest t'atyreve, e
tha, Duhej, o burra, të më dëgjonitë, edhe të
mos ngriheshitë nga Krita, edhe të mos hiq-
22 nimë këto të-këqia e këtë dëm. Edhe nda-
shti u këshiλonj juve të kini zëmërë të-gëzua-
rë; sepse nukë dotë humpnjë asnjë shpirt prej
23 jush, veç lundrësë. Sepse këtë natë m' uduk
një ëngjëll i Perëndisë, i të-cilit jam, të-cilin'
24 edhe adduronj, Edhe tha, Mos ki frikë, Pa-
vel; ti duhetë të dalç përpara Qesarit; edhe
ja Perëndia ty t'i ka falurë gjith' ata që lun-
25 dronjënë bashkë me ty. Përandaj kini zë-
mërë të-gëzuarë, o burra; sepse besonj mbë
Perëndinë, se kështu dotë jetë, sikundrë më
26 është folurë mua. Edhe duhetë të bjemë ja-
shtë mbë një ujdhezë.
27 Edhe kur erdhi e-katrë-mbë-dhjetëta natë,
tek po bihesimë këtu këtje ndë dett Adria-
tik, si nga mez' i natësë detarëtë sikur ku-
28 pëtoninë se po aferonenë ndë një tokë. Edhe

BKSH

kur hothnë skandhallinë, gjetnë njëzet pash
ujë; edhe si vanë pakëzë më tej, hothnë e-
dhe prapë skandhallinë, edhe gjetnë pesë-mbë-
29 dhjetë pash; Edhe passi kishinë frikë semos
bininë jashtë ndë vënde shkëmbënjsh, hothnë
katrë grepa prej bishtit të lundrësë, edhe
luteshinë të bënetë ditë.
30 Po passi detarëtë kërkoninë të ikëninë
nga lundra, edhe sbritnë govatënë ndë dett,
me fjalë se sikur dotë hithninë grepa nga
31 ball'i lundrësë, Pavli i tha kryeqindësit edhe u-
shtëtarëvet, Ndë mos ndënjçinë këta ndë lun-
32 drët, ju nukë *dotë* muntni të shpëtoni. Atë-
here ushtëtorëtë prenë litarët' e govatësë,
edhe e lanë të bjerë jashtë.
33 Edhe gjersa që të bënej ditë, Pavli u lu-
tej gjithëve të hanë gjë, dyke thënë, Sot është
e-katrë-mbë-dhjetëta ditë që dyke priturë jeni
34 të-urëtë e pa ngrënë gjë. Përandaj u lutem
juve të hani gjë; sepse këjo është për shpë-
timinë t'uaj; se asndonjëj prej jush nukë dot' i
35 bjerë as qime prej kresë. Edhe si tha këto,
mori bukë, e i ufal Perëndisë përpara të-gji-
36 thëve, edhe si e theu, zuri të hajë. Edhe të-
gjithë si muarnë zëmëmë, muarnë edhe ata
37 edhe hëngrrë. Edhe ishimë të-gjithë ndë lun-
drët dy qint e shatë-dhjet' e gjashtë spirt.
38 Edhe si ungjinjnë me ushqim, lehtësoninë
lundrënë dyke hedhurë grurëtë jashtë ndë
39 dett. Edhe kur ugdhi, nukë e njihninë

BKSH

vëndinë; po vështroninë një gji, që kishte
buzë toke, edhe nd'atë umenduanë, po të
40 muntninë, t'a shtininë jashtë lundrënë. Edhe
si hoqnë lart grepatë, lanë *lundrënë* ndë dett,
dyke sgidhurë ndë gjithatë kohë të-lidhurat'
e timonëvet; edhe si ngritnë pëlhurën' e-mes-
me nga frynte *era*, ja mbaninë dreq tokësë.
41 Edhe si ranë ndë një vënt me det nga të dy
anëtë, shtynë lundrënë jashtë; edhe ball' i
lundrësë, si umbështet, mbeti i-patundurë, po
bishti shkallmonej nga të-rrahurit' e-ashpërë
42 të valëvet. Edhe ushtërorëtë bënë këshillë të
vrisninë të-lidhuritë, që të mos ikënte ndonjë
43 dyke bërë mbë not. Po kryeqindësi dyke da-
shurë të shpëtonjë Pavlinë, i ndaloj nga këjo
këshillë, edhe urdhëroj sa muntninë të bë-
njënë mbë not të hidhenë më parë e të dalënë
44 mbë tokët; Edhe të-tjerëtë *duallnë*, ca mbi
dhoga, e ca mbi *copëra të-thyera* të lundrësë.
Edhe kështu shpëtuanë të-gjithë mbë tokët.

Krye. 28.

1 Edhe si shpëtuanë, atëhere e njohnë se
2 ujdhesa qyhetë Melitë. Edhe varvarëtë rrë-
fyenë mbë ne jo të-pakë mirësi; sepse ndes-
në zjarr, e na muarnë brënda të-gjithë, sepse
binte shi e ishte ftohëtë.

3 Edhe Pavli kur mblodhi ca shkarpa, edhe
i vuri ndë zjarrt, dolli nga të-nxehëtitë një
4 nepërkë e i ugjit ati ndë dorët. Edhe var-

varëte si panë bishënë varurë prej dorës' s'
ati, i thoshinë njëri tjatërit, Me të-vërtetë ky
njeri qënka vrasës, të-cilinë, ndonëse shpëtoj
prej detit, gjyqi *i Perëndisë* nuk'e la të rronjë.
5 Po ay e shkundi bishënë ndë zjarrt, edhe
6 nukë pësoj ndonjë gjë të-keqe. Edhe ata prit-
ninë të ehej a papandehuraj të binte përdhe
i-vdekurë; po passi pritninë shumë kohë, edhe
shihninë, se asndonjë e-keqe s'i ubë, ndërru-
anë mëndje, e thoshinë se është perëndi.
7 Edhe rreth ati vëndi ishinë ara të të-parit
të ujdhesësë që quhej Puplë, i-cili na priti
e na mbajti ndë shtëpit miqësisht tri dit.
8 Edhe goditi i ati i Puplit të dergjet' i-sëmurë
prej ethesh e prej barku të-keq; tek i-cili
Pavli, si hyri, ufal, edhe vuri duartë mbi
9 atë, edhe e shëroj. Edhe si ubë kjo, edhe
të-tjerëtë sa kishinë sëmundje ndë ujdhesët,
10 vininë *tek ay* edhe shëroneshinë; Të-cilëtë
edhe me shumë ndere na nderuanë, edhe
kur ishimë për të ikurë, *na* dhanë ato që ki-
shimë nevojë.
11 Edhe pas tre muajsh ikmë me një lun-
drë Aleksandrine, që kishte dimëruarë ndë
ujdhesët, *e cila kishte* shënjë të Dhioskurë-
12 vet. Edhe si arritmë ndë Syrakusë, mbetmë
13 *atje* tri dit. Edhe që andej dyke ardhurë rro-
tullë arritmë ndë Rigjë; edhe pas një dite
passi fryti erë shiu, mbë dy dit erthmë ndë
14 Potiollë. Atje gjetmë vëllezër, të-cilëtë na u-

BKSH

lutnë të mbetemi ndër ata shtatë dit, edhe
15 kështu unismë për ndë Romë. Edhe që an-
dej vëllezëritë kur dëgjuanë për ne, na duall-
në përpara gjer ndë Trekt t'Appiut e gjer
ndë të Tri Tavernat; të-cilëtë kur i pa Pavli,
i ufal ndersë Perëndisë, edhe mori zëmërë.
16 Edhe kur erthmë ndë Romë, kryeqindësi
dha të-lidhuritë ndë dorët të të-parit të ush-
tërisë; po Pavlit i udha lejë të rrijë mbë ve-
tëhe bashkë me ushtëtorinë që e ruante.
17 Edhe pas tri ditsh Pavli thërriti të-parët' e
Judhenjet; edhe ata si umblothnë, u thoshte
atyre, O burra vëllezër, ndonëse unë s' kam
bërë gjë kundrë llauzit a kundrë zakonëvet
t'atërvet *t'anë*, më dhanë nga Jerusalimi të-
18 lidhurë ndë duart të Romanëvet; Të-cilëtë
si më pyetnë, deshnë të më lëshoninë, sepse
s' kishte asndonjë ngajë për vdekje tek unë.
19 Po passi Judhenjtë flisninë kundrë, ushtrën-
guashë të thërres mbë Qesarinë, jo se kam
20 për të përfolurë mbë gjë kombinë t' im. Për
këtë punë pra u thirra juve, që t' u sboh e
t' u flas; sepse për shpresën' e Israilit jam
lidhurë me këtë vark hekurash.
21 Edhe ata i thanë, Neve as kartëra kemi
marrë për ty nga Judhea, as erdhi ndonjë
nga vëllezëritë të dëftenjë a të flasë gjë të-
22 keqe për ty. Po duamë të dëgjojmë prej teje
ç' ke ndër mëntt; sepse për këtë sektë neve
dimë se kudo kundrëflitetë.

BKSH

23 Edhe passi i ndanë ati një ditë, erthnë
shumë *veta* tek ay atje ku kishte rënë; të-
cilëvet ay u dëftente me dëshmime mbretë-
rin' e Perëndisë, dyke mbushurë atyre mën-
djenë për punët' e Jisujt edhe nga nom'i Moi-
siut edhe nga profitëritë, që ndë mëngjest e
24 gjer mbrëmanet. Edhe ca bindeshinë mb'ato
që u thoshte, po të-tjerë nukë zininë besë.
25 Edhe si nuk'ishinë mbë një fjalë ndër mest
të tyre, ikninë, passi tha Pavli një fjalë, Se
mirë u foli Frym'e-Shënjtëruarë atërvet t'anë
me anë të profitit Isai, Dyke thënë, „Shko
te ky llaus edhe thuaj," Me të-degjuarë dotë
dëgjoni, e nukë dotë merrni vesh; edhe dyke
27 parë dotë shihni, e nukë dotë kupëtoni; Sep-
se utrash zëmër' e këti llauzi, edhe me ve-
shëtë dëgjuanë rëndë, edhe syt'e tyre i mbyll-
në; semos ndonjë herë shohënë më sytë, e
dëgjonjënë me veshëtë, e kupëtonjënë me zë-
28 mërënë, edhe kthenenë, e i shëronj ata." Letë
jetë pra e-diturë mbë ju, se shpëtim' i Perën-
disë udërgua mbë kombetë; ata edhe dot' a
29 dëgjonjënë. Edhe si tha këto, Judhenjtë iknë,
dyke ngrënë me shumë fjalë njëri me tjatërinë.
20 Edhe Pavli mbeti dy vjet të-tërë ndë një
shtëpi të-veçantë me të-paguarë; edhe priste
31 gjith' ata që vininë tek ay, Dyke lëçiturë
mbretërin' e Perëndisë, e dyke mësuarë *njerë-
zet* ato punëra që kishinë të bëninë me Zotinë
Jisu Krisht, me çdo kuxim *e* pa ndalim.

BKSH

Karta e Apostollit Pavël mbë Romanëtë.

Krye 1.

1 Pavli, sbërbëtuar i Jisu Krishtit, i-thërri-
tur' apostoll, i-ndarë për *të lëçitur'* ungjillin'e
2 Perëndisë, (Që qe zotuarë që përpara me anë
të profitërvet të ti ndë shkronjat të-shënjtë-
3 ruara,) për të Birin' e ti Jisu Krishtinë, Zo-
tinë t'ënë, i-cili pas mishit lindi nga far' e
4 Dhavidhit, *Edhe* pas frymës' së shënjtërisë
udëftye Bir Perëndië me fuqi, me anë të
5 të-ngjallurit *të ti* prej së-vdekurish; Me anë
të të-cilit muarmë hir e apostoli për emerin'e
ati, që të bindenë ndë besët gjithë kombetë;
6 Ndër mest të të-cilëvet jeni edhe ju të-thë-
7 rriturë te Jisu Krishtit; Mbë gjithë ju që jeni
ndë Romë, të-dashurë të Perëndisë, të-thërri-
turë shënjtorë, hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim
prej Perëndisë, Atit t' ënë, edhe prej Zotit
Jisu Krisht.
8 Me përpara i falem ndersë Perëndisë
t' im me anë të Jisu Krishtit për gjithë ju,
sepse besa juaj zihetë n' gojë mbë gjithë
9 botënë; Sepse dëshmimtari im është Perën-
dia, të-cilit i shërbenj me shpirtinë t' im ndë
ungjillt të Birit t' ati, se pa pushim u kujtonj

BKSH

10 juve, Dyke luturë gjithënjë ndë të-falurat
t'ime, që të dojë Perëndia ndonjë · herë të
11 m' a bënjë mbarë të vinj tek ju. Sepse kam
shumë mall t' u shoh juve, që t'u ap ndonjë
12 dhurëti shpirtërie qe të forcohi; Edhe këjo
është të ngushulonem bashkë me ju me anë
të besës' se-bashkëtë, s' uajsë edhe s' imesë.
13 Edhe nukë dua të mos e dini, o vëllezër,
se shumë herë e vura ndër mëntt të vinj tek
ju, (po undaluashë gjer ndashti,) që të kem
ndonjë pemë edhe ndër mest t' uaj, sikundrë
14 edhe ndër mest të kombevet të-tjerë. Jam
detuar mbë Grekër e mbë varvarë, mbe të-
15 ditur' e mbë të-paditurë; Kështu, sa varetë
nga unë, jam i-gatishim të lëçis ungjillinë
edhe ndër ju që jeni ndë Romë.
16 Sepse nukë kam turp për ungjillin' (e
Krishtit); sepse është fuqi Perëndie për shpë-
tim mbë cilinëdo që beson, mbë Judhenë me
17 pare, edhe mbë Grekunë *me pastaj*; Sepse
me anë t' ati sbulonetë drejtëri' e Perëndisë
prej besë mbë besë, sikundrë është shkruarë,
"I-drejti prej bese dotë rronjë.„
18 Sepse zëmërim Perëndie sbulonetë prej
qielli mbi çdo pabesëri e paudhëri të nje-
rësvet, që mbanjënë të-vërtetënë ndë pau-
19 dhëri. Sepse çdo që munt të dijë njeriu për
Perëndinë ësht' e-çfaqurë ndër ata; sepse
20 Perëndia u'a çfaqi atyreve. Sepse të-padu-
kurat' e ati, fuqia e ati e-përjetëshme edhe

BKSH

hieria, qε-kur-se ubë bota, shihenë kthjellëtë
dyke umarrë me mënt me anë t'atyreve që ja-
në bërë, kaqë sa ata të mos kenë seç të thonë.
21 Sepse, ndonëse e njohnë Perëndinë, nuk' e
lavduruanë si Perëndi, as nuk'i ufalnë ndersë;
po ubënë të-kotë ndë të-menduarat të tyre,
edhe uerrësua zëmër'e atyre e-pakupëtuar-
22 shime. Dyke thenë, se janë të-mënçim, u-
23 marruanë; Edhe ndërruanë lavdin'e të-pa-
vdjerit Perëndi mbë shëmbëllesë fytyre njeriu
të-vdjershim, e shpesësh, e katrëkëmbësesh
e shtërpinjsh.
24 Përandaj edhe i dha Perëndia ata ndë
ndyrësirë me anë të dëshërimevet të zëmë-
ravet t' atyre, që të çnderonenë trupat'e atyre
25 ndër mest t' atyre. Të-cilëtë ndërruanë të-
vërtetën'e Perëndisë ndë gënjeshtrë, edhe
nderuan'e adhuruanë krijesënë me tepërë se
Krijetarinë, i-cili esht'i-bekuarë për gjithë je-
26 tënë. Amin. Përandaj Perëndia i dha ata ndë
dëshërimë çnderimi; sepse edhe femërat'e
atyre ndërruanë të-përdoruritë sipas naturë-
së ndë *të-përdorurë që është* kundrë naturë-
27 së; Gjithashtu edhe meshkujtë lanë të-për-
dorurit' e femërësë si pas naturësë, e udoq-
në ndë dëshërimt të tyre njëri me tjetrinë,
dyke punuarë turpje meshkuj mbë meshkuj,
e dyke marrë ndë vetëhet të tyre çpagimnë
28 që duhej të kobimit të tyre. Edhe sikundrë
nukë deshnë të njohënë Perëndinë, Perëndia

i dha ata ndë një mëndje të-prishurë, që të
29 bënjënë ato që nukë ka hie *të bënenë*; Sepse
ata janë plot me çdo farë paudhërie, kur-
vërie, dinakërie, lakmimi, ligësie; mbushurë
me cmir, me vrasje, me qartë, me kobim,
30 me poshtëri; Asish që pishtëllinjënë, asish
që përflasënë, asish që e kanë cmir Perën-
dinë, asish që shanjënënë, madhështorë, krye-
lartë, asish qe çpifnjënë të-këqia, të-pabindurë
31 te prindëritë, Të-çmëndurë, asish që s'mba-
njënë fjalëtë që kanë lidhurë, të-padhëmçurë,
32 të-papajtuarshim, të-papërdëllyershim; Të-
cilëtë, ndonëse njohënë drejtërin'e Perëndisë,
se ata që punonjënë të-tillatë vëjenjënë për
vdekje, jo vetëm' i bënjënë ato, po edhe gje-
njënë pëlqim mb' ata që i punonjënë.

Krye 2.

1 Përandaj s' munt të drejtëronjç vetëhenë,
o njeri, cilido që të jesh ti që gjykon; sepse
mb' atë që gjykon tjetërinë, dënon vetëhenë
t' ënde; sepse ti që gjykon gjithato punon.
2 Edhe e dimë, se gjyqi i Perëndisë është me
të-vërtetë kundr' atyreve që punonjënë të-
3 tillatë. Edhe mendon këtë ti, o njeri që gjy-
kon ata që punonjënë të-tillatë, edhe që i bën
ato *edhe vetë*, se ke për të shpëtuarë nga gjy-
4 qi i Perëndisë? Apo bën për asgjë pasjen' e
mirësis' s'ati e të durimit e të zëmërës' së-
gjerë, edhe nuk' e di, se mirësi' e Perëndisë

5 të bje ty ndë pendim? Po për ashpërimnë
t'ënt edhe për zëmërën' e-papenduarë mbleth
mbë vetëhenë t'ënde zëmërim për ndë ditët
të zëmërimit e të sbulesës'së gjyqit të-drejtë
6 të Perëndisë, I-cili dot' j'a çpaguanjë gjithë-
7 sicilit pas punëvet t'ati; Atyreve që kërko-
njënë me durim ndë punë të-mirë lavdi e nder
8 e pavdjerje *dot'u apë* jetë të përjetëshme; Po
mb'ata qe grindenë edhe nuk' i bindenë së
vërtetësë, po i bindenë paudhërisë, dotë jetë
9 zëmërim e zëmëratë, Hidhërim edhe shtrëngim
mbë çdo spirt njeriu që punon të-ligënë, Ju-
10 dheu më parë edhe *pastaj* Greku; Po lavdi
e nder e paqtim mbë cilinëdo që punon
të-mirënë, mbë Judhenë më parë edhe *pas-*
11 *taj* mbë Grekunë. Sepse te Perëndia s'ka të-
12 mbajturë anë; Sepse sa fëjyenë pa nom, pa
nom edhe dotë vdirenë; edhe sa fëjyenë
13 ndënë nom, me mom dotë gjykonenë, (Sepse
nukë janë të-drejtë përpara Perëndisë ata që
dëgjonjënë nomnë, po ata që mbushnjënë no-
14 mnë dotë drejtëronenë. Sepse kur gjëndarëtë
që s'kanë nom, prej nature bënjënë punët' e
nomit, këta, ndonëse s' kanë nom, janë vetë
15 nom ndë vetëhet të tyre; Të-cilëtë dëftenjënë
punën' e nomit të-shkruarë ndë zëmërat të
tyre, sepse kanë ndërgjegjen'e tyre dyke dësh-
muarë bashkë me ata, edhe mendimetë dyke
përfolurë a edhe dyke drejtëruarë njëri tja-
16 tërinë;) Mb' atë ditë, kur dotë gjykonjë Pe-

BKSH

rëndia të-fshehurat' e njerësvet me anë të
Jisu Krishtit, pas ungjillit t' im.
17 Na ti quhesh Judhe, edhe prëhesh ndë nomt,
18 edhe mburresh mbë Perëndinë, Edhe njeh da-
shurimn'*e ati*, edhe çquan ato që ndanjënë,
19 sepse mësonjesh prej nomit; Edhe ke besim
mbë vetëhenë t'ënde, se je udhëheqës i të-
verbërvet, drit' e atyreve që janë nd'errësirë,
20 Ndreqës i të-marrëvet, mësonjës i foshnjavet,
edhe se ke shëmbëllën' e diturisë e të së-
21 vërtetësë ndë nomt. Ti pra që mëson tjatërinë,
vetëhenë t'ënde nuk'e mëson? ti që lëçit të
22 mos vjedhënë, vjeth? Ti që thua të mos kur-
vëronjënë, kurvëron? ti që mërzit idhujtë,
23 vjeth gjë kishe? Ti që mburresh mbë nomnë,
çpërnderon Perëndinë dyke shkelurë nomnë?
24 Sepse „emëri i Perëndisë për juve shahetë
ndër kombet", sikundrë është shkruarë.
25 Sepse rrethpresja bën dobi, ndë mbusç no-
minë; po ndë shkelç mominë, rrethpresja jote
26 ubë parrethpresje. Ay pra që nuk' është i-rreth-
prerë ndë ruajtë porosit'e nomit, parrethpre-
sja e ati a nukë dotë numëronetë rrethpresje?
27 Edhe ay që është i-parrethprerë ndë trupt
edhe mbush nominë dotë të gjykonjë ty që
ke shkronjën'*e nomit* edhe rrethpresjenë, e
28 shkel nominë. Sepse nuk'është Iudhe ay që
është përjashta *Judhe*, as rrethpresje ajo që
29 është për faqe ndë misht: Po Judhe *është* ay
që esthë përbrënda *Judhe*, edhe rrethpresje

BKSH

ajo e zëmërësë, që *është* pas frymësë *e* jo pas shkronjësë, i të-cilit *Judhe* nderi është jo prej njerësvet, po prej Perëndisë.

Krye 3.

1 Ç'ka më tepërë pra Judheu? a cila është
2 dobia e rrethpresjesë? Shumë nga çdo anë.
Më përpara, sepse fjalët' e Perëndisë u ube-
3 suanë *Judhenjet.* Sepse çë, ndë mos besuanë
ca? mos dotë hethnjë poshtë besën' e Pe-
4 rëndisë pabesëria e atyreve? Qoftë lark; po
Perëndia qoft'i-vërtetë, edhe çdo njeri gënje-
shtar, sikundrë është shkruarë, „Që të dalç
i-drejtë ndë fjalët të tua, edhe të munç kur
të gjykonesh."
5 Po ndë dëften shtrëmbëria jonë drejtërin'
e Perëndisë, ç'duhetë të themi? mos ësht'i-
strëmbërë Perëndia që bje zëmëratënë? (si
6 njeri flas;). Qoftë lark; sepse *atëhere* qysh
7 dotë gjykonjë Perëndia botënë? Sepse ndë
qoftë se me anë të gënjeshtrësë s'ime ushtua
e-vërtet'e Perëndisë për lavdi t'ati, përse më
8 unë gjykonem si fajtuar? Edhe, (sikundrë
shahemi, edhe sikundrë thonë ca, se neve
themi,) përse të mos bëjmë të-ligatë, që të
vinjënë të-miratë? Dënimi i të-ketillëvet ësht'
i-drejtë.
9 Çë pra? jemi neve më të-mirë *se gjënta-
rëtë?* pa fjalë jo; Sepse e treguamë më për-
para, se edhe Judhenjtë edhe Grekëritë, të-

10 gjithë janë ndënë faj; Sikundrë është shkru-
11 arë, „Se s'ka të-drejtë as një; S' ka as një
që kupëton; s'ka as një që kërkon Perëndinë.
12 Të-gjithë duallnë jashtë udhësë, bashkë u-
bënë të-pavëjyerë; s' ka kush të bënjë
13 të-mirë; s' ka as një" „Varr i-hapëtë është
gurmaz' i atyre; më gjuhët' e tyre flisninë
kobime;" „verër aspidhash është ndënë buzët
14 t'atyre" „Goj'e të-cilëvet është plot me mallë-
15 kim e me hidhërim." „Këmbët' e atyreve janë
të-çpejta për të derdhurë gjak"; „Të-shkretuar'
e të-hequrë keq *është* ndëpër udhët t' aty-
17 reve; Edhe udhë paqtimi nukë kanë njohurë."
18 „Nuk'është frikë Perëndie përpara syvet t'a-
tyre".
19 Edhe dimë se sa thotë nomi, u'a thot' a-
tyre që janë ndënë nomt; që të thuretë çdo
gojë, edhe gjithë bota të bënetë fajtore për-
20 para Perëndisë. Sepse prej punërash nomi
s' ka për të dal' i-drejtë asndonjë mish për-
para ati; sepse me anë të nomit njihetë faji.
21 Po ndashti pa nom uçpërfaq drejtëria e
Perëndisë, dyke umartirisurë prej nomit edhe
22 prej profitërvet; *Po,* drejtëria e Perëndisë
me anë të besësë mbë Jisu Krishtinë ndër gjithë
e mbi gjith' ata që besonjënë; sepse nukë ka
23 *ndonjë farë* ndryshimi; Sepse të-gjithë fë-
jyenë, edhe të-gjithëve u shteretë lavdia e Pe-
24 rëndisë; Edhe dalënë të-drejtë dhurëti me
anë të hirit t' ati, me anë të çpërblimit që

25 është mbë Jisu Krishtinë; Të-cilinë Pe-
rëndia e vuri që përpara *që të jetë* vegëlë
çpërblimi me anë të besësë ndë gjakt t'ati,
që të tregonjë drejtërin'e ti, për ndjesën'e
fajevet që qënë bërë përpara, me anë të du-
26 rimit të Perëndisë; Që të tregonjë drejtërin'e
ti ndë këtë kohë, që të jet' ay i-drejtë, edhe
të nxjerrë të-drejtë atë që i beson Jisujt.
27 Ku *është* pra të-mburruritë? Umbyll jashtë.
Me cilinë nom? *me nomn'e* punëvet? Jo; po
me nomin'e besësë.
28 Kupëtojmë pra, se njeriu del' i-drejtë me
anë të besësë, pa punët' e nomit.
29 Apo vetëm' i Judhenjet është Perëndia?
e jo edhe i kombevet? Po, *është* edhe i kom-
30 bet; Sepse një është Perëndia që dotë nxje-
rrë të-drejtë rrethpresjenë prej besësë, edhe
31 parrethpresjenë me anë të besësë. Nominë
pra hethmë poshtë me anë të besësë? Qoftë
lark; po nominë vërtetojmë.

Krye 4.

1 Ç' dotë themi pra se fitoj Avraami, ati
ynë pas mishit?
2 Sepse ndë dolli i-drejtë Avraami prej pu-
nevet, ka mbë se të mburretë, po jo për-
3 para Perendisë. Sepse ç'thotë shkronja? „Edhe
i besoj Avraami Perëndisë, edhe i unumërua
4 ati për drejtëri." Edhe ati që punon paga
5 nuk' i numëronetë si hir, po si detyrë; Po

ati që s' punon, edhe i beson ati që nxjer
të-drejtë të-shtrëmbërinë, besa e ati numë-
ronetë për drejtëri.
6 Sikundrë edhe Dhavidhi e rrëfen të-lu-
mëruarët' e ati njeriu, të-cilit Perëndia i nu-
7 muron drejtëri pa punëra, *dyke thënë:* „Lum
ata, të-cilëvet u undjenë paudhëritë, edhe
8 të-cilëvet u umbuluanë fajetë. Lum ay njeri,
të-cilit Zoti nukë dot' i numëronjë faj."
9 Këta të-lumëruarë pra *thuhetë* vetëmë për
ata që janë të-rethprerë, apo edhe për ata
që nukë janë të-rrethprerë? sepse themi se
10 besa i unumërua Avraamit për drejtëri. Si
pra *i* unumërua? kur ishte i rrethprerë, apo
kur ishte i-parrethprerë? Jo kur ishte i-rreth-
11 prerë, po kur ishte i-parrethprerë. Edhe mori
shënjën' e rrethpresjesë për vulë të drejtërisë
që fitoj prej besësë që kishte, kur ishte i-
parrethprerë, që të jet' ay atë i gjith' atyreve
që besonjënë, kur janë të-parrethprerë, që t'u
12 numëronetë edhe atyreve drejtëria; Edhe atë
i rrethpresjesë jo vetëmë mb' ata që janë të-
rrethprerë, po edhe mb' ata që ecënjënë pas
gjurmëvet të besës' s' atit t'ënë Avraam, kur
qe i-parrethprerë.
13 Sepse të-zotuarëtë mb' Avraamnë a mbë
farën' e ati, se dotë jetë trashëgimtar' i bo-
tësë, nuk' *ubë* me anë të nomit, po me anë
14 të drejtërisë që është prej besësë. Sepse ndë
janë trashëgimtarë ata që janë prej nomit,

besa ësht' e-sbrazëtë, edhe të-zotuarëtë ra
15 poshtë. Sepse nomi sjell zëmëratë; sepse ku
16 s' ka nom, *s'ka* as të-dalë jashtë *nomit.* Për-
andaj *trashëgimi është* prej besësë, që të
jetë dhurëti, *edhe* të-zotuarëtë te jetë të-si-
guruarë mbë gjithë farënë, jo vetëmë mb'atë
që është prej nomit, po edhe mb' atë që
është prej besës' s' Avraamit, i-cili është atë
17 i neve të gjithëve, (Sikundre është shkruarë,
„Se të bëra atë të shumë kombeve,") përpara
Perëndisë, të-cilit i besoj, edh' i-cili ep jetë
të-vdekuret, edhe quan të-paqënatë si të-
18 qëna. Ay pa pasurë shpresë me shpresë be-
soj, se dotë bënej atë i shumë kombeve, si-
kundrë qe folurë, „Kështu dotë jetë fara jote;"
19 Edhe passi nuk' ishte i-dobëtë ndë besët
nuk' umendua, se ndashti trup' i ti ishte i-vde-
kurë, sepse ishte posht' e lart një qint vjeç, as
20 të-vdekurit' e shtratit të Sarrësë; As ndë të-
zotuarët' të Perëndisë pat dysim dyke mos
besuarë, po uforcua ndë besët, dyke dhënë
21 lavdi Perëndisë, E dyke qënë i-bindurë, se atë
që i uzotua Zoti ësht' i-zoti edhe t'a bënjë.
22 Përandaj edhe i unumërua ati për drejtëri.
23 Edhe nuk' ushkrua vetëmë për atë, se i
24 unumërua ati, Po edhe për ne, ndë të-cilët
dotë numëronetë, *për ne*, të-cilët'i besojm'ati
që ngjalli prej së-vdekurish Jisunë, Zotinë
25 t'ënë; I-cili udha ndër duar për fajetë t'anë,
edhe ungjall për të-drejtëruarëtë t'enë.

BKSH

Krye 5.

1 Si duallmë pra të-drejtë prej bese, kemi
paqtim me Perëndinë me anë të Zotit t'ënë
2 Jisu Krisht, Prej të-cilit kemi edhe të-hyrëtë
me anë të besësë ndë këtë hir, ndë të-cilët
qëndrojmë; edhe mburremi mbë shpresën'e
3 lavdis' së Perëndisë. Edhe jo vetëmë *këjo,*
po edhe mburremi mbë shtrëngimetë, dyke
4 diturë, se shtrëngimi sjell durim, Edhe duri-
5 mi provë, edhe prova shpresë; Edhe shpresa
nukë turpëron, sepse dashuria e Perëndisë
është derdhurë ndë zëmërat t'ona me anë të
Frymës'së-Shënjtëruarë që na është dhënë.
6 Sepse kur ishimë neve edhe po të-sëmurë,
Krishti vdiq ndë kohët *që qe urdhëruarë* për
7 të-pabesëtë. Sepse mezi për njeri të-drejtë
do ndonjë të vdesë; sepse për të-mirinë mba-
8 se edhe kuxon ndonjë të vdesë. Po Perëndia
dëften dashurin'e ti mbë ne, sepse tek ishi-
më neve edhe po fajtorë, Krishti vdiq për
9 ne; Shumë më tepërë pra, si duallmë të-
drejtë ndashti me anë të gjakut t'ati, dotë
10 shpëtojmë nga zëmërata me anë t'ati. Sepse,
ndë qoftë se kur ishim'armiq upaqtuamë me
Perëndinë me anë të vdekjes'së Birit t' ati,
shumë më tepërë passi upaqtuamë dotë
shpëtojmë me anë të jetës's'ati.
11 Edhe jo vetëmë *këtë,* po edhe mburremi
mbë Perëndinë me anë të Zotit t' ënë Jisu

Krisht, me anë të të-cilit muarmë ndashti
të-paqtuarëtë.
12 Përandaj sikundrë me anë të një njeriu
hyri faji ndë botët, edhe me anë të fajit
vdekja, edhe kështu shkoj vdekja mbi gjithë
13 njerëzit, sepse që të-gjithë fejyenë; (Sepse
edhe gjer ndë kohët të nomit faji ishte ndë
botët, po faj nukë numëronetë, kur s'ka nom.
14 Po vdekja mbretëroj që prej Adhamit *e* gjer
te Moisiu edhe mb'ata që nukë fëjyenë sipas
shëmbëllës'së të-fëjyerit t'Adhamit, i cili ishte
forma e ati që dotë vinte.
15 Po jo si faji, kështu edhe dhurata; sepse
ndë qoftë se për fajin' e njëj vdiqnë të-shu-
mëtë, shumë më tepërë hiri i Perëndisë edhe
dhurata me anë të hirit të një njeriu, të
Jisu Krishtit, tepëroj mbë të-shumëtë.
16 Edhe dhurata nuk'është si *puna që ubë*
me anë të njëj që fëjeu; sepse faji prej njëj
ubë për dënim *të të-gjithëve*, po dhurëtia *ubë*
17 për të-drejtëruarë prej shumë fajesh. Sepse
ndë qoftë se prej fajit të njëj mbretëroj vde-
kja me anë të njëj, shumë më tepërë ata që
marrënë tepëricën'e hirit edhe të dhurëtis'së
drejtërisë dotë mbretëronjënë ndë jetët me
anë të njëj, të Jisu Krishtit.)
18 Sikundrë pra me anë të një faji *erdhi*
dënim mbë gjithë njerëzitë, kështu edhe me
anë të një drejtërie *erdhi* mbë gjithë njerëzitë
19 të-drejtëruarë për jetë. Sepse sikundrë me

anë të të-mos-dëgjuarit të një njeriu ubënë
fajtorë të-shumëtë, kështu edhe me anë të të-
dëgjuarit të njëj dotë bënenë të-drejtë të-
shumëtë.
20 Edhe nomi hyri ndër mest, që të tepëro-
një faji. Edhe ku tepëroj faji, fort tepërë te-
21 përoj hiri; Që, sikundrë mbretëroj faji me
anë të vdekjesë, kështu edhe hiri të mbre-
tëronjë me anë të drejtërisë për jetë të për-
jetëshme, me anë të Jisu Krishtit, Zotit t'ënë.

Kyre 6.

1 Ç'të themi pra? të qëndrojmë ndë fajt,
që të tepëronjë hiri.?
2 Mos dhëntë Zoti; neve që vdiqmë ndë
3 fajt, qysh dotë rrojmë më nd' atë? A
nuk'e dini, se sa upagëzuamë mbë Jisu Kri-
4 shtinë, mbë vdekjen' e ati upagëzuamë? U-
varruamë pra bashkë me atë me anë
të pagëzimit ndë vdekjet, që, sikundrë
Krishti ungjall prej së-vdekurish me anë të
lavdis' s' Atit, kështu edhe neve të ecëjmë
5 ndë jetë të-re. Sepse ndë ubëmë një bimë
bashkë me atë pas shëmbëllimit të vdekjes'
s'ati, dotë jemi edhe pas *shëmbëllimit* të të-
6 ngjallurit; Dyke diturë këtë, se njeriu ynë i-
vjetërë ukryqëzua bashkë *me atë*, që të
prishetë trupi i fajit, që të mos i shërbejmë
7 më fajit. Sepse ay që vdiq ulirua nga faji.
8 Edhe ndë vdiqmë bashkë me Krishtinë, besoj-

9 më se edhe dotë rrojmë baskhë me atë; Sepse
e dimë se Krishti, që ungjall prej së-vdeku-
rish, nukë vdes më; vdekja nuk'e pushton
10 më atë. Sepse atë që vdiq, vdiq një herë për
fajnë ; po atë që rron, rron mbë Perëndinë.
11 Kështu edhe ju numëro-e-ni vetëhenë t'uaj,
se jeni të-vdekurë për fajinë, po të-gjallë
mbë Perëndinë, me anë të Jisu Krishtit, Zo-
tit t' ënë.
12 Letë mos mbretëronjë pra faji ndë trupt
t'uaj të-morçim, që t'i bindeni ati pas dëshë-
13 rimevet t'ati; As mos tregoni anët' e trupit
t'uaj armë shtrëmbërie ndë fajt; po tregoni
vetëhenë t'uaj te Perëndia si të-gjallë prej
së vdekurish, edhe anët *e trupit* t uaj armë
14 drejtërie te Perëndia. Sepse faji nukë dot' u
pushtonjë juve; sepse nukë jemi ndënë nom,
po ndënë hir.
15 Çë pra? të fëjejmë, sepse nukë jemi ndënë
nom, po ndënë hir? Zoti mos e dhëntë.
16 Nuk'e dini, se mb' atë që tregoni vetë-
henë t'uaj shërbëtorë që t'i bindeni, jini shër-
bëtorë t'ati që i bindeni, a të fajit për vde-
17 kje, a të të-dëgjuarit për drejtëri? Po i falemi
ndersë Perëndisë, se ishitë *një herë* shërbë-
torë të fajit, po *ndshti* ubinttë prej zëmëre
ndë formët të mësimit qe udha ndër ju.
18 Edhe si uliruatë nga faji, ubëtë shërbëtorë
19 të drejtërisë. Njerëzish po flas, për dobësi-
rën'e mishit t'uaj. Sepse sikundrë i bëtë a-

BKSH

nët' *e trupit* t'uaj shërbëtorë ndë ndyrësirët
edhe ndë panomit për panominë, kështu nda-
shti bëni anët' *e trupit* t'uaj shërbëtorë ndë
20 drejtërit për shënjtërim. Sepse kur ishitë
shërbëtorë të fajit, ishitë të-liruarë nga drej-
21 tëria. Ç'farë peme pra kishit' atëhere nga ato
punë, për të-cilatë ndashti kini turp? sepse
22 e pastajmja e atyreve është vdekje. Po nda-
shti që uliruatë nga faji, edhe ubëtë shër-
bëtorë te Perëndia, keni pemënë t'uaj për
shënjtërim; edhe për funt jetë të-përjetësh-
23 me. Sepse paga e fajit është vdekje, po dhu-
rëtia e Perëndisë *është* jet'e-përjetëshme me
anë të Jisu Krishtit, Zotit t'ënë.

Krye 7.

1 Apo nuk'e dini, o vëllezër, (sepse u flas
njerësve qe dinë nomnë,) se nomi ka pushtet
2 mbi njerinë sa kohë rron? Sepse gruaja e-
martuarë ësht' e-lidhurë nga nomi me burrinë
gjersa ky ësht' i-gjallë; po ndë vdektë burri,
3 lironetë nga nomi i burrit. Kur rron pra bu-
rri, ndë ubashkoftë me tjetërë burrë, dotë
jetë kurvë; po ndë vdektë burri, esht' e-liru-
arë nga nomi, që të mos jetë kurvë, ndë u-
4 bashkoftë me tjetërë burrë. Përandaj, vëlle-
zërit'e mi, edhe ju jeni të-vdekurë te nomi
me anë të trupit të Krishtit, që të bashko-
neni me tjetërë, me atë që ungjall prej së-
vdekurish, që të bjemë pemë te Perëndia.

BKSH

5 Sepse kur ishimë ndë misht, dëshërimet' e
fajevet, qe ishinë me anë të nomit, punone-
shinë ndër anët *të trupit* t'ënë, që të bjemë
6 pemë nde vdekjet; Po ndashti usgithmë nga
nomi, passi vdiq ay prej të-cilit ishimë pu-
shtuarë; që të punojmë pas frymës' së-re, e
jo pas shkronjës' së-vjetërë.
7 Ç'të themi pra? nomi *është* faj? Qoftë
lark; po fajnë nuk'e njoha, veç me anë të
nomit; sepse edhe dëshërimnë nukë dot'a
njihnjam, po të mos thoshte nomi, „Mos dë-
8 shërojsh.“ Po faji dyke marrë çkak me anë
të porosisë ngjalli tek unë çdo farë dëshë-
9 rimi; sepse pa nom faji është i-vdekurë. Edhe
unë rronjam një herë pa nom; po kur erdhi
porosia, faji ungjall përsëri, e unë vdiqa;
10 edhe *kështu* porosia qe udha për jetë, ajo
11 ugjënt tek unë për vdekje. Sepse faji, dyke
marrë çkak me anë të porosisë, më gënjeu,
12 edhe me anë t'asaj më vrau. Përandaj nomi
ësht' i-shënjtëruarë, edhe porosia e-shënjtë-
ruar'edhe e-drejtë edhe e-mirë.
13 Ajo gjë pra që ësht' e-mirë ubë tek unë
vdekje? Qoftë lark; po faji, që të duketë faj,
me anë të së-mirësë pruri tek unë vdekje,
qe me anë të porosisë faji të bënetë fort te-
përë fajtuar.
14 Sepse e dimë se nomi ësht'i-frymëtë; po
15 unë jam i-mishtë, shiturë ndënë fajinë. Sep-
se atë që punonj nuk' e njoh; sepse nukë

BKSH

bënj atë që dua, po bënj atë që kam cmir.
16 Edhe ndë bënj atë qe nukë dua, jam mbë
17 një fjalë me nomnë, se ësht' i-mirë. Po nda-
shti nuk' e bënj më unë këtë, po faji që rri
18 tek unë. Sepse e di, së nukë rri tek unë,
(do-me-thënë ndë misht t'im,) gjë e-mirë;
sepse të-dashuritë gjendetë tek unë, po të
19 punonj të-mirënë nuk' e gjenj; Sepse nukë
bënj të-mirënë që dua *të bënj*, po të-keqenë
20 që nukë dua, këtë punonj. Edhe ndë bënj
unë atë që nukë dua, më nuk' e punonj un'
21 atë, po faji që rri tek unë. Gjenj pra këtë
nom, se kur dua unë të bënj të-mirënë,
22 gjëndetë tek unë e-liga. Sepse pas njeriut
të-përbrëndësh gjen shëfrim mbë nomn' e
23 Perëndisë; Po shoh një tjatërë nom ndër
anët të *trupit* t'im që lufton kundrë nomit
të mëndjes' s'ime, edhe më skllavos ndë nomt
të fajit që është ndër anët *të trupit* t' im.
24 Mjerë unë njeriu! kush dotë më shpëtonjë
25 nga ky trup i vdekjesë? I falem ndërsë Pe-
rëndisë me anë të Zotit t' ënë Jisu Krisht.
Kështu pra unë me mëndjenë i shërbenj no-
mit të Perëndisë; po me mishinë *i shërbenj*
nomit të fajit.

Krye 8.

1 Ndashti pra s'ka ndonjë dënim për ata
që janë mbë Jisu Krishtinë, që nuk'ecënjënë
2 pas mishit, (po pas Frymësë). Sepse nomi i

BKSH

Frymës' së jetësë mbë Jisu Krishtinë më li-
3 roj prej nomit të fajit edhe prej vdekjesë. Se-
pse atë që s'muntte të bënte nomi, sepse
ishte i-dobëtë me anë të mishit, Perëndia
dyke dërguarë Birin'e ti me shëmbëllim mi-
shi fajtuar, edhe për faj, dënoj fajinë ndë
4 misht; Që të mbushetë drejtërim'i nomit mbë
ne që nukë ecëjmë pas mishit, po pas Fry-
5 mësë. Sepse ata që rronjënë pas mishit,
kanë ndër mëntt punët' e mishit; po ata *që*
rronjënë pas Frymësë *kanë ndër mëntt* punët'e
6 Frymësë. Sepse mendimi i mishit është vde-
kje, po mendimi i Frymësë *është* jetë edhe
7 paqtim. Sepse mendim'i mishit ësht'armiqësi
te Perëndia; sepse ndë nomt të Perëndisë
8 nukë bindetë, po as nukë munt. Edhe sa
janë të mishit nukë muntnjënë t'i pëlqenjënë
Perëndisë.
9 Po ju nukë jeni të mishit, po të Frymësë,
ndë qoftë se rri Frym'e Perëndisë ndër ju.
Po ndë mos ka ndonjë Frymën'e Krishtit,
10 ky nuk'është i ati. Po ndë është Krishti ndër
ju, trupi ësht'i-vdekurë për fajinë; po fryma
11 është jetë për drejtërinë. Po ndë rri ndër ju
Frym'e ati që ngjalli Jisunë prej së-vdeku-
rish, ay që ngjalli Krishtinë prejsë-vdekurish
dot'u apë jetë edhe trupavet t'uaj të-mor-
çim, me anë të Frymës'së ti që rri ndër ju.
12 Kështu pra, o vëllezër, jemi detorë jo të
13 mishi, që të rrojmë pas mishit. Sepse ndë

BKSH

rrofshi pas mishit, kini për të vdekurë, po
ndë vrafshi punët' e trupit me anë të Fry-
13 mësë, dotë rroni. Sepse sa hiqenë prej Fry-
mës' së Perëndisë, këta janë bij të Perëndisë.
15 Sepse s' keni marrë frymë robërie, që të
keni frikë përsëri, po keni marrë frymë birë-
rie, me anë të së-cilësë thërresmë, Avva, o
16 Atë. Vetë Fryma dëshmon bashkë me fry-
17 mënë t'ënë, se jemi bij Perëndie. Edhe ndë
jemi bij, *jemi* edhe trashëgimtarë; trashëgim-
tarë të Perëndisë, edhe trashëgimtarë bash-
kë me Krishtinë, ndë vuafshimë bashkë me
atë, që edhe të lavduronemi bashkë me atë.
18 Sepse unë mendonem, se të-vuarat' e së-
tanishmesë kohë nukë vëjenjënë të mbaraso-
nenë me lavdinë që dotë sbulonetë ndër ne.
19 Sepse të-priturit' e-math të kriesësë pret
20 të-çpërfaqurit' e bijvet të Perëndisë. Sepse
kriesa uvu ndënë urdhër të kotësirësë, jo
dyke dashurë, po për atë që e vuri ndënë
21 urdhër, Me shpresë se edhe vetë kriesa dotë
lironetë nga robëria e prishjesë, e *të vejë* ndë
22 lirit të lavdis' së bijvet të Perëndisë. Sepse e
dimë se gjithë kriesa psherëtin e ka të-dhëm-
23 bura bashkë gjer ndashti. Edhe jo vetëm'
ajo, po edhe ata që kanë pemën' e-parë të
Frymësë, edhe neve vetë psherëtijmë ndër ve-
tëhet t'ënë, dyke priturë birërinë, *do-me-thënë*
24 çpërblimnë e trupit t' ënë. Sepse me shpesënë
shpëtuamë; po shpresa që shihetë nuk' është

shpresë, sepse për atë *gjë* që e seh njeriu
25 përse edhe të sprenjë? Po ndë shprejmë për
atë *gjë* që nuk' e shohëmë, me anë të duri-
mit e presëmë.
26 Gjithashtu edhe Fryma na ndih ndë do-
sirat t'ona, sepse nukë dimë për ç'farë gjëje
të falemi sikundrë duhetë, po vetë Fryma lu-
27 tetë për ne me psherëtima të-pazëshme. Edhe
ay që vëzhgon zëmëratë e di seç *ështē* men-
dimi i Frymësë, se pas *dashurimit të* Perën-
disë lutetë për shënjtorëtë.
28 Edhe e dimë se të-gjitha u ndihnjënë për
të-mirë atyreve që duanë Perëndinë, atyreve
29 që janë thirrurë pas dashurimit t'ati. Sepse
sa njohu që përpara, këta edhe i ndau që
përpara që të jenë si-një-një nga forma me
fytyrën' e Birit të ti, që të jet' ay i parëlindurë
30 ndër shumë vëllezër. Edhe sa ndau që për-
para, këta edhe i thirri; edhe sa thirri, këta
edhe i drejtëroj; edhe sa drejtëroj, këta edhe
i lavduroj.
31 Ç'të themi pra për këto *punë*? Ndë është
Perëndia bashkë me ne, kush *dotë jetë* kun-
32 drë nesh? Sepse ay që nukë kurseu Birin'
e ti, po e dha ndër duar për gjithë ne,
qysh nukë dotë na falnjë neve të-gjitha bash-
33 kë me atë? Cili dotë përflasë të-zgjedhurit'e
Perëndisë. Perëndia *është* ay që drejtëron.
34 Cili dotë jet' ay që dënon? Krishti *ësht'* ay
që vdiq, po edhe më tepër' ay që ungjall,

i-cili edhe është mbë të-djahtët të Perën-
35 disë, i-cili edhe lutëtë për ne. Cili dotë
na ndanjë nga dashuria e Kristit? Shtrën-
gim, a ngushtim, a vdekje, a zi, a të-sveshurë,
36 a rrëzik, a thikë? (Sikundrë është shkruarë,
„Se për tynë vritemi gjithë ditënë; unumë-
37 ruamë posi dhën për të therurë.“) Po mbë
gjithë këto neve dalëmë me tepërë se mun-
38 dës me anë t'ati që na deshi. Sepse më ësh-
të mbushurë mëndja se as vdekje, as jetë,
as ëngjëj, as pushtete, as fuqira, as ato që
janë ndashti, as ato që kanë për të ardhurë,
39 As lartësirë, as thellësirë, as ndonjë tjetërë
kriese, dotë muntnjë të na ndanjë nga da-
shuria e Perëndisë që është mbë Jisu Krish-
tinë Zotinë t'ënë.

Krye 9.

1 Të-vërtetë them mbë Krishtinë, nukë gë-
njenj, (edhe *mbë këtë* ep dëshmim bashkë me
mua dërgjegja ime me anë të Frymës' së-Shënj-
2 tëruarë,) Se kam hidhërim të-math edhe pa
3 pushim të-dhëmburë ndë zëmërët t'ime. Se-
pse unë vetë donjam të-ishnjam i-mallëku-
arë, *i-ndarë*, nga Krishti për vëllezërit' e mi,
4 për farëfisasit' e mi pas mishit; Të-cilëtë
janë Israilitë, të të-cilëvet *është* bireria, edhe
lavdia, edhe dhjatatë, edhe të-vënurit' e no-
5 mit, edhe adhurimi, edhe të-zotuaratë; Të të-
cilëvet *janë* atëritë, edhe prej të-cilëvet lindi

BKSH

Krishti pas mishit, i-cili është përmbi të-
gjitha Perëndi i-bekuarë për *gjithë* jetëtë.
Amin.
6 Po nukë munt të jetë që të ketë rënë
poshtë fjal' e Perëndisë. Sepse gjithë sa janë
7 prej Israilit, këta nukë janë Israil; As sepse
janë far' e Avraamit, *për këtë janë* të-gjithë
bij *t'ati*; po „mbë Isaakunë dotë quhetë fara
8 jote.„ Do-me-thënë, bijt' e mishit, nukë *janë*
këta bij të Perëndisë; po bijt'e të-zotuarit numë-
9 ronenë për farë. Sepse fjal'e të-zotuarit është
këjo, „Mbë këtë kohë dotë vinj, edhe Sarra
dotë ketë bir."
10 Edhe jo vetëmë *këjo*, po edhe Reveka kur
ugjënt me barrë prej një *burri*, prej Isaakut
11 atit t'ënë; (Sepse para se të lindinë *djemtë*,
edhe para se të bëninë ndonjë *punë* të-mirë
a të-ligë, që të mbetetë urdhëri i-parë i Pe-
rëndisë që është prej të-sgjedhuri, jo prej
12 punësh, po prej ati që thërret,) I utha asaj,
„Se m'i-madhi dot' i shërbenjë më të-vogë-
13 lit;" Sikundrë është shkruarë, „Jakovin' e
desha, po Isafinë e pata cmir."
14 Ç'të themi pra? Mos *ka* shtrëmbëri te
15 Perëndia? Qoftë lark. Sepse Moisiut i thotë,
„Dotë përdëllenj atë që të përdëllenj, edhe
dotë më dhëmbetë për atë që të më dhëm-
16 betë." Kështu pra *këjo* nuk' *ështe* prej ati që
do, as prej ati që suletë, po prej Perëndisë
17 që përdëllen. Sepse shkronja i thotë Farao-

nit, „Se për këtë të ngrita, që të dëftënj mbë
ty fuqinë t'ime, edhe që të rrëfenetë emëri
18 im mbë gjithë dhenë.“ Atë pra që do t'e
përdëllenjë, e përdëllen; edhe atë që do *t'*
ashpëronjë, e ashpëron.
19 Dotë më thuash pra, Përse më gjen faj?
cili munt të rrijë kundrë dashurimit t'ati?
20 Po cili je ti, o njeri, që i kundrëpërgjigjesh
Perëndisë? Mos munt t'i thotë gatesa gato-
21 njësit, Përse më bëre kështu? Apo s'ka pu-
shtet stëmbari mbi baltënë, që të bënjë prej
gjithati brumi një enë për nder, edhe një tje-
22 tërë për çnderim? E cë, ndë Perëndia, duke
dashurë të-dëftenjë zëmëratën' *e ti*, edhe të
bënjë të-njohurë fuqin'e ti, duroj me shumë
zëmërë të-gjerë enë zëmërate që qenë bërë
23 për të humburë? Edhe që të bënjë të-njo-
hurë pasjen' e lavdis' së tij mbi enë përdë-
24 llimi, të cilatë i bëri për lavdi, Mbi ne, të-
cilëtë edhe na thirri jo vetëmë prej Judhenjvet,
po edhe prej kombevet?
25 Sikundrë edhe ndë Osienë thotë, „Dotë
quanj llaus t'im atë s'ka qënë llauzi im,
26 edhe të-dashurë, të-mosdashurënë.“ „Edhe
dotë jetë nd' atë vënt, tek u është thënë aty-
reve, Nukë *jeni* ju llauzi im, atje dotë quhe-
27 në bij të Perëndis' së-gjallë.“ Edhe Isaia bër-
tet për Israilinë, „*Edhe* ndë qoftë numëri i
të bijvet të Israilit posi rëra e detit, e-mbe-
28 tura e atyre dotë shpëtonjë; Sepse dotë mba-

BKSH

ronjë e dotë shkurtonjë llogari me drejtëri,
sepse Zoti dotë bënjë logari të-shkurtuarë
29 mbi dhet.“ Edhe sikundrë tha që përpara I-
saia, „Zoti Savaoth të mos kishte lënë farë
mbë ne, dotë ishimë bërë posi Sodhomatë,
edhe dotë kishimë përgjaturë me Gomorratë.“
30 Ç'të themi pra? Se ata kombe që s'ndoqnë
drejtëri, arritnë mbë drejtëri, mbë drejtërinë
31 që është prej besësë; Po Israili dyke ndje-
kurë nomn' e drejtërisë, ndë nomt të drejtë-
32 risë nuk' arriti. Përse? Sepse nuk' e *ndiqte*
me anë bese, po me anë të punëvet të nomit.
33 Sepse upenguanë ndë gurt të pëngesësë;
sikundrë është shkruarë, „Na tek vë ndë
Sion një gur pëngese, edhe një shkëmp skan-
dhalli, edhe kushdo që i beson ati nukë dotë
turpëronetë.“

Krye. 10.

1 Vëllezër, dëshërimi i zëmërësë s'ime, edhe
lutja që *bënj* mbë Perëndinë për Israilinë,
2 është për shpëtim *t' atyre.* Sepse dëshmonj
për ata, se u përvëlonetë zëmëra për Perën-
3 dinë, po jo pas kupëtimi të-drejtë. Sepse dyke
mos njohurë drejtërin' e Perëndisë, edhe dy-
ke kërkuarë të ngrehënë drejtërin' e tyre,
4 nuk' ubintnë ndë drejtërit të Perëndisë. Se-
pse fundi i nomit është Krishti për drejtëri
te cilido që beson.

BKSH

5 Sepse Moisiu shkruan për drejtërinë që
është prej nomit, *dyke thënë*, „Se njeriu që
6 bën këto, dotë rronjë me anë t'atyre." Po
drejtëria që është prej besësë thotë kështu,
„Mos thuash ndë zëmërët t'ënde, Kush dotë
hipënjë ndë qiellt?" do-me-thënë, që të sbre-
7 së Krishtinë; A, „Kush dotë sbresë ndë pa-
fundjet?" do-me-thënë, që të sjellë lart Kri-
8 shtinë prej së-vdekurish. Po ç'thotë? „Fjala
është afërë teje, ndë gojët t'ënde e ndë zë-
mërët t'ënde;" do-me-thënë, fjala e besësë,
9 që lëçismë; Se ndë rrëfefsh me gojënë t'ën-
de Zotinë Jisu, edhe ndë besofsh ndë zëmë-
rët t'ënde se Perëndia e ngjalli atë prej së-
10 vdekurish, dotë shpëtonjç. Sepse *njeriu* be-
son me zëmërë për drejtëri, edhe me gojë
bënetë rrëfim për shpëtim; Sepse shkronja
thotë, „Gjithëkush beson mb'atë, nukë dotë
turpëronetë."
12 Sepse s'ka të-çquarë ndër mest të Judheut
e të Grekut; sepse gjithay Zot *ësht'* i të-gji-
thëve, i-pasurë për gjith'ata që thërresënë
13 mb' atë. Sepse gjithëkush të thërresë mb'e-
mërin'e Zotit, dotë shpëtonjë.
14 Qysh pra dotë thërresënë mb'atë, të-cilit
nuk'i besuanë? edhe qysh dot'i besonjën'ati
për të-cilinë nukë kanë dëgjuarë? edhe qysh
15 dotë dëgjonjënë, pa pasurë lëçitës? Edhe qysh
dotë lëçinjënë, ndë mos udërgofshinë? Sikun-
drë është shkruarë, „Sa të-bukura janë këm-

bët' e atyreve që apënë zën' e-mirë për paq-
tim, t'atyreve që apënë zën' e-mirë për të-
16 miratë. Po të gjithë nuk'ubintnë ndë ungjillt,
sepse Isaia thotë, „Zot, kush i besoj të-lë-
çiturit t'ënë?"
17 Besa pra është prej dëgjimi; edhe dëgji-
18 mi me anë të fjalës' së Perëndisë. Po them,
Mos nukë dëgjuanë? Po, me të-vërtetë „zër'i
atyreve dolli mbë gjithë dhenë, edhe fjalët'e
19 atyreve *vanë* gjer nd' anët të botësë. „Po
them," Mos nukë njohu Israili? I-pari Moi-
siu thotë, „Unë dot' u shtje juve ndë zili me
anë t'atyre që nukë janë kombi *im*, edhe dot'
u bënj juve të zëmërohi me anë një kombi që
20 s'ka mënt." Po Isaia kuxon edhe më tepërë
e thotë, „Ugjënçë tek ata që s'më kërkoni-
në, udukçë mb'ata që nukë pyetninë për
21 mua." Po Israilit i thotë, „Tërë ditënë shtri-
ta duart' e mia mbë një llaus që nukë bin-
det' e flet kundrë."

Krye. 11.

1 Them pra, Mos e hodhi tej Perëndia llau-
zin' e ti? Qoftë lark; sepse edhe unë Israilit
jam, prej farës' s'Avraamit, prej degës'së Ve-
2 niaminit. Perëndia nuk'e hodhi tej llauzin'e
ti, të-cilin' e njohu që përpara. Apo nukë di-
ni ç'thotë shkronja për Ilinë? qysh flet te
3 Perëndia kundrë Israilit, (dyke thënë,) „Zot
profitërit'e tu i vranë, edhe theroret' e tua i

rrëzuanë; edhe unë mbeta i-vetëmë, edhe
4 kërkonjënë jetënë t'ime." Po ç'i thotë për-
gjigja e Perëndisë.? „Kam lënë për vetëhenë
t'ime shtatë mijë burra, të-cilëtë nuk' uunjnë
5 mbë gjunjë përpara Vaallit. "Kështu pra edhe
ndë kohët të-tanishme ka mbeturë një mbe-
6 tje pas të-sgjedhurit të hirit. Edhe nd'*është*
prej hiri, nuk'*është* më prej punërash; sepse
ndryshe hiri nuk'është më hir. Po ndë është
prej punërash, nuk' është më hir; sepse puna
7 nuk' është më punë. Çë pra? Israili nuk'e gjeti
atë që kërkon; po të-sgjedhurit'e gjetnë, edhe
8 të tjerët' uverbuanë, (Sikundrë është shkruarë
„Perëndia u dha atyre frymë të-dërmituri, sy
që të mos shohënë, edhe veshë që të mos dë-
9 gjonjënë.") gjer mbë ditët të-sorme. Edhe
Dhavidhi thotë, „Ubëftë truvez'e atyrë për
kurth, e për lak e për pëngesë, e për çpagim mb'
10 ata; Uerrësofshinë syt' e atyre për të mos parë;
edhe kurrizin' e atyreve kërrus-e për gjithënjë.
11 Them pra, Mos fëjyenë, që të rrëzonenë?
Qoftë lark; po me anë të të-rrëzuarit t'atyre
ubë shpëtim ndër kombet, që t'i shtjerë ata
12 ndë zili. Edhe ndë është të-rrëzuarët'e atyreve
pasje për botënë, edhe humbja e atyreve
pasje për kombetë, sa më të-tepërë dotë jetë
të-mbushurit' e atyreve?
13 Sepse juve kombevet u them, (gjersa jam
unë apostoll i kombevet, lavduronj shërbe-
14 sënë t' ime,) Semos i shtije ndë zili ata që

janë mishi im, edhe shpëtonj ca nga ata.
15 Sepse ndë *është* të-hedhurit'e atyreve tej të-
paqtuarë të botësë, ç'*tjetërë dotë jetë* të-pritu-
rit'e atyre, përveç se jetë prej së-vdekurish.
16 Edhe ndë është pem'e-parë e-shënjtëru-
arë, *është* edhe *tërè* brumi; edhe ndë është
17 rrënja e-shënjtëruarë, janë edhe degatë; Po
ndë ukëputnë ca nga degatë, e ti që ishnje
ulli i-egrë ushartove ndër ato, edhe ubëre
pjesëtar i rrënjësë edhe i të-majmit të dru-
18 rit të ullirit, Mos umburr kundrë degavet;
edhe ndë burresh, ti nukë mban rrënjënë, po
19 rrënja *të mban* ty. Dotë thuash pra, Ukëput-
20 në degatë, që të shartonem unë. Mirë; për
pabesërinë ukëputnë, po ti qëndron me anë
të besësë. Mos umbaj mbë të-lartë, po kij
21 frikë; Sepse Perëndia ndë mos kurseu de-
gatë prej nature, *druaj* semos nukë kursenjë
edhe ty.
22 Shih pra mirësinë edhe ashpërimn'e Pe-
rëndisë; mb'ata që urrëzuanë, ashpërimnë,
edhe mbë ty, mirësinë, ndë qëndrofsh ndë
mirësit; sepse *ndryshe* edhe ti dotë këputesh.
23 Kështu edhe ata, ndë mos qëndrofshinë ndë
pabesërit, dotë shartonenë; sepse Perëndia
24 ësht'i-fuqishim prapë t'i shartonjë ata. Sepse
ndë ukëpute ti nga ullir' i-egre prej nature,
edhe kundrë naturësë ushartove ndë ulli të-
butë, sa më tepërë këta që janë prej nature
dega dotë shartonenë ndë ullit të tyre?

25 Sepse nukë dua të mos dini, o vëllezër,
këtë fshehtësirë, (që të mos mbahi të-mën-
çim ndër vetëhet t'uaj,) se ubë të-verbuarë
mbë një pjesë të Israilit, gjersa të hynjë të-
26 mbushurit'e kombevet; Edhe kështu gjithë
Israili dotë shpëtonjë, sikundrë është shkru-
arë, „Dotë vinjë prej Sionësë ay që çpër-
blen, edhe dotë largonjë pabesëritë nga Ja-
27 kovi. Edhe këjo është nga ana ime dhjata
mb' ata, kur të heq fajet'e atyre."
28 Sipas ungjillit janë armiq për ju, po si-
pas të-sgjedhurit *janë* të-dashurë për atëritë.
29 Sepse dhurëtit' edhe të-thërriturit' e Perën-
30 disë janë të-patundura. Sepse sikundrë edhe
ju njëhere ishitë të-pabindurë te Perëndia, po
ndashti upërdëllyetë me anë të të-pabindurit
31 të këtyreve; Kështu edhe këta ndashti nuk'
ubintnë, që me anë të përdëllimit *që utregua*
32 mbë ju të përdëllenenë edhe ata. Sepse Pe-
rëndia i mbylli të-gjithë ndë pabindjet, që t'i
përdëllenjë të-gjithë.
33 O thellësirë pasjeje e urtësie e diturie
Perëndie! sa të pavëzhguarshim janë gjyqet'
e tu, edhe sa të-pakupëtuarshime udhët' e tua!
34 Sepse „kush e njohu mëndjen' e Zotit? a
35 kush ubë këshillës i ati?" A „kush i dha gjë
36 përpara, që t'i bënetë ati çpagim?" Sepse prej
ati, edhe me anë t' ati, edhe mb' atë janë të-
gjitha; mb' atë qoftë lavdia ndë jetët të je-
tëvet. Amin.

BKSh

Krye 12.

1 U lutem pra juve, o vëllezër, për përdëlli-
met' e Perëndisë, të tregoni trupatë t' uaj kur-
ban të-gjallë, të-shënjtëruarë, të-pëlqyerë te
Perëndia, *që është* adhurimi juaj i-mënçim.
2 Edhe mos bëhi mbë një formë me këtë jetë;
po ndërroni formënë t' uaj me anë të të-për-
sëriturit të mëndjesë s' uaj, që të provoni cili
është i-miri, i-pëlqyeri edhe i-sosuri dashu-
rim i Perëndisë.
3 Sepse them, me anë t' ati hirit që më është
dhënë, mbë gjithë-sicilinë prej jush, të mos
mendonjë *për vetëhen' e ti* më tepërë se sa
gjan të mendonjë, po të mendonjë kështu,
që të bënetë i-urtë, pas masës' së besësë që
4 i ndau Perëndia gjithë-sicilit. Sepse sikun-
drë ndë një trup kemi shumë anë, edhe gji-
5 thë anëtë nukë kanë gjithatë punë; Kështu
edhe *neve*, ndonëse jemi shumë, jemi një trup
mbë Krishtinë, edhe gjithë-sicili jemi anë të
6 njëri tjatrit. Edhe kemi dhurëtira te-ndrysh-
me pas hirit që na udha; ndë *kemi* profiti,
letë profitepsmë pas pjesës' së besësë *që na*
7 *udha*; Ndë shërbesë, *letë qëndrojmë* ndë shër-
besët; kush është mësonjës, *letë epetë* pas
8 mësimit; Kush ka *dhurëtin'* e të dhënit kë-
shilla, *letë apë* këshilla; kush ep nga e tia,
letë apë me zëmërë të-thjeshtë; kush ësht' i-
parë, *letë jetë i-parë* me kujdes; kush përdë-
llen, *letë përdëllenjë* me buzë të-qeshurë.

BKSH

9 Dashuria letë mos jetë me dy faqe; kini
10 cmir të-ligënë, e ngjituni pas së-mirësë. Doni
fort njëri tjetërinë me dashuri vëllazërie; ndë
11 të-nderuarë shkoni-e njëri tjetërinë; Ndë pu-
nët të jini të-papërtuarshim; ndë shpirtt të
12 jini të-nxehëtë; Zotit t'i shërbeni; Ndë shpre-
sët të gëzohi; ndë shtrëngimt të duroni;
13 ndë të-falurit të qëndroni; Ndë nevojat të
shënjtorëvet të ndihni; nga të-priturit të-hu-
14 ajtë me miqësi mos hiqni dorë. Bekoni ata
që u ndjekënë juve; bekoni e mos mallëko-
15 ni. Gëzohi me ata që gëzonenë, edhe qani
16 me ata që qanjënë. Kini gjithata mendime
ndër mest t'uaj; mos umbani mbë të-lartë
po unjuni bashkë me të-përunjuritë; mos kuj-
toni vetëhenë t'uaj për të-mënçim.

17 Asnjeriu mos i çpaguani të-keqe për të-
keqe; kujdesuni për *punëra* të-mira përpara
18 gjithë njerësvet. Ndë mundetë, sa varetë nga
19 ju, të kini paqtim me gjithë njerëzitë. Mos
merrni çpagim për vetëhenë t' uaj, o të-da-
shurë, po bëni udhë zëmërimit; sepse është
shkruarë, „Imi është çpagimi; unë kam për
20 të çpaguarë, thotë Zoti.“ Ndë i arthtë uri pra
armikut t' ënt, ep-i të hajë; ndë i arthtë et,
ep-i të pijë; sepse dyke bërë këtë dotë ngrum-
bullonjç thëngjij *të-ndezurë* mbi kryet t' ati.
21 Mos umunt prej së-ligësë, po munt të-ligënë
me të-mirënë.

Krye 13.

1 Çdo shpirt letë unjë kryetë ndë pushtetet
që janë përmbi atë; sepse nukë ka pushtet
veç prej Perëndisë; edhe pushtetetë që janë
2 jan' urdhëruarë prej Perëndisë. Përandaj ay që
rri kundrë pushtetit, i rri kundrë urdhërit të
Perëndisë; edhe ata që rrinë kundrë, dotë
3 marrënë dënim mbë vetëhet të tyre. Sepse
urdhëtarëtë nukë janë frikë për punërat' e-
mira, po për të-ligatë. Do pra të mos i kesh
frikë pushtetit? bëj të-mirënë, edhe dotë kesh
4 lavdim prej ati. Sepse urdhërtari është shër-
bëtuar i Perëndisë të ti për të-mirënë. Po
ndë bëfsh të-ligënë, kij frikë; sepse nuk' e
mban mbë kot thikënë; sepse është shërbë-
tuar i Perëndisë, çpagimmarrës që të mbu-
shnjë zëmërimnë kundrë ati që punon të-li-
5 gënë. Përandaj është nevojë të unjni kryetë,
jo vetëmë për zëmërimnë, po edhe për ndër-
6 gjegjenë. Sepse për këtë paguani edhe pa-
gesa, sepse janë shërbëtorë Perëndie, që shi-
6 konjënë këtë punë. La-u-ni pra të-gjithëve
detyratë; ati që i kini detyrë pagesënë, pa-
gesënë; *ati që i kini detyrë* të-dhënatë, të-dhë-
natë; ati *që i kini detyrë* frikënë, frikënë; ati
që i kini detyrë nderinë, nderinë.

8 Asnjeriu mos i kini detyrë asgjë, përveç se
të doni njëri tjatërinë; sepse ay që do tjatërinë,
9 ka mbushurë nominë. Sepse porositë, „Mos

kurvëronjç, Mos vraç, Mos vjethç, Mos apç
dëshmim të-rrem, Mos dëshëronjç," edhe çdo
tjetërë porosi *që të jetë*, janë përmbledhurë
ndë këtë fjalë, „Të duash të-afërminë t' ënt
10 posi vetëhenë t'ënde." Dashuria të-afërmit
nuk' i bën keq; dashuria pra ëhstë të-mbu-
shurit' e nomit.
11 Edhe ketë, dyke diturë kohënë, se ndashti
është ora të sgjonemi nga gjumi; sepse nda-
shti shpëtimi ynë *është* më afërë, se atëhere
13 që besuamë. Nata uthye, e dita uafërua; letë
hethmë pra tej punët' e errësirësë, *edhe* letë
veshmë armët' e dritësë. Let' ecëjmë hieshim
si ditënë; jo ndër lodrëtia e ndër të-dejtura,
jo ndër shtrate *kurvërie* e ndër ndyrësira, jo
14 ndër qarta e ndë cmir; Po vishni Zotinë Jisu
Krisht, edhe mos kini kujdes për mishinë
që t' i bëni dëshërimetë.

Krye 14.

1 Edhe atë që ësht' i-dobëtë ndë besët, prit-
e-ni *me të-mirë*, e jo me të-grindura për men-
2 dime. Sepse një beson se *munt* të hajë *nga*
të-gjitha, po ay që është i-dobëtë ha lakëra.
3 Ay që ha letë mos bënjë për asgjë atë që
s' ha; edhe ay që s' ha letë mos gjykonjë atë
4 që ha; sepse Perëndia e ka priturë. Cili je ti
që gjykon shërbëtorin' e-huaj? mbë zotin' e ti
ay qëndron a bje; po dotë qëndronjë; sepse
Perëndia ësht' i-fortë t'a qëndronjë atë.

BKSH

5 Sepse një e çëmon një ditë më tepërë se
një tjetërë ditë, e një tjetërë çëmon gjithë
6 dittë si-një-një. Gjithë-sicili letë mendonetë
si i është mbushurë mëndja. Ay që ruan di-
tënë, për Zotin' e ruan, edhe ay që nuk' e
ruan ditënë, për Zotinë nuk' e ruan. Ay që
ha, për Zotinë ha, edhe ay që nukë ha, për
Zotinë nukë ha, edhe i faletë ndersë Perën-
7 disë. Sepse asndonjë prej nesh s' rron për
vetëhen' e ti, edhe asndonjë s' vdes për ve-
8 tëhen' e ti. Sepse edhe ndë rrojmë, për Zo-
tinë rrojmë; edhe ndë vdesmë, për Zotinë
vdesmë. Edhe ndë rrojmë pra edhe ndë vdes-
9 më, të Zotit jemi. Sepse për këtë Krishti edhe
vdiq (edhe ungjail) edhe rrojti përsëri, që të
zotëronjë edhe mbi të-vdekurit' edhe mbi të-
gjallëtë.
10 Po ti përse gjykon vëllanë t'ënt? a edhe
ti përse bën për asgjë vëllanë t' ënt? sepse
ne të-gjithë dotë dalëmë përpara gjykatës'
11 se Krishtit. Sepse është shkruarë, „Rronj unë,“
thotë Zoti, „se mua dotë më unjetë çdo gju,
edhe çdo gjuhë dotë lavduronjë Perëndinë.“
12 Kështu pra gjithë-sicili prej nesh dot' i apë
fjalë Perëndisë për vetëhen' e ti.
13 Pra, letë mos gjykojmë më njëri tjatërinë;
po gjykoni më tepërë këtë, të mos i vini vë-
14 llajt pëngesë, a skandhall. E di edhe më
është mbushurë mëndja mbë Zotinë Jisu, se
prej vetiu s' ka asndonjë gjë të-ndyrë, veç

BKSH

për atë që mendon se ndonjë gjë ësht' e-
15 ndyrë, për atë ësht' e-ndyrë. Po ndë hidhë-
ronetë yt vëlla për të-ngrënëtë t' ënt, *ti* nukë
ecën më pas dashurisë. Mos e bëj atë të
humbasë për të-ngrënëtë t' at, *atë* për të-ci-
16 linë Krishti vdiq. Letë mos shahetë pra e-
17 mira juaj. Sepse mbretëria e Perëndisë nuk'
është të-ngrën' e të-pirë, po drejtëri e paqtim
18 e gëzim ndë Frymët të-Shënjtëruarë; Sepse
ay që i shërben Krishtit me këto, ësht' i-pël-
qyerë te Perëndia, edhe i-priturë te njerëzitë.
19 Kështu pra letë ndjekmë ato që janë për
paqtimnë, edhe ato që janë për të ndrequrë
20 njëri tjetrinë. Mos e prish punën' e Perën-
disë për të-ngrënë. Të-gjitha janë të-qëruara;
po është keq për njerinë që ha me skan-
21 dhall. Është mirë të mos hajë mish njeriu,
as të mos pijë verë, as *të mos bënjë gjë*, mbë
të-cilënë pengonet' a skandhaliset' a sëmuret'
22 yt vëlla. Ke ti besë? kij-e atë ndë vetëhet
t' ënde përpara Perëndisë; lum ay që nukë
dënon vetëhen' e ti mb' atë *gjë* që e gjen
23 për të-mirë. Po ay që është me dy mëndje,
edhe ndë hëngrëtë, dënonetë; sepse nukë
ha prej bese; edhe çdo gjë që nukë *bënetë*
prej bese, është faj.

Krye 15.

1 Edhe neve të-fortëtë kemi detyrë të mbaj-
më dobësirat' e atyre që janë të-dobëtë, e jo

BKSH

2 t'i pëlqejmë vetëhesë: Po gjithë-sicili prej
nesh let' i pëlqenjë të-afërmit për të-mirënë,
3 për ndreqje. Sepse edhe Krishti nuk' i pël-
qeu vetëhes' së ti, po sikundrë është shkru-
arë, „Të-sharat' e atyreve që të shanjënë ty
4 ranë mbi mua." Sepse sa ushkruanë që më
përpara, ushkruanë që më përpara për më-
simnë t'ënë, që të kemi shpresë me anë të
durimit e të ngushullimit të shkronjavet.
5 Edhe Perëndia i durimit e i ngushullimit u
dhëntë juve të këni gjithatë mëndje ndër mest
6 t'uaj sipas Jisu Krishtit; Që të lavduroni me
një zëmërë *e* me një gojë Perëndinë edhe
7 Atin' e Zotit t'ënë Jisu Krisht. Përandaj pritni
njëri tjatërinë, sikundrë edhe Krishti na priti
për lavdi të Perëndisë.
8 Edhe them, se Jisu Krishti ubë shërbë-
tuar i rrethpresjesë për të-vërtetën' e Perën-
disë, që të vërtetonjë të-zotuaratë mbë atë-
9 ritë; Edhe që të lavduronjënë kombetë Pe-
rëndinë për përdëllimn' *e ati*, sikundrë është
shkruarë, „Për këtë dotë të lavduronj ndër
kombe, edhe mb' emërinë t' ënt dotë psall."
10 Edhe përsëri thotë, „Gëzohi, o kombe, ba-
11 shkë me llauzin' e ati." Edhe përsëri, „Lavdu-
roni Zonë, gjithë kombetë, edhe lëvdoni atë,
12 gjithë llauzetë." Edhe përsëri Isaia thotë,
„Dotë jetë rrënja e Jesseut," edhe „Ay që dotë
ngrihetë që të mbretëronjë mbi kombet; mb'
atë dotë shprenjënë kombetë."

13 Edhe Perëndia i shpresësë u mbushtë ju-
ve me çdo farë gëzimi e paqtimi me anë të
besësë, që të tepëroni ndë shpresët me anë
të fuqis' së Frymës' se-Shënjtëruarë.
14 Po edhe mua vetë, o vëllezër, më është
mbushurë mëndja për ju, se edhe ju jeni plot
me mirësi, të-mbushurë me çdo dituri, edhe se
15 muntni të këshilloni njëri tjatërinë. Po u shkru-
ajta juve gjer mbë një shkallë më me kuxim,
që t'u bje ndër mëntt, për hirinë që m' udha
16 prej Perëndisë, Që të jem shërbëtuar i Jisu
Krishtit mbë kombet, dyke punuarë të shënj-
tëruarënë punë të ungjillit të Perëndisë, që
të bënetë e-pëlqyerë dhurat' e kombevet *edhe*
e-shënjtëruarë me anë të Frymës' së-Shënj-
17 tëruarë. Kam pra të-mburrurë mbë Jisu Kri-
shtinë për punëratë që kanë të bëjnë me
18 Perëndinë. Sepse nukë dotë kuxonj të flas
per ndonjë nga ato *punëra*, të-cilatë Krishti
nukë bëri me anë t'ime, për të prurë ndë
19 të-bindurë kombetë, me fjalë e me punë, Me
fuqi shënjash e çudirash, me fuqi të Frymës'
së Perëndisë, kaqë sa që nga Jerusalimi e
përqark e gjer ndë Ilirit e kam mbushurë *me*
20 ungjillin' e Krishtit. Edhe kështu upërpoqa
të lëçis ungjillinë, jo ku ishte i-njohurë emër'
i Krishtit, që të mos ndërtonj mbi themel të-
21 huaj; Po, sikundrë është shkruarë, „Ata, ndër
të-cilët s' është dhënë zë për atë, dotë sho-

BKSH

hënë; edhe ata që s'kanë dëgjuarë, dotë ku-
pëtonjënë.
22 Përandaj edhe undaluashë shumë herë e
23 s' erdha dot tek ju. Po ndashti si s'kam më
vënt ndëpër këto anë, edhe passi prej shu-
24 më vjeç kam mall të vinj tek ju, Kur të vete
ndë Spani, dotë vinj ndër ju; sepse shprenj
dyke shkuarë *që aty* t'u shoh juve, edhe të
përcillem prej jush për atje, passi të nginjem
25 gjer mbë një shkallë me ju. Po ndashti po
vete ndë Jerusalim, për të-shërbyerë shënj-
26 torëvet. Sepse Maqedhonia edhe Ahaia e gjet-
në gjë të-pëlqyerë t'u bënjënë një ndihmë
të-vobeqvet të shënjtorëvet që janë ndë Je-
27 rusalim. Me të-vërtetë u pëlqeu *këjo*, edhe
janë detorë ndër ata; sepse ndë ubënë kom-
betë pjesëtarë bashkë me ata ndë punërat të
shpirtit, kanë detyrë t'u shërbenjënë atyreve
28 edhe ndë punërat të mishit. Si të mbaronj pra
këtë, edhe t'u'a ap atyre me siguri këtë pemë,
29 dotë shkonj nga ju për ndë Spani. Edhe e
di, se dyke ardhurë tek ju, dotë vinj me plo-
tësirë të bekimit të ungjillit të Krishtit.
30 Edhe u lutem juve, o vëllezër, me anë të
Zotit t'ënë Jisu Krisht, edhe me anë të da-
shuris'së Frymës'së-Shënjtëruarë, të mundohi
bashkë me mua dyke falurë Perëndisë për
31 mua; Që të shpëtonj nga ata që janë kun-
drësharë të besësë ndë Judhet, edhe që të
jet'e-pëlqyerë mbë shënjtorëtë shërbesa ime

BKSH

32 që po bënj për Jerusalimënë; Që të vinj te ju
me gëzim, ndë dashtë Perëndia, edhe të prë-
33 hem bashkë me ju. Edhe Perëndia i paq-
timit *qoftë* bashkë me ju të-gjithë. Amin.

Krye 16.

1 Edhe u ndorëzonj juve Fivënë, motrënë
t'ënë, që është shërbëtore e kishësë ndë Qen-
2 kreë; Që t'a pritni mbë Zotinë sikundrë vë-
jen për shënjtorëtë, edhe t'i ndihni asaj mbë
çdo gjë që të ketë nevojë prej jush; sepse
edhe ajo u ka ndihurë shumë vetave, edhe
mua vetë.
3 Ep-u-ni të-fala me shëndet Prisqillës' edhe
Aqyllësë, bashë-punëtorëvet të-mi mbë Jisu
4 Krishtinë, (Të-cilëtë për jetënë t'ime vunë
qafën'e tyre ndënë thikët; të-cilëvet u falem
ndersë jo vetëm' unë, po edhe gjithë kishët'
5 e kombevet;) *Si* edhe kishësë që është ndë
shtëpit t'atyreve. Epni të-fala me shëndet të-
dashurit t'im Epenet, i-cili është pem' e-parë
e Ahaisë mbë Krishtinë. Epni të-fala me
shëndet Mariamësë, e-cila shumë umundua
7 për ne. Epni të-fala me shëndet Andhronikut
edhe Junisë, fare-fisasvet të-mi e bashkë-
skllevërvet të-mi, të-cilëtë janë të-shënuar-
shim ndër mest t'apostojvet, të-cilëtë edhe
më përpara se unë kanë qënë mbë Krishti-
8 në. Epni të-fala me shëndet Ampliut, të-dashu-
9 rit t'im mbë Zotinë. Epni të-fala me shëndet

BKSH

Urvanit bashkëpunëtorit t'ënë mbë Krishtinë,
10 si edhe Staqiut të-dashurit t'im. Epni të-fala
me shëndet Apeliut të-provuarit mbë Kri-
shinë. Epni të-fala me shëndet atyreve *që janë*
11 *prej shtëpis'* s'Aristovulit. Epni të-fala me
shëndet Irodhionit farëfisasit t'im. Epni të-
fala me shëndet atyreve *që janë* prej shtëpis'
12 së Narqissit, atyreve që janë mbë Zonë. Epni
të-fala me shëndet Tryfenës' edhe Tryfosësë,
të-cilatë mundonenë mbë Zotinë. Epni të-fala
me shëndet së-dashurësë Persidhë, e-cila
13 shumë umundua mbë Zotinë. Epni të-fala
me shëndet Rufit të-sgjedhurit mbë Zotinë'
14 edhe s'ëmës' s'ati, që është edhe imja. Epni
të-fala me shëndet Asinkritit, Flegondit, Er-
majt, Patrovit, Ermiut, edhe vëllezërvet që ja-
15 në bashkë me ata. Epni të fala me shëndet
Fillollogut edhe Julisë, Nireut edhe motrës'
s'ati, edhe Olimbaut, edhe gjithë shënjtorëvet
16 që janë bashkë me ata. Epni të-fala me
shëndet njëri tjatërit me të-puthurë të-shënj-
tëruarë. U falenë me shendet juve kishët' e
Krishtit.
17 Edhe u lutem juve, o vëllezër, të ruhi
nga ata që bënjënë çarje e skandhali kun-
drë mësimit që kini nxënë ju, edhe të lar-
18 goni nga ata. Sepse të-tillëtë nuk' i shërbe-
njënë Zotit t'ënë Jisu Krisht, po barkut të
tyre; edhe me fjalë t'embëla e të-bukura gë-
19 njenjënë zëmërat'e atyreve që s'dinë ligësi. Se-

BKSH

pse të-bindurit t'uaj *ndë besët* arriti mbë të-
gjithë. Sa për juve pra, gëzonem; edhe dua
të jini të-diturë për të-mirënë, e të-miturë
20 për të-ligënë. Edhe Perëndia i paqtimit dotë
dërmonjë Satananë ndënë këmbët t'uaj për-
së-çpejti. Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë*
bashkë me ju. (Amin.)
21 U falenë me shëndet Timotheu bashkë-
punëtori im, edhe Lluqiu e Jasoni e Sosi-
patri, farëfisasit'e mi.
22 U falem me shëndet mbë Zotinë unë Ter-
tiu që shkrova kartënë.
23 U faletë me shëndet Gaiu, i-cili ka pri-
turë mua edhe gjithë kishënë ndë shtëpit.
U faletë me shëndet Erasmi kujdestari i qy-
tetit, edhe vëllaj Kuart.
24 Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë* bashkë
me ju. Amin.
25 Edhe mb'atë që munt t'u forconjë juve
pas ungjillit t'im edhe pas të-lëçiturit të Jisu
Krishtit, pas sbulesës' së fshehësirësë që qe
26 ndënë heshtje prej motesh të-përjetëshm, Po
tani uçpërfaq, edhe me anë të shkronjavet
të profitërvet, pas urdhërit të të-përjetësh-
mit Perëndi, unjoh mbë gjithë kombetë, që
27 t' i bindenë besësë; Mbë të-vetëminë *e* të-
diturinë Perëndi *qoftë* lavdia me anë të Jisu
Krishtit për gjithë jetënë. Amin.

Karta e-parë e apostollit Pavël mbë Korinthianëtë.

Krye 1.

1 Pavli, i-thërritur' apostoll i Jisu Krishtit
me anë të dashurimit të Perëndisë, edhe vë-
2 llaj Sosthen, Mbë kishën' e Perëndisë që
është ndë Korinthë, *mbë* të-shënjtëruarëtë mbë
Jisu Krishtinë, *mbë* të-thërrituritë shënjtorë,
bashkë me gjith'ata që thërresënë mbë çdo
vënt mb' emërin' e Zotit t'ënë Jisu Krisht,
3 t'atyreve edhe t'ënit; Hir *qoftë* mbë ju edhe
paqtim prej Perëndisë Atit t'ënë, edhe prej
Zotit Jisu Krisht.
4 I falem ndersë përherë Perëndisë t'im për
ju, për *atë* hirin' e Perëndisë që udha mbë
5 ju me anë të Jisu Krishtit; Se ubëtë të-
pasurë me anë t'ati mbë të-gjitha, mbë çdo
6 fjalë e mbë çdo të-diturë; Sikundrë dësh-
7 mim' i Krishtit uvërtetua ndër ju; Kaqë sa
s'jetni prapa as mbë ndonjë dhurëti, dyke
8 priturë sbulesën' e Zotit t'ënë Jisu Krisht; I-
cili edhe dot' u vërtetonjë juve gjer ndë funtt
që të dilni faqe-bardhë ndë ditët të Zotit
9 t'ënë Jisu Krisht. Besnik është Perëndia, prej
të-cilit uthërrittë ndë shoqërit të Birit t' ati
Jisu Krisht, Zotit t'ënë.

BKSH

10 Edhe u lutem juve, o vëllezër, me anë t'e-
mërit të Zotit t'ënë Jisu Krisht, të thoni që
të-gjithë gjithatë fjalë, edhe të mos jenë ça-
rje ndër mest t'uaj, po të jini të-bashkuarë
ngushtë, dyke pasurë gjithatë mëndje e gji-
11 thatë mendim. Sepse më rrëfyenë për ju, o
vëllezër, ata *që janë prej shtëpis'* së Klloësë,
12 se ka grindje ndër mest t'uaj. Edhe këtë e
them, se sicilido prej jush thotë, Unë jam i
Pavlit, e un' i Apollojt, e un' i Qifajt, e un'i
13 Krishtit. Ndarë qënkërka Krishti? Mos Pavli
ukryqëzua për ju? Apo mb'emërit të Pavlit
14 upagëzuatë? I falem ndersë Perëndisë, se
asndonjë prej jush s'kam pagëzuarë, veç
15 Krispin' edhe Gainë; Që të mos thotë ndo-
një prej jush, se mb'emërit t'im e pagëzova.
16 Pagëzova edhe shtëpin' e Stefanajt; veç kë-
tyreve nukë di ndë pagëzova ndonjë tjetërë.
17 Sepse Krishti nukë më dërgoj që të pa-
gëzonj, po që të lëçit ungjillinë; jo me di-
turi fjalë, që të mos dalë i-kotë kryqi i
18 Krishtit. Sepse fjala e kryqit mb'ata që hum-
benë është marrësi, po mbë ne që shpëtoj-
19 më është fuqi Perëndie. Sepse është shkrua-
rë. „Dotë humbas diturin'e të-diturëvet, edhe
20 dotë heth tej mënçërin'e të-mënçimvet.“ Ku
ësht'i-dituri? ku *është* shkronjësi? ku është
kërkimtari i kësaj jetë? a nukë marrosi Pe-
21 rëndia diturin'e kësaj jete? Sepse passi ndë
diturit të Perëndisë bota nuk'e njohu Perën-

dinë me anë të diturisë, i pëlqeu Perën-
disë me marrësin' e të-lëçiturit të shpëtonjë
22 ata që besonjënë. Sepse edhe Judhenjtë kër-
konjënë shënjë, edhe Grekëritë kërkonjënë
23 dituri; Po neve lëçismë Krishtinë të-kryqë-
zuarë, *i-cili* mbë Judhenjtë *është* skandhall,
24 edhe mbë Grekëritë marrësi; Po mb'ata që
janë thërriturë, Judhenj e Grekër, Krishti *është*
25 fuqi Perëndie edhe dituri Perëndie. Sepse
marrësia e Perëndisë është më e-diturë se
njerëzitë; edhe dobësira e Perëndisë është
më e-fortë se njerëzitë.
26 Sepse e shihni të-thërrituritë t'uaj, o vë-
llezër, se ndër ju pas mishit ka jo shumë
të-diturë, jo shumë të-fuqishim, jo shumë të-
27 fisçim. Po Perëndia sgjodhi të-marrat' e bo-
tësë, që të turpëronjë të-dituritë; edhe Pe-
rëndia sgjodhi të-dobëtat'e botësë, që të tur-
28 përonjë të-fortatë; Edhe Perëndia sgjodhi të-
pafisçimet'e botësë edhe ato që janë të-sha-
ra, edhe ato që nukë janë, qe të prisnjë ato
29 që janë; Që të mos mburretë çdo mish për-
30 para ati. Edhe ju jeni prej ati mbë Jisu
Krishtinë, i-cili ubë mbë ne dituri prej Pe-
rëndie, drejtëri edhe shënjtërim edhe çpër-
31 blim; Që, sikundrë është shkruarë, „Ay që
mburretë, mbë Zotinë letë mburretë."

Krye 2.

1 Edhe unë, o vëllezër, kur erdha te ju,

BKSH

nukë erdha me lartësirë fjale a diturie, që
2 t'u dëftenj juve dëshmimin'e Perëndisë. Sep-
se e pashë të udhësë të mos di tjetërë gjë
ndër ju, veç Jisu Krishtinë, edhe këtë të-
3 kryqëzuarë. Edhe un' erdha ndër ju me do-
bësirë e me frikë e me shumë të-dridhurë;
4 Edhe fjala ime edhe të-lëçituritë t'im nuk'
ubënë me fjalë diturie njeriu që mbushnjënë
mëndjenë, po me të-dëftyerë Fryme e fuqie;
5 Që të mos jetë besa juaj me anë të dituris'
së njerësvet, po me anë të fuqis'së Perëndisë.
6 Edhe flasmë dituri ndër mest t'atyre që
janë të-sosurë, po jo dituri të kësaj jete, as
të urdhërtarëvet të kësaj jete, që prishenë;
7 Po flasmë dituri Perëndie ndë fshehësirë,
atë të-fshehurënë që urdhëroj Perëndia që
8 përpara jetëvet për lavdinë t'ënë; Të-cilënë
asndonjë nga urdhërtarët' e kësaj bote nuk'e
njohu; sepse po t'e kishinë njohurë, nukë
9 dotë kishinë kryqëzuarë Zotin' e lavdisë; Po,
sikundrë është shkruarë, „Ato që sy s'i pa,
e vesh s'i dëgjoj, e ndë zëmërë njeriu nukë
hipnë, këto Perëndia i bëri gati për ata që
10 e duan' atë.“ Po Perëndia na i sbuloj me
anë të Frymës' së ti; sepse Fryma i vëzhgon
11 të-gjitha, edhe të-thellat' e Perëndisë. Sepse
cili prej njerësvet njeh punët' e njeriut, për-
veç fryma e njeriut që është nd'atë? Kështu
edhe punët' e Perëndisë asndonjë s'i njeh,
12 përveç Fryma e Perëndisë. Edhe neve s'kemi

BKSH

marrë frymën' e botësë, po Frymënë që është
nga Perëndia, që të njohëm' ato që na janë
13 dhurëtuarë nga Perëndia. Për këto edhe
flasmë, jo me *fjalë* të-mësuara prej dituris'
së njerësvet, po me *fjalë* të-mësuara prej Fry-
mës'së-Shënjtëruarë, dyke mbarasuarë punëra
shpirtërishte me punëra shpirtërishte.
14 Po njeriu i naturësë nukë pret punërat'e
Frymës' së Perëndisë; sepse janë marrësi
për atë, edhe nukë munt t'i njohë *ato*; sepse
15 *ato* gjykonenë shpirtërisht. Po njeriu i shpir-
tit i gjykon të-gjitha edhe vetë nukë gjyko-
16 netë as prej ndonjëj. Sepse cili e njohu mën-
djen'e Zotit, që t'a mësonjë atë? po neve
kemi mëndje Krishti.

Krye 3.

1 Edhe unë, o vëllezër, nukë munda të flas
mbë ju, posi mbë njerës të shpirtit, po posi
mbë njerës të mishit, posi mbë foshnje mbë
2 Krishtinë; U ushqeva juve me qumësht, e jo
me gjellë; sepse edhe nukë muntnitë *t'a*
prititë atë, po edhe as ndashti nukë muntni;
3 Sepse edhe po jeni njerës të mishit; sepse
gjersa ka ndër ju cmir e qartë e ndarje, a
nukë jeni njerës të mishit, edhe ecëni pas
4 *mënyrës' se* njeriut? Sepse kur thotë njëri,
Unë jam i Pavlit, edhe tjetëri, Unë jam i
Apollojt, a nukë jemi njerës të mishit?
5 Cili pra është Pavli, e cili Apolloj, për-

BKSH

veç se shërbëtorë, me anë të të-cilëvet be-
suatë, edhe sikundrë i dha Zoti gjithë-sicilit?
6 Unë mbolla, Apolloj ujiti, po Perëndia *i* rriti.
7 Kështu pra as ay që mbjell nuk'është gjë,
8 as ay që ujit, po Perëndia që rrit. Edhe ay
që mbjell edhe ay që ujit janë një; edhe gji-
thë-sicili dotë marrë pagën' e ti si pas mun-
9 dimit të ti. Sepse neve jemi punëtorë bashkë
me Perëndinë; ju jeni ar' e Perëndisë, ndër-
tesa e Perëndisë.
10 Unë pas hirit të Perëndisë që m' udha,
si *ndonjë* kryemjeshtër i-diturë hodha themel;
e një tjatërë ndërton mbi *atë*; po gjithë-si-
11 cili letë vërë re qysh ndërton mbi *atë*. Sepse
asndonjë nukë munt të vërë tjatërë themel,
përveç ati që është vënë, i-cili është Jisu Krishti.
12 Edhe ndë ndërtoftë ndonjë mbi këtë themel,
ar, ergjënt, gurë të-paçëmuarë, dru, bar, ka-
13 llam; E gjithë-sicilit puna dotë çfaqetë; sepse
dita dot'a tregonjë *atë*; sepse me anë të zja-
rrit nxiretë ndë shesh; edhe zjarri dotë pro-
vonjë punën' e sicilitdo ç' farë *pune* është.
14 Ndë mbettë puna e ndonjëjt që ndërtoj, dotë
15 marrë pagë; Ndë udjektë puna e ndonjëjt,
dot' i bënetë dëm; po ay vetë dotë shpëto-
një, posi prej zjarrit.
16 Nuk' e dini se jeni tempull Perëndie,
17 edhe Frym' e-Shënjtëruarë rri ndër ju? Ndë
prishtë ndonjë tempullin' e Perëndisë, këtë
dota prishnjë Perëndia; sepse tempulli i Pe-

18 rëndisë, i-cili jeni ju, është i-shënjtëruarë. As-
ndonjë letë mos gënjenjë vetëhen' e ti; ndë
panden ndonjë ndër mest t' uaj se ësht' i-
diturë ndë këtë botë, letë bënet' i-marrë, që
19 të bënetë i-diturë. Sepse dituria e kësaj bote
është marrësi përpara Perëndisë. Sepse është
shkruarë, „Ay që zë të-dituritë ndë dinakërit
20 t'atyreve."Edhe përsëri, „Zoti njeh mendimet'
e të-diturëvet se janë të-kotë.
21 Përandaj asndonjë letë mos mburretë
22 mbë njerës; sepse të-gjitha janë t'uajatë; A
Pavli, a Apolloj, a Qifaj, a bota, a jeta, a
vdekja, a këto që janë ndashti, a ato që
23 dotë vinjënë; të-gjitha janë t'uajatë; Edhe
ju, të Krishtit; edhe Krishti, i Perëndisë.

Krye 4.

1 Kështu letë na numëronjë *çdo* njeri, si
shërbërorë të Krishtit, edhe *si* kujdestarë të
2 fshehësiravet të Perëndisë. E tjetëra që kër-
konetë ndër kujdestarët është që të gjëndetë
3 gjithë-sicili besëtar. Sa për mua fort pak
gjë është të gjykonem prej jush, a prej gjyqi
njeriu; po as *vetë* vetëhenë nuk' e gjykon.
4 Sepse ndërgjegja ime nukë më qërton për
asgjë; po me këtë nukë jam i-drejtëruarë;
5 po Zoti ësht'ay qe më gjykon. Përandaj mos
gjykoni as gjë përpara kohësë, gjersa të vi-
një Zoti; i-cilli edhe dotë nxjerrë ndë dritë
të-fshehurat' e errësirësë, edhe dotë çfaqnjë

BKSH

këshillat' e zëmëravet; edhe atëhere lëvdimi
dotë bënetë mbë gjithë-sicilinë nga Perëndia.
6 Edhe këto, o vëllezër, për shëmbëllë i
ktheva përmbi vetëhenë t'ime edhe përmbi
Apollonë, per të-mirënë t'uaj; që të mësohi
prej nesh të mos mendoni me tepërë nga
ç'është shkruarë, që të mos madhështonetë
ndonjë prej jush për njërinë kundrë tjatërit.
7 Sepse cili të çquan ty *nga tjatëri*? edhe ç' gjë
ke ti që nuk'e more? Edhe ndë e ke marrë,
ç'burresh sikur se nuk' e ke marrë?
8 Ndashti jeni të-nginjurë, ndashti ubëtë
të-pasurë, mbretëruatë pa neve; edhe makar
të kishitë mbretëruarë, që edhe neve të mbre-
9 tëronimë bashkë me ju. Sepse më duketë
se Perëndia neve apostojtë na tregoj për
më të-poshtërit' e *njerësvet*, si të-dënuarë ndë
vdekje; sepse ubëmë lodrë ndë botët, ndë
10 ëngjëjt e ndë njerëzit. Neve *jemi* të-marrë
për Krishtinë, e ju të-mënçim mbë Krish-
tinë; neve të-dobëtë, e ju të-fortë; ju të-lav-
11 duruarshim, e neve të-çnderuarë. Gjer mbë
këtë orë edhe uri kemi, edhe et kemi, e të-
sveshurë jemi, e me shuplaka rrihemi, e si-
12 llemi andej e këtej, E mundonemi dyke pu-
nuarë me duartë t'ona; kur përqeshemi, be-
13 kojmë; kur ndiqemi, durojmë; Kur shahemi,
lutemi; ubëmë posi të-fshirat'e botësë, posi
lëmishtet' e të-gjithëve gjer mbë këtë ditë.
14 Nukë shkruanj këto për të turpëruarë

juve, po u këshillonj juve posi bij të mi të-
15 dashurë. Sepse ndë paçi dhjetë mijë mëso-
njës mbë Krishtinë, po *nukë kini* shumë atër;
sepse unë u polla mbë Krishtinë Jisu me
16 anë të ungjillit. U lutem juve pra të bëni
17 si bënj unë Përandaj u dërgova juve Timo-
thenë, i-cili është biri im i-dashurë edhe be-
sëtar mbë Zotinë; ky dot' u sjellë juve ndër
mëntt udhët' e mia që janë mbë Krishtinë,
sikundrë mëson kudo mbë çdo kishë.
18 Po ca *veta* umadhështuanë, sikurse unë
19 s' kishnjam për të ardhurë ndër ju; Po çpejt
kam për të ardhurë ndër ju, ndë dashtë Zoti,
edhe kam për të njohurë jo fjalën' e atyreve
20 që madhështonenë, po fuqinë. Sepse mbre-
tëria e Perëndisë nuk' është me fjalë, po me
21 fuqi. Ç'doni? me shkop të vinj ndër ju, apo
me dashuri e me frymë butësire?

Krye. 5.

1 Gjithëzaj dëgjonetë ndër ju kurvëri, edhe
e-këtillë kurvëri që as ndër kombet (nukë
zihetë n'gojë), kaqë sa një të ketë gruan' e t'et.
2 Edhe ju jeni madhështuarë, e nukë bëtë vajë
me të-tepërë, që të ngrihetë nga mezi juaj
3 ay që bëri këtë punë? Sepse unë, ndonëse
s'jam aty me trupinë, me shpirtinë jam aty,
edhe sikurse jam aty kam gjykuarë ndashti
për këtë njeri që bëri të-këtillënë punë, që,
4 Mb' emërit të Zotit t'ënë Jisu Krisht, passi

BKSH

të mblidhi ju edhe shpirti im me fuqin'e Zo-
5 tit t'ënë Jisu Krisht, T'a epni të-këtillinë *njeri*
ndë dorët të Satanajt për prishjen'e mishit, që
t'i shpëtonjë shpirti ndë ditët të Zotit Jisu.
6 Nuk'është të-mirë të-mburruritë t'uaj; nukë
dini se pak brumë mbruh gjithë të-mbrujtu-
7 ritë? Qërohi pra nga brumi i-vjetërë, që të
jini të-mbrujturë të-ri, sikundrë jeni pa brumë;
sepse pashka jonë, *që është* Krishti, ubë kur-
8 ban për ne. Përandaj letë kremtërojmë jo me
brumë të-vjetërë, as me brumë keqësie e
ligësie, po me të-pambrumura *bukë* zëmëre
së-kthjellëtë e së-vërtetë.
9 U shkrova juve ndë kartët, të mos për-
10 zihi me kurvarë; Edhe jo fare *të mos për-
zihi* me kurvarët' e kësaj bote, a me lak-
mimtarëtë, a me rrëmbenjësitë, a me idhulla-
trëtë; sepse atëhere duhetë të dilni jashtë
11 nga bota. Po ndashti u shkrova juve, të mos
përzihi, ndë qoftë se ndonjë që quhetë vëlla
është kurvar, a lakmimtar, a idhullatër, a
përqeshës, a pianec, a rrëmbenjës; me të-ti-
12 llinë as të mos hani bashkë. Sepse ç'më du-
hetë të gjykonj edhe të-jashtëshmitë? Nukë
13 gjykoni ju të-brëndëshmitë? Po të-jashtë-
shmitë Perëndia dot' i gjykonjë; përandaj
nxirni të-ligunë jashtë nga mezi juaj.

Krye 6.

1 Kuxon ndonjë prej jush, kur ka ndonjë

gjë kundrë tjatërit, të gjykonetë përpara të-
2 shtrëmbërvet, e jo përpara shënjtorëvet? Nukë
dini se shënjtorëtë dotë gjykonjënë botënë?
edhe ndë bota gjykonetë prej jush, nukë jini
3 të-zotër të gjykoni më të-vogëla *punëra*? Nuk'
e dini, se dotë gjykojmë engjëj? sa më tepërë
4 punëra të kësaj jete? Ndë kini pra punëra të
kësaj jete për të gjykuarë, ata që nukë zihe-
5 në për gjë ndë kishët, këta vini gjykatës. Për
turp t'uaj ua them *këtë*. Kështu nukë qënka
ndër mest t'uaj as një i-urtë, i-cili të munt-
një të gjykonjë ndër mest të vëllajt të ti?
6 Po gjykonetë vëlla me vëlla, edhe kjo *bënetë*
7 përpara të-pabesëvet? Ndashti pra është faj
i-math ndër ju të kini gjyqe njeri me tjatërinë.
Përse më mirë nukë lini t'u bënetë juve pa-
udhëri? Përse më mirë nukë lini t' u bënetë
8 dëm juve? Po ju bëni paudhëri e bëni dëm,
edhe këto *u'a bëni* vëllezërvet.
9 Apo nukë dini se të-shtrëmbëritë nukë
dotë trashëgonjënë mbretërin' e Perëndisë?
Mos gënjehi; as kurvarë, as idhullatrë, as
ndyrës, as të-sqaqurë, as ata që venë prapa
10 meskujsh, As vjedhës, as lakmimtarë, as
pianikë, as përqeshës, as rrëmbenjës, nukë
dotë trashëgonjënë mbretërin' e Perëndisë.
11 Edhe të-këtillë ishitë ca *prej jush*; po ulatë,
po ushënjtëruatë, po udrejtëruatë, me a-
në të emërit të Jisu Krishtit, edhe me anë
të Frymës' së Perëndisë t' ënë.

12 Të-gjitha janë ndë pushtett t'im, po të-
gjitha nukë bënjënë dobi; të-gjitha janë ndë
pushtett t'im, po unë nukë pushtonem as prej
13 ndonjë gjëje. Gjellëtë janë për barkunë, edhe
barku për gjellëtë; po Perëndia edhe këtë e-
dhe ato dot' i prishnjë. Po trupi nuk' *është*
për kurvërinë, po për Zotinë, edhe Zoti për
14 trupinë; Edhe Perëndia edhe Zotinë e ngja-
lli, edhe neve dotë na ngallnjë me anë të
15 fuqis' së ti. Nuk'e dini, se trupetë t'uaj janë
anë të Krishtit? të marr pra unë anët' e Kri-
shtit, e t'i bënj ato anë kurve? Qoftë lark!
16 A nuk' e dini se ay që ngjitetë me kurvënë
është një trup *me atë?* sepse „dotë jenë,"
17 thotë, „të dy ndë një mish." Po ay që ngji-
18 tetë me Zotinë, është një frymë *me atë.* Lar-
goni kurvërinë; Çdo faj që bën njeriu, është
jashtë trupit; po ay që kurvëron fëjen mbë
19 trupt të vetëhes'së ti. Apo nuk' e dini se trupi
juaj është tempull i Frymës' së-Shëntëruarë
që *rri* ndër ju, të-cilën' e keni prej Perën-
disë, edhe nukë jeni *të-zotërit'* e vetëhesë
20 s'uaj? Sepse ubletë me çëmim; lavduroni pra
Perëndinë me trupinë t'uaj, edhe me shpir-
tinë t'uaj, që janë të Perëndisë.

Krye 7.

1 Edhe për ato *punë* që më shkruatë, mirë
është për njerinë të mos i mbështetetë gruaje.
2 Po për kurvëritë letë ketë gjithë-sicili gruan'e

BKSH

3 ti, edhe gjithë-sicila letë ketë burrën'e saj. Bu-
rri let'i apë gruasë *atë* dashurinë që i ka de-
4 tyrë; gjithashtu edhe gruaja burrit. Gruaja s'e
urdhëron trupin' e saj, po burri; gjithashtu
edhe burri nuk' e urdhëron trupin' e ti, po gru-
5 aja. Mos j'a shterni njëri tjatërit, përveç se
ndë kini lidhurë fjalë për gjer mbë një kohë,
që të bini pas agjërimit e pas të-falurit, edhe
përsëri mblidhuni bashkë që të mos u ngasë
6 Satanaj për të-mos-përmbajturitë t' uaj. Edhe
këtë po e them prej mëndjesë *s' ime*, jo prej
7 urdhëri. Sepse dua gjithë njerëzitë të jenë
si edhe vetëheja ime; po gjithë-sicili ka dhu-
ratë të-veçantë nga Perëndia, njëri kështu, e
tjatëri ashtu.

8 Edhe po u them të-pamartuarëvet edhe
të-vavet, *se* është mirë për ata, ndë mbeçinë
9 si edhe unë; Po edhe ndë mos përmbanjënë
dot vetëhen' e tyre, letë martonenë; sepse
është më mirë të martonetë *njeriu* se të nxe-
hetë.

10 Edhe të-martuarëtë i porosit, jo unë, po
11 Zoti, të mos ndahetë gruaja nga burri; Po edhe
ndë undaftë, letë mbetet' e-pamartuarë, a
letë pajtonetë me burrin' *e saj;* edhe burri të
mos e lërë gruan' *e ti.*

12 Edhe të-tjerëvet u them unë, jo Zoti, Ndë
ka ndonjë vëlla grua të-pabesë, edhe ajo do
të rronjë baskkë me atë, letë mos e lërë atë.
13 Edhe një grua që ka burrë të-pabesë, edhe

BKSH

ay do të rronjë bashkë me atë, letë mos e
14 lërë atë. Sepse burr' i-pabesë është i-shënj-
tëruarë me anë të gruasë; edhe gruaj' e-pa-
besë ësht' e-shënjtëruarë me anë të burrit;
sepse tjetrazi bijtë t' uaj dot' ishinë të-pëgërë;
15 po ndashti janë sënjtorë. Po ndë undaftë i-
pabesi, letë ndahetë; Vëllaj a motëra nukë
janë bërë robër ndë të-këtillá punëra; po
16 Perëndia na ka thirrurë ndë paqtim. Sepse
ç'di ti o grua, ndë kë për të shpëtuarë bu-
rrinë? a ç'di ti, o burrë, ndë ke për të shpë-
17 tuarë gruanë? Po sikundrë Perëndia i ndau
gjithë-sicilit, *edhe* sikundrë Zoti thërriti gjithë-
sicilinë, kështu letë ecënjë; edhe kështu ur-
dhëronj mbë gjithë kishëtë.
18 Uthërrit i-rretprerë ndonjë *ndë besët?* letë
mos e fshehnjë rrethpresjenë. I pa-rrethprerë
19 uthërrit ndonjë? letë mos rrethpritetë. Rreth-
presja s'është gjë, edhe parrethpresja s'është
gjë, po të-ruajturit'e porosivet të Perëndisë.
20 Gjithë-sicili mb' atë të-thërriturë qε uthërrit'
21 mb' atë letë mbesë. Uthërrite *kur* jeshe rop?
mos ki kujdes; po ndë munt të bënesh i li-
22 ruarë, përdor-e këtë më mirë. Sepse ay që
uthërrit mbë Zotinë *kur qe* rop, ësht' i-liruar'
i Zotit; gjithashtu edhe ay që uthërrit *kur*
23 *qe* i-liruarë, është rop i Krishtit. Me çëmim
24 ubletë; mos bëhi robër njerëzish.. Γjithë-si-
cili, o vëllezër, mb' atë që uthërrit, mbë këtë
letë mbetetë ndaj Perëndisë.

25 Edhe për vërgjëreshatë s' kam urdhërë
nga Zoti; po ap mëndje si i-përdëllyerë prej
26 Zotit të jem besëtar. Pandenj pra se këjo
është e-mirë për nevojën'e-tanishimë, se është
27 mirë për njerinë të jetë kështu. Je lidhurë
me grua? mos kërko të-sgjidhurë. Je sgji-
28 dhurë nga grua? mos kërko grua. Po edhe
ndë umartofsh, nukë fëjeve; edhe vërgjë-
resha ndë umartoftë, nukë fëjeu; po të-keti-
llëtë dotë kenë shtrëngim ndë misht; e un'u
kursenj juve.
29 Edhe këtë e them, o vëllezër, se koha
paskëtaj është e-shkurtërë; kaqë sa edhe
ata që kanë gra të jenë posikur s'kanë; edhe
30 ata që qanjënë, posikur s' qanjënë; Edhe ata
që gëzonenë, posikur s' gëzonenë; edhe ata
qe blenjënë, posikur s'i karë ndënë urdhë-
31 rit të tyre; Edhe ata që përdornjënë këtë
botë, posikur s'e përdornjënë; sepse forma
32 e kësaj bote shkon. Edhe dua të jini pa kuj-
dese; i-pamartuari ka kujdes për punërat'e
33 Zotit, qysh t'i pëlqenjë Zotit; Po i-martuari
ka kujdes për punërat'e botësë, qysh t'i pël-
34 qenjë gruasë. Ndan gruaja prej vërgjëreshë-
së; e-pamartuara ka kujdes për punërat'e
Zotit, që të jet' e-shënjtëruarë edhe ndë trupt
edhe ndë shpirtt; e-martuara ka kujdes për
punërat'e botësë, qysh t'i pëlqenjë burrit.
35 Edhe këtë po u'a them juve për të-mi-
rënë t'uaj; jo që t'u vë lak, po që të jini të-

hieshim edhe të-ngjiturë pas Krishtit pa
kujdese.
36 Po ndë kujton ndonjë se silletë shëmtu-
arë mbë vërgjëreshën'e ti, ndë i shkoftë lul'
e kohës' s' asaj *pa martuarë*, edhe duhetë të
bënetë kështu, letë bënjë ç' të dojë; nukë fë-
37 jen; letë martonenë. Po ay që rri i-qëndru-
arshim ndë zëmërët, e s'ka nevojë, po ka
pushtet për dashurimin' e ti, edhe e vendosi
ndë zëmërët të ti të ruanjë vërgjëreshën' e ti,
38 bën mirë. Përandaj edhe ay që e marton
vërgjëreshënë, bën mirë; edhe ay që s'e mar-
ton, bën më mirë.
39 Gruaja është lidhurë (nga nomi) për sa
kohë rron burr' i asaj; po ndë i vdektë burri,
ësht' e-liruarë të martonetë me cilinë të dojë,
40 vetëmë *këjo punë të bënetë* mbë Zotinë. Po
sipas mëndjesë s' ime, më e-lumurë është,
ndë mbettë kështu; edhe më duketë, se edhe
unë kam Frymë Perëndie.

Krye 8.

1 Edhe sa për kurbanët' e idhujvet, dimë, se
të-gjithë kemi dituri; *po* dituria madhështon,
2 e dashuria ndërton. Ndë i duketë ndonjëj
se di gjë, *ky* edhe nukë mësoj asgjë sikun-
3 drë duhetë të mësonjë; Po ndë do ndonjë
4 Perëndinë, ky është i-njohurë prej ati. Për
të-ngrënëtë pra e kurbanëvet që bënenë mbë
idhujtë, e dimë se idhulli s' është asgjë ndë

BKSH

botët, edhe se nukë ka tjetërë Perëndi veç
5 një. Sepse ndonëse ka asish që thuhenë pe-
rëndira, a ndë qiellt, a mbi dhet; (sikundrë
thuhetë se ka shumë perëndira, edhe shumë
6 zotër;) Po mbë ne *është* një Perëndi, Ati, prej
të-cilit janë të-gjitha, edhe neve mb' atë; edhe
një Zot, Jisu Krishti, me anë të të-cilit janë të-
7 gjitha, edhe neve me anë t'ati. Po nuk' është
mbë të-gjithë këjo dituri; sepse ca veta me
ndërgjegjenë *se diç është* idhulli gjer sot e
hanë posi kurban mbë idhullinë, edhe ndër-
gjegja e atyreve dyke qën' e-dobëtë pëgëretë.
8 Po të-ngrënëtë nukë na dorëzon te Pe-
rëndia; sepse as ndë hëngrëshimë, dotë ke
mi gjë më shumë; as ndë mos hëngrëshimë,
9 dotë kemi gjë më pak. Po shikoni semos
ky pushteti juaj bënetë pëngesë mbë të-do-
10 bëtitë. Sepse ndë të paftë ndonjë ty që ke
dituri, se rri ndë mësallë ndë tempull idhush,
ndërgjegja e ati që është i-dobëtë a nukë
dotë marrë kuxim të hajë kurbanëtë mbë
11 idhujtë? Edhe *kështu* për diturinë t' ënde dotë
humbasë vëllaj i-dobëtë, për të-cilinë Krihsti
12 vdiq. Edhe kur fëjeni ju kështu mbë vëlle-
zëritë, edhe plagosni ndërgjegjen' e atyre të-
13 dobëtë, mbë Krishtinë kini fëjyerë. Përandaj
ndë qoftë se të-ngrënëtë *t' im* skandhalis t' im
vëlla, s' kam për të ngrënë mish për gjithë
jetënë, që të mos skandhalis t' im vëlla.

BKSH

Krye 9.

1 Nukë jam *un'* apostoll? Nukë jam *un'* i-
liruarë? Nukë pashë *unë* Jisu Krishtinë, Zo-
tinë t' ënë? Nukë jeni ju puna ime mbë Zo-
2 tinë? Ndë mos jam apostoll mbë të-tjerë,
po pak-sε-paku mbë ju jam; sepse mbë Zo-
3 tinë vulla e apostolisë s' ime jeni juve. Për-
gjigja ime mb' ata që më gjykonjënë është
4 këjo, Mos nukë kemi *edhe neve* pushtet të
5 ham' e të pimë? Mos nukë kemi *edhe neve*
pushtet të heqëmë me vetëhe një grua nga
motratë, sikundrë edhe të-tjerëtë apostoj,
6 edhe të vëllezërit' e Zotit, edhe Qifaj? A po
vetëm' unë edhe Varnava nukë kemi pushtet
7 të mos punojmë? Cili vete ndonjë herë ndë
luftë me të-prishura prej vetëhes' së ti? Cili
vë veshtë, edhe nukë ha nga pem' e ati? A
cili kullot grigjë, edhe nukë ha nga qumështi
8 i grigjësë? Mos i flas *unε* këto *vetëmë* si
9 njeri? apo nukë thotë këto edhe nomi? Sepse
ndë nomt të Moisiut është shkruarë, „Nukë
dot' i lithç gojënë kaut që shin." Mos për
10 qetë ka kujdes Perëndia? A po për ne me
të-vërtetë e thotë këtë? sepse për ne u-
shkrua, se ay që lëron, me shpresë gjan të
lëronjë; edhe ay që shin, *shin* me shpresë se
11 dotë ketë pjesë ndë shpresët të ti. Neve ndë
mbuallmë mbë ju gjërëratë shpirtëriake, *pun'*
e-madhe është ndë korrçimë gjërëratë t' uaj

12 të-mishta? Ndë qoftë se të-tjerë marrënë pjesë
të këti pushteti mbi ju, nukë gjan më tepërë
neve? Po *neve* nuk' e përdormë këtë pushtet;
po durojmë të-gjitha, që të mos bjemë ndo-
një ndalim ndë ungjllit të Krishtit.
13 Nuk' e dini, se ata që bënjënë *punërat'* e
shënjtëruara, prej hieroresë hanë? edhe ata
që qëndronjënë përanë theroresë, marrënë
14 pjesë nga theroreja? Kështu edhe Zoti ur-
dhëroj, që ata që lëçisnjënë ungjillinë prej
ungjillit të rronjënë.
15 Po unë asndonjë nga këto nukë përdora,
as nuk' i shkrova këto, që të më bënetë kë-
shtu; sepse është më mirë për mua të vdes,
se të nxjerrë ndonjë të-mburruritë t' im të-
16 kotë. Sepse ndë lëçis ungjillinë, nuk' është
të-mburrurë për mua; sepse këjo është një
nevoj' e-madhe për mua; edhe mjerë unë, ndë
17 mos lëçiça ungjillinë. Sepse ndë e bënj këtë
dyke dashurë, pagë kam; po ndë *e bënj* dy-
ke mos dashurë, më është zënë besë kuj-
18 desi. Cila pra është paga ime? *është* që me
lëçitjenë t' ime t'a bënj ungjillin' e Krishtit të
lëçitetë pa të-prishura, që kështu të mos e
përdor për keq pushtetnë që kam mbë un-
gjillinë.
19 Sepse dyke qën' i-liruarë nga të gjithë, e
bëra vetëhenë t' ime shërbëtuar mbë të-gjithë,
20 që te fitonj më të-shumëtë, Edhe ubëshë te
Judhenjtë si Judhe, që të fitonj Judenjtë; tek

ata që janë ndënë nom *ubëshë* si ndënë nom,
21 që të fitonj ata që janë ndënë nom; Te të-
panomëtë *ubëshë* si i-panom, (ndonëse nuk'
ishnjam i-panom te Perëndia, po me nom
22 mbë Krishtinë,) që të fitonj të-panomëtë. Te
të-dobëtitë ubëshë si i-dobëtë, që të fitonj të-
dobëtitë; te të-gjith' ubëshė të-gjitha, që me
23 çdo mënyrë të shpëtonj ca veta. Edhe këtë
e bënj për ungjillinë, që të bënem pjesëtar
i ati.
24 Nuk' e dini, se ata që sulenë ndë shesht
të lodravet të trimërisë, që të-gjithë sulenë,
po një e merr bravurënë; kështu, suluni që
25 t'a merrni. Edhe kushdo që përpiqetë, e për-
mban vetëhenë nga të-gjjtha; e ata *e bënjënë
këtë,* që të marrënë një kurorë që prishetë
po neve *e bëjmë, që të marrëmë kurorë* të-
26 pavdjershime. Unë pra kështu sulem, jo si-
kur jam ndë dyshim; kështu luftonj me grusht,
27 jo sikur rrah erënë; Po mundonj trupinë t' im
edhe e bënj rop, semos, passi u lëçita të-
tjerëve, unë hidhem poshtë.

Krye 10.

1 Edhe nukë dua të mos dini ju, o vëllezër,
se gjithë atëritë t'anë ishinë ndënë ret, edhe
2 të-gjithë shkuanë ndëpër dett; Edhe të-gjithë
upagëzuanë mbë Moisinë ndë ret e ndë dett;
3 Edhe të-gjithë gjithatë të-ngrënë shpirtëriake
4 hëngrrë; Edhe të-gjithë gjithatë të-pirë shpir-

BKSH

tëriake pinë; sepse pininë prej *një* guri shpir-
tëriak që u vinte pas; edhe *ky* gur ishte
5 Krishti. Po Perëndia më të-shumëtë nga ata
nuk' i pëlqeu; sepse ranë të-vdekurë ndë
shkretëtirët.

6 Edhe këto ubënë *për* shëmbëlla mbë ne
që të mos dëshërojmë *edhe* neve punëra të-
7 liga, sikundrë dëshëruan' ata. As idhullatrë
mos ubëni, posi ca *veta* nga ata, sikundrë
është shkruarë, „Llauzi ndënji të haj' e të pijë,
8 edhe ungritnë të lozinë.“ As të mos kurvë-
rojmë, sikundrë ca *veta* nga ata kurvëruanë,
edhe ranë *të-vdekurë* mbë një ditë njëzet' e
9 tri mijë *veta*. As të mos ngasmë Krishtinë,
sikundrë edhe ca nga ata e nganë, edhe u-
10 prishnë nga gjërpënjtë. As të mos murmurisni,
sikundrë edhe ca nga ata murmurisnë, edhe
11 uprishnë prej *ëngjëllit* prishës. Edhe gjithë
këto bëneshinë mb' ata për shëmbëlla, edhe
ushkruanë për mësim mbë ne, mbë të-cilët
12 arrinë të-mbaruarat' e jetëvet. Përandaj ay
që pandeh se qëndron, letë shohë semos
bjerë poshtë.

13 *Tjatërë* ngasje nuk u ka gjeturë juve për-
veç se *ngasje* njeriu; po Perëndia është be-
sëtar edhe nukë dot' u lërë juve të ngiteni
tej fuqisë s' uaj, po bashkë me të-ngarëtë
dot' u tregonjë udhë shpëtimi, që të muntni
të duroni.

14 Përandaj, o të dashurit' e mi, largohuni
nga idhullatria.
15 Flas posi mbë të-mënçim; gjyko-e-ni ju
16 atë që them. Potiri i bekimit që bekojmë, a
nuk' është të-marrë pjesë ndë gjakt të Kri-
shtit? Buka që thyejmë, a nukë është të-marrë
17 pjesë ndë trupt të Krishtit? Sepse ne të-shu-
mëtë jemi një bukë, një trup; sepse të-gjithë
18 kemi pjesë prej gjithasaj buke. Shikoni Is-
railinë pas mishit; ata që hanë kurbanëtë, a
19 nukë janë pjesëtarë te theroresë? Ç' them
pra? se idhulli është gjë? apo se kurbani
20 mbë idhullinë është gjë? *jo;* Po *them*, se
ato që bënjënë kurban kombetë, u'a bë-
njënë kurban djajvet, e jo Perëndisë; edhe
21 *unë* s' dua ju të bëhi pjesëtarë të djajvet. S'
munt të pini potirin' e Zotit edhe potirin' e
djajvet; nukë munt të jeni pjesëtarë të tru-
vezës' së Zotit edhe të truvezës' së djajvet.
22 Apo Zotinë duamë t'a shtjemë mbë zili? mos
jemi më të-fortë se ay?
23 Të-gjitha janë ndë pushtett t' im, po të-
gjitha s' bënjënë mirë; të-gjitha janë ndë push-
24 tett t' im, po të-gjitha s' ndërtonjënë. Asndonjë
letë mos kërkonjë *të-mirën'* e ti; po giithë-
25 sicili të tjatërit. Hani çdo gjë që shitetë
ndë mish-shitoret, pa vëzhguarë gjë për ndër-
26 gjegjenë; Sepse „dheu ësht' i Zotit, edhe të-
27 mbushurit' e ati.“ Edhe ndë u therrittë juve
ndonjë nga të-pabesëtë, edhe doni të vini,

hani çdo gjë që t'u vihetë përpara, pa vëzh-
28 guarë gjë për ndërgjegjenë. Po ndë u thëntë
juve ndonjë, Këjo është kurban idhulli, mos
hani, *edhe këtë* për atë që u dëfteu, edhe për
ndërgjegjenë; (sepse „dheu ësht'i Zotit, edhe
29 të-mbushurit e ati.") Edhe ndërgjegje them,
jo t' ëndenë, po të tjetërit; sepse përse *të*
gjykonetë liria ime prej ndërgjegjes' së tja-
30 tëri *njeriu*? Edhe ndë unë marr pjesë më të-
falurë ndersë, përse të shahem për atë për
31 të-cilinë unë falem ndersë? Ndë hëngrëshi
pra, a ndë pifshi, a ndë bëfshi gjë, të-gjitha
32 t'i bëni për lavdi të Perëndisë. Mos bëhi
pëngesë as mbë Judhenj, as mbë Grekër, as
33 mbë kishën' e Perëndisë; Sikundrë edhe unë
mbë çdo gjë u pëlqenj të-gjithëve, sepse nukë
kërkonj të-mirënë t'ime, po *të-mirën'* e të-
shumëvet, që të shpëtonjënë.

Krye 11.

1 Bëni si bënj unë, sikundrë edhe unë *bënj*
si Krishti.

2 Edhe u lëvdonj juve, o vëllezër, se mbë
gjithë gjërërat më kujtoni, edhe mbani poro-
sitë që u lashë me gojë, sikundrë u'a dha-
shë juve.

3 Edhe dua t'a dini ju, se kryet' e çdo bu-
rri është Krishti; edhe kryet' e gruasë *është*
burri; edhe kryet' e Krishtit *është* Perëndia.
4 Çdo burrë kur falet' a kur profiteps, ndë

BKSH

pastë mbuluarë kryetë, turpëron kryet' e ti.
5 Edhe çdo grua, kur falet' a kur profiteps me
krye të-sbuluarë, turpëron kryet' e saj, sepse
është një e si-një-një me *gruanë* që ka rruarë
6 *kryetë*. Sepse ndë mos mbulonetë gruaja, edhe
letë qethetë. Po ndë *është* turp për gruanë
7 të qethetë, a të rruhetë, letë mbulonetë. Se-
pse burri nukë duhetë të mbulonjë kryetë,
sepse është figur' edhe lavdi e Perëndisë: po
8 gruaja është lavdi e burrit. Sepse burri nuk'
9 është prej gruasë, po gruaja prej burrit; Se-
pse edhe nuk' ukriua burri për gruanë, po
10 gruaja për burrinë. Përandaj gruaja duhetë
të ketë pushtet mbi kryet *të saj*, për ëngjëjtë.
11 Po mbë Zotinë as burrë *ka* pa grua, as grua
12 pa burrë. Sepse sikundrë gruaja *është* prej
burrit, kështu edhe burri *është* me anë të
gruasë; edhe të-gjitha *janë* prej Perëndisë.
13 Gjykoni *edhe* ju ndër vetëhet t'uaj; i ka
14 hije gruasë t'i faletë e-sbuluarë Perëndisë? Po
edhe natura vetë a nukë na mëson, se një
burrë ndë pastë leshëra të-gjata, këjo është
15 çnderim për atë? Po gruaja ndë ka leshëra
të-gjata, *këjo* është lavdi për atë; sepse leshë-
ratë i janë dhënë asaj ndë vent mbulese.
16 Po ndë duketë ndonjë se do të bënjë
qarta, neve s' kemi të-këtillë zakon, as ki-
shët' e Perëndisë.
17 Edbe dyke porositurë këtë nuk' *u* lëvdonj,
se mblidheni jo për më të-mirënë, po për

BKSH

18 më të-keqenë. Sepse më përpara, kur mbli-
dheni ndë kishët, dëgjonj se ka çarje ndër
mest t'uaj; edhe gjer mbë një shkallë besonj.
19 Sepse gjan të jenë edhe çarje ndër mest
t'uaj, që të çfaqenë ata që janë të-vëjejturë
ndë mest t' uaj.
20 Kur mblidheni pra bashkë mbë një vënt,
këjo nuk' është për të ngrënë darkën'ë Zotit:
21 Sepse mbë të ngrënët gjithë-sicili merr më
përpara se tjetëri darkën'e ti të-veçantë;
edhe kështu njëri ka uri, edhe tjatëri ësht'
22 i-dejturë. Mos nukë keni shtëpira për të
ngrën'e për të pirë? apo s'e zini për gjë
kishën'e Zotit, edhe turpëroni ata që s'ka-
në? Ç' t'u them juve? t'u lëvdonj për këtë?
nuk' u lëvdonj.
23 Sepse unë mora prej Zotit atë që edhe
u dhashë juve, se Zoti Jisuj mb' atë natë që
24 *dot'* epej ndër duar, mori bukë, Edhe si u-
fal ndersë e theu, edhe tha, Merrni *e* hani; ky
është trupi im që thyhetë për ju; këtë bëni
25 për kujtimnë t'im. Gjithashtu edhe potirinë,
passi udarkua, dyke thënë, Ky potir është
dhjata e-re mbë gjakunë t'im; këtë bëni sa
26 herë të pini, për kujtimnë t'im. Sepse sa he-
rë të hani këtë bukë, edhe të pini këtë po-
tir, rrëfeni vdekjen'e Zotit gjer mb'atë kohë
që të vinjë.
27 Përandaj ay që të hajë këtë bukë, a të
pijë potirin' e Zotit, pa qën' i-vëjejturë, dotë

BKSH

jetë fajtuar i trupit e i gjakut të Krishtit.
28 Njeriu pra letë vëzhgonjë vetëhen' e ti, e
kështu letë hajë nga *ajo* bukë, edhe letë pijë
29 nga *ay* potir. Se ay që ha e pi pa qën' i-vë-
jejturë, ha e pi dënim për vetëhen' e ti, se-
30 pse nukë çquan trupin' e Zotit. Përandaj ka
ndër mest t'uaj shumë të-dobët' edhe të-së-
31 murë, edhe vdesënë mjatt *veta*. Sepse po të
çquanimë vetëhenë t'ënë, nukë dotë gjyko-
32 neshimë. Po kur gjykonemi, mundonemi prej
Zotit, që të mos dënonemi bashkë me botënë.
33 Përandaj, o vëllezër, kur mblidheni për të
34 ngrënë, pritni njëri tjatërinë. Po ndë i arthtë
uri ndonjëj, letë hajë ndë shtëpit *të ti*, që të
mos mblidheni për dënim. Edhe të-tjeratë,
kur të vinj, dot' i vë mbë udhë.

Krye 12.

1 Edhe për dhuratatë shpirtëriake, o vëlle-
2 zër, nukë dua të jini të-paditurë. E dini, se
ishitë gjindarë, dyke uhequrë sikundrë biqe-
3 shitë pas idhujvet që s' kanë zë. Përandaj u
bënj juve me diturë, se asndonjë që flet me
Frymë të-Shënjtëruarë nukë thotë për Jisunë,
qoft' i-mallëkuarë; edhe asndonjë nukë munt
të thotë se Jisuj është Zot, veç me anë të
Frymës' së Shënjtëruarë.
4 Edhe ka të-ndara dhuratash, po Fryma
5 është gjithajo. Ka edhe të-ndara shërbeshash,
6 po Zoti është gjithay; Ka edhe të-ndara pu-

nërash, po Zoti është gjithay që punon të-
gjitha mbë të-gjitha.
7 Edhe gjithë-sicilit i epetë të-çfaqurit' e
8 Frymësë për të-mirënë. Sepse një i epetë me
anë të Frymësë fjalë urtësie, e tjatëri fjalë
9 diturie, pas gjithasaj Fryme; Edhe tjatëri besë,
me anë të gjithasaj Fryme; e tjatëri dhuratë
10 shërimesh, me anë të gjithasaj Frymë; E
tjatëri të-punuara çudirash, e tjatëri profiti,
e tjatëri të-çquara frymash, e tjatëri çdo farë
gjuhërash, e tjatëri të-përkthyerë gjuhërash;
11 Edhe të-gjitha këto i punon një edhe gjithajo
Frymë, dyke ndarë gjithë-sicilit dhurëtira veç
e veç si të dojë *vetë*.
12 Sepse sikundrë trupi është një, edhe ka
shumë anë, edhe gjithë anët' e një trupi, ndo-
nëse janë shumë, bënjënë një trup, kështu edhe
13 Krishti. Sepse neve të-gjithë jemi pagëzuarë
me anë të gjithasaj Fryme mbë një trup, a
Judhenj a Grekër, a robër a të-liruarë; edhe
të-gjithë jemi ujiturë mbë një Frymë.
14 Sepse edhe trupi nuk' është një anë, po
15 shumë. Ndë thëntë këmba, Sepse nukë jam
dorë, nukë jam nga trupi; mos për këtë nuk'
16 është nga trupi? Edhe ndë thëntë veshi, Sepse
nukë jam sy, nukë jam nga trupi; mos për
17 këtë nuk' është nga trupi? Po të ishte gjithë
trupi sy, ku *dotë ishte* të-dëgjuarëtë? po të
ishte gjithë *trupi* të-dëgjuarë, ku *dot' ishte*
18 të-marrëtë erë? Po ndashti Perëndia ka vënë

anëtë, gjithë-sicilënë nga ato, ndë trupt, si
19 deshi. Po ndë ishinë të-gjitha një anë, ku
20 *dotë ishte* trupi? Po ndashti *janë* shumë anë,
21 e një trup. Edhe syri s'munt t'i thotë do-
rësë, Nukë më duhe; a përsëri krej *t'u thotë*
22 këmbëvet, Nukë më duhi. Po ato anë të tru-
pit që dukenë se janë më të-dobëta, këto janë
23 shumë më tepërë të-nevojshime. Edhe ato
anë që na dukenë se janë më të-panderçimet'
e trupit, këtyreve u bëjmë më shumë nder;
edhe kështu të-shëmtuaratë t'ona kanë më
24 tepëre hije; Po *anëtë* t' ona të-hijeshime nu-
kë kanë nevojë. Po Perëndia, dyke dhënë
më tepërë nder asaj *ane* që ka të-shtera, e
25 bashkoj trupinë *me një të këtillë mënyrë*, Që
të mos ketë çarje ndë trupt, po të kenë gjith-
26 atë kujdes anëtë njëra për tjatrënë. Edhe ndë
pësoftë një anë, gjithë anëtë pësonjënë bashkë
me atë; a ndë underoftë një anë, gjith' anëtë
gëzonenë bashkë me atë.
27 Edhe ju jeni trupi i Krishtit, edhe anë
28 veç e veç. Edhe Perëndia vuri ca *veta* ndë
kishët, së-pari apostoj, së-dyti profitër, së-
treti mësonjës, pastaj çudira, pastaj dhurata
shërimesh, ndihmëra, qiverrira, farë gjuhërash.
29 Mos *janë* të-gjithë apostoj? mos *janë* të-gji-
thë profitër? mos janë të-gjithë mësonjës?
30 mos *bënjënë* çudira të-gjithë? Mos kanë të-
gjithë dhurata shërimesh? mos flasënë gju-
hëra të-gjithë? mos përkthenjënë të-gjithë?

BKSH

31 Po lypni me zëmërë të-përvëluarë më të-
miratë dhurata; edhe *dot'* u dëftenj juve një
udhë shumë më të-lartë.

Krye 13.

1 Ndë folça gjuhërat' e njerëzet edhe t' ën-
gjëjvet, e të mos kem dashuri, ubëshë *si* ra-
më që kumbon, a *si* qymvallë që tringëllin.
2 Edhë ndë paça profiti, edhe të di gjithë fshe-
hësirat' edhe çdo dituri, edhe ndë paça gji-
thë besënë, kaqë sa të tunt nga vëndi male,
3 e dashuri të mos kem, s' jam asgjë. Edhe ndë
ndafsha gjithë gjënë t' ime për të ushqyerë
të-vobeqtë, edhe ndë dhënça ndër duar trupnë
t' im që të digjetë, e dashuri të mos kem,
s' më bën as fare dobi.
4 Dashuria është zëmërë-gjerë, *edhe* bën të-
mira; dashuria s' ka cmir; dashuria s' ësht'
5 e-vrazhëtë, nukë mbahetë mbë të-math, S' bën
punë të-shëmtuara, s' kërkon të-sajatë, nukë
6 zëmëronetë, s' mendon të-ligënë; S' gëzonetë
mbë shtrëmbërinë, po gëzonetë mbë të-vër-
7 tetënë. Të-gjitha i mban, të-gjitha i beson, të-
gjitha i shpren, të-gjitha i duron.
8 Dashuria kurrë s' bje poshtë. Po *të-tjeratë*,
a profitira *qofshinë*, dotë bjenë poshtë; a gju-
hëra, dotë pushonjënë; a dituri, dotë humbasë.
9 Sepse neve gjer mbë një shkallë dimë, edhe
10 gjer mbë një shkallë profitepsimë; Po kur
të vinj' e-plota, atëhere ajo që është gjer

11 mbë një shkallë dotë prishetë. Kur ishnjam
foshnje, si foshnje flisnjam, si foshnje kupë-
tonjam, si foshnje mendonesha; po kur ubëshë
12 burrë, i hodha tej punërat' e foshnjesë; Sepse
ndashti shohëmë mbë t'errët *si* ndëpër pas-
qyrë, po atëhere *dotë shohëmë* faqe për faqe;
ndashi njoh gjer mbë një shkallë, po atëhere
dotë njoh sikundrë edhe unjohçë.
13 Edhe ndashti mbetetë besa, shpresa, da-
shuria, këto të tria; po m' e-madhja nga
këto është dashuria.

Krye. 14.

1 Ndiqni dashurinë; edhe lypni me zëmërë
të-përvëluarë *dhuratatë* shpirtëriake, po më
2 tepërë që të profitepsni. Sepse ay që flet
gjuhë *të-panjohurë* nuk' u flet njerëzet, po
Perëndisë; sepse asndonjë s' e kupëton, po
3 me shpirtin' *e ti* flet fshehësira; Po ay që
profiteps, u flet njerëzet për ndërtim e për
4 mësim e për ngushullim. Ay që flet gjuhë *të-
huaj* ndërton vetëhen' e ti; po ay që profi-
5 teps, ndërton kishënë. Edhe dua të-gjithë ju
të flitni gjuhëra, po më tepërë të profitepsni;
sepse ay që profiteps është më i-math se ay
që flet gjuhëra, përveç ndë e përktheftë, që
të marrë ndërtim kisha.
6 Edhe ndashti, o vëllezër, ndë arthça tek
ju dyke folurë gjuhëra, ç' dobi dot' u bënj
juve, ndë mos u folça juve a me të-sbuluarë,

7 a me dituri, a me profiti a me mësim? Edhe
ato që s' kanë shpirt e nxjerrënë zë, a fyell
a qitharë, ndë mos dhënçinë zëre të-çquarë,
si dotë njihetë të-rënit' e fyellit, a të-rënit'
8 e qitharësë? Sepse, ndë dhëntë trumbeta zë
që s' kupëtonetë, cili dotë bënetë gati për
9 luftë? Kështu edhe ju, ndë mos dhënçi me
anë të gjuhësë zë që të kupëtonetë mirë, qysh
dotë kupëtonet' ajo që flitetë? sepse dotë flis-
10 ni nd' erët. Ndë botët mbase ndodhenë kaqë
farë zërrash, edhe asndonjë nga ata *s' është*
11 që s' ka mendim. Ndë mos diça pra men-
dimn' e zërit, dotë jem një varvar tek ay që
flet, edhe ay që flet, një varvar tek unë.
12 Kështu edhe ju, passi u përvëlonetë zë-
mëra për dhuratatë shpirtëriake, lypni të kini
13 të-tepëra për ndërtimn' e kishësë. Përandaj
ay që flet gjuhë *të-panjohurë*, letë faletë që
14 *të-bënet' i-zoti* t'a kthenjë. Sepse ndë ufalça
me gjuhë *të-panjohurë*, shpirti im faletë, po
15 mëndja ime nukë sjell pemë. Ç' duhetë pra?
Dotë falem me shpirtinë, po dotë falem edhe
me mënyrë që të kupëtohem; dotë psall me
shpirtinë, po dotë psall edhe me mënyrë që
16 të kupëtohem. Sepse ndë lavdurofsh me shpir-
tinë, ay që është nga rredhi i të-padituret,
qysh dotë thotë Amin, kur ti falesh ndersë,
17 edhe ay nukë di seç thua. Sepse ti mirë fa-
18 lesh ndersë, po tjatëri nukë ndërtonetë. I
falem ndersë Perëndisë t'im, se flas më

19 shumë gjuhëra se ju të-gjithë; Po ndë ki-
shët dua *më mirë* të flas pesë fjalë me më-
nyrë që të kupëtohem, që të mësonj edhe
të-tjerë, se dhjetë mijë fjalë me gjuhë *të-
panjohurë.*
20 O vëllezër, mos bëhi çuna ndër mëntt;
po bëhi foshnje mbë të-ligënë, edhe të-sosu-
21 rë ndë mëntt. Sepse ndë nomt është shkru-
arë, „Se me të-tjera gjuhëra, e me të-tjera
buzë, dot'i flas këti llauzi; po as kështu nukë
22 dotë më dëgjonjënë," thotë Zoti. Përandaj
gjuhëratë janë për shënjë, jo mb'ata që be-
sonjënë, po mbë të-pabesëtë; e profitia është
jo për të-pabesëtë, po për ata që besonjënë.
23 Ndë umbleththë pra gjithë kisha mbë një vënt,
edhe të-gjithë të flasënë gjuhëra *të-panjohu-
ra,* e të hynjënë *njerës* të paditur'a të-pabe-
së, a nukë dotë thonë, se jeni të-shkalluarë?
24 Po ndë profitepsshinë të-gjithë, e të hynjë
një i-pabesë a i-padituarë, ky qërtonetë prej
25 të-gjithëve, *e* gjykonetë prej të-gjithëve; Edhe
kështu të-fshehurat' e zëmërës' s' ati çpërfa-
qenë; edhe kështu dotë bjerë me faqe për-
mbys, e dot'i faletë Perëndisë, dyke lëçiturë
se Perëndia me të-vërtetë qënkërka ndër
mest t'uaj.
26 Ç'duhetë pra, o vëllezër? Kur të mbli-
dheni, gjithë-sicili prej jush të-psallurë ka,
mësim ka, gjuhë ka, sbulesë ka, të përkthy-
erë *gjuhërash* ka, të-gjitha letë bënenë për

BKSH

27 ndërtim. Ndë foltë ndonjë gjuhë *të-panjohu-*
rë, let'a bënjënë këtë dy nga dy, a më të-
shumënë tre nga tre, edhe *këtë* njëri pas
28 tjatërit; edhe një letë përkthenjë; Po ndë
mos pastë përkthenjës, letë heshtnjë ndë
kishët, edhe letë flasë me vetëhen'e ti e me
29 Perëndinë. E profitër letë flasënë dy a tre,
30 edhe të-tjerëtë letë çquanjënë. Edhe ndë arth-
të sbulesë ndonjëj tjatëri që rri, i-pari letë
31 heshtnjë. Sepse munt njëri pas tjatërit të-
gjithë të profitepsnjënë, që të nxënë të-gjithë,
32 edhe të-gjithë të ngushullonenë. Edhe fry-
mërat'e profitërvet unjënë krye të profitëritë;
33 Sepse Perëndia nuk'është *Perëndi* trazimi,
po paqtimi, sikundrë mbë gjithë kishët të
shënjtorëvet.
34 Gratë t'uaj letë heshtnjënë ndë kishët,
sepse nuk' u ndjenetë atyre të flasënë, po të
unjënë kryetë, sikundrë edhe nomi thotë.
35 Po ndë duanë të nxënë gjë, letë pyesënë bu-
rrat'e tyre ndë shtëpit; sepse është turp për
36 gratë të flasënë ndë kishë. Apo prej jush
dolli fjal' e Perëndisë? apo mbë ju vetëm'
arriti?
37 Ndë i duketë ndonjëj se është profit a
njeri shpirtëriak, letë njohë se ato që u shkru-
38 anj juve janë porosi të Zotit; Po ndë mos
39 di ndonjë këtë, letë mos e dijë. Përandaj,
o vëllezër, kërkoni me zëmërë të-përvëluarë
të profitepsni, edhe mos ndaloni të flasënë

BKSH

40 gjuhëra. Të-gjitha letë bënenë sikundrë ka
hije e me udhë.

Krye 15.

1 Edhe *ndashti*, o vëllezër, u dëftenj juve
ungjillinë, që u ungjillëzova juve, të-cilin'
edhe e muartë, mbë të-cilin' edhe qëndroni;
2 Me anë t'ati edhe shpëtoni, ndë e mbajçi
atë, sikundrë u'a ungjillëzova juve, veç ndë
3 besuatë mbë kot. Sepse u dhashë juve më
përpara atë që mora edhe unë, se Krishti
4 vdiq për fajetë t'anë, pas shkronjavet; Edhe
se ukall ndë varrt, edhe se ungjall të-tre-
5 tënë ditë, pas shkronjavet; Edhe se i uduk
6 Qifajt, pastaj të dy-mbë-dhjetëvet; Pastaj u-
duk mbë më tepërë se mbë pesë qint vëllezër
njëheresh, prej të-cilëvet më të-shumëtë rro-
7 njënë gjer sot, po ca kanë flejturë; Pastaj i
8 uduk Jakovit, pastaj gjithë apostojvet; Edhe
më pastaj nga të-gjithë uduk edhe tek unë,
9 posi mbë një të-dështuarë. Sepse unë jam
më i-vogëli i apostojvet, edhe s'jam i-vëjej-
turë të quhem apostoll, sepse ndoqa kishën'e
10 Perëndisë. Po me hirin'e Perëndisë jam ç'
jam; edhe hiri i ati që *m'udha* nuk'ubë i-
kotë, po umunduashë më tepërë se ata të-
gjithë; po jo unë, po hiri i Perëndisë që
11 *është* bashkë me mua. A unë pra, a ata, kë-
shtu lëçismë, edhe kështu besuatë.
12 Edhe ndë lëçitetë Krishti se ungjall prej

BKSH

së-vdekurish, qysh ca veta ndër ju thonë,
13 se të-ngjallurë të-vdekurish nukë ka? Edhe
ndë mos ka të-ngallurë të-vdekurish, as Kri-
14 shti nuk'ungjall; Edhe ndë mos ungjall Kri-
shti, pa fjalë të-lëçituritë t'ënë është të-kotë,
15 edhe besa juaj e-kotë; Edhe qënkemi edhe
dëshmimtarë të-rrem të Perëndisë, sepse dësh-
muamë për Perëndinë, se ngjalli Krishtinë;
të-cilinë nuk'e paska ngjallurë, ndë qoftë
16 kështu se nukë ngjallenë të-vdekuritë. Sepse
ndë mos ngjallenë të-vdekuritë, as Krishti
17 nuk'ungjall. Po ndë mos ungjall Krishti, besa
juaj ësht' e-kotë; edhe po jeni ndë fajet t'uaj;
18 Pa fjalë edhe ata që flejtnë mbë Krishtinë
19 janë të-humburë. Ndë shpresfshimë, mbë Kri-
shtinë vetëmë mbë këtë jetë, jemi më të-
mjerët'e gjithë njerësvet.
20 Po ndashti Krishti ungjall prej së-vdeku-
rish; ubë pem' e-parë e atyre që kanë flej-
21 turë. Sepse sikundrë vdekja *erdhi* me anë
njeriu, *kështu* edhe të-ngjallurit' e të-vdeku-
22 ret *është* me anë njeriu. Sepse sikundrë të-
gjithë vdesënë mb' Adhaminë, kështu edhe
23 të-gjithë dotë marrënë jetë mbë Krishtinë; Po
gjithë-sicili ndë radhët të ti; Krishti *është*
pem' e-parë, pastaj sa janë të Krishtit, mbë
24 të-ardhurit t'ati *për së-dyti*; Pastaj *dotë jetë*
fundi, kur të apë mbretërinë ndë dorët të
Perëndisë edhe Atit; kur të prishnjë çdo ur-
25 dhër e çdo pushtet e fuqi. Sepse duhetë të

BKSH

mbretëronjë ay, gjersa të vërë gjith' armiqtë
26 ndënë këmbët t' atia; I-pastajmi armik që
27 dotë prishetë *është* vdekja. Sepse „të-gjitha
i vuri poshtë ndënë këmbët t' atia;" po kur
thotë, se të-gjitha janë vënë poshtë, merretë
vesh se mbetetë jashtë ay që vuri ndënë atë
28 të-gjitha. Edhe kur t' i unjënë kryetë ati të-
gjitha, atëhere edhe vetë Biri dotë unjë kry-
etë tek ay që vuri të-gjitha ndënë atë, që të
jetë Perëndia të-gjitha mbë të-gjitha,
29 Sepse ç' dotë bënjënë ata që pagëzonenë
për të-vdekuritë? ndë qoftë se me të-vërtetë
nukë ngjallenë të-vdekuritë, përse edhe pa-
30 gëzonenë për të-vdekuritë? Përse edhe neve
31 jemi ndënë rrëzik mbë çdo orë? Përdita vdes,
edhe se është kështu bënj be mbë të-mbu-
rruritë *t'im* për ju që kam mbë Jisu Krish-
32 tinë, Zotinë t' ënë. Ndë si njeri luftova me
bisha ndë Efesët, ç' dobi kam, ndë qoftë se
nukë ngallenë të-vdekuritë? „letë hamë e letë
33 pimë; sepse nesërë dotë vdesëmë." Mos gë-
njehi; *sepse* „Shoqërira të-liga prishnjënë
vetia të-mira."
34 Sgjohi mbë të-drejtënë, e mos fëjeni; sepse
ca *veta* nga ju nukë e njohënë Perëndinë;
për turp t'uaj po u'a them juve *këtë.*
35 Po dotë thotë ndonjë, Qysh ngjallenë të-
36 vdekuritë? edhe me ç' farë trupi vinjënë? O
i-marrë, atë që mbjell ti, nukë merr jetë, ndë
37 mos vdektë. Edhe atë që mbjell, nukë mbjell

atë trupinë që është për të bërë, po një koqe
të-sveshurë, si të goditnjë, a gruri a ndonjë
38 tjetërë gjëje nga të-tjeratë. Po Perëndia i ep
trup si të dojë, edhe gjithë-sicilësë nga fa-
39 ratë trupin' e saj të-veçantë. Çdo mish nuk'
është gjithay mish; po tjatër' është mishi i
njerëzet, e tjatërë mishi i bagëtivet, e tjatërë
40 i pishqet, e tjatërë i shpeset. Ka edhe trupe
qielli, edhe trupe dheu; po tjatër' është lavdia
e atyreve të qiellit, e tjatër' e atyreve të dheut.
41 Tjatër' është lavdia e diellit, e tjatërë lavdia
e hënësë, e tjatërë lavdia e yjvet; sepse yll
nga yll ndan ndë lavdit.
42 Kështu edhe të-ngjallurit' e të-vdekuret;
mbilletë ndë prishje, *e* ngrihetë ndë paprishje;
43 Mbilletë ndë çnderim, *e* ngrihetë ndë lavdi;
mbilletë ndë dobësirë, *e* ngrihetë ndë fuqi;
44 Mbilletë trup shtëze, e ngrihetë trup shpirti.
45 Ka trup shtëze, ka edhe trup shpirti. Kështu
ësht' edhe shkruarë, I-pari njeri, Adhami, „ubë
frym' e-gjallë;" i-pastajmi Adhani, shpirt që
46 ep jetë. Edhe nuk' ubë më përpara ajo e
shpirtit, po ajo e shtëzësë, pastaj ajo e shpir-
47 tit. Njeriu i-parë është prej dheut, i-balttë;
48 njeriu i-dytë është Zoti prej qielli. I-çfarëtë
është i-baltti, t' atillë *janë* edhe të-balttëtë;
edhe i-çfarëtë *është* qiellori, t' atillë *janë* edhe
49 qiellorëtë. Edhe sikundrë veshmë figurën' e
të-balttit, dotë vëshmë edhe figurën' e qiello-
50 rit. Edhe këtë e them, o vëllezër, se mish

edhe gjak s'munt të trashëgonjë mbretërin'e
Perëndisë, as prishja trashëgon paprishjenë.
51 Ja tek po u them juve një fshehësirë: të-
gjithë nukë dotë flemë, po të-gjithë dotë ndë-
52 rronemi, Mbë një të-filmë, mbë një të-hedhurë
të syrit, ndë trumbetët të-pastajme; sepse dotë
bjerë trumbetë, edhe të-vdekuritë dotë ngja-
llenë të-paprishurë, edhe neve dotë ndërro-
53 nemi. Sepse ky *trup* që prishetë duhetë të
veshnjë paprishjenë, edhe ky *trup* që vdes
duhetë të veshnjë pavdekjenë.
54 Edhe ky *trup* që prishetë kur të veshnjë
paprishjenë, edhe ky *trup* që vdes kur të
veshnjë pavdekjenjë, atëhere dotë bënetë fjala
qëështe shkruarë, „Upërpi vdekja nga vito-
55 reja.“ „Ku është, o vdekje, thumbi yt? ku
56 ësttë, o varr, vitoreja jote?“ Edhe thumbi i
vdekjesë *është* faji; edhe fuqia e fajit *është*
57 nomi. Po falemi ndersë Perëndisë që na dha
vitorenë me anë të Zotit Jisu Krisht.
58 Përandaj, o vëllezërit'e mi të-dashurë,
qëndroni të-fortë e të-patundurë, dyke tepë-
ruarë përherë ndë punët të Zotit, sepse e dini
se mundimi juaj nuk' është i-kotë mbë Zotinë.

Krye 16.

1 Edhe për të-mbledhurit'e ndihmëravet për
shënjtorëtë, sikundrë urdhërova kishët'e Ga-
2 llatisë, kështu bëni edhe ju. Të-parënë *ditë*
të *çdo* jave gjithë-sicili prej jush letë vërë

BKSH

mbë nj'anë, e letë mbledhë atë që t'ja bënjë
mbarë *Perëndia*, që, kur të vinj, të mos bë-
3 nenë atëhere të-mbledhura *ndihmërash*. Edhe
kur të vinj, ata që të sgjithni ju me kartëra
dot'i dërgonj, që të shpienë dhuratënë t'uaj
4 ndë Jerusalim. Edhe ndë qoftë gjë e-vëjejturë
të vete edhe unë, dotë vinjënë bashkë me mua.
5 Edhe dotë vinj tek ju, si të shkonj ndë-
për Maqedhonit, (sepse *ndashti* po shkonj
6 ndëpër Maqedhonit;) Edhe mundetë të mbe-
tem te ju *ca kohë*, a edhe të dimëronj, që të
7 më përcillni ju kudo që të vete. Sepse nukë
dua që t'u shoh juve ndashti dyke shkuarë;
po shprenj të mbetem përanë jush ca kohë,
8 ndë *më* dhëntë leië Zoti. Edhe dotë mbetem
ndë Efesë gjer të-kremten' e Pentikostisë;
9 Sepse m' uhap një der' e madhe edhe *plot* me
punë, edhe kundrështarë janë shumë.
10 Edhe ndë arthtë Timotheu, vështoni të
jetë pa frikë ndër ju; sepse *ëdhe ay* punon
11 punën' e Zotit sikundrë edhe unë. Asndonjë
pra të mos e bënjë për asgjë; po përcill-e-
ni me paqtim, që të vinjë tek unë; sepse po
12 e pres bashkë me vëllezëritë. Sa për vëllanë
Apollo, i uluçë shumë që të vinte ndër ju
bashkë me vëllezëritë; edhe asfare s' deshi të
vinjë ndashti; po dotë vinjë, kur të ketë nge.
13 Rrini sgjuarë, qëndroni ndë besët; bëhi bu-
14 rra, e forcohi. Gjithë punëtë t' uaj letë bë-
nenë me dashuri.

15 Edhe u lutem juve, o vëllezër, (e dini
shtëpin' e Stefanajt, se është pem' e-parë e
Aharisë, edhe se e bënë vetëhen'e tyre kusht
16 ndë shërbesët të shënjtorevet;) të unjni kryetë
edhe ju ndë të-këtillët, edhe ndë çdo njeri
që punon bashkë *me ne* edhe mundonetë.
17 Edhe gëzonem për të-ardhurit' e Stefanajt
edhe të Furtunatit edhe të Ahaikojt, sepse
18 këta mbushnë të-shterëtë t'uaj; Sepse prejtnë
shpirtinë t'im edhe t'uajnë. Nderoni pra të-
këtillëtë.
19 U falenë juve me shëndet kishët' e Asisë.
U falenë juve me shëndet mbë Zotinë Aqilla
edhe Priskilla bashkë me kishënë *që është*
20 ndë shtëpit t'atyreve. U falenë juve me shën-
det gjithë vëllezëritë. Përshëndetni njëri tja-
tërinë me të-puthurë të-shënjtëruarë.
21 Të-faluritë me shëndet *ushkrua* me do-
22 rënë t' ime, të Pavlit. Ndë është ndonjë që
23 nukë do Zotinë t' ënë Jisu Krisht, letë jetë
anathema. Maran-Atha *). Hiri i Zotit Jisu
24 Krisht *qoftë* me ju. Dashuria ime *qoftë* me
gjithë ju mbë Jisu Krishtinë. Amin.

*) Zoti ynë vjen.

BKSH

Karta e-dytë e Apostollit Pavël mbë Korinthianëtë.

Krye 1.

1 Pavli, apostoll i Jisu Krishtit me anë të
dashurimit të Perëndisë, edhe vëllaj Timothe,
mbë kishën'e Perëndisë që është ndë Ko-
rinthë, bashkë me gjithë shënjtorëtë që janë
2 ndëpër gjithë Ahainë; Hir qoftë mbë ju edhe
paqtim nga Perëndia Ati ynë, edhe nga Zoti
Jisu Krisht.
3 I-bekuarë *qoftë* Perëndia edhe Ati i Zotit
t'enë Jisu Krisht, Ati i përdëllimevet edhe
4 Perëndia i çdo ngushullimi, Qe na ngushu-
llon mbë çdo shtrëngim t'ënë, që të munt-
më të ngushullojm'ata *që gjëndenë* mbë çdo
shtrëngim, me anë të *ati* ngushullimi që ngu-
shullonemi *edhe neve* vetë nga Perëndia;
5 Sepse sikundrë tepëronjënë të-pësuarat'e
Jisu Krishtit mbë ne, kështu me anë të Jisu
6 Krishtit tepëron edhe ngushullimi ynë. Edhe
ndë kemi shtrëngime, kemi për ngushullimin'
e për shpëtimnë t'uaj, qe punonetë me anë
të durimit të gjithatyre të-pësuarave që pë-
sojmë edhe ne; a ndë ngushullonemi, *ngu-
shullonemi* për ngushullimin' e për shpëtiminë
t'uaj; edhe shpresa jonë për ju *ësht*'e-pa-

BKSh

7 tundurë. Sepse e dimë, se sikundrë jeni pje-
sëtarë mbë të-pësuarat, kështu *dotë jeni* edhe
mbë ngushullimt.
8 Sepse s'duamë të mos dini, o vëllezër,
për shtrëngiminë t' ënë që na gjajti nd' Asit,
se vuajtmë jashtë masësë, përmbi fuqinë t'
ënë, kaqë sa udëshpëruam' edhe për jetënë.
9 Po neve ndë vetëhet t'ënë kishimë marrë
vendimn'e vdekjesë, që të mos kemi shpresë
mbë vetëhenë t'ënë, po mbë Perëndinë që
10 ngjall të-vdekuritë; I-cili na shpëtoj prej një
vdekjeje kaqë se-madhe, edhe na shpëton;
mbë të-cilinë shprejmë, se edhe *prapë* dotë
11 *na* shpëtonjë, Kur të na ndihni edhe ju me
të-luturëtë për ne, qe të bënetë të-falurë
ndersë për neve prej shumë vetash për dhu-
ratënë *që udha* mbë ne me anë të shumë
njerësve.
12 Sepse të-mburruritë t'anë është këta, dësh-
mimi i ndërgjegjesë s'anë, se me thjeshtë-
sirë e me kthjellësirë Perëndie, e jo me di-
turi mishi, po me hir Perëndie, usuallmë ndë
13 *këtë* botë, edhe më tepërë te ju. Sepse nuk'
u shkruajmë juve të-tjera, po ato që kën-
doni, a edhe i njihni; edhe shprenj se edhe
14 gjer ndë funt dot'i njihni, Sikundrë edhe na
keni njohurë gjer mbë një shkallë, se jemi
mburrim mbë ju, sikundrë *edhe* juve mbë ne,
ndë ditët të Zotit Jisu.
15 Edhe me këtë besim donja të vinja te ju

më përpara, që të kishitë *një* hir të-dytë,
16 Edhe prej jush të-shkonja ndë Maqedhonit;
edhe përsëri nga Maqedhonia të vinja te ju,
edhe prej jush të përcilleshe për ndë Judhet.
17 Dyke menduarë pra këtë, vallë mos përdora
mëndje të-lehëtë? apo sa mendonj, pas mi-
shit i mendonj, që të jetë mbë mua po po,
18 e jo jo? Po Perëndia është besëtar, se fjala
jonë që *ufol* mbë ju s'ubë po edhe jo.
19 Sepse i Bir'i Perëndisë Jisu Krisht, që u-
lëçit ndër ju me anë t'ënë, me anë t'ime edhe
te Silluanit edhe të Timotheut, s'ubë po edhe
20 jo, po ubë po mb'atë. Sepse gjithë të-zotua-
rat'e Perëndisë janë mb'atë po, edhe mb'atë
amin, për lavdi të Perëndisë me anë t'ënë.
21 Edhe ay qe na forcon neve bashkë me ju
mbë Krishtinë, e që na leu *me vaj, është*
22 Perëndia. I-cili edhe na vulosi, edhe na dha
kaparin'e Frymësë ndë zëmërat t'ona.
23 Edhe unë thërres për dëshmimtar Perën-
dinë mbë shpirtinë t'im, se dyke kursyerë
24 juve s'erdha më ndë Korinthë; Jo se kemi
pushtet mbi besënë t'uaj, po se jemi bashkë-
punëtorë të gëzimit t'uaj; sepse qëndroni
ndë besët.

Krye 2.

1 Edhe me vetëhenë t'ime vendosa këtë,
2 të mos vinj përsëri te ju me hidhërim. Sepse
unë ndë u hidhërofsha juve, e cili ësht' ay

që më gëzon, ndë mos është ay që hidhë-
3 ronetë prej meje? Edhe u shkrova juve këtë,
që, kur të vinj, të mos kem hidhërim nga
ata që duhej të kishnjam gëzim; dyke pa-
surë shpresë mbë gjithë ju, se gëzimi im
4 është i juve të-gjithëve. Sepse prej shumë
shtrëngimi e acarimi të zëmërësë u shkrova
juve me shumë lot, jo që të hidhëroneni, po
që të njihni dashurinë që kam me të-tepërë
mbë ju.
5 Edhe ndë ubë ndonjë ngajë hidhërimi,
s'më ka hidhëruarë mua vetëmë, po gjithë
ju gjer mbë një shkallë, që të mos u ngar-
6 konj juve të-gjithë. Mjaft *është* për të-këti-
llinë *njeri* ky qërtim që ubë prej më të-shu-
7 mëvet. Kaqë sa përkundrazi *duhetë* më te-
përë t'a ndjeni *atë* edhe t'a ngushulloni, që
të mos përpihetë i-këtilli *njeri* nga hidhëri-
8 mi i-tepërë. Përandaj u lutem juve t'i dëf-
9 teni ati dashuri. Sepse përandaj edhe u
shkrova, që të njoh provënë t'uaj, ndë jini
10 të-dëgjuarshim mbë të-gjitha. Edhe ati që
t'i falni gjë, *j'a fal* edhe unë; sepse ndë kam
falur' unë gjë, kujdo që t'ja kem falurë, për
ju *e kam bërë këtë*, përpara Krishtit, që të
mos tepëronjë fuqia e Satanajt përmbi ne;
11 Sepse i dimë mendimet'e ati.
12 Edhe kur erdha ndë Troadhë për *të-lëçi-
turë* ungjillin' e Krishtii, edhe m' uhap derë
për Zotinë, s'pata të-prëjturë ndë shpirtt

BKSH

t'im, sepse nukë gjeta Titonë vëllanë t'im;
13 Po si u lashë shëndet atyre, dolla *e vajta*
ndë Maqedhoni.
14 Po i falemi ndersë Perëndisë që na bën të
dalëmë mundës kurdo mbë Krishtinë, edhe
që çpërfaq mbë çdo vënt erën' e-mirë e
15 të njohurit të ti me anë t'ënë. Sepse er' e-
mirë e Krishtit jemi *neve* përpara Perëndisë
mb'ata që shpëtonjënë edhe mb'ata që hum-
16 basënë; Mbë këta *jemi* erë vdekjeje për
vdekje, e mb'ata erë jete për jetë. Edhe për
17 këto cili ësht' i-zoti? Sepse neve nuk'e
prishmë për kobim fjalën'e Perëndisë, sikun-
drë *bëjnë* të-shumëtë, po si prej zëmërë së-
kthjellëtë, po si prej Perëndie, përpara Pe-
rëndisë, flasmë mbë Krishtinë.

Krye 3.

1 Zëmë përsëri të ndorëzojmë vetëhenë t'
ënë? apo mos kemi nevojë, si ca *veta*, për
kartëra ndorëzimi mbë ju, a për kartëra
ndorëzimi prej jush? Ju jeni karta jonë
shkruarë brënda ndë zëmërat t'ona, që nji-
3 het'e këndonetë nga gjithë njerëzitë; Edhe
çpërfaqeni se jeni një kart'e Krishtit, e-bërë
me anë të shërbimit t'ënë, që është shkrua-
rë jo me mellan, po me Frymën'e Perëndis'
së-gjallë, jo mbë dërrasa të-gurta, po mbë
dërrasa të-mishta të zëmërësë.
4 Edhe të-këtillë të-besuarë kemi mbë Pe-

BKSH

5 rëndinë me anë të Krishtit; Jo se jemi të-
zottë prej vetiu të kupëtojmë ndonjë gjë,
posi prej vetëhesë s'onë, po trimëria jonë
6 *është* nga Perëndia; I-cili edhe na bëri të-
zottë të jemi shërbëtorë të dhjatës'së-re, jo
të shkronjësë, po të frymësë; sepse shkronja
vret, po fryma ep jetë.
7 Po ndë qoftë se shërbesa e vdekjesë, që
është shkruarë me shkronja ndë gur, ubë e-
lavduruarshime, kaqë sa të bijt' e Israilit s'
muntninë të vështroninë me sy faqen'e Moi-
siut nga lavdia e faqes' s' ati, që ishte për
8 të prishurë. Qysh nukë dotë jetë më shumë
9 e-lavduruarshime shërbesa e Frymësë? Se-
pse ndë qoftë se shërbesa e dënimit *është*
lavdi, skumë më tepërë tepëron ndë lavdit
10 shërbesa e drejtërisë. Sepse as ulavdurua
nga këjo anë ajo që qe e-lavduruarshime,
për punë t' asaj lavdisë që kapërxen çdo
11 masë. Sepse ndë qoftë se ajo që qe për të
prishurë *qe* e-lavduruarshime, shumë më te-
për' *ësht'* e-lavduruarshime ajo që mbetetë.
12 Dyke pasurë pra të-këtillë shpresë, fla-
13 sëmë me shumë kuxim; Edhe jo si Moisiu që
vinte mbulesë mbi faqet të ti, që të mos e
vështroninë me sy të bijt' e Israilit fundin' e
14 asaj që ishte për të prishurë. Po mëndjet'e aty-
re uverbuanë; sepse gjer mbë ditën' e-sormë
gjithajo mbulesë mbetetë e-pasbuluarë mbë
të-kënduarët të dhjatës' së-vjetërë, *e-cila mbu-*

BKSH

15 *lesë* ësht' e-prishurë me anë të Krishtit. Po
gjer sot, kur këndonetë Moisiu, mbulesë gjën-
16 detë mbi zëmërët t'atyre. Po kur të kthenetë
17 *Israili* te Zoti, dot' i hiqetë mbulesa. Po, Zoti
është Fryma; edhe ku është Frym' e Zotit,
18 atje është liri. Po neve të-gjithë dyke parë
lavdin' e Zotit me faqe të-sbuluarë posi ndë
pasqyrë, ndërrojmë formënë mbë gjithatë
shëmbëllesë prej lavdie mbë lavdi, posi prej
Frymës' së Zotit.

Krye. 4.

1 Përandaj dyke pasurë këtë shërbesë, si
2 kundrë upërdëllyemë, s'lodhemi; Po mohua-
më të-fshehurat' e turpërisë, e s' ecëjmë me
dinakëri, as nukë prishmë fjalën'e Perëndisë
me kobim, po me të-përçfaqurit' e së-vërte-
tësë ndorëzojmë vetëhenë t'ënë mbë çdo ndër-
3 gjegje njerëzish përpara Perëndisë. Edhe ndë
qoftë se është i-mbuluarë ungjilli ynë, është
4 i-mbuluarë mb' ata që humbenë; Sepse Pe-
rëndia i kësaj jete verboj mendimet' e aty-
reve që s' besonjënë, që të mos ndriçonjë
mb' ata drita e ungjillit të lavdis' së Krishtit,
5 i-cili është shëmbëlles' e Perëndisë. Sepse s'
lëçijmë vetëhenë t'ënë, po Zotinë Jisu Krisht;
edhe vetëhenë t' ënë, *për* shërbëtorë mbë ju
6 për Krishtinë. Sepse Perëndia që tha të ndri-
çonjë dritë nga errësira, *ësht'* ay që ndriçoj
ndë zëmërat t'ona për *të dhënë* të-ndriturit'

e të-njohurit të lavdis'së Perëndisë ndë fa-
qet të Jisu Krishtit.
7 Edhe kemi këtë thesar ndë enë të-bal-
tëta, që të jetë tepërica e fuqisë nga Perën-
8 dia, edhe jo nga ne; Mbë çdo gjë shtrëngo-
nemi, po nukë jemi ndë ngushtësirë; jemi
9 të-ngatëruarë, po nukë dëshpëronemi; Ndi-
qemi, po nukë jemi të-lënë *nga Perëndia;*
jemi të-hedhurë poshtë, po s'jemi të-hum-
10 burë; Kurdo bjemë rreth vdekjen'e (Zotit)
Jisu ndë trupt *t'ënë*, që edhe jeta e Jisujt të
11 çpërfaqetë ndë trupt t'ënë. Sepse neve që
rrojmë gjithënjë epemi mbë vdekje për Kri-
shtinë, që të çpërfaqet' edhe jeta e Jisujt ndë
12 misht t'ënë të-mortçim. Kaqë sa vdekja puno-
13 netë mbë ne, e jeta mbë ju. Edhe dyke pa-
surë po atë frymë të besësë, pas të-shkrua-
rit, „Besova, përandaj fola," edhe neve be-
14 sojmë, përandaj edhe flasëmë; Dyke diturë,
se ay që ngjalli Zotinë Jisu dotë ngjalnjë
edhe neve me anë të Jisujt, edhe dotë na
15 nxjerrë përpara ati bashkë me ju. Sepse të-
gjitha *janë* për ju, që hiri dyke tepëruarë për
të-faluritë ndersë e më të-shumëvet të te-
16 përonjë mbë lavdin'e Perëndisë. Përandaj s'
lodhemi; po ndonëse njeriu ynë i-përja-
shtësm prishetë, i-përbrëndëshmi përsëritetë
17 dita me ditë. Sepse shtrëngimi ynë i-lehëtë
që është për pak kohë punon për ne një të-
18 përjetëshme lavdi së-tepërmi të-madhe; Sep-

se neve nukë shtjemë sytë mb'ato që shihenë, po mb'ato që nukë shihenë; sepse ato qè shihenë janë për pak kohë, po ato që nukë shihenë janë të-përjetëshme.

Krye 5.

1 Sepse e dimë, se ndë uprishtë shtëpia
jonë e-baltëtë e kësaj tende, kemi një *tja-
tërë* ndërtesë prej Perëndisë, një shtëpi jo
të-bërë me dorë, *po* të-përjetëshme, ndë qiejt.
2 Sepse ndë këtë *tendë* neve psherëtijmë, dyke
dëshëruarë të veshmë përsipërë shtëpinë t'
3 ënë qiellore; Ndë qoftë se kemi veshurë *atë*,
4 nukë dotë gjëndemi të-sveshurë. Sepse *neve*
që jemi ndë këtë tendë, psherëtijmë ndënë
barrët t'asaj; sepse s'duamë të svishemi, po
të vishemi përsipërë, që të përpihetë e-mor-
5 çimja prej jetësë. Edhe ay që na bëri për
këtë punë, *është* Perëndia, i-cili edhe na dha
6 kaparin' e Frymësë. Dyke pasurë pra zëmërë
përherë, edhe dyke diturë, se gjersa rrimë
7 ndë trupt jemi lark nga Zoti; (Sepse ecëjmë
8 me besë, *e* jo me faqe;) Përandaj kemi zë-
mërë e na pëlqen me tepërë të jemi lark
9 nga trupi, e të jemi përanë Zotit. Përandaj
edhe përpiqemi, a dyke qënë afërë, a dyke
qënë lark, të jemi të-pëlqyerë tek ay.
10 Sepse të-gjithë ne duhetë të dukemi për-
para gjykatores' së Krishtit, që të çpaguhetë
gjithë-sicili për ato *punëra që janë punuarë*

me anë të trupit, sipas atyreve që bëri, a
të-mirë, a të-ligë.
11 Dyke diturë pra frikën'e Zotit, njerësvet
u'a mbushmë mëndjenë, edhe të Perëndia
jemi të-çfaqurë; edhe shprenj se edhe ndë
12 ndërgjegjet t'uaj jemi të-çfaqurë. Sepse nukë
ndorëzojmë vetëhenë t'ënë përsëri te ju, po u
apëmë juve ngajë të mburreni për neve, që të
keni *ç't'u thoni* atyreve që mburrenë me faqe,
13 e jo me zëmërë. Sepse ose jemi jashtë mënç,
për Perëndinë *jemi*, ose jemi ndër mëntt,
14 për ju *jemi*. Sepse dashuria e Krishtit na
shtrëngon; sepse kështu gjykojmë, se ndë
vdiq një për të-gjithë, të-gjithë pa fjalë vdiq-
15 në; Edhe vdiq për të-gjithë, që të mos rro-
njënë më për vetëhen' e tyre ata që rronjënë,
16 po për atë që vdiq e ungjall për ata. Përan-
daj neve që ndashti e paskëtaj s'njohëmë as-
ndonjë pas mishit; edhe ndonëse e njohmë
Krishtinë pas mishit, po ndashti më s'e njo-
17 hëmë. Përandaj ndë është ndonjë mbë Krish-
tinë, *ky është* ndërtes'e-re; të-vjetëratë shku-
18 anë, ja të-gjitha tek ubënë të-ra. Edhe të-
gjitha janë prej Perëndisë, që na paqtoj me
vetëhen' e ti me anë të Jisu Krishtit, edhe
19 na dha shërbesën'e të-paqtuarit; Do-me-thë-
në Perëndia ishte mbë Krishtinë, dyke paq-
tuarë botënë me vetëhen'e ti, pa numëruarë
atyre fajet'e atyre; edhe vuri ndër ne *për
shërbësë* fjalën'e të-paqtuarit.

20 Për Krishtinë pra lajmësojmë, sikurse t'u
lutej Perëndia me anë t'ënë; u lutemi pra
juve për Krishtinë, paqtohi me Perëndinë.
21 Sepse *Perëndia* atë që s'njohu faj për ne e
bëri *të jetë* faj, që të bënemi neve drejtëria
e Perëndisë me anë t'ati.

Krye 6.

1 Edhe si punëtorë bashkë me atë, u lute-
mi juve të mos e pritni hirin'e Perëndisë
2 mbë të-kotë; (Sepse thotë, „Ndë kohë të-
pëlqyerë të dëgjova ty, edhe ndë ditë shpë-
timi të ndiha ty;" ja ndashti *tek është* koh' e-
pëlqyerë; ja ndashti *tek është* ditë shpëtimi;)
3 Mbë asndonjë gjë s' apëmë asndonjë pën-
4 gesë, që të mos shahetë shërbesa jonë; Po
mbë çdo gjë ndorëzojmë vetëhenë t'ënë si
shërbëtorë të Perëndisë, ndë shumë durim,
ndë shtrëngime, ndë nevoja, ndë ngushtime,
5 Ndë të-rrahura, ndë burgje, ndë trumbullı-
më, ndë mundime, ndë të-pafIejtura, ndë a-
6 gjërime; Ndë pastrim, ndë urtësi, ndë zëmë-
rë të-gjerë, ndë mirësi, ndë Frymë të-Shënj-
7 tëruarë, ndë dashuri pa dy faqe; Ndë fjalë
të së-vërtetësë, ndë fuqi të Perëndisë; me
armët'e drejtërisë ndë dorët të-djathtë e ndë
8 të-mëngjërët; Ndë lavdi e *ndë* çnderim, ndë
emërë të-mirë e *ndë* emërë të-keq; posi gë-
9 njeshtarë, po të-vërtetë; Posi të-panjohurë,
po të-njohurë mirë; po si *njerës* që vdesënë,

po jà tek rrojmë; posi të-munduarë, po jo
10 të-vdekurë; Posi të-hidhëruarë, po gjithënjë
të-gëzuarë; posi të-vobeq, po shumë veta i
bëjmë të-pasurë; possi *njerës* që s'kanë gjë,
po të-gjitha i kemi ndë dorë.
11 Goja jonë uhap mbë ju, o Korinthianë, zë-
12 mëra jonë usgjerua. Nukë jeni ndë ngushtim
mbë ne, po jeni ndë ngushtim përbrënda
13 jush. *Dyke çpaguarë* pra *neve* gjithatë çpa-
gim, (posi bijve *u* flas,) sgjerohuni edhe ju.
14 Mos hyni mbë një sgjedhë me të-pabe-
sëtë; sepse ç'pjesë ka drejtëria me panominë?
15 edhe ç'shoqëri *ka* drita me errësirënë? Edhe
ç'të-bashkuarë *ka* Krishti me Velialinë? a
16 ç'pjesë *ka* besëtari me të-pabesinë? A ç'ba-
shkim ka tempulli i Perëndisë me idhujtë? se-
pse ju jeni tempulli i Perëndis' së-gjallë, si-
kundrë tha Perëndia, „Se dotë rri brënda
ndër ata, edhe dotë ecënj; edhe dotë jeni Pe-
rëndia i atyreve, edhe ata dotë jenë llauzi
17 im.“ Përandaj „dilni nga mezi i atyreve, e-
dhe ndahi *nga ata*,“ thotë Zoti, „edhe mos
ziri me dorë gjë të-pëgërë;“ edhe „unë dot'
18 u pres juve përbrënda, Edhe dotë jem Ati
juaj, edhe ju dotë jeni bijt' e mi edhe bijat'
e mija, „thotë Zoti Gjithë-pustetësi.

Krye 7.

1 Dyke pasurë pra, o të-dashurë, këto të-
zotuara, letë qërojmë vetëhenë t'ënë nga ç'do

BKSH

ndyrësirë të mishit e të shpirtit, dyke pu-
nuarë shënjtëri me frikë Perëndie.
2 Ep-na-ni neve vënt *ndër ju*; asnjeriu s'i
bëmë keq; asŋeri nukë prishmë *ndë karaktirt,*
3 asŋeriu s'i muarmë gjë tepërë. Nuk' e them
këtë për të dënuarë juve; sepse u thashë juvë
që përpara, se jeni ndë zëmërat t'ona, kaqë
sa të vdesmë bashkë e të rrojmë bashkë.
4 Shumë kuxim kam mbë ju, shumë të-mbu-
rrurë kam për ju; jam plot me ngushullim,
kam gëzim të-math me të-tepërë mbë gjithë
shrtëngimnë t'ënë.
5 Sepse si erthmë ndë Maqedhoni, trupi ynë
s'pat asndonjë të-prëjturë, po gjëndeshimë
ndë shtrëngime mbë çdo gjë; përjashta luf-
6 tëra, përbrënda frikëra. Po Perëndia që ngu-
shullon të-përunjuritë, na ngushulloj me të-
7 arđurit' e Titosë; Edhe jo vetëmë me të-ar-
dhurit' e ati, po edhe me ngushullimnë që u-
ngusullua ndër ju, dyke dëftyerë neve ma-
llinë t'uaj të-math, të-qarëtë t'uaj, zëmërënë
t'uaj të-përvëluarë për mua; kaqë sa ugëzova
8 më tepërë. Sepse, ndonëse u hidhërova juve
me kartënë, s'pendonem, ndonëse pendone-
she; sepse shoh se ajo kartë, ndonëse për
9 pak kohë, u hidhëroj juve. Ndashti gëzonem,
jo se uhidhëruatë, po se uhidhëruatë për pen-
dim; sepse uhidhëruatë si pas *udhës' së* Pe-
rëndisë, që të mos u bënetë juve ndonjë
10 dëm prej nesh. Sepse hidhërimi sipas *udhës'*

së Perëndisë bje pendim për shpëtim, për të-
cilinë s' pendonetë njeriu; po hidhërimi i bo-
11 tësë bje vdekje. Sepse ja gjithajo punë, të-
hidhëruarëtë t' uaj sipas *udhës' së* Perëndisë,
sa kujdes solli mbë ju! po *sa* fjalë për të-
drejtëruarë, po *sa* zëmëratë, po *sa* frikë, po
sa mall, po *sa* zëmërë të-përvëluarë, po sa
çpagim! me të-gjitha e dëftyetë vetëhenë t'uaj
12 se jeni të-qëruarë mbë *këtë* punë. Përandaj,
ndonëse u shkrova juve, nuk' *e bëra këtë* për
atë që bëri paudhëri, as për atë që i ubë pa-
udhëri, po që të trëgonetë mbë ju kujdesi ynë
që këmi për ju përpara Perëndisë.
13 Përandaj ungushulluamë për ngusullimnë
t' uaj; edhe shumë më tepërë ugëzuamë për
gëzimn' e Titose se i uprëjt shpirti prej juve
14 të-gjithëve. Sepse ndë umburra mbë gjë tek
ay për ju, s' uturpëruashë; po sikundrë u
folmë juve për të-gjitha me të-vërtetë, kështu
edhe të-mburruritë t' ënë të Titua *për ju* dolli
15 të-vërtetë; Edhe atij i shtonetë më tepërë
dashuria për ju, kur bje ndër mëntt të-bin-
durit' e juve të-gjithëve, *se* qysh me frikë
e me të-dridhurë e prittë atë.
16 Gëzonem pra se mbë çdo *punë* kam ku-
xim mbë ju.

Krye 8.

1 Edhe u bëjmë juve të dini, o vëllezër, hi-
rin' e Perëndisë që është dhënë mbë kishërat

BKSHI

2 të Maqedhonisë; Se tepërica e gëzimit t'atyre,
ndonëse ishinë ndë shumë provim shtrëngi-
mi, edhe vobëzia e atyre e-thellë e treguanë
me të-tepërë pasjen' e dorës' s'atyre së-liru-
3 arë. Sepse pas fuqis' së tyre, (e dëshmonj
këtë,) edhe përmbi fuqin' e tyre *dhanë* dyke
4 dashurë vetë; më shumë të lutura na ulutnë
neve t'a presëmë dhuratën' e pjesën' *e tyre*
5 ndë shërbesët që është për shënjtorëtë. Edhe
këtë bënë, jo sikundrë shpryemë, po dhanë ve-
tëhen' e tyre më përpara te Zoti, *pastaj* edhe
6 te ne me dashurim të Perëndisë; Kaqë sa i u-
lutmë Titosë, sikundrë e pat zënë përpara,
këstu edhe t'e mbaronjë mbë ju edhe këtë hir.
7 Po sikundrë tepëroni mbë çdo gjë, ndë
besë e ndë fjalë e ndë dituri e ndë çdo kuj-
des, e ndë dashurit t'uaj mbë neve, *kështu* të
8 tepëroni edhe ndë këtë hir. Nuk'e them këtë
me urdhër, po që me anë të kujdesit të të-tje-
rëvet të provonj edhe të-thjeshtët' e dashu-
9 risë s'uaj; Sepse dini hirin' e Zotit t'ënë Jisu
Krisht, se, ndonëse ishte i-pasurë, ubë i-
vobek për ju, që të bëhi ju të-pasurë me
10 anë të vobëzis' s' ati. Edhe mbë këtë u ap
këshillë; sepse këjo është e-mirë për ju, të-
cilëtë zutë që vjet jo vetëmë t'a bëni, po
11 edhe t'a kërkoni. Ndashti pra mbaro-e-ni
edhe të-bërëtë, që, sikundrë *qe* dëshira për të
kërkuarë, kështu të jetë edhe për të mbarua-
12 rëtë nga ato qe kini. Sepse ndë është gati

zëmëra te ndonjë që përpara, ky është i-
priturë me të-mirë pas atyreve që ka, *e* jo
13 pas atyreve që s' ka. Sepse nukë dua të-
14 tjerë *të kenë* të-prëjturë, e ju shtrëngim; Po
të bënetë me mbarasim, që mbë këtë kohë
tepërica juaj *të mbushnjë* të-shterët' e aty-
reve, që edhe tepërica e atyreve të mbushnjë
të-shterëtë t'uaj *mbë ndonjë kohë;* që kështu të
15 bënetë mbarasim, Sikundrë është shkruarë,
„Ay që *mblodhi* shumë, nukë mori më shumë,
edhe ay që *mblodhi* pak, nukë mori më pak.
16 Po falemi ndersë Perëndisë që ep ndë
17 zëmërët të Titosë gjithatë kujdes për ju; Se-
pse priti të-luturitë *t' ënë*; edhe dyke qënë i-
kujdesurë më tepërë, dolli me dashuri të ti
18 që të vinjë te ju. Edhe bashkë me atë dër-
guam' atë vëllanë, lëvdim' i të-cilit për ungji-
19 llinë *është* ndëpër të-gjithë kishët; (Edhe jo
vetëmë *këjo*, po edhe usgjoth prej kishëvet
që të jetë shoku ynë ndë udhët me këtë dhu-
ratë, që punonetë prej nesh për lavdin' e Zo-
tit vetë, edhe *për të dëftyerë* zëmërënë t' uaj të-
20 gatishime;) Dyke druajturë nga këjo, se mos
na shanjë ndonjë për këtë *ndihmë* të-tepërë
21 që punonetë prej nesh; Sepse kujdesemi për
punëra të-mira jo vetëmë përpara Zotit, po
22 edhe përpara njerësvet. Edhe dërguamë bashkë
me ata vëllanë t' ënë, të-cilinë e kemi pro-
vuarë shumë herë mbë shumë punëra se ësht'
i-kujdesurë, po ndashti është shumë më i-kuj-

23 desurë për besimn' e-math që ka mbë ju. Sa
për Titonë, *ay është* shoku im edhe mbë ju
bashkëpunëtuar; edhe sa për vëllezëritë t' anë,
këta janë apostoj të kishëvet, lavdi e Krish-
24 tit. Dëfteni pra mb'ata, edhe përpara kishë-
vet, dëftesën' e dashurisë s' uaj, edhe të të-
mburrurit t' ënë për ju.

Krye 9.

1 Sa për shërbesënë që bënetë për shënj-
torëtë ësht' e-tepërë për mua t'u shkruanj
2 juve. Sepse e di zëmërënë t' uaj të-gatishime,
për të-cilënë mburrem për ju te Maqedho-
nasitë, se Ahaia ubë gati që vjet; edhe për-
vëlimi i zëmërësë s' uaj ndezi më të-shumëtë
3 veta. Edhe dërgova vëllezëritë, që sa për
këtë gjë të mos dalë të-kotë të-mburruritë
t' ënë për ju, qe, (sikundrë thoshnjam,) të
4 jeni bërë gati; Semos, ndë arçinë bashkë me
mua Maqedhonas, e u gjenjënë juve të-pabërë
gati, turpuronemi neve (që të mos themi ju,)
5 për këtë qëndrim të të-mburrurit *t' ënë*. Për-
andaj umenduashë *se është* nevojë t'u lutem
vëllezërvet që të vinjënë më përpara te ju, e
të bënjënë gati këtë eleimoninënë t' uaj që
uzotuatë që përpara, që kështu të jetë këjo
gati si eleimosinë, e jo si lakmim.

6 Edhe këtë *e them, se* ay që mbjell me
kursim, edhe me kursim dotë korrnjë; edhe
ay që mbjell me dorë të-hapëtë, edhe me

7 dorë të-hapëtë dotë korrnjë. Gjithë-sicili *letë*
apë sikundrë t'i dojë zëmëra, jo me hidhërim,
a prej nevoje; sepse Perëndia do atë që ep
8 me zëmërë të-gëzuarë. Edhe Perëndia ësht' i-
fortë të tepëronjë çdo hir mbë ju, kaqë sa
passi të kini gjithënjë mbë çdo *gjë* gjithë sa
duhenë, të кini të-tepëra për çdo punë të-mirë;
9 (Sikundrë është shkruarë, „Përndau, u dha
të-vobeqvej; drejtëria e ati mbetetë për jetën'
10 *e jetësë.*" Edhe ay që i ep farë ati që mbjell,
edhe bukë për të ngrënë, dhëntë e shumcftë
farënë t' uaj, e rrittë pemët' e drejtërisë s' uaj;)
11 *E* të bëhi të-pasurë nga të-gjitha mbë çdo
punë që kèrkon dorë të-hapëtë, e-cila gjë pu-
non me anë t' ënë të-falurë ndersë mbë Pe-
12 rëndinë. Sepse puna e kësaj shërbese jo ve-
tëmë mbush me të-plotë të-shterat' e shënj-
torëvet, po edhe tepëron me shumë të-falura
13 ndersë mbë Perëndinë, (Sepse dyke provua-
rë këtë shërbesë, *ata* lavduronjënë Perëndi-
në për të-binduritë që rrëfeni mbë ungjillin'e
Krishtit, edhe për dorënë t'uaj të-hapëtë që
14 u ndih atyre edhe gjithëve,) Edhe me të-lu-
turit' e atyre për ju, sepse kanë shumë mall
për ju, për të-tepërinë hir të Perëndisë mbë ju.
15 *Qoftë* të-falurë ndersë mbë Perëndinë për
dhurëtin'e ati që s'tregonetë *me gojë.*

Krye 10.

1 Edhe unë vetë Pavli u lutem juve me

BKSH

anë të butësirës' e të ëmblësirës'së Krishtit,
unë i-cili faqe për faqe jam i-përunjurë ndë
mest t'uaj, e për-së-largu kam kuxim mbë
2 ju; Edhe u lutem, që, kur të vinj, të mos
marr kuxim me *atë* besimnë, me të-cilinë
mendonj të kuxonj kundrë disave, të-cilëtë
na numëronjënë se sikur ecëjmë pas mishit;
3 Sepse, ndonëse ecëjmë ndë misht, nukë bëj-
4 më luftë pas mishit. Sepse armëi'e luftësë
s'onë nukë *janë* të-mishta, po të-forta me
5 Perëndinë për të rrëzuarë fortesa; Sepse rrë-
zojmë mendime edhe çdo lartësirë qe ngri-
hetë lart kundrë të-njohurit të Perëndisë,
edhe bëjmë rop çdo mendim që t'i bindetë
6 Krishtit; Edhe jemi gati të marrëmë çpagim
për çdo pabindje, kur të bënetë të-plotë të-
binduritë t'uaj.
7 A shihni ato *që dukenë* për faqe? Ndë
ka ndonjë të-besuarë mbë vetëhen' e ti se
ësht' i Krishtit, let'a mendonjë këtë përsëri
prej vetëhes' së ti, se, sikundrë ay *ësht'* i
Krishtit, kështu edhe neve *jemi* të Krishtit.
8 Sepse, edhe ndë uburrça ca më tepërë për
pushtetinë t'ënë, që na dha Zoti për ndër-
tim, e jo për të-rrëzuarëtë t'uaj, nukë dotë
9 turpëronem; Qe të mos dukem, se dua t'u
10 frikësonj juve me anë të kartëravet. Sepse,
thotë *ndonjë*, kartëratë janë të-rënda edhe të-
forta; po të-qënurit'*e ati* këtu me trup *është*
11 të-dobëtë, edhe fjala *e ati* s'vëjen gjë. I-kë-

BKSH

tilli letë dijë këtë, se të-çfarëtë jemi ndë fja-
lët me kartëra, kur jemi lark, t'atillë *jemi*
12 *edhe* mbë punët, kur jemi afërë. Sepse nukë
kuxojmë të numërojmë a të mbarasojmë ve-
tëhenë t'ënë me disa *veta* nga ata që ndorë-
zojnë vetëhen'e tyre; po ata vetë dyke maturë
vetëhen' e tyre me vetëhen' e tyre, edhe dyke
mbarasuarë vetëhen' e tyre me vetëhen'e tyre
13 s'kupëtonjënë. Po neve nukë dotë mburremi
jashtë masësë, po pas masës' së rregullesë
qe ndau Perëndia mbë ne, masë, sa të arrij-
14 më edhe gjer ndër ju; Sepse s'e shtrijmë te-
përë vetëhenë t'ënë, sikurse nukë arritmë
ndër ju; sepse edhe gjer te ju arritmë me
15 anë të ungjillit të Krishtit. Edhe nukë mbu-
rremi jashtë masësë për mundime të-huaj,
po kemi shpresë, se, dyke ushtuarë besa ju-
aj, dotë madhonemi mbë ju për-së-tepëri,
16 pas rregullësë s'onë, Kaqë sa të lëçijmë un-
gjillinë edhe mb'ata vënde që janë tej jush,
që të mos mburremi për ato që janë gati
17 ndë rregullë të-huaj. Po ay që mburretë, mbë
18 Zotinë letë mburretë; Sepse s'ësht'i-provuarë
ay që ndorëzon vetëhen'e ti, po ay të-cilin'
e ndorëzon Zoti.

Krye. 11.

1 Makar të duroni pakëzë marrësinë t'ime;
2 po edhe më duroni. Sepse u kam zili juve
me zili Perëndie; sepse u vlova juve me një

BKSH

burrë, që t'u nxjer përpara Krishtit *si* vër-
3 gjëreshë të-pastrëtë. Po kam frikë, se mos
sikundrë gjarpëri gënjeu Evënë me dinakë-
rin'e ti, prishetë kështu *edhe* mëndja juaj
dyke rënë nga thjeshtësira që është mbë
4 Krishtinë. Sepse ndë arthtë ndonjë e t'u lë-
çitnjë një tjetërë Krisht, që nuk' e kemi lë-
çiturë, a merrni *një* tjetërë frymë, qe s'e keni
marrë, a *një* tjetërë ungjill, që s'e keni pri-
turë, me të-mirë dot'e duronit' atë.
5 Po pandeh, se as mbë ndonjë punë s'kam
mbeturë prapa *edhe* nga më të-shënuarëtë
6 apostoj. Edhe ndonëse jam njeri i-trashë
mbë fjalët, po jo *edhe* nga dituria; po me
çdo mënyrë uçpërfaqmë mbë të-gjitha ndër
7 ju. Apo bëra faj, dyke unjurë vetëhenë t'ime,
që të lartoneni ju, sepse dhurëti u lëçita juve
8 ungjillin'e Perëndisë? Të-tjera kishë i ropa,
dyke marrë të-nevojshimetë *prej atyreve* për
9 të shërbyerë juve. Edhe kur ishnjam ndër
ju e pata të-shterë, s'i ubëra barrë asndo-
njëj; sepse të-shterëtë t'im e mbushnë vë-
llezëritë që erthnë nga Maqedhonia; edhe
mbë çdo punë uruajçe, edhe dotë ruhem, që
10 të mos bënem barrë mbë ju. E-vërteta e
Krishtit është tek unë, se nukë dotë me
mbylletë *goja për* këta të mburrurë ndë vën-
11 det të Ahaise. Përse? sepse s'u dua juve?
12 Perëndia e di. Po atë që bënj, edhe *gjithënjë*
dot'a bënj, që të pres shkakun' e atyreve që

BKSH

duanë shkak, që mb'atë *punë* që mburrenë
të gjëndenë të-tillë si edhe neve.
13 Sepse të-tillëtë *njerës janë* apostoj të-rrem,
punëtorë kobimtarë, dyke ndërruarë formënë
14 mbë apostoj të Krishtit. Edhe s' është për
të çudituarë; sepse vetë Satanaj ndërron for-
15 mënë mbë ëngjëll drite. S' është pra *pun'* e
madhe, ndë edhe punëtorët' e ati ndërronjënë
formënë mbë punëtorë drejtërie; e-pastajm' e
të-cilëvet dotë jetë sipas punëvet t' atyre.
16 Përsëri them, Asndonjë letë mos më pan-
dehnjë se jam i-marrë; ndë mos, pak-së-paku
prit-më-ni si të-marrë, që të mburrem edhe
17 unë pakëzë. Atë që flas mbë këtë kuxim *t'im*
për të mburrurë, nuk' e flas sipas Zotit, po
18 si ndë marrësi *e sipërë*. Me-qënë-që shumë
veta mburrenë pas mishit, dotë mburrem edhe
19 unë. Sepse dyke qënë *ju* të-urtë, me ëmbëlsirë
20 duroni të-marrëtë; Sepse duroni, ndë u bëftë
juve ndonjë robër, ndë *u* hëngërtë ndonjë,
ndë *u* marrtë ndonjë *t' uajatë*, ndë umbajtë
ndonjë mbë të-math, ndë u rrahtë ndonjë
21 juve ndë faqet. Për turp e them këtë, sikurse
neve ishimë të-dobëtë; po mbë çdo gjë që ku-
xon ndonjë, (si i-marrë po kuvëndonj,) kuxonj
22 edhe unë. Evrej janë? edhe unë; Israilitë janë?
edhe unë; far' e Avramit janë? edhe unë;
23 Shërbëtorë të Krishtit janë? (*si* jashtë mënç
flas,) më tepërë unë; mbë mundime më te-
përë, mbe plagë jashtë masësë, ndë burgje

24 më tepërë, ndë vdekje shumë herë. Prej Ju-
dhenjvet pesë herë mora dy-zet *frushkulla*
25 pa një; Tri herë urrahçë me shkop, një herë
ugodiçë me gurë, tri herë umbyçë ndë det,
një nat' e një ditë kam bërë ndë funtt *të de-*
26 *tit*; Ndë udhëtime shumë herë, ndë rrëzike
lumënjsh, ndë rrëzike kursarësh, ndë rrëzike
prej farësë *s' ime*, ndë rrëzike prej kombesh,
ndë rrëzike ndë qytet, ndë rrëzike ndë shkre-
tëtirë, ndë rrëzike ndë det, ndë rrëzike ndër
27 vëllezër të-rrem; Ndë mundim e ndë të-vu-
arë, ndë të-paflejtura shumë herë, ndë uri e
ndë et, ndë agjërime shumë herë, ndë të-
28 ftohëtë e ndë të-sveshurë; Përveç të-për-
jashtësmevet, puna ime e-përdiçime, kujdesi
29 i kishëvet. Kush është i-dobëtë, e *unë* s' jam
i-dobëtë? kush skandhalisetë, e *unë* s'digjem?
30 Ndë gjan të mburrem, dotë mburrem për
ato *punëra* që kanë të bëjnë me dobësirënë
31 t'ime. Perëndia edhe Ati i Zotit t' ënë Jisu
Krisht, i-cili ësht' i-bekuarë ndë jetët *të jetë-*
32 *vet*, e di se nukë gënjenj. Ndë Dhamaskë i-
par'i kombit *i-vënë prej* mbretit Aretë ruan-
te rrotullë qytetin' e Dhamasqinevet, sepse
33 donte të më zinte; Edhe nga një dritare prej
murit usbriçë me një çportë, edhe shpëtova
nga duart' e ati.

Krye 12.

1 Të mburrem me të-vërtetë s'më bën mirë;

sepse dotë vinj ndë të-para e ndë sbulesa
të Zotit.
2 Di një njeri mbë Krishtinë përpara katrë-
mbë-dhjetë vjeç, (a se me trup, s'e di; a se
jashtë trupit, s' e di; Perëndia e di;), se i-ti-
lli *njeri* urrëmbye gjer mbë të-tretinë qiell.
3 Edhe e di të-tillinë njeri, (a se me trup, a
4 se jashtë trupit, s' e di; Perëndia e di;) Se
urrëmbye ndë paradhis, edhe dëgjoj fjalë të-
pafolura *me gojë*, të-cilatë s'i ndjenetë njeriut
t' i flasë.
5 Për të-tillinë *njeri* dotë mburrem; po për
vetëhenë t' ime nukë dotë mburrem, veç për
6 dobësirat' e mia. Sepse ndë daça të mburrem,
nukë dotë jem i-marrë; sepse të-vërtetënë
dotë them; po ndruanj, semos pandehnjë
ndonjë për mua më tepërë nga ajo që më
sheh, a më tepërë nga ajo që dëgjon prej
meje.
7 Edhe që të mos mbahem mbë të-math për
sbulesat' e-tepëra, m'udha një gjëmp ndë trupt,
ëngjëll Satan, që të më bjerë me shuplaka, që
8 të mos mbahem mbë të-math. Për këtë tri
herë i uluçë Zotit, që të mërgonetë prej meje;
9 Edhe më tha, Mjaft të është hiri im; sepse
fuqia ime ndë dobësirë tregonet' e-mbaruarë.
Me gëzim të-math pra dotë mburrem më te-
përë për dobësirat' e mia, që të rrijë tek unë
10 fuqia e Krishtit. Përandaj gjenj pëlqim ndë
dobësira, ndë të-shara, ndë nevoja, ndë të-

BKSH

ndjekura, ndë shtrëngime, për Krishtinë; se-
pse, kur jam i-dobëtë, atëhere jam i-fuqishim.
11 Ubësh' i-marrë (dyke mburrurë); ju më
shtrënguatë; sepse duhej unë të dorëzoneshe
prej jush; sepse as mbë një gë s'mbeta pra-
pa nga me të-shënuarët' apostoj, ndonëse
12 s'jam gjë. Shënjat' e apostollit upunuanë ndër
ju me ç'do durim, me çudira, e me shënja, e
13 me fuqira. Sepse mbë ç'punë mbettë prapa
nga kishët' e-tjera, përveç se unë vetë nuk'
ubëshë barrë mbë ju? fal-m'a-ni këtë pau-
dhëri.
14 Ja e-treta herë që jam gati për të ar-
dhurë te ju, e nukë dua t'u bënem barrë; se-
pse s'kërkonj t'uajatë, po juve; sepse bijtë s'
kanë detyrë të mblethnjënë për prindëritë,
15 po prindëritë për bijtë. Po unë me gëzim të-
math dotë prish edhe dotë prishem fare për
shpirtëratë t'uaj, ndonëse, me-gjithë-që u dua
16 më tepërë, duhem më pak. Po letë jetë *kështu*,
unë nuk' ubëshë barrë mbë ju; po dyke qënë
17 dinak, u zura juve me kobim. Mos lakmova
gjë prej jush me anë të ndonjëj nga ata që
18 dërgova te ju? I uluçë Titosë, edhe bashkë
me atë dërgova vëllanë; mos lakmoj gjë
prej jush Titua? nuk' ecmë me gjithatë fry-
më? nuk' *ecmë* mbë gjithato gjurmë?
19 Përsëri pandehni se drejtëronemi përpara
jush? flasëmë përpara Perëndisë mbë Krish-
tinë; edhe të-gjitha *këto*, o vëllezër, *i bëjmë*

BKSH

20 për të-ndërtuaritë t'uaj. Sepse kam frikë, se-
mos, kur të vinj, nuk' u gjenj juve asish që dua,
edhe unë nukë gjëndem te ju i-atillë që doni;
kam frikë, semos janë *ndër ju* qarta, zilira,
zëmërata, të-zëna, të-përfolura, pishtëllime,
21 të-mbajtura mbë të-math, trazime; Semos,
kur të vinj përsëri te ju, me përunjë Perën-
dia im, edhe bënj vajë për shumë nga ata
që kanë fëjyerë që përpara, edhe s'janë pën-
duarë për pëgërsirën' e për kurvërin' e për
ndyrësirënë që punuanë.

Krye 13.

1 Këjo *është* e-treta herë që vinj te ju „Mbë
goje dy e tre dëshmimtarëve dotë qëndro-
2 ŋë çdo fjalë." Thashë më përpara, edhe po
them më përpara, sikurse jam aty të-dytë-
në herë, edhe ndashti që jam lark u shkruanj
atyreve që kanë fëjyerë që përpara edhe gjithë
të-tjerëvet, se, ndë arthça përsëri, nukë dotë
3 kursenem; Sepse kërkoni provë të Krishtit që
flet me anë t'ime, i-cili s'ësht' i-dobëtë mbë
4 ju, po i-fuqishim ndër ju. Sepse, ndonëse ukry-
qëzua prej dobësire, po rron prej fuqis' së
Perëndisë; sepse edhe neve ndonëse jemi të-
dobëtë mbë atë, po dotë rrojmë bashkë me
5 atë mbë ju prej fuqis' së Perëndisë. Shikoni
vetëhenë t' uaj, ndë jeni ndë besët; provoni
vetëhenë t'uaj; apo s'e njihni vetëhenë t'uaj,
se Jisu Krishti është ndër ju? veç ndë qofshi

BKSH

6 të-paprovuarë mbë ndonjë gjë. Edhe shpërenj
se dot'a njihni se neve s'jemi të-paprovuarë.
7 Edhe i lutem Perëndisë që të mos bëni ndonjë
gjë të-ligë; jo që të dukemi ne të-provuarë, po
që të bëni ju të-mirënë, e neve letë jemi të-
8 paprovuarë. Sepse s'mundimë të bëjmë gjë
9 kundrë së-vërtetësë, po për të vërtetënë. Se-
pse gëzonemi, kur neve jemi të-dobëtë, e ju
jeni të-fuqishim; për këtë edhe lutemi, *do-me-*
10 *thënë* për të-ndrequritë t'uaj. Përandaj shkru-
anj këto, kur jam lark, që të mos sillem ash-
përë, kur të jem afërë, sipas pushtetit që
më ka dhënë Zoti për të ndërtuarë, e jo për
të prishurë.
11 Pra, o vëllezër, gëzohuni, ngushullohuni,
jini mbë gjithatë mëndje, kini paqtim; edhe
Perëndia i dashurisë edhe i paqtimit dotë
12 jetë bashkë me ju. Përshëndetni njëri tjatëri-
në me të-puthurë të-shënjtëruarë; u falenë
juve me shëndet gjithë shënjtorëtë.
13 Hiri i Zotit Jisu Krisht, edhe dashuria e
Perëndisë, edhe shoqëria e Frymës' së-Shënj-
tëruarë qoftë me gjithë ju. Amin.

BKSH

Karta e apostollit Pavël mbë Gallatianëtë.

Krye. 1.

1 Pavli, apostoll (jo prej njerëzish, as me
anë njeriu, po me anë të Jisu Krishtit, edhe
të Perëndisë Atit që e ngjalli atë prej së-
2 vdekurish,) Edhe gjithë vëllezëritë *që janë*
bashkë me mua, mbë kishërat të Gallatisë;
3 Hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim nga Perëndia
4 Ati, edhe nga Zoti ynë Jisu Krisht, Që dha
vetëhen' e ti për fajetë t'anë, që të na shpë-
tonjë nga këjo jet' e-ligë, pas dashurimit të
5 Perëndisë edhe Atit t'ënë, Mbe të-cilinë *qoftë*
lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.
6 Çuditem se kaqë çpejt shkoni prej ati që
u thirri juve me anë të hirit të Krishtit ndë
7 tjetërë ungjill; I-cili nuk' është tjatërë, po
janë ca *veta*, të-cilëtë u trumbullonjënë juve,
edhe duanë të ndryshonjënë ungjillin' e Krish-
8 tit. Po edhe neve, a ëngjëll prej qielli ndë u
lëçittë juve *tjatër'* ungjill e jo atë që u lëçit-
9 më juve, qoft' i mallëkuarë. Sikundrë thamë
më përpara, edhe ndashti përsëri them, Ndë
u lëçittë juve ndonjë *njeri tjatër'* ungjill e jo
10 atë që kini marrë, qoft' i-mallëkuarë. Sepse
ndashti njerësvet u mbush mëndjenë unë apo

Perëndisë? apo kërkonj të pëlqehem te nje-
rëzitë? sepse ndë pëlqeheshe edhe të njerë-
zitë, nukë dotë ishnjam shërbëtuar i Krishtit.
11 Po u bënj të dini ju, o vëllezër, se un-
gjilli që ulëçit prej meje s' është pas njeriu;
12 Sepse as unë s' e mora prej njeriu, as umë-
suashë *prej njeriu*, po prej sbulese së Jisu
13 Krishtit. Sepse kini dëgjuarë, se qysh shko-
njam njëherë ndë Judhaismët, se fort tepërë
ndiqnjam kishën' e Perëndisë, edhe e bënjam
14 rrëmullë; Edhe vinjam mbarë ndë Judhai-
smët më tepërë se shumë moshëtarë *të mi*
ndë kompt t'im, sepse ishnjam më tepërë
zilitar për porositë që kishinë lënë atërit' e mi.
15 Po kur i pëlqeu Perëndisë që më ndau
veç që nga barku i mëmësë, edhe më thirri
16 me anë të hirit të ti, Që të sbulonjë Birin' e
ti tek unë, që t'a ungjillëzonj atë ndër kom-
bet, për-një-here s' mora këshillë nga mish
17 a nga gjak; As nukë hipa ndë Jerusalim te
apostojtë që qenë përpara meje, po vajta nd'
Aravi, edhe përsëri ukthyeshë ndë Dhamaskë.
18 Pastaj pas tre vjeç hipa ndë Jerusalim, për
të pjekurë me Pjetrinë; edhe mbeta përan'
19 ati pesë-mbë-dhjetë dit; Edhe tjetërë nga a-
postojtë nukë pashë, veç Jakovinë të vëllan'
20 e Zotit. Edhe sa u shkruanj juve, ja *tek po*
21 *rrëfenj* përpara Perëndisë, se s' gënjenj. Pas-
taj erdha ndë vëndet të Syrisë edhe të Qili-
22 qisë; Edhe nukë ishnjam njohurë me faqe me

BKSH

23 kishët'e Judhesë që ishinë mbë Krishtinë; Po
vetëmë kishinë dëgjuarë, se ay që na ndiqte
njëherë, ndashti po ungjillëzon *atë* besënë që
24 bënte rrëmullë njëherë. Edhe lavduroninë Pe-
rëndinë për punë t'ime.

Krye 2.

1 Pastaj pas katrë-mbë-dhjetë vjeç përsëri
hipa ndë Jerusalim bashkë me Varnanënë, si
2 mora me vetëhe edhe Titonë; Edhe hipa pas
sbulese *nga an' e Perëndisë*, edhe u rrëfeva
atyre ungjillinë që lëçis ndër kombet, po më
tepërë atyreve që dukeshinë më të-shënuarë,
3 *nga frika* semos breth, a brodha mbë kot. Po
as Titua që qe bashkë me mua, ndonëse
ishte Grek, nuk' ushtrëngua të rrethpritetë;
4 Edhe *këjo* për vëllezërit' e-rrem që ishinë fu-
turë fshehuraj, të-cilëtë hynë fshehuraj, për
të përgjuarë lirinë t'ënë që kemi mbë Jisu
5 Krishtinë, që të na bënjënë robër; Këtyreve
as për një orë nuk' u uunjmë kryetë që t' u
bindemi, që të mbësë te ju e-vërtet'e ungji-
6 llit. Edhe për ata që u duketë se diç janë,
çfarëdo që të kenë qënë ndonjëherë, asfare
s' dua të di; Perëndia nukë shikon mbë faqe
njeriu; sepse ata që dukenë *se diç janë* nukë
7 shtuanë gjë tek unë; Po përkundrazi, kur
panë se mua m' ubesua ungjilli i parrethpre-
sjesë, sikundrë Pjetrit *ungjilli* i rrethpresjesë;
8 (Sepse ay që vepëroj mbë Pjetrinë që të jetë

apostoll mbë të-rrethprerëtë, vepëroj edhe
mbë mua *që të jem apostoll* mbë kombetë;)
9 Edhe si e njohnë hirinë që m' udha, Jakovi e
Qifaj e Joani, të-cilëtë dukeshinë së ishinë
shtylla, *na* dhanë mua edhe Varnavësë të-
djathtat' *e tyre* për *shënjë* shoqërie, që neve
të vemi ndër kombet, e ata ndër të-rrethpre-
10 rët; Vetëmë *na porositnë* të kujtojmë të-vo-
beqtë; të-cilënë punë edhe ukujdesa t'a bënj.
11 Edhe kur erdhi Pjetri ndë Antıohi, i ndënj-
ta kundrë për faqe, sepse vëjente te qërto-
12 nej; Sepse pa ardhurë ca *veta* nga Jakovi,
hante bashkë me kombetë; po kur erthnë, hiqej
edhe e ndante *veç* vetëhen' e ti, sepse kishte
13 frikë nga ata që ishinë prej rrethpresjesë. Edhe
bashkë më atë uhoqnë *veç* edhe të-tjerëtë Ju-
dhenj, kaqë sa edhe Varnava uhoq ndë ipo-
14 krisit t'atyreve. Po kur pashë, se nuk'ecënjënë
drejt sipas së-vërtetës' s' ungjillit, i thashë
Pjetrit përpara të gjithëve, Ndë qoftë se ti
që je Judhe rron posi kombetë, e jo posi
Judhenjtë, përse shtrëngon kombetë të rro-
15 njënë posi Judhenjtë? Neve që jemi prej fisi
16 Judhenj edhe jo prej kombesh fajtore, Dyke
diturë, se s'del i-drejtë njeriu prej punërash
nomi, veç me anë të besës' së Jisu Krishtit,
edhe neve i besuamë Jisu Krishtit, që të da-
lëmë të-drejtë prej besës' së Krishtit, e jo
prej punëravet të nomit; sepse asndonjë njeri
s' ka për të dalë i-drejtë prej punëravet të

BKSH

17 nomit. Po ndë qoftë se, dyke kërkuarë të da-
lëmë të-drejtë mbë Krishtinë, ugjëntmë edhe
neve fajtorë, Krishti pa fjalë qënka shërbëtuar
i fajit? Qoftë lark.
18 Sepse ndë ndërtonj përsëri ato që prishă,
19 bënj vetëtëhenë t'ime porosi-prishës. Sepse
unë me anë të nomit vdiqa ndë nomt, që të
20 rronj mbë Perëndinë. Bashkë me Krishtinë u-
kryqëzuashë; Edhe s'rronj më unë, po Kri-
shti rron tek unë; edhe ajo që rron *unë* nda-
shti ndë misht, rronj ndë besët të Birit të
Perëndisë, i-cili më deshi edhe dha ndër duar
21 vetëhen' e ti për mua. Nukë heth poshtë hi-
rin' e Perëndisë; sepse ndë qoftë të-drejtu-
arëtë me anë të nomit, atëhere Krishti vdiq
mbë kot.

Krye 3.

1 O Gallatiannë të-marrë, kush u mëreu juve,
(që të mos bindeni mbë të-vërtetënë,) për-
para syvet të të-cilëvet Jisu Kristi upërshkrua
2 i-kryqezuarë ndër mest t'uaj. Këtë vetëmë dua
të marr vesh prej jush, Prej punërash nomi e
muartë Frymënë, apo prej të-dëgjuarit të be-
3 sësë? Kaqë të-marrë qënki? passi nistë me
4 Frymë, ndashti mbaroni me mish. Mbë kot
pësuatë kaqë? ndë qoftë se vetëmë mbë kot..
5 Ay pra që u ep juve Frymënë, ede punon çu-
dira ndër ju, prej punërash nomi *i bën këto*,
a prej të-dëgjuarit të besësë?

6 Sikundrë „Avraami i besoj Perëndisë, edhe
7 i unumërua ati për drejtëri;" Di-e-ni pra, se
ata që janë prej besësë, këta janë bij t'A-
8 vraamit. Edhe shkronja dyke parë që përpara
se Perëndia nxjer kombetë të-drejtë prej be-
sësë, i dha zë Avraamit që përpara, „Se
9 gjithë kombetë dotë bekonenë mbë ty." Pë-
randaj ata *që janë* prej besësë bekonenë
bashkë me besëtarinë Avraam.
10 Sepse sa *njerës* janë prej punërash nomi
janë ndënë mallëkim; sepse është shkuarë,
„I-mallëkuarë është cilido që s'qëndron mbë
gjithato që janë shkruarë ndë vivlit të no-
11 mit, për të bër' ato." Po se asndonjë s'del
i drejtë me anë të nomit përpara Perëndisë,
është *gjë* e-çfaqurë „Sepse i-drejti dotë rro-
12 një prej besësë." Edhe nomi nuk'është prej
besësë, po „njeriu që bën ato, dotë ronjë me
13 anë t'atyrëve." Krishti na çpërbleu nga ma-
llëkimi i nomit, sepse ubë mallëkim për ne;
sepse është shkruarë „I-mallëkuarë është si-
14 cilido që varretë ndë dru." Që të vinjë bekimi
i Avraamit ndër kombet me anë të Iisu Kri-
shtit, që të marrëmë të-zotuarët'e Frymësë me
anë të besësë.
15 O vëllezër, si njeri flas; po *edhe* dhjatë
njeriu, passi vërtetonetë, asnjeri s'e heth
16 poshtë, a shton *gjë mb' atë*. Edhe të-zotuarat'
i ufolnë Avraamit edhe farës' s'ati; nukë
thotë, Edhe faravet, si për shumë, po si për

17 një „Edhe farësë s'ate," që është Kishti. Edhe
këtë e them, se dhjatënë që qe vërtetuarë
më përpara prej Perëndisë mbë Krishtinë
nomi që ubë pas katrë qint e tri-dhjetë vjeç
nuk' e heth poshtë, që të prishnjë të-zotu-
18 arëtë. Sepse ndë qoftë se trashëgimi është
prej nomi, nuk' është më prej të-zotuari; po
Perëndia j'a fali këtë Avraamit me anë të
të-zotuarit.
19 Përse pra *udha* nomi? Ushtua për punë
të të-shkeluravet të porosivet, gjersa të-vinte
fara, mbë të-cilënë qe bërë të-zotuarëtë; e-
dhe *ky nom* uurdhërua me anë ëngjëjve ndë
20 dorët të *një* mestari. Edhe mestari s'është i
njëj *vetëmë*; po Perëndia është një.
21 Nomi pra *qënka* kundrë të-zotuaravet të
Perëndisë? Qoftë lark! sepse ndë ishte dhënë
nom që munt të apë jetë, *atëhere* drejtëria dot'
22 ishte me të-vërtetë prej nomit; Po shkronja i
mbylli të-gjitha ndënë fajinë, që t' u epetë të-
zotuarëtë prej besësë mbë Jisu Krishtinë aty-
23 reve që besonjënë. Edhe përpara se të vinte
besa, ruheshimë ndënë nom, të-mbyllurë brën-
24 da ndë besët, e-cila ishte për të sbuluarë. Pë-
randaj nomi ubë mësonjësi ynë mbë Kristinë,
25 që të dalëmë të-drejtë prej besësë; Po passi
erdhi besa, s'jemi më ndënë mësonjës.
26 Sepse të-gjithë jemi të Perëndisë me anë
27 të besësë që është mbë Jisu Krishtinë. Sepse
sa jeni pagëzuarë mbë Krishtinë, Krishtinë

BKSH

28 kini veshurë. Nukë ka *më* Judhe as Grek;
nukë ka *më* shërbëtuar as të-lirë; nukë ka
më mashkull e femërë; sepse ju të-gjithë jeni
29 mbë Jisu Krishtinë. Edhe ndë jini ju të Krish-
tit, pa fjalë jini far' e Avraamit, edhe pas të-
zotuarit trashëgimtarë.

Krye 4.

1 Edhe them, *se* sa kohë trashëgimtari ësh-
të foshnjë, s'ndan nga shërbëtori, ndonëse
2 ësht' i zot' i të-gjithave; Po është ndënë qiver-
nitarë e kujdestarë, gjer mb' atë kohë që ësht'
3 urdhëruarë nga i ati. Kështu edhe neve, kur
ishimë foshnje, ishimë robër ndënë stihiat të
4 botësë; Po kur erdhi të-mbushurit' e kohësë,
Perëndia dërgoj të Birinë, që lindi prej gru-
5 aje edhe që qe ndënë nom, Që të çpëblenjë
ata që ishinë ndënë nom, që të marrënë bi-
6 rërinë. Edhe me-qënë-që jemi bij, Perëndia
dërgoj Frymën'e Birit të ti ndë zëmërat t' uaj
7 që thërret, Avva, o Atë. Përandaj nukë je me
shërbëtuar, po bir; edhe ndë je bir, *je* edhe
trashëgimtar i Perëndisë me anë të Krishtit.
8 Po atëhere, passi s'njihnitë Perëndinë u
punuatë atyreve që s'janë prej nature perën-
9 dira; Po ndashti, passi njohtë Perëndinë, e
që të them më mirë unjohtë prej Perëndisë,
qysh kthehi përsëri mbë të-dobëtat' e mbë
të-vobegatë stihia, të-cilavet prapë si për-
10 para doni t'u punoni? Vini re dit, e muaj,

11 e kohëra, e vjet. Kam frikë për ju semos
mbë kot umunduashë për ju.
12 O vëllezër, u lutem juve bëhi posi unë,
sepse edhe unë jam posi ju; s'më keni bërë
13 ndonjë të-keqe. Edhe e dini, se të-parënë
herë u'a lëçita juve ungjillinë me dobësirë të
14 mishit. Edhe ngasjenë t'ime që kishnjam ndë
misht t'im nuk' e zutë për gjë, as e hothtë
tej, po më prittë si ëngjëll Perëndie, si Jisu
15 Kristinë. Cila pra ishte lumeria juaj? Sepse
dëshmonj për ju, se ndë mundej, *edhe* sytë
t'uaj dot' i nxirnitë e dotë m'i epnitë mua.
16 Armiku juaj pra ubëshë, se u them juve të-
vërtetënë?
17 Dëftenjënë zëmërë të-përvëluarë te ju,
po jo të-mirë; përkundrazi duanë t'u mbyll-
njënë juve jashtë, që të keni *juve* zëmërë të-
18 përvëluarë për ata. Po *është* mirë të këni zë-
mërë të-përvëluarë për të-mirënë gjithënjë, e
19 jo vetëmë kur gjëndem ndë mest t'uaj. Djem-
thit' e mi, përsëri kam të-dhëmbura të-pjelli
për ju, gjersa të formonetë Krishti ndër ju;
20 Edhe donjam të ishnjam ndë mest t'uaj nda-
shti, edhe të ndërronjam zënë t' im, sepse
nukë di ç'të mendonem për ju.
21 Pa më thoni, ju që doni të jeni ndënë
22 nom, a nukë dëgjoni nomnë? Sepse është
shkruarë, se Avraami pat dy bij; një prej
23 shërbëtoresë, edhe një prej së-lirësë; Po ay
që lindi prej shërbëtoresë lindi pas mishit; e

ay *që lindi* prej së-lirësë, lindi me anë të të-
24 zotuarit. Të-cilatë dëftenjënë tjëtërë për tje-
tërë; sepse këtu janë të dy dhjatatë; njëra
nga mali Sina, që pjell për skllavëri, e-cila
25 është Agara. (Sepse Agara është mali Sina
nd' Arabi, edhe përgjigjetë ndë Jerusalimët të-
sorme; edhe është ndë skllavëri bashkë me
26 të bijtë.) Po Jerusalima *që është* lart ësht' e
27 lirë, e-cilaëstë mëma e neve të gjithëve. Se-
pse është shkruarë, „Gëzohu *ti,* o shterpë që
nukë pjell; nxir zënë edhe thërrit ti që nukë ke
të-dhëmdhura të-pjelli; sepse djemt' e shkre-
tëtirësë *janë* më shumë se t'asaj që ka bu-
28 rrinë;" Edhe neve, o vëllezër, jemi, posi Isa-
29 aku, bij të të-zotuari. Po sikundrë atëhere ay
që lindi pas mishit ndiqtë atë *që kishte lin-
durë* pas frymësë, kështu *është* edhe ndashti.
30 Po ç'thotë shkronja? „Nxir jashtë shërbëto-
ren' edhe të birin' e asaj; sepse s'ka për të
trashëguarë i bir' i shërbëtoresë bashkë me
të birin' e së-lirësë."
31 Nukë jemi pra, o vellezër, bij të shërbë-
toresë, po të së-lirësë.

Krye 5.

1 Qëndroni pra ndë lirit, me të-cilënë na
liroj Krishti, edhe mos hyni përsëri ndë sgje-
dhët të skllavërisë.
2 Ja unë Pavli te po u them juve, se, ndë
urrethprefshi, Krishti nukë dot' u bënjë juve

3 dobi asfare. Edhe dëshmonj përsëri mbë çdo
njeri që rrethpritetë, se është detuar të mba-
4 një gjithë nominë. Undatë nga Krishti ju që
delni të-drejtë me anë të nomit; ratë poshtë
5 nga hiri. Sepse neve me anë të Frymësë pres-
më *për* shpresën'e të-drejtëruarit prej besësë.
6 Sepse mbë Jisu Krishtinë as rrethpresja ka
ndonjë ,fuqi, as parrethpresja, po besa që
vepëronetë me anë dashurie.
7 Ju ecënitë mirë; kush u pengoj që të
8 mos bindeni mbë të-vërtetënë? Këta të-bin-
durë nuk' është prej ati që u thërret juve.
9 Pakëzë brumë mbruh gjithë të-mbrujturitë.
10 Unë kam shpresë mbë ju me anë të Zotit,
se nukë dotë kini ndër mëntt tjatërë gië; po
ay që u trumbulon juve, cilido që të jetë, ay
11 ka për të mbajturë mundimnë. Edhe unë, o
vëllezër, ndë qoftë se lëçis edhe më rreth-
presje, përse ndiqem më? atëhere uprish
12 skandhalia e kryqit. Zoti dhëntë të copëto-
nenë ata që u trumbuλonjënë juve.
13 Sepse ju, o vëllezër, uthërrittë ndë liri; ve-
tëmë mos e përdorni lirinë për shkak të mi-
shit, po me anë të dashurisë t'i shërbeni
14 njëri tjatërit. Sepse gjithë nomi mhushetë
ndë një fjalë, ndë këtë, „Të duash të-afër-
15 minë t'ënt si vetëhenë t'ënde." Po ndë kaf-
shofshi e ndë hëngërshi njëri tjatërinë, shi-
koni mos prisheni njëri prej tjatërit.
16 Them pra, Ecëni pas Frymësë, edhe nukë

17 dotë bëni dëshërimn' e mishit. Sepse mishi
dëshëron kundrë Frymësë, e Fryma kundrë
mishit; edhe këto janë njëra kundrë tjatërësë,
18 që të mos bëni ato që doni. Po ndë qoftë
se Fryma u heq udhënë juve, nukë jeni ndë-
në nom.
19 Edhe punërat' e mishit janë të-çfaqura;
të-cilatë janë pëgërësi, kurvëri, ndyrësi, plank-
20 prisësi, Idhullatri, magji, armiqësira, grindje,
21 zili, zëmërime, të-zëna, të-ndara, eresi, Cmire,
vrasje, të-dejtura, lodrëti, edhe kësosh si këto;
për të-cilatë u them juve më përpara, sikun-
drë edhe u thashë më përpara, se ata që pu-
nonjënë të-tillatë mbretëri Perëndie s' kanë
për të trashëguarë.
22 Po pem' e Frymësë është dashuri, gëzim,
paqtim, zëmër' e-gjerë, ëmblësirë, mirësi, besë,
23 Butësirë, vetëpërmbajtje; kundrë të-tillavet
nukë ka nom.
24 Edhe ata që janë të Krishtit, e kanë kry-
qësuarë mishinë bashkë më pësimet' e me
25 dëshërimetë. Ndë rrojmë pas Frymësë, pas
Frymësë edhe të ecëjmë.
26 Letë mos kërkojmë lavdi të-kotë, dyke
ngarë njëri tjatërinë, dyke pasurë cmir njëri
tjatërinë.

Krye 6.

1 O vëllezër, edhe ndë rëntë njeri ndë ndo-
një faj, ju që jeni të frymësë ndërto-e-ni të-

tillinë me frymë butësire; dyke vënë re ve-
2 tëhenë t' ënde, semos ngitesh edhe ti. Mbani
barrëtë njëri tjatërit, edhe kështu mbushni
3 nomn' e Krishtit. Sepse ndë i duketë ndonjëj
se diç është, tek s' është gjë, gënjen vetëhen'
4 e ti. Po gjithë-sicili letë provonjë punën' e ti,
edhe atëhere vetëmë për vetëhen' e ti dotë
5 ketë të-mburruritë, e jo për tjatërinë; Sepse
gjithë-sicili dotë mbanjë barrën' e ti.
6 Edhe ay që mësonetë ndë fjalët *prej ndo-
njëj*, atë që *e* mëson let'a bënjë pjesëtar ndë
7 gjithë të-mirat *të tia*. Mos gënjehi; Perëndia
nukë përbuzetë; sepse ç' të mbjellë njeriu,
8 këtë edhe dotë korrnjë; Sepse ay që mbjell
ndë misht të ti, prej mishit dotë korrnjë pri-
shje; po ay që mbjell ndë Frymët, prej Fry-
9 mësë dotë korrnjë jetë të-përjetëshme. Letë
mos lodhemi pra dyke bërë të-mirënë, sepse
ndë mos ulothçimë, dotë korrmë ndë kohët
10 që duhetë. Përandaj gjersa kemi kohë, letë
punojmë të-mirënë mbë të-gjithë, po më fort
mb' ata që janë ndë një besë me ne.
11 Shikoni me ç' farë shkronja të-mëdha u
12 shkrova me dorënë t' ime. Sa duanë të duke-
në të-mirë ndë misht, këta u ngutnjënë juve
të rrethpriteni, vetëmë që të mos ndiqenë për
13 kryqin' e Krishtit. Sepse as ata që rrethpri-
tenë s' e ruajnënë nominë, po duanë të rreth-
priteni ju, që të mburrenë ndë misht t' uaj.
14 Po për mua qoftë lark të mburrem *për tja-*

BKSH

tërë gjë, veç për kryqin'e Zotit t' ënë Jisu
Krisht, me anë të të-cilit bota është kryqëzu-
15 arë tek unë, edhe unë te bota. Sepse mbë
Jisu Krishtinë as rrethpresja ka fuqi, as pa-
16 rrethpresja, po kriesa e-re. Edhe sa ecënjënë
pas kësaj rregulle, *qoftë* paqtim edhe për-
dëllim mb'ata, edhe mbë Israilin'e Perëndisë.
17 *Ndashti e* paskëtaj asndoŋë letë mos më
mundonjë: sepse unë mbanj shënjat' e Zo-
tit Jisu ndë trupt t'im.
18 Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht qoftë bashkë
me frymënë t'uaj, o vëllezër. Amin.

Karta e apostollit Pavël mbë Efesianëtë.

Krye 1.

1 Pavli, apostoll i Jisu Kristit me anë të
dashurimit të Perëndisë, mbë shënjtorët që
janë ndë Efesë, edhe mbë besëtarëtë mbë
2 Jisu Krishtinë; Hir edhe paqtim *qoftë* mbë ju
prej Perëndisë, Atit t'ënë, edhe *prej* Zotit Jisu
Krisht.
3 I-bekuarë *qoftë* Perëndia edhe Ati i Zo-
tit t'ënë Jisu Krisht, që na bekoj me çdo
bekim shpirti ndë qielloret me anë të Krish-
4 tit; Sikundrë na sgjodhi neve me anë t'atij
përpara se të kriohetë bota, që të jemi shënj-

torë edhe faqe-bardhë përpara ati me anë
5 të dashurisë; Passi na ndau që përpara për
birëri mbë vetëhen' e ti me anë të Jisu Krish-
6 tit, pas pëlqimit të dashurimit të ti, Për lëv-
dim të lavdis' së hirit të ti, të-cilinë na dhu-
7 rëtoj me anë të të-Dashurit *të ti*; Tek i-cili
kemi çpërblimnë ma anë të gjakut t'ati, ndje-
8 sën' e fajevet, pas pasjes' së hirit t'ati, Të-
cilinë e tepëroj mbë ne me çdo dituri e ur-
9 tësi, Dyke bërë neve të njohëmë fshehë-
sirën' e dashurimit të ti pas pëlqimit të ti,
që e pat vënë ndër mëntt me vetëhen'e ti,
10 Që, ndë qiverit të të-mbushurit të kohë-
rəvet, të përmblethnjë të-gjitha mbë Krish-
tinë, edhe ato *që janë* ndë qiejt edhe ato *që*
11 *janë* mbi dhet; Mbë atë, mbë të-cilinë edhe
muarmë trashëgim, urdhëruarë që përpara
sikundrë e pat vënë ndër mëntt ay që ve-
përon të-gjitha pas ëndës' së dashurimit të ti;
12 Që të jemi për lëvdim të lavdis' s' ati *neve*
13 që shpëryemë që përpara mbë Krishtinë; Mbë
të-cilënë *shpëryetë* edhe ju, passi dëgjuatë
fjalën' e së-vërtetësë, ungjillin' e shpëtimit t'
uaj; edhe mbë të-cilinë passi besuatë uvu-
lostë me Frymën' e-Shënjtëruarë e të-zotua-
14 rit, E-cila është kapari i trashëgimit t'ënë,
gjer mbë të-çpërblyerët të llauzit që ufitua
për lëvdim të lavdis' s' ati.
15 Përandaj edhe unë, kur dëgjova besënë
t'uaj mbë Zotinë Jisu, edhe dashurinë që kini

BKSH

16 mbë gjithë shënjtorëtë, S' pushonj dyke fa-
lurë ndersë Perëndisë për ju, *e* dyke për-
17 mëndurë juve ndë të-falurat të mia, Që t'u
apë juve Perëndia i Zotit t'ënë Jisu Krisht,
Ati i lavdisë, frymë diturie e sbulese, që t'a
18 njihni atë; Që syt' e mëndjesë s'uaj të jenë
të-ndriturë, që të njihni cila është shpresa
e të-thërriturit t' ati, edhe cila është pasja e
lavdis' së trashëgimit t' ati mbë shënjtorët;
19 Edhe cilëtë është të-matht' e-tepërë të fu-
qis' s' ati mbë ne që besojmë, pas vepërimit
20 të pushtetit të fuqis' s' ati: Të cilën' e vepë-
roj mbë Krishtinë, kur e ngjalli atë prej
së-vdekurish, edhe e vuri të rrijë mbë të-
21 djathtët të ti mbë qielloret, Përsipërë çdo
urdhëri e pushteti e fuqie e zotërie e emëri
që quhetë jo vetëmë ndë këtë jetë, po edhe
22 ndë atë që vjen; Edhe të-gjitha i vuri ndënë
këmbët t'ati, edhe e bëri krye përmbi të-gji-
23 tha ndë kishët, E-cila është trupi i ati, të-
mbushurit' e ati që mbush të-gjitha mbë të-
gjitha.

Krye. .2

1 Edhe u *dha jetë* juve, që ishitë të-vde-
kurë për të-skelurit' e porosivet e për fajetë,
2 Mbë të-cilët ectë njëherë, pas jetës' së kë-
saj bote, pas urdhërtarit të pushtetit të e-
rësë, *që është* fryma që vepëron tani mbë
3 të bijt' e mosbindjesë: Ndër mest të të-cilëvet

edhe neve të-gjithë rrojtmë njëherë pas dë-
shërimevet të mishit t' ënë, dyke bërë dashu-
rimet' e mishit edhe të mendimevet *t'anë*; e-
dhe ishimë prej nature djem zëmërate, sikun-
4 drë edhe të-tjerëtë. Po Perëndia që është i-
pasurë ndë përdëllim, për dashurin'e ti të-shu-
5 mënë me të-cilënë na deshi, Ndonëse ishimë
të-vdekurë për fajetë, na dha neve jetë bash-
kë me Krishtinë; (me hir jeni të-shpëtuarë:)
6 Edhe na ngjalli bashkë, edhe na vuri të rri-
më bashkë ndë qielloret me anë të Jisu
7 Krishtit; Që të rrëfenjë ndë jetët që vinjënë
pasjen' e-tepërë të hirit të ti me anë të mi-
rësisë *që ka* mbë ne me anë të Jisu Krish-
8 tit. Sepse me hir jemi të-shpëtuarë me anë
të besësë; edhe këjo nuk' *është* prej jush,
9 *po është* dhurata e Perëndisë; Jo prej punë-
10 rash, që të mos mburretë ndonjë. Sepse jemi
kries' e ati, kriuarë mbë Jisu Krishtinë për
punëra të-mira, të-cilat' i bëri gati Perëndia
që përpara, që të ecëjmë nd' ato.
11 Përandaj sill-e-ni ndër mëntt t' uaj, ju
që ishitë njëherë gjëndarë pas mishit, që thu-
heshitë të-parethprerë prej atyreve që thuhe-
në të-rrethprerë *për një rrethpresje* të-bërë me
12 dorë ndë misht, Se ishitë nd' atë kohë pa
Krisht, të-ndarë veç nga qytetëria e Israilit,
edhe të-huaj nga dhjatat' e të-zotuarit, pa
pasurë shpresë, edhe të-paperëndishim ndë
13 botët; Po ndashti me anë të Jisu Krishtit ju

BKSH

që ishitë njëherë lark uaferuatë me anë të gja-
14 kut të Krishtit. Sepse ay është paqtimi ynë,
ay që bëri të dy;a një, edhe rrëzoj murin' e-
15 mesm e të-ndarit, Dyke prishurë armiqësinë
ndë trupt të ti, *do-me-thënë* nomin' e porosi-
vet që ishinë ndë urdhëra, që të ndërtonjë
ndë vetëhet të ti të dy mbë një njeri të-ri,
16 dyke bërë paqtim; Edhe të dy ndë një trup
t'i paqtonjë me Perëndinë me anë të kry-
17 qit, passi vrau armiqësinë nd'atë. Edhe er-
dhi e lëçiti ungjillin' e paqtimit mbë ju që
18 *ishitë* lark, edhe mb'ata që *ishin'* afërë; Se-
pse me anë t'ati kemi te dy të-hyrëtë me
një Frymë te Ati.
19 Përandaj s'jeni më të-huaj e të-përjash-
tësm, po bashkëqytetës të shënjtorëvet e
20 shtëpiakës të Perëndisë; Sepse undërtuatë
mbi themelin' e apostojvet e të profitërvet,
21 ku gur çipi është vetë Jisu Krishti; Mbë të-
cilinë gjithë ndërtesa lidhurë e përmbledhurë
bashkë rritete ndë tempull të-shënjtëruarë
22 mbë Zotinë; Mbë të-cilinë edhe ju jeni ndër-
tuarë bashkë që të rrijë Perëndia me anë
të Frymësë.

Krye 3.

1 Për këtë punë unë Pavli *jam* i-lidhuri i
2 Jisu Kishtit për ju kombetë, Sepse dëgjuatë
qiverin' e hirit të Perëndisë që m' udha për
3 ju, Se me të-sbuluarë m'a bëri të-njohurë

BKSH

fshehësirënë, (sikundrë u shkrova përpara me
4 pak *fjalë*; Prej të-cilavet dyke kënduarë munt
të kupëtoni mëndjenë t'ime ndë fshehësirët
5 të Krishtit;) E-cila ndë të-tjerë breza s' ubë
e-njohurë ndë të bijt të njerësvet, sikundrë
ndashti usbulua me anë të Frymësë tek a-
postojt' edhe te profitërit' e ati të-shënjtëru-
6 arë; Që të jenë kombetë bashkëtrashëgimtarë
e një trup e bashkëpjesëtarë ndë të-zotuarët
7 t'ati mbë Krishtinë me anë të ungjillit; Të-
cilit *un'* i ubëra shërbëtuar pas dhuratës' së
hirit të Perëndisë, që m' udha pas vepërimit
8 të fuqis' s' ati. Mua më të-vogëlit nga gjithë
shënjtorëtë m' udha ky hir, të ungjillëzonj
ndër kombet të-pavëzhguarshimenë pasje të
9 Krishtit, Edhe të ndriçonj të-gjithë, *që të dinë*,
ç' është të-pasurë pjesë ndë fshehësirët që qe
fshehurë që prej jetëvet te Perëndia që krioj
10 të-gjitha (me anë të Jisu Krishtit;) Që të nji-
hetë ndashti ndë urdhëratat e ndë pushtetet
ndë qielloret me anë të kishësë e-paanëta
11 dituri' e Perëndisë, Pas qëllimit të-përjetëshm
12 që bëri mbë Jisu Krishtinë, Zotinë t' ënë; Me
anë të të-cilit kemi kuximnë edhe me besim
të-plotë të-hyrëtë me anë të besësë mb' atë.
13 Përandaj u lutem juve të mos likshohi për
shtrëngimet' e mi që kam për ju, e-cila *gjè*
është lavdia juaj.

14 Përandaj unj gjunjët' e mi përpara Atit të
15 Zotit t' ënë Jisu Krisht, prej të-cilit quhetë

16 çdo atëri ndë qiejt e mbi dhet, Që t'u apë
juve pas pasjes' së lavdis' së ti, të forcohi ndë
fuqi me anë të Frymës' s' ati mbë njerin' e-
17 përbrëndëshm; Që të rrijë Krishti ndë zëmë-
18 rat t' uaj me anë të besësë, Qe të-rrënjosur'
e të-themelosurë ndë dashurit të muntni të
kupëtoni bashkë me gjithë shënjtorëtë, ç'është
të-gjerët' e të-gjatëtë, e të-thellët' e të-lartëtë,
19 Edhe të njihni dashurin' e Krishtit që kapër-
xen çdo dituri, që të mbusheni me gjithë të-
mbushurit' e Perëndisë.
20 Edhe mb' atë që pas fuqisë që vepëronetë
ndër ne munt të bënjë shumë më tepërë nga
21 gjithë sa kërkojm' a mendojmë, Mb' atë *qoftë*
lavdia ndë kishët me anë të Jisu Krishtit
mbë gjithë brezat të jetës' së jetëvet. Amin.

Krye 4.

1 U lutem pra juve un' i-lidhuri mbë Zotinë
të ecëni sikundrë vëjen mbë të-thirrurit që
2 uthërritë, Me çdo mëndje përunjtjeje e butë-
sire, me zëmërë të-gjerë, dyke duruarë njëri
3 tjatërinë me dashuri, Dyke kujdesurë të ruani
bashkimn' e Frymësë me anë të lidhjes' së
4 paqtimit. Një trup e një Frymë *ka*, sikundrë
edhe uthërrittë me një shpresë të të-thërri-
5 turit t' uaj; Një Zot, një besë, një pagëzim;
6 Një Perëndi edhe Atë i të-gjithëve, i-cili është
përmbi të-gjithë, edhe me anë të të-gjithëve,
edhe ndër gjithë ju.

BKSH

7 Edhe gjithë-sicilit prej nesh i udha hiri
8 pas masës' së dhurëtis' së Krishtit. Përandaj
thotë, „Si hipi lart, skllavosi skllavëri, edhe
9 u dha dhurata njerësvet." Edhe se, „ay hi-
pi," ç' *tjetërë* është, veç se edhe sbriti më
përpara ndë më të-poshtërat anë të dheut?
10 Ay që sbriti, ësht' ay që edhe hipi përsipërë
11 gjithë qiejvet, që të mbushnjë të-gjitha. Edhe
ay dha ca *të jenë* apostoj, e ca profitër, e ca
12 ungjillëzorë, e ca barinj e mësonjës, Për ndreq-
jen' e shënjtorëvet, për punën' e shërbesësë,
13 për ndërtesën' e trupit të Krishtit; Gjersa të
arrijmë të-gjithë ndë bashkimt të besësë, edhe
të të-njohurit të Birit të Perëndisë, ndë bu-
rrë të-mbaruarë, ndë masët të moshës' së
14 të-mbushurit të Krishtit; Që të mos jemi më
foshnje, që trumbullonenë e që sillenë këtu
e atje prej çdo ere të mësimit, prej gënje-
shtrës' se njerësvet, *e* prej dinakërisë për të
15 kobuarë mjeshtërish; Po dyke folurë të-vër-
tetënë me dashuri të rritemi së-gjithash mb'
16 atë, i-cili është kryetë, Krishti; Prej të-cilit
tërë trupi i-përmbledhurë bashkë e i-lidhurë
bashkë me anë të bashkimit të çdo ndihme,
që ep me masë sicilado anë, sipas vepërimit
të-duheshim që ka, bën të-rriturit' e trupit,
për të-ndërtuarët' e vetëhes' së ti me dashuri.
17 Them pra këtë, edhe dëshmonj mbë Zo-
tinë, të mos ecëni më, sikundrë ecënjënë edhe
kombet' e-tjerë ndë kotësirët të mëndjes' së

18 tyre, Dyke qënë të-errësuarë nga mëndja, e
të-larguarë nga jeta e Perëndisë, për padi-
tjenë që është ndër ata, për ashpërimn' e zë-
19 mërës' së tyre; Të-cilëtë pa ndjerë dhëmbje
dhanë vetëhen' e tyre ndë fëlliqëri, që të pu-
20 nonjënë çdo ndyrësi me lakmim. Po ju nuk'
21 e keni nxënë kështu Krishtinë, Ndë qoftë se
e keni dëgjuar' atë edhe jeni mësuarë mb'
22 atë, sikundrë *ësht'* e-vërteta mbë Jisunë; Të
svishni njerin' e-vjetërë *që është* pas të-rroj-
turit që *rronitë* më përpara, i-cili prishetë pas
23 dëshërimevet të kobimit; Edhe të përtërihi
24 ndë frymët të mëndjsë s' uaj, E të vishni nje-
rin' e-ri, që është ndërtuarë pas Perëndisë me
drejtëri e me shënjtëri të së-vërtetësë.
25 Përandaj, dyke hedhurë tej gënjeshtrënë,
„flisni të-vërtetënë sicili me të-afërmin' e ti;"
26 sepse jemi anë të njëri tiatërit.—„Zëmërohi e
mos fëjeni;" djelli letë mos perëndonjë mbë
27 zëmërimt t'uaj; As mos i bëni vënt djallit.—Ay
28 që vjeth, letë mos vjedhë më, po më tepërë
letë mundonetë dyke punuarë të-mirënë me
duart' *e tia*, që të ketë t'i apë ati që ka ne-
29 vojë.—Çdo fjal' e-kalburë letë mos dalë prej
gojës' s' uaj, po ajo që është e-mirë për ndër-
tesën' e nevojësë, që t'u apë hir atyre që dë-
gjonjënë.
30 Edhe mos hidhëroni Frymën' e-Shënjtë-
ruarë të Perëndisë, me të-cilën' uvulostë për
ditën' e çpërblimit.

BKSH

31 Çdo pikëllim e mëri e zëmëratë e të-bër-
titurë e të-sharë, letë hiqetë *lark* prej jush
32 bashkë me çdo ligësi; Edhe bëhi njëri mbë
tjatërinë të-mirë, zëmërë-dhëmburë, dyke
ndjerë njëri tjatërinë, sikundrë edhe Perëndia
u ndjeu juve me anë të Krishtit.

Krye 5.

1 Bëhi pra shëmbëllimtarë të Perëndisë, si
2 djem të-dashurë; Edhe ecëni me dashuri, si-
kundrë edhe Krishti na deshi, edhe e dha ve-
tëhen' e ti për ne dhuratë e kurban të Pe-
rëndia, për erë të-mirë.
3 Po kurvëri e çdo ndyrësi, a lakmim, as
të-zihetë n' gojë ndër ju, sikundrë u ka hijë
4 shënjtorëvet; As turpëri e fjalë të-marra a
fjalë për të përqeshurë, të-cilatë s' kanë hije;
5 po më tepërë të-falurë ndersë. Sepse këtë e
dini, se çdo kurvar, a ndyrës, a lakmimtar,
i-cili është idhullatër, s' ka traeëgim ndë
6 mbretërit të Krishtit e të Perëndisë. Asnjeri
letë mos u kobonjë juve me fjalë të-kota;
sepse për këto *punë* vjen zëmërat' e Perën-
7 disë mbi të bijt' e pabindjesë. Mos ubëni pje-
8 sëtarë bashkë me ata. Sepse njëherë ishit'
errësirë, po ndashti *jeni* dritë mbë Zotinë;
9 Ecëni si djem të dritësë, (Sepse pem' e Fry-
mësë është mbë çdo mirësi, e drejtëri, e të-
10 vërtetë;) Dyke provuarë ç'*gjë* ësht' e-pëlqyerë
11 te Zoti; Edhe mos shoqëroni ndë punërat të-

BKSH

papemshime të errësirësë, po më tepërë t'i
12 qërtoni. Sepse ato që p ınonenë fshehuraj
13 nga ata, është turp edhe t'i thotë *njeriu*. Po
gjithë sa qërtonenë pıej dritësë, çfaqenë; se-
14 pse çdo që çfaqetë është dritë. Përandaj
thotë, Ngreu ti që fle, edhe ngjallu prej së-
vdekurish, edhe Krishti dotë të ndriçonjë.
15 Shikoni pra qysh të ecëni me kujdes; jo si
16 të-marrë, po si të-urtë, Dyke çpërblyerë ko-
17 hënë, sepse dittë janë të-këqia. Përandaj mos
bëhi të-çmëndurë, po *asish* që kupëtonjënë
18 ç'është dashurimi i Zotit. Edhe mos dehi me
verë, ndë të-cilët ka plankprishje; po mbu-
19 shuni me Frymë të-Shënjtëruarë, Dyke fo-
lurë ndë mest t'uaj me psallma e me
hymna e me kënkë shpirtërishte, dyke kën-
duar' e dyke psallurë Zotit me zëmërënë t'uaj;
20 Dyke i falurë ndersë Perëndisë edhe Atit mb'
emërit të Zotit t'ënë Jisu Krisht përherë për
21 të-gjitha; *Edhe* dyke unjurë kryetë njëri tja-
tërit me frikë Perëndie.
22 Ju gratë, binduni burravet t'uaj, posi Zo-
23 tit; Sepse burri është kryet' e gruasë, sikun-
drë edhe Krishti *është* kryet' e kishësë, edhe
24 ay është shpëtimtari i trupit. Po sikundrë ki-
sha i bindetë Krishtit, kështu edhe gratë *let'
u bindenë* burravet të tyre së-gjithash.
25 Ju burratë, doni gratë t'uaj, sikundrë edhe
Krishti deshi kishënë, edhe dha vetëhen' e ti
26 për atë, Që t'a shënjtëronjë, dyke pastruarë

27 atë me të-larët' e ujit, me anë të fjalësë; Që
t'a nxjerrë atë përpara vetëhes' së ti kishë
të-lavduruarshime, që s' ka këllirë, a rrudhë,
a ndonjë nga të-këtillatë, po që të jet' e-shënj-
28 tëruarë e pa të-metë. Kështu kanë detyrë bu-
rratë të duanë grat' e tyre, posi trupërat' e
tyre. Ay që do gruan' e ti, do vetëhen' e ti;
29 Sepse asndonjë ndonjëherë s' e pati cmir mi-
shin' e ti, po e ushqen edhe e ngroh, sikun-
30 drë edhe Zoti kishënë. Sepse jemi anë të
trupit t' ati, prej mishit t'ati edhe prej eshtë-
31 ravet t' ati. „Përandaj njeriu dotë lerë t' an'
e t' ëmënë edhe dotë ngjitetë pas gruas' së
32 ti, edhe dotë jenë të dy një mish." Këjo fshe-
hësirë ësht' e-madhe; po unë e them *këtë* për
Ktishtin' e për kishënë.
33 Po edhe ju veç e veç, gjithë-sicili kështu
let'a dojë gruan' e ti, posi vetëhen' e ti; edhe
gruaja let' i ketë frikë burrit.

Krye 6.

1 Ju djemtë, binduni prindërvet t' uaj mbë
2 Zotinë; Sepse këjo ësht' e-drejtë. „Ndero t'ët
atë e t' ët ëmë," (e-cila është porosi e-parë
3 me të-zotuarë,) „Që të të bënetë mirë ty, e
të jesh jetë-gjatë mbi dhet."
4 Edhe ju atëritë, mos zëmëroni djemtë t' uaj,
po i arrëseni ata me mësim e me këshillë
të Zotit.
5 Ju shërbëtorëtë, binduni zotërinjvet t' uaj

pas mishit me frikë e me të-dridhurë, me
kthjellësirë të zëmërësë s' uaj, posi Krishtit;
6 Jo si shërbëtorë për faqe, si asish që *du-*
anë t' u pëlqenjënë njerëzet, po si shërbëtorë
të Krishtit, dyke bërë dashurimn' e Perëndisë
7 prej shpirti, *Si* dyke punuarë me zëmërë të-
8 mirë Zotit, e jo njerësvet; Sepse e dini, se
çdo të-mirë që të bënjë gjithë-sicili, këtë
edhe dotë marrë prej Zotit, a shërbëtuar *qof-*
të, a i-lirë.
9 Edhe ju zotërinjtë, gjithato bëni tek ata,
dyke lënë të-frikësuaratë; sepse e dini, se
edhe ju vetë keni Zot ndë qiejt, edhe tek ay
s' ka të-mbajtur' anë.
10 Pra, o vëllezërit' e mi, forcohi mbë Zotinë
11 edhe ndë pushtett të fuqis' s' ați; Vishni gjith'
armët' e Perëndisë, që të muntni t' u qëndroni
12 kundrë mjeshtërivet të djallit; Sepse lufta
jonë nuk' është kundrë gjaku e mishi, po
kundrë urdhëratavet, kundrë pushtetevet,
kundrë mbretërvet t' errësirës' së kësaj jete,
13 kundrë frymavet të-liga ndë qiellorret. Për-
andaj merrni me vetëhe gjith' armët' e Pe-
rëndisë, që të muntni të qëndroni kundrë ndë
ditët të-keqe, edhe si të keni bërë gati të-
14 gjitha, të qëndroni *mbë këmbë*. Qëndroni *mbë*
këmbë pra ngjeshurë mezinë t' uaj me të-
vërtetënë, edhe veshurë thurakun' e drejtë-
15 risë, Edhe mbathurë këmbëtë me të-qënuritë
16 gati për ungjillin' e paqtimit. Edhe përmbi

të-gjitha, merrni me vetëhe mburonjën' e be-
sësë, me të-cilënë dotë muntni të shuani
17 gjithë shëgjetat' e-ndezura e të-ligut; Edhe
merrni përkrenoren' e shpëtimit, edhe thikën'
18 e Frymësë, që është fjala e Perëndisë; Dyke
falurë ndë Frymë mbë çdo kohë me çdo farë
të-faluri e të-luturi, edhe mbë gjithë këtë dy-
ke ndënjurë sgjuarë me çdo farë durimi e
19 të-luturi për gjithë shënjtorëtë. Edhe për mua,
që të më epetë fjalë të hap gojënë t'ime me
kuxim, që t'a bënj të-njohurë fshehësirën'e un-
20 gjillit, Për të-cilinë *unë* jam lajmës ndë vark
hekurash, që të flas për atë me kuxim, si-
kundrë gjan të flas.
21 Po që të dini edhe ju të-miatë, ç' bënj,
të-gjitha dot' ua rrëfenjë juve Tiqiku, vëllaj
i-dashurë edhe shërbëtuar besëtar mbë Zo-
22 tinë; Të-cilinë e dërgova ndër ju për këtë
punë, që të mësoni punëratë t' ona, edhe që
të ngushullonjë zëmëratë t' uaj.
23 Paqtim *qoftë* mbë vëllezëritë, edhe da-
shuri me besë nga Perëndia, Ati, edhe nga
24 Zoti Jisu Krisht. Hir *qoftë* bashkë me gith'
ata që duanë Zotinë t' ënë Jisu Krisht me
zëmërë të-kthjellëtë. Amin.

Karta e Apostollit Pavël mbë Filippianëtë.

Krye 1.

1 Pavli edhe Timotheu, shërbëtorë të Jisu
Krishtit, mbë gjithë shënjtorëtë mbë Jisu
Krishtinë, që janë ndë Filippë, bashkë me
2 episkopët' e me dhjakëritë; Hir *qoftë* mbë ju
edhe paqtim prej Perëndisë, Atit t' ënë, edhe
prej Zotit Jisu Krisht.
3 I falem ndersë Perëndisë t'im sa herë u kuj-
4 tonj juve, (Sepse gjithënjë mbë çdo të-luturë
5 lutem me gëzim për gjithë ju,) Për pjesënë
t' uaj *që kini* ndë ungjillt që prej së-parësë
6 ditë *e* gjer ndashti; Sepse më është mbushurë
mëndja për këtë, se ay që nisi *të bënjë* pu-
në të-mirë ndër ju, dot'a mbaronjë gjer mbë
7 ditët të Jisu Krishtit. Sikundrë ësht' e-drejtë
tek unë të kem ndër mëntt këtë për gjithë
ju, sepse u kam juve ndë zëmërët *t' ime*, se
edhe ndë të-lidhurat të mia, edhe ndë të-
mbrojturit me fjalë, edhe ndë të-vërtetuarët
të ungjillit ju të-gjithë keni qënë pjesëtarë
8 bashkë me mua ndë hirt. Sepse dëshmimtari
im është Perëndia, se kam shumë mall për
9 gjithë ju me dashuri Jisu Krishti. Edhe për
këtë falem, që të tepëronjë dashuria juaj edhe

BKSH

shum' e më shumë ndë të-njohur' e ndë çdo
10 të-kupëtuarë, Që të çquani ato që ndanjënë
njëra prej tjatërësë, edhe të jeni zëmërë-kthje-
llëtë e të-papenguarë gjer mbë ditët të Krish-
11 tit, Plot me pemë drejtërie, të-cilatë janë me
anë të Jisu Krishtit, për lavdi e për lëvdim
të Perëndisë.
12 Edhe dua t'a dini, o vëllezër, se sa më
ngjanë mua ndihnë më tepërë për mbrothë-
13 sin' e ungjillit; Kaqë sa të-lidhurat' e mia për
Krishtinë ubënë të-çfaqura mbë gjithë gjy-
14 katën' e mbë gjithë të-tjerëtë; Edhe më të-shu-
mët' e vëllezërvet mbë Zonë, dyke marrë zë-
mërë nga të-lidhurat' e mia, më tepërë kuxo-
15 njënë pa frikë të flasënë fjalënë. Ca me të-
vërtetë nga cmiri e nga *dashuria për* qarta
e lëçisnjënë Krishtinë, po ca edhe nga dë-
16 shir' e-mirë. Ata e lëçisnjënë Krishtinë nga
cmiri, jo me zëmërë të-kthjellëtë, dyke pan-
dehurë se shtonjënë shtrëngime mbë të-lidhu-
17 rat të mia; Po këta nga dashuria, sepse dinë,
18 se jam vënë për të mbrojturë ungjillinë. Ç' del
pra? veç se me çdo farë mënyre, me shkak,
ose me të-vërtetë, Krishti lëçitetë, edhe për
19 këtë gëzonem, edhe dotë gëzonem. Sepse
e di, se këjo dotë më dalë për shpëtim, me
anë të të-luturit t' uaj, edhe me anë të ndih-
20 mës' së Frymës' së Jisu Krishtit, Pas të-pri-
turit pa durim edhe pas shpresësë s' ime, se
nukë dotë turpëronem as mbë ndonjë *gjë*, po

me çdo kuxim, si gjithënjë, kështu edhe
ndashti dotë madhëronetë Krishti ndë trupt
t'im, ose me anë jete, ose me anë vdekjeje.
21 Sepse tek unë të-rrojturitë *është* Krishti, edhe
të-vdekuritë, fitim.
22 Po ndë qoftë se të-rrojturitë ndë misht t'im
është që të sjellë pemë puna ime, atëhere
23 ç' të sgjeth nukë di: Sepse shtrëngonem prej
të dyjave; sepse *nga njëra anë* kam dëshë-
rim të ikënj e të jem bashkë me Krishtinë;
24 sepse *kështu është* shumë më mirë: Po *nga*
ana tjetërë të-mbeturitë *t' im* ndë misht është
25 më të-nevojshim për ju. Edhe këtë me siguri
e di se dotë mbetem edhe dotë qëndronj
bashkë me gjithë ju, për mbarësinë t' uaj mbë
26 besët e për gëzimnë t'uaj; Që të tepëronjë
me anë t'ime të-mburruritë t' uaj mbë Jisu
Krishtinë, me të-ardhuritë t'im përsëri ndër
27 ju. Vetëmë të shkoni jetënë sikundrë vëjen
mbë ungjillin' e Krishtit, që të dëgjonj për
ju, ose kur të vinj e t'u shoh juve, ose për-
së-largu kur s'jam aty, se qëndroni mbë një
frymë, dyke përpjekurë me një shpirt për-së-
28 bashkëti për besën' e ungjillit; E dyke mos
utrëmburë as mbë gjë nga ata që rrinë kun-
drë; e-cila gjë mbë ata dotë jetë dëftesë
humbjeje, po mbë ju shpëtimi, edhe këjo nga
29 Perëndia. Sepse mbë ju është falurë për pu-
në të Krishtit, jo vetëmë t'i besoni ati, po
30 edhe të pësoni për atë; Dyke pasurë gjithatë

BKSH

luftë që patë mbë mua, edhe ndashti dëgjoni
se është mbë mua.

Krye 2.

1 Ndë ka pra ndonjë ngushullim mbë Krish-
tinë, a ndonjë të-ngushulluarë dashurie, a
ndonjë shoqëri Frymë, a zëmërë-dhëmbje e
2 përdëllime, Bëni të-plotë gëzimnë t' im me
të-qënë mbë gjithatë mëndje, dyke pasurë
gjithatë dashuri, dyke qënë një shpirt i-bash-
3 këtë e me një mëndje. Mos *punoni* asgjë prej
cmiri a prej mëndjeje së-kotë, po me përunj-
tje mëndjeje, dyke numëruarë sicili tjatërinë
4 më të-lartë se vetëhen' e ti. Mos mendohi
gjithë-sicili për të tiatë, po gjithë-sicili edhe
për punët' e të tjerëvet.
5 Edhe letë jetë mbë ju gjithajo mëndje që
6 ishte edhe mbë Jisu Krishtinë; I-cili, dyke
qënë ndë formët të Perëndisë, nuk' e numë-
roj për rrëmbim të-qënuritë si-një-një me
7 Perëndinë; Po sbrazi vetëhen' e ti, edhe mori
formë shërbëtori, e ubë posi njerëzitë mbë
8 të-përgjajturë; Edhe dyke ugjëndurë ndë fyty-
rët posi njeri, e përunji vetëhen' e ti, e ubë
i-bindurë gjer mbë vdekje, edhe vdekje kryqi.
9 Përandaj edhe Perëndia e lartoj fort tepërë,
edhe i fali ati *një* emërë që *është* përmbi çdo
10 emërë; Që mbë emërit të Jisujt të unjetë çdo
gju i atyreve që janë ndë qiejt e mbi dhet
11 e ndënë dhet, Edhe çdo gjuhë të rrëfenjë se

Jisu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë
12 Atë. Përandaj, o të-dashurit' e mi, sikundrë
keni qënë të-bindurë përherë, jo sikundrë
keni qënë vetëmë kur jam ndër ju, po ndashti
shumë më tepërë që nukë jam ndër ju, pu-
noni *për* shpëtimn' e vetëhesë s'uaj me frikë
13 e me të-dridhurë; Sepse Perëndia është ay
që veperon ndër ju edhe të-dashurit' edhe
14 të-veperuarëtë, pas pëlqimit të ti. Bëni të-
15 gjitha pa murmuri e pa kundrështime, Që
të jeni faqebardhë e të-tërë, bij Perëndie
pa të-metë, ndë mest të një kombi dredha-
rak e të-shtrëmbërë, ndër mest të të-cilëvet
16 ndritni posi dritarë ndë botët, Dyke mbaj-
turë fjalën' e jetësë, për të-mburruritë t' im
ndë ditët të Krishtit, se nukë brodha mbë
17 kot, as mbë kot nuk' umunduashë. Po edhe
ndë qoftë se bënem të-çpërkaturë përmbi
kurbant e përmbi shërbesët të-besësë s' uaj,
gëzonem e gasmonem bashkë me gjithë ju;
18 Gjithashtu edhe ju gëzohi e gasmohi bash-
kë me mua.
19 Edhe shprenj mbë Zotinë Jisu, Timothenë
t'a dërgonj për-së-çpejti ndër ju, që të më
ngushullonetë shpirti edhe mua, kur të marr
20 vesh punëratë t' uaj. Sepse s'kam asndonjë
tjatërë që t'a ketë shpirtinë si-një-një *me
t' iminë*, i-cili me zëmërë të-kthjellëtë të kuj-
21 desetë për punëratë t'uaj. Sepse të-gjithë kër-
konjënë *enteresat'* e tyre, jo ato të Jisu Krish-

BKSH

22 tit. Edhe e dini provimin' e ati, se, posi bir
me t' anë, punoj bashkë me mua për ungji-
23 llinë. Këtë pra shprenj t'a dërgonj sa-kaqë-
herash, posa që të marr vesh si dotë venë
24 punërat' e mia. Edhe kam besë mbë Zotinë
se edhe vetë për-së-çpejti dotë vinj.
25 Po umenduashë se ësht' e-nevojshime të
dërgonj ndër ju Epafrodhitnë, vëllanë edhe
bashkëpunëtorinë edhe bashkëushtëtorinë
t'im, që udërgua nga ju, edhe më shërbeu
26 ndë nevojët; Sepse kishte shumë mall për
ju të-gjithë, edhe i vinte keq, sepse dëgjuatë
27 se qe sëmurë. Edhe vërtet qe sëmurë afërë
për vdekje; po Perëndia e përdëlleu; edhe
jo vetëm' atë, po edhe mua, që të mos kem
28 hidhërim mbi hidhërim. Përandaj u'a dërgova
atë juve më me nxitim, që të gëzohi, kur t'a
shihni atë përsëri, edhe unë të kem më pak
29 hidhërim. Prit-e-ni atë mbë Zotinë më çdo
30 gëzim, edhe të-këtillëtë t'i keni mbë nder; Se-
pse për punën' e Krishtit uafërua gjer mbë
vdekje, dyke vënë ndënë rrëzik jetën' e ti,
që të mbushnjë të-shterët' e shërbesësë s' uaj
mbë mua.

Krye 3.

1 Mbë ndë funt, o vëllezërit' e mi, gëzohu-
ni mbë Zotinë. T' u shkruanj juve gjithato
gjërëra, për mua s' është pun' e-rëndë, po për
ju është siguri.

2 Ruhi nga qëntë, ruhi nga punëtorët' e-liq;
3 ruhi nga të-prerëtë; Sepse rrethpresja jemi
neve që adhurojmë Perëndinë me frymë, edhe
që mburremi mbë Jisu Krishtinë, edhe nukë
4 kemi shpresë ndë misht; Ndonëse edhe unë
kam besim ndë misht. Ndë pandeh ndonjë
tjetërë, se ka besim ndë misht, unë *gjan të*
5 *kem* më shumë; Rrethprerë tetë ditsh, prej
kombit të Israilit, prej farës' së Veniaminit,
6 Evre prej Evrenjsh, pas nomit Farise, Nga
përvëlim' i zëmërësë ndjekës i kishësë, nga
7 drejtëria që është pas nomit faqe-bardhë. Po
ato që më ishinë fitim, këto i numërova
8 për Krishtinë dëm. Po, me të-vërtetë kujtonj
të-gjitha se janë dëm për të-çquarët' e të njo-
hurit të Jisu Krishtit, Zotit t'im; për të-cilinë
udëmëtova të-gjitha, edhe i numëronj se janë
9 plehë, që të fitonj Krishtinë, Edhe të gjëndem
me atë, dyke pasurë jo drejtërinë t' ime që
është prej nomit, po atë që është me anë
të besësë mbë Krishtinë, drejtërinë që është
10 prej Perëndisë mbi besët; Që të njoh atë,
edhe fuqin' e të-ngjallurit t'ati, edhe shoqë-
rin' e të-hequravet t' ati, dyke bërë vetëhenë
11 mbë një formë me vdekjen' e ati; Mbase
kështu i arrinj të-ngjallurit prej së-vdekurish.
12 Jo se *unë* ndashti e kam marrë bravurënë,
a se jam bërë i-sosurë, po e ndjek prapa,
mbase e arrinj, për të-cilënë gjë edhe uzushë
13 prej Jisu Krishtit. O vëllezër, unë s'e numë-

14 ronj vetëhenë t' ime se e kam marr' atë; Po
një *punë bënj*, dyke harruarë ato *që shkuanë*
prapa, edhe dyke shtriturë mb' ato *që kam*
përpara, sulem drejt shënjësë mbi bravurën'
e të-thërriturit të Perëndisë mbë Jisu Krish-
tinë prej së-larti.

15 Sa jemi të-sosurë pra, këtë letë kemi
ndër mëntt; po ndë mendoneni për ndonjë
gjë ndryshe, edhe këtë dot' u' a sbulonjë
16 juve Perëndia. Po mbë atë që arritmë, pas
gjithasaj rregulle letë ecëjmë, gjithatë *gjë* letë
kemi ndër mëntt.

17 O vëllezër, bëhi bashkë-shëmbëllenjës të
mi, edhe vini re ata që ecënjënë kështu, sikun-
18 drë na keni neve shëmbëllesë. Sepse shumë
ecënjënë, për të-cilëtë u thoshnjam juve shu-
më herë, edhe ndashti dyke qarë po u them,
19 se *ata janë* armiqt' e kryqit të Kristit; E pas-
tajmja e të-cilëvet është humbje, edhe Pe-
rëndia i të-cilëvet *është* barku, edhe lavdia
e atyre është ndë turpërit t' atyre, të-cilëtë
20 kanë ndër mëntt punërat' e dheut. Sepse,
të-rrojturitë t'ënë *është* ndë qiejt, që ku edhe
21 presimë Shpëtimtarinë, Zotnë Jisu Krisht; I-
cili dotë ndërronjë trupin' e të-përunjurit t'
ënë, që të bënetë mbë një formë me trupin'
e lavdis' s'ati, pas vepërimit me të-cilinë *ay*
munt edhe të vërë të-gjitha ndënë vetëhen'
e ti.

BKSH

Krye 4.

1 Përandaj, o vëllezërit' e mi të-dashurë e
të-mallënjyerë, gëzimi edhe kurora ime, kë-
shtu qëndroni mbë Zotinë, o të-dashurë.
2 I lutem Evodhisë, i lutem edhe Sintikësë,
3 gjithatë mëndje të kenë mbë Zotinë. Edhe të
lutem edhe ty, o shoku i-thjeshtë, ndih-u aty-
reve, të-cilatë umunduanë bashkë me mua
ndë ungjillt, bashkë edhe me Klimentinë edhe
me të-tjerëtë bashkëpunëtore të mi, emërat' e
të-cilëvet janë ndë vivlit të jetësë.
4 Gëzohi përherë mbë Zotinë; përsëri dotë
5 them, Gëzohi. Butësira juaj letë njihetë mbë
6 gjithë njerëzitë. Zoti është afërë. Mos kini
kujdes për asgjë; po mbë çdo gjë letë nji-
henë të-kërkuaratë t' uaj te Perëndia me të-
falurë ndersë me anë të të-falurit e të të-
7 luturit. Edhe paqtimi i Perëndisë që kapër-
xen çdo mëndje dotë ruanjë zëmëratë t'uaj
edhe mendimetë t'uaj me anë të Jisu Krishtit.
8 Përandaj, o vëλezër, sa janë të vërteta, sa
janë të-hieshime, sa *janë* të-drejta, sa *janë* të-
qëruara, sa *janë* të-dashura, sa *janë* të-dë-
gjuara me nder te-mirë, ndë ka ndonjë mi-
rësi, edhe ndë *ka* ndonjë lëvdim, këto men-
9 doni. Ato që edhe nxutë, edhe muartë, edhe
dëgjuatë, edhe patë tek unë, këto punoni; e-
dhe Perëndia i paqtimit dotë jetë bashkë
me ju.
10 Edhe ugëzova mbë Zotinë shumë, se nda-

BKSH

shti përsëri e rrëfyetë të-lulëzuarë kujdesnë
që kini për mua; për të-cilinë edhe kujdese-
11 shitë, po s'kishitë kohë të-pëlqyerë. Nuk'e them
këtë se s'kam *të-nevojshimetë*; sepse unë jam
mësuarë të jem i-kënaqurë me ato që kam.
12 Di të përunjem, di edhe të rronj me të-te-
përa; mbë çdo vënt e mbë të-gjitha jam më-
suarë edhe të nginjem edhe të kem uri, e-
dhe të rronj me të-tepëra edhe të shkonj
13 me skamje. Të gjtha munt *t'i bënj* me anë
të Krishtit që më ep fuqi.
14 Po bëtë mirë qe m'ubëtë shokë ndë shrën-
15 gimt t'im. Edhe ju, o Filippianë, e dini, se
ndë të-nisurit të ungjillit, kur dolla nga Ma-
qedhonia, asndonjë kishë nukë m'ubë shoqe
16 për dhënëje e për marrje veç ju vetëmë; Sepse
edhe ndë Thesalonikë një herë edhe dy he-
17 rë ndë nevojët më dërguatë *ndihmë:* Jo se kër-
konj dhuratë; po kërkonj pemënë që shumo-
18 netë për llogari t'uaj. Po të-gjitha i kam, e-
dhe më tepëronjënë; jam i mbushurë, se
prita prej Epafrodhitit ato që *më dërguatë*
ju, ere të-mire, kurban të-priturë, të-pëlqyerë
19 te Perëndia. Edhe Perëndia im ka për të
mbushurë gjithë nevojënë t'uaj pas pasjes'
së ti ndë lavdi, me anë të Jisu Krishtit.
20 Edhe mbë Perëndinë edhe Atinë t'ënë
qoftë lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.
21 Epni të-fala me shëndet çdo shënjti mbë
Jisu Krishtinë; u falenε me shëndet vëllezë-

22 ritë që janë bashkë me mua. U falenë juve
me shëndet gjithë shënjtorëtë, po më fort
ata që janë nga shtëpia e Qesarit.
23 Hir' i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë* bash-
kë me gjithë ju. Amin.

Karta e apostollit Pavël mbë Kollossianëtë.

Krye 1.

1 Pavli, apostoll i Jisu Krishtit me anë të
dashurimit të Perëndisë, edhe Timotheu vë-
2 llaj, Mbë shënjtorëtë edhe mbë vëllezëritë be-
sëtarë mbë Krishtinë që janë ndë Kollo-
ssë; hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim prej Pe-
rëndisë, Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.
3 I falemi ndersë Perëndisë edhe Atit të
Zotit t'ënë Jisu Krisht, dyke falurë përherë
4 për ju, Passi dëgjuamë për besënë t'uaj mbë
Krishtinë, edhe për dashurinë që kini mbë
5 gjithë shënjtorëtë, Për shpresënë që ruhetë
për ju ndë qiejt, të-cilënë e keni dëgjuarë që
përpara ndë fjalët të së-vërtetës' së ungjillit,
6 Që erdhi mbë ju, sikundrë edhe mbë gji-
thë botënë; edhe bje pemë, sikundrë edhe
mbë ju, që mb' atë ditë që dëgjuat' edhe
7 njohtë hirin' e Perëndisë me të-vërtetë; Si-

kundrë edhe e mësuatë nga Epafraj, *nga* i-
dashuri bashkë-shërbëtori ynë, i-cili është për
8 ju shërbëtuar besëtar i Krishtit; I-cili edhe
na dëfteu dashurinë t' uaj ndë Frymët.
9 Përandaj edhe neve,që mb' atë ditë që dë-
gjuamë, nukë pushojmë dyke falurë për ju, e-
dhe dyke luturë që të mbusheni prej të-njohurit
të dashurimit t' ati me çdo urtësi e kupëtim
10 shpirti; Që të ecëni sikundrë vëjen për Zo-
tinë, për të pëlqyerë *ati* mbë të-gjitha, dyke
sjellë pemë mbë çdo punë të-mirë, edhe dyke
11 urriturë nde të-njohurit të Perëndisë; Dyke
uforcuarë me çdo farë fuqie, pas pushte-
tit të lavdis' s' ati, për çdo durim e zëmërë
12 të-gjerë me gëzim; Dyke falurë ndersë Atit,
i-cili na bëri të-vëjejturë të kemi pjesë ndë
13 trashëgimt të shënjtorëvet ndë dritët; I-cili na
shpëtoj nga pushteti i errësirësë, edhe na
pruri ndë mbretërit të Birit të dashuris' së
14 ti; Mbë të-cilinë kemi çpërblimnë me anë të
15 gjakut t' ati, ndjesën' e fajevet; I-cili është
shëmbëlles' e të-padukurit Perëndi, i-parëlin-
16 duri i gjithë kriesësë; Sepse me anë t'ati u-
kriuanë të-gjitha, sa janë ndë qiejt edhe sa
janë mbi dhet, të-dukurat' e të-padukuratë,
a frone, a zotërinj, a urdhëra, a pushtete, të-
gjitha janë kriuarë me anë t'ati edhe për atë;
17 Edhe ay është përpara të-gjithave, edhe të-
18 gjitha me anë t' ati qëndronjënë; Edhe ay
është kryet' e trupit, të kishësë; ay është të-

nisuritë, i-parëlinduri prej të-vdekurvet, që
të bënetë ay i-parë mbë të-gjitha.
19 Sepse mb' atë i pëlqeu Atit të rrijë gjithë
20 të-mbushuritë, Edhe me anë t' ati të paqto-
një të-gjitha me vetëhen' e ti, dyke paqtuarë
me anë të gjakut të kryqit t' ati, me anë t'ati,
edhe ato që janë mbi dhet, edhe ato që janë
ndë qiejt.
21 Edhe ju, që ishitë njëherë të-huaj edhe
22 armiq nga mëndja me punërat' e-liga, Ndashti
u paqtoj *me Perëndinë* ndë trupt të mishit të
ti, me anë të vdekjesë, që t'u nxjerrë juve
përpara vetëhes' së ti shënjtorë e faqe-bar-
23 dhë e të-pafajshim, Ndë qëndrofshi ndë be-
sët të-themelosur' e të-patundurë, e të mos lu-
ani nga shpresa e ungjillit që dëgjuatë, i-
cili ulëçit mbë gjithë kriesënë që është ndënë
qiellt; të-cilit *ungjill* unë Pavli i ubëshë shër-
bëtuar.
24 Ndashti gëzonem ndë të-hequrat të mia
për ju, edhe mbush mungimet' e shtrëngime-
vet të Krishtit ndë misht t'im për trupin'e ati,
25 që është kisha; Së-cilësë unë i ubëshë shërbë-
tuar pas kujdesit të Perëndisë që m' udha
për ju, që të mbush *të-lëçiturit'* e fjalës' së
26 Perëndisë, Fshehësirënë që ishte fshehurë nga
jetët' e nga brezatë, edhe ndashti uçfaq mbë
27 shënjtorët' e ati; Ndë të-cilët Perëndia deshi
të tregonjë cila është pasja e lavdis' së kë-
saj fshehësire mbë kombetë, e-cila është Kri-

28 shti mbë ju, shpresa e lavdisë; Të-cilinë ne-
ve e lëçisëmë dyke këshilluarë çdo njeri,
edhe dyke mësuarë çdo njeri me çdo urtësi,
që t'a nxjerrëmë çdo njeri të-sosurë mbë Jisu
29 Krishtinë. Për këtë punë edhe mundonem,
dyke upërpjekurë pas vepërimit t'ati që ve-
për on tek unë me fuqi.

Krye 2.

1 Sepse dua t'a dini sa të-math të-përpje-
kurë kam për ju edhe për ata që janë ndë
Llaodhiqi, edhe për gjithë sa s' kanë parë
2 faqenë t' ime ndë misht, Që të ngushullonenë
zëmërat' e atyreve, dyke ubashkuarë ndë da-
shuri, edhe mbë çdo farë pasjeje të kupëti-
mit të-mbaruarë, që të njohënë fshehësirën'
3 e Perëndis' edhe Atit edhe të Krishtit; Tek
i-cili janë fshehurë gjithë thesarët' e urtësis'
4 e të diturisë. Edhe e them këtë, që të mos
u gënjenjë juve ndonjë me fjalë të-gatuara.
5 Sepse ndonëse me trupinë nukë jam aty, po
me shpirtinë jam bashkë me ju, dyke ugëzu-
arë e dyke parë radhënë t' uaj, edhe të-pa-
6 tundurit' e besësë s' uaj mbë Krishtinë. Sikun-
drë pra e keni marrë Zotinë Jisu Krisht,
7 *kështu* ecëni mb' atë, Dyke pasurë rrënjë e
dyke undërtuarë mb' atë, edhe dyke uforcu-
arë ndë besët, sikundrë umësuatë, dyke te-
përuarë mb' atë me të-falurë ndersë.

8 Vështroni semos u gënjenë juve ndonjë

me anë të fillosofisë edhe të kobimit të-kotë,
pas fjalëvet të-lëna prej njerësvet, pas sti-
9 hiavet të botësë, e jo pas Krishtit. Sepse tek
ay rri gjithë të-mbushurit' e hierisë trupërisht;
10 Edhe jeni të-mbushurë tek ay, i-cili është
11 kryet' e çdo urdhëri e e çdo pushteti; Mbë
të-cilin' edhe urrethpretë me rrethpresje që
s' bënetë me dorë, dyke sveshurë trupin' e
fajevet të mishit me anë të rrethpresjes' së
12 Krishtit, Dyke ukallurë ndë varr bashkë me
atë ndë pagëzimt, ndë të-cilët edhe ungjalltë
bashkë me anë të besës' së vepëtimit të Pe-
rëndisë, i-cili ngjalli atë prej të-vdekurvet.
13 Edhe juve, tek ishitë të-vdekurë ndë fajet e
ndë parrethpresjet të mishit t' uaj, u bëri të-
gjallë bashkë me atë, dyke falurë juve gji-
14 thë fajetë; *Edhe* dyke shuarë dorëshkronjën'
e porosivet që ishte kundrë nesh, e-cila ish-
te e-kundrejtë mbë ne, edhe këtë e hoqi nga
15 mezi, dyke mbërthyerë atë mbë kryqt; Edhe
passi i sveshi urdhëratat' edhe pushtetetë, i
turpëroj ndër sy, dyke thriamvepsurë mbi
atë kundrë atyre.
16 Letë mos u gjykonjë juve pra asndonjë,
për të-ngrënë a për të-pirë, a për gjërëra që
kanë të bëjnë me të-kremte a me hënë të-re,
17 a me të-shëtuna; Të-cilatë janë hije të punë-
ravet që kanë për të ardhurë, po trupi *ësht'*
18 i Kristit. Asndonjë letë mos u shternjë juve
bravurënë më faqe mëndjeje së-përunjurë e-

dhe feje t' ëngjejvet, dyke hyrë mbë pu-
nëra që s'i ka parë, dyke fryturë vetëhenë
19 mbë kot prej mëndjes' së mishit të ti, Edhe
nukë mban kryetë, *Krishtinë*, prej të-cilit gji-
thë trupi, dyke upërmbajturë e dyke ulidhurë
bashkë me anë të nyjevet e të bashkë-lidh-
jevet, rritetë pas të-rriturit të Perëndisë.
20 Ndë qoftë pra se vdiqtë bashkë me Krish-
tinë nga stiqiat' e botësë, përse dyke rruarë
21 ndë botët jeni ndënë urdhërata, (Mos zësh,
22 mos ngjëronesh, mos pjekç me dorë, Të-ci-
latë të-gjitha prishenë nga të-përndoruritë;)
pas porosivet e pas mësimevet të njerësvet?
23 Të-cilatë dukenë se kanë dituri mbë feda-
shje, mbë mëndje të-përunjurë e mbë të-mos-
kursyerë të trupit, sepse s'kanë mbë ndonjë
farë nderi mishinë për të kënaqur' atë.

Krye 3.

1 Ndë qoftë se ungjalltë bashkë me Krish-
tinë, kërkoni ato që *janë* lart, ku Krishti është
2 ndënjurë mbë të-djathtë të Perëndisë. Kini
ndër mëntt ato që *janë* lart, jo ato që janë
3 mbi dhet. Sepse vdiqtë, edhe jeta juaj është
fshehurë bashkë me Krishtinë te Perëndia.
4 Kur të çfaqetë Krishti, jeta jonë, atëhere edhe
ju bashkë me atë dotë çfaqi ndë lavdi.
5 Bëni pra të-vdekura anët' e trupit' tuaj që
janë mbi dhet, kurvërinë, ndyrësirënë, zëmë-
rën' e-keqe, dëshërimin' e-lik edhe lakmimnë,

6 që është idhullatri; Për të-cilatë *gjërëra* vjen
zëmërat' e Perëndisë përmbi të bijt' e pabin-
7 djesë; Ndë të-cilat edhe ju ectë njëherë, kur
8 rronitë ndër ato. Po ndashti hithni edhe ju
të-gjitha *këto*, mërinë, zëmëratënë, të-ligënë,
vllasfiminë, fjalët' e-ndyra prej gojësë s'uaj.
9 Mos thoni gënjeshtra njëri tjatërit, passi sve-
shtë njerin' e-vjetërë bashkë me punërat' e ati,
10 Edhe veshtë të-rinë që përtërihetë mbë të-njo-
hurë pas shëmbëllës' s'ati që e ka kriuarë;
11 Ku s'ka Grek e Judhe, rrethpresje e pa-rreth-
presje, varvar, Sqith, shërbëtuar, të-lirë, po
të-gjitha e mbë të gjitha *është* Krishti.
12 Vishni pra, si të-sgjedhurë të Perëndisë
shënjtorë edhe të-dashurë, zëmëra përdëlli-
meve, mirësi, mendje të-përunjturë, butësirë,
13 zëmërë të-gjerë; Dyke duruarë njëri tjatërinë,
edhe dyke ndjerë njëri tjatërinë, ndë pastë
ndonjë të-qarë kundrë ndonjëj; sikundrë edhe
14 Krishti u ndjeu juve, kështu edhe ju. Edhe
përmbi gjithë këto *vishni* dashurinë, e-cila
15 është baskë-lidhja e qënjes' së-sosurë. Edhe
paqtimi i Perëndisë letë mbretëronjë ndër
zëmërat t'uaj, mbë të-cilin' edhe uthërrittë ndë
një trup; edhe bëhi asish që e njohënë të-
mirënë.
16 Fjal' e Perëndisë letë rrijë mbë ju e-pa-
surë me çdo farë diturie; mësoni e këshilloni
njëri tjatërinë me psallma e me hymna e me
kënkë shpirtërishte, dyke kënduarë me hir

17 ndë zëmërët t' uaj mbë Zotinë. Edhe çdo që
të bëni me fjalë a me punë, të-gjitha *t'i bëni*
mb' emërë të Zotit Jisu, dyke falurë ndersë
Perëndisë edhe Atit me anë t' ati.

18 Ju gratë, binduni burravet t' uaj, sikundrë
gjan mbë Zotinë.

16 Ju burratë, doni gratë *t'uaj*, edhe mos ini
të-hidhurë tek ato.

20 Ju bijtë, binduni prindërvet t'uaj mbë të-
gjitha; sepse këjo ësht' e-pëlqyerë te Zoti.

21 Ju atëritë, mos i zëmëroni bijtë t'uaj, që të
mos u likshtonetë zëmëra.

22 Ju shërbëtorëtë, binduni së-gjithash zo-
tërinjvet *t'uaj* pas mishit, jo me të-shërbyerë
vetëmë përpara syvet, si asish që *duanë* t'u
pëlqenjënë njerësvet, po me mituri zëmëre,
23 dyke pasurë frikë nga Perëndia. Edhe çdo që
bëni, prej shpirti puno-e-ni, posi Zotit, e jo
24 njerësve; Dyke diturë se prej Zotit keni për
të marrë çpagimin' e trashëgimit; sepse Zotit
25 Krisht i shërbeni; Po ay që punon shtrëm-
bëri, dotë marrë çpagimin' e shtrëmbëris' së
ti; sepse s' ka të-mbajturë anë.

Krye 4.

1 Ju zotërinjtë, ep-u-ni shërbëtorëvet *t' uaj*
të-drejtënë edhe sa u bën, dyke diturë, se e-
dhe ju keni Zot ndë qiej.

2 Qëndroni mbë të-falurit, dyke ndënjurë
3 sgjuarë nd' atë me të-falurë ndersë; Dyke fa-

BKSH

lurë ndë gjithatë kohë edhe për ne, që të na
hapnjë Perëndia derë të fjalësë, që të flasë-
më fshehësirën'e Krishtit, për të-cilënë edhe
4 jam lidhurë; Që t'a çfaq atë, sikundrë du-
hetë të flas.
5 Ecëni me urtësi mbë të-jashtësmitë, dyke
6 çpërblyerë kohënë. Fjala juaj letë jetë për-
herë me hir, me kripë ndrequrë, që të dini
qysh duhetë t'i përgjigjeni gjithë-sicilit.
7 Gjithë punërat'e mia dot' u'a rrëfenjë
juve Tiqiku, vëllaj i-dashurë, edhe punëtuar
besëtar, edhe shërbëtuar bashkë me mua
8 mbë Zotinë; Të-cilinë e dërgova ndër ju për
gjithë-këtë *punë*, që të marrë vesh punëratë
t'uaj, edhe të ngushullonjë zëmëratë t' uaj;
9 Bashkë me Onisiminë, besëtarin' edhe të-da-
shurinë vëlla, i-cili është prej jush; ata dot' u
rrëfenjënë juve gjithë të-këtushmetë.
10 U faletë juve me shëndet Aristarku robi
bashkë me mua, edhe Marku, i nip' i Varna-
vësë, (për të-cilinë muartë porosira; ndë
11 arthtë te ju, prit-e-ni *me të-mirë;*) Edhe Ji-
suj që thuhetë Just, të-cilëtë janë nga rreth-
presja; këta vetëmë janë bashkëpunëtorë
të mi ndë mbretërit të Perëndisë, të-cilët'
12 ubënë tek unë ngushullim. U faletë juve
me shëndet Epafraj që *është* prej jush, shër-
bëtuar i Krishtit, i-cili përpiqetë për ju gji-
thënjë ndë të-falurat, që të qëndroni të-so-
sur' edhe të mbushurë mbë çdo dashurim të

13 Perëndisë. Sepse *unë* dëshmonj për atë, se i
përvëlonetë shumë zëmëra për ju, edhe për
ata *që janë* ndë Laodhiqi, edhe për ata *që janë*
14 ndë Hierapolë. U faletë me shëndet juve
Lukaj, mjekësi i-dashurë, edhe Dhimaj.
15 Fal-u-ni me shëndet vëllezërvet që janë
ndë Llaodhiqi, edhe Nimfajt edhe kishësë *që*
16 *është* ndë shtëpit t'ati. Edhe si të këndonetë
karta ndër ju, bëni që të këndonetë edhe
ndë kishët të Llaodhiqiasvet; që të këndoni
edhe juve atë *që dot'u dërgonetë* prej Llaodhi-
17 qisë. Edhe tho-i-ni Arqippit, Ki kujdes ndë
shërbesët që more mbë Zotinë, që t'a mbushç
atë.
18 Të-faluritë me shëndet *ushkrua* me dorë-
në t'ime, të Pavlit. Kujtoni të-lidhurat'e mia.
Hiri *qoftë* bashkë me ju. Amin.

Karta e-Parë e apostollit Pavël mbë Thessallonikasitë.

Krye 1.

1 Pavli edhe Silluani edhe Timotheu, mbë
kishën'e Thessallonikasvet *që është* mbë Pe-
rëndinë, Atinë, edhe mbë Zotinë Jisu Krisht;
hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim prej Perëndi-
së, Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.
2 I falemi ndersë Perëndisë përherë për gji-

thë ju, edhe u kujtojmë juve ndë të-falurat
3 t'ona, Dyke kujtuarë pa pushim punën' e be-
sësë s'uaj, edhe mundimin' e dashurisë, edhe
durimin'e shpresësë mbë Zotinë t'ënë Iisu
Krisht, përpara Perëndisë edhe Atit t' ënë;
4 Sepse e dimë, o vëllezër të-dashurë prej Pe-
5 rëndisë, të-sgjedhuritë t'uaj. Sepse ungjilli ynë
nuk' ubë te ju me fjalë, po edhe me fuqi,
edhe me Frymë të-Shënjtëruarë, edhe me
shumë të-mbushurë të mëndjesë, sikundrë e
dini të-çfarëtë qemë ndë mest t'uaj për ju.
6 Edhe ju bëtë sikundrë bëmë neve edhe Zo-
ti, sepse e prittë fjalënë ndër shumë shtrën-
gim, *po* me gëzim të Frymës' së-Shënjtëru-
7 arë; Kaqë sa ubëtë shëmbëlla mbë gjith'
ata që besonjënë ndë Maqedhoni e ndë A-
8 hai. Sepse prej jush oshëtiti fjal'e Zotit, jo
vetëmë ndë Maqeðoni e ndë Ahai, po edhe
mbë çdo vënt arriti *zëri* i besësë s'uaj mbë
Perëndinë; kaqë sa neve s'kemi nevojë të
9 flasëmë gjë; Sepse vetë ata tregonjënë për ne,
ç'farë të-hyri patmë ndër ju, edhe qysh u-
kthyetë nga idhujtë te Perëndia, që t'i shër-
10 beni Perëndis' së-gjallë edhe të-vërtetë, Edhe
të prisni Birin' e ati nga qiejtë, të-cilin' e
ngjalli prej së-vdekurish, Jisunë, që na shpë-
ton nga zëmërimi që vjen.

Krye 2.

1 Sepse vetë ju e dini, o vëllezër, të-hyrë-

BKSH

2 të t'ënë ndër ju, se nuk' ubë mbë kot; Po si
hoqmë keq më përpara edhe ushamë, sikun-
drë e dini, ndë Filippë, muarmë kuxim mbë
Perëndinë t'ënë të flasëmë ndër ju ungjillin'
3 e Perëndisë me shumë të-përpjekurë. Sepse
mësimi ynë nukë *qe* prej të-gënjyeri, as prej
4 ndyrësire, as me kobim; Po sikundrë upro-
vuamë prej Perëndisë të besonemi ungjillinë,
kështu flasëmë, jo sikur t'u pëlqejmë njerës-
vet, po Perëndisë që provon zëmëratë t'ona.
5 Sepse as fjalë me lajka nukë përndormë
ndonjëhere, sikundrë e dini, as shkak lakmi-
6 mi; Perëndia është dëshmimtar; As kërkua-
më lavdi prej ŋerëzish, as prej jush, as prej
të-tjerësh, ndonëse muntnimë t'u bëneshimë
7 juve barrë, si apostoj të Krishtit *që jemi;* Po
qemë të-butë ndër mest t'uaj, posi mëndesa
8 *qe* ngroh ndë gjit bijt' e saj: Kështu dyke
pasurë dashuri të-nxehëtë për ju, na ka ënda
t'u apëmë juve jo vetëmë ungjillin' e Perën-
disë, po edhe shpirtetë t'anë, sepse qetë të-
9 dashurë ndër ne. Sepse e mbani mënt, o vëlle-
zër, të-lodhuritë t'ënë edhe mundimnë; sepse
dyke punuarë dit' e natë, që të mos i bëne-
mi barrë ndonjëj prej jush, lëçitmë ungjillin'
10 e Perëndisë te ju. Ju *jeni* dëshmimtarë edhe
Perëndia, se me shënjtëri e me drejtëri e pa
11 palavi kemi qënë mbë ju që besoni; Sikun-
drë e dini, se gjithë-sicilinë prej jush e ngut-
nim' edhe e ngushullonimë, si një atë bijt' e

BKSH

12 ti, edhe shtrënguarë *u* porositnimë, Që të ecë-
ni sikundrë vëjen te Perëndia, që u thërriti
juve ndë mbretërit e ndë lavdit të ti.
13 Përandaj edhe neve i falemi ndersë Pe-
rëndisë pa pushim, se kur muartë fjalën' e
Perëndisë që dëgjuatë prej nesh, e prittë *atë*
jo si fjalë njerëzish, po, (sikundrë është me
të-vërtetë), si fjalë Perëndie, e-cila *fjalë* ve-
14 përonetë ndër ju që besoni. Sepse ju, o vë-
llezër, bëtë sikundrë bënë kishët' e Pe-
rëndisë, që janë ndë Judhet mbë Iisu Krish-
tinë, sepse edhe ju pësuatë po ato punëra
prej njëkombasvet t'uaj, sikundrë edhe ata
15 prëj Judhenjvet; Të-cilëtë edhe Zotinë Jisu e
vranë *si* edhe profitërit' e tyre, edhe neve na
ndoqnë, edhe Perëndisë s'i pëlqenjënë, edhe
16 mbë gjithë njerëzitë janë kundrë; Të-cilëtë na
ndalonjënë t'u flasëmë kombevet që të shpë-
tonjënë, për të mbushurë fajet' e tyre përherë;
po arriti zëmërimi mbi ata gjer ndë funtt.
17 Po ne, o vëllezër, si uvarfëruamë nga ju
për pak kohë me faqe, jo me zëmërë, më
tepërë upërpoqmë me shumë mall të shohë-
18 më faqenë t'uaj. Përandaj deshmë të vijmë te
ju, (më fort unë Pavli,) edhe një herë edhe
19 dy herë, po na ndaloj Satanaj. Sepse cila
është shpresa jonë' a gëzimi, a kurora e të-
mburrurit? apo nukë *jeni* edhe ju përpara
Zotit t'ënë Jisu Krisht mbë të-ardhurit t'ati?
20 Sepse ju jeni lavdia jonë edhe gëzimi.

BKSH

Krye 3.

1 Përandaj, passi nukë muntmë të durojmë më,
e gjetmë për mirë të mbetemi të-vetëmë nd'
2 Athinë, edhe dërguamë Timothenë, vëllanë
t'ënë, edhe shërbëtuar të Perëndjsë, edhe shok-
në t'ënë ndë punët të ungjillit të Krishtit, që t'u
forçonjë e t'u ngushullonjë për besënë t'uaj;
3 Që të mos tundetë asndonjë ndë këta shtrën-
gime; sepse ju vetë e dini se për këtë jemi
4 vënë. Sepse, kur ishimë përanë jush, u tho-
shimë juve që përpara, se kemi për të hequrë
shtëngime, sikundrë edhe ubë, edhe e dini.
5 Përandaj edhe unë, passi s'duronjam *dot* më,
dërgova që të marr vesh për besënë t'uaj,
se mos u ngau ay që nget, edhe vejë mbë
kot mundimi ynë.
6 Po ndashti që erdhi Timotheu nga ju ndër
ne, edhe na pruri zën' e-mirë për besën' e
për dashurinë t'uaj, edhe se na kujtoni gji-
thënjë për të-mirë, edhe se kini mall të na
7 shihni, sikundrë edhe neve juve, Përandaj,
o vëllezër, me gjithë shtrëngimin' edhe nevo-
jënë t'ënë, ungusulluamë për ju, prej besësë
8 s'uaj; Sepse ndashti rrojmë, ndë qëndrofshi
9 ju mbë Zotinë. Sepse ç'farë të-faluri ndersë
munt t'i apënë Perëndisë për ju, për gjithë
gëzimnë që gëzonemi për ju përpara Perën-
10 disë t'ënë, Nat' e ditë dyke luturë fort tepërë
që të shohëmë faqenë t'uaj, edhe të mbush-
më të-metat' e besësë s'uaj?

BKSh

11 Po vetë Perëndia edhe Ati ynë, edhe Zo-
tj ynë Jisu Kisht, na drejtoftë udhënë te ju.
12 Edhe Zoti shtoftë edhe tepëroftë dashurinë
t'uaj njëri mbë tjatërinë edhe mbë të-gjithë,
13 sikundrë edhe neve kemi mbë ju; Për të for-
cuarë zëmëratë t'uaj pa pallavi ndë shënjtë-
rit, përpara Perëndisë edhe Atit t'ënë, ndë t'
ardhurit të Zotit t'ënë Jisu Krisht bashkë me
gjithë shënjorët' e ati.

Krye 4.

1 Së-pastajmi pra, o vëllezër, u lutemi juve
edhe u ngutmë me anë të Zotit Jisu, sikun-
drë muartë prej nesh se si duhetë të ecëni
edhe t'i pëlqeni Perëndisë, *kështu* të tepëroni
2 tepër' e më tepërë. Sepse e dini ç'farë poro-
3 sirash u lamë juve me anë të Zotit Jisu. Se-
pse ky është dashurimi i Perëndisë, shënj-
4 tërimi juaj, të hiqni dorë nga kurvëria; Të
dijë gjithë-sicili prej jush të mbanjë enën'e
5 ti me shënjtërim e me nder; Jo ndë pësim
dëshërimi, posi edhe kombetë që s'njohënë
6 Perëndinë. Të mos kapërxenjë ndonjë e
t'i bënjë keq të vëllajt mbë *këtë* punë; se-
pse Zoti *është* çpagimtar për gjithë këto, si-
kundrë edhe u thamë juve që përpara, edhe
7 me dëshmime u vërtetuamë. Sepse Perëndia
nukë na thirri ndë ndyrësirë, po ndë shënj-
8 tërim. Përandaj ay që heth tej *këto*, nukë

heth tej njeri, po Perëndinë, që na dha ne-
ve Frymën' e ti të-Shënjtëruarënë.
9 Edhe për dasurin' e vëllazërisë s'keni
nevojë t'u skuajmë juve; sepse ju vetë jeni
të mësuarë prej Perëndisë që të doni njëri
10 tjatërinë; Sepse edhe e bëni këtë mbë gjithë
vëλezëritë që janë ndë githë Maqedhonit. Po
u lutemi juve, o vëllezër, të tepëroni *mbë këtë*
11 tepër' e më tepërë; Edhe t'a kini për nder
të rrini urtë, e të shikoni punëratë t' uaj, edhe
të punoni me duartë t'uaj, sikundrë u poro-
12 sitmë juve, Që të ecëni ndër të-jashtësmit
sikundrë ka hije, edhe të mos keni nevojë
për asgjë.
13 Edhe nukë dua juve të mos dini, o vëllezër,
për ata që kanë flejturë, që të mos u vinjë keq,
sikundrë edhe të-tjerëvet që s'kanë shpresë.
14 Sepse ndë besojmë se Jisuj vdiq edhe ungjall,
kështu edhe Perëndia ata që kanë flejturë me
15 anë të Jisujt dot i bjerë bashkë me atë. Sepse
këtë u themi juve me fjalë të Zotit, se ne të-
gjallëtë që dotë mbetemi gjer mbë të ardhurit
të Zotit nukë dot' u'a arrijmë atyreve që kanë
16 flejturë; Sepse Zoti vetë dotë sbresë nga qie-
lli me urdhër, me zë ëngjëlli të-parë, edhe
me trumbetë Perëndie, edhe të-vdekuritë *që
vdiqnë* mbë Krishtinë dotë ngjallenë më përpa-
17 ra; Pastaj ne të-gjallëtë që dotë kemi mbeturë
dotë rrëmbenemi bashkë me ata ndër ret,
për të dalë përpara Zotit nd'erët; edhe kësh-

BKSh

18 tu dotë jemi përherë bashkë me Zotinë. Ngu-
shulloni pra me këto fjalë njëri tjatërinë.

Krye 5.

1 Edhe për motet'e për kohëratë, o vëlle-
2 zër, nukë keni nevojë t'u shkruanj juve; Se-
pse ju e dini hollë, se dita e Zotit, posi vje-
3 dhësi natënë, kështu vjen. Sepse kur thonë,
Paqtim edhe siguri, atëhere vjen mbi ata
humbje e-papandehurë, posi të-dhëmburatë
gruasë me barrë; edhe nukë dotë shpëtonjënë.
4 Po ju, o vëllezër, nukë jeni ndë errësirë, që
5 t'u arrinjë ajo ditë posi vjedhës. Të gjithë ju
jeni bij drite e bij dite; nukë jemi të natësë, as
6 të errësirësë. Letë mos flemë pra sikundrë
edhe të-tjerëtë, po letë rrimë sgjuarë edhe
7 letë jemi të-përmbajturë. Sepse ata që flenë,
natënë flenë; edhe ata që dehenë, natënë de-
8 henë; Po ne, pasi jemi të ditësë, letë për-
mbajmë vetëhenë, dyke veshurë thurakun'
e besës'e të dashurisë, edhe *për* përkrenare
9 shpresën' e shpëtimit. Sepse Perëndia nukë
na ka urdhëruarë për zëmërim, po për tra-
shëgim shpëtimi, me anë të Zotit t'ënë Jisu
10 Krisht, Që vdiq për ne, që, ose sgjuarë
11 jemi, ose flemë, të rrojmë bashkë me atë. Pë-
randaj ngushulloni njëri tjatërinë, edhe ndër-
toni njëri tjatërinë, sikundrë edhe bëni.
12 Edhe u lutemi juve, o vëllezër, t'i njihni
ata që mundonenë ndër ju, e janë mbi ju

BKSH

13 mbë Zotinë, edhe u këshillonjënë juve; Edhe
t'i nderoni me dashuri fort tepërë për punën'
e atyreve. Kini paqtim ndë mest t'uaj.
14 Edhe u lutemi juve, o vëllezër, këshilloni të-
prapëtë, ngushulloni zëmërë-pakëtë, ndih-u-ni
të-sëmurëvet, kini zemërë të-gjerë mbë gjithë.
15 Vështroni semos ndonjë i kthenjë ndonjëj
të-keqe për të-keqe; po kërkoni përherë të-
mirënë edhe te njëri tjatëri, edhe te të-gjithë.
16 Përherë gëzohi.
17 Pa pushim faluni.
18 Për çdo gjë epni të-falura ndersë; sepse
ky *është* dashurimi i Perëndisë për ju mbë
Jisu Krishtinë.
19 Mos shuani Frymënë.
20 Mos hithni poshtë profiti.
21 Të-gjitha provoni, të-mirënë mbani.
22 Hiqni dorë prej çdo farë së-lige.
23 Edhe vetë Perëndia i paqtimit u shënj-
tëroftë juve të-tërë; edhe uruajtë e-tërë fryma
juaj, edhe shpirti, edhe trupi, pa palavi ndë
24 të-ardhurit të Zotit t'ënë Jisu Krisht. Besëtar
ësht' ay që u thërret juve, i-cili edhe dot'a bënjë.
25 O vëllezër, fali për ne. (26) Përshëndetni
gjithë vëllezëritë me të-puthurë të-shënjtëru-
27 arë. U ve mbë be juve mbë Zotinë, të këndone-
të karta mbë gjithë vëllezërit' e-shënjtëruarë.
28 Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë* bash-
kë me ju. Amin.

BKSH

Karta e-Dytë e apostollit Pa-vel mbë Thessallonikasitë.

Krye 1.

1 Pavli edhe Silluani edhe Timotheu, mbë
kishën'e Tessallonikasvet, *që është* mbë Pe-
2 rëndinë, Atinë t'ënë, edhe mbë Zotinë Jisu
Krisht; Hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim nga Pe-
rëndia, Ati ynë, edhe nga Zoti Jisu Krisht.
3 Kemi detyrë t'i falemi ndersë përherë Pe-
rëndisë për ju, o vëllezër, sikundrë se vëjen,
sepse po shtonetë fort besa juaj, edhe da-
shuria e kujdo prej jush mbë njëri tjatërinë
4 po tepëron; Kaqë sa ne vetë mburremi për
ju ndë kishërat të Perëndisë, për durimnë
t'uaj edhe për besënë ndër gjithë të-ndje-
kurat t'uaj edhe ndër shtrëngimet që hiqni;
5 *E-cıla gjë është një* dëftim i gjyqit të-drejtë
të Perëndisë, që të bëhi ju të-vëjejturë për
mbretërin' e Perëndisë, për të-cilënë edhe vu-
6 ani. Sepse *ësht'* e-drejtë përpara Perëndisë' t'u
apë shtrëngim atyreve që u shtrëngoŋënë
7 juve; Po juve që shtëngohi, të prëjturë bash-
kë me ne, kur të duketë Zoti Jisu Krisht
prej qielli bashkë me ëngjëjt' e fuqis' së ti,
8 Ndë flakë zjarri, dyke bërë çpagim atyreve që
nukë njohënë Perëndi, edhe atyreve që nuk' i
9 bindenë ungjillit të Zotit t'ënë Jisu Krish; Të-
cilëtë dotë mundonenë me të-prishurë të-

BKSh

përjetëshm nga faqeja e Zotit, edhe nga lav-
10 dia e fuqis' s' ati, Kur të vinjë të lavduronetë
ndër shënjtoret të ti, edhe të bënet' i-çudiçim
ndër gjith'ata që besonjënë, (sepse ju i be-
suatë dëshmimit t'ënë,) nd' atë ditë.
11 Përandaj edhe *ne* falemi përherë për ju,
që t'u bënjë juve Perëndia ynë të-vëjejturë
për të-thërriturit' *e ti*, edhe të mbushnjë çdo pël-
qim të mirësis' *së ti*, edhe punën' e besësë me
12 fuqi; Që të lavduronetë emëri i Zotit t' ënë
Jisu Krisht ndër ju, edhe ju mb' atë, pas hi-
rit të Perëndisë t'ënë edhe të Zotit Jisu Krisht.

Kre. 2.

1 Edhe sa për të-ardhurit' e Zotit t'ënë Jisu
Krist, edhe për të-mbledhuritë t' ënë mb' atë,
2 u lutëmi juve, o vëllezër, Të mos tundi çpejt
nga mëndja *juaj*, as të mos trumbullohi as
prej fryme, as prej fjale, as prej karte sikur-
se *së-shkruarë* prej nesh, se sikur uafërua dit'
3 e Krishtit. Letë mos u gënjenjë juve ndonjë
as me ndonjë mënyrë; sepse *s'ka për të ar-
dhur'ajo ditë*, pa mos ardhurë më përpara të-
ngrituritë krye, edhe të sbulonetë njeriu i fa-
4 jit, i bir'i humbjesë, Ay që rri kundrë e ngri-
hetë lart kundrë çdo *farë gjëje* që thuhetë
Perendi a lutje, kaqë sa të rrijë ndë tempull
të Perëndisë si Perëndi, dyke deftyerë vetë-
hen'e ti se është Perëndi.
5 Nukë mbani mënt se, edhe kur ishnjam

6 përanë jush, u'a thoshnjam juve këto? Edhe
ndashti e dini atë që e ndalon *atë*, që të
7 sbulonetë ndë kohët të ti. Sepse fshehësira
e paudhësisë ndashti vepëronetë; vetëmë gjer-
sa te hiqetë nga mezi ay që e ndalon ndash-
8 ti; Edhe atëhere dotë sbulonetë i-paudhi, të-
cilinë Perëndia dot'a humbasnjë me frymën'
e gojës' së ti, edhe dot'a prishnjë me të-duku-
9 rit' e të-ardurit të ti; Ky *i-paudhë* dotë vinjë
pas vepërimit të Satanajt me çdo fuqi e me
10 shënja e me çudira gënjeshre, Edhe me çdo
kobim të shtrëmbërisë, ndër mest t'atyre që
humbenë; sepse nukë pritnë dashurin' e së-
11 vërtetësë që të shpëtonjënë. Edhe përandaj
Perëndia dot'u dërgonjë atyre vepërim kobi-
12 mi, që t'i besonjënë gënjeshtësë; Qe të dënc-
nenë gith' ata që nuk' i besuanë së-vërtetësë,
po pëlqyenë shtëmbërinë.
13 Po neve kemi detyrë t'i falemi ndersë Pe-
rëndisë përherë për ju, o vëllezër të-dashu-
rë prej Zotit, se Perëndia u sgjodhi juve që
ndë kryet për shpëtim me anë të shënjtëri-
mit të Frymësë, edhe me anë të besësë mbë
14 të-vërtetënë, Ndë të cilët u thirri juve me a-
në të ungjillit t'ënë, për të fituarë lavdin' e
Zotit t'ënë Jisu Krisht.
15 Përandaj pra, o vëllezër, qëndroni, edhe
mbani ato porosi që umësuatë, a me anë
16 fjale, a me anë karte prej nesh. Edhe vetë
Zoti ynë Jisu Krist, e Perëndia edhe Ati ynë'

BKSh

i-cili na deshi e *na* dha ngushullim të-për-
jetëshm edhe shpresë të-mirë me anë të hi-
17 rit, Ngushulloftë zëmëratë t'uaj e u forcof-
të mbë çdo fjalë e punë të-mirë.

Krye 3.

1 Mbë ndë funtt, o vëllezër, fali për ne
që të mbrothësonjë me të-çpejtë fjala e Zo-
tit edhe të lavduronetë, sikundrë edhe ndër
2 ju, Edhe që të spëtojmë nga njerëzit e-kotë
e të-liq; sepse besa nuk'është ndër të-gjithë.
3 Po Zoti është besnik, i-cili dot'u forconjë
4 juve e dot u ruanjë prej të-ligut. Edhe kemi
të-besuarë mbë ju me anë të Zotit, se ato
që u porositmë juve, edhe i bëni, edhe dot' i
5 bëni. Edhe Zoti drejtoftë zëmëratë t' uaj ndë
dashurit të Perëndisë, edhe ndë durimt të
Krishtit.
6 Edhe u porositimë juve, o vëllezër, mbë e-
mërë të Zotit t'ënë Jisu Krisht, të mërgohi
nga çdo vëlla që ecën pa ment,e jo pas poro-
7 sisë që mori prej nesh. Sepse juve e dini qysh
duhetë të bëni si bëjmë neve; sepse nuk' u
8 suallmë si të-marrë ndër ju, As dhurëti hën-
grëmë bukë prej ndonjëj, po me të-lodhur' e
me mundim, dyke punuarë nat' e ditë, që të
9 mos i bëneshimë barrë ndonjëj prej jush; Jo
se s'kemi pushtet, po që t'u apëmë juve ve-
tëhenë t'ënë për shëmbëllesë që të bëni si
10 bëjmë neve. Sepse edhe kur ishimë ndër ju

këtë u porositnimë juve, se ndë mos do ndo-
11 një të punonjë, as të mos hajë. Sepse dëgjoj-
më se ca veta ndër ju ecënjënë jo si duhetë,
edhe se s' punonjënë fare, po sillen' andej e
këtej pa ndonjë punë, dyke umarrë me pu-
12 nëra të-huaj. Të-këtillëtë i porositimë e i
ngutimë me anë të Zotit t' ënë Jisu Krisht, që
dyke punuarë me pushim të hanë bukën' e
tyre.
13 Po ju, o vëllezër, mos ulothni dyke bërë
14 mirë. Edhe ndë qoftë se ndonjë nukë i dë-
gjon fjalësë s'anë me anë të *kësaj* karte, shë-
no-e-ni atë; edhe mos shoqëroni me atë, që
15 të turpëronetë. Po mos e vështroni atë si ar-
mik, po këshillo-e-ni si vëlla.
16 Edhe vetë Zoti i paqtimit u dhëntë juve
paqtiminë kurdo me çdo mënyrë. Zoti *qoftë*
me ju të-gjithë.
17 Të-fallurítë me shëndet *ushkrua* me do-
rënë t' ime, te Pavlit, që është shënjë mbë çdo
kartë; kështu shkruanj: Hiri i Zotit t'ënë Jisu
Krish *qoftë* bashkë me ju të-gjithë. Amin.

BKSH

Karta e-Parë e apostollit Pavël mbë Timothenë.

Krye 1.

1 Pavli, apostoll i Jisu Krishtit, pas urdhë-
rit të Perëndisë, shpëtimtarit t'ënë, edhe të
2 Zotit Jisu Krisht, shpresësë s'onë, Mbë Timo-
thenë, të-thjeshtinë djalë mbë besët, *qoftë* hir,
përdëllim, paqtim, prej Perëndisë, Atit t'ënë,
edhe prej Jisu Krishtit, Zotit t'ënë.
3 Sikundrë t'uluçë, kur vinja për ndë Ma-
qedhoni, të preç ndë Efesë, që të porosiç ca
4 veta të mos mësonjënë mësime të-tjerë, As
të mos u vënë vesh përrallave e brezave që
s'kanë të-mbaruarë, të-cilatë bjenë qarta më
tepërë se të-ndërtuarë ndë besët të Perën-
disë, *kështu bëj*.
5 Edhe fundi i porosisë është dashuri prej
zemëre së-kthjellëtë, edhe prej ndërgjegjeje
6 së-mirë, edhe prej bese pa ipokrisi; Prej të-
cilavet *ca veta* ularguanë e ukthyenë ndë fja-
7 lë të-kota, Dyke dashurë të jenë nom-mëso-
njës, ndonëse s' kupëtonjënë as ato që thonë,
8 as ato që i bënjënë për të-vërteta. Edhe e
dimë, se nomi *ësht'* i-mirë, ndë qoftë [se e
9 përndor atë njeriu me udhe, Dyke diturë këtë,
se nomi nuk' është vënë për të-drejtinë, po
për të-paudhët' e për të-pabinduritë, për ata
që s'druanjënë *Perëndinë* e për fajtorëtë, për

të-shtrëmbërit'e për të-ndyrëtë, për atëvra-
10 sësit' e mëmëvrasësitë, për njerivrasësitë, Për
kurvarëtë, për ata që bjenë me meshkuj, për
ata që shesënë njerës, për gënjeshtarëtë, për
ata që shkelnjënë benë, edhe për ç'do gjë tje-
tërë që i del kundrë mësimit të-shëndoshë,
11 Pas ungjillit të lavdis' së të-lumurit Perëndi,
që m'u besua mua.
12 Edhe i falem ndersë Jisu Krishtit, Zotit t'
ënë, që më dha fuqi, se më numëroj për besë-
13 tar, e më vuri ndë shërbesët mua, Që më përpa-
ra ishnja vllasfimitar, e ndjekës e sharanik;
po upërdëllyeshë, sepse pa diturë i bëra ndë
14 pabesëri; Edhe hiri i Zotit t'ënë tepëroj *mbë
mua* me besë e me dashuri që është mbë Jisu
15 Krishtinë. Për të zënë besë është fjala edhe
e-vëjyerë për të priturë, se Jisu Krishti er-
dhi në botët që të shpëtonjë fajtorë, prej të-
16 cilëvet i-pari jam unë; Po përandaj upër-
dëllyeshë, që të dëftenjë Jisu Krishti më për-
para tek unë gjithë zëmërën' e-gjerë, për
shëmbëllë mbë ata që i kanë për të besuarë
17 ati për jetë të-përjetëshme. Edhe mbë mbre-
tin' e jetëvet, të-pavdjerinë, të-padukurinë,
të-vetëminë (të-diturë) Perëndi, *qoftë* nder
edhe lavdi ndë jetët të jetëvet. Amin.
18 Këtë porosi po të lë ndë dorë tyj, o bir
Timothe, pas profitivet që ufolnë më përpa-
ra për ty, të luftonjç pas atyreve luftën' e-
19 mirë, Dyke pasurë besë edhe ndërgjegje të-

BKSH

mirë, të-cilënë ca dyke hedhurë tej ranë ja-
20 shtë nga besa; Prej këtyreve është Ymeneu
edhe Aleksandri, të-cilëtë i kam dhënë ndë
dorët të Satanajt, që të-mësonenë të mos
vllasfimisnjënë.

Krye 2.

1 Lutem pra më përpara nga të-gjitha të
bënenë të-lutura, të-falura, të-folura, të-fa-
2 lura ndersë, për gjithë njerëzitë, Për mbretër,
për gjithë sa janë mbë shkallë të-lartë, që të
shkojmë jetë të-qet' e të-siguruarë me çdo
3 perëndi-ndrojtje e mënyrë të-hieshime. Sepse
këjo *ësht'* e-mir' edh'e-pëlqyerë përpara Pe-
4 rëndisë, shpëtimtarit t'ënë, I-cili do të shpëto-
njënë gjithë njerëzitë, edhe të vinjënë ndë të-
5 njohurit të së-vërtetësë. Sepse një është Pe-
rëndia, një *ësht'* edhe mesësi ndër mest të-
Perëndisë edhe të njerësvet, njeriu Jisu Krisht,
6 Që dha vetëhen' e ti çpërblim për të-gjithë,
7 *për* dëshmim ndë kohëra të-urdhëruara, Për
të-cilinë *dëshmim* uvushë unë lëçitës edhe
apostoll, (të-vërtetënë them mbë Krishtinë,
nukë gënjenj,) mësonjës i kombevet ndë be-
sët edhe ndë të-vërtetët.

8 Dua pra burratë të falenë mbë çdo vënt,
dyke ngriturë duar të pastrëta, pa zëmërim
9 e pa dyshim. Gjithashtu edhe gratë letë sto-
lisnjënë vetëhen' e tyre me rrobë të-hieshime,
me turp e me urtësi, jo me gërsheta, a me

ar, a me margaritarë, a me rroba shumë të-
10 vëjyera; Po me punëra të-mira, (e-cila gjë
u ka hie atyre grave që tregonenë për pe-
11 rëndindruanjëse). Gruaja letë mësonetë ndë
12 pushim me çdo farë të-binduri; Sepse gru-
asë nuk' i ap lejë të mësonjë *të-tjerë*, as
13 të jetë zot mbi burrinë, po të pushonjë. Se-
14 pse përpara ugatua Adhami, pastaj Eva. E-
dhe Adhami nuk' ugënjye, po gruaja ugënjye
15 e dolli jasht' udhësë; Po dotë spëtonjë me
anë të të-pjellit fëmijë, ndë qoftë se *këta*
qëndronjënë ndë besët e ndë dashurit e ndë
shënjtërimt me urtësi.

Krye 3.

1 Për të zënë besë është fjala; Ndë deshë-
ron ndonjë të bënet' episkop, punë të-mi-
2 rë dëshëron. Duhetë pra episkopi të jetë i-
pazënë ndë faj, burrë i një gruaje, vetë-për-
mbanjës, i-urtë, i-hieshim, huaj-pritës, i-zoti
3 të mësonjë *njerëzitë*; Jo pianik, jo grindës,
(jo i-dhënë pas fitimi të-keq); po i-butë, *njeri*
që s' do të zihetë, *njeri* që s' lakmon për
4 ergjënt; *Njeri* qe qivernis mirë shtëpin' e ti,
që ka fëmijë të-bindurë me çdo farë urtë-
5 sie; (Sepse ndë qoftë se ndonjë nukë di të
qivernisnjë shtëpin' e ti, qysh dotë kujdesetë
6 për kishën' e Perëndisë?) Të mos jetë më-
suarë rishtazi *ndë besët*, që të mos fryhetë
me madhështi e të bjerë ndë dënimt të dja-

7 llit. Duhetë edhe të ketë dëshmim të-mirë
edhe nga të-jashtësmitë që të mos bjerë ndë
turp e ndë lakt të djallit.

8 Dhjakëritë gjithashtu, *duhetë të jenë* të-
hieshim, jo me dy faqe ndë fjalët, jo të-dhë-
nurë ndë shumë verë, jo të-rënë pas fitimi
9 të-lik; Të kenë fshehësirën'e besësë me ndër-
10 gjegje të-kthjellëtë. Edhe këta letë provone-
në më parë, *e* pastaj letë bënenë dhjakër, ndë
qoftë se nukë hiqenë ndëpër gojë për fajtorë.
11 Grat'*e tyre* gjithashtu *të jenë* të-hieshime, jo
kallzimtare, vete-përmbanjëse, besëtare mbë
12 të-gjitha. Dhjakëritë letë jenë burra të një
gruaje,edhe asish që qiverisnjënë mirë fëmi-
13 jën' e tyre e shtëpit'e tyre Sepse ata që kanë
shërbyerë mirë, fitonjënë shkallë të-mirë për
vetëhen' e tyre, edhe shumë kuxim ndë be-
sët që është mbë Jisu Krishtinë.

14 Këto po të shkruanj, dyke shpëryerë të
15 vinj për-së-çpejti te ti; Po ndë mënofsha, që
të dish si duhetë të sillesh ndë shtëpit të Pe-
rëndisë, e-cila është kisha e Perëndis' së-
gjallë, shtylla edhe pshtetja e së-vërtetësë.

16 Edhe pa kundrëfjalë e-madhe është fshe-
hësira e besësë; Perëndia uçfaq ndë mish,
dolli i-drejtë ndë Frymët, uduk nd' ëngjëj, u-
lëçit ndër kombe, uzu besë ndë botët, hipi
lart me lavdi.

Krye 4.

1 Edhe Fryma çfaqurë thotë, se ndë kohëra
të-pastajme dotë ngrenë krye ca *veta* nga
besa, e dot' u mbanjënë vesh frymave gënje-
2 shtare, edhe mësimeve djajsh, Qe flasënë
gënjeshtra me ipokrisi, që kanë ndërgjegjen'
3 e tyre të-djegurë, Të-cilëtë ndalonjënë mar-
tesënë, e *urdhëronjënë* të largonenë *besë-
tarëtë* nga të-ngrëna, të-cilatë Perëndia i ka
kriuarë, që t' i marrënë me të-falurë nder-
së besëtarëtë edhe ata që kanë njohurë të-
4 vertetënë. Sepse çdo kriesë e Perëndisë *ësht'*
e-mirë, edhe nukë ka gjë për te hedhurë tej,
5 po të merretë me të-falurë ndersë; Sepse
shënjtëronetë me fjalën' e Perëndisë e me
të-faluritë.
6 Ndë u sjellç ndër mëntt vëllezërvet këto,
dotë jesh shërbëtuar i-mirë i Jisu Krishtit,
i-ushqyerë me fjalet' e besësë, edhe me
7 mësimn' e-mirë, qe i ke rënë pas. Edhe prej
fjalëvet të-ndyra edhe të plakavet hiq dorë,
edhe stërvit vetëhenë t' ënde ndë besët të-
8 mirë. Sepse të-stërviturit' e trupit është të-
dobishim për pak kohë; po besa e-mirë së-
gjithash ësht' e-dobishime, sepse ka të-zo-
tuarë për këtë jetë ndashti edhe për atë që
9 ka për të ardhurë. Për të zënë besë është
fjala edhe e-vëjyerë për të-priturë *të-mirë.*
10 Sepse për këtë edhe mundonemi edhe përbu-

BKSH

zemi, sepse shpëryemë mbë të-gjallinë Perën-
di, i-cili është shpëtimtari i gjithë njerës-
11 vet, po më fort i besëtarëvet. —Porosit këto
edhe mëso.
12 Asndonjë letë mos të hethnjë poshtë për
të-ritë t'ënt, po bënu shëmbëllë e besëtarë-
vet ndë fjalë, ndë të-shoqëruarë, ndë da-
shuri, (ndë frymë,) ndë besë, ndë *zëmërë* të-
13 qëruarë. Gjersa të vinj, epu pas të-këndua-
14 rit, pas të-këshilluarit, pas të-mësuarit. Mos
jij i-pakujdesurë për dhurëtinë që është te
ti, e-cila t'udha me anë profitie, me të vënit'
15 eduarvet të pleqësisë *mbë ty*. Mbë këto kujde-
su, mbë këto qëndro, që të jetë e-çfaqurë mba-
16 rësia jote mbë të-gjithë. Ruaj vetëhenë t'ënde
edhe mësimnë; qëndro mb' ato. Sepse ndë
bëfsh këtë, edhe vetëhenë t'ënde dotë shpë-
tonjç, edhe ata që të dëgjonjënë ty.

Krye 5.

1 Plakunë mos e qërto, po mëso-e posi a-
2 të; të-rinjtë, posi vëllezër; Plakatë, posi më-
ma; të-ratë, posi motëra, me çdo *zëmërë* të-
qëruarë.
3 *Grat'* e-va ndero-i, ato që janë me të-vër-
4 tetë të-va. Edhe ndë ka ndonjë e-ve djem a
nipër, letë mësonjënë më përpara shtëpin' e
tyre të kenë besë të-mirë, edhe t'u apënë çpa-
gime prindërvet *të tyre*; sepse këjo ësht'e-mirë
5 edhe e-pëlpyerë përpara Perëndisë. Edhe ajo

që është me të-vërtetë e-ve edhe *ka mbeturë*
e vetëmë shpren mbë Perëndinë, edhe qën-
dron ndë të-luturat e ndë të-falurat nat'e ditë;
6 Po ajo që prish shumë për dëfrime, ndo-
7 nëse rron, ka vdekurë. Edhe këto porosit, që
8 të mos zihenë gojë për të-liga. Po ndë qoftë
se ndonjë nukë mendonetë më përpara për
të-titë, edhe më fort për ata të shtëpis' së
ti, ky ka mohuarë besënë, edhe është më i-
lik se i-pabesi.
9 E-ve më pak se gjashthë-dhjetë vjeç letë
mos vihetë ndë numërët *të të-vavet, edhe* të
10 ketë qënë grua e një burri, Edhe të ketë
dëshmim për punëra të-mira; ndë ka rritu-
rë fëmijë, ndë ka priturë të-huaj, ndë ka larë
këmbë shënjtorësh, ndë u ka ndihurë aty-
reve që kanë qënë ndë shtrëngim, ndë ka
11 rënë prapa çdo farë pune së-mirë. Po hiq dorë
nga të-vatë më të-ra; sepse si të mërzitenë nga
12 Krishti, duanë të-martonenë; Dyke pasurë
dënimn' *e tyre*, sepse shkelnë besën e-parë.
13 Edhe mbë gjithatë kohë mësonenë dyke
vaturë shtëpi mbë shtëpi të jenë përtacka;
edhe jo vetëmë përtacka, po edhe fjalë-shu-
ma e kërkimsore, dyke folurë ato s'gjan
14 *të flasënë.* Dua pra të-ratë të martonenë, të bë-
njënë djem, të bënenë zonja shtëpie, të mos
i apën' asndonjë shkak armikut për të folurë
15 keq. Sepse ca nga ato ndashti janë kthyerë
16 prapa Satanajt. Ndë qoftë se ndonjë besëtar

a besëtare ka *gra* të-va, let' u apënë atyre
të nevojshimetë, edhe letë mos ngarkonetë
kisha, që *të muntnjë* t' u ndihnjë atyreve që
janë me të-vërtetë të-va.
17 Pleqtë *e kishësë* që shikonjënë mirë pu-
nënë letë ndëronenë dy herë më tepërë, më
fort ata që mundonenë me fjalë e me më-
18 sim. Sepse shkronja thotë, „Nukë dotë mbyllç
gojën' e kaut që shin;“ edhe, „I-vëjyerë *është*
19 punëtori për pagën' e ti“. Mos prit kallëzim
kundrë plaku, veç përpara dy a tre dësh-
20 mimtarëve. Ata që fëjenjënë qërto-i përpara
të-gjithëve, që të kenë frikë edhe të-tjerëtë.
21 Të urdhëronj përpara Perëndisë, edhe Zotit
Iisu Krisht, edhe ëngjëjvet të-sgjedhurë, t'i
ruanjç këto pa bërë të-çquarë ndë mest nje-
riu e njeriu, e asgjë të mos bëjnjç me të-mbaj-
turë anë.
22 Mos vërë duar me të-çpejtë as mbi ndo-
një, as mos ubëj pjesëtar ndër faje të-huaj;
23 ruaj vetëhenë t'ënde të-qëruarë. Mos pi më
ujë, po përdor pakëzë verë për stomakunë
t'ënt e për sëmundjet' e tua të-dëndura.
24 Ca njerësve fajetë u dukenë faqeza, edhe
shkonjënë përpara *atyreve* ndë gjyq; po ca
25 *të-tjerëve* u venë prapa. Gjithashtu edhe pu-
nërat' e-mira janë të-çfaqura; edhe ato që
janë tjetrazi nukë munt të fshihenë.

BKSH

Krye 6.

1 Sa janë robër ndënë sgjedhë, let' i numë-
ronjënë zotërinjt' e tyre të-vëjyerë për çdo farë
nderi, që të mos shahetë emër' i Perëndisë
2 edhe mësimi. Edhe ata që kanë zotërinj be-
sëtarë, letë mos i bënjënë për asgjë, sepse
janë vëllezër; po më shumë let' *u* punonjënë,
sepse janë besëtarë edhe të-dashurë ata që
shohënë dobi nga pun' *e atyre* e-mirë. Këto
mëso edhe këshillo.
3 Edhe ndë mëson ndonjë mësime të-tjerë, e-
dhe nukë vete pas fjalëvet të-shëndosha të
Zotit t'ënë Jisu Krisht, edhe pas mësimit që
4 është pas besës' së-mirë, *Ky* është madhë-
shtuar, edhe nukë di asgjë, po vuan prej
sëmundjeje për çështje e për të-ngrëna me
fjalë, prej të-cilavet del çmir, qartë, të-shara,
5 mendime të-liq, Fjalime të-kotë të-njerësve
të-prishurë nga mëndja, edhe të-cilëvet u
shteret' e-vërteta, sepse pandehnjënë, se bes'
e-mirë është *për* fitim. Mërgohu nga të-tillëtë.
6 Po fitim i-math është bes'e-mirë me mbastim
7 mbë të-pakët. Sepse as gjë s'kemi prurë ndë
botët; edhe ësht' e-ç'faqurë se edhe të nxjerimë
8 gjë nukë mundimë. Po kur kemi ushqime e
9 të-mbuluara, letë na mbastonjënë këto. Po
ata që duanë të bënenë të-pasurë, bjenë ndë
ngasje edhe ndë lak, edhe ndë shumë dëshëri-
me të-marrë e të-dëmçim, të-cilëtë i kredhënë

10 njerëzitë ndë prishje e ndë humbje. Sepse
rrënja e gjithë të-ligavet është ergjëndashja;
të-cilënë ca dyke dëshëruarë uaratisnë nga
besa, edhe e depërtuanë vetëhen' e tyre me
shumë të-këqia.
11 Po ti, o njeriu i Perëndisë, hiq dorë nga kë-
to; edhe ndiq drejtëri, të-ndrojturë nga Pe-
12 rëndia, besë, dashuri, durim, butësirë. Lufto
luftën' e-mirë të besësë, rrok jetën'e përje-
tëshme, ndë të-cilët edhe uthirrë, edhe rrëfe-
ve rrëfimin' e mirë përpara shumë dëshmim-
13 tarëve. Të porosit përpara Perëndisë që u
ep jetë të-gjithave, edhe përpara Jisu Krish-
tit që dëshmoj ndë ditët të Pont Pillatit
14 rrëfimin' e-mirë, Të ruanjç porosinë të-pafë-
lliqurë, pa palavi,gjer mbë të-dukurit të Zo-
15 tit t'ënë Jisu Krisht, Të cilëtë ndë kohë të-ur-
dhëruara dot' a dëftenjë i-lumuri edhe i-ve-
tëmi Fuqitar, Mbreti i atyreve që mbretëro-
16 njënë edhe Zoti i atyre që zotëronjënë, Ay që
i-vetëmë ka pavdekje, edhe që rri ndë dritë
të-paafëruarshime, të-cilinë asndonjë nga nje-
rëzitë nuk' e pa, as munt t'a shohë; mbë
të-cilinë *qoftë* nder e pushtet i-përjetëshm.
Amin.
17 Të-pasuritë ndë këtë jetë porosit-i të mos
mbahenë mbë të-math, as të mos shprenjënë
ndë pasjet që s'qëndron *ndë një vënt*, po mbë
Perëndinë e gjallë, i-cili na ep të-gjitha dorë-
18 hapurë për të parë dobi; Të punonjënë pu-

nëra të-mira, të bënenë të pasurë ndë punëra
të-mira, të jenë dorë-dhënës, të-shoqëruar-
19 shim, Dyke vënë *kështu* me pasje të-madhe
për vetëhen' e tyre një themeli për të-prit-
menë, që të arrinjënë jetën' e-përjetëshme.
20 O Timothe, ruaj ndorjenë, dyke ulargu-
arë nga të-ndyratë fjalë të-kota, edhe nga
kundrë-fjalët' e diturisë që mbë të-rrem qu-
21 hetë *kështu*; Të-cilënë ca dyke pasurë për
mjeshtëri ranë jashtë nga besa. — Hiri qoftë
me ty. Amin.

Karta e-Dytë e apostollit Pavël mbë Timothenë.

Krye 1.

1 Pavli, apostoll i Jisu Krishtit me anë të
dashurimit të Perëndisë, pas të-zotuarit të
2 jetësë që është mbë Jisu Krishtinë, Mbë Ti-
mothenë, birin' e-dashurë, *qoftë* hir, përdë-
llim, paqtim prej Perëndisë, Atit, edhe prej
Jisu Krishtit, Zotit t' ënë.
3 I falem ndersë Perëndisë, të-cilin' e lus
që nga prindërit' *e mi* me ndërgjegje të-kthje-
llëtë, se pa pushim të kujtonj ndë të-falu-
4 rat të mia nat' e ditë, Edhe se, kur kujtonj lott'
e tu, kam mall të të shoh, që të mbushem
5 me gëzim; Sepse bje ndër mëntt besënë t'ën-
de pa ipokrisi që është te ti, e-cila më për-

para ndënjti te jot' gjyshe Lloidhë, edhe te
jot' ëmë Evnikë; edhe më është mbushurë
mëndja *se ka ndënjurë* edhe te ti.
6 Për këtë ngajë të përmënt ty të ngjallç
përsëri dhurëtin' e Perëndisë, e-cila është te
ti me anë të të-vënit të duarvet të mia mbi
7 ty. Sepse Perëndia s'na ka dhënë frymë frike,
po fuqie e dashurie e urtësisë.
8 Mos kij turp pra për dëshmimn' e Zotit
t'ënë, edhe për mua të lidhurin' e ati; po hiq
keq bashkë me mua për ungjillinë pas fu-
9 qis' së Perëndisë: I-cili na shpëtoj, edhe na
thërriti me të-thërtiturë të-shënjtëruarë, jo pas
punëravet t'ona, po pas vendimit të ti, edhe
pas hirit që na udha mbë Jisu Krishtinë që
10 përpara kohëravet të-përjetëshme, Edhe që
uçfaq ndashti me anë të të-dukurit të-shpë-
timtarit t'ënë Jisu Krisht, i-cili prishi vdekje-
në, edhe nxori ndë dritë jetën' edhe pavdekjenë
11 me anë të ungjillit. Për kët uvushë unë lë-
çitës edhe apostol edhe mësonjës i kombe-
12 vet; Për të-cilënë punë edhe pësonj këto; po
nukë kam turp; sepse e di kujt i kam besu-
arë, edhe më është mbushurë mëndja, se ay
munt të ruanjë ndorjenë t'ime gjer mb' atë ditë.
13 Ruaj formën' e fjalëvet të-shëndosha, që
dëgjove prej meje, me besë e me dashuri që
14 është mbë Jisu Krishtinë. Ndorjenë e-mirë ru-
aj-e me anë të Frymës' së-Shënjtëruarë që rri
ndër ne.

15 *Ti* e di këtë, se gjith' ata që janë nd' Asi
më kthyenë krahëtë, prej të-cilëvet është Fy-
16 gjelli edhe Hermogjeni. Zoti dhëntë përdë-
llim ndë shtëpit të Onisiforit; sepse shumë
herë më dha zëmërë, edhe s'pat turp prej he-
17 kuravet të mia, Po kur erdhi ndë Romë, më
18 kërkoj me shumë nxitim, edhe *më* gjeti. Zoti
i dhëntë ati të gjenjë përdëllim nga Zoti nd'
atë ditë. Edhe sa më shërbeu nd' Efesë, ti i
di më mirë.

Kre. 2.

1 Ti pra, o biri im, forcohu ndë hirt që
2 është mbë Jisu Krishtinë; Edhe sa dëgjove
prej meje me shumë dëshmimtarë, ep-i ndër
duar të njerësve besëtarë, të-cilëtë dotë
3 jenë të-zottë të mësonjënë edhe të-tjerë. Ti
pra vuaj posi ushtëtar i-mirë i Jisu Krish-
4 tit. Sepse asndonjë që vete ushtëtar nukë
ngatëronetë me punërat e të-rrojturit, që t'i
5 pëlqenjë ati që e mori ushtëtar. Po ede ndë
luftoftë ndonjë, nukë kurorëzonetë, ndë mos
6 luftoftë pas nomit. Bujku që mundonetë du-
7 hetë i-parë të-marrë pjesë nga pemëtë. Ku-
pëto ato që them; edhe Zoti të dhëntë mënt
8 mbë të-gjitha. Ki ndër mëntt Jisu Krishtinë
nga far' e Dhavidhit që është ngjallurë prej
9 së-vdekurish, pas ungjillit t'im; Për të-cilinë
vuanj gjer mbë të-lidhura posi keq-bërës;
10 po fjal' e Perëndisë nukë lidhetë. Përandaj

BKSH

të-gjitha i duronj për të-sgjedhuritë, që të
gjenjën' edhe ata shpëtimnë që është mbë
Jisu Krishtinë, bashkë me lavdi të-përjetë-
11 shme. Për të zënë besë është *këjo* fjalë; se-
pse ndë vdiqmë bashkë *me Krishtinë*, kemi
12 edhe për të rruarë baskë *me atë*; Ndë durof-
shimë, kemi edhe për të mbretëruarë bashkë
me atë; ndë *e* mohofshimë, edhe ay dotë na
13 mohonjë; Ndë dalçimë të-pabesë, ay mbetetë
besëtar; nukë munt të mohonjë vetëhen'e ti.
14 Këto u'a bjerë ndër mëntt, dyke porosi-
turë ata përpara Zotit, të mos hahenë me
fjalë, *e-cila gjë s' është* për asgjë e-dobishi-
me, *po* për prishje t'atyre që dëgjonjënë.
15 Kujdesu t'a nxjerç vetëhenë t' ende të-pro-
vuarë përpara Perëndisë, punëtuar faqe-bar-
dhë, që pret drejtë fjalën' e së-vërtetësë.
16 Edhe largohu nga të-udyratë fjalë të-kota;
17 sepse stonjënë më shumë pabesëri; Edhe
fjal' e atyreve ka për të ngrënë posi qimezë;
18 nga këta është Hymenaj edhe Filiti, Të-
cilëtë duallë jashtë udhës' së të-vërtetësë.
dyke thënë, se ndashti ubë të-ngallluritë; edhe
përmbysnjënë besën' e cave.
19 Po themeli' e-fortë e Perëndisë qëndron,
edhe ka këtë vulë: Zoti njeh ata që janë të-
titë; edhe, Letë largonetë nga shtrëmbëria
kushdo që zë n' gojë emërin' e Krishtit.
20 Edhe ndë *një* shtëpi të-madhe nukë ka
vetëm' enë të-arta e të-ergjënta, po edhe të-

drunjta e të-baltta; e ca *duhenë* për *punë* të-
21 nderçime, e ca për *punë* te-panderçime. Ndë
qëroftë pra ndonjë vetëhen' e ti nga këto, dotë
jetë enë për nder, e-shënjtëruarë, edhe e-
vëjyerë per të zonë, e-bërë gati për çdo punë
të-mirë.
22 Edhe largohu nga dëshërimet' e djalërisë;
edhe bjer'i pas drëjterisë, besësë, dashurisë,
paqtimit bashkë me ata që thërresënë mbë
23 Zotinë prej zëmëre së-kthjellëtë. Edhe hiq
dorë nga të-marrat'e të-padiçimetë të-ngrëna
me fjalë, dyke diturë se *ato* pjellënë të-zëna.
24 Edhe shërbëtor' i Zotit nukë duhetë të zi-
hetë, po të jet'i-butë mbë të-gjithë, i-zoti të
mësonjë *njerëzitë*, *njeri* që duron të-ligënë,
25 *Njeri* që mëson me butësirë ata që kanë men-
dime te-kundrejtë, *edhe kështu* mbase u ep
atyreve Perëndia pendim, që të njohënë të-
26 vërtetënë, Edhe të shpëtonjenë nga laku i
djallit, prej të-cilit janë zënë robër ndë da-
shurimt t' ati.

Krye 3.

1 Edhe dij-e këtë, se ndë ditt të-pastajme
2 kanë për të ardhurë kohëra të-këqia; Sepse
njerëzitë dotë jenë vetëdashës, ergëntdashës,
krye-lartë, madhështorë, vllasfimitarë, të-pa-
bindurë nde prindërit, mos-mirënjohës, të-
3 paudhë, Të-padhëmçurë, të-papaqtuarshim,
kallëzimtarë, të-pambajturë, të-egërë, t' atillë

BKSh

4 që s' duanë të-mirënë, Trathëtorë, gojë-sbra-
zëtë, të-fryjturë, kënaqëdashës me tepërë
5 se perëndidashës, Të-cilëtë kanë të-dukurë
bese së-mirë, po fuqin' e asaj e kanë mohu-
6 arë; edhe nga këta largohu. Sepse prej kë-
tyrë jan' ata që hynjënë ndëpër shtëpirat,
edhe skllavosnjënë gratë që janë ngarkuarë me
7 faje, e hiqenë prëj çdo farë dëshërimesh, Të-
cilatë gjithënjë mësonenë, e kurrë s' munt të
8 vinjënë ndë të-njohurit të së-vërtetësë. Edhe si-
kundrë Janniu e Jambriu ndejtnë kundrë Mo-
isiut, kështu edhe këta rrinë kundrë së-vërte-
tësë, njerës të-prishurë nga mëndja, të-pa-
9 provuarshim ndë besët. Po s'kanë për të mbro-
thësuarë më tepërë; sepse marrësia e atyre
dotë çfaqetë mbë të-gjithë, sikundrë *uçfaq* e-
dhe e atyreve.
10 Po ti i re prapa mësimit t' im, të-sjella-
vet, qëllimit, besësë, zëmërës' së-gjerë, dashu-
11 risë, durimit, Të-ndjekuravet, të-pësuaravet,
që më gjajtnë ndë Antiohi, ndë Ikoni, nde
Lystrë; ç'fare të-ndjekurash hoqa? edhe Zoti
12 më shpëtoj nga të-gjitha. Po edhe gjithë sa
duanë të rronjënë me besë të-mirë mbë Jisu
13 Krishtinë dotë ndiqenë. Po njerëzit' e-liq e
gënjeshtarë dotë venë mbarë mbë më të-li-
gënë, dyke gënjyerë *të-tjerë* e dyke gënjyerë
vetëhenë.
14 Po ti qëndro mb' ato që nxure e uvërte-
15 tove, dyke diturë prej cilit i ke nxënë; Edhe

se që nga foshnjëria i di shkronjat' e-shënj-
tëruara, të-cilatë munt të të bënjënë të-di-
turë për shpëtim me anë të besësë që është
16 mbë Jisu Krishtinë. Gjithë shkronja është
prej Frymës' së Perëndisë, edhe e-dobishime
për mësim, për qërtim, për të-ndrequrë, për
17 arrësim që është me drejtëri; Që të jet' i-so-
surë njeriu i Perëndisë, i-bërë gati për çdo
punë të-mirë.

Krye 4.

1 Të urdhëronj pra unë përpara Perëndisë
edhe Zotit Jisu Krisht, që ka për të gjykuarë
të-gjall' e të-vdekurë ndë të-dukurit të ti edhe
2 ndë mbretërit të ti; Lëçit fjalënë; qëndro me
kohë *e* pa kohë; qërto, bjerë ndër sy, ngut
me çdo farë zëmëre së-gjerë e me mësim.
3 Sepse ka për të ardhurë kohë, kur nukë dotë
duronjënë mësimn' e-shëndoshë, po dotë
mbledhënë grumbullë përanë vetëhes' së tyre
mësonjës pas dëshërimevet të tyre, për të
4 gudulisurë veshëtë; Edhe nga e-vërteta dot'
i largonjënë veshëtë, edhe dotë kthenenë *të*
5 *venë* pas përrallavet. Po ti rri sgjuarë mbë
të-gjitha, vuaj, bëj punë ungjilltari, shërbe-
sënë t' ënde bëj-e të-mbaruarë.
6 Sepse unë ndashti jam dyke derdhurë
gjakunë, edhe koha e të-ikurit t'im arriti.
7 Luftën' e-mirë luftova, udhën' e mbarova, be-
8 sën' e ruajta; Paskëtajthi më mbetetë kurora

e drejtërisë, të-cilënë dotë m'a apë Zoti nd'atë
ditë, i-drejti gjykatës; edhe jo vetëmë mua,
po edhe gjith' atyreve që duanë të-dukurit'
e ati.
9 Përpiqu të vish çpejt tek unë. (10) Sepse
Dhimaj më la, sepse deshi këtë botë, edhe
vate ndë Thessallonikë; Krisku ndë Gallati;
11 Titua ndë Dhallmati; Vetëmë Llukaj është
bashkë me mua. Markunë merr-e me vetëhe
edhe bjer'-e bashkë me ty; sepse më është i-
12 vëjyerë ndë punët. Edhe Tihikun' e dërgova
ndë Efesë.
13 Kur të vish, bjerë gunënë që lashë ndë
Troadhë përanë Karpit, edhe libratë, po më
fort memvranatë.
14 Aleksandër ramtori shumë të-liga më bëri;
15 Zoti j'a çpagoftë pas punëravet t'ati; Prej të-
cilit edhe ti ruhu; sepse shumë rri kundrë
fjalëvet t' ona.
16 Ndë të-mbrojturit t'im të-parë asndonjë
nukë erdhi bashkë me mua, po të-gjithë më
17 lanë; (mos u unumëroftë atyre *për faj*;) Po
Zoti më ndënji përanë, edhe më dha fuqi që
me anë t' ime të mbushetë të-lëçituritë, edhe
të dëgjonjënë gjithë kombetë; edhe shpëtova
18 nga goj' e leonit. Edhe Zoti dotë më shpëto-
një nga çdo pun' e-keqe, edhe dotë *më* ru-
anjë për mbretërin' e ti qiellore; mbë të-ci-
linë *qoftë* lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.
19 I ufal me shëndet Priskësë edhe Ahillit,

BKSH

20 edhe shtëpis' s' Onisiforit. Erasti mbeti ndë
Korinthë; edhe Trofimnë e lashë të-sëmurë
21 ndë Militë. Përpiqu të vinjç përpara dimërit.
Të faletë me shëndet Efvuli, edhe Pudhi, edhe
Lini, edhe Kllavdhia, edhe gjithë vëllezëritë.
22 Zoti Jisu Krisht *qoftë* bashkë me frymënë
t'ënde.
Hiri *qoftë* bashkë me ju. Amin.

Karta e apostollit Pavël mbë Titonë.

Krye 1.

1 Pavli, shërbëtuar i Perëndisë, edhe apo-
stóll i Jisu Krishtit, pas besës' së të-sgjedhu-
rëvet të Perëndisë, edhe pas të-njohurit të
2 së-vërtetësë që është pas besës' së-mirë, Me
shpresë për jetën' e-përjetëshme, të-cilën' u-
zotua Perëndia që s'gënjen përpara kohëra-
3 ve të-përjetëshme, Edhe çfaqi ndë kohëra të-
ndara fjalën' e ti me anë të të-lëçiturit që m'u-
besua mua pas urdhërit të Shpëtimtarit t'ënë
4 Perëndi; Mbë Titonë, të-thjeshtinë djalë pas
besës'*s'ënë* së-bashkëtë, hir *qoftë*, (përdëllim,)
paqtim prej Perëndisë, Atit, edhe prej Zotit t'
ënë Iisu Krishtit, Shpëtimtarit t' ënë.
5 Përandaj të lashë ndë Kritë, që të ndreqç
të-metatë, edhe të vësh mbë çdo qytet pleq

6 sikundrë të urdhërova unë; Kush të jetë i-
pahequrë për faj, burrë i një gruaje, që ka
bij besëtarë që s'përflitenë për plank-prishës,
7 a për të-pabindurë. Sepse episkopi duhetë
të jetë i-pahequrë për faj, posi kujdestar i
Perëndisë; jo i-vrazëtë, jo zëmërak, jo dej-
marak, jo ngrindës, jo *njeri* që lakmon mbë
8 fitim të-lik; Po dorë-hapëtë, mirë-dashës, i-urtë,
9 i-drejtë, shënjt, i-përmbajturë; I-ngjiturë pas
fjalës' së-vërtetë pas mësimit *që mori*, që të
muntnjë edhe të ngutnjë *të-tjerë* me anë të
mësimit të-shëndoshë, edhe të qërtonjë ata
që flasënë kundrë.
10 Sepse janë shumë të-pabindurë që flasënë
fjalë të-kota e që prishnjënë mëndjenë, më
11 fort ata që janë nga rrethpresja; Të-cilëvet
duhetë t' u mbyllmë gojënë; të-cilëtë për-
mbysnjënë shtëpira të-tëra, dyke mësuarë sa
12 nukë duhenë, per fitim *të tyre* të-ndyrë. Një
nga ata, profit i atyreve, tha, "Kritasitë janë
gjithënjë gënjeshtarë, bisha të-liga, barqe të-
ngeshim.„
13 Ky dëshmim ësht' i-vërtetë; për të-cilënë
ngajë qërto-i ata ashpërë, që të shëndoshenë
14 ndë besët; Edhe të mos u vënë vesh përra-
llavet të Judhenjvet, edhe porosivet të nje-
15 rësvet që mërzitnjënë të-vërtetënë. Te të-që-
ruaritë të-gjitha janë të-qëruara; po ndë të-
pëgëret e ndë të-pabesët asgjë s' ësht' e-që-
ruarë, po edhe mëndja e atyreve edhe ndër-

BKSH

16 gjegja janë të-pëgëra. Rrëfenjënë me gojë se
njohënë Perëndi, po me punëratë e moho-
njënë, sepse janë të-ndyrë edhe të-pabindurë,
edhe mbë çdo punë të-mirë të-paprovuarshim.

Krye 2.

1 Po ti folë sa i kanë hie mësimit të-shën-
2 doshë; — Pleqtë të jenë të-përmbajturë, të-hi-
eshim, të-urtë, të-shëndoshë ndë besët, ndë
3 dashurit, ndë durimt. Gjithashtu edhe plaka-
të të kenë të-sjella sikundrë u ka hie shënj-
torëvet; të jenë jo kallëzimtare, jo të-bëra
rop ndë shumë verë, *të jenë* mësimtare të-
4 mira, Që të mësonjënë të-ratë të duanë bu-
5 rrat' e djemt' e tyre, *Të jenë* të-urta, të-që-
ruara, shtëpiruajtëse, të-mira, të-bindura ndë
burrat të-tyre, që të mos shahetë fjal' e Pe-
6 rëndisë.—Të-rinjtë gjithashtu ngut-i të jenë
7 të-urtë; Mbë të-gjitha të-dëftenjç vetëhenë
t' ënde shëmbëllë punërash të-mira, *dyke*
8 *ruajturë* ndë mësimt paprishje, nder, Fjalë të-
shëndoshë e të-padënuarshime, që të turpë-
ronetë ay që është kundrë, e të mos ketë të
9 flasë për ju asndonjë të-ligë. Shërbëtorëtë t'u
bindenë zotërinjvet të tyre, mbë gjithë pu-
nërat të jenë të-pëlqyershim, të mos fla-
10 sënë kundrë; Të mos e bëjnë të-tyrenë gjën'
e-huaj, po të dëftenjënë çdo besë të-mirë,
që të stolisnjënë ndër gjithë *punërat* mësimn'e
Perëndisë, Shpëtimtarit t' ënë.

11 Sepse uduk hiri i Perëndisë qe sjell
12 shpëtim mbë gjithë njerëzitë, I-cili na mëson
të mohojmë pabesërinë edhe dëshërimet' e
botësë, e të rrojmë me urtësi e me drejtëri
13 e me besë të-mirë ndë këtë jetë, Dyke pri-
turë shpresën' e-lumurë edhe të-dukurit' e
lavdis' së të-madhit Perëndi edhe të Shpë-
14 timtarit t' ënë Jisu Krisht; I-cili dha vetëhen'
e ti për ne, që të na çpërblenjë prej çdo
paudhërie, edhe të qëronjë për vetëhen' e ti
një llaus të-sgjedhurë, zëmërë-përvëluarë për
punëra të-mira.
15 Këto folë, e porosit, e qërto me çdo pu-
shtet; asnjëri letë mos të hedhë ty poshtë.

Krye 3.

1 Bjer'u'a ndër mentt atyreve të unjënë
kryetë ndënë urdhërat e ndënë pushtetet, të
bindenë *ndër ata*, të jenë gati për çdo punë
2 të-mirë, Asnjëri të mos shanjënë, të mos
zihenë, të jenë të-butë, dyke rrëfyerë çdo
3 butësirë mbë gjithë njerëzitë. Sepse edhe
neve ishimë njëherë të-marrë, të-pabindurë,
të-gënjyerë, dyke shërbyerë dëshërimeve të-
ndryshm e kënaqjeve, dyke shkuarë jetënë
ndë të-ligë e ndë cmir, të-mërziturë e dyke
pasurë mëri njëri jatërinë.
4 Po kur uçfaq mirësia edhe dashuria mbë
5 njerëzitë e Shpëtimtarit t'ënë Perëndi, Jo prej
punërash drejtërie që punuamë neve, po pas

BKSH

përdëllimit të ti na shpëtoj, me anë të të-
larit të përsërilindjesë, edhe me anë të të-
6 përtërijturit të Frymës' së-Shënjtëruarë, Që
derdhi me dorë të-hapëtë mbi ne me anë të
7 Jisu Krishtit, Shpëtimtarit t' ënë; Që, passi të
dalëmë të-drejtë me anë të hirit t' ati, të bë-
nemi trashëgimtarë pas shpresës' së jetës' së-
përjetëshme.

8 Për të besuar' është fjala; edhe këto dua
t'i vërtetonjç, që të kujdesenë ata që i kanë
besuarë Perëndisë të jenë të-parë për punë-
ra të-mira. Këto janë të-miratë e të-dobi-
9 shimetë mbë njerëzitë. Po kërkuarje të-marra,
e breza njerëzish, e grindje, edhe luftëra no-
mi, *këto* i largo; sepse janë të pa-dobishi-
me edhe të-kota.

10 Nga njeriu eretik, si t'a mësonjç një herë
11 e dy herë, hiq dorë, Dyke diturë se i-këtilli
ësht' i-prishurë, edhe fëjen, sepse e ka dënu-
arë vetë vetëhenë.

12 Kur të dërgonj Artemanë a Tihikunë te ti,
çpejto të vinjç tek unë ndë Nikopolë, sepse
13 atje vendosa të-dimëronj. Nomtarinë Zina
edhe Apollonë përcill-i me kujdes, që të
mos u shteretë atyre asgjë.

14 Edhe letë nxënë edhe t' anëtë të jenë të-
parë për punëra të-mira për nevojat' e ne-
vojshime, që të mos jenë të-papemshim.

15 Të falenë me shëndet gjith' ata që janë

bashkë me mua. Fal-u me shëndet atyreve
që na duanë ndë besët.
Hiri *qoftë* bashkë me gjithë ju. Amin.

Karta e apostollit Pavël mbë Filimoninë.

Krye 1.

1 Pavli, i-lidhurë i Jisu Krishtit, edhe Timo-
theu, vëllaj, mbë Filimonin' e-dashurë edhe
2 bashkëpunëtorinë t'ënë, Edhe mb' Apfin' e-
dashurë, edhe mb' Arhippinë bashkëushtëto-
rinë t'ënë, edhe mbë kishënë ndë shtëpit t'ën-
3 de; Hir *qoftë* mbë ju e paqtim prej Perën-
disë, Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.
4 I falem ndersë Perëndisë t'im, dyke prurë
ndër mëntt ty përherë ndë të-falurat të mia,
5 Sepse dëgjonj për dashurinë t'ënde edhe për
besënë që ke mbë Zotinë Jisu, edhe mbë gjithë
6 shënjtorëtë; Që të bënetë shoqëria e besësë
s'ate e-pemshime me anë të të-çfaqurit të çdo
së-mire që është ndër ju mbë Jisu Kishtinë.
7 Sepse kemi shumë gëzim edhe ngushullim
për dasurinë t'ënde, sepse zëmërat' e shënj-
torëvet janë prëjturë me anë t'ënde, o vëlla.
8 Përandaj, ndonëse kam shumë kuxim mbë
Jisu Krishtinë të të urdhëronj ty atë që duhetë,
9 *Po* për dashurinë më tepërë *të* lutem, dyke

qënë i-atillë *që jam*, si plaku Pavel, po nda-
10 shti edhe i-lidhurë i Jisu krishtit. Të lutem
për birinë t'im, që më lindi ndër të-lidhurat
11 të mia, për Onisiminë; I-cili qe njëherë i-
vëjyerë te ti, po ndashti ësht' i-vëjyerë për
ty edhe për mua, të-cilinë e dërgova përsëri
12 Edhe ti prit-e atë, do-me-thënë zëmërënë
13 t'ime. Unë desha t'a mbanj atë përanë vetë-
hesë s'ime që të më shërbenjë ndë vëntt t'ënt,
14 ndë të-lidhurat të ungjillit; Po pa mëndjenë
t'ënde nukë desha të bënj asgjë, që të mos
jet' e-mira jote si prej nevoje, po prej da-
15 shjeje. Sepse mbase përandaj unda *prej teje*
16 për pak kohë, që t'a kesh atë për jetë; Jo
më si shërbëtuar, po më tepërë se shërbëtuar,
vëlla të dashurë, veçan tek unë, po sa më tepë-
rë te ti edhe pas mishit edhe mbë Zotinë.
17 Ndë më ke pra pjesëtar, prit-e atë posi mua.
18 Edhe ndë qoftë se të ka bërë ndonjë paudhëri,
19 a të ka detyrë, këtë numëro-m'a mua. Unë
Pavli shkrova me dorënë t'ime, unë dotë pa-
guanj; që të mos të them, se edhe vetëhenë
20 t'ënde m'a ke detyrë. Po, o vëlla, makar të
marr unë prej teje këtë të-mirë mbë Zotinë;
21 prëj zëmërënë t'ime mbë Zotinë. Dyke pasurë
shpresë se dotë *më* dëgjonjç shkrova te ti,
sepse e di se edhe më tepërë se ç'të them
dotë bënjç.

22 Mbë gjithatë kohë bë-më gati edhe vënt
për të ndënjurë, sepse shprenj se me anë të

të-faluravet t'uaj dotë dhurëtonem ndër ju.
23 Të faletë me sëndet Epafraj që është rop
24 bashkë me mua mbë Jisu Krishtinë, Marku,
Dhimaj, Llukaj, bashkëpunëtorët' e mi.
25 Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë* bashkë
me frymënë t'uaj. Amin.

Karta e apostollit Pavel mbë Ebrenjtë.

Krye 1.

1 Perëndia, passi u foli që-moti atërvet t' anë
me anë të profitërvet shumë herë e me shumë
2 mënyrëra, Ndë këto dit të-pastajme na foli
neve me anë të Birit, të-cilin' e bëri trashë-
gimtar të të-gjithave, me anë të të-cilit bëri
3 edhe jetëtë: I-cili, dyke qënë ndriçim' i lav-
disë edhe karaktir' i qënjes' s' ati, edhe dy-
ke mbajturë të-gjitha me fjalën' e fuqis' së
ti, passi me anë të vetëhes' së ti qëroj faje-
të t'anë, ndënjti mbë të-djathtët të madhë-
4 risë ndë të-lartët *vënde*; Edhe ubë kaqë m'
i-mirë nga ëngjëjtë, sa më të-çquarë emërë
se ata ka trashëguarë.
5 Sepse cilit prej ëngjëjvet i tha ndonjë-
herë, "Ti jë biri im; unë sot të kam pjellë?„
6 Edhe përsëri "Unë dot' i jem ati Atë, edhe
ay dotë më jetë Bir?„ Edhe, kur të kllasë

BKSH

përsëri të-parë lindurinë ndë botët, thotë,
7 „Edhe let' i falen'ati gjithë ëngjëjt' e Perën-
disë.„ Ethe për ëngjëjtë thotë," Ay që bën
ëngjëjt' e ti frymëra, edhe punëtorët' e ti fla-
8 kë zjarri." Po për të Birinë *thotë*, „Froni yt,
o Perëndi, *është* ndë jetët të jetësë: shkop
9 drejtërie *është* shkopi i mbretërisë s' ate. Deshe
drejtërinë, e pate cmir paudhërinë; përandaj
të leu, o Perendi, Perëndia yt, me vaj gëzimi
10 më tepërë se pjesëtarët'e tu." Edhe, "Ti ndë
kryet, o Zot, themelose dhenë, edhe punëra
11 të duarvet te tua janë qiejtë. Ata dotë pri-
shenë, po ti mbetesh; edhe të-gjithë si rrobë
12 dotë vjetëronenë, Edhe posi të-veshurë dot'
i pshtjellç ata, edhe dotë ndërronenë; po ti
je gjithay, edhe vjet' e tu nukë dotë shterenë.„
13 Edhe cilit prej ëngjëjvet i tha ndonjëhërë,
"Rri prej së-djathtësë s' ime, gjersa të vë
armiqt' e tu ndënëkëmbje të këmbëvet të
14 tua.„ Nukë janë të-gjithë frymëra punëtore,
që dërgonenë per shërbesë për ata që kanë
për të trashëguarë shpëtim?

Krye 2.

1 Përandaj duhetë neve më tepërë t' u'a
vëmë veshnë atyreve që dëgjuamë, semos
2 shkasëmë ndonjë' herë. Sepse ndë dolli e-vër-
tetë fjala që ufol me anë të ëngjëjvet, edhe
çdo të-shkelurë *porosie* edhe të-mos-dëgjuarë
3 mori mundim të-drejtë, Qysh neve dotë shpë-

tojmë, ndë mos ukujdesçimë për një kaqë të-
math shpëtim? i-cili, passi zuri të flitetë prej
Zotit, uvërtetua ndër ne prej atyreve që ë
4 dëgjuanë; Edhe Zoti dëshmonte bashkë me
shënja e me çudira, e me çdo farë fuqirash,
edhe me të-ndara *dhurëtiras*h të Frymës' së-
Shënjtëruarë, pas dashurimit të ti.
5 Sepse nuk' e vuri ndënë pushtett të ën-
gjëjvet botënë që ka për të ardhurë, për të-
6 cilënë po flasëmë. Edhe dikush dëshmoj mbë
një vënt, dyke thënë, "Ç' është njeriu, që t'a
kujtonjç? a i bir' i njeriut që t'a vështronjç?
7 E bëre pak gjë më të-poshtërë nga ëngjëjtë;
me lavdi e me nder e kurorëzove atë, edhe
e vure përmbi punërat të duarvet të tua:
8 Të-gjitha i vure përposh këmbëvet t' ati;"
sepse passi vuri të-gjitha ndënë pushtett t'
ati, nukë la asgjë të-pavënë ndënë pushtett
t' ati. Po ndashti nukë shohëmë edhe të-
9 gjitha të jenë vënë ndënë pushtett t' ati. Po
Jisunë që qe bërë pak gjë më i-poshtërë nga
ëngjëjtë e shohëmë, për pësimin' e vdekjesë,
të-kurorëzuarë me lavdi e me nder, që me
hirin' e Perëndisë të ngjëronetë vdekje për
10 çdo njeri. Sepse i duhej ati, për të-cilinë
janë të-gjitha, edhe me anë të të-cilit *ubënë*
të-gjitha, dyke prurë shumë bij ndë lavdi, të
bënjë me anë të-pësuarave të-sosurë krye-
tarin' e shpëtimit t' atyreve.
11 Me-qënë-që edhe ay që shënjtëron edhe

BKSH

ata që shënjtëronenë *janë* të-gjithë prej njëj;
për të-cilënë ngajë nukë turpëronetë t' i qu-
12 anjë ata vëllezër, Dyke thënë, "Dot' u rrë-
fenj emërinë t'ënt vëllezërvet të mi, ndë mest
13 të kishësë dotë të lavduronj.„ Edhe prapë,
„Unë dotë kem shpresënë t' ime mb' atë,"
Edhe përsëri, "Ja unë, edhe çunatë që më
14 dha Perëndia." Edhe me-qënë-që çunatë kanë
marrë pjesë prej mishi e gjaku, edhe ay
gjithashtu mori pjesë prej gjithatyre *gjërëra-
ve*, që të prishnjë me anë të vdekjesë atë
që ka pushtetin'e vdekjesë, do-me-thënë dja-
15 llinë, Edhe të shpëtonjë gjith' ata, të-cilëtë
për frikën' e vdekjesë ishinë gjithë jetën' *e
16 tyre* ndënë skllavëri. Sepse me të-vërtetë nuk'
u ndih ëngjëjvet, po farës' s' Avraamit i ndih.
17 Përandaj duhej t' u gjante së-gjithash vë-
llezërvet, që të bënej kryëprift i-dhëmçurë
edhe besëtar mbë punëratë që kanë të bënjënë
me Perëndinë, që të bënjë të-paqtuarë për
18 fajet' e llauzit. Sepse mb' atë që pësoj vetë,
kur unga, munt t' u ndihnjë atyreve që ngi-
tenë.

Krye 3.

1 Andaj, o vëllezër shënjtorë, pjesëtarë te
të-thërriturit prej qielli, vështroni apostollin
edhe kryepriftin' e rrëfimit t'ënë, Jisu Krish-
2 tinë; I-cili është besëtar tek ay që e bëri, si-
kundrë edhe Moisiu *qe besëtar* ndë gjithë

3 shtëpit t'ati. Sepse ky ulavdurua kaqë më
tepërë se Moisiu, sa ka më shumë nder se
4 shtëpia ay që e ndërtoj atë. Sepse çdo shtëpi
ndërtonetë prej ndonjëj; po ay që ndërtoj të-
5 gjitha *është* Perëndia. Edhe Moisiu qe besë-
tar ndë gjithë shtëpit t'ati si shërbëtuar, për
dëshmim t'atyre *gjërërave* që dotë fliteshinë;
6 Po Krishti, si bir mbi shtëpin' e ti; shtëpia
e të-cilit jemi neve, ndë mbajçimë shtrën-
guarë kuximin' edhe të-mburrurit' e shpresë-
së gjer ndë funt.
7 Përandaj, sikundrë thotë Frym' e-Shënj-
8 tëruarë, „Sot ndë dëgjofshi zën' e ati, Mos
ashpëroni zëmëratë t'uaj si ndë pikëllimt, ndë
9 ditët të ngasjesë ndë shkretëtirët; Ku atëritë
t'uaj më nganë, më provuanë, edhe panë pu-
10 nërat' e mia dyzet vjet. Përandaj uzëmëruashë
me atë bres, edhe thashë,Përherë gënjenenë ndë
zëmërët *të tyre*; edhe ata nuk' i njohnë udhët' e
11 mia. Përandaj bëra be ndë zëmëratët t'ime,
S'kanë për të hyrë ndë të-prëjturit t'm."
12 Vështroni, o vëllezër, që të mos ketë as-
ndonjë prej jush zëmërë të-ligë pabesërie, që
13 të ngrerë krye kundrë Perëndis' së-gjallë; Po
ngutni njëri jatërinë përdita, gjersa quhetë
dita „Sot"; që të mos ashpëronetë ndonjë prej
14 jush me të-gënjyerit' e fajit. Sepse jemi bërë
pjesëtarë të Krishtit, ndë mbajçimë shtrën-
guarë të-nisurit' e të-besuarit gjer ndë funtt;
15 Kur thuhetë, „Sot, ndë ndëgjofshi zën e ati,

BKSH

mos ashpëroni zëmëratë t'uaj, si ndë pikë-
16 llimt." Sepse ca veta, passi dëgjuanë, e pikë-
lluan' *atë*; po jo gjithë ata që dyallë prej E-
17 gjyptësë me anë të Moisiut. Edhe me cilët'
uzëmërua dyzet vjet a jo me ata që fëjyenë,
të-cilëvet eshtërat' u ranë ndë shkretëtirët?
18 Edhe për cilëtë bëri be se nukë dotë hyni-
në ndë të-prëjturit t' ati, veç se për ata që
19 s'bindeshinë? Edhe shohëmë se për pabesë-
rinë nukë muntnë të hynjënë.

Krye 4.

1 Letë kemi pra frikë, semos, gjersa mbe-
tetë ndër ne të-zotuarë për të hyrë ndë të
prëjturit t'ati, duketë ndonjë prej jush se mbe-
2 ti jashtë. Sepse edhe neve jemi ungjillëzua-
rë, sikundrë edhe ata; po nuk'u bëri atyre
dobi fjala që dëgjuanë, sepse s'qe bashkuarë
3 me besë mb'ata që e dëgjuanë. Sepse hyjmë
ndë të prëjturit neve që besuamë, sikundrë
ka thënë, „Përandaj bëra be ndë zëmëratët
t'ime, S'kanë për të hyrë ndë të-prëjturit
t'im;" ndonëse punërat' e ati umbaruanë që
4 kur se ungreh bota. Sepse ka thënë ndë një
vënt për të-shtattënë ditë kështu: „Edhe u-
prëjt Perëndia mbë të-shtattënë *ditë* nga gjithë
5 punërat'e tia". Edhe ndë këtë *vënt* përsëri „S'
kanë për të hyrë ndë të-prëjturit t'im."

6 Passi ka mbeturë pra të hynjënë ca veta
nd' atë, edhe ata që uungjillëzuanë më për-

7 para nukë hynë për të-pabindurit' *e tyre*, Për-
sëri ndan një ditë, „Sot," dyke thënë me anë
të Dhavidhit, pas kaqë kohe; sikundre është
thënë „Sot ndë dëgjofshi zën' e ati, mos ash-
përoni zëmëratë t'uaj."

8 Sepse po t'i kishte prëjtur' ata Jisuj *i Na-
viut,* nukë dotë kishte folurë pastaj për *një*
9 tjatërë ditë. Mbetetë pra të-prëjturë për lla-
uzin'e Perëndisë.

10 Sepse ay që hyri ndë të-prëjturit t'ati, edhe
ay uprëjt nga punërat' e tia, sikundrë Pe-
rëndia nga të-tiatë.

11 Letë përpiqemi pra të hyjmë mb'ata të-
prëjturë, që të mos bjerë ndonjë mb'atë shëm-
12 bëlesë të pabindjesë. Sepse fjal' e Perën-
disë *ësht'* e-gjallë, edhe e punësë, edhe më e-
prehëtë se çdo thikë me dy presje, edhe
depërton gjer ndë të-ndarët të shpirtit edhe
të frymësë, të nyjevet e të palcavet, edhe
13 çquan kujtimet'e mendimet' e zëmërësë. Edhe
s'ka asndonjë kriesë që të mos jetë e-çfa-
qurë përpara ati, po të-gjitha *janë* lakuriq
edhe të-sbuluara ndë syt t'ati, të-cilit neve
i kemi për të dhënë fjalë.

14 Dyke pasurë pra një kryeprift të-math që
depërtoj qiejtë, Jisunë, të Birin' e Perëndisë,
15 letë mbajmë rrëfiminë *t' ënë.* Sepse s' kemi
kryeprift që nukë munt t'i vinjë keq për do-
bësiratë t'ona, po *kryeprift* që unga së-gji-

BKSH

16 thash *posi ne*, përveç se nukë fëjeu. Letë a-
fëronemi pra me kuxim ndë front të hirit, që
të marrëmë përdëllim, edhe të gjejmë hir për
ndihmë ndë kohët të nevojësë.

Krye 5.

1 Sepse çdo kryeprift që merretë prej nje-
rësve, vihetë *kryeprift* për njerëzitë mbë pu-
nëratë që kanë të bënjënë me Perëndinë, që
2 të bjerë dhurata e kurbanë për faje; Të-
cilit munt t'i vinjë keq për ata që janë të-
paditur' e të-gënjyerë; sepse edhe ay vetë
3 është veshurë me dobësirë. Edhe përandaj
ka detyrë, sikundrë për llauzinë, kështu edhe
për vetëhen' e ti, të bjerë *kurban* për faje.
4 Edhe asndonjë nuk' e merr këtë nder prej
vetëhes' së ti, po ay që thërritetë nga Perën-
5 dia, posi Aaroni. Kështu edhe Krishti nuk' e
lavduroj vetëhen' e ti që të bënetë kryeprift,
po ay që i foli, „Ti je Biri im, unë sot të
6 kam pjellë." Sikundrë edhe mbë tjetërë vënt
thotë, „Ti *je* prift për gjithë jetënë pas re-
gullës' së Melqisedhekut.

7 I-cili ndë ditt të mishit të ti, pasi pruri
të-falura e të-lutura me klithmë të-fortë e
me lot tek ay që muntte t'a shpëtonte atë
nga vdekja, edhe udëgjua për të-druajturit'e
8 ti *nga Perëndia*, Ndonëse ishte bir, nxuri
9 nga ato që pësoj të jet' i-bindurë. Edhe si
ubë i-sosurë, ubë ngajë për shpëtim të-për-

BKSH

jetëshm mbë gjith' ata që i dëgjonjën' ati,
10 Dyke qën' i-quajturë nga Perëndia kryeprift
11 pas regullës' së Melqisedhekut. Për të-cilinë
kemi të themi shumë punëra, të-cilatë nukë
sgidhenë lehtë me fjalë; sepse jeni bërë të-
rëndë nga veshëtë *për të dëgjuarë.*
12 Sepse, ndonëse sipas kohësë *që ka shku-
arë* duhej të ishitë mësonjës, përsëri keni ne-
vojë t'u mësonjë juve ndonjë stiqiat' e-para
të fjalëvet të Perëndisë; edhe keni arriturë
të keni nevojë për qumësht, e jo për ushqim
13 të-shëndoshë. Sepse kushdo që ushqehetë me
qumësht, ësht' i-paprovuarshim ndë fjalët të
14 drejtërisë; sepse është foshnje. Po ushqimi
i-fortë është për *njerës* të-sosurë, të-cilëtë me-
qënë-që janë mësuarë kështu, i kanë ndjenjat'
e tyretë-stërvitura për të çquarë të-mirën' e
të-ligënë.

Krye 6.

1 Përandaj si të lëmë kryet' e mësimit të
Krishtit, letë bihemi mbë të-mbaruarët, pa
vënë përsëri themeli pendimi prej punërash
2 të-vdekura, e besë mbë Perëndinë, Mësimi
për pagëzime, e të të-vënurit të duarvet, e
të të-ngjallurit të të-vdekurvet, e të gjyqit të-
3 përjetëshm. Edhe këtë dot'a bëjmë, ndë dhën-
4 të lejë Perëndia; Sepse është punë që s' bë-
netë ata që undriçuanë një herë, edhe ndjenë
shijën' e dhurëtisë qiellore. edhe ubënë pje-

5 sëtarë të Frymës' së-Shënjtëruarë, Edhe ndje-
në shijën' e fjalës' së-mirë të Perëndisë, edhe
6 të fuqivet të jetës' së-pritme, Edhe pastaj u-
rrëzuanë, të përtërihenë përsëri ndë pendim;
sepse kryqëzonjënë përsëri ndë vetëhet të
tyre të Birin' e Perëndisë, edhe e turpëro-
njënë.
7 Sepse dheu që pi shinë që bje shumë he-
rë mbi atë, edhe pjell barëra të-dobishime
për ata, për të-cilëtë edhe punonetë, merr
8 bekim nga Perëndia. Po ndë nxjertë gjëm-
ba e murriza, *ësht'* i-paprovuarshim edhe a-
fërë mallëkimit, fundi i të-cilit ëshë të digjetë.
9 Po për ju, o të-dashurë, ndonëse flasëmë
kështu, na është mbushurë mëndja, se *keni*
më të-miratë gjërëra, të-cilatë janë bashku-
10 arë me shpëtimnë. Sepse Perëndia nuk' është
i-shtrëmbërë, që të harronjë punënë t'uaj, e-
dhe mundimin' e dashurisë që dëftyetë mb'
emërin' e ati me shërbesënë që u bëtë e po
11 u bëni shënjtorëvét. Edhe dëshërojmë që
gjithësicili prej jush të dëftenjë gjithatë
kujdes për të-vërtetuarët'e-plotë të shpresë-
12 së gjer ndë funtt; Që të mos bëhi të-përtu-
arshim, po të bëni si'ata që trashëgonjënë të-
zotuaratë me anë të besës' e të zëmërës'
së-gjerë.
13 Sepse Perëndia, kur i uzotua Avraamit
passi s'kishtë asndonjë më të-math, mbë të-
cilinë të bënte be, bëri be mbë vetëhen' e ti,

BKSH

14 Dyke thënë, „Vërtet dyke bekuarë dotë të
bekonj, edhe dyke shumuarë dotë të shu-
15 monj.“ Edhe kështu *Avraami*, dyke priturë
16 me durim, fitoj të-zotuarëtë. Sepse njerëzitë
bëjnë be mbë më të-madhinë, edhe beja mbë
ata është fundi i çdo kundrëfoljeje për të-
17 vërtetuarë. Kështu Perëndia, dyke dashurë të
dëftenjë më tepërë mbë trashëgimtarët' e të-
zotuarit' të-pakthyerit' e ëndës' së ti, vuri
18 ndërmjetës benë, Që me anë dy gjërërave të-
pakthyershime, ndë të-cilat është pun' e-pa-
mundurë të gënjenjë Perëndia, të kemi ngu-
shullim të-fortë neve që usulmë që të mbajmë
19 shpresënë që kemi përpara; Të-cilënë e kemi
posi angurë të-shpirtit të-siguruarë e të-vër-
tetuarë, edhe që hyn mbë të-përbrëndëshmet
20 të kurtinësë; Atje ku Krishtit hyri për ne e na
hapi udhënë, passi ubë kryeprift pas regullës,
së Melqisedhekut.

Krye 7.

1 Sepse ky Melqisedheku, mbreti i Salimit,
prift i fort të-lartit Perëndi, i-cili upoq me
Avraaminë, kur kthenej prej të-gririt të mbre-
2 tërvet, edhe e bekoj; Të-cilit Avraami i ndau
edhe të-dhjettë nga gjithë *plaçkatë*, (i-cili më
përpara përkthenetë mbret drejtërie, edhe
pastaj edhe mbret i Salimit, që do me thënë
3 mbret paqtimi,) Pa atë, pa mëmë, pa gjene-
allogji, pa pasurë as të nisurë ditsh, as funt

jete, po i-përgjajturë me Birin' e Perëndisë,
mbetetë prift për gjithënjë.
4 Pa mendohuni sa i-math *ishte* ky, të-cilit
Avraami kryeati i dha edhe të-dhjettë nga
5 plaçkatë. Edhe nga të bijt'e Leviut ata që
marrënë priftërinë, kanë porosi të marrënë pas
nomit të-dhjettë nga llauzi, do-me-thënë nga
vëllezërit' e tyre, ndonëse kanë dalë nga mezi
6 i Avraamit; Po ay që nuk' e kishte gjenea-
llogjinë nga ata mori të-dhjettë nga Avraami,
7 edhe bekoj atë që kishte të-zotuaratë. Edhe
pa ndonjë kundrëfjalë m'i-vogëli bekonetë
nga m'i-madhi.
8 Edhe këtu njerës të-morçim marrënë të-
dhjetta ;po atje *merr të-dhjetta* ay që dëshmo-
9 netë se rron. Edhe që të them kështu, me
anë të Avraamit edhe Leviu, që merr të-
10 dhjetta, dha të-dhjetta. Sepse ishte edhe ndë
mest të t'et, kur upoq me atë Melqisedheku.
11 Po të ishtë pra të-mbaruarëtë me anë
të priftërisë Levitike, (sepse llauzi mbi atë
mori nomnë), ç'nevojë më ishte të ngrihetë
tjatërë prift pas regullës' së Melqisedhekut,
e të mos thuhetë pas regullës' s' Aaronit?
12 Sepse kur ndërronetë priftëria, prej nevoje
13 bënetë edhe ndërrim nomi. Sepse ay, për të-ci-
linë thuhenë këto, ishte prej tjatërë fare, prej
së-cilësë asndonjë s'i qe afëruarë theroresë.
14 Sepse është gjë e-çfaqurë, se Zoti ynë lindi
nga Judha, mbë të-cilënë farë asgjë për prif-

15 tëri nukë foli Moisiu. Po edhe shumë më
tepërë ësht'e-çfaqurë, sepse pas shëmbëllimit
16 të Melqisedhekut ngrihetë tjatërë prift, I-cili
nuk'ubë pas nomit të porosis' së mishit, po
17 pas fuqis' së jetësë që s'ka funt. Sepse dëshmon,
dyke thënë, „Se ti je prift për gjithë jetënë pas
regullës' së Melqisedhekut."
18 Sepse porosia e-parë bje poshtë, kur është
19 e-dobëtë edhe e-padobishime; (Sepse nomi
nukë mbaroj asndonjë farë pune;) po kalli
një shpresë më të-mirë, më anë të së-cilësë
i afëronemi Perëndisë.
20 Edhe me-qënë-që nuk' *ubë prift* pa të-bërë
21 be; (Sepse ata qenë bërë priftër pa të-bërë be,
po ky me të-bërë be, m'anë të ati që i tha
ati, „Zoti bëri be, edhe nukë dotë pendone-
të, Ti je prift për gjithë jetënë pas regullës'
22 së Melqisedhekut;") Kaqë i *njëj* dhjate më
së-lartë ubë dorëzënës Jisuj.
23 Edhe ata qenë bërë priftër më shumë *se
një*, sepse ndaloneshinë prej vdekjesë të mbe-
24 tenë për gjithënjë; Po ky, passi mbetetë
për gjithë jetënë, ka priftërinë të-pandërru-
25 arshime. Përandaj edhe munt t'i shpëtonjë
fare ata që afëronenë përanë Perëndisë me
anë t'ati, sepse gjithënë rron që të lajmëso-
një për ata.
26 Sepse i-këtillë kryeprift duhej pëj ne,
shënjt, i-pafajm, i-pazhyerë, i-ndarë veç nga
27 fajtorëtëe, edh i-bërë më i-lartë se qiejtë; I-

cili nukë ka përdita nevojë, si ata kryepriftërritë,
të bjerë kurbanë më përpara për fajet' e ti,
edhe pastaj për ata të llauzit; sepse këtë e
bëri një herë, kur pruri *kurban* vetëhen' e ti.
28 Sepse nomi vë kryepriftër njerës që kanë
dobësirë; po fjala e të bërit be që ubë pastaj
nomit *vuri* Birinë, i-cili është i-mbaruarë për
gjithë jetënë.

Krye 8.

1 Edhe përmbledhja e atyreve që themi ësh-
të *këjo*, Kemi një të-tillë kryeprift, i-cili ndënji
ndë të-djathtët të fronit të madhërisë ndë
2 qiejt, *edhe është* shërbëtuar i shënjtëroresë,
edhe i tendës' së-vërtetë të-cilën'e nguli Zo-
ti, e jo njeri.
3 Sepse çdo kryeprift vihetë që të bjerë
dhurëtira e kurbanë; përandaj *është* nevojë
4 të ketë edhe ky diç që t'a bjerë kurban. Sepse
ndë ishte mbi dhet, nukë dot' ishe prift, se-
pse janë priftëritë që bjenë dhurëtiratë pas
5 nomit; Të-cilëtë punonjënë pas shëmbëllës'
edhe pas hies' së qiellorevet, sikundrë i qe
folurë Moisiut, kur kishte për të ndërtuarë
tendënë; sepse „Shiko," thotë, „t'i bënjç të-
gjitha pas formësë që t'udëftue tyj ndë malt."
6 Po ndasti Krishti mori një shërbesë kaqë
më të-çquarë, sa është edhe lajmës i një
dhjate më së-mirë, e-cila ubë nom përmbi
të-zotuara më të-mira.

7 Sepse ndë ishte pa palavi ajo e-para, nu-
8 kë dotë kërkonej vënt për të-dytënë. Sepse *Pe-*
rëndia dyke qërtuarë ata thotë, „Ja tek po
vijnë dit, thotë Zoti, edhe dotë bënj një dhja-
të të-re me shtëpin'e Israilit edhe me shtë-
9 pin' e Judhësë; Jo pas dhjatës' që bëra me
atërit' e atyre atë ditë që i rroka ata prej
dore, që t'i nxirnjam ata prej dheut të Eqjy-
ptësë; sepse ata nukë qëndruanë ndë dhjatët
t'ime, edhe unë s'i vura re ata, thotë Zo-
10 ti. Sepse këjo *është* dhjata që dotë bënj
me shtëpin' e Israilit pas atyre ditve, thotë
Zoti, Dotë vë nomet' e mi ndë mëndjet t'
atyre, edhe dot' i skruanj ata mbi zëmërat t'
atyre, edhe dotë jem tek ata *për* Perëndi, e-
11 dhe ata dotë më jënë *për* llaus. Edhe nukë
dotë mësonjënë gjithësicili të-afërmin' e ti,
edhe gjithësicili vëllan' e ti, dyke thënë, Njih
Zotinë; sepse të gjithë dotë më njohënë, që
prej të-vogëlit t' atyre e gjer mbë të-madhin'
12 e atyre. Sepse dotë jem i-përdëllyershim mbë
paudhërit' e atyreve, edhe nukë dotë kujtonj
më fajet' e atyreve edhe panomit' e atyreve."
13 Dyke thënë „të-re„ e vjetëroj të-parënë;
edhe ajo që vjetëronet'e mblaketë është afë-
rë prishjesë.

Krye 9.

1 Kishte pra edhe tenda e-parë urdhëre lu-
2 tjeje, edhe sënjtërorenë prej kësaj bote; Se-

pse undërtua tend' e-parë, ndë të-cilët ishte e-
dhe kandileri, edhe truveza, edhe parëvënja
3 e bukëvet,e-cila *tendë* thuhetë Sënjtërore. E-
dhe pas kurtinës' së-dytë *ishte* tenda që thu-
4 hetë Shënjtërore e Shëntërorevet, E-cila kishte
një tymtore të-artë, edhe arkën' e dhjatësë
të-mbuluarë rreth nga të-gjithë anëtë me ar,
ndë të-cilët ishte shtëmba e-artë që kishte
mannënë, edhe shkopi i Aaronit që biu, edhe
5 dërrasat'e dhjatësë; Edhe pësipër'asaj ishinë
Qeruvimet' e lavdisë që i lëshoninë hie fro-
nit të përdëllimit; për të-cilatë nuk'është
ndashti nevojë të themi hollë hollë.
6 Edhe tek ishinë këto ndëtuarë kështu, ndë
të-parët tendë gjithënjë hynjënë priftëritë që
7 bënjënë lutjetë; Po ndë të-dytët një herë ndë
vitt *hyn* vetëmë kryeprifti, jo pa gjak, të-cilin'
e bje *kurban* për vetëhen' e ti edhe për fa
8 jet' e llauzit që i bënjënë nga paditja; Edhe
këtë e dëftente Frym' e-Shënjtëruarë, se e-
dhe s'ishte çfaqurë udha mbë Shënjtëroren'
e Shënjtërorëvet, sepse tend' e-parë edhe po
9 qëndronte; E-cila ishte formë për kohën' e
atëhershime, kur bininë dhurëtira e kurbanë,
të-cilatë nukë muntninë t'a bëninë të-sosurë
10 nga dërgjegja atë që lutej, Sepse ishinë ur-
dhëruarë vetëmë për të-ngrëna e për të-pira
e për ç'do farë të-larash, e për urdhëre mishi,
gjer mbë kohët të të-ndrequrit.
11 Po si erdhi Krishi, kryeprifti i të-miravet

BKSH

që kanë për të ardhurë me anë të më së-
madhes' e më së-mbaruarësë tendë, që s'është
bërë me dorë, do-me-thënë, *që s' është* prej
12 kësaj kriese, As me anë gjaku cjepsh e
viçash, po me anë të gjakut të ti hyri një
herë ndë Shënjtëroret *të Shënjtërorëvet*, edhe
13 fitoj çpërblim të-përjetëshm. Sepse ndë qoftë
se gjaku i demavet e i cjepvet, edhe hiri i
mëshqerësë që përskat të-pëgërëtë, shënjtë-
14 ron për pastrimin'e mishit, Sa më tepërë gja-
ku i Krishtit, i-cili me anë të Frymës' së-
përjetëshme pruri vetëhen'e ti *për kurban* pa
palavi te Perëndia, dotë pastronjë ndërgje-
gjenë t'uaj nga punëra të-vdekura, që të lusni
Perëndin' e-gjallë?
15 Edhe përandaj është mestar i një dhjate
së-re, që, me anë të vdekjesë që ubë për
çpërblimin' e të-shkelurit të porosivet ndë
kohët të dhjatës' së-parë, të marrënë ata që
janë thërriturë të-zotuarët' e trashëgimit të-
16 përjetëshm. Sepse atje ku ka dhjatë është
nevojë të ketë vdekje t'ati që bëri dhjatënë;
17 Sepse dhjata ka fuqi mb'ata që kanë vdekurë;
sepsë kurrë s'ka fuqi gjersa rron ay që bëri
18 dhjatënë. Përandaj as e-para nukë qe vërtetua-
19 rë pa gjak; Sepse passi ufol prej Moisiut çdo
porosi pas nomit mbë gjithë llauzinë, mori
gjakun' e viçërvet e të cjepvet, bashkë me
ujë e me lesh të-kuq e me hyssop, e për-
20 skati edhe atë vivlinë e gjithë llauzinë, Dyke

thënë, „Ky është gjaku i dhjatësë, që urdhë-
21 roj Perëndia mbë ju.“ Edhe gjithashtu për-
skati me gjak edhe tendën' edhe gjith' enët'
22 e shërbesësë. Edhe po-thua me gjak të-gjitha
qëronenë pas nomit, edhe pa derdhurë gjak
s'ka ndjesë *fajesh.*
23 Ishte nevojë pra format' e qiellorevet të
qëronenë me këta, po qielloretë me kurbanë
24 më të-mirë se këta. Sepse Krishti nukë hyri
ndë shënjtërore të-bëra me dorë, *që janë*
kundrëforma të të-vërtetavet, po ndë qiellt
vetë, që të duketë ndashti përpara Perëndisë
25 për ne; As të bjerë *kurban* vetëhen' e ti shu-
më herë, sikundrë kryeprifti hyn ndë shënjtë-
26 roret vit për vit me gjak të-huaj; (Sepse *a-
tëhere* duhej shumë herë të pësonte qëkur
se ufillua bota;) po ndashti një herë ndë
funtt të jetëvet uçfaq, që të prishnjë fajinë
27 me anë të kurbanit të vetëhes' së ti. Edhe
sikundrë është urdhëruarë për njerëzitë një
herë të vdesënë, edhe pastaj është gjyqi;
28 Kështu edhe Krishti, passi një herë upru
kurban që të ngrerë fajet' e shumëve, dotë
duketë për-së-dyti pa faj ndër ata që e pre-
sënë për shpëtim.

Krye 10.

1 Sepse nomi, dyke pasurë një hie të të-
miravet që kishinë për të ardhurë e jo atë
figurën' e gjërëravet, s' munt kurrë me anë

të gjithatyre kurbanëve, që bjenë vit për vit
përherë, të bënjë të-sosurë ata që afëronenë.
2 Sepse atëhere dotë kishinë pushuarë së pruri
kurbanë, sepse lutësitë, si të qëroneshinë një
herë, nukë dotë kishinë më asdonjë ndërgje-
3 gje fajesh. Po nd' ata *bënetë* kujtim fajesh
4 vit per vit. Sepse është *gjë* e-pamundurë gjak
5 demash e cjepsh të heqnjë faje. Përandaj,
dyke hyrë ndë botët, thotë, „Kurban e dhu-
ratë nukë deshe, po bëre gati për mua trup.
6 *Kurbanë* të-gjithëdjegurë edhe të-*prura* për
7 faj nukë pëlqeve. Atëhere thashë, Na tek po
vinj, (ndë ballët të vivlisë është shkruarë
për mua,) për të bërë, o Perëndi, dashurimnë
8 t'ënt." Passi tha më sipërë, "Se kurban edhe
dhuratë, edhë të-gjithëdjegura edhe *të-prura*
për faj nukë deshe, as nuk' i pëlqeve,„ (të-
9 cilatë bihenë pas nomit,) Atëhere tha, "Na
tek po vinj, për të bërë, o Perëndi, dashu-
rimnë t' ënt.„ Heth tej të-parënë, që të qën-
10 dronjë të-dytënë. Prej këti dashurimi jemi
shënjtëruarë me anë të të-prurit kurban të
trupit të Jisu Krishtit që *ubë kurban* një herë
për gjithë.

11 Edhe çdo prift rri përdita dyke shërbyerë,
edhe bje shumë herë gjithata kurbanë, të-
cilëtë kurrë nukë muntnjënë të heqënë faje.
12 Po ay, passi prurri një kurban për faje, ndë-
nji për gjithënjë ndë të-djathtët të Perëndisë,
13 Dyke priturë paskëtaj gjersa të vihenë ar-

BKSH

miqt' e ati ndënëkëmbjë të këmbëvet t' ati.
14 Sepse me një dhuratë bëri të-sosurë për gji-
thënjë ata që shënjtëronenë.
15 Po edhe Frym' e-Shënjtëruarë dëshmon
mbë ne; sepse passi pat thënë më përpara,
16 "Këjo *është* dhjata që dotë bënj mb' ata pas
atyre ditve, thotë Zoti, dotë vë nomet' e mi
ndë zëmërat t' atyreve, edhe dot' i shkruanj
17 ata ndë mëndjet t' atyreve.„ *Shtoj*, "Edhe
fajet' e atyreve edhe paudhërit' e atyreve nukë
18 dot' i kujtonj më.„ Edhe ku ka ndjesë të kë-
tyreve, nukë ka më dhuratë për faj.
19 Dyke pasurë pra, o vëllezër, sy të hyj-
më ndë shënjtëroret me anë të gjakut të
20 Jisujt, Me anë një udhe së-rë edhe së-gjallë,
të-cilënë e hapi për nę me anë të kurtinësë,
21 do-me-thënë, të mishit të ti, Edhe *dyke pa-
surë* një prift të-math mbi shtëpit të Perën-
22 dise, Let' afëronemi me zëmërë të-vërtetë e
me besë të-mbaruarë, dyke pasurë zëmëratë
t' ona të-qëruara prej ndërgjegjeje së-ligë;
23 Edhe, dyke pasurë trupinë të-larë me ujë të-
kulluarë, letë mbajmë rrëfimin' e shpresësë
të-patundurë; sepse besëtar ësht' ay që u-
24 zotua; Edhe letë kujdesemi njëri për tjatë-
rinë, dyke nguturë ndë dashuri e ndë punëra
25 të-mira; Edhe letë mos lëmë të-mbledhuritë
t' anë bashkë, sikundrë është zakon mbë ca
veta, po të ngutimë njëri tjatërinë; edhe kaqë
më tepërë, sa shihni ditënë që po afëronetë.

26 Sepse ndë fëjefshimë neve dyke dashurë,
passi muarmë të-njohurit' e së-vërtetësë, nukë
27 mbetetë më kurban për faje; Po një të-pri-
turë gjyqi të-frikshim, edhe *një* të-ndezurë
zjarri, i-cili ka për të ngrënë ata që janë
28 kundrë. Ndë shkeltë ndonjë nomin' e Moisi-
ut, pa përdëllim përpara dy a tre dëshmim-
29 tarëve vritetë; Sa më të-keq mundim, u du-
ketë juve, *se* dotë heqë ay që ka shkelurë me
këmbe të Birin'e Perëndisë, edhe e ka numë-
ruarë *si gjë* të-pëgërë gjakun' e dhjatësë, me
të-cilinë ushënjtërua, edhe ka sharë frymën'
30 e hirit? Sepse e dimë atë qe ka thënë, "Çpa-
gimi *eshte* imi, unë kam për të çpaguarë,
thotë Zoti. Edhe përsëri, "Zoti dotë gjykonjë
31 llauzin' e ti.„ *Pun'* e-frikshime *është* të bjerë
njeriu ndër duart të Perëndis' së-gjallë.

32 Bini ndër mëntt *ato* ditt' e-para, ndë të-
cilat, passi undriçuatë, duruatë të-madhe
33 luftë të-hequrash; Kur, dyke ubërë lodrëti *prej
botësë* me të-shara e me shtrëngime; kur, dy-
ke ubërë pjesëtarë t' atyreve që pesonjënë të
34 këtillatë. Sepse treguatë dhëmbje *për mua*
ndë të-lidhurat të mia, edhe të-rrëmbyerët'
e kamjesë s' uaj e prittë me gëzim, dyke di-
turë, se keni për vetëhenë t' uaj ndë qiejt
35 një pasje më të-mirë e të-qëndruarshime. Mos
e humpni pra kuximinë t' uaj që ka për të
dhënë çpagim të-math.

36 Sepse ju keni nevojë për durim, që të

bëni dashurimn' e Perëndisë, edhe të merrni
37 të-zotuarëtë. „Sepse edhe fort pakëzë kohë,
edhe dotë vinjë ay që vjen, edhe nukë dotë
38 mënonjë.„ "Edhe i-drëjti dotë rronjë prej be-
sësë;„ edhe "ndë uheqtë *ndonjë* prapa, shpirti
39 im nukë gjen pëlqim mb' atë.„ Po neve nukë
jemi nga ata që hiqenë prapa për humbje,
po nga ata që besonjënë për shpëtim të-
shpirtit.

Krye 11.

1 Edhe besa është të-qënurë të gjërërave
që shpërehenë, dëftesë punërave që nukë
shihenë.
2 Sepse me anë të kësaj muarnë dëshmim
të-mirë të-moçimitë.
3 Me anë të besësë kupëtojmë se jetët' u-
ndërtuanë me fjalën'e Perëndisë, kaqë sa ato
që shihenë nuk' ubënë prej *gjërërave* që du-
kenë.
4 Me anë të besësë Abeli i pruri Perëndisë
më të mirë kurban se Kaini, me anë të së-
cilësë mori dëshmim se ishte i-drejtë, sepse
Perëndia dha dëshmim për dhuratat' e ati;
edhe me anë t' asaj, ndonëse vdiq, edhe po
flet.
5 Me anë të besësë Enohu undërrua vëndit,
që të mos shohë vdekje, "edhe nukë gjëndej,
sepse Perëndia e ndërroj vëndit;„ sepse më
përpara se të ndërrohej vëndit kishte dëshmim,

6 se i kishte pëlqyerë Perëndisë. Edhe pa besë
është pun' e-pamundurë t' i pëlqenjë *njeriu*
ati; sepsë ay që afëronetë te Perëndia du-
hetë të besonjë, se është, edhe se bënetë
pagë-dhënës mb' ata që e kërkonjënë atë.
7 Me anë të besësë i udëftye Noesë nga
Perëndia për ato *punëra* që edhe nukë shi-
heshinë, edhe si ufrikësua, ndërtoj një arkë
për shpëtim të shtëpis' së ti; me anë te së-
cilësë dënoj botënë, edhe ubë trashëgimtar
i drejtërisë *që eshtë* me anë të besësë.
8 Me anë të besësë ubint Avraami, kur
uthërrit të dalë mb' atë vënt, të-cilinë kishte
për të marrë për trashëgim, edhe dolli pa di-
9 turë se ku vete. Me anë të besësë vate e
ndënji ndë dhet të të-zotuarit si *mbë një* dhe
të-huaj, edhe ndënji ndë tenda, bashkë me
Isaakun' e me Jakovinë bashkëtrashëgimtarët'
10 e gjithati të-zotuari; Sepse priste qytetinë
që kishte themelitë, mjeshtër edhe ndërtestar
i të-cilit është Perëndia.
11 Me anë të besësë edhe ajo Sarra mori
fuqi të bënetë me barrë, edhe, ndonëse i ki-
shte shkuarë koha e moshësë, polli, sepse
12 e numëroj të besësë atë që i uzotua. Përan-
daj edhe prej njëj *njeriu*, edhe këtij gati për
të vdekurë, lintnë *kaqë shumë njerës* sa yjt'
e qiellit nga shumica, edhe posi rëra e-pa-
numëruarë që është ndë buzët të detit.
13 Këta të-gjithë vdiqnë më besë, pa marrë

të-zotuaratë, po i panë ato për-së-largu, (edhe
uvërtetuanë për ato,) edhe i përshëndoshnë
ato, edhe rrëfyenë së janë të-huaj edhe t' ar-
14 dhurë mbi dhet. Sepse ata që flasënë të-
15 këtilla, dëftenjënë se kërkonjënë atdhe. Edhe
ndë e mbaninë mënt atë *atdhe*, prej të-cilit
patnë dalë, dotë gjeninë kohë të ktheneshinë
16 *atjë*. Po ndashti dëshëronjënë *një atdhe* më
të-mirë, do-me-thënë, qielluar; përandaj Pe-
rëndisë nuk' i vjen turp të quhetë Perëndi i
atyreve; sepse bëri gati për ata qytet.
17 Me anë të besësë Avraami, kur provonej,
pruri Isakunë *për kurban;* edhe ay që pat
priturë të-zotuaratë pruri për *kurban birin'* e
18 ti të-vetëmlindurinë, Mbë të-cilinë qe folurë
„Se mbë Isaakunë dotë quhetë fara jote;"
19 Dyke menduarë, se Perëndia munt të ngjall-
një edhe prej së-vdekurish; prej të-cilëvet
edhe e mori atë prapë me të-përgjajturë.
20 Me anë të besësë Isaaku bekoj Jakovin'
edhe Isafinë për *punëratë* që kishinë për të-
ardhurë.
21 Me anë të besësë Jakovi dyke vdekurë
bekoj sicilin' e bijvet të Josifit, „edhe ufal
dyke pshteturë mbi majët të shkopit të ti."
22 Me anë të besësë Josifi dyke vdekurë
përmëndi për të-dalët' e bijvet të Israilit *nga*
Egjypta, edhe porositi për eshtërat' e tia.
23 Me anë të besësë Moisiu, si lindi, ufsheh
tre muaj prej prindërvet të ti, sepse panë se

çuni ishte i-bukurë; edhe nuk' utrëmpnë nga
24 urdhëri i mbretit. Me anë të besësë Moisiu,
si ubë i-math, mohoj të thuhetë i bir' i së
25 bijës' së Faraonit; Sepse sgjodhi më tepërë
të heqë keq bashkë me llauzin' e Perëndisë,
26 se të ketë dëfrim faji për pákëzë kohë; Dyke
numëruarë dhunën' e Krishtit për më të-ma-
dhe pasje se thesarëtë ndë Egjyptë; sepse
27 shikonte ndë çpagimt. Me anë të besësë la
Egjypënë pa pasurë frikë për zëmëratën' e
mbretit; sepse qëndroj posi dyke parë të-
28 padukurinë. Me anë të besësë bëri pashkënë
edhe të-përskaturit' e gjakut, që të mos i
ngiste ata ay që prishte të-parëlinduritë.
29 Me anë të besësë shkuanë ndëpër Dett
të-Kuq posi ndëpër tokë; të-cilinë kur e pro-
vuanë Egjyptianëtë, umbytnë.
30 Me anë të besësë ranë muret' e Jerihosë,
si uqerthëiluanë shtatë herë.
31 Me anë të besësë kurva Rahabë nukë hum-
bi bashkë me ata që s' bindeshinë, passi
priti përgjonjësitë me paqtim.
32 Edhe ç' të them më? Sepse nukë dotë më
arrinjë koha të tregonj për Gjedheoninë, e
për Barakunë, e për Sampsoninë, e për Jef-
thaenë, për Dhavidhinë e për Samuilin' e për
33 profitëritë; Të-cilëtë me anë të besësë muntnë
mbretërira, punuanë drejtëri, fituanë të-zotu-
34 aratë, thurnë gojë leonësh, Shuanë fuqin' e
zjarrit, shpëtuanë nga gojët' e thikësë, muarnë

fuqi nga dobësiratë, ubënë të-fortë ndë luf-
35 të, thyenë ushtërirat' e të-hujvet; Gra mu-
arnë të-vdekurit' e tyre të-ngjallurë; e të-tjerë
umunduanë, sepse nukë pritnë shpëtiminë,
36 që të fitoninë *një* të-ngjallurë më të-mirë; E
të-tjerë uprovuanë me të-përqeshura e me
të-rrahura, po edhe me të-lidhura e me burk;
37 Uvranë me gurë, usharruanë, unganë, vdiqnë
prerë prej thike; vininë vënde mbë vënde
veshurë me lëkurë dhënsh, *e* me lëkurë dhish,
dyke pasurë nevojë, dyke pasurë shtrëngime,
38 dyke hequrë keq, (*Ata* për të-cilëtë bota nuk'
ishte e-vëjyërë;) dyke shkuar' andej e këtej
ndëpër shkretëtira e ndëpër male e ndëpër
shpella e ndëpër vërat të dheut.
39 Edhe këta të-gjithë, ndonëse muarnë dësh-
mim *të-mirë* me anë të besësë, nukë muarnë
40 të-zotuarëtë; Sepse Perëndia pat urdhëruarë
që përpara një gjë më të-mirë për ne, që të
mos bënenë të-sosurë pa neve.

Krye 12.

1 Andaj edhe neve, rrethuarë prej një kaqë
së-madhe reje dëshmimtarësh, letë hethmë
tej çho barrë edhë fajinë që *na* pushton
kaqë lehtë, edhe me durim letë sulemi ndë
2 udhët që është përpara nesh, Dyke shiku-
arë mbë Jisunë që *është* kryet' edhe fundi i be-
sësë, i-cili përgëzimnë që ishte përpara ati du-
roj kryqnë, pa zënë për gjë turpjenë, edhe

ndënji ndë të-djathtët të fronit të Perëndisë.
3 Sepse kujtoni atë që duroj prej fajtorë-
vet të-këtillë kundrëfolje mbë vetëhen'e ti,
që të mos lodhi dyke udobëtuarë ndë shpir-
tërat t'uaj.
4 Ju edhe s'keni qëndruarë gjer mbë gjak,
5 dyke luftuarë kundrë fajit; Edhe keni harru-
arë këshillenë, që posi bijve u flet juve,
dyke thënë, "Biri im, mos hith tej mundi-
min'e Zotit; mos e hump zëmërënë, kur qërto-
6 nesh prej ati. Sepse atë që do Zoti e mun-
don, edhe rreh çdo bir që pret përanë vetë-
7 hesë.„ Ndë durofshi mundiminë, Perëndia si-
lletë mbë ju, posi mbë bij; sepse cili është
8 ay bir që s'e mundon i ati? Po ndë jeni pa
mundim, mbë të-cilinë ubënë pjesëtarë të-gji-
9 thë, atëhere jeni doçër, e jo bij. Pastaj atë-
ritë t'anë pas mishit i kishimë mundonjës, e-
dhe i nderonim'ata; a nukë dot'i unjmë kryetë
shumë më tepërë Atit të frymavet, edhe të
10 rrojmë? Sepse ata *na* mundoninë për pak
dit, sipas pëlqimit të tyre; po ay për të-mi-
rënë *t' ënë*, që të bënemi pjesëtarë të shënj-
11 tëris' s' ati. Edhe çdo mundim ndashti nukë
duketë se bje gëzim, po hidhërim; po pas-
taj u ep pemë paqtimi prej drejtërie atyreve
12 që janë stërviturë me anë t' ati. „Përandaj
forconi duart' e-dobëtuara edhe gjunjët' e-kë-
13 puturë,„Edhe" bën-u-ni këmbëvet t' uaj udhë
të-drejta,„ që të mos dalë jashtë udhësë ajo që

ësht' e-çalë, po më tepërë të shëronetë.
14 Kërkoni paqtim me të-gjithë, edhe shënj-
tëriminë, pa te-cilinë asndonjë nukë ka për
15 të parë Zotinë; Dyke vënë re semos mbetetë
ndonjë i-shterurë nga hiri i Perëndisë; "semos
mbinjë ndonjë rrënj' e-hidhurë, e *u* trumbu-
llon.„ edhe me anë të kësaj ndyrenë shumë
16 *vëta*; Se mos ndodhetë ndonjë kurvar e i-
ndyrë si Isafi, që shiti parëlindjet' e ti për një
17 gjellë. Sepse e dini, se edhe pastaj, kur de-
shi të trashëgonjë bekimnë, uhoth tej; sepse
nukë gjeti vënt pendimi, ndonëse e kërkoj
me lot.
18 Sepse nukë jeni afëruarë ndë mal që zi-
hetë me dorë, e që digjetë me zjarr, edhe
mbë vrërësirë, e mbë errësirë, e mbë thë-
19 llim, E mbë zë trumbete, e mbë zë fjalësh,
të-cilin' ata që e dëgjuanë ulutnë të mos u
20 flitej më fjala atyreve; (Sepse nukë *munt-
ninë të* duroninë urdhërinë, që "Edhe shtëzë
ndë i pjektë malit, dotë vritetë me gurë, a
21 dotë shëgjetonetë me shëgjetë;„ Edhe kaqë
të-frikshim ishte të-dukuritë, *sa* Moisiu tha,
22 Jam fort i-frikësuarë edhe i-trëmburë;) Po
uaferuatë ndë malt Sion, edhe ndë qytett të
Perëndis' së-gjallë, ndë qjelloret Jerusalime,
23 edhe ndë shumë mijëra ëngjëjsh, Ndë mble-
dhjet e ndë kishët të të-parëlindurëvet, të-ci-
lëtë janë shkruarë ndë qiejt, edhe te Perën-
dia, gjykatësi i të-gjithëve, edhe te shpirtë-

rat' e të-drejtëvet që janë bërë të-sosurë,
24 Edhe te mestari i dhjatës' së-re Jisu, edhe ndë
gjakt të të-përskaturit, që flet më mirë se
ay i Abelit.
25 Shikoni semos hiqni dorë nga ay që flet;
sepse ndë mos shpëtuanë ata që hoqnë dorë
nga ay qe fliste *tek ata* mbi dhet, shumë
më tepërë *nukë dotë sdpëtojmë* neve, ndë i
kthefshimë krahëtë ati *që flet* prej qiejvet;
26 Zër' i të-cilit atëhere tundi dhenë; po ndashti
uzotua, dyke thënë, "Unë edhe një herë dotë
27 tunt jo vetëmë dhenë, po edhe qiellinë.„ E-
dhe këjo *fjalë* "Edhe një herë„ dëften të-
ndërruarrët' e vëndit t' atyreve që tundenë,
posi të-bëra *me dorë*, që të mbetenë ato që
28 nukë tundenë. Përandaj passi marrëmë një
mbretëri të-patundurë, letë mbajmë hirinë,
me anë të të-cilit pëlqyershim t' adhurojmë
29 Perëndinë, me nder e me të-druajturë. Sepse
"Perendia ynë *është* zjarr që tret.„

Krye 13.

1 Dashuria e vëllazërisë letë mbesë; (2) Mos
harroni dashurinë mbë të-huajtë; sepse me
anë të kësaj ca pa diturë pritnë ëngjëj ndë
3 shtëpit të tyre. Kujtoni te-lidhuritë, si të-
lidhurë bashkë me ata; ata që heqënë
keq, sikur se jeni edhe vetë ndë trupt *t' aty-*
4 *reve.* Martesa letë jet' e-nderçime ndër të-
gjithë, edhe shtrati i-paturpëruarë; sepse kur-

varët' e pëgërësitë dot' i gjykonjë Perëndia.
5 Të-sjellatë t' uaj *letë jenë* pa lakmim ergjën-
di; let' u jenë mjaft ato që keni ndashti; se-
pse ay ka thënë, "Nukë të kam për të lënë,
as nukë kam për të hequrë dorë prej teje;„
6 Përandaj neve me kuxim letë themi, "Zoti
është ndihmësi im, edhe nukë dotë kem frikë;
ç' dotë më bënjë njeriu?„
7 Kujtoni të-parëtë t'uaj, të-cilët' u folnë
juve fjalën' e Perëndisë; besën' e atyre kini-
e për shëmbëllë, dyke pasurë përpara syvet
pemën' e të-sjellavet t'atyre.
8 Krishti *është* gjithay dje edhe sot, edhe
9 ndë jetët të jetëvet. Mos bihi andej e këtej
prej mësimesh të-ndryshm e të-huaj; sepse
është mirë të forconetë zëmëra juaj me hir,
e jo me të-ngrëna, ndë të-cilat sa ecnë nukë
panë *ndonjë* dobi.
10 Kemi një therore, prej së-cilësë s' kanë
pushtet të hanë ata që adhuronjënë ndë
11 tendët. Sepse trupat' e atyre shtëzave, gjaku
i të-cilavet bihetë brënda ndë shënjtëroret
prej kryepriftit për faj, digjenë jashtë fu-
12 shatësë. Përandaj edhe Jisuj, që të shënjtë-
ronjë llauzinë me anë të gjakut të ti, pësoj
13 jashtë portësë. Letë dalëmë pra tek ay jash-
të fushatësë, dyke mbajturë dhunën' e ati.
14 Sepse nukë kemi këtu qytet që mbetetë *përherë*,
15 po kërkojmë atë që ka për të ardhurë. Me
anë t' ati pra letë biemë gjithënjë te Perëndia

BKSH

kurban lavdie, do-me-thënë, pemë buzësh, që
16 rrëfenjënë emërin' e ati. Edhe mos harroni të
bëni mirë e t'u epni ndihmë *të-vobeqvet*, sepse
mbë të këtillë kurbanë gjen pëlqim Perën-
17 dia. Binduni ndë të-parët t'uaj, edhe dëgjo-
i-ni; sepse ata rrinë sgjuarë për shpirtëratë
t'uaj, sepse ata kanë për të dhënë fjalë; që
t'a bënjënë këtë me gëzim, e jo dyke pshe-
rëtiturë; sepse këjo nuk' u bën dobi juve.
18 Faluni per ne; sepse na është mbushurë
mëndja, se kemi ndërgjegje të-mirë, dyke
dashurë të sillemi mirë mbë gjithë punërat.
19 Po më tepërë u lutemi juve t'a bëni këtë,
që të kthenem ndër ju më çpejt.
20 Edhe Perëndia i paqtimit, i-cili ngriti prej
së-vdekurish barin' e-math të dhënvet me
anë të gjakut të dhjatës' së-përjetëshme,
21 Zotinë t'ënë Jisu Krisht, U bëftë juve të-sɔ-
surë mbë çdo punë të-mirë, që të bëni da-
shurimin' e ati, dyke punuarë ndër ju atë
që është e-pëlqyerë përpara ati, me anë të
Jisu Krishtit; mbë të-cilinë *qoftë* lavdia ndë
jetët të jetëvet. Amin.
22 Edhe u lutem juve, o vëllezër, duroni fja-
lën' e këshillësë; sepse me pak fjalë u shkro-
va juve.
23 E dini se vëllaj Timotheu ulëshua *nga
burgu*, më të-cilinë, ndë arthtë më çpejt, dot'
u shoh juve.
24 Ep-u-ni të-fala me shëndet gjithë të-pa-

rëvet t'uaj, edhe gjithë shënjtorëvet. U falenë
me shëndet juve ata që janë nga Italia.
25 Hiri *qoftë* me ju të-gjithë. Amin.

Karta e-përgithëshme e apostollit Jakov.

Krye 1.

1 Jakovi, shërbëtuar i Perëndisë edhe i Zotit
Jisu Krisht, mbë të dy-mbë-dhjetë faratë që
janë përndarë andej e këtej, gëzuashi.
2 Numëro-e-ni për gëzim të-math, o vëllezërit'
e mi, kur bini mbë çdo farë ngasjesh;
3 Dyke diturë, se provimi i besësë s'uaj
4 punon durim; Edhe durimi letë ketë punë
të-sosurë, që të jeni të-sosur' edhe te-tërë,
pa qënë të-metë as mbë ndonjë gjë.
5 Edhe ndë ndonjë prej jush ësht' i-metë ndë
dituri, letë lypënjë prej Perëndisë që u ep
të-gjithëve pa kursim, e nukë qërton; edhe
6 dot' i epet' ati. Po letë lypënjë me besë, pa
pasurë dyshim asfare; sepse ay që ka dy-
shim i gjan valës' së detit, që ngrihetë prej
7 erës' e përpiqetë. Sepse letë mos pandehnjë
8 ay njeri, se dotë marrë gjë nga Zoti; Njeriu
me dy mëndje ësht' i-paqëndruarshim mbë
gjith' udhët' e tia.
9 Edhe letë mburretë vëllaj shkallë-poshtërë

BKSH

10 ndë të-lartët të ti; E i-pasuri ndë të-përu-
njurit të ti: sepse posi lule bari dotë shko-
11 një. Sepse lindi djelli me të-përvëluarët' *e ti,*
edhe thau barinë, edhe lulej' e ati ra, edhe
bukuria e faqes' s' ati humbi; kështu edhe
i-pasuri dotë fyshketë ndë udhët të tia.
12 Lum ay njeri që duron ngasje; sepse passi
të provonetë, dotë marrë kurorën' e jetësë,
të-cilënë u është zotuarë Zoti atyreve që e
duanë.
13 Asndonjë, kur ngitetë, letë mos thotë, se
ngitem nga Perëndia; sepse Perëndia nukë
munt të ngitetë nga të-ligatë, edhe ay as-
14 ndonjë nukë nget. Po gjithësicili ngitetë dyke
uhequr' e dyke ukobuarë prej dëshërimit të
15 vetëhes' së ti. Pastaj dëshërimi, si të mbar-
setë, pjell faj; edhe faji, si të bënetë, pjell
vdekje.
16 Mos ugënjeni, o vëllezërit' e mi të-dashu-
17 rë; Çdo dhënëje e-mirë, edhe çdo dhurëti
e-sosurë, është së-sipërmi, edhe sbret nga
Ati i dritavet, mbë të-cilinë s' ka të-ndë-
18 rruarë a hie të kthyeri. Prej dashurimit të ti
na polli me anë të fjalës' së të-vërtetësë, që
të jemi neve një pem' e-parë e ndërtesa-
vet t' ati.
19 Përandaj, o vëllezërit' e mi të-dashurë, çdo
njeri letë jet' i-çpejtë mbë të dëgjuarë, i-më-
nuarë mbë të-folurë, i-mënuarë mbë zë-
20 mërim; Sepse zëmërimi i njeriut nukë pu-

BKSH

21 non drejtërin' e Perendisë. Përandaj, si të
hithni tej çdo ndyrësi e të-tepëruarë ligësie,
pritni me butësirë fjalënë që është mbjellë
ndër ju, e-cila munt të shpëtonjë shpirtëratë
22 t'uaj. Edhe bëhi asish që e bënjënë fjalënë
e jo vetëm' asish që e dëgjonjënë, dyke gë-
23 njyerë vetëhenë t'uaj. Sepse kush dëgjon
fjalënë e nuk' e bën, ky i gjan një njeriu që
shikon faqen' e ti naturake ndë pasqyrë;
24 Sepse e shikoj vetëhen' e ti, edhe iku, edhe
25 përnjëhere harroj i-çfarëtë ishte. Po ay që
unjet' e shikon ndë nomt të-sosurë të lirisë,
edhe qëndron *mb' atë*, ky dyke ubërë jo asi
që dëgjon e harron, po asi që bën punënë,
ky dotë jet' i-lumurë ndë punët të ti.
26 Nde pandeh ndonjë ndër ju se është i-
feshim, edhe s'i vë fre gjuhës' së ti, po ko-
bon zëmërën' e ti, feja e këti *ësht'* e-kotë.
27 Fe e-kthjellët' edhe e-papëgërë përpara Pë-
rëndisë edhe Atit është këjo, Të shikonjë
njeriu të-varfër' e *gra* të-va ndë shtrëngimt
t'atyre, *edhe* të ruanjë vetëhen' e ti të-pazhy-
erë nga bota.

Krye 2.

1 Vëllezërit' e mi, mos kini besën' e të-lav-
duruarshimit Zotit t'ënë Jisu Krisht me të-
2 bërë faqe. Sepse ndë hyftë ndë mbledhjet
t'uaj *ndonjë* njeri që ka unazë t'artë me
rrobë të-çkëlqyerë, edhe të hynjë edhe një

3 i-vobek me rrobë të-fëlliqurë, Edhe të shtini
sytë mb' atë që ka veshurë rrobën' e-çkël-
qyerë, edhe t'i thoni ati, Ti rri këtu mirë,
edhe të vobegut t'i thoni, Ti rri atje, a, Rri
4 këtu ndënë ndënëkëmbjenë t'ime; A nukë
bëtë me vetëhenë t'uaj të-çquarë *ndër mest*
t'atyre, edhe ubëtë gjykatës mendimeve të-
5 liq? Pa dëgjoni, o vëllezërit' e mi të-dashurë,
A nukë sgjodhi Perëndia të-vobeqt' e kësaj
bote *për* të-pasurë ndë besët, edhe *për* tra-
shëgimtarë të mbretërisë, të-cilën' u është
6 zotuarë atyreve që e duanë? Po ju e çpër-
nderuatë të-vobegunë. A nuk' u mundonjënë
juve të-pasuritë, edhe ata u heqnjënë ndë-
7 për gjykatat? A nukë shanjënë ata emërin'
8 e-mirë, me të-cilinë jeni quajturë? Ndë
ruani pra nomin' e-mbretëruarë, pas shkro-
njësë, „Të duash të-afërminë t' ënt posi ve-
9 tëhenë t'ënde," bëni mirë; Po ndë mbani anë,
bëni faj, edhe qërtohi nga nomi si porosi-
shkelës.
10 Sepse ay që të ruanjë gjithë nominë, edhe
të fëjenjë mbë një *gjë*, është fajtuar mbë të-
11 gjitha. Sepse ay që tha, „Mos kurvëronjç,"
tha edhe, „Mos vraç". Po ndë mos kurvë-
rofsh, po të vraç, ubëre shkelës i nomit.
12 Kështu flisni, edhe kështu bëni, sikurse
jeni për të gjykuarë prej nomit të lirisë;
13 Sepse giyqi *dotë jetë* i-papërdëllyershim
mb' atë që s' bëri përdëllim; edhe përdëlli-

mi mburretë kundrë gjyqit.
14 Ç' dobi ka, o vëllezërit' e mi, ndë thëntë
ndonjë se ka besë, e punëra të mos ketë?
15 mos munt t'a shpëtonjë besa? Ndë qoftë se
vëllaj a motëra janë lakuriq, edhe u shteret'
16 ushqimi i-përditshim, Edhe t'u thot' atyre
ndonjë prej jush, Shkoni ndë paqtim, ngrohi
e ngihi, e të mos u epni atyreve ato që janë
17 të-nevojshime për trupinë, ç'dobi ka? Kësh-
tu edhe besa, ndë mos pastë punëra, ësht'
18 e-vdekurë ndë vetëhet të saj. Po dotë thotë
ndonjë, Ti ke besë, e unë kam punëra;
dëfte-më besënë t'ënde nga punërat' e tua,
edhe unë dotë të dëftenj besënë t'ime nga
19 punërat' e mia. Ti beson se Perëndia është
një; mirë bën; edhe djajtë besonjënë, edhe
20 dridhenë. Po a do të kupëtonjç, o njeri i-
kotë, se besa pa punëratë esht' e-vdekurë?
21 Avraami, ati ynë, a nukë dolli i-drejtë nga
punëratë, kur pruri Isaakunë, të birin' e ti,
22 mbi therorenë? A sheh se besa punonte
bashkë me punërat' e ati, edhe besa ubë
23 e-sosurë nga punëratë? Edhe umbush shkro-
nja që thotë, „Edhe Avraami i besoj Pe-
rëndisë, edhe i unumërua për drejtëri" edhe
24 uquajt „miku i Perëndise". A shihni pra se
njeriu del i-drejtë nga punëratë, e jo nga
25 besa vetëmë? Edhe gjithashtu edhe kurva
Rahabë a nukë dolli e-drejtë nga punëratë,
kur priti ata që ishinë dërguarë, edhe i nxrori

BKSh

26 nga një tjatërë udhë? Sepse sikundrë trupi
pa frymë ësht' i-vdekurë, kështu edhe besa
pa punëratë ësht' e-vdekurë.

Krye 3.

1 Mos bëhi shumë mësonjës, o vëllezërit' e
mi, dyke diturë se dotë marrëmë më të-math
2 dënim; Sepse mbë shumë *punëra* të-gjithë
fëjejmë. Ndë qoftë se nukë fëjen ndonjë ndë
fjalë, ky është burr' i-sosurë, i-fuqishim
3 t'i vërë fre edhe gjithë trupit. — Na kuajvet
frenjtë u'a vëmë ndë gojët, që të na bindenë,
edhe e heqmë gjithë trupin' e atyreve. —
4 Na edhe aniatë, ndonëse janë kaqë të-mëdha
edhe shtyhenë prej erërash të-forta, shpihenë
prej një timoni të-vogëlë, atje ku të dojë
5 qivernitari. Kështu edhe gjuha është një cop'
e-vogëlë, po mbahetë mbë të math. — Na
pak zjarr tek djek kaqë të-madhe lëndë.
6 Edhe gjuha është zjarr, bota e shtrëmbërisë.
Keshtu ndër anët *të trupit* t'ënë gjuha është
ajo që fëlliq gjithë trupinë, edhe flakëron'
rrotën' e jetësë, edhe flakëronetë prej gjehe-
7 nësë.—Sepse çdo farë bishash e shpesësh,
shtërpinjsh e gjësh të-gjalla të detit, sbutetë,
edhe është sbuturë prej naturës' së njeriut;
8 Po gjuhën' asndonjë nga njerëzitë s'munt t'a
sbutnjë; është *një* e-keqe që s'munt të push-
9 tonetë, plot me vërer që bje vdekje. Me atë
bekojmë Perëndinë edhe Atinë, edhe me atë

mallëkojmë njerëzitë që janë bërë pas shëm-
10 bëllimit të Perëndisë. Prej gjithasaj goje del
bekim edhe mallëkim. Nukë duhetë, o vëlle-
11 zërit' e mi, të bënenë këto kështu. Mos bu-
rimi prej gjithasaj vëre buron ujë t'ëmbëlë
12 edhe të-hidhurë? Mos munt, o vëllezërit' e mi,
drur' i fikut të bënjë ullinj, a hardhia *të bë-
një* fiq? Kështu asndonjë burim s' *munt* të bë-
një ujë të-kripurë edhe t'ëmbëlë.
13 Kush *është* ndër ju i-mënçim e i-diturë?
letë rrëfenjë prej të-sjellavet të-mira punë-
14 rat' e ti me butësirë urtësie. Po ndë kini ndë
zëmërët t'uaj cmir të-hidhurë edhe grindje,
mos mbahi mbë të-math edhe mos gënjeni
15 kundrë së-vërtetësë. Këjo dituri nukë sbret
prej së-sipërmi, po është prej dheu, prej
16 shtëze, prej djalli; Sepse ku *ka* cmir e
grindje, atje *ka* trazyrë e çdo punë të-ligë.
17 Po dituria që është prej së-sipërmi, më për-
para është e-kthjellëtë, pastaj paqtore, e-
butë, e-bindurë, plot me përdëllim e me pu-
nëra të-mira, s'mbanj anë edhe s'është me
18 dy faqe. Edhe pema e drejtërisë mbilletë
me paqtim prej atyreve që bënjënë paqtim.

Krye 4.

1 Nga se vinjënë luftëra e qarta ndër ju?
Jo që këtej, nga dëshërimetë që luftonjënë
2 ndër anët *të trupit* t'uaj? Dëshëroni, e nukë
keni; vritni e keni cmir, edhe nukë munt të

qëlloni ; zihi e luftoni, po nukë keni ; sepse
3 nukë lypni. Lypni, e nukë merrni, sepse lyp-
ni keq, që të prishni ndë dëshërimet t'uaj.
4 O kurvarë e kurva, nukë dini se miqësia
e botësë ësht' armiqësi e Perëndisë? ay pra
që të dojë të jetë miku i botësë, bënetë ar-
5 miku i Perëndisë. Apo pandehni se mbë kot
shkronja thotë, Për cmir dëshëron fryma që
6 ndënji ndër ne? Po *Perëndia* ep një hir më
të-math, përandaj thotë, „Perëndia madhë-
shtorëvet u rri kundrë, po kryeunjurëvet u ep
7 hir.“ Binduni pra te Perëndia ; rrini kundrë
8 djallit, edhe dotë ikënjë nga ju. Afërohuni
Perëndisë, edhe dot' u afëronetë juve. Pa-
stroni duartë *t'uaj*, o fajtorë, edhe qëroni zë-
9 mëratë, o njerës me dy mëndje. Hiqni keq
e bëni vajë e qani ; të-qeshuritë t'uaj letë
kthenetë mbë vajë, edhe gëzimi juaj mbë
10 hidhërim. Përunjuni përpara Zotit, edhe dot'
u ngrerë lart juve.
11 Mos flisni keq njëri për tjatërinë, o vë-
llezër; ay që flet keq për vëllanë, edhe gjy-
kon të vëllanë, flet keq për nomnë, edhe
gjykon nomnë; edhe ndë gjykon nomnë, nu-
12 kë je ruajtës i nomit, po gjykatës *i ati*. Një
është nom-dhënësi që munt të shpëtonjë e-
dhe të humbasë; cili je ti që gjykon tjatë-
rinë?
13 Ejani tashti ju që thoni, Sot a nesërë dotë
vemi ndë këtë qytet, edhe dotë bëjmë atje

një vit, edhe dotë tregëtojmë e dotë fitojmë;
14 Ju që nukë dini se ç' dotë bënetë nesërë; se-
pse ç' është jeta juaj? është me të-vërtetë
një avull që duketë për pakëzë *kohë*, e pa-
15 staj humbetë; Ndë vëntt që të thoni, Ndë
dashtë Perëndia, edhe ndë rrofshimë, dotë
16 bëjmë këtë a atë. Po tashti mburreni mbë
madhështirat t' uaj; çdo të-tillë të-mburrurë
është të-lik.
17 Mb' atë pra që di të bënjë të-mirë, edhe
nukë bën, mb' atë *kjo* është faj.

Krye 5.

1 Ejani tashi' ju të-pasuritë, qani e ulurini për
2 të-këqiatë që dotë vinjënë mbi ju. Pasja juaj
ukalp, edhe rrobatë t'uaj u'a brëjti mola.
3 Ari juaj edhe ergjëndi undryshk, edhe ndry-
shku i atyreve dotë jetë për dëshmim kun-
drë jush, edhe dotë hajë mishratë t' uaj si
zjarr; mblothtë thesarë për ditt' e-pastajme.
4 Na tek bërtet paga që u'a keni mbajturë
punëtorëvet që korrnë aratë t' uaj; edhe të-
bërtiturat' e korrësvet hynë ndë veshët të
5 Zotit Sabaoth. Ukënaqtë e bëtë pallë mbi
dhet; ushqyetë zëmëratë t' uaj posi mbë ditë
6 të të-theruri; Dënuatë, *edhe* vratë të-drejtinë;
e *ay* nuk u rri juve kundrë.
7 Kini zëmërë të-gjerë pra, o vëllezër, gjer
mbë t' ardhurit të Zotit. Na bujku tek pret
të-paçëmuarënë pemë të dheut, e ka zëmërë

BKSH

të-gjerë për atë, gjersa të marrë shin' e-lash-
8 të e të-voninë. Kini zëmërë të-gjerë edhe
ju, forconi zëmëratë t' uaj; sepse t' ardhurit'
e Zotit uafërua.
9 Mos psherëtini kundrë njëri tjatërit, o vë-
llezër, që të mos dënoneni; ja gjykatësi tek
10 rri përpara dyervet. Merrni për shëmbëllesë,
o vëllezërit' e mi, të te-hequrit keq e të zëmërës'
së-gjerë profitëritë, që folnë mb' emërit të
11 Zotit. Na tek lumërojmë ata që duronjënë; e
keni dëgjuarë durimin' e Jovit, edhe e patë
të-pastajmen' e Zotit, se Zoti është fort i-
përdëllyershim edhe i-dhëmçurë.
12 Edhe përpara të-gjithave, o vëllezërit' e
mi, mos bëni be, as për qiellinë, as për dhenë,
as ndonjë tjatërë be; po letë jetë poja juaj,
po, edhe joja, jo; që të mos bini ndë dënim.
13 Heq keq ndonjë ndër ju? letë faletë; ka
14 zëmërë të-gëzuarë? letë psallnjë. Esht' i-së-
murë ndonjë ndër ju? letë thërresë pleqt' e
kishësë, edhe letë falenë përmbi atë, e let'a
15 lyenjënë më vaj mb' emërit të Zotit. Edhe
urata *që është* me besë dot'a shpëtonjë atë
që lëngon, edhe Zoti dot'a ngrerë atë; edhe ndë
16 pastë bërë faje, dot' i falenë. Rrëfeni fajetë njëri
tjatërit, edhe fali njëri për tjatërinë, që të
shërohi. Shumë fuqi ka të-luturit' e të-drejtit,
17 kur bënetë *me të-nxehëtë.* Ilia ishte një njeri
që pësonte posi ne, edhe ufal dyke luturë
që të mos bjerë shi; edhe nukë ra shi mbi

18 dhet tre vjet e gjashstë muaj; Edhe përsëri
ufal, edhe qiell: dha shi, edhe dheu dha
pemën' e ti.
19 O vëllezër, ndë daltë ndonjë ndër ju jashtë
udhës' së të-vërtetësë, edhe t'a kthenjë ndonjë
20 atë, Let'a dijë se ay që kthen fajtuar prej kobi-
mit të udhës' s' ati, dotë shpëtonjë një shpirt
prej vdekjeje, edhe dotë mbulonjë shumicë
fajesh.

Karta e-parë e përgjithëshme e apostollit Pjetër

Krye 1.

1 Pjetri, apostoll i Jisu Krishtit, mb' ata që
rrinë ndë dhe të-huaj, të-përndarë ndëpër
Pont *e* ndëpër Gallati, *e* ndëpër Kappadhoqi,
2 *e* ndëpër Asi, e ndëpër Vithini, Të-sgjedhurë
pas të-parënjohurit të Perëndisë, Atit, me anë
të shënjtërimit të Frymësë, për dëgjim e për
përskatje të gjakut të Jisu Krishit; hir edhe
paqtim ushumoftë mbë ju.
3 Qoft' i-bekuarë Perëndia edhe Ati i Zotit
t'ënë Jisu Krisht, i-cili pas përdëllimit të ti
të-shumëtë na polli përsëri ndë *një* shpresë
të-giallë më anë të të-ngjallurit të Jisu Krish-
4 tit prej së-vdekurish, Për *një* trashëgim të-
paprishur' e të-papëgërë e të-pafyshkurë, që
5 është ruajturë ndë qiejt për ne, Të-cilëtë

BKSH

BKSH

me fuqin' e Perëndisë ruhemi me anë të be-
sësë, për shpëtim të-gatishim të sbulonetë
6 ndë kohët të fundit. Për këtë gëzohi, ndo-
nëse tashti pakëzë, (ndë udashtë), hidhëro-
7 hi mbë çdo farë të-ngarash, Që provimi i
besës' s'uaj që është shumë m' i-çëmuar-
shim se ari që prishetë, ndonëse provonetë
me anë zjarri, të gjëndetë për lëvdim e për
nder e për lavdi, kur të sbulonetë Jisu Kri-
8 shti; Të-cilinë, ndonëse s' e keni parë, e doni;
mbë të-cilinë, ndonëse tashti nuk' e shihni,
besoni edhe gëzohi me gëzim të-lavduruar-
9 shim që s' munt të rrëfenetë me gojë, Dyke
marrë të-pastajmen' e besësë s' uaj, shpëti-
10 min' e shpirtëravet; Për të-cilinë shpëtim
kërkuan' edhe vëshguanë profitëritë që pro-
fitepsnë për hirinë *që dotë epej* mbë ju;
11 Dyke vëshguarë mbë cilënë a mbë ç' farë
kohe çfaqte Fryma e Krishtit që *ishte* mb'
ata, kur dëshmonte më përpara për të-pë-
suarat' e Krishtit, edhe për lavditë pas aty-
12 reve; Mbë të-cilët usbulua jo për vetëhen' e
tyre, po për ne i punonin' ato *punëra*, të-
cilatë tashti urrëfyenë mbë ju me anë t'
atyreve që ungjillëzuan' ungjillinë mbë ju
me anë të Frymës' së-Shënjtëruarë, që udër-
gua nga qielli, mbë të-cilatë ëngjëjtë dëshë-
ronjënë të kërrusen' e t' i shohënë.
13 Përandaj si të ngjishni mezat' e mëndjesë
s'uaj, përmbani vetëhenë *nga të-ligatë*, edhe

kini shpresë të-plotë mbë hirinë që dotë
vinjë mbë ju, kur të sbulonetë Jisu Krishti,
14 Si djem të-dëgjuarshim, pa bërë vetëhenë
t'uaj mbë një formë me dëshërimet' e-parë,
15 që kishitë ndë paditjet t'uaj; Po sikundrë
është shënjt ay që u thirri juve, kështu edhe
ju bëhi shënjtorë mbë gjithë të-sjellatë *t'uaj*;
16 Sepse është shkruarë, „Bëhi shënjtorë, sepse
unë jam shënjt."
17 Edhe ndë quani Atë atë që gjykon pa
mbajtur' anë pas punës'së gjithësicilit, shko-
ni me frikë kohën' e të-ndënjurit t'uaj ndë
18 këtë dhe të-huaj që rrini; Dyke diturë se
nuk' uçpërblyetë nga jeta juaj e-kotë që u
kanë lënë juve atëritë me gjërëra që prishenë,
19 *si* me ergjënt a me ar, Po me gjakun' e-
paçëmuarë të Krishtit, posi një qëngji pa
20 palavi e pa të-shgjërryerë; I-cili qe urdhë-
ruarë përpara se të ngrihetë bota, e uçfaq
21 ndë kohërat të fundit për ju, Që me anë
t' ati i besoni Perëndisë që e ngjalli atë
prej së-vdekurish, edhe i dha ati lavdi, që
besa juaj edhe shpresa të jetë mbë Perën-
dinë.
22 Si të qëroni pra shpirtëratë t'uaj me të-
binduritë *t'uaj* ndë të-vërtetët me anë të
Frymësë, për një dashuri vëllazërie e pa dy
faqe, të doni fort njëri tjatërinë prej zëmëre
23 së-kthjellëtë; Sepse jeni lindurë përsëri jo
prej fare që prishetë, po *prej fare* që s'

prishetë, me anë të fjalës' së Perëndisë që
24 rron e që mbetetë (për gjithë jetënë). Sepse
„çdo mish është posi bar, edhe çdo lavdi
njeriu posi lule bari; utha bari, edhe lulja e
25 ati ra; Po fjal' e Zotit mbetetë për gjithë
jetënë." Edhe këjo është fjala që uungjillëzua
mbë ju.

Krye 2.

1 Si të hithni tej pra çdo ligësi e çdo ko-
bim, e ipokrisira, e cmire, e çdo të-përfolura,
2 Posi foshnja lindurë rishtazi, të dëshëroni
qymështin' e thjeshtë të shpirtit, që të rri-
3 teni me anë t' ati; Sepse e keni ngjëruarë
„se Zoti ësht' i-mirë."
4 Mbë të-cilinë dyke ardhurë posi mbë gur
të-gjallë, të-hedhurë tej nga njerëzitë, po të-
5 sgjedhurë nga Perëndia *e* të-nderçim, Edhe
ju, posi gurë të-gjallë, ndërtohi *mbë* shtëpi
shpirtërie, priftëri të-shënjtëruarë, që të bini
kurbanë shpirtërie, të-pëlkyershim te Perëndia
6 me anë të Jisu Krishtit. Përandaj edhe është
shkruarë ndë shkronjët, „Na tek vë ndë
Sion *një* gur krye çipi, të-sgjedhurë, të-nder-
çim; edhe ay që i beson ati nukë dotë tur-
7 përonetë." Mbë ju pra që besoni është nderi
vetë; po mbë të-pabinduritë, „guri që hoth-
në tej ata që ndërtoninë", ky ubë krye çipi
edhe „gur pëngese, edhe gur skandhalie;"
8 Të-cilëtë pengonenë ndë fjalët, sepse nukë

bindenë ; për të-cilënë *gjë* edhe ishinë ndarë.
9 Po ju jeni „gjindje e-sgjedhurë, priftëri mbre-
tërie, komp i-shënjtëruarë," llaus që fitoj
Perëndia, që të rrëfeni mirësit' e ati, që u
thirri juve nga errësira ndë dritët të ti të-
10 çudiçime ; *Ju*, të-cilëtë njëherë nuk' *ishitë*
llaus, po tashti *jeni* llaus i Perëndisë ; *ju* që
njëherë nuk' ishitë të-përdëllyerë, po tashti
upërdëllyetë.
11 O të-dashurë, u lutem *juve* si të-huaj e
të-ardhurë *që jeni*, të hiqni dorë nga dëshë-
rimet' e mishit, të-cilëtë janë ndë luftë kun-
12 drë shpirtit; Të keni të-sjellatë t'uaj të-mira
ndër mest të kombevet, që, tek u përflasënë
juvë për keqbërës, kur të shohënë punëratë
t'uaj të-mira, të lavduronjënë prej atyre Pe-
rëndinë ndë ditët të të-ardhurit.
13 Unjni pra kryetë çdo urdhëri prej njeriu,
14 për Zotinë; Kaqë mbretit, se qëndron mbë
lart nga gjithë, sa *edhe* qivernitarëvet, si
të-dërguarë prej ati për të marrë çpagim nga
ata që bënjënë keq, e për të lëvduarë ata që bë-
15 njënë mirë. Sepse kështu është dashurimi i
Perëndisë, që dyke bërë mirë t'i mbyllni
gojënë padituris' së njerësvet të-marrë ;
16 Si të-lirë, e jo si *njerës* që kanë lirinë *për* mby-
lesë të ligësisë, po si shërbëtorë të Pe-
17 rëndisë. Nderoni të-gjithë; doni vëllazërinë ;
kini frikë Perëndisë; nderoni mbretinë.
18 *Ju* shërbëtorëtë, unjni kryetë zotërinjvet *t'uaj*

me çdo frikë, jo vetëmë të-mirëvet e të-
19 butëvet, po edhe të-shtrëmbërvet; Sepse
këjo është hir, të duronjë njeriu hidhërime
për ndërgjegjenë mbë Perëndinë, dyke pë-
suarë pa udhë.
20 Sepse ç' farë lavdie *është*, ndë durofshi,
kur të rriheni për faje? po ndë durofshi
dyke bërë mirë e dyke hequrë keq, këjo
21 *është* hir përanë Perëndisë. Sepse për këtë
uthërritë, sepse edhe Krishti pësoj për ju,
e u la juve një shëmbëllesë, që të ecëni pas
22 gjurmëvet t'ati; I-cili „nukë bëri faj, as
23 ugjënt kobim ndë gojët t' ati." I-cili kur për-
qeshej nukë përqeshte, kur pësonte nukë
frikësonte, po epte vetëhen' e ti ndë dorët
24 t'ati që gjykon me të-drejtë; I-cili vetë mbaj-
ti fajetë t'anë ndë trupt të ti mbi drut, që,
si të vdesëmë ndë fajet, të rrojmë ndë drej-
25 tëri; „me plagën' e ati ushëruatë." Sepse
ishitë „si dhën të-aratisura;" po tashti u-
kthyetë te Bariu edhe tek Episkopi i shpir-
tëravet t'uaj.

Krye 3.

1 Gjithashtu edhe *ju* gratë, unjni kryetë bur-
ravet t'uaj, që, edhe ndë mos ubinçinë ca
veta ndë fjalët, të fitonenë pa fjalë nga
2 të-sjellat' e gravet, Si të shohënë të-sjellatë
3 t'uaj të-thjeshta e me frikë. Të-cilavet stolia letë
mos jetë e-përjashtëshme, ajo e te-gërshetua-

BKSH

rit të flokëvet e të të-varurit të stolivet të-arta,
4 a të të-veshurit të rrobavet, Po njeriu i-fshe-
hurë i zëmërësë, *stolisurë* me paprishjen' e
frymës' së-butë edhe së-qetë, e-cila përpara
5 Perëndisë është shum' e-vëjyerë. Sepse kështu
njëherë edhe grat' e-shënjtëruara, ato që
shpreninë mbë Perëndinë, stolisninë vetëhen'
e tyre, dyke unjurë kryetë burravet të tyre;
6 Sikundrë Sarra bindeshe te Avraami, dyke
quajturë atë zot; bija të së-cilësë jeni ju,
kur bëni mirë edhe s' frikësohi as nga ndo-
një frikë.

7 Ju burratë, gjithashtu, rrini bashkë *me
gratë t'uaj* me urtësi, dyke dhënë nder kom-
bit të gruasë si ene më së-dobëtë, edhe si
bashkëtrashëgimtarëve të hirit të jetësë, që
të mos pengonenë të-faluratë t'uaj.

8 Edhe më ndë funtt, *bëhi* të-gjithë mbë
një mëndje, të-dhëmçurë, vëlla-dashës, të-
9 përdëllyersim, zëmër-ëmbëlë; Mos çpaguani
të-keq për të-keq, a të-sharë per të-sharë; po
përkundrazi, dyke bekuarë; sepse për këtë
10 uthërrittë, që të trashëgoni bekim; „Sepse kush
do të dojë jetë, edhe të shohë dit të-bardha,
letë pushonjë gjuhën' e ti nga e-keqia, edhe
11 buzët' e tia nga të-folurit ë kobim. Letë mër-
gonetë nga e-liga, edhe letë bënjë mirë:
letë kërkonjë paqtim, edhe let'a ndjekë atë.
12 Sepse syt' e Zotit janë mbi të-drejtët, edhe
veshët' e ati mbë lutjen' e atyreve; po fa-

BKSH

qeja e Zotit është kundrë atyreve që bë-
njënë keq.“
13 Edhe kush dot’ u bënjë keq juve, ndë i.
14 rafshi prapa së-mirësë? Po edhe ndë heqçi keq
për drejtërinë, të-lumurë jeni, „edhe nga frik’
e atyreve mos kini frikë, as mos trubullohi;“
15 Po“ shënjtëroni Zotinë, Perëndinë,“ ndë zë-
mërat t’uaj; edhe ini gati përherë të epni
fjalë me butësirë e me frikë sicilitdo që të
kërkonjë prej jush fjalë për shpresënë që
16 është ndër ju; Dyke pasurë ndërgjegje të-
mirë, që, ndonëse flasënë keq për ju posi
për keqbërës, të turpëronen’ ata që përfla-
sënë të-sjellatë t’uaj të-mira mbë Jisu Krish-
17 tinë. Sepse *është* më mirë të hiqni keq dyke
bërë mirë, ndë është kështu dashurimi i Pe-
rëndisë, se dyke bërë keq.
18 Sepse edhe Krishti një herë pësoj për
fajetë, i-drejti për të-shtrëmbëritë, që të na
bjerë te Perëndia, dyke vdekurë pas mishit,
19 po dyke ungallurë me anë të Frymësë; Me
anë të së-cilësë vate e lëçiti edhe te frymatë
20 që ishinë ndë burkt, Të-cilatë nuk’ ubint-
në njëherë *moti*, kur i priste njëherë zëmër’
e-gjerë e Perëndisë, ndë ditt të Nohësë, tek
ndërtonej arka, ndë të-cilët të-pakë (do-me-
thënë tetë) shpirte shpëtuanë me anë të
21 ujit; Kundrëformë e të-cilit dyke qënë pa-
gëzimi na shpëton edhe neve sot, (jo të-he-
dhuritë tej të ndyrësis’ së mishit, po dësh-

mimi i ndërgjegjes' së-mirë mbë Perëndinë,)
22 me anë të të-ngjallurit të Jisu Krishtit; I-cili
vate ndë qiellt edh' është ndë të-djathtët të
Perëndisë, edhe të-cilit i unjtnë kryetë ën-
gjëjt' e pushtetet' e fuqitë.

Krye 4.

1 Passi pësoj pra Krishti ndë mish për
ne, armatosuni edhe ju me gjithatë mendim;
sepse ay që pësoj ndë misht, pushoj nga
2 faji; Që t'a shkoni jetënë që u mbetetë ndë
misht jo më ndë dëshërimet të njerësvet, po
3 ndë dashurimt të Perëndisë. Sepse mjaft
është për ne koha e jetësë që shkoj, që pu-
nuamë dashurimin' e kombevet, dyke ecurë
ndë ndyrësira, ndë dëshërime, ndë të-dejtura,
ndë lodërti, ndë të-pira, edhe ndë idhullatri-
4 ra të-paudha; Edhe përandaj u vjen çudi
atyreve, se nukë ecëni bashkë *me ata* ndë
gjithatë vërshim të plankprishjesë, edhe u
5 shanjënë *juve*; Të-cilëtë dot' i apënë fjalë
ati që është gati të gjykonjë të-gjallë e të-
6 vdekurë. Sepse për këtë ulëçit ungjilli edhe
te të-vdekuritë, që të gjykonenë pas njerësvet
ndë misht, e të rronjënë pas Perëndisë ndë
frymët.
7 Edhe fundi i të-gjithave uaferua; urtësohi
8 pra, e rrini sgjuarë ndë të-falurat. Edhe
përmbi të-gjitha ki-e-ni të-nxehëtë dashurinë
ndë mest t'uaj; sepse „dashuria dotë mbu-

9 lonjë shumicë fajesh." Ki-e-ni derënë të-ha-
10 pëtë njëri për tjatërinë, pa murmurim. Gji-
thësicili sikundrë mori dhurëti, pas kësaj shër-
beni-i njëri tjatërit, si kujdestarë të-mirë të
11 hirit shumë farësh të Perëndisë. Ndë flet ndo-
një, *letë flasë fjalë* si fjalë Perëndie; ndë
shërben ndonjë, *letë shërbenjë* si prej fuqisë
që i ep Perëndia, që mbë të-gjitha të lavdu-
ronetë Perëndia me anë të Jisu Krishtit, mbë
të-cilinë është lavdia edhe pushteti ndë jetët
të jetëvet. Amin.
12 O të-dashurë, mos u vinjë çudi juve për
mundimn' e-keq qe ubë mbë ju për të pro-
vuarë juve, sikurse gjau mbë ju ndonjë punë
13 e-çudiçime e-veçantë; Po gëzohi, se jeni
pjesëtarë të pësimevet të Krishtit, që të gë-
zohi dyke ugëzuarë edhe ndë të-sbuluarët të
14 lavdis' s' ati. Ndë shahi për emërin' e Krish-
tit, jeni të-lumurë; sepse Fryma e lavdisë
edhe ajo e Perëndisë prëhetë mbë ju; pas
atyreve shahetë, po pas jush lavduronetë.
15 Sepse asndonjë prej jush letë mos pësonjë
si vrasës, a *si* vjedhës, a *si* keqbërës, a si
16 asi që shikon punërat' e-huaj; Po ndë pë-
softë si i-krishterë, letë mos ketë turp, po
17 letë lavduronjë Perëndinë mbë këtë; Sepse
arriti koha të nisetë gjyqi nga shtëpia e
Perëndisë; edhe nde *nisetë* më përpara nga
ne, ç' *dotë jetë* e-pastajmja e atyreve që s'
18 bindenë ndë ungjillt të Perëndisë? Edhe

„ndë i-drejti mezi shpëton, i-pabesi edhe
19 fajtori ku dotë duketë?„ Andaj edhe ata që
pësonjënë pas dashurimit të Perëndisë, letë
besonenë shpirtërat' e tyre me të punuarë
të-mirë ndë dorët t' ati si mbë besëtarinë
krietar.

Krye. 5.

1 U lutem pleqvet që janë ndër ju unë pla-
ku, shoku i atyreve, edhe dëshmimtar i pë-
simevet të Krishtit, edhe pjesëtar i *asaj* lav-
2 disë që është për të sbuluarë; Ruani gri-
gjën' e Perëndisë që është ndër ju, dyke
kujdesurë *për atë* jo me pahir, po dyke
dashurë; as për fitim të-lik, po me zëmërë
3 të-gatishime; Jo sikur se jini zotërinj mbi
trashëgimn' *e Perëndisë*, po dyke bërë vetë-
4 henë t'uaj shëmbëllesë të grigjësë. Edhe kur
të çfaqetë kryebariu, dotë merrni kurorën'
e-pafishkurë të lavdisë.
5 Gjithashtu *edhe ju* më të-rinjtë, unjni krye-
të pleqvet; edhe të-gjithë, dyke unjurë krye-
të njëri tjatërit, vishni mëndjen' e-përunjurë;
sepse „Perëndia u rri kundrë madhështorë-
6 vet, po të-përunjurëvet u ep hir.“ Përunjuni
pra ndënë dorët të-fortë të Perëndisë, që
t'u lartësonjë juve ndë kohët *që duhetë*;
7 Edhe gjithë kujdesnë t'uaj hidh-e-ni mb' atë,
sepse ay kujdesetë për ju.
8 Përmbani vetëhenë, rrini sgjuarë; sepse

BKSH

kundrë-gjyqësi juaj, djalli, posi leon që ulë-
rin, vjen përqark dyke kërkuarë cilinë të
9 përpijë. Të-cilit rrini-i kundrë *dyke qëndrua-
rë* të-fortë ndë besët, sepse e dini se gjithata
pësime bënenë ndër vëllezërit t'uaj që janë
10 ndë botët. Edhe Perëndia i çdo hiri, që na
thërriti ndë lavdit të ti të-përjetëshme me
anë të Jisu Krishtit, si të pësoni pak, ay u
bëftë të-sosurë, *u* forcoftë, *u* dhëntë fuqi, u
11 themeloste. Mb' atë *qoftë* lavdia edhe pu-
shteti ndë jetët të jetëvet. Amin.
12 Me anë të Silluanit, vëllajt besëtar, u shkro-
va juve me pak fjalë, sikundrë më duketë,
dyke lutur' e dyke dhënë dëshmim, se ky
është hiri i-vërtetë i Perëndisë, *ky* ndë të-
13 cilët qëndroni. U faletë me shëndet juve
kisha që është ndë Vavilonë, *që ësht'* e-
sgjedhurë bashkë me ju, edhe Marku, biri
14 im. Përshëndetni njëri tjatërinë me të-puthu-
rë dashurie.

Paqtim *qoftë* mbë gjithë ju që jeni mbë
Jisu Krishtinë. Amin,

Karta e-dytë e-përgjithëshme e apostollit Pjetër.

Krye 1.

1 Simeon Pjetri, shërbëtuar edhe apostoll i

Jisu Krishtit, mb' ata që kanë marrë për
pjesë besë të-çëmuarë sa *edhe* ne, me anë
të drejtëris' së Perëndisë t' ënë edhe të Shpë-
2 timtarit Jisu Krisht; Hir edhe paqtim ushumoftë
mbë ju me anë të të-njohurit të Perëndisë
edhe të Jisu Krishtit, Zotit t' ënë.
3 Sikundrë e-hieruarshimja fuqi' e ati na fali
gjith' ato *që duhenë* për jetë e për besë të-
mirë me anë të të-njohurit t' ati që na thër-
4 riti me lavdi e me mirësi; Me anë të të-
cilavet na ufalnë më të-mëdhatë e të-nder-
çime të-zotuara, që me anë të këtyreve të
bëhi pjesëtarë të naturës' së Perëndisë, dyke
larguarë prisjenë që është me anë të dëshë-
5 rimit ndë botët; Edhe për gjithë këtë *punë*,
dyke vënë çdo të-përpjekurë, shtoni ndë be-
sët t' uaj mirësinë, edhe ndë mirësit dituri-
6 në, Edhë ndë diturit të përmbajturit' e vetë-
hesë, edhe ndë të-përmbajturit të vetëhesë
durimnë, edhe ndë durimt besën' e-mirë,
7 Edhe ndë besët të-mirë vëllazërinë, edhe
8 ndë vëllazërit dashurinë. Sepse po të jenë
këto ndër ju edhe të shtohenë, nukë dot'
u bënjënë juve përtacër të-epapemshim mbë
9 të-njohurit të Zotit t' ënë Jisu Krisht. Sepse
ay, mbë të-cilinë nukë janë këto, ësht' i-
verbërë, dritë-shkurtërë, edhe harroj pastri-
10 min' e fajevet të ti të-vjetërë. Përandaj, o
vëllezër, kujdesuni më tepërë të siguroni të-
thërriturit' e të-sgjedhuritë t' uaj; sepse dyke

BKSH

11 bërë këto, nukë dotë fëjeni kurrë. Sepse
kështu me të-plotë dot' u epetë juve të-hy-
rëtë ndë mbretërit të-përjetëshme të Zotit
e Shpëtimtarit t' ënë Jisu Krisht.
12 Përandaj nukë dotë përtonj t' u'a bje
ndër mëntt këto përherë, ndonëse i dini, e
13 jeni të-forcuarë ndë këtë të-vërtetë. Po u*në*
mendonj, se është e-drejtë, gjersa jam ndë
këtë tendë, t' u ngut juve dyke prurë ndër
14 mëntt; Sepse e di, se për-së-çpejti dot'a
heth tej tendënë t' ime, sikundrë edhe Zoti
15 ynë Jisu Krisht m'a çfaqi. Po dotë kujdesem,
që ju, edhe pas vdekjesë s' ime, të muntni
përherë t' i kujtoni ato.
16 Sepse u bëmë juve të dini fuqinë edhe
të-ardhurit' e Zotit t' ënë Jisu Krisht, jo dyke
vaturë pas përrallave të-ndrequra me mjesh-
tëri, po *me të-treguarë*, se me sytë t' anë e
17 pamë madhërin' e ati. Sepse mori nder e
lavdi prej Perëndisë, Atit, kur i erdhi ati një
i-këtillë zë prej lavdis' së-lavduruarshime,
18 „Ky është Biri im i-dashurë, ndë të-cilët
gjeta pëlqim." Edhe këtë zë e dëgjuamë se
erdhi nga qielli, kur ishimë bashkë me atë
ndë malt të-shënjtëruarë.
19 Edhe kemi më të-vërtetuarë fjalënë profi-
tike, ndë të-cilët bëni mirë të shikoni si ndë
një kandile që ndrit ndë *një* vënt të-errëtë,
gjersa të sbardhëllonjë dita, edhe yll' i dri-
20 tësë të lintnjë ndë zëmërat t' uaj; Dyke diturë

që përpara këtë, se asndonjë profiti e shkro-
njesë nukë bënetë prej kupëtimit të-veçantë
21 *t' ati që profiteps.* Sepse kurrë nukë erdhi
ndonjë profiti prej dashurimi njeriu, po dyke
ushtyturë prej Frymës' së-Shënjtëruarë folnë
njerëzit' e-shënjtëruarë të Perëndisë.

Krye 2.

1 Po kanë qënë edhe profitër të-rrem ndër
llaust, sikundrë edhe ndër ju dotë ketë më-
sonjës të-rrem, të-cilëtë dotë futnjënë fshe-
hurazi eresira humbjeje, dyke mohuarë edhe
atë Zotëninë që i bleu ata, edhe dyke hequrë
kështu mbë vetëhen' e tyre humbje të-çpejtë.
2 Edhe shumë *veta* dotë venë pas hum-
bjevet t' atyre, për të-cilëtë udh'e së-vërtetësë
3 dotë shahetë. Edhe për lakmim dot' u tregë-
tonjënë me fjalë të-çpifura: dënimi i të-ci-
lëvet që moti nukë mënon, edhe humbja e
atyreve nukë fle.
4 Sepse Perëndia ndë mos kurseu ëngjëjtë
që fëjyenë, po i hodhi ndë funtt të dheut
të-lidhurë me hekura errësire, e i dha që të
5 ruhenë për gjyq; Edhe *ndë* mos kurseu bo-
tën' e-mocime, po pruri përmbytje mbi bo-
tën' e të-pabesëvet, Edhe ruajti Noenë vet'
6 i-tettë, *këtë* lëçitës të drejtërisë; Edhe
dënoj ndë humbje qytetet' e Sodhomavet e
të Gomorrësë, edhe i bëri hi, edhe i vuri
shëmbëllë t' atyreve që dotë rroninë të-pa-

BKSH

7 besë; Edhe shpëtoj të-drejtinë Llot, që hel-
monej prej të-sjellavet të-ndyra të të-pabe-
8 sëvet; (Sepse ky i-drejtë, dyke ndënjurë
ndër mest t' atyreve, ditë me ditë mundonte
shpirtin' *e ti* të-drejtë me te-par' e me të-
9 dëgjuarë punërat' *e atyre* të-paudha; Di Zoti
të shpëtonjë besëtarëtë nga ngasja, edhë të-
shtrëmbëritë t'i ruanjë për ditën' e gjyqit që
10 të mundonenë; Edhe më tepërë ata që venë
prapa mishit me dëshërim ndyrësire, edhe
bënjënë për asgjë pushtetnë; *janë* kuximtarë
të-vrazhëtë, *edhe* nukë trëmbenë dyke sharë
11 pushtetetë; Tek ëngjëjtë që janë më të-më-
dhenj ndë forcë e ndë fuqi nukë bjenë kun-
drë atyre gjyqim të-foluri keq përpara Zotit.
12 Po këta posi shtëzë prej nature pa mënt, që
kanë lindurë që të zihenë (ndë lak), e të
prishenë, flasënë keq për gjërëra që s'i dinë,
edhe dotë prishenë ndë prishjet të tyre, dyke
13 marrë pagën' e shtrëmbëris' *së tyre*. E numë-
ronjënë për shëfrim të-kënaqurit' e-përdit-
shim; *janë* të-shgjërruarë e të-fëlliqurë; gë-
zonenë ndë kobimet të tyre, kur han' e pinë
14 bashkë me ju; Sytë i kanë plot me kurvëri,
edhe që nukë pushonjënë nga faji; gënjenjënë
shpirtëra të-paforcuarë, kanë zëmërë të-stër-
viturë ndë lakmime, *janë* djem mallëkimi:
15 Dyke lënë udhën' e-drejtë, ukobuanë, e
vanë pas udhës' së Vallaamit, *birit* të Vosorit,
16 i-cili deshi pagën' e shtrëmbërisë; Po uqër-

tua për panomin' e ti; sepse kafshë pa gojë,
dyke folurë me zë njerju, e ndaloj marrësin'
17 e profitit. Këta janë kronje pa ujë, re që
shtyhenë prej ere së-fortë, për të-cilëtë është
ruajtur' errësir' e-zezë për gjithë jetënë.
18 Sepse dyke folurë shumë të-mëdha *fjalë*
kotësire, kobonjënë me dëshërimet' e mishit
e me ndyrësiratë ata që me të-vërtetë shpë-
tuanë nga ata që e shkonjënë jetënë ndë
19 kobim; Dyke zotuar' atyreve liri, tek ata
vetë janë robër të prishjesë; sepse prej ati
që të mundetë ndonjë, këti i bënetë edhe
20 rop. Sepse ata që shpëtuanë nga ndyrësit' e
botësë me anë të të-njohurit të Zotit edhe Shpë-
timtarit Jisu Krisht, ndë ungatërofshinë përsëri
mbë këto, edhe të mundenë, mb' ata të-pastaj-
21 metë ubënë më të-këqia se të-paratë. Sepse më
mirë ishte për ata të mos e kishinë njohurë
udhën' e drejtërisë, se passi e njohnë të
kthenenë nga porosi' e-shënjtëruarë që udha
22 mb' ata. Edhe gjau mb' ata ajo *që thotë*
parimia e-vërtetë, „Qëni ukthye mbë të-
vjellët të ti;" edhe, Derri si ula ushkrye
ndë lucët.

Krye 3.

1 Po u shkruanj juve, o të-dashurë, tashti
këtë kartë të-dytë, me të-cilatë *kartëra* çonj
mëndjenë t'uaj të-kthjellëtë me të-përmëndu-
2 rë; Qe të kujtoni fjalëtë që ufolnë më për-

BKSH

para nga profitërit' e-shënjtëruarë, edhe po-
rosin' e ne apostojvet të Zotit edhe Shpë-
3 timtarit. Di-e-ni më përpara këtë, se ndë
ditt të-pastajme dotë vinjënë përqeshës, të-
cilëtë dot' ecënjënë pas dëshërimevet të tyre,
4 E dotë, thonë, ky është të-zotuarët' e t'ar-
dhurit t' ati? sepse që mb' atë *ditë* që flejtnë
atëritë, të-gjitha mbetenë kështu qe kur se
5 unis kriesa. Sepse dyke dashurë nuk' e dinë
këtë, se me fjalën' e Perëndisë ubënë qiejtë
njëherë moti, *si* edhe dheu që është bërë
6 prej uji e me anë uji; Me anë të të-cilavet bota
e-atëhershime umbulua me ujë edhe humbi;
7 Edhe qiejt' e-sorm edhe dheu me anë të
gjithasaj fjale janë ruajturë si ndë thesore,
dyke uruajturë për zjarr mbë ditët të gjyqit
e të humbjes' së njerësvet të-pabesë.
8 Edhe një, këtë, mos e harroni, se përanë
Zotit një ditë është si një mijë vjet, edhe
9 një mijë vjet si një ditë. Zoti nukë mënon
të-zotuarët' e ti, sikundrë e numëronjënë për
të-mënuarë: po tregon zëmërë të-gjerë mbë
ne, sepse nukë do të humbasënë disa *veta*,
10 po të-gjithë të vinjënë ndë pendim. Edhe
dita e Zotit dotë vinjë posi vjedhës natënë;
ndë të-cilët qiejtë dotë shkonjënë me kris-
më, e stiqiatë dyke undezurë dotë tretenë,
edhe dheu edhe punëratë që janë nd' atë
dotë digjenë tej-për-tej.
11 Kur pra këto të-gjitha tretenë, të-çfarëtë

duhetë të jeni juve ndë të-sjella të-shënj-
12 tëruara e ndë besë të-mirë, Dyke pritur' e
dyke dëshëruarë fort të-ardhurit' e ditës' së
Perëndisë, ndë të-cilët qiejtë dyke udjegurë
ndë zjarr dotë tretenë, edhe stiqiatë dyke
13 undezurë dotë tretenë ? Edhe pas të-zotuarit
t' ati presëmë qiej të-rinj edhe dhe të-ri,
ndë të-cilët rri drejtëri.
14 Përandaj, o të-dashurë, dyke priturë këto,
kujdesuni të gjëndeni përpara ati ndë paq-
15 tim pa palavi e pa të-metë. Edhe zëmërënë
e-gjerë të Zotit t' ënë numëro-e-ni për shpë-
tim, sikundrë edhe vëllaj ynë i-dashurë Pa-
vel u shkroj juve pas diturisë që i udha
16 ati, Sikundrë edhe ndë gjithë kartërat të tia,
dyke folurë ndër ato për këto punëra ; ndër
mest të të-cilavet ka ca që s' kupëtonenë, të-
cilatë të-padituritʼ e të-paqëndruarshimitë i
shtrëmbëronjënë, sikundrë edhe shkronjat' e-
tjera, për humbjen' e vetëhes' së tyre.
17 Ju pra, o të-dashurë, dyke diturë që për-
para këto, ruhi, që të mos hiqeni me kobi-
min' e të-panomëvet, e të bini poshtë nga
18 siguria juaj. Edhe shtohi ndë hirt e ndë të-
njohurit të Zotit t' ënë edhe Shpëtimtarit Jisu
Krisht. Mb' atë *qoftë* lavdia edhe tashti edhe
ndë ditët të jetës' së-përjetëshme. Amin.

Kart' e-parë e-përgjiðëshme e apostollit Joan.

Krye 1.

1 Atë që ishte që ndë kryet, atë që kemi
dëgjuarë, atë që kemi parë më sytë t'anë,
atë që vumë re, edhe duartë t'ona e preknë, për
2 Fjalën' e jetësë; (Edhe jeta uçfaq, edhe e pamë
edhe dëshmojmë, edhe u apënë juve zë për
jetën'e-përjetëshme, që ishte tek Ati, edhe uçfaq
3 ndër ne;) Atë që kemi parë edhe kemi dë-
gjuarë, *për atë* u apëmë zë juve, që të
keni edhe ju pjesë me ne; edhe pjesa jonë
është me Atin' edhe me Birin' e ati Jisu Krisht.
4 Edhe këto u'a shkruajmë juve, që të jet' i-
plotë gëzimi juaj.
5 Edhe ky është zëri që kemi dëgjuarë nga
ay, edhe u apëmë zë juve, Se Perëndia është
dritë, edhe nukë ka ndonjë errësirë tek ay.
6 Ndë thënçimë së kemi pjesë me atë, edhe
ecëjmë nd' errësirët, gënjejmë, edhe nukë
7 bëjmë të-vërtetënë. Po ndë ecëshimë ndë dri-
tët, sikundrë ay është ndë dritët, kemi pjesë
njëri me tjatërinë, edhe gjaku i Jisu Krishtit,
Birit t'ati, na qëron nga çdo faj.
8 Ndë thënçimë se s' kemi faj, kobojmë ve-
tëhen' t' ënë, edhe e-vërteta nuk' është ndër
9 ne. Ndë rrëfefshimë fajetë t'anë, është be-

sëtar edhe i-drejtë, që të na ndjenjë fajetë
10 edhe të na qëronjë nga çdo shtrëmbëri. Ndë
thënçimë se s' kemi fëjyerë, e bëjmë atë
gënjeshtar, edhe fjal' e ati nuk' është ndër ne.

Krye 2.

1 Djemthit' e mi, u shkruanj juve këto, që të
mos fëjeni; edhe nde fëjeftë ndonjë, kemi kush
2 të lutetë tek Ati, Jisu Krishtin' e-drejtë. Edhe
ay është çpërblimi për fajetë t'anë; edhe jo
vetëmë për t'anëtë, po edhe për të-gjithë
botësë.

3 Edhe nga këjo e dimë, se e kemi njohurë
4 atë, ndë ruajçimë porosit' e ati. Ay që tho-
të, E kam njohur' atë, edhe s'ruan porosit' e
ati, është gënjeshtar, edhe e-vërteta nuk'
5 është mb' atë; Po ay që ruan fjalën' e ati,
me të-vërtetë dashuria e Perëndisë ësht' e-
mbaruarë te ky. Nga këjo e dimë, se jemi
6 mb' atë. Ay që thotë se mbetetë mb' atë, ka
detyrë, sikundrë eci ay, edhe ky kështu të
ecënjë.

7 Vëllezër, nuk' u shkruanj juve porosi të-re,
po porosi të-vjetërë, atë të-cilënë e kishitë
që ndë kryet; porosia e-vjetërë është fjala
8 që dëgjuatë që ndë kryet. Përsëri u shkruanj
juve një porosi të-re, e-cila *gjë* ësht' e-vërtetë
mb'atë edhe mbë ju; sepse errësira shkon, edhe
9 drita e-vërtetë po ndrit. Ay që thotë se është

BKSH

ndë dritët, edhe i ka mëri të vëllat, nd' errë-
10 sirë është gjer tashi. Ay që do të vëllanë
mbetetë ndë dritët, edhe skandhali nukë ka
11 tek ay. Po ay qe i ka mëri të vëllat, nd' e-
rrësiret ecën, edhe nukë di se ku vete, sepse
errësira i verboj sytë.
12 U shkruanj juve, djemthit' e *mi*, se undjenë
13 fajetë t'uaj për emërin' e ati. U shkruanj juve,
atër, sepse e keni njohur' atë që *është* që
ndë kryet; u shkruanj juve, djaloshë, se e
keni mundurë të-ligunë; u shkruanj juve, çuna,
14 sepse e keni njohurë Atinë. U shkrova juve,
atër, sepse e keni njohur' atë që është që
ndë kryet; u shkrova juve, djaloshë, sepse
jeni të-fortë, edhe fjal' e Perëndisë mbetetë
ndër ju, edhe e keni mundurë të-ligunë.
15 Mos doni botënë, as ato që janë ndë botët.
Ndë do ndonjë botënë, dashuria e Atit nuk'
16 është mb' atë. Sepse çdo *gjë që është* ndë
botët, dëshërimi i mishit, edhe dëshërimi i
syvet, edhe madhështia e jetësë, nuk' është
17 prej Atit, po është prej botësë. Edhe bota
shkon, edhe dëshërim' i asaj; po ay që bën
dashurimin' e Perëndisë mbetetë ndë jetët
të-përjetëshme.
18 Çuna, është or' e fundit; edhe sikundrë
dëgjuatë, se antikrishti vjen, edhe tashi
shumë antikrishtër ka; andaj dimë, se është
19 or' e fundit. Prej nesh duallnë, po nuk
ishinë prej nesh; sepse, ndë ishinë prej nesh,

dotë kishinë mbeturë me ne; po *duallnë*,
që të çfaqenë se nukë janë të-gjithë prej nesh.
20 Edhe ju keni të-lyerë prej Shënjtit, edhe i
21 dini të-gjitha. Nuk' u shkrova juve, sepse
nukë dini të-vërtetënë, po sepse e dini, edhe
sepse çdo gënjeshtrë nuk' është nga e-vër-
22 teta. Kush është gënjeshtari, veç ay që mo-
hon se Jisuj nuk' është Krishti? ky ësht' anti-
23 krishti, ay që mohon Atin' edhe Birinë. Kush-
do që mohon Birinë, s'ka as Atinë; (ay që-
rrëfen Birinë, ka edhe Atinë).
24 Ajo pra që ju dëgjuatë qëndë kryet, letë
mbetetë ndër ju. Ndë mbettë ndër ju ajo
që dëgjuatë që ndë kryet, edhe ju dotë
25 mbeteni te Biri e tek Ati. Edhe këta është
të-zotuarëtë që ay na uzotua, jet' e-përje-
26 tëshme. Këto u'a shkrova juve për ata që
27 u kobonjënë. Edhe *ata* të-lyerëtë që muartë
nga ay mbetetë ndër ju, edhe s'keni nevojë
t'u mësonjë juve ndonjë; po sikundrë u më-
son juve gjthata të-lyerë për të gjitha, *kështu*
është edhe e-vërtetë, edhe nuk' është gënje-
shtrë; edhe sikundrë u mësoj juve, dotë mbe-
teni mb' atë.
28 Edhe tashi, djemthit' *e mi*, mbetuni mb' atë,
që, kur të çfaqetë, të kemi kuxim, e të mos
turpëronemi nga ay mbë t'ardhurit t'ati.
29 Ndë e dini, se ësht' i-drejtë, e dini se kush-
do që bën drejtërinë prej ati ka lindurë.

BKSH

Krye 3.

1 Shihni ç'farë dashurie na ka dhënë Ati, që
të quhemi djem të Perëndisë; përandaj bota
nukë na njeh, sepse nuk' e njohu atë.
2 Të-dashurë, tashi jemi djem të Perëndisë;
po edhe s'është çfaqurë se ç'dotë jemi; po
e dimë, se, kur të çfaqetë, do të jemi
posi ay; sepse do t'a shohëm' atë sikundtë
3 është. Edhe kushdo që ka këtë shpresë mb'
atë, pastron vetëhen' e ti, sikundrë ay ësht'
4 i-pastrëtë. Kushdo që bën fajinë, bën edhe
5 panominë; sepse faji është panomia. Edhe
e dini, se ay uçfaq, që të ngrerë fajetë
6 t'anë; edhe faj nukë ka tek ay. Kushdo që
mbetetë mb' atë, nukë fëjen; kushdo që fëjen
nuk' e ka par' atë, as nuk' e ka njohur' atë.
7 Djemthit' *e mi*, letë mos u kobonjë juve as-
ndonjë; ay që bën drejtërinë, ësht' i-drejtë,
8 sikundrë ay ësht' i-drejtë. Ay qe bën fajnë,
është nga djalli; sepse që ndë kryet djalli
është dyke fëjyerë. Përandaj uçpërfaq i Bir'
i Perëndisë, që të prishnjë punërat' e djallit.
9 Ay që ka lindurë prej Perëndisë, faj nukë
bën, sepse fara e ati mbetetë mbë atë; edhe
s'munt të fëjenjë, sepse ka lindurë prej Pe-
10 rëndisë. Me këtë çquhenë djemt' e Perëndisë,
edhe djemt' e djallit. Kushdo që nukë bën
drejtëri, nuk' është nga Perëndia, *si* edhe ay
që nukë do të vëllanë.
11 Sepse këjo është porosia që ndëgjuatë

12 që ndë kryet, të duamë njëri tjatërinë; Jo si-
kundrë Kaini i-cili ishte prej të-ligut, edhe
theri të vëllanë. Edhe përse e theri atë? sepse
punërat' e ati ishinë të-liga, e ato të të
vëllat *ishinë* të-drejta.
13 Mos çuditi, vëllezërit' e mi, ndë bota u ka më-
14 ri juve. Neve e dimë, se kemi shkuarë prej vde-
kjesë ndë jetët, sepse duamë vëllezëritë; ay që
15 nukë do vëllanë, mbetetë ndë vdekjet. Kush-
do që i ka mëri të vëllat, është njeri-vrasës;
edhe e dini se çdo njeri-vrasës s'ka jetë të-
përjetëshme që mbetetë ndë vetëhet të ti.
16 Nga këjo e njohëmë dashurin' e *Krishtit*,
se ay vuri jetën' e ti për ne; edhe neve kemi
detyrë të vëmë jetënë t'ënë për vëllezëritë.
17 Po ay që ka të-mirat' e botësë, edhe sheh
të vëllanë që ka nevojë, edhe mbyll zëmërën'
e ti prej ati, qysh *munt të* mbetetë dashuria
18 e Perëndisë tek ay? Djemthit' e mi, të mos
duamë me fjalë, as me gjuhë, po me punë
e me të-vërtetë.
19 Edhe nga këjo e njohëmë se jemi prej
së-vërtetësë, edhe dotë sigurojmë zëmëratë
20 t'ona përpara ati; Se ndë na dënon zëmëra,
pa fjalë Perëndia është më i-math se zëmëra
21 jonë, edhe njeh të-gjitha. Të-dashurë, ndë
mos na dënon zëmëra jonë, kemi kuxim te
22 Perëndia; Edhe çdo që të lypëjmë, e ma-
rrëmë nga ay, sepse ruajmë porosit' e ati,
23 edhe bëjmë të pëlqyeratë përpara ati. Edhe

këjo është porosia e ati, të besojmë mb' e-
mërit të Birit t'ati Jisu Krisht, edhe të du-
amë njeri tjatërinë, sikundrë na la porosi.
24 Edhe ay që ruan porosit' e ati, mbetetë mb'
atë, edhe ay mbë këtë, edhe nga këjo e njo-
hëmë se mbetetë ndër ne, nga Fryma që na
dha.

Krye 4.

1 Të- dashurë, mos i besoni çdo fryme, po
provoni frymatë, ndë janë nga Perëndia;
sepse shumë profitër të-rrem duallnë ndë bo-
2 tët. Nga këjo e njihni Frymën' e Perëndisë;
çdo frymë që rrëfen, se Jisu Krishti ka ar-
3 dhurë ndë mish, është nga Perëndia; Edhe
çdo frymë që nukë rrëfen se Jisu Krishti ka
ardhurë ndë mish, nuk' është nga Perëndia;
edhe këjo është *fryma* e antikrishtit, që keni
dëgjuarë se vjen, edhe qe tashi është ndë
botët.
4 Ju jeni nga Perëndia, djemthit' *e mi*, edhe
i keni mundurë ata; sepse ay *që është* ndër
ju është më i-math se ay *që është* ndë botët.
5 Ata prej botësë janë; përandaj prej botësë
6 flasënë, edhe bota i dëgjon ata. Neve jemi
nga Perëndia; ay që njeh Perëndinë, na
dëgjon; ay që nukë është nga Perëndia, nu-
kë na dëgjon. Nga këjo njohëmë frymën' e
së-vërtetësë, edhe frymën' e kobimit.
7 Të-dashurë, letë duamë njëri tjatërinë; sepse

BKSH

dashuria është nga Perëndia; edhe kushdo
që do ka lindurë prej Perëndisë, edhe e njeh
8 Perëndinë. Ay që nukë ka dashuri. nuk' e
njohu Perëndinë; sepse Perëndia është da-
9 shuri. Mbë këtë uçfaq dashuria e Perëndisë
mbë ne, se Perëndia Birin' e ti të-vetëmlin-
durinë e dërgoj ndë botët, që të rrojmë me
10 anë t'ati. Mbë këtë është dashuria, jo se
neve e deshmë Perëndinë, po se ay na deshi
neve, edhe dërgoj Birin' e ti çpërblim për
11 fajetë t' anë. Të-dashurë, ndë na deshi kështu
Perëndia, edhe neve kemi detyrë të duamë
12 njëri tjatërinë. Asndonjë s'e ka parë Perën-
dinë ndonjë herë. Nde duamë njëri tjatërinë,
Perëndia mbetetë ndër ne; edhe dashuria e
13 ati ësht' e-sosurë mbë ne. Nga këjo e njo-
hëmë, se mbetemi mb' atë, edhe ay ndër
ne, sepse na ka dhënë nga Fryma e ti.
14 Edhe neve kemi parë, edhe dëshmojmë,
se Ati dërgoj Birinë Shpëtimtar të botësë.
15 Ay që të rrëfenjë se Jisuj është i Bir' i Pe-
rëndisë, Perëndia mbetetë mb' atë, edhe ay
16 mbë Perëndinë. Edhe neve e kemi njohur'
edhe e kemi besuarë dashurinë, që ka Pe-
rëndia mbë në. Perëndia është dashuri; edhe
ay që mbetetë ndë dashurit, mbetetë mbë
17 Perëndinë, edhe Perëndia mb' atë. Mbë këtë
është e-sosurë dashuria me ne, që të kemi
kuxim ndë ditët të gjyqit; sepse sikundrë
ay është, kështu edhe ne jemi ndë këtë botë.

BKSH

18 Frikë nukë ka ndë dashurit, po dashuria
e-sosurë e nxier jashtë frikënë; sepse frika
ka mundim; edhe ay që ka frikë nuk' është
20 i-mbaruarë ndë dashurit. Neve e duamë atë;
sepse ay më parë na deshi. Ndë thëntë ndo-
një, Se dua Perëndinë, edhe i ka mëri të
vëllat, është gënjeshtar; sepse ay që s' do të
vëllanë të-cilinë e ka parë, qysh munt të
21 dojë Perëndinë të cilinë s'e ka parë? Edhe
këtë porosi e kemi nga ay, Ay që do Perën-
dinë, të dojë edhe të vëllanë.

Krye 5.

1 Kushdo që beson se Jisuj është Krishti,
ka lindurë prej Perëndisë; edhe kushdo që
do atë që e ka pjellë, do edhe atë që ka
2 lindurë prej ati. Nga këjo e njohëmë se dua-
më të bijt' e Perëndisë, kur duamë Perën-
3 dinë, edhe ruajmë porosit' e ati. Sepse këjo
është dashuria e Perëndisë, të ruajmë po-
rosit' e ati; edhe porosit' e ati nukë janë
4 të-rënda. Sepse çdo gjë që ka lindurë prej
Perëndisë e munt botënë, edhe kejo është
5 vitoreja që mundi botënë, besa jonë. Cili
ësht' ay që munt botënë, veç ay që beson,
se Jisuj është i Bir' i Perëndisë?
6 Ky ësht' ay që erdhi me anë uji e me anë
gjaku, Jisu Krishti; jo me anë uji vetëmë,
po me anë uji edhe gjaku; edhe Fryma
është ajo që dëshmon, sepse Fryma ësht' e-

7 vërteta. Sepse tre janë ata që dëshmonjënë
ndë qiellt, Ati, Fjala, edhe Frym' e-Shënjtë-
8 ruarë; edhe këta të tre janë një. Edhe tre
jan' ata që dëshmonjënë ndë dhet, Fryma,
edhe ujëtë, edhe gjaku; edhe këta të tre janë
mbë një.
9 Ndë qoftë se presëmë dëshmimin' e nje-
rësvet, dëshmimi i Perëndisë është më i-
math; se ky është dëshmimi i Perëndisë që
10 ka dëshmuarë për të Birinë. Ay që i beson
të Birit të Perëndisë, ka dëshmimnë ndë
vetëhet të ti; ay që nuk' i beson Perëndisë,
gënjeshtar e ka bërë atë, sepse nuk' i besoj
dëshmimit që dëshmoj Perëndia për të Bi-
11 rinë. Edhe ky është dëshmimi, se Perëndia
na dha jetë të-përjetëshme, edhe këjo jetë
12 është tek i Biri. Ay që ka Birinë, ka jetënë;
ay që s' ka të Birin' e Perëndisë, s' ka je-
13 tënë. Këto u'a shkrova juve që besoni mb'
emërët të Birit të Perëndisë, që t'a dini se
keni jetë të-përjetëshme, (edhe që të besoni
mb' emërët të Birit të Perëndisë.)
14 Edhe ky është kuximi që kemi tek ay, se,
ndë lypçimë gjë pas dashurimit t' ati, na
15 dëgjon. Edhe ndë e dimë se na dëgjon, çdo
që të lypëjmë, e dimë se marrëmë të-lypu-
ratë që kemi lypurë prej ati.
16 Ndë paftë ndonjë vëllan' e ti se fëjen faj
jo për vdekje, dotë lypënjë, edhe *Perëndia*
dot' i apë ati jetë, atyreve që nukë fëjenjënë

BKSH

për vdekje. Ka faj për vdekje; nukë them
17 të lutetë për atë *faj*. Çdo shtrëmbëri është
faj; edhe ka faj jo për vdekje.
18 E dimë se kushdo që ka lindurë nga Pe-
rëndia nukë fëjen; po ay që ka lindurë nga
Perëndia e ruan vetëhen' ë ti, edhe i-ligu
19 nuk' e përket. E dimë se jemi nga Perëndia;
20 edhe gjithë bota gjëndetë mbë të-ligët. Po e
dimë se i Bir' i Perëndisë erdhi, edhe na
dha kupëtim, që të njohëmë të-vërtetinë;
edhe jemi mbë të-vërtetinë, mbë të Birin' e
ati Jisu Krisht. Ky ësht' i-vërteti Perëndi,
edhe jeta e-përjetëshme.
21 Djemthit' *e mi*, ruani *vetëhenë t' uaj* nga
idhujtë. Amin.

Kart' e-dytë e apostollit Joan.

1 Unë plaku mbë Zonjën' e-sgjedhurë, edhe
mbë bijt' e asaj, të-cilëtë un' i dua me të-
vërtetë; edhe jo vetëm' unë, po edhe gjith'
2 ata që kanë njohurë të-vërtetënë; Për të-
vërtetënë që mbetetë ndër ne, edhe dotë jetë
3 bashkë me ne për gjithë jetënë; Qoftë bashkë
me ju hir, përdëllim, paqtim prej Perëndisë,
Atit, edhe prej Zotit Jisu Krishtit, Birit t'
Atit, ndë të-vërtetë e ndë dashuri.
4 Ugëzuashë shumë, se gjeta *ca* nga bijt' e
tu dyke ecurë ndë të-vërtetët, sikundrë muar-
5 më porosi prej Atit. Edhe tashi të lutem ty,

o Zonjë, jo sikur se të shkruanj *ndonjë* po-
rosi të-re, po atë që kishimë që ndë kryet,
6 të duamë njëri tjatërinë. Edhe këjo është
dashuria, të ecëjmë pas porosivet t' ati. Këjo
është porosia, sikundrë e dëgjuatë që ndë
kryet, të ecëni mb' atë.

7 Sepse shumë kobimtarë hynë ndë botët,
të-cilëtë nukë rrëfenjënë se Jisu Krishti erdhi
ndë mish; i-tilli është kobimtari edhe anti-
8 krishti. Vështroni vetëhenë t'uaj, që të mos
humbasëm' ato që punuamë, po të marrëmë
9 pagë të-plotë. Kushdo që shkel *porosinë*
edhe nukë mbetetë ndë mësimt të Krishtit,
ky nukë ka Perëndi ; ay që mbetetë ndë më-
simt të Krishtit, ky ka edhe Atin' edhe Bi-
10 rinë. Ndë qoftë se vjen ndonjë ndër ju, e
nukë bje këtë mësim, mos e merrni ndë
11 shtëpi, edhe mos i thoni ati, Gëzuash; Sepse
ay që i thotë ati, Gëzuash, bënetë pjesëtar
ndë punërat t' ati të-liga.

12 Ndonëse pata shumë për të shkruarë
juve, nukë desha me kartë e me mellan
t' u'a shkruanj ; po shprenj të vinj te ju,
edhe të flas gojë për gojë, që të jetë i-plotë
gëzimi ynë.

13 Të falenë me shëndet djemt' e s' at mo-
tëre së-sgjedhurë. (Amin.)

BKSH

Kart' e-tretë e apostollit Joan.

1 Unë plaku mbë Gaion' e-dashurë, të-cilin'
un' e dua me të-vërtetë.
2 I-dashurë, për të-gjitha lutem të veç
mbarë e të jesh shëndoshë, sikundrë vete
3 mbarë shpirti yt. Sepse ugëzuashë shumë,
se vinjënë vëllezër edhe dëshmonjënë për të-
vërtetënë t' ënde, sikundrë ti ecën ndë të-
4 vërtetët. Nukë kam gëzim më të-math se
këtë, të dëgjonj se djemt' e mi ecënjënë ndë
të-vërtetët.
5 I-dashurë, punë të-vëjejturë për besëtar
bën, çdo që u bën vëllezërvet e të-huajvet,
6 Të-cilëtë dëshmonjënë për dashurinë t' ënde
përpara kishësë; të-cilëtë ndë i përcjellç si-
kundrë vëjen te Perëndia, mirë dotë bënjç.
7 Sepse për emërin' e ati duallnë, pa marrë
8 asgjë nga kombetë. Neve pra kemi detyrë
të presëmë të-tillëtë *njerës,* që të bënemi
bashkëpunëtorë ndë të-vërtetët.
9 I shkrova kishësë; po Dhiotrefi që do
10 të jetë i-parë ndër ata nukë na pret; Për-
andaj ndë arthça, dot' i kujtonj punërat' e
ati që bën, dyke folurë me të-tepërë fjalë
të-liga kundrë nesh; edhe sikur të mos i
ishinë mjaft këto, as vetë nukë pret vëllezë-
ritë, po edhe ata që duanë *t' i presënë* i nda-
11 lon, edhe nga kisha i nxjer jashtë. I-dashu-
rë, mos ki për shëmbëllë të-ligënë, po të-

mirënë. Ay që bën mirë, është nga Perëndia;
po ay që bën keq, nuk' e ka parë Perën-
dinë.
12 Për Dhimitrin' epetë dëshmim i-mirë nga
të-gjithë, edhe nga e-vërteta vetë ; edhe neve
dëshmojmë, edhe e dini se dëshmimi ynë
ësht' i-vërtetë.
13 Shumë kishnjam për të shkruarë, po nukë
dua të të shkruanj me mellan e me pëndë ;
14 Po shprenj për-së-çpejti të të shoh, edhe
15 dotë flasëmë gojë për gojë. Paqtimi *qoftë*
mbë ty. Të falenë me shëndet miqtë. U fal
me shëndet miqvet emërë mbë emërë.

Kart' e-pergjithëshme e apostollit Judhë.

1 Judha, shërbëtuar i Jisu Krishtit, edhe i
vëllaj i Jakovit, mbë të-thërrituritë *që janë*
të-shënjtëruarë prej Perëndisë, Atit, edhe të-
2 ruajturë prej Jisu Krishtit ; Përdëllim, e paq-
tim, e dashuri, shumoftë mbë ju.
3 Të-dashurë, passi vë çdo kujdes t' u
shkruanj juve për shpëtimin' e-bashkëtë, pata
nevojë t' u shkruanj juve, e t' u lutem të luf-
toni për besënë që u udha një herë shënjto-
4 rëvet. Sepse hynë fshehurazi disa njerës,
të-cilëtë përpara që moti ishinë shkruarë për
ndë këtë dënim, *njerës* të-pabesë, që kthe-

BKSH

njënë hirin' e Perëndisë t'ënë ndë ndyrësi,
edhe mohonjënë të-vetëminë Zotëri (Perën-
dinë), edhe Zotinë t' ënë Jisu Krisht.
5 Edhe dua t' u bje juve ndër mëntt, ndo-
nëse ju e dini këtë, se Zoti, si shpëtoj
llauzinë nga dheu i Egjyptësë, pastaj i
6 humbi ata që nukë besuanë. Edhe ata ën-
gjëjtë që nukë ruajtnë gjëndjen' e tyre të-
parë, po lanë vëndin' e tyre, i ka ruajturë
me të-lidhura të-përjetëshme ndënë errësirë,
7 për gjyqin' e ditës' së-madhe; Posi Sodo-
mat' e Gomorratë, edhe *ata* qytetetë rreth
atyreve, që udhanë ndë kurvëri pas mëny-
rës' s' atyreve, edhe vanë prapa tjatëri mishi,
janë vënë përpara për shëmbëllesë dyke
8 umunduarë me zjarr të-përjetëshm. Gjithashtu
edhe këta, dyke parë ëndërra, ndyrinë mishi-
në, e pushtetinë e bënjënë për asgjë, edhe
9 ofiqetë i shanjënë. Po Mihaili, i-par' i ën-
gjëjvet, kur dyke luftuarë hahej me djallinë
për trupin' e Moisiut, nukë kuxoj të bjerë
kundr' ati ndonjë dënim vllasfimie, po tha,
10 Zoti të qërtoftë ty. Edhe këta për gjërëra që
nuk' i dinë flasënë keq; edhe prishenë *mb'*
ato që i dinë prej naturë, posi shtëzëtë pa
11 mënt. Mjerë ata! sepse ecnë ndë udhët të
Kainit, edhe për pagë uderthnë me vrap pas
kobimit të Ballaamit, edhe uhumpnë ndë
kundrëfjalët të Koreut.
12 Këta janë këllirëra ndë gostirat të da-

shurisë s' uaj, kur han' e pinë bashkë *me ju*
pa frikë, e kullosënë vetëhen' e tyre; *janë*
re pa ujë që bihenë andej e këtej prej erë-
ravet; *janë* drurë vjeshte të pa-pemshim, dy
13 here vdekurë, çkulurë nga rrënjëtë; Valë deti
t' egra që shkumëzonjënë turpjet' e tyrë; yj
që bihen' andej e këtej, për të-cilëtë është
ruajtur' errësir' e-zezë për gjithë jetënë.
14 Edhe për këta profitepsi edhe Enohu i-
shtatti prej Adhamit, dyke thënë, "Ja tek er-
dhi Zoti me mijëra prej shënjtorëvet të ti,
15 Që të bënjë gjyq përmbi gjithë, edhe të qër-
tonjë gjithë të-pabesëtë *ndër mest* t' atyreve,
për gjithë punërat' e pabesëris' s' atyre që
punuanë me pabesëri, edhe për gjithë fjalët'
e-ashpëra që fajtorë të-pabesë folnë kundr'
16 ati.„ Këta jan' asish që murmurisnjën' e qa-
henë, dyke ecurë pas dëshërimevet të tyre;
edhe goja e atyre flet *fjalë* fort të-trasha, e-
dhe përkëdhelnjënë njerës, që të kenë dobi
nga ata.
17 Po ju, o të-dashnrë, sillni ndër mëntt fja-
lëtë që ufolnë më përpara nga apostojt' e
18 Zotit t' ënë Jisu Krisht, Se u thoshinë juve,
„se ndë kohët të-pastajmë dotë ketë përqeshës
që *dot'* ecënjënë pas dëshërimevet të pabe-
sërivet të tyrë.„
19 Këta jan' ata që ndanjënë veç vetëhen' e
tyre, posi shtëzë, që s' kanë Frymë.
20 Po ju, o të-dashurë, dyke ndërtuarë ve-

BKSH

tëhenë t' uaj përmbi besët t' uaj fort të-
shënjtëruarë, e dyke falurë me Frymë të-Shënj-
21 tëruarë, Ruani vetëhenë t' uaj ndë dashu-
rit të Perëndisë, dyke priturë përdëllimin' e
Zotit t' ënë Jisu Krisht për jetë të-përjetësh-
22 më. Edhe ca i përdëlleni, kur hahenë *me ju*; Edhe
23 të-tjerë i shpëtoni me frikë, dyke rrëmbyerë
ata nga zjarri, *edhe* dyke pasurë mëri edhe
atë rrobënë që është fëlliqurë nga mishi.
24 Edhe mb' atë që munt t' u ruanjë juve
të-pafajm, e t' u qëndronjë juve faqe-bardhë
25 ndë gëzim përpara lavdis' së ti, Mbë të-ve-
tëminë (të-diturë) Perëndi, Shpëtimtarinë t'
ënë, qoftë lavdi edhe madhëri, fuqi edhe
pushtet, edhe tani edhe ndë gjithë jetët të-
përjetëshme. Amin.

Sbulesa e Joan Theollogut.

Krye 1.

1 Sbulesa e Jisu Krishtit, të-cilënë j'a dha
ati Perëndia, që t'u dëftenjë shërbëtorëvet
të ti sa duhetë të bënenë për-së-çpejti; edhe
i dërgoj e i çfaqi me anë të ëngjëllit të ti
2 mbë shërbëtorin' e ti Joan; l-cili dëshmoj
për fjalën' e Perëndisë, edhe *për* dëshmimn'
3 e Jisu Krishtit, edhe për sa pa. Lum ay që
këndon, edhe ata që dëgjonjënë fjalët' e *kë-
saj* profitie, edhe ruanjënë sa janë shkruarë

BKSH

nd' atë; sepse koha ësht' afërë.
4 Joani mbë të shtatë kishët *që janë* nd'
Asi; hir edhe paqtim *qoftë* mbë ju nga ay
që është edhe që ishte edhe që vjen; edhe
nga të shtatë frymatë që janë përpara fronit
5 t' ati; Edhe nga Jisu Krishti, *që është* dësh-
mimtari besëtar, i-parëlinduri prej së-vdeku-
rish, edhe zotënia i mbretërvet të dheut;
mb' atë që na deshi, edhe që na lau nga
6 fajetë t' anë me gjakun' e ti, Edhe që na
bëri mbretër edhe priftër të Perëndia edhe
Ati i ti, mb' atë *qoftë* lavdia edhe pushteti
ndë jetët të jetëvet. Amin.
7 Ja te vjen bashkë me retë, edhe dot' a
shohë atë çdo sy, edhe ata që e çpuan' atë;
edhe dotë ulërinjënë mb' atë gjithë kombet'
8 e dheut; po, amin. Unë jam Allfa e Omega,
(të-nisurit' edhe të-mbaruarëtë,) thotë Zoti,
Ay që ësht' edhe që ishte edhe që vjen,
Gjithëpushtetësi.
9 Unë Joani, që jam edhe vëllaj juaj, edhe
pjesëtar bashkë me ju ndë shtrëngimt edhe ndë
mbretërit edhe ndë durimt të Jisu Krishtit, qeshë
ndë ujdhesët që quhetë Patmë, për fjalën' e Pe-
rëndisë, edhe për dëshmimn' e Jisu Krishtit.
10 Arçë ndë frymë ditën' e-djelë; edhe dëgjova
prapa meje *një* zë të-math posi *zë* trumbete,
11 I-cili thoshte, (Unë jam Allfa edhe Omega,
i-pari edhe i-pastajmi; edhe,) Ç' sheh, i shku-
aj ndë vivli, edhe u'a dërgo kishëvet (që

BKSH

janë ndë Asi,) nde Efesë, e ndë Smyrnë, e
ndë Përgamë, e ndë Thyatirë, e ndë Sardhë,
e ndë Filladhelfi, e ndë Llaodhiqi.
12 Edhe ukthyeshë të shoh zënë që foli me
mua; edhe kur ukthyeshë, pashë shtatë kan-
13 dile t' arta, Edhe ndë mest të shtatë kandi-
levet *një* që gjante me bir njeriu, veshurë me
një rrobë të-gjatë gjer ndër këmbë, edhe
14 ngjeshurë përanë sisëvet *një* bres t' artë. E-
dhe kryet' e ati edhe flokët' e ati ishinë të-
bardhë posi lesh i-bardhë, si dëborë; edhe
15 syt' e ati posi flakë zjarri; Edhe këmbët' e
ati gjaninë me hallkolivan, si të-ndezurë ndë
furrë; edhe zër' i ati posi zë shumë ujërash.
16 Edhe kishte ndë dorët të ti të-djathtë shtatë
yj; edhe nga goja e ati dilte një shpatë e-
prehëtë me dy presje; edhe faqeja e ati *ndrit-*
17 *te* posi djelli që ndrit ndë fuqit të ti. Edhe
kur pashë atë, rashë ndë këmbët t' ati posi
i-vdekurë; edhe *ay* vuri dorën' e ti të-djathtë
mbi mua, e më tha, Mos ufrikëso, unë jam
18 i-pari edhe i-pastajmi, Edhe ay që rron;
edhe qesh' i-vdekurë, edhe ja tek jam i-gja-
llë ndë jetët të jetëvet; (amin;) edhe kam
19 kyçet' e hadhit, edhe të vdekjesë. Shkruaj
ato që pe, edhe ato që janë, edhe ato që
20 janë për të bërë paskëtaj; Fshehësirën' e të
shtatë yjvet që pe mbë të-djathtët t' ime, e-
dhe të shtatë kandilet' e-arta. Të shtatë yjtë
janë ëngjëjt' e të shtatë kishëvet; edhe të

BKSH

shtatë kandiletë (që pe) janë të shtatë kishëtë.

Krye 2.

1 Shkruaj ëngjëllit të kishës' s' Efesësë,
Këto thotë ay që mban të shtatë yjtë ndë
të-djathtët të ti, ay që ecën ndë mest të
2 shtatë kandilevet të-arta; I di punërat' e tua,
edhe mundimnë t' ënt, edhe durimnë t' ënt,
edhe se s' munt të duronjç të-liqtë, edhe se
provove ata që thonë se janë apostoj, edhe
3 nukë janë; edhe i gjete gënjeshtarë. Edhe
vove, edhe ke durim, edhe për emërinë t'im
4 umundove, edhe nuk' ulodhe. Po *diç* kam
kundrë teje, sepse e le dashurinë t' ënde të-
5 parënë. Kujtohu pra nga re poshtë, edhe pen-
dohu, edhe bëj punërat' e-para; ndë mos,
dotë vinj çpejt te ti, edhe dotë luanj kandi-
lenë t' ënde nga vëndi i asaj, ndë mos upen-
6 dofsh: Po ke këtë *të-mirë*, se u ke mëri pu-
nëravet të Nikollaitëvet, të-cilavet u kam
mëri edhe unë.
7 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë
Fryma kishëvet; Atij që munt dot' i ap të
hajë nga druri i jetësë, që është ndë mest
të paradhisit të Perëndisë.
8 Edhe ëngjëllit të kishës' së Smyrnasvet
shkruaj,
Këto thot' i-pari edhe i-pastajmi, i-cili
9 që i-vdekur' edhe rroj; I di punërat' e tua
edhe shtrëngimin' edhe vobëzinë, (po je i-

BKSH

pasurë,) edhe vllasfimin' e atyreve që thonë
për vetëhen' e tyre se janë Judhenj, edhe
nukë janë, po janë mbledhje e Satanajt.
10 Mos ufrikëso fare nga sa ke për të pë-
suarë; ja djalli te ka për të vënë ca prej
jush ndë burk, që të provohi; edhe dotë kini
shtrëngim dhjetë dit. Bënu besëtar gjer mbë
vdekje, edhe dotë t' ap kurorën' e jetësë.
11 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë
Fryma kishëvet; Ati që munt nukë dot' i
bënetë keq prej vdekjes' së-dytë.
12 Edhe ëngjëllit të kishësë ndë Pergamë
shkruaj,
Këto thot' ay që ka shpatën' e-pre-
13 hëtë me dy presje; I di punërat' e tua,
edhe ku e ke të-ndënjuritë, *e ke* atje ku
është fron' i Satanajt; edhe mban emërinë
t'im, edhe nukë mohove besënë t' ime, edhe
nd' ato dit që *ishte* Antipa, dëshmimtari im
besëtar, i-cili uvra ndër ju, atje ku ka të-
14 ndënjuritë Satanaj. Po kam pak *gjë* kundrë
teje, sepse ke atje ca që mbanjënë mësimin'
e Ballaamit, i-cili mësonte Ballakunë të bë-
një skandhali përpara të bijvet të Israilit,
që të hanë kurbanë idhujsh edhe të kurvë-
15 ronjënë. Kështu ke edhe ti *ca veta* që mba-
njënë mësimin' e Nikollaitëvet që e kam
16 mëri. Pendohu; se ndë mos, vinj çpejt te ti,
edhe dotë luftonj kundrë atyreve me shpa-
tën' e gojësë s' ime.

BKSH

17 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë
Fryma kishëvet; Ati që munt dot' i ap të
hajë nga manna që është fshehurë, edhe
dot' i ap *një* haliq të-bardhë, edhe mbi ha-
liqt është shkruarë një emërë i-ri, të-cilin'
asndonjë s' e njeh veç ay që e merr.
18 Edhe ëngjëllit të kishësë ndë Thyatirë
shkruaj,
Këto thot' i Bir' i Perëndisë, ay që ka
syt' e ti posi flakë zjarri, edhe këmbët' e
19 ati gjanjënë me hallkolivan; I di punërat' e
tua, edhe dashurinë, edhe shërbesënë, edhe
besënë, edhe durimnë t' ënt, edhe punërat' e
tua, edhe të pastajmetë *se janë* më të-tepëra
20 se të-paratë. Po kam (pak *gjë*) kundrë teje,
se lë gruanë Jezabelë, që thotë për vetëhen'
e saj se është profitëreshë, të mësonjë edhe
të kobonjë shërbëtorët' e mi që të kurvëronjënë
21 edhe të hanë kurbanë idhujsh. Edhe i dha-
shë kohë asaj të pendonetë nga kurvëria e
22 saj, edhe nuk' upendua. Ja unë tek e vë atë
ndë shtrat, edhe ata që kurvëronjënë me atë
ndë shtrëngim të-math, ndë mos upëndof-
23 shinë nga punërat' e tyre. Edhe të bijt' e
asaj dot' i vras me vdekje. Edhe gjithë kishëtë
dotë njohënë, se unë jam ay që vëshgonj
veshnjat' edhe zëmëratë; edhe dot' i ap gjithë-
24 sicilit prej jush pas punëravet t' uaj. Edhe u
them juve edhe të-tjerëvet *që janë* ndë Thya-
tirë, sa s' kanë këtë mësim, edhe të-cilëtë s'

i njohnë thellësirat' e Satanajt, sikundrë tho-
25 në, Nukë dotë vë tjetërë barrë mbë ju; Po
atë që keni mba-e-ni, gjer sa të vinj.
26 Edhe ati që munt, edhe që ruan punërat' e
mia gjer ndë funtt, dot' i ap ati pushtet mbi
27 kombet; Edhe „dotë kullosnjë ata me shkop
të-hekurtë; dotë thyhenë posi enët' e shtëm-
barit;" sikundrë edhe un' i mora prej t' im
28 Et; Edhe dot' i ap ati yllin' e mëngjesit.
29 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë
Fryma kishëvet.

Krye 3.

1 Edhe ëngjëllit të kishësë ndë Sardhë
shkruaj,
Këto thotë ay që ka të shtatë fry-
mat' e Perëndisë, edhe të shtatë yjtë; I di
punërat' e tua, se e ke emërinë se rron, e-
2 dhe je i-vdekurë. Benu i-sgjuarë, edhe forco
të-mbeturëtë sa janë gati për të vdekurë;
sepse nuk' i gjeta punërat' e tua të-sosura
3 përpara Perëndisë. Kujtohu pra qysh more
edhe dëgjove, edhe ruaj-i, edhe pendohu. Ndë
mos ndënjç pra sgjuarë, dotë vinj te ti posi
vjedhës, edhe nukë dotë dish mbë ç' orë dotë
4 vinj te ti. Ke pak emëra edhe ndë Sardhë,
qe nuk' i ndynë rrobat' e tyre; edhe dotë
ecënjënë bashkë me mua me *rroba* të-bardha, se-
5 pse janë të-vëjyerë. Ay që munt, ky dotë vishe-
të me rroba të-bardha; edhe nukë dotë shu-

BKSH

anj emërin' e ati nga vivlia e jetësë, edhe
dotë rrëfenj emërin' e ati përpara t' im Et,
edhe përpara ëngjëjvet t' ati.
6 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë,
Fryma kishëvet.
7 Edhe ëngjëllit të kishësë ndë Filladhelfi
shkruaj,
Këto thotë shënjti, i-vërteti, ay që ka
kyçin' e Dhavidhit; ay që hap, edhe as-
ndonjë s'mbyll; edhe mbyll, edhe asndonjë
8 s' hap; I di punërat' e tua; ja tek kam vënë
përpara teje një derë të-hapurë, edhe as-
ndonjë s'munt t'a mbyllnjë atë; sepse ke pak
fuqi, edhe ruajte fjalënë t'ime, edhe nukë
9 mohove emërinë t'im. Ja tek dot' i bënj ata
nga mbledhja e Satanajt që thonë për ve-
tëhen' e tyre se janë Judhenj, edhe nukë janë,
po gënjenjënë; ja tek dot' i bënj ata të vi-
njën' e të falenë përpara këmbëvet të tua,
10 edhe të njohënë se unë të desha ty. Sepse
ruajte fjalën' e durimit t'im, edhe unë dotë
të ruanj ty nga ora e ngasjesë që ka për të
ardhurë mbë gjithë botënë, që të provonjë
11 ata që rrinë mbi dhet. Na tek vinj çpejt;
mba atë që ke, që të mos marrë ndonjë ku-
12 rorënë t' ënde. Kush të muntnjë, atë dot' a
bënj shtyllë ndë tempullt të Perëndisë t'im,
edhe nukë dotë dalë më jashtë; edhe dotë
shkruanj mbi atë emërin' e Perëndisë t' im,
edhe emërin' e qytetit të Perëndisë t' im, të

Jerusalimit të-ri, që sbret prej qiellit nga Pe-
rëndia im, edhe emërinë t'im të-rinë.
13 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë
Fryma kishëvet.
14 Edhe ëngjëllit të kishës' së Llaodhiqeasvet
shkruaj,
Këto thot' ay që ësht' Amin, besëtari edhe
i-vërteti dëshmimtar, të-nisurit' e kriesës' së
15 Perëndisë; I di punërat' e tua, se as i-fto-
hëtë je as i-ngrohëtë; makar të ishnje i-fto-
16 hët' a i-ngrohëtë; Po passi je kështu i-va-
këtë, edhe as i-ftohët' as i-ngrohëtë, dotë të
17 vjell nga goja ime. Sepse thua, Se jam i-
pasurë, edhe ubësh' i-pasurë, edhe s' kam
nevojë as prej ndonjëj, edhe nuk' e di se ti
je i-ngratë, edhe i-mjerë, edhe i-vobek, edhe
18 i-verbërë, edhe i-sveshurë. Të këshillonj ty
të blesh prej meje ar të-provuarë ndë zjarr,
që të bënesh i-pasurë; edhe rroba të-bardha,
që t'i veshç, edhe të mos duketë turpëria e të-
sveshurit t' ënt; edhe lyej syt' e tu me kol-
19 lurë që të shohç. Unë *gjithë* sa i dua, i qër-
tonj edhe i mundonj; ki zili pra edhe pen-
20 dohu. Ja tek rri ndë derët edhe trokëllinj;
ndë dëgjoftë ndonjë zënë t' im, edhe hap de-
rënë, dotë hynj tek ay, edhe dotë darkonem
bashkë me atë, edhe ay bashkë me mua.
21 Ati që munt dot' i ap të rrijë bashkë me
mua ndë front t' im, sikundrë edhe unë mun-
da, edhe ndënja bashkë me t'im Atë ndë

front t' ati.
22 Ay që ka vesh, letë dëgjonjë ç' u thotë
Fryma kishëvet.

Krye 4.

1 Pas këtyre pashë, e ja një der' e-hapurë
ndë qiellt; edhe zër' i-parë, që dëgjova posi
zë trumbete që fliste bashkë me mua, thosh-
te; Hipë këtu, edhe dotë të dëftenj sa du-
hetë të bënenë paskëtaj.
2 Edhe përnjëhere arçë ndë frymë, edhe ja
tek ishtë një fron ndë qiellt, edhe mbi front
3 ishtë ndënjurë *një*; Edhe ay që rrinte gjantë
mbë të-parët me gur jaspidhe edhe sardhi-
ne; edhe *ishte* një ylver rreth fronit që gjantë
4 mbë të-paret me smaragdinë. Edhe përqark
fronit ishinë njëzet e katrë frone; edhe mbë
fronet (pashë) ndënjurë të njëzet e katrë
pleqtë, veshurë me rroba të-bardha; edhe
kishinë mbi krerët të tyre kurorë të-arta.
5 Edhe nga froni dilninë vetëtima e bumbul-
lima e zëra. Edhe përpara fronit ishinë shta-
të lambadha zjarri të-ndezura, të-cilatë janë
6 të shtatë frymat' e Perëndisë. Edhe përpara
fronit *ishte* një det i-qelqtë që gjante me
krystall; edhe ndë mest të fronit edhe rro-
tullë fronit katrë shtëzë, që ishinë plot me
7 sy përpara e prapa. Edhe shtëz' e-parë gjante
me leon, edhe shtëz' e-dytë gjante me viç,
edhe shtëz' e-tretë e kishtë faqenë posi nje-
ri, edhe shtëz' e-katërtë gjante me shqiponjë

BKSH

8 që fluturon. Edhe të katrë shtëzëtë kishinë
sicila veçan nga gjashtë krahë përqark, edhe
përbrënda ishinë plot me sy; edhe nukë pu-
shojnë dit' e natë dyke thënë, „Shënjt, shënjt,
shënjt është Zoti, Perëndi Gjithëpushte-
tësi," ay që ishte edhe që është edhe që
vjen.
9 Edhe kur t'i apënë shtëzëtë lavdi e nder
e të-falurë ndersë ati që ka ndënjurë mbi
10 front, që rron ndë jetët të jetëvet, Të njëzet
e katrë pleqtë dotë bjenë përpara ati që ka
ndënjurë mbi front, edhe dot' i falenë ati
që rron ndë jetët të jetëvet, edhe dotë vënë
kurorët' e tyre përpara fronit, dyke thënë,
11 I-vëjyerë je, o Zot, të marrç lavdin' e nderin'
e fuqinë; sepse ti i kriove të-gjitha, edhe për
dashurimnë t'ënt janë, edhe ukriuanë.

Krye 5.

1 Edhe pashë mbë të-djathtët t'ati që kishte
ndënjurë mbi front një vivli shkruarë për-
brënda e përjashta, vulosurë me shtatë vula.
2 Edhe pashë një ëngjëll të-fortë dyke lëçiturë
me zë të-math, Cili ësht' i-zoti të hapnjë vi-
3 vlinë edhe të sgithnjë vulat' e asaj? Edhe as-
ndonjë nukë muntte ndë qiellt, as mbi dhet,
as ndënë dhet, të hapnjë vivlinë, as t'a shohë
4 atë. Edhe unë qanjam shumë, sepse asndonjë
nuk' ugjënt i-zoti të hapnjë (e të këndonjë)
5 vivlinë, as t'a shohë atë. Edhe një nga pleq-

BKSH

të më thotë, Mos qaj; ja tek mundi leoni
që është prej farës' së Judhësë, rrënja e Dha-
vidhit, të hapnjë vivlinë, edhe të sgithnjë të
shtatë vulat' e asaj.
6 Edhe pashë, edhe ja ndë mest të fronit
edhe të katrë shtëzëvet, edhe ndë mest të
pleqvet, një Qënq që po rrinte posi i-therurë,
edhe që kishte shtatë brirë, edhe shtatë sy;
të-cilëtë janë të shtatë frymat' e Perëndisë
7 që janë dërguarë mbë gjithë dhenë. Edhe er-
dhi e mori vivlinë prej së-dhjathtës' s'ati që
kishte ndënjurë mbi front.
8 Edhe kur mori vivlinë, të katrë shtëzët'
edhe të njëzet e katrë pleqtë ranë përpara
Qëngjit, të-cilëtë kishinë gjithësicili qitharëra
e kupa t'arta mbushurë me thimiama, të-cilatë
9 janë të-falurat' e shënjtorëvet; Edhe këndo-
njënë një kënkë të-re, dyke thënë, I-vëjyerë
je të marrç vivlinë, edhe të hapç vulat' e asaj;
sepse uthere, edhe na çpërbleve te Perëndia
me gjakunë t'ënt, prej çdo fare e gjuhe e
10 llauzi e kombi; Edhe na bëre mbretër e priftër
te Perëndia ynë; edhe dotë mbretërojmë mbi
11 dhet. Edhe pashë, edhe dëgjova një zë shumë
ëngjëjsh përqark fronit edhe shtëzëvet edhe
pleqvet; edhe numëri i atyreve ishte dhjetë-
12 mijëra dhjetë-mijërash, e mijëra mijërash, Që
thoshninë me zë të-math, I-vëjyer' është Qën-
13 gji i-therurë të marrë fuqin' e bekimnë.—E-
dhe çdo kriesë që është ndë qiellt e mbi

BKSH

dhet, e ndënë dhet, e sa janë ndë dett, edhe
gjithë sa *janë* nd' ato, dëgjova që thoshinë, Mb'
atë që ka ndënjurë mbi front edhe mbë Qëngjinë
qoftë bekimi e nderi e lavdia e pushteti ndë jetët
14 të jetëvet. Edhe të katrë shtëzëtë thoshinë, Amin;
(edhe të njëzet e katrë) pleqtë ranë edhe
i ufalnë (ati që rron ndë jetët të jetëvet).

Krye 6.

1 Edhe pashë, kur hapi Qëngji njërënë nga
vulatë, edhe dëgjova një nga të katrë shtë-
zëtë që thoshte, posi *me* zë bumbullime, Eja
2 edhe shih. Edhe pashë, edhe ja një kal' i-
bardhë; edhe ay që kishte ndënjurë mbi atë
kishte një hark; edhe i udha ati një kurorë,
edhe dolli dyke mundurë, edhe që të muntnjë.
3 Edhe kur hapi vulën' e-dytë, dëgjova shtë-
4 zën' e-dytë, që thoshte, Eja (edhe shih). Edhe
dolli një tjatërë kalë i-kuq; edhe ati që kishte
ndënjurë mbi atë i udha të ngrerë paqtimnë
nga dheu, edhe të thernjënë njëri tjatërinë,
edhe i udha ati një thik' e-madhe.
5 Edhe kur hapi vulën' e-tretë, dëgjova të-
tretënë shtëzë që thoshte, Eja edhe shih. Edhe
pashë, edhe ja një kal' i-zi, edhe ay që kishte
ndënjurë mbi atë kishte një zigare ndë do-
6 rët të ti. Edhe dëgjova një zë ndë mest të
katrë shtëzëvet që thoshte, Një shënik gruri
për një dinar; edhe tre shënikë elbi për një
dinar; edhe, Vajit edhe verësë mos i bëj dëm·

BKSH

7 Edhe kur hapi vulën' e-katrëtë, dëgjova
zën' e së-katrësë shtëzë që thoshte, Eja edhe
8 shih. Edhe pashë, edhe ja një kal' i-ligurë, edhe
ay që kishte ndënjurë sipër' ati quhej Mortje,
edhe Hadhi i vinte prapa bashkë, edhe udha
ndër ata pushtet përmbi të-katrëtën' e dheut
të vrasënë me shpatë e me zi *buke* e me
vdekje, edhe me bishat' e dheut.
9 Edhe kur hapi vulën' e-pesëtë, pashë për-
posh theroresë shpirtërat' e atyreve që janë
therurë për fjalën' e Perëndisë, edhe për
10 dëshmiminë që kishinë; Edhe thërrisninë me
zë të-math, dyke thënë, Gjer kur, o Zotëni
i-shënjtëruar' e i-vërtetë, nukë gjykon edhe
nukë merr çpagiminë për gjakunë t'ënë nga
11 ata që rrinë mbi dhet? Edhe i udhanë gji-
thësicilit stolira të-bardha, edhe u utha atyreve
të prëhen' edhe pak kohë, gjersa të mbushen'
edhe bashkëshërbëtorët' e atyreve, edhe vë-
llezërit' e atyreve, ata që janë për të vrarë
sikundrë edhe ata.
12 Edhe pashë, kur hapi vulën' e-gjashtëtë;
edhe ja tek ubë një tërmet i-math, edhe dje-
lli ubë i-zi posi thes i-dhirë, edhe hëna u-
13 bë posi gjak; Edhe yjt' e qiëllit ranë mbë
dhet, posi drur' i fikut që heth fiqt' e-paa-
14 rrirë, kur tundetë prej ere së-madhe. Edhe
qielli uhoq posi vivli kur pështiletë, edhe
çdo mal e ujdhesë luajtnë nga vëndet' e tyre.
15 Edhe mbretërit' e dheut, e njerëzit' e-mëdhenj,

BKSH

e të-pasuritë, e kryemijësitë, e të-fortëtë, e-
dhe çdo shërbëtuar, edhe çdo i-lirë, fshehnë
vetëhen' e tyre ndëpër shpellat' e ndëpër
16 shkëmbënjt' e malevet, Edhe u thonë malevet
e shkëmbënjvet, Bini mbi ne, edhe fshih-na-ni
nga faqeja e ati që ka ndënjurë mbi front,
17 edhe nga zëmërata e Qëngjit; Sepse erdhi dit'
e-madhe e zëmëratës' s' ati; edhe cili munt
të qëndronjë?

Krye 7.

1 Edhe pastaj pashë katrë ëngjëj që rrininë
mbë të katrë çipat' e dheut, edhe mbaninë
të katrë erërat' e dheut, që të mos frynte
erë mbi dhet, as mbi dett, as mbë çdo dru.
2 Edhe pashë një tjatërë ëngjëll që hipi
nga të-lindurit' e djellit e që kishte vulën' e
Perëndis' së-gjallë; edhe u thërriti me zë të-
math të katrë ëngjëjvet, të-cilëvet u udha t'
3 u bënjënë dëm dheut edhe detit, E thoshte,
Mos i bëni dëm dheut, as detit, as drurëvet,
gjersa të vulosmë shërbëtorët' e Perëndisë
t'ënë ndë ballët t'atyreve.
4 Edhe dëgjova numërin' e atyreve që u-
vulosnë; një qint e dyzet e katrë mijë *ishinë*
të-vulosurë prej gjithë faravet të bijvet të
5 Israilit; Prej farës' së Judhësë, dy-mbë-dhjetë
mijë të-vulosurë; prej farës' së Rubinit, dy-
mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej farës' së
6 Gadit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; Prej

farës' s'Ashirit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulo-
surë; prej farës' së Nefthaliut, dy-mbë-dhjetë
mijë të-vulosutë; prej farës' së Manassehut,
7 dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; Prej farës'
së Simeonit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë;
prej farës' së Leviut dy-mbë-dhjetë mijë të-
vulosurë; prej farës' së Issaharit, dy-mbë-
8 dhjetë mijë të-vulosurë; Prej farës' së Zabu-
llonit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulosurë; prej
farës' së Josifit, dy-mbë-dhjetë mijë të-vulo-
surë; prej farës' së Beniaminit, dy-mbë-dhjetë
mijë të-vulosurë.

9 Pastaj pashë, edhe ja shumë gjindje, të-
cilënë asndonjë s'muntte t'a numëronte, prej
çdo kombi e farësh e llaużesh e gjuhërash, që
rrininë përpara fronit e përpara Qëngjit, veshu-
rë me stolira të-bardha, edhe mbaninë *dega*
10 hurmash ndër duart të tyre: Edhe thërrisninë
me zë të-math, e thoshinë, Shpëtimi është i Pe-
rëndisë t'ënë qe ka ndënjurë mbi front edhe
11 i Qëngjit. Edhe gjithë ëngjëjtë rrininë për-
qark fronit edhe pleqvet edhe të katrë shtë-
zëvet, edhe ranë përmbys përpara fronit, e
12 i ufalnë Perëndisë, Dyke thënë, Amin; be-
kimi e lavdia e dituria e të-faluritë ndersë
e nderi e fuqia e forca është mbë Perëndinë
t'ënë ndë jetët të jetëvet. Amin.

13 Edhe upërgjeq një nga pleqtë, e më tha,
Cilëtë janë këta që janë veshurë me stolira të-
14 bardha, edhe nga erthnë? Edhe i thash' ati,

BKSH

Zot, ti e di. Edhe më tha, Këta jan' ata që
vinjënë prej shtrëngimit të-math; edhe lanë
stolirat' e tyre, edhe sbarthnë stolirat' e tyre
15 ndë gjakt të Qëngjit. Përandaj janë përpara
fronit të Perëndisë, edhe e lusënë dit e natë
16 nde tempullt t'ati; edhe ay që ka ndënjurë mbi
front ka për të ndënjurë ndër ata. Nukë dotë
kenë më uri, as nukë dotë kenë më et, as
dotë bjerë djelli mbi ata, as çdo farë vape;
17 Sepse Qëngji që është ndër mest të fronit
dot' i ruanjë ata e dot' u heqnjë udhën' aty-
reve ndë burime ujërash të-gjalla; edhe Pe-
rëndia dotë fshinjë çdo lot nga syt' e aty-
reve.

Krye 8.

1 Edhë kur hapi të-shtattënë vulë, ubë ndë
qiellt pushim sindonja gjysmë ore.
2 Edhe pashë të shtatë ëngjëjtë, të-cilëtë
rrininë përpara Perëndisë edhe u udhanë a-
tyreve shtatë trumbeta.
3 Edhe erdhi një tjatërë ëngjëll, edhe qën-
droj mbi theroret, e mbante një tymtar të-
artë; edhe i udhanë ati shumë thimjama, që
t'i bjerë bashkë me të-falurat' e gjithë shënj-
torëvet mbë theroren' e-artë që *është* përpara
4 fronit. Edhe hipi tymi i thimiamavet me të-
falurat' e shënjtorëvet prej dorës' s' ëngjëllit
5 përpara Perëndisë; Edhe ëngjëlli mori tym-
tarinë, edhe e mbushi nga zjarri i theroresë

edhe e hodhi ndë dhet; edhe ubënë zëra e
bumbullima e vetëtima e tërmet.
6 Edhe të shtatë ëngjëjtë që kishinë të
shtatë trumbetatë ubënë gati që t'u bjenë
trumbetavet.
7 Edhe ëngëlli i-parë i ra trumbetësë, edhe
ubë breshër e-zjarr përzjerë me gjak, edhe
uhothnë ndë dhet; edhe e-treta e drurëvet u-
doq; edhe çdo bar i-njomë udoq.
8 Edhe ëngjëlli i-dytë i ra trumbetësë, edhe
posi një mal i-math që digjetë me zjarr u-
9 hoth ndë dett; Edhe e-treta e detit ubë gjak;
edhe vdiq e-treta e kriesavet të-gjalla që
ishinë nde dett; edhe e-treta e lundravet u-
prish.
10 Edhe ëngjëlli i-tretë i ra trumbetësë, edhe
ra nga qielli një yll i-math që digjej si llam-
badhë, edhe ra mbi të-tretën' e lumënjvet,
11 edhe mbi burimet' e ujëravet; Edhe emëri i
yllit quhetë Apsinth; edhe e-treta e ujëravet
ubë apsinth, edhe shumë njerës vdiqnë nga
ujëratë, sepse uhidhëruanë.
12 Edhe ëngjëlli i-katrëtë i ra trumbetësë,
edhe uplagos e-treta e djellit, edhe e-treta e
hënësë, edhe e-treta e yjvet, që të errësonet'
e-treta e atyreve, edhe dita të mos ndritnjë
të-tretën' e saj, edhe nata gjithashtu.
13 Edhe pashë, edhe dëgjova një ëngjëll që
fluturonte ndë mest të qiellit, që thoshte me
zë të-math, Mjerë, mjerë, mjerë ata që rrinë

BKSH

mbë dhet, për zëret' e-tjerë të trumbetës' së
të tre ëngjëjvet që dot' u bjenë trumbetavet.

Krye 9.

1 Edhe ëngjëlli i-pesëtë i ra trumbetësë, e-
dhe pashë se një yll kishte rënë nga qielli
mbi dhet, edhe i udha ati hapësi i pusit të
2 pafundjesë. Edhe hapi pusin' e pafundjesë;
edhe dolli tym nga pusi posi tym i një ka-
mine së-madhe; edhe uerrësua djelli edhe
3 era nga tymi i pusit. Edhe nga tymi duallë
karkaleca mbi dhet, edhe u udha atyreve pu-
4 shtet, sikundrë kanë përçollakët' e dheut. E-
dhe u utha atyreve të mos i bënjënë dëm
barit të dheut, as ndonjëj njomësire, as
ndonjëj druri, veç vetëmë njerësvet që
s'kanë vulën' e Perëndisë ndë ballët të tyre.
5 Edhe u udha atyreve të mos i vrasën' ata, po
të mundonenë pesë muaj; edhe mundimi i
atyreve *ishte* posi mundim përçollaku, kur
6 çupit njerinë. Edhe nd' ato dit njerëzitë do-
të kërkonjënë vdekjenë, edhe nukë dot'a gje-
njënë; edhe dotë dëshëronjënë të vdesënë,
7 edhe vdekja dotë ikënjë nga ata. Edhe nga
forma karkalecatë u shëmbëlleninë kuajve
që janë bërë gati për luftë; edhe mbi krerët
t' atyreve *kishinë* si kurora që gjaninë me ar,
edhe faqet' e atyreve ishinë posi faqe njerë-
8 zish. Edhe kishinë leshra posi leshra grash;
edhe dhëmbët' e atyreve *ishinë* posi të leonë-

9 vet. Edhe kishinë thurakë posi thurakë të-
hekurtë; edhe zëri i krahëvet t'atyre ishte po-
si zë qeresh me shumë kuaj kur sulenë ndë
10 luftë. Edhe kishinë bishtër që shëmbëllenine
me përçollakë, edhe thumba ishinë ndëpër
bishtërit t'atyreve;.edhe pushteti i atyreve ish-
11 te t'u bënjënë dëm njerësvet pesë muaj. Edhe
kishinë mbret përmbi vetëhet të tyre ëngjë-
llin' e pafundjesë; i-cili e ka emërinë Abadhon,
edhe ndë Gërqishtet e ka emërinë Apolion
[prishës].
12 Një mjerësi shkoj; ja tek po vinjënë e-
dhe dy paskëtaj.
13 Edhe ëngjëlli i-gjashttë i ra trumbetësë, e-
dhe dëgjova një zë nga të katrë brirët' e the-
14 rorës' s' artë që është përpara Perëndisë, Që
i thoshte të-gjashttit ëngjëll që kishte trum-
betënë, Sgith të katrë ëngjëjtë që janë li-
15 dhurë mbë lumin' e-math Efrat. Edhe u-
sgithnë të katrë ëngjëjtë që ishinë bërë gati
për orën' e për ditën' e për muajin' e për vi-
tinë, që të vrasënë të-tretën' e njerësvet.
16 Edhe numëri i ushtëtorëvet të kalorisë ishte
17 dy dhjetë - mijëra dhjetë - mijërash. Edhe kë-
shtu pashë kuajtë ndë të-pamët edhe ata
që rininë mbi ata, se kishinë thurakë prej
zjarri e prej jaqinthi e prej shqufuri; edhe
krerët' e kuajvet *ishinë* posi krerë leonësh,
edhe nga goj' e atyreve dilte zjarr e tym e
18 shqufur. Nga këta të trë uvranë e-treta e

BKSH

njerësvet, nga zjarri e nga tymi e nga shqu-
19 furi që dilte nga gojët' e atyreve, Sepse pu-
shtetet' e atyreve janë ndë gojët t' atyreve;
sepse bishtërit' e atyreve shëmbëlleninë me
gjërpënj, edhe kishinë krerë, edhe me ata
20 bëninë dëm. Edhe njerëzit' e-tjerë, ata që
nuk' uvranë me këto plagë, as nuk' upen-
duanë nga punërat' e duarvet të tyre, që të
mos u falenë djajvet, e idhujvet të-artë e të-
ergjënttë e të-ramtë e të-gurtë e të-drunjtë,
të-cilëtë s' muntnjën' as të shohënë, as të
21 dëgjonjënë, as të ecënjënë; Edhe nuk' upen-
duanë nga vrasjet' e tyre, as nga magjit' e
tyre, as nga kurvëria e tyre, as nga të-vje-
dhurat' e tyre.

Kyre 10.

1 Edhe pashë një tjatërë ëngëll të-fortë dy-
ke sbriturë nga qielli, të-veshurë me re; edhe
kishte ylver mbi kryet; edhe faqeja e ati
ishte posi djelli, edhe këmbët' e ati posi shty-
2 lla zjarri. Edhe kishte ndë dorët të ti një
vivlizë të-hapurë; edhe vuri këmbën' e ti të-
djathtënë mbi dett, edhe te-mëngjërënë mbi
3 dhet. Edhe bërtiti me zë të-math posi leoni
kur pëllet. Edhe kur bërtiti, folnë të shtatë
4 bumbullimatë me zërat' e tyre. Edhe kur fol-
në të shtatë bumbullimatë (me zërat' e tyre),
kishnjam për të shkruarë; edhe dëgjova një
zë nga qielli që (më) thoshte, Vulos ato që

BKSH

folnë të shtatë bumbulimatë, edhe mos i
5 shkruaj ato. Edhe ëngjëlli që pashë dyke
ndënjurë mbi dett edhe mbi dhet ngriti dorën'
6 e ti mbë qiellinë, Edhe bëri be për atë që rron
ndë jetët të jetëvet, i-cili krioj qiellin' edhe
sa janë nd' atë, edhe dhenë edhe sa janë
nd' atë, edhe detinë edhe sa janë nd' atë, se
7 kohë nukë dotë jetë më; Po ndë ditt të zërit
të ëngjëllit të-shtattë, kur dot' i bjerë trum-
betësë, atëhere dotë mbaronetë fshehësir' e
Perëndisë, sikundrë u'a kishte dhënë zën' e-
mirë shërbëtorëvet të ti profitër.
8 Edhe *ay* zëri që dëgjova nga qielli, përsëri
fliste me mua, e thoshte, Shko, e merr vi-
vlizën' e-hapurë ndë dorët t' ëngjëllit
9 që ka ndënjurë mbi dett e mbi dhet. E-
dhe vajta tek ëngjëlli, e i thashë, Ep-më vi-
vlizënë. Edhe *ay* më thotë, Merr-e, e-
dhe haj-e atë; edhe dotë hidhëronjë barkunë
t' ënt, po ndë gojët t' ënde dotë jet' e-ëm-
10 bëlë posi mjaltë. Edhe mora vivlizënë
nga dor' e ëngjëllit, edhe e hëngra; edhe i-
shte ndë gojët t' ime e-ëmbëlë posi mjaltë;
edhe kur e hëngra atë, uhidhërua barku im.
11 Edhe më thotë, Duhetë të profitepç përsëri për
shumë llauze e kombe e gjuhëra e mbretër.

Krye 11.

1 Edhe m' udha një kallam që gjante me
shkop; edhe ëngjëlli rrinte e *më* thoshte,

BKSH

Ngreu, edhe mat tempullin' e Perëndisë,
edhe therorenë, edhe ata që falenë nd' atë.
2 Po avllinë që është përjashta tempullit lër-e
jashtë, edhe mos e mat, sepse udha ndër
kombet; edhe qytetin' e-shënjtëruarë dot'a
shkelnjënë dyzet e dy muaj.
3 Edhe dot' u ap të dy dëshmimtarëvet të
mi, edhe dotë profitepsnjënë një mijë e dy
qint e gjashtë-dhjetë dit, veshurë me thasë.
4 Këta janë të dy drurët' e ullirit, edhe të dy
kandiletë që rrinë përpara Perëndis' së dheut.
5 Edhe ndë dashtë ndonjë t'u bënjë dëm aty-
reve, zjarr del nga goj' e atyreve, edhe ha
armiqt' e atyreve; edhe ndë dashtë ndonjë t'
u bënjë dëm atyreve, kështu duhetë të vritet'
6 ay. Këta kanë pushtet të mbyllnjënë qiellinë,
që të mos bjerë shi ndë ditt të profitis' s'
atyreve; edhe kanë pushtet mbi ujërat t' i
kthenjënë mbë gjak, edhe t'i bjenë dheut me
çdo farë plage, sa herë të duanë.
7 Edhe kur të mbaronjënë dëshmimn' e tyre,
bisha që del nga pafundja dotë bënjë luftë
me ata, edhe dot' i muntnjë, edhe dot' i vrasë.
8 Edhe kufomat' e atyreve *dotë dergjenë* mbi
rugët të qytetit të-math, që quhetë shpirtë-
rish Sodhomë edhe Egjyptë, ku edhe Zoti
ynë ukryqëzua.
9 Edhe prej llauzëvet e prej faravet e prej
gjuhëravet e prej kombevet *shume veta* dot'
i shohënë kufomat' e atyreve tri dit e gjys-

më, edhe nukë dotë lënë kufomat' e atyreve
10 të vihenë ndë varre. Edhe ata që rrinë mbi
dhet dotë gëzonenë për ata, edhe dotë gas-
monenë; edhe dotë dërgonjënë dhurëtira njëri
tjatërit; Sepse këta të dy profitër munduan'
ata që rrinë mbi dhet.
11 Edhe pas tri dit e gjysmë hyri mb' ata
frymë jete prej Perëndisë; edhe qëndruanë
mbë këmbët të tyre, edhe i mori frik' e-ma-
12 dhe ata që i shihninë. Edhe dëgjuanë një
zë të-math nga qielli që u thoshte atyreve,
Hipni këtu. Edhe hipnë ndë qiellt mbë ret;
13 edhe armiqt' e atyreve i panë ata. Edhe nd'
atë orë ubë një tërmet i-math, edhe e-dhjetta e
qytetit ra, edhe uvranë ndë tërmett shtatë
mijë emëra njerëzish; edhe të-tjerët' i mori
frika, edhe i dhanë lavdi Perëndis' së qiellit.
14 E-dyta mjerë shkoj: ja tek po vjen çpejt
e-treta mjerë.
15 Edhe i-shtatti ëngjëll i ra trumbetësë, e-
dhe ubënë zëre të-mëdhenj ndë qiellt që tho-
shinë, Mbretërirat' e botës' ubënë te Zotit t'
ënë, edhe të Krishtit t' ati, edhe dotë mbre-
tëronjë ndë jetët të jetëvet.
16 Edhe të njëzet e katrë pleqtë që rrininë
përpara Perëndisë mbi fronat të tyre ranë
me faqe përdhe, edhe i ufalnë Perëndisë,
17 Dyke thënë, Të falemi ndersë ty, o Zot, Pe-
rëndi Gjithëpushtetës, *i-cili je* ay që eshtë e-
dhe ay që ishte (edhe ay që vjen); sepse

more fuqinë t' ënde të-madhe, edhe mbretë-
18 rovë; Edhe kombet' uzëmëruanë, edhe erdhi
zëmërata jote, edhe koha e të-vdekuret, që
të gjykonenë, edhe t' u apç pagënë shërbë-
torëvet të tu profitër, edhe shënjtorëvet, edhe
atyreve që i kanë frikë emërit t' ënt, të-ve-
gjëlvet e të-mëdhenjvet, edhe të prishç ata që
prishnjënë dhenë.
19 Edhe uhap tempulli i Perëndisë ndë qiellt,
edhe uduk arka e dhjatës' s' ati ndë tem-
pullt t'ati; edhe ubënë vetëtima e zëra e büm-
bullima e tërmet e breshër i-math.

Krye 12

1 Edhe uduk një shënj' e-madhe ndë qiellt;
një grua që kishte veshurë djellinë, edhe hë-
na ishte përposh këmbëvet t' asaj, edhe mbi
kryet t' asaj *ishte* një kurorë dy-mbë-dhjetë
2 yjsh; Edhe passi ishte me barrë, bërtiste nga
të-dhëmburat' e barkut, e mundonej për të
pjellë.
3 Edhe uduk një tjetërë shënjë ndë qiellit,
edhe ja një dragua i-math *e* i-kuq, i-cili kishte
shtatë krerë e dhjetë brirë; edhe mbi kre-
4 rët t' ati shtatë kurorë; Edhe bishti i ati
hiqte të-tretën' e yjvet të qiellit, edhe i ho-
dhi ata ndë dhet. Edhe dragoj ndënji për-
para gruasë që kishte për të pjellë, që të
5 hante të birin' e asaj, kur te pillte. Edhe
polli një djalë mashkull, i-cili ka për të ku-

lloturë gjithë kombetë me shkop të-hekurtë;
edhe djal'i asaj urrëmbye te Perëndia edhe te
6 fron' i ati. Edhe gruaja iku ndë shkretëtirët,
ku kishte vënt të bërë gati nga Perëndia, që
t'a ushqenjënë atje një mij' e dy qint e gja-
shtë-dhjetë dit.
7 Edhe ubë luftë ndë qiellt; Mihaili edhe
ëngjëjt' e ati luftuanë kundrë dragojt, edhe
8 dragoj luftoj, edhe ëngjëjt' e ati. Edhe nukë
muntnë, as ugjënt vënt për ata ndë qiellt.
9 Edhe uhoth poshtë dragoj i-math, gjarpëri i-
moçim që quhetë djall, edhe Satanaj, ay që
kobon gjithë botënë, uhoth poshtë ndë dhet,
edhe ëngjëjt' e ati uhothnë *poshtë* bashkë me
10 atë. Edhe dëgjova një zë të-math që thoshte
ndë qiellt, Tashi ubë shpëtimi edhe fuqia e-
dhe mbretëria e Perëndisë t' ënë, edhe pu-
shteti i Krishtit t' ati; sepse uhoth *poshtë*
përfolësi i vëllezërvet t'anë, ay që përflet ata
11 përpara Perëndisë t'ënë nat' e ditë. Edhe ata e
muntnë atë për gjakun' e Qëngjit, edhe për
fjalën' e dëshmimit të tyre; edhe nuk' e desh-
12 në jetën' e tyre gjer mbë vdekje. Përan-
daj gëzohuni, o qiej, edhe ju që rrini nd'
ata. Mjerë (ata që rrinë) ndë dhet e nde
dett, se sbriti djalli te ju, dyke pasurë zë-
mërim të-math, sepse e di se ka pak kohë.
13 Edhe kur pa dragoj se uhoth *poshtë* ndë
14 dhet, ndoqi gruanë që polli mashkullinë. E-
dhe i udhanë gruasë dy krahë të shqiponjës'

BKSH

së-madhe, që të fluturonjë ndë shkretëtirët
ndë vëntt të saj, ku ushqenetë kohë edhe
kohëra edhe gjysmë kohe, *lark* nga faqeja e
15 gjarpërit. Edhe gjarpëri lëshoj prapa gruasë
nga goja e ti ujë posi lumë, që të bënjë që
16 t'a marrë atë lumi. Edhe dheu i ndihu gruasë,
edhe dheu hapi gojën' e ti, edhe e përpiu
17 luminë që lëshoj dragoj nga goj' e ti. Edhe
dragoj uzëmërua kundrë gruasë, edhe vate të
bënjë luftë bashkë me të-tjerët' e farës' s'
asaj që ruanjënë porosit' e Perëndisë edhe
që kanë dëshmimn' e Jisu (Krishtit).

Krye 13.

1 Edhe ndënja mbi rërët të detit; edhe pa-
shë një bishë që dilte nga deti, që kishte
shtatë krerë, e dhjetë brirë; edhe mbi brirët
t' asaj dhjetë kurorë, edhe mbi krerët t' a-
2 asaj një emërë vllasfimie. Edhe bisha që
pashë shëmbëllente me pardhall, edhe këm-
bët' e asaj ishinë posi t'ariut, edhe goj' e asaj
posi gojë leoni; edhe dragoj i dha asaj fu-
qin' e ti, edhe fronin' e ti, edhe pushtet të-
3 math. Edhe (pashë) një nga krerët' e asaj posi
të-plagosurë për vdekje; edhe plaga e asaj
për vdekje ushërua; edhe gjithë dheu uçudit
4 prapa bishësë. Edhe i ufalnë dragojt që i dha
pushtet bishësë, edhe i ufalnë bishësë, dyke
thënë, Kush i gjan bishësë? Kush munt të
luftonjë me atë?

BKSH

5 Edhe i udha asaj gojë që flet *fjalë* të-
mëdha edhe vllasfimira, edhe i udha asaj pu-
6 shtet të bënjë luftë dyzet e dy muaj. Edhe ha-
pi gojën' e saj mbë vllasfimi kundrë Perën-
disë, që të vllasfimisnjë emërin' e ati, edhe
tendën' e ati, edhe ata që rrinë ndë qiellt.
7 Edhe i udha asaj të bënjë luftë me shënjto-
rëtë, edhe t'i muntnjë; edhe i udha asaj pu-
8 shtet përmbi çdo farë e gjujë e komp. Edhe
dot' i falen' asaj gjith' ata që rrinë mbi dhet,
emërat' e të-cilëvet nukë janë shkruarë ndë
vivlit të jetës' së Qëngjit që është therurë që-
9 kur se është ngrehurë bota.—Kush ka vesh,
10 letë dëgjonjë.—Kush të bjerë *tjatërinë* ndë
skllavëri, ndë skllavëri dotë vejë; kush të
vrasë me thikë, duhetë *edhe* ay të vritetë me
thikë. Këtu është durimi edhe besa e shënj-
torëvet.
11 Edhe pashë një tjetërë bishë që dilte nga
dheu, edhe kishte dy brirë që shëmbëlleninë
12 me *brirë* qëngji, edhe fliste si dragua. Edhe
bënte gjithë pushtetin' e bishës' së-parë për-
para asaj; edhe bënte dhenë edhe ata që rrinë
mb' atë t'i falenë bishës' së-parë, së-cilësë
13 plaga për vdekje i ushërua. Edhe bënte shë-
nja të-mëdha, kaqë sa edhe zjarr bënte të
sbresë nga qielli mbi dhet përpara njerësvet.
14 Edhe kobonte ata që rrininë mbi dhet, për
shënjatë që i udhanë asaj të bënjë përpara
bishësë, e u thoshte atyreve që rrininë mbi

dhet t'i bënjën' ikonë bishësë që kishte pla-
15 gën' e thikësë, edhe rroj. Edhe i udha asaj t'i
apë frymë ikonës' së bishësë, kaqë sa edhe
të flasë ikon' e bishësë, edhe të bënjë që të
vriten' ata që s' i falen' ikonës' së bishësë.
16 Edhe bënte të-gjithë, të-vegjëlit' e të-më-
dhenjtë, edhe të-pasurit' edhe të-vobeqtë, edhe
të-lirët' edhe shërbëtorëtë, të marrënë një *shë-
një* të-gërvishturë mbë dorën' e tyre të-djath-
17 të, a mbë ballërat' e tyre; Edhe që të mos
muntte ndonjë të blerë a të shesë, përveç
ay që ka të-gërvishturitë, a emërin' e bishësë,
18 a numërin' e emërit t' asaj. Këtu është ditu-
ria; ay që ka mëndjenë *ndë kokë* letë bënjë
llogari numërin' e bishësë; sepsë është numër
njeriu, edhe numër' i asaj është gjashtë qint e
gjashtë-dhjet' e gjashtë.

Krye 14.

1 Edhe pashë, edhe ja një Qënq tek rrinte mbi
malt Sion, edhe bashkë me atë *ishinë* njëqint
e dyzet e katrë mijë që kishinë emërin' e Atit
2 t'ati të-shkruarë mbë ballërat' e tyre. Edhe dë-
gjova një zë nga qielli posi zë shumë ujërash,
edhe posi zë bumbullime së-madhe; edhe dë-
gjova një zë qitharorësh që qitharisninë me
3 qitharat' e tyre. Edhe këndoninë (posi) një
kënkë të-re përpara fronit, edhe përpara të
katrë shtëzëvët edhe pleqvet; edhe asndonjë
s' muntte të merrte vesh kënkënë, veç të një

BKSH

qint e dyzet e katrë mijëtë, që ishinë blerë
4 prej dheut. Këta jan' ata që nuk' undyrnë me
gra, sepse janë të-virgjërë; këta jan' ata që
i venë prapa Qëngjit kudo që të vejë; këta
ublenë nga njerëzitë, që të jenë pem' e-parë
5 te Perëndia edhe te Qëngji. Edhe ndë gojët
t' atyre nuk' ugjënt kobim, sepse janë pa të-
metë (përpara fronit të Perëndisë).
6 Edhe pashë një tjatër' ëngjëll dyke flutu-
ruarë ndë mest të qiellit, i-cili kishte ungji-
llin' e-përjetëshm, që t'ungjillëzonjë mb' ata
që rrinë mbi dhet, edhe mbë çdo komp e
7 farë e gjuhë e llaus; E thoshte me zë të-
math, Kini frikë Perëndisë, edhe epni lavdi
ati, sepse erdhi ora e gjyqit t' ati; edhe i u-
falni ati që bëri qiellin' e dhen' e detin' e bu-
rimet' e ujëravet.
8 Edhe një tjatër' ëngjëll vate prapa, e
thoshte, „Ra, ra Babillona," (qytet') i-math;
sepse ujiti gjithë kombetë me verën' e zëmë-
rimit të kurvëris' së saj.
9 Edhe një ëngjëll i-tretë vate prapa aty-
reve, dyke thënë me zë të-math, Kush t'i fa-
letë bishës' edhe ikonës' s' asai, edhe të-marrë
të-gërvishturë mbë ballën' e ti a mbë dorën'
10 e ti, Edhe ay dotë pijë nga vera e zëmëri-
mit të Perëndisë, që është derdhurë e-papër-
zjerë ndë potirt të zëmërimit t' ati; edhe dotë
mundonetë me zjarr e me squfur përpara ën-
gjëjvet të-shënjtëruar' edhe përpara Qëngjit.

BKSH

11 Edhe tymi i mundimit t'atyreve hipën ndë
jetët të jetëvet; edhe s'kanë të-prëjturë dit'
e natë ata që i falenë bishësë edhe ikonës'
s'asaj, edhe ay që merr të-gërvishturit' e e-
12 mërit t'asaj. Këtu është durimi i shënjtorë-
vet; këtu jan' ata që ruanjënë porosit' e Pe-
rëndisë edhe besën' e Jisujt.
13 Edhe dëgjova një zë nga qielli që (më)
thoshte, Shkruaj, Të-lumurë që tani jan' ata
të-vdekurë që vdesënë mbë Zotinë. Po, thotë
Fryma, që të prëhenë nga mundimet' e tyre;
edhe punërat' e atyre u venë prapa, bashkë
me ata.
14 Edhe pashë, edhe ja një re e-bardhë, edhe
mbi ret kishte ndënjurë *një* që shëmbëllente
me bir njeriu, edhe kishte mbi kryet të ti një
kurorë t'artë, edhe ndë dorët të ti një dra-
15 për të-prehëtë. Edhe një tjatër' ëngjëll dolli
nga tempulli dyke thërriturë me zë të-math
mb'atë që kishte ndënjurë mbi ret, Dërgo
drapërinë t'ënt, edhe korr; sepse (të) erdhi
ora të korrç, sepse utha të-korrët' e dheut.
16 Edhe ay që kishte ndënjurë mbi ret vuri dra-
përin' e ti mbi dhet; edhe dheu ukorr.
17 Edhe një tjatër' ëngjëll dolli nga tempulli
që ishte ndë qiellt, dyke pasur' edhe ay një
18 drapër të-prehëtë. Edhe një tjatër' ëngjëll dolli
nga theroreja, i-cili kishte pushtet mbi zjarrt;
edhe thërriti me zë të-math mb'atë që kishte
drapërin' e-prehëtë, dyke thënë, Dërgo drapë-

BKSH

rinë t'ënt të-prehëtë, edhe vil rrusht' e vesh-
19 tit të dheut, sepse uarrinë rrusht' e ati. Edhe
ëngjëlli vuri drapërin' e ti ndë dhet, edhe voli
veshtin' e dheut, edhe hodhi rrushtë ndë tirët
20 të-madhe të zëmërimit të Perëndisë. Edhe tira
ushtyp përjashta qytetit, edhe dolli gjak nga
tira gjer mbë frenjt të kuajvet, ndë një vënt
një mijë e gjashtë qint stadhesh.

Krye 15.

1 Edhe pashë një tjatërë shënjë ndë qiellt
të-madh' e të-çudiçime, shtatë ëngjëj, të-cilëtë
kishinë të shtatë plagët' e-pastajme, sepse
mb' ato umbarua zëmërimi i Perëndisë.
2 Edhe pashë posi një det të-qelqtë të-për-
zjerë me zjarr; edhe ata që muntnë bishën'
edhe ikonën' e asaj, (edhe shënjën' e asaj,)
edhe numërin' e emërit t'asaj, që po rrininë
mbi detin' e-qelqtë, edhe kishinë qitharat' e
3 Perëndisë; Edhe këndoninë kënkën' e Moi-
siut, shërbëtorit të Perëndisë, edhe kënkën'e
Qëngjit, dyke thënë, Të-mëdha e të-çudiçime
janë punët' e tua, o Zot, Perëndi Gjithëpu-
shtetës; të-drejta edhe të-vërteta *janë* udhët' e
4 tua, o mbret i shënjtorëvet. Cili nukë dotë
të ketë frikë ty, o Zot, edhe *nukë* dotë lav-
duronjë emërinë t'ënt? sepse *ti* vetëmë *je*
shënjt; sepse gjithë kombetë dotë vinjënë, e
dotë falenë përpara teje; sepse gjyqet' e tu
uçpërfaqnë.

BKSH

5 Edhe pastaj pashë, edhe ja tek uhap tem-
6 pulli i tendës' së dëshmimit ndë qiellt. Edhe
duallë nga tempulli të shtatë ëngjëjtë, që ki-
shinë të shtatë plagëtë, veshurë me li të-pas-
trët' e të-ndriçim, edhe ngjeshurë rreth krah-
rorëvet breza t'artë.
7 Edhe një nga të katrë shtëzëtë u dha të
shtatë ëngjëjvet shtatë botila t'arta mbushurë
me zëmërimin' e Perëndisë që rron ndë jetët
të jetëvet.
8 Edhe tempulli umbush me tym nga lav-
dia e Perëndisë, edhe nga fuqia e ati; edhe
asndonjë nukë muntte të hynte ndë tempullt,
gjer sa të mbaroneshinë të shtatë plagët' e
të shtatë ëngjëjvet.

Kyre 16.

1 Edhe dëgjova një zë të-math nga tem-
pulli qe u thoshte të shtatë ëngjëjvet, Shko-
ni e derthni botilat' e zëmërimit të Perëndisë
mbi dhet.
2 Edhe vate i-pari, edhe derdhi botilen' e
ti mbi dhet; edhe ubë një plag' e-keqe edhe
e-ligë mb' ata njerëzitë që kishinë të-gërvish-
turit' e bishësë, edhe mb' ata që i faleshin' i-
konës' s' asaj.
3 Edhe i-dyti ëngjëll derdhi botilen' e ti ndë
dett edhe ubë gjak posi gjak të-vdekuri; e-
dhe çdo frym' e gjallë që *ishte* ndë dett vdiq.
4 Edhe i-treti ëngjëll derdhi botilen' e ti

ndëpër lumënt e ndëpër burimet të ujëravet;
5 edhe ubë gjak.—Edhe dëgjova ëngjëllin' e ujë-
ravet që thoshte, I-drejtë je ti, (o Zot,) që je
ay që është edhe që ishte edhe Shënjti, se-
6 pse gjykove këto. Sepse derdhnë gjak shënj-
torësh edhe profitërsh, edhe gjak u dhe aty-
7 reve të pinë; sepse u vëjen atyreve. — Edhe
dëgjova (një tjatërë) nga theroreja që thoshte,
Po, o Zot, Perëndi Gjithëpushtetës, të-vërtetë
edhe të-drejtë janë gjyqet' e tu.
8 Edhe i-katërti ëngjëll derdhi botilen' e ti
mbi djellët; edhe i udha ati të djegë njerë-
9 zitë me zjarr. Edhe njerëzitë udoqnë me
një të-djegurë të-math, edhe shanë emërin' e
Perëndisë që ka pushtet mbi këto plagë; e-
dhe nuk' upenduanë që t'i apënë lavdi ati.
10 Edhe i-pesëti ëngjëll derdhi botilen' e ti
mbi front të bishësë; edhe uerrësua mbre-
tëria e asaj; edhe përtrypninë gjuhët' e tyre
11 nga të-dhëmburitë; Edhe shanë Perëndin' e
qiellit për të-dhëmburat' edhe për plagët' e
tyre, edhe nuk' upenduanë nga punërat' e
tyre.
12 Edhe i-gjashtëti ëngjëll derdhi botilen' e
ti mbi lumin' e-math Effrat; edhe ujët' e ati
utha, që të bënetë gati udha e mbretërvet
13 që janë nga të-lindurit' e djellit. Edhe pashë
tri fryma të-ndyra që shëmbëlleninë mbë
bretkosa, *që dilninë* nga goja e bishësë, edhe
14 nga goja e profitit gënjeshtar; Sepse janë

BKSH

fryma djajsh që bënjënë shënja, të-cilatë ve-
në te mbretërit' e (lheut edhe të) gjithë bo-
tësë, që të mbledhën' ata për luftën' e asaj
ditës' së-madhe të Perëndisë Gjithëpushtetës.
15 (Ja tek vinj posi vjedhës; lum ay që rri sgju-
arë, edhe ruan rrobat' e tia, që të mos ecë-
një sveshurë, e të shohënë të-shëmtuarët' e
16 ati.) Edhe i mblodhi ata nd' atë vënt qe
quhetë Ebraisht Armagjeddon.
17 Edhe i-shtatëti ëngjëll derdhi botilen' e ti
nd' erët; edhe dolli një zë i-math nga tem-
pulli i qiellit, nga froni, që thoshte, Umba-
18 rua. Edhe ubënë zëra e bumbullime e vetë-
tima, edhe ubë një tërmet i-math, që i-atillë
nuk' është bërë që kur se kanë qënë njerë-
zitë mbi dhet, një kaqë fort i-math tërmet.
19 Edhe qyteti i-math unda mbë tri pjesë, edhe
qytetet' e kombevet ranë. Edhe erdhi ndë kuj-
tim përpara Perëndisë Babilona e-madhe, që
t'i apë kupën' e verës' së zëmërimit të zëmë-
20 ratës' së ti. Edhe çdo ujdhesë iku, edhe ma-
21 letë s'ugjëntnë. Edhe një breshër i-math posa
një tallant sbriti nga qielli mbi njerëzit; edhe
njerëzitë shaninë Perëndinë për plagën' e bre-
shërit, sepse plag' e ati ishte fort e-madhe.

Krye 17.

1 Edhe erdhi një nga *ata* të shtatë ëngjëjtë
që kishinë të shtatë botilatë, edhe foli ba-
shkë me mua, e më tha, Eja, dotë të dëftenj

BKSH

gjyqin' e kurvës' së-madhe që ka ndënjurë
2 mbi ujërat të-shuma; Me të-cilënë kurvëruanë
mbretërit' e dheut, edhe udejtnë ata që rrinë
3 mbi dhet nga vera e kurvëris' s'asaj. Edhe më
shpuri me frymë ndë një vënt të-shkretë;
edhe pashë një grua që po rrinte mbi një
bishë të-kuqe, që ishte plot me emëra vlla-
sfimie, që e kishte shtatë krerë e dhjetë brirë.
4 Edhe gruaja ishte veshurë me porfirë e me
të-kuq, edhe përaruarë me ar e me gurë të-
çëmuarë e me margaritarë, e kishte ndë dorët
të saj një kupë të-artë mbushurë me ndyrë-
5 sira e më pëgërësira të kurvëris' së saj; Edhe
mbë ballët t' asaj ishte shkruarë një emër,
Fshehësirë, Babillona e-madhe, nëna e kurvavet
6 *edhe të ndyrësiravet të dheut.* Edhe pashë
gruanë dyke udejturë nga gjaku i shënjtorë-
vet, edhe nga gjaku i dëshmimtarëvet të Ji-
sujt. Edhe kur e pashë atë, uçudita me çudi
të-madhe.
7 Edhe ëngjëlli më tha, Përse uçudite? unë
dotë të them tyj fshehësirën' e gruasë, dhe
të bishësë që mban atë, e-cila ka të-shtatë
8 krerët' e të dhjetë brirëtë. — Bisha, të-cilënë
pe, ishte, edhe nuk' është, edhe dotë dalë nga
pafundja, edhe dotë vejë ndë humbje; edhe
dotë çuditen' ata që rrinë mbi dhet, emërat'
e të-cilëvet nukë janë shkruarë ndë vivlit të
jetësë që kur është ngrehurë bota, kur të sho-
hënë *atë* bishënë që ishte, edhe nuk' është,

9 ndonëse është. Këtu është mëndja që ka dituri.
Të shtatë krerëtë janë shtatë male, ku rri gru-
10 aja mbi ata. Edhe janë shtatë mbretër; të
pesëtë ranë, edhe njëri është, edhe tjatëri e-
dhe s'ka ardhurë; edhe kur të vinjë, pak ko-
11 hë duhetë të mbetetë. Edhe bisha që ishte,
edhe nuk' është, edhe ky është i-tetti *mbret*,
edhe është nga të-shtatëtë, edhe vetë ndë
12 humbje. Edhe të dhjetë brirëtë që pe, janë
dhjetë mbretër, të-cilëtë edhe s'kanë marrë
mbretëri, po marrënë pushtet posi mbretër një
13 orë bashkë me bishënë. Këta kanë një mëndje,
edhe dotë apënë ndë dorët të bishësë fuqin'
14 edhe pushtetin' e tyre. Këta dotë luftonjënë
me Qëngjinë, edhe Qëngji dot' i muntnj' ata,
sepse është Zot i zotërvet edhe Mbret i mbre-
tërvet; edhe ata *që janë* bashkë me atë janë
të-thërritur' e të-sgjedhur' e besëtarë.
15 Edhe më thotë, Ujëratë që pe *atje* ku rri
kurva, janë llauze e gjindje, e kombe e gju-
16 hëra. Edhe të dhjetë brirëtë, të-cilëtë pe mbi
bishët, këta dot' i kenë cmir kurvësë, edhe
dot'a bënjën' atë të-shkretë edhe lakuriq, e-
dhe dotë hanë mishrat' e asaj, edhe atë dot'a
17 djegënë ndë zjarr. Sepse Perëndia dha ndë
zëmërat t'atyreve të bënjënë mëndjen' e ati,
edhe të bënenë me një mëndje, edhe mbre-
tërin' e tyre t' j'a apënë bishësë, gjersa të-
18 mbaronenë fjalët' e Perëndisë. Edhe gruaja

që pe është qyteti i-math që ka mbretëri mbi
mbretërit të dheut.

Krye 18.

1 Edhe pastaj pashë një ëngjëll dyke sbri-
turë nga qielli, që kishte një pushtet të-math;
2 edhe dheu undrit prej lavdis' s' ati. Edhe bër-
titi (fort) me zë të-math, dyke thënë, „Ra, ra
Babillona„ e-madhe, edhe ubë të-ndënjurit'e
djajvet, edhe shtrofka e çdo fryme së-ndyre,
edhe shtrofka e çdo farë shpesi të-ndyrë e të-
3 mërziturë. Sepse nga vera e zëmërimit të kur-
vëris' s' asaj pinë gjithë kombetë, edhe mbre-
tërit'e dheut kurvëruanë bashkë me atë, edhe
tregëtarët' e dheut ubënë të-pasurë nga të-
tepërit'e shëfrimit t'asaj.
4 Edhe dëgjova një tjatërë zë nga qielli që
thoshte, Dilni prej asaj, llauzi im, që të mos
keni pjesë ndër fajet t'asaj, edhe të mos
5 merrni nga plagët' e asaj; Sepse fajet'e asaj
arritnë gjer mbë qiellt, edhe Perëndia kujtoj
6 paudhërit'e asaj. Çpagua-j'a-ni asaj, sikun-
drë edhe ajo u'a çpagoj (juve), edhe j'a çpa-
guani për një dy pas punëravet t'asaj; me
kupënë, me të-cilënë shtyri, shtini-i asaj për
7 një dy. Sa lavduroj vetëhen'e saj edhe ukë-
naq ndë shëfrimet, kaqë mundim e vajë ep-i-
ni asaj; sepse thotë me zëmërën' e saj, Po
rri mbretëreshë, edhe nukë jam e-ve, edhe
8 s' kam për të parë vajë.—Përandaj mbë një

BKSH

ditë dotë vinjënë plagët' e asaj, vdekje edhe
vajë edhe zi *buke*; edhe dotë digjetë ndë
zjarr, sepse i-fortë *është* Zoti, Perëndia, që
gjykon atë.
9 Edhe dotë qanjënë për atë edhe dotë
mbanjënë zi për atë mbretërit' e dheut, ata
që kurvëruan' edhe shëfryenë bashkë me atë,
kur të shohënë tymin' e të-djegurit t' asaj,
10 Dyke ndënjurë prej së-largu, nga frika e
mundimit t' asaj, e dyke thënë, Mjere, mjerë
ti qyteti i-math, Babillona, qyteti i-fortë, sep-
se për një orë erdhi gjyqi yt.
11 Edhe tregëtarët' e dheut qanjënë e bënjënë
vajë për atë, sepse asndonjë nukë ble më
12 barrët' e atyreve; Barrë ari e ergjëndi, e gu-
rësh të-çëmuarë, e margaritarësh, e pëlhure
së-hollë, e porfire, e mëndafshi e të-kuqeje;
edhe çdo dru me erë të-mirë, e çdo enë
prej kokalle elefandi, e çdo enë prej druje
së-paçëmuarë, e rame, e hekuri, e mermeri;
13 Edhe kanellë, e thimiamëra, e vaj ere, e li-
van, e verë, e vaj, e atherë mjelli, e grurë, e
bagëti, e dhën, e kuaj, e qere, e skllevër, e
14 shpirtëra njerëzish. Edhe pemët' e dëshërimit
të shpirtit t'ënt iknë prej teje, edhe gjithë të-
majmet' edhe të-ndrituratë iknë prej teje, e-
15 dhe më nukë dot' i gjenjç. Tregëtarët' e kë-
tyreve, që ubënë të-pasurë nga ajo, dotë rrinë
prej së-largu për frikën' e mundimit t'asaj,
16 dyke qarë e dyke bërë vaje, E dyke thënë,

Mjerë, mjerë qyteti i-math, që ishte vëshurë
me vishnje e me porfirë e me të-kuqe, edhe
përaruarë me ar e me gurë të-çëmuarë e me
margaritarë; sepse për një orë ushkretua
gjithë këjo pasje.
17 Edhe çdo zot anie, edhe gjithë sumica që
është mbi aniat, e detarë, e gjithë sa puno-
18 njënë detinë, ndënjnë prej së-largu, Edhe
bërtisninë, kur shihninë tymin' e të-djegurit
t'asaj, dyke thënë, Cili *qytet* ka qënë posi ky
19 qytet i-math? Edhe hothnë pluhur mbi kre-
rët të tyre, edhe bërtisninë dyke qarë e dy-
ke bërë vajë, e thoshninë, Mjerë, mjerë qy-
teti i-math, nde të-cilët ubënë të-pasurë nga
pasja e asaj gjith' ata që kishninë ania ndë
dett, sepse për një orë ushkretua.
20 Gëzohu për atë, o qiell, edhe ju apostojt'
e shënjtëruarë edhe profitëritë, sepse Perën-
dia gjykoj gjyqinë t'uaj kundrë asaj.
21 Edhe një ëngjëll i-fortë ngriti një gur po-
si gur mulliri të-math, edhe e hodhi ndë dett,
dyke thënë, Kështu dotë hidhetë me fërtymë
Babillona, qyteti i-math, edhe nukë dotë gjën-
22 detë më. Edhe zë qitharorësh e musikorësh
e fyellorësh e trumpetarësh nukë dotë dë-
gjonetë më te ti; edhe çdo mjeshtër prej çdo
farë mjeshtërie nukë dotë gjëndetë më te ti;
edhe zë mulliri nukë dotë dëgjonetë më te ti;
23 Edhe dritë kandileje nukë dotë ndritnjë më
te ti; edhe zë dhëndërri e nuseje nukë dotë

BKSH

dëgjonetë më te ti; sepse tregëtarët' e tu i-
shinë të-mëdhenjt' e dheut, sepse me magjinë
24 t'ënde ukobuanë gjithë kombetë. Edhe nd'atë
ugjënt gjak profitërsh e shënjtorësh edhe të
gjith' atyreve që janë therurë mbi dhet.

Krye 19.

1 Edhe pastaj dëgjova posi një zë të-math
shumë gjindjeje ndë qiellt që thoshte, Alilluja,
shpëtimi e lavdia e nderi e fuqia *qoftë* mbë
2 (Zotinë) Perëndinë t'ënë; Sepse gjykoj kurvën'
e-madhe që prishi dhenë me kurvërin' e saj,
edhe mori çpagim prej dorës' s'asaj për gja-
3 kun' e shërbëtorëvet të ti. Edhe për-së-dyti
thanë, Alilluja. Edhe tymi i asaj hipën ndë
4 jetët të jetëvet. Edhe ranë të njëzet e katrë
pleqtë, edhe të katrë shtëzëtë, e i ufalnë Pe-
rëndisë që rrinte mbi front, dyke thënë, A-
5 min; Alilluja. Edhe dolli nga froni një zë që
thoshte, Lavduroni Perëndinë t'ënë, gjithë ju
shërbëtorët' e ati, ju që i keni frikë ati, edhe
të-vegjëlit' e të-mëdhenjtë.
6 Edhe dëgjova posi një zë shumë gjindjeje,
edhe posi një zë shumë ujërash, edhe posi
një zë bumbullimash të-forta, që thoshinë, Ali-
lluja; se mbretëroj Zoti, Perëndia Gjithëpu-
7 shtetës. Letë gëzonemi, e letë gasmonemi, e let'
i apëmë ati lavdinë, sepse erdhi dasma e Qën-
gjit, edhe gruaja e ati bëri gati vetëhen' e saj.
8 Edhe i udha asaj të vishetë me vishnje të-

BKSH

pastrëtë e të-ndriturë; sepse vishnjeja është
të-drejtat'e shënjtorëvet.
9 Edhe më thotë, Shkruaj, Lum ata që janë
ftuarë ndë dasmët të Qëngjit. Edhe më thotë,
Këto janë fjalët'e-vërteta të Perëndisë.
10 Edhe rashë përpara këmbëvet t'ati që t'i
falem; edhe *ay* më thotë, Vështro, semos bënjç
këtë; *sepse* unë jam bashkëpunëtori yt edhe
i vëllezërvet të tu që kanë dëshmimn'e Ji-
sujt; *po* fal-i-u Perëndisë; sepse dëshmimi i
Jisujt është fryma e profitisë.
11 Edhe pashë qiellinë të-hapurë, edhe ja një
kal' i-bardhë, edhe ay që rrinte mb'atë qu-
hej Besëtar edhe i-Vërtetë, edhe me drejtëri
12 gjykon e lufton. Edhe syt' e ati *ishinë* posi
flakë zjarri, edhe mbi kryet t'ati *kishte* shu-
më kurorë; edhe kishte një emër të-shkruarë,
13 të-cilinë asndonjë s'e di veç ay. Edhe ishte
veshurë me një rrobë ngjyerë ndë gjak; edhe
14 emër' i ati quhetë *Fjala e Perëndisë*. Edhe
ushtëritë që ishinë ndë qiellt i vininë prapa
hipurë mbi kuaj të-bardhë, e veshurë me
15 vishnje të-bardhë edhe të-pastrëtë. Edhe prej
gojës' s'ati dilte një shpat' e-prehëtë, që t'u
bjerë kombevet me atë; edhe ay „dot' i ku-
llosnjë ata me shkop të-hëkurtë;" edhe ay
shkel tirën' e verës' së zëmërimit edhe të zë-
16 mëratës' së Perëndisë Gjithëpushtetës. Edhe
mbi rrobët e mbi kofshët të ti ka të-shkruarë
emërinë, *Mbret i mbretërvet edhe Zot i zotërvet*.

BKSH

17 Edhe pashë një ëngjëll që rrinte ndë dje-
llët; edhe thërriti me zë të-math, dyke thënë
gjithë shpesvet që fluturonjënë ndë mest të
qiellit, Ejani edhe mblidhuni ndë darkët të
18 Perëndisë të-math, Që të hani mishra mbre-
tërsh, e mishra kryemijësve, e mishra të-for-
tësh, e mishra kuajsh edhe t'atyreve që ka-
në ndënjurë mbi ata, edhe mishra të të-gji-
thëve, të-lirëve e shërbëtorëve, edhe të-ve-
gjëlve e të-mëdhenjve.
19 Edhe pashë bishënë edhe mbretërit' e dheut,
edhe ushtërit' e atyreve mbledhurë, që të bë-
ninë luftë me atë që rrinte mbi kallët, edhe
20 me ushtërin' e ati. Edhe uzu bisha, edhe ba-
shkë me atë profiti gënjeshtar, ay që bëri shë-
njatë përpara asaj, me të-cilatë koboj ata që
muarnë të-gërvishturit' e bishësë, edhe ata
që i ufalnë ikonës' s' asaj; të-gjallë uhothnë
që të dy ndë lëqert të zjarrit që digjetë me
21 squfur. Edhe të-tjerët' uvranë me shpatën'
e ati që rrinte mbi kallët, e-cila dilte prej
gojës' s'ati; edhe gjithë shpest' unginjnë nga
mishrat' e atyreve.

Krye 20.

1 Edhe pashë një ëngjëll dyke sbriturë nga
qielli, i-cili kishte hapësin' e pafundjesë, edhe
2 një vark të-math ndë dorët të tij. Edhe zuri
draguanë, gjarpërin' ë-moçim, i-cili është Djalli
edhe Satanaj; edhe e lidhi atë një mijë vjet.

3 Edhe e hodhi ndë pafundjet, edhe e mbylli,
edhe vuri vulë sipër' ati, që të mos kobonjë
më kombetë, gjersa të mbaronenë të një mijë
vjettë; edhe paskëtaj duhetë të sgidhetë për
pak kohë.
4 Edhe pashë frone; edhe ndënjnë mbi ata,
edhe gjyq udha ndër ata; edhe pashë shpir-
tërat' e atyreve që ishinë therurë për dësh-
mimin' e Jisujt, edhe për fjalën' e Perëndisë,
edhe të-cilëtë nuk' i ufalnë bishësë, as ikonës'
s'asaj; edhe nukë muarnë të gërvishturitë
mbi ballët të tyre edhe mbi dorët të tyre;
edhe rruan' e mbretëruanë bashkë me Kri-
5 shtinë ata të një mijë vjettë. Edhe të vdekurit'
e-tjerë nuk' ungjallnë, gjersa të mbushenë të
një mijë vjettë; këta është të-ngjallurit' e-parë.
6 I-lumur' edhe shënjt ësht' ay që ka pjesë ndë
të-ngjallurit të-parë; mbi këta vdekj' e-dytë
s'ka pushtet, po dotë jenë priftër të Perën-
disë, edhe dotë mbretëronjënë bashkë me atë
një mijë vjet.
7 Edhe kur të mbaronenë të një mijë vjëttë,
8 dotë sgidhetë Satanaj nga burgu i ti. Edhe
dotë dalë të kobonjë kombetë që gjëndenë
mbë të katrë anët' e dheut, Gogun' e Mago-
gunë, që t'i mbledhë ata për luftë, numër' i
9 të-cilëvet është posi rër' e detit. Edhe hipnë
mbë të-gjerët' e dheut, edhe qerthëlluanë ush-
tërin' e shënjtorëvet, edhe qytetin' e-dashurë;
edhe shbriti zjarr prej qiellit nga Perëndia,

BKSH

10 edhe i hëngri. Edhe djalli që kobonte ata, u-
hoth ndë lëqert të zjarrit e të squfurit; ku ishte
bisha edhe profiti gënjeshtar; edhe dotë mun-
donenë dit' e natë, ndë jetët të jetëvet.
11 Edhe pashë një fron të-bardhë e të-math,
edhe atë që rrinte mb' atë, prej faqes' së të-
cilit iku dheu edhe qielli; edhe nuk' ugjënt
12 vënt për ata. Edhe pashë të-vdekuritë, të-
vegjël' e të-mëdhejn, rrininë përpara Pe-
rëndisë, edhe vivliat' uhapnë; edhe uhap një
vivli tjatërë, e-cila ësht' e jetësë; edhe ugjy-
kuanë të-vdekuritë nga ato që ishinë shkru-
13 arë ndë vivliat, pas punëravet të tyre. Edhe
deti dha të-vdekuritë që ishinë nd' atë, edhe
mortja edhe hadhi dhanë të-vdekuritë që i-
shinë ndër ata; edhe ugjykuanë gjithësicili
14 pas punëravet të tyre. Edhe mortja edhe ha-
dhi uhothnë ndë lëqert të zjarrit; këjo është
15 vdekj' e-dytë. Edhe ay që s' ugjënt shkruarë
ndë vivlit të jetësë, uhoth ndë lëqert të zjarrit.

Krye 21.

1 Edhe pashë një qiell të-ri edhe një dhe
të-ri; sepse qielli i-parë edhe dheu i-parë
2 shkoj; edhe deti nuk' është më. Edhe (unë Jo-
ani) pashë qytetin' e-shënjtëruarë, Jerusalimën'
e-re, dyke sbriturë prej qiellit nga Perëndia,
q' ishte bërë gati posi nuse e-stolisurë për
3 burrin' e saj. Edhe dëgjova një zë të-math
nga qielli që thoshte, Ja tenda e Perëndisë

bashkë me njerëzitë, edhe dotë rrijë bashkë
me ata, edhe ata dotë jenë llauzi i ati, edhe
Perëndia vetë dotë jetë baskkë me ata Pe-
4 rëndi i atyreve. Edhe (Perëndia) dotë fshijë
çdo lot nga syt'e atyreve, edhe vdekja nukë
dotë jetë më; as vajë, as të-bërtiturë, as të-
dhëmburë nukë dotë ketë më; sepse të-pa-
ratë shkuanë.
5 Edhe tha ay që kishte ndënjurë mbi front,
Ja të-gjitha tek i bënj të-ra. Edhe më thotë,
Shkruaj; sepse këto fjalë janë të-vërteta edhe
6 të-besuara. Edhe më tha, Umbarua; unë jam
Allfa edhe Omega, të-nisurit'edhe të-mbaru-
arëtë. Unë dot' i ap dhurëti ati që ka et nga
7 burimi i ujit të jetësë. Ay që munt dotë tra-
shëgonjë të-gjitha, edhe dot' i jem Perëndi,
8 edhe ay dotë më jetë bir. Edhe frikacarët' e
të-pabesët' e të-ndyrët' e vrasësit' e kurvarët'
e magjistarët' e idhullatrët' e gjithë gënjeshta-
rëtë *dotë kenë* pjesën' e tyre ndë lëqert që
digjetë me zjarr e me squfur; këjo është vdekj'
e-dytë.
9 Edhe erdhi tek unë një nga të shtatë ën-
gjëjtë që kishinë të shtatë botilatë mbushurë
me të shtatë plagët' e-pastajme, edhe foli
bashkë me mua, dyke thënë, Eja, dotë të
10 dëftenj tyj nusenë, gruan'e Qëngjit. Edhe më
shpuri me frymë ndë një mal të-math e të-
lartë, edhe më dëfteu qytetin' (e-math), Jeru-
salimën' e-shënjtëruarë, dyke sbriturë prej qi-

BKSH

11 ellit nga Perëndia, Që kishte lavdin' e Pe-
rëndisë; edhe të-ndriturit' e asaj shëmbëllente
me gur fort të-çëmuarë, posi me gur jaspi-
12 dhe që shkëlqente si krystall. Edhe kishte një
mur të-math e të-lartë; kishte edhe dy-mbë-
dhjetë porta, edhe mbi portat dy-mbë-dhjetë
ëngjëj, edhe emëra të-shkruarë përsipër, të-
cilëtë janë *emërat'* e të dy-mbë-dhjetë faravet
13 të bijvet të Israilit. Nga ana që lint djelli, tri
porta, nga an' e borësë, tri porta; nga an' e
mesditësë, tri porta; nga an' e perëndimit, tri
14 porta. Edhe muri i qytetit kishte dy-mbë-
djetë themele, edhe nd' ata *ishin'* emërat' e të
dy-mbë-dhjetë apostojvet të Qëngjit.
15 Edhe ay që fliste bashkë me mua kishte
një kallam t'artë, që te matte qytetin' edhe
16 portat' e ati edhe murin' e ati. Edhe qyteti
ishte me katrë çipa, edhe ishte sa i-gjatë, kaqë
edhe i-gjerë; edhe mati qytetinë me kallamnë,
gjer mbë dy-mbë-dhjetë mijë stadhe; të-gja-
tët' e të-gjerët' e të-lartët' e ati janë si-një-një.
17 Edhe mati murin' e ati, një qint e dyzet e
katrë kut, pas masës' së njeriut, do-me-thënë,
18 të ëngjëllit. Edhe ndërtesa e murit t'ati ishte
jaspidhë; edhe qyteti ar i-kulluarë që shëm-
19 bëllente me qelq të-kulluarë, Edhe themelet'
e murit të qytetit *ishinë* stolisurë me çdo fa-
rë gurësh të-çmuarë; themel' i-parë *ishte* a-
spidhë; i-dyti, sapfir; i-treti, halqidhon; i-ka-
20 tërti, smaragdh; i-pesëti, sardhonik; i-gjashtëti,

sardhi; i-shtatti, gur ari; i-tetti, viryl; i-nëntti,
topaz; i-dhjetti, krysopras; i-një-mbë-dhjetti,
21 jaqinth; i-dy-mbë-dhjetti, amethyst. Edhe të
dy-mbë-dhjetë portat' ishinë dy-mbë-djetë
margaritarë, gjithësicila portë ishte prej një
margaritari; edhe udh' e qytetit *ishte* ar' i-
kulluarë, posi qelq i-ndëpërdukshim.
22 Edhe tempull nukë pashë nd' atë; sepse
tempull' i ati është Zoti, Perëndia.Gjithëpushte-
23 tës, edhe Qengji. Edhe qyteti s'ka nevojë prej
djelli, as prej hëne, që të ndritnjënë nd' atë;
sepse lavdia e Perëndisë e ndriti atë, edhe
24 kandilej' e asaj është Qëngji. Edhe kombet'
(e të shpëtuarëvet) dot' ecënjënë ndë dritët
t'ati; edhe mbretërit' e dheut bjenë lavdin' e
25 nderin'e tyre mb' atë. Edhe portat'e ati nukë
dotë mbyllenë ditënë; sepse natë nukë dotë
26 ketë atje. Edhe dotë bjenë lavdin' edhe nde-
27 rin' e kombevet mb' atë. Edhe nukë dotë hy-
një nd' atë asndonjë *gjë* që pëgër e bje ndy-
rësi, e gënjeshtrë; po vetëm' ata që janë shkru-
arë ndë vivlit të jetës' së Qëngjit.

Krye 22.

1 Edhe më dëfteu një lumë (të kulluarë) me
ujë të jetësë, të-shkëlqyerë posi krystall, që
dilte prej fronit të Perëndisë edhe të Qëngjit.
2 Ndë mest të udhës' *së qytetit*, edhe mbë kët'
anë e mb' at' anë të lumit, ishte drur' i jetësë
që ep dy-mbë-dhjetë pemë, dyke bërë mbë
çdo muaj pemën' e ti; edhe fletët' e drurit

3 *janë* për shërim të kombevet. Edhe asndonjë
mallëkim nukë dotë ketë më: edhe froni i
Perëndisë edhe i Qëngjit dotë jetë nd' atë;
edhe shërbëtorët' e ati dot'a adhuronjënë atë.
4 Edhe dotë shohënë faqen' e ati, edhe emëri
5 i ati dotë jetë mbi ballërat t'atyre. Edhe natë
nukë dotë ketë atje; edhe s'kanë nevojë prej
kandileje e prej drite djelli, sepse Zoti, Pe-
rëndia, i ndrit ata; edhe dotë mbretëronjënë
ndë jetët të jetëvet.
6 Edhe më tha, Këto fjalë *janë* të-besuara
edhe të-vërteta; Edhe Zoti, Perëndia i profi-
tërvet të-shënjtëruarë, dërgoj ëngjëllin' e tij,
që t'u dëftenjë shërbëtorëvet të ti sa duhetë
të bënenë për-së-çpejti. —Ja tek vinj çpejt;
7 lum ay që ruan fjalët' e profitis' së kësaj vivlie.
8 Edhe unë Joani jam ay që pashë e dë-
gjova këto; edhe kur dëgjova edhe pashë,
rashë të falem përpara këmbëvet t' ëngjëllit
9 qe më dëftente këto. Edhe *ay* më thotë, Vësh-
tro semos *bënjç këtë*; sepse jam bashkëshër-
bëtori yt, edhe i vëllezërvet të tu profitër,
edhe i atyreve që ruanjënë fjalët' e kësaj vi-
vlie; *po* fal-i-u Perëndisë.
10 Edhe më thotë, Mos vulosç fjalët' e pro-
fitis' së kësaj vivlie; sepse koha është afërë.
11 Ay që bën paudhëri, letë bënjë paudhëri
edhe më; edhe ay që është i-shgërryerë, letë
shgërrynet' *edhe* më; edhe i-drejti letë bënet'
i-drejtë edhe më; edhe i-shënjtëruari letë
12 shënjtëronet' edhe më. Edhe ja tek vinj çpejt;

edhe paga ime *është* bashkë me mua, që t'j'a
paguanj gjithësicilit sikundrë dotë jetë pun' e
13 ati. Unë jam Allfa e Omega, të-nisurit' edhe
të-mbaruarëtë i-pari edhe i-pastajmi.
14 Lum ata që bënjënë porosit' e ati, që të
kenë pushtet mbë drurin' e jetësë, edhe me
15 anë të portavet të hynjënë ndë qytett. Edhe
jashtë janë qënt' e magjistarët' e kurvarët' e
vrasësit' e idhullatrëtë, edhe kushdo qe do e
16 bën gënjeshtrënë. Unë Jisuj e dërgova ëngjë-
llinë t'im që të dëshmonjë ndër ju për këto
ndëpër kishët; unë jam rrënja edhe fara e
Dhavidhit, ylli i-ndriçim edhe i mëngjesit.
17 Edhe Fryma edhe nuseja thonë, Eja; edhe
ay qe dëgjon, letë thotë, Eja; edhe ay që ka
et, letë vinjë; edhe ay që do, letë marrë dhu-
rëti ujët' e jetësë.
18 (Sepse) ap dëshmim mbë gjithësicilinë që
dëgjon fjalët' e profitis' së kësaj vivlie. Nde
shtoftë ndonjë mbë këto, Perëndia dot' i shto-
një ati plagëtë *që janë* shkruarë ndë këtë
19 vivli. Edhe ndë heqtë ndonjë *njeri* nga fjalët
e vivlis' së kësaj profitie, Perëndia dotë heq-
një pjesën' e ati nga vivlia e jetësë, edhe nga
qyteti i-shënjtëruarë, edhe nga ato që janë
shkruarë ndë këtë vivli.
20 Ay që dëshmon për këto thotë, Po vinj
çpejt, Amin, po eja, o Zoti Jisu.
21 Hiri i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë* bashkë
me ju të-gjithë. Amin.

FUNT.

BKSH

BKSH

BKSH
1989

BKSH

BKSH